



**RAPORT AUDITIMI**  
**MBI**  
**(Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë)**  
**në**

**BASHKIA ELBASAN**

**Tiranë, 2024**

# **PËRMBAJTJA**

<b><u>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</u></b> .....	4
<b><u>1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit</u></b> .....	4
<b><u>2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve</u></b> .....	11
<b><u>3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit</u></b> .....	13
<b><u>II. HYRJA</u></b> .....	14
<b><u>1. Objektivat e auditimit</u></b> .....	14
<b><u>2. Qëllimi i auditimit</u></b> .....	14
<b><u>3. Identifikimi i çështjes</u></b> .....	15
<b><u>4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese</u></b> .....	15
<b><u>5. Përgjegjësitë e audituesve</u></b> .....	15
<b><u>6. Kriteret e vlerësimit</u></b> .....	16
<b><u>7. Standardet e auditimit</u></b> .....	16
<b><u>8. Metodologjia e auditimit</u></b> .....	16
<b><u>9. Dokumentimi i auditimit</u></b> .....	16
<b><u>III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</u></b> .....	17
<b><u>1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin - Bashkia Elbasan</u></b> .....	17
<b><u>2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit</u></b> .....	17
<b><u>1 Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.</u></b> .....	18
<b><u>2 Mbi planifikimin dhe zbatimin e PBA-së dhe buxhetit vjetor për vitin 2022.</u></b> .....	44
<b><u>3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2022.</u></b> .....	80
<b><u>4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.</u></b> .....	107
<b><u>4.1 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.</u></b> .....	177
<b><u>5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit të Bashkisë Elbasan</u></b> .....	195
<b><u>6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore.</u></b>	217
<b><u>IV. GJETJE DHE REKOMANDIME</u></b> .....	226

## Lista e shkurttimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

## 1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Auditimi mbuloi çështjet kryesore të veprimtarisë së Bashkisë Elbasan si: menaxhimi financiar dhe kontrolli, auditimi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, të ardhurat, vlerësimi i pasqyrave financiare, planifikimi dhe zhvillimi i procedurave të prokurimit publik, zbatimi i kontratave të punimeve në investimet publike, administrimi i aseteve, shfrytëzimi për veprimtari ekonomike të fondit pyjor si dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm. Për analizimin dhe vlerësimin e aktivitetit të subjektit sipas pikave të planifikuara në programin e auditimit, grupi i auditimit vlerësoi sistemet e kontrollit të brendshëm dhe analizozi të gjitha evidencat e grumbulluara gjatë kryerjes së auditimit në terren sipas çështjeve përkatëse.

Në përfundim të punës audituese në terren, grupi i auditimit ka mbajtur dhe protokolluar në Bashkinë Elbasan 15 akt konstatime dhe 4 akt verifikim. Mbi akt konstatimet dhe akt verifikimet e mbajtura nga grupi i auditimit si dhe mbi Projekt Raportin e Auditimit janë paraqitur observacione nga Bashkia Elbasan të cilat janë trajtuar në përputhjeve me përcaktimet e Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH-së. Gjithashtu, në ambientet e KLSH-së më datë 29.01.2024 ishte caktuar për tu zhvilluar takimi përfundimtarë me përfaqësuesit e Bashkisë Elbasan, takim i cili nuk u zhvillua pasi subjekti me emailin e datës 30.01.2024 nuk e pa të arsyeshme zhvillimin e këtij takimi.

## 2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje e gjetjeve	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të studimit Tekniko - ekonomik së bashku me anekset e përcaktuara dhe nga verifikimet për zbatimin e udhëzimit nr.1, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të Fondit Pyjor dhe Kulloror Publik”, nuk ka dalë asnjë VKM për heqjen nga Fondi Pyjor/Kulloror për 12 hektar shfrytëzim nga subjekti ekonomik “Y.S” SHPK, aq më tepër të kemi dhe një ndryshim të zërit kadastral për këto 12 hektar. Nisur nga QKB si dhe duke parë aktivitetin dhe pagesën e taksave të subjektit “Y.S” SHPK me NIPT L.....T, ndër to dhe Tarifën për Mbrojtjen dhe Përmirësimin e Mjedisit siç referohet nga Inspektoriati i Mjedisit të Bashkisë Elbasan, duket qartë që ky subjekt ekonomik, po ushtron aktivitet të plotë duke shfrytëzuar lejen minerare shfrytëzimi PN-3593-05-2012 që prej vitit 2013. Konkluzioni është që ky subjekt po ushtron veprimtarinë ekonomike duke shfrytëzuar sipërfaqen prej 12 hektarësh, pa pasur një kontratë përdorimi të Fondit Pyjor/Kulloror të këtyre 12 hektarëve në pronësi të Bashkisë Elbasan, që prej vitit 2012.</p> <p>B - Për subjektin “SH.G” SHPK me NIPT K.....D Nga auditimi është konstatuar se në dosje administrohen disa kontrata qiraje 1 vjeçare për përdorimin e fondit pyjor/kulloror me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, për vitin 2007, si dhe me Komunën</p>	E lartë	<p>Nga Bashkia Elbasan, të merren masa në mënyrë të menjëhershme që të bllokohet aktiviteti ekonomik i këtyre guroreve, deri në momentin e përfundimit të procedurave ligjore, në lidhje me heqjen nga fondi pyjor dhe ndryshimi i zërit kadastral i sipërfaqeve përkatëse të guroreve të sipërcituara. Gjithashtu, para momentit të zhbllokimit, pasi të jenë kryer të gjitha procedurat ligjore për heqjen nga fondi pyjor, Bashkia Elbasan të bëjë një vlerësim për dëmin e shkaktuar nga përdorimi i paligjshëm i sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kulloror, dhe t’jua faturojë subjekteve përkatëse private.</p>

	<p>Shushicë për vitet 2011, 2012 dhe 2013. Megjithatë subjekti ekonomik, shfrytëzon sipërfaqen prej 5 hektarësh që prej vitit 2014 pa kontratë qiraje si dhe nuk ka përmbushur detyrimet për heqjen nga fondi pyjor/kullosor të cilin e shfrytëzon dhe ky fond është aset i Bashkisë Elbasan.</p> <p>C - Për subjektin “Rr.U.A” SHPK me NIPT J.....O Nga auditimi është konstatuar se në dosje administrohen disa kontrata qiraje 1 vjeçare për përdorimin e fondit pyjor/kullosor me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, për vitin 2013, 2014 të cilat janë ripërsëritur. Në konkluzion, ky subjekt ekonomik, shfrytëzon sipërfaqen prej 0,5 hektarësh që prej vitit 2015 pa kontratë qiraje si dhe nuk ka përmbushur detyrimet për heqjen nga fondi pyjor/kullosor të cilin e shfrytëzon dhe ky fond është aset i Bashkisë Elbasan.</p> <p>D - Për subjektet “U.Q” SHPK me NIPT J.....Q dhe “V.H” SHPK me NIPT K.....C.</p> <p>Për këto subjekte ekonomike, nga Bashkia Elbasan, Agjencia e Shërbimeve Pyjore, nuk administrohet asnjë dosje subjekti, pra praktikisht Bashkia Elbasan nuk ka asnjë informacion për aktivitetin e U.Q SHPK dhe V.H SHPK në territorin e saj dhe nuk ka asnjë informacion për sa i përket shfrytëzimit të aseteve të saj (fondit pyjor/ kullosor në total prej 4,58 ha) për efekt të nxjerrjes së gurit gëlqeror siç parashikohet në aktet e miratimit të lejes minerare, përkatësisht nr. 922/1 datë 10.05.2016 për U.Q SHPK dhe nr. 1304/3 datë 26.01.2009 për V.H SHPK.</p> <p>Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligji nr. 9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin Pyjor”, neni 17 si dhe neni 19 pika 3, si dhe nenin 801 dhe 802 të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 “të “Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë” miratuar me ligjin Nr.7850, datë 29.7.1994, me ndryshimet, si dhe nenin 24, pika 10 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, dhe VKM 1353 datë 10.10.2008, i ndryshuar “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar. <i>(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 52-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).</i></p>		
2	<p>Nga auditimi rezultoi se në 4 raste në fondin pyjor dhe kullosor janë nënshkruar kontrata me shoqëritë koncesionare, të cilët janë në papajtueshmëri me Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për dhënie në Përdorim të Fondit Pyjor, konkretisht si vijon:</p> <p>-Kontrata qiraje nr.1616, datë 02.04.2021, HEC Kotorri e nënshkruar ndërmjet Bashkisë Elbasan, e përfaqësuar nga Kryetari i saj, z. G.LL dhe Shoqërisë</p>	E lartë	Kryetari i Bashkisë Elbasan të analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për rishikimin e Nenit 3 dhe Nenit 5 (pika 5.2) të kontratave të sipërcituara si dhe llogaritjen e detyrimeve.

	<p>"A" ShPK, e regjistruar si person juridik në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS L.....T.</p> <p>-Kontrata qiraje nr.1322, datë 28.02.2018, HEC Kamiçani e nënshkruar ndërmjet Bashkisë Elbasan, e përfaqësuar nga Kryetari i saj, z. Q.S dhe shoqërisë "I" ShPK e regjistruar si person juridik në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS K.....N.</p> <p>-Kontrata qiraje nr.1323, datë 28.02.2018, HEC Arcova e nënshkruar ndërmjet Bashkisë Elbasan, e përfaqësuar nga Kryetari i saj, z. Q.S dhe shoqërisë "I" ShPK e regjistruar si person juridik në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS K.....N.</p> <p>-Kontrata qiraje nr.1919/2, datë 13.05.2020, HEC Bukaniku e nënshkruar ndërmjet Bashkisë Elbasan, e përfaqësuar nga Kryetari i saj, z. G.LL dhe Shoqërisë "B.N" ShPK, e regjistruar si person juridik në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS K.....O.</p> <p>Për sa me sipër, rezulton se përcaktimet e Nenit 3 dhe Nenit 5 (pika 5.2) e kontratave përkatëse të cilat bien në kundërshtim me pikën 20 të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit Nr.01, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik" i ndryshuar ku citohet "<i>Pagesa e qirasë është vjetore, duke u llogaritur nga data e lidhjes së kontratës dhe shlyhet në momentin e lidhjes së kontratës dhe në të njëjtën datë në vitin pasardhës</i>". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 52-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).</p>		
3	<p>Nga auditimi i Aseteve të Bashkisë Elbasan, rezulton se Drejtoria e asetëve nuk ka pajisur me dokument pronësie 10,086 prona të paluajtshme, të cilat nuk janë regjistruar pranë ASHK, nga këto: <i>Bashkia 3,508 prona dhe 12 Njësiti Administrative 6,578 prona</i> pa certifikate pronësie, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 20/2020 "<i>Për kadastrën</i>". Drejtoria e Aseteve nuk disponon shkresa në drejtim të ASHK, për zgjidhjen e problemit të regjistrimit pasurive të saj, pasi ky proces është neglizhuar dhe nuk ka ecur periodikisht krahasuar me aplikimet e bëra.</p> <p>- Drejtoria e Aseteve nuk ka regjistruar në kontabilitet 22 prona paluajtshme pajisur me certifikate pronësie në 2022 (<i>15 apartamente, 5 are, 1 truall dhe 1 ish-zyre arsimore</i>), sipas aneksit 11 pika 3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit në kundërshtim me Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 "<i>Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme</i>", i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 73-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).</p>	E lartë	Bashkia Elbasan të marrë masa për regjistrimin e 10,086 pronave të saj, krijimin e regjistrimit pronave, pajisjen e tyre me certifikatë pronësie, duke bashkëpunuar me institucionet tjera si dhe regjistrimin në kontabilitet 22 prona paluajtshme, pajisur me certifikate pronësie në vitin 2022 ( <i>15 apartamente, 5 are, 1 truall dhe 1 ish-zyre arsimore</i> ), sipas aneksit 11 pika 3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.
4	Nga auditimi rezultoi se në 7 raste në procedurat e prokurimit publik, njësia e prokurimit nuk ka	E lartë	Kryetari i Bashkisë Elbasan të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të

	<p>argumentuar kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht në procedurat me objekt si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i shkollës mesme “Kostandin Kristoforidhi”, (rikonstruksion dhe shtesë anësore 4 kate dhe palestër)”</li> <li>- Në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim rrjeti KUZ në zonat Informale”. zhvilluar në vitin 2022.</li> <li>- Në procedurën e prokurimit me objekt “Sistemim asfaltim i rrugëve “Grigor Nosi”, “Xhafer Duhaxhiu”, “Hasan Kopili” në lagjen 5 Maji” zhvilluar në vitin 2022.</li> <li>- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion, shtesë 4-kat dhe palestër “Shkolla Artistie Onufri” (e mesme e bashkuar) zhvilluar në vitin 2022.</li> <li>- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rionstruksioni i palestrave dhe tavaneve sportive, Shkolla e Mesme e Bashkuar “Luigj Gurakuqi”, Elbasan zhvilluar në vitin 2022.</li> <li>- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rivitalizimi urban i qendrës së Gjinarit dhe Fushëkuqës”, zhvilluar në vitin 2022.</li> <li>- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i gjendjes faktike të rrugës “Azmi Stringa” dhe “10 Korriku”, lagja “V. Xhuvani”., zhvilluar në vitin 2022. Veprimet e mësipërme në hartimin e kriterëve të veçanta të DST, bien në kundërshtim me kërkesat e pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. <i>(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2 faqe 96-172 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).</i></li> </ul>		<p>konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kriteret e veçanta për kualifikim që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e objektit që prokurohet.</p>
5	<p>Nga auditimi rezultoi se miratimi i “Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup>”, me nr. AN131020220037, për të cilën është marrë vendimi për miratim Nr. 2769/5 Prot; datë 07.12.2022, të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, për objektin “Prishje e objektit ekzistues dhe ndërtim i objektit me 4, 6, 8, 10, 11 dhe 12 kat me 2 kate parkim nëntokë”, me adresë në lagjen “Dyli Haxhire”, Bashkia Elbasan, me subjekt zhvillues z. D.S , është aplikuar gabim sipërfaqja prej 91.3 m<sup>2</sup> për kalimin në favor të Bashkisë Elbasan 3% (tre përqind) të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale sipas Ligjit nr. 22/2018 “Për strehim social”, datë 03.05.2018.</p>	E lartë	<p>Drejtorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të marrë të gjitha masat e nevojshme për lidhjen e një Akt-marrëveshjeve me subjektet zhvillues “Z. D.S”, për kalimin e sipërfaqes totale prej 75.63 m<sup>2</sup> (166.91-91.3) banim në favor të Bashkisë Elbasan.</p>

	<p>Nga përllogaritja e grupit të auditimit, sipërfaqja takuese si kontribut i sektorit privat ndaj fondit publik të banesave sociale, rezulton të jetë 5564.32 m<sup>2</sup> (sip. banim) * 0.03 = 166.93 m<sup>2</sup>. Bashkia Elbasan referuar akt marrëveshje me subjektin zhvillues z. D.S ka përcaktuar si detyrim sipërfaqen prej 91.3 m<sup>2</sup> me diferenc 75.63 m<sup>2</sup> (166.91-91.3) banim që duhet të kaloj në favor të Bashkisë Elbasan. Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar si dhe V.K.M.-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar me V.K.M.-në nr. 271 datë 06.04.2016 “Për një ndryshim në V.K.M.-në nr. 408 datë 13.05.2015”, nenin 19 të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 5, faqe 197-218 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).</p>		
6	<p>Në objektin “Rikonstruksioni dhe ndërhyrje në linjën KUZ dhe ndërtimi i sheshit të parkimit te varrezat publike” nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt me vlerë <b>887,852 lekë me TVSh</b>, veprime në kundërshtim me kontratën me nr. 5457/6 prot., datë 07.03.2022, lidhur midis Bashkisë Elbasan dhe OE “I” ShPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 172-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).</p>	E lartë	<p>Bashkia Elbasan të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej <b>877,852 lekë</b> me TVSh nga OE “I” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës me nr. 5457/6 prot., datë 07.03.2022, me objekt “Rikonstruksioni dhe ndërhyrje në linjën KUZ dhe ndërtimi i sheshit të parkimit te varrezat publike”, vlerë kjo që përbën dëm ekonomik ndaj fondeve të buxhetit të shtetit.</p>
	<p>Në objektin “Sistemim asfaltim i rrugëve “Grigor Nosi”, “Xhaferr Duhaxhiu”, “Hasan Kopili”, në lagjen 5 Maji” nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt me vlerë <b>778,220 lekë me TVSh</b>, veprime në kundërshtim me kontratën me nr. 1288/6 prot., datë 10.06.2022, lidhur midis Bashkisë Elbasan dhe OE “B.N” ShPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 172-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).</p>	E lartë	<p>Bashkia Elbasan të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 778,220 lekë me TVSh nga OE “B.N” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës me nr. 1288/6 prot., datë 10.06.2022, me objekt “Sistemim asfaltim i rrugëve “Grigor Nosi”, “Xhaferr Duhaxhiu”, “Hasan Kopili”, në lagjen 5 Maji”, vlerë kjo që përbën dëm ekonomik ndaj fondeve të buxhetit të shtetit.</p>
7	<p>Nga auditimi i bankës për vitin 2022 rezultoi se në 7 raste, është likuiduar TVSH 2–herë për vlerën 709,648 lekë për zërat “Pajisjet elektrike e hidraulike”, pasi nuk është ndarë veças vlera e “montimit” të pajisjeve pa TVSh dhe veças vlera e “pajisjeve” me TVSh dhe vihet në fund të situacionit, për rrjedhojë përfituar padrejtësisht nga subjektet, konkretisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>vlera 23,587 lekë, “B.N” ShPK, për objektin “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet</li> </ol>	E lartë	<p>Bashkia Elbasan të marrë masa për arkëtimin e vlerës <b>709,648 lekë</b> e cila përbën dëm ekonomik, për likuidim 2 herë TVSH, në 7 raste, të TVSH-së për 5 subjekte:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Subjekti “B.N” ShPK, në vlerën 23,587 lekë</li> <li>Subjekti “B.N” ShPK në vlerën 244,886 lekën</li> <li>Subjekti “B ” ShPK në vlerën 85,315 lekë</li> <li>Subjekti “E” ShPK në vlerën 107,080 lekë</li> <li>Subjekti “E” ShPK në vlerën 13,400 lekë</li> </ol>



	<p>varfra e të pafavorizuara”, sipas urdhër shpenzimit 295 dhe 296 datë 11.05.2022;</p> <p>2. vlera 244,886 lekë, “B.N”, për objektin “Rikonstruksion 3 rrugëve dhe shesheve pallateve 579,579/3, 579/4, 579/5, 580/1”, sipas urdhër shpenzimit 425 datë 10.06.2022;</p> <p>3. vlera 85,315 lekë, “B” ShPK, për objektin “Rikonstruksion i fushës minikalçetos dhe rrethim i kompleksit sportiv Sh.Lamcja”, sipas urdhër shpenzimit nr. 430 datë 10.06.2022;</p> <p>4. vlera 107,080 lekë, “E” ShPK, për objektin “Rikonstruksion rrugës Abdyl Kajanaku”, sipas urdhër shpenzimit nr. 426 datë 10.06.2022;</p> <p>5. vlera 13,400 lekë, “E” ShPK, për objektin “Rikonstruksion shtese kati dhe palestër Shkolla Artistike Onufri”, sipas urdhër shpenzimit nr. 1242 datë 27.12.2022;</p> <p>6. vlera 180,000 lekë, “S.” ShPK, për objektin “Rehabilitim sheshit urban lindje rrugës Iljaz Kosova, xhamia Fush-Mret”, sipas urdhër shpenzimit 1152 datë 07.12.2022;</p> <p>7. Vlera 55,380 lekë, subjekti fizik “A.B ” për blerjen e 5 pompave zhytëse dhe elektrike për nevoja të saj sipas urdhër shpenzimit nr. 142 datë 21.07.2022 të ASHP.</p> <p>Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 ,“Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 73-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).</p>		<p>6. Subjekti “SH ” ShPK. në vlerën 180,000 lekë</p> <p>7. Subjekti fizik “A.B” në vlerën 55,380 lekë.</p>
8	<p>Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se: Në fund të vitit 2022 gjendja e debitorëve është në vlerën 139,229,606 lekë ndërsa progresiv deri në 31.12.2022 për subjektet fizik/juridik është 732,528,023 lekë, vlerë kjo që sjell të ardhura të pa-arkëtuara nga planifikimi në buxhetin e Bashkisë Elbasan. Gjendja e debitorëve e familjarëve është në vlerën 91,931,722 lekë ndërsa progresiv deri në 31.12.2022 për subjektet fizik/juridik është 295,754,386 lekë, vlerë kjo që sjell të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Elbasan. Për taksën e tokës bujqësore për vitin 2022 janë debitorë 9287 familjeve me vlerë të detyrimit 23,152,825 lekë, ndërsa vlera progresive deri me 31.12.2022, që përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Elbasan është në vlerën 75,567,148 lekë. Gjendja e debitorëve ndaj drejtorisë së ShMZSh-së progresiv deri në 31.12.2022 është 1,069,250 lekë, vlerë kjo që sjell të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Elbasan.</p> <p>Në total borxhi tatimor në Bashkinë Elbasan rezulton në vlerë 1,029,351,659 lekë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Elbasan. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Tatim Taksave lidhur me zbatimin e hapave që janë</p>	E lartë	<p>Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Elbasan, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Taksa dhe tarifa familjare në vlerë 295,754,386 lekë;</li> <li>2. Debitorë e Bizneseve në vlerë 732,528,023 lekë;</li> <li>3. Debitorë ndaj Drejtorisë së ShMZSh në vlerë 1,069,250 lekë.</li> </ol> <p>a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.</p> <p>b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).</p> <p>c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Tatim Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një</p>

	<p>ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar bizneset debitorë sipas Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4 pika 1 dhe 2, Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 89, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore të Republikës së Shqipërisë”, pika 89, i ndryshuar. Pas kalimit të afatit për pagimin në mënyrë vullnetare të këtyre detyrimeve, Drejtoria e Tatimeve Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave ka urdhëruar bllokimin e llogarive bankare apo llogarive depozitë për 2079 subjekte në vlerën 417,628 mijë lekë. <i>(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 2.6, faqe 51-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).</i></p>		<p>shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.</p> <p>d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Tatim Taksave, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.</p> <p>e- Sektori i Tatim Taksave të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Elbasan, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.</p> <p>f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.</p>
9	<p>Nga auditimi i gjobave të vendosura nga Inspektorati i Mbrojtës Territorit, Bashkia Elbasan për vitin 2022 janë vendosur 83 gjoba në vlerë 41,100,000 lekë, nga të cilat është paguar në mënyrë vullnetare nga 8 subjekte vlera 3,600,000 lekë si dhe nuk kanë paguar 75 subjekte me vlerë totale të gjobave të vendosura 37,500,000 lekë për periudhën 01.01.2022-31.12.2022. Nga Inspektorati i Mbrojtës Territorit nuk janë ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, në kundërshtim me nenin 16, i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime, nenet, 9, 22 dhe 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. <i>(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 2.6, faqe 51-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).</i></p>	E lartë	<p>Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për vlerën totale <b>37,500,000 lekë</b>. Gjithashtu, IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.</p>

### 3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

#### OPINIONI I AUDITIMIT

##### **I. Opinioni mbi pasqyrat financiare për vitin 2022:**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Elbasan për vitin ushtrimor 2022, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., si dhe shënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme të auditimit, shprehim një opinion **kualifikuar**<sup>1</sup> për llogaritë vjetore të Bashkisë Elbasan, duke arritur në përfundimin se anomalitë e konstatuara apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura në llogaritë vjetore të vitin **2022**, të shprehura në bazën për opinion.

##### **Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare**

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI P 10- “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 130- “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën 16,823 mijë lekë të materialitetit si dhe anomalitë e konstatuara, si vijon:

- Pasqyrimi i gabuar i llogarisë analitike 468 “*Debitor ndryshëm*” për 1,056,298,715 lekë me llogarinë analitike në pasiv 467 “*Debitorë ndryshëm*” për 1,064,539,415.

-Mos regjistrimi në kontabilitet i 22 prona të paluajtshme, pajisur me certifikate pronësie në vitin 2022 që përfshijnë 15 *pasuri apartamente*, 5 *pasuri are*, 1 *pasuri truall dhe 1 ish-zyre arsimore*).

##### **II. Opinioni mbi përputhshmërinë**

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Elbasan, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të **kualifikuar** të përputhshmërisë.

##### **Baza për dhënien e opinionit**

- Bashkia Elbasan nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

-Nuk janë marrë masa të plota për uljen e detyrimeve të prapambetura. Edhe pse janë likuiduar gjatë vitit buxhetor detyrime të prapambetura, nga ana tjetër edhe gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime të reja të prapambetura, duke çuar në 31.12.2022 vlerën e tyre, me burim financimi të ardhurat e veta në 67 milion lekë.

-Janë konstatuar anomali në hartimin e kriterëve të veçanta të DST në procedurat e prokurimit

<sup>1</sup> “Sipas **Manualit të Auditimit Financiar** të KLSH-së, miratuar me vendim nr. 246, datë 29.12.2022, Kapitulli 7.3.5 “Opinionet mbi auditimin financiar”, pika 4.2, “*Opinion i Modifikuar me rezervë*”, jepet në ato raste kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe datë përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë”.

publik, pasi janë vendosur kritere të cilat nuk kanë lidhje të ngushtë me natyrën dhe madhësinë e kontratës.

- Në 3 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues dhe lidhur kontrata me operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit.

- Në auditimi i kontratave të zbatimit rezultuan diferenca në volumet e punimeve në vlerën 877,852 lekë me TVSh

- Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve, pasi në datën 31.12.2022 rezulton një vlerë e pa arkëtuar prej 1,084,419 mijë lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Elbasan, e krijuar nga mos pagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat.

#### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Elbasan:**

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Elbasan.

#### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:**

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojme bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar, si dhe nëse hartimi i kritereve të DST, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve janë në përputhshmëri me kriteret e fushës së prokurimeve publike dhe kriteret e kontratave të lidhura. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të institucionit të audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të jap opinion për këtë.

## **I. HYRJA**

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 767/1 prot., datë 13.09.2023, ndryshuar, me shkresën nr. 767/2 prot., datë 01.11.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 14.09.2023 deri në datën 13.11.2023, në subjektin Bashkia Elbasan u krye “Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022. Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

- 1.H.I - Përgjegjës Grupi
- 2.B.B - Anëtar
- 3.E.K - Anëtar
- 4.S.J - Anëtar
- 5.A.D - Anëtar
- 6.B.B - Anëtar
7. B.B - Anëtar

**Titulli:** Auditim financiar dhe përputhshmërie.

**Marrësi:** Raporti i Auditimi i drejtohet subjektit të audituar Bashkia Elbasan.

### **1. Objektivat e auditimit**

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Elbasan kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuarra dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)<sup>2</sup>;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

### **2. Qëllimi i auditimit**

Objekivi i auditimit financiar në Bashkinë Elbasan është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

### **3. Identifikimi i çështjes**

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Elbasan dhe përgjegjësi, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

1. Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.
2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
3. Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2022.
4. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.
5. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
6. Mbi organizimin dhe funksionimin e IMTV-së.
7. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

### **4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Elbasan, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit

<sup>2</sup>Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

financiar në sektorin publik. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

## **5. Përgjegjësitë e audituesve**

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

## **6. Kriteret e vlerësimit**

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Elbasan është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Elbasan. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- Ligji Nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- “VKM nr. 187, datë 8.3.2017 për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, i ndryshuar.
- VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”;
- VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim;

- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- Udhëzimi i MFE nr. 10, datë 28.02.2020 “Për përgatitjen e PBA vendor 2021-2023”;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.
- Etj.

## **7. Standardet e auditimit**

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Elbasan grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë :

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik“;
- ISSAI 200 “Parimet themelore të auditimit financiar”.
- ISSAI 2200-2899 "Standardet e auditimit financiar";
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC.

## **8. Metodologjia e auditimit**

### 1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

### 2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin.

### 3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

### 4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

### 5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

### 6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

### 7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Elbasan me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

### 8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

#### *Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit*

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale<sup>3</sup>.

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtuar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH-j<sup>a</sup> aplikon<sup>4</sup>.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

### **9. Dokumentimi i auditimit**

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në

<sup>3</sup> ISSAI 1315

<sup>4</sup> Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm \* Risku i kontrollit \* Risku i Zbulimit



arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

## **II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

### **1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin**

Auditimi në subjektin Bashkia Elbasan, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t'u audituar.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave.

Bashkia Elbasan është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”.

### **Profili i Bashkisë Elbasan**

Bashkia e Elbasanit kufizohet në veri me Bashkinë Tiranë, në lindje me Bashkinë Librazhd, në jug-lindje me Bashkinë Prrenjas, në jug-perëndim me Bashkinë Gramsh dhe në perëndim me bashkitë Cërrik dhe Peqin. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Elbasanit. Sipas Censurit të vitit 2011, kjo bashki numëron 141,714 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil ajo numëron një popullsi prej 205,892 banorësh dhe me densitet prej 236.11 banorë për km<sup>2</sup>. Bashkia e Elbasanit ka një sipërfaqe prej 872,03 km<sup>2</sup>. Ajo përbëhet nga 13 njësi administrative. Bashkia ka nën administrimin e saj një qytet dhe 116 fshatra. Ajo është një nga bashkitë më të mëdha në Shqipëri, si dhe një nga bashkitë më komplekse për t'u administruar. Qyteti i Elbasanit, me rreth 80 mijë banorë, ka aktualisht rreth 60% të popullsisë së bashkisë ndërsa pjesa tjetër është e ndarë përkatësisht në njësitë administrative, disa prej të cilave gjenden në terrene të thyera malore. Bashkia ka në territorin e saj një pjesë të madhe të industrisë së rëndë të Shqipërisë, përfshirë fabrikën e çelikut, atë të çimentos, ferrokromit, etj. Një pjesë e njësisve administrative shtrihen përgjatë luginës së Elbasanit, por më shumë se gjysma e ish-komunave gjenden në një seri zonash malore, duke filluar nga Graceni e duke vazhduar me Labinot Mal, Gjinarin e Zavalinën apo edhe ish- komuna Funar.

## **REZULTATET E AUDITIMIT SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT:**

### **1 Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm**

Bazuar në *Misionin* e Vetëqeverisjes Vendore “për të siguruar qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve” nëpërmjet: zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë; nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore; realizimit të shërbimeve, në

përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative; për të rritur cilësinë e jetës si dhe shtuar aktivitetet për t'i shërbyer popullsisë së bashkisë Elbasan<sup>5</sup>; referuar dhe Ligjit nr. 10296 dt. 08.07.2010, kreu III “Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”, neni 19, në të cilin citohet: “Titullarët e njësive të sektorit publik, zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetri: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informacioni dhe komunikimi, Monitorimi”, Bashkia Elbasan, për çdo vit ka përgatitur “Deklaratën dhe Pyetësorin e Vetëvlerësimit” dhe i ka dërguar në MFE/ Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar/ Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit. Më poshtë po i analizojmë në mënyrë të detajuar, duke përcaktuar mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

## 1. Mjedisi i kontrollit



Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxherial dhe punonjësve të tjerë të njësive publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrave, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

Referuar nenit 20 të Ligjit nr. 10296 “Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli”, titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e

mjedisit të kontrollit. Nga auditimi u konstatua se, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, Kreu II, neni 8, pika 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e Titullarit”; neni 9 pika 4/a “Përgjegjshmëria menaxheriale e Nëpunësit Autorizues”, në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kreu IV “Zbatimi i MFK”, pika, 4,2,10/a “Roli i nëpunësit autorizues të njësive”, rezulton se janë hartuar/miratur: “Plan i Përgjithshëm Vendor” - [PPV] me Fokus Strategjia e Zhvillimit Vendor, Analiza & Vlerësimi Territorit, Parashikimet e Planit, Vlerësimi Strategjik Mjedisor, Materiali hartografik si dhe “Rregullore e Planit Vendor”, të cilët hartohen si bashkëpunim i Bashkisë me KKT<sup>6</sup> dhe miratur me VKB Elbasan nr.130 datë 07.01.2016; Gjithashtu Bashkia Elbasan ka hartuar dhe miratur në vitin 2017 Strategjinë e Zhvillimit Vendor - [SZHV], ku paraqiten synimet kryesore për çdo fushë përgjegjësie dhe identifikohen veprimet që njësia duhet të ndërmarrë për realizimin e tyre, duke parashikuar edhe kostot përkatëse, kjo në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” Kreu VI, neni 32 pika 2/a,b,c. [PPV] përmban: objektivat strategjike dhe rregullat e zhvillimit me instrumentet për zbatueshmërinë e tyre për periudhën 2017<sup>7</sup> e në vazhdim; për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të territorit, respektim dhe mbrojtje të tokës me vlera natyrore, bujqësore, kulturore, të krijojnë vende pune, të nxisin zhvillimin ekonomik dhe, me përdorimin e kujdesshëm të instrumenteve financiare, të sigurojnë të ardhura të drejtpërdrejta dhe përfitime për projekte investimi publik në nivel vendor.

<sup>5</sup> Misioni dhe Vizioni përbëjnë dhe hapin 2 të ciklit të MFK sipas Manualit të MFK miratur me Urdhër të Ministrisë të Financave nr. 8980/2010 dhe përditësuar me atë nr. 108/2016.

<sup>6</sup> Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) emëruar sipas VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017

<sup>7</sup> Me Vendim nr. 1 datë 29.12.2016 të KKT, është miratur PPV i Bashkisë Elbasan për periudhën 2016-2030

BASHKIA ELBASAN	Njësitë Administrative	Nr. i banorëve 31.12.2022
	Elbasan	
Papër		
Bradashesh		
Gracen		
Funar		
Labinot Fushë		
Labinot Mal		
Shushicë		
Shirgjan		
Tregan		
Gjinar		
Gjergjan		
Zavalinë		

Punoi: Grupi i Auditimit

### 1.1. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.

Bashkia Elbasan ushtron funksionet e veta me Rregulloren e Brendshme “Mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe procedurat për zbatimin e kompetencave vendore në administratën dhe njësitë administrative të Bashkisë Elbasan”, hartimi dhe miratimi i të cilës është mbështetur në zbatimin e Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9 pika 1/1 germa ‘b’, Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimet e Këshillit Bashkiak [VKB] të çdo viti respektiv “Mbi miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të bashkisë, institucioneve në varësi dhe njërive administrative” si dhe Vendimit të Kryetarit “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Elbasan”. Kjo Rregullore është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 55 datë 08.02.2017 dhe nr. 1117 prot., datë 08.02.2017, e cila i përket Strukturës Organizative miratuar për vitin 2017. Ndërsa Këshilli bashkiak ka miratuar numrin e përgjithshëm të punonjësve: për vitin 2021 me VKB nr. 169 datë 24.12.2020 “Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve të bashkisë Elbasan për vitin 2021”; për vitin 2022 me VKB nr. 117 datë 14.12.2021 me nr. 6032/1 prot., datë 16.12.2021; Me Vendim të kryetarit nr. 866 datë 04.10.2021 është miratuar struktura organizative e Bashkisë Elbasan bashkë me njësitë vartëse.

Për periudhën nën auditim e në vijim, ndryshimet në strukturën organizative të miratuara me VKB janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan, si dhe këto ndryshime të strukturës nuk janë pasqyruar në Rregulloren e brendshme të njësisë.

**b.** Mbi respektimin e etikës nga punonjësit e institucionit, Bashkia Elbasan ka hartuar dhe miratuar me Vendi të Kryetarit nr. 185 datë 04.12.2019 “Kodin e Etikës së Bashkisë Elbasan” konform Ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9, pika 1/1 germa ‘b’, VKM nr. 306 datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”.

**c.** Bashkia Elbasan nuk ka hartuar dhe miratuar “Rregulloren e Posaçme për Parandalimin e konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksioneve publike” me nr. 1612 prot., datë 24.01.2022, në kundërshtim me Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9, pika 1/1 germa ‘b’, neni 46; Ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar; Kjo Rregullore përcakton rastet e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike dhe ka si qëllim parandalimin e tyre.

“Kodi i Etikës” dhe “ Rregullore për Parandalimin e Konfliktit të Interesit” përcaktojnë rregullat e sjelljes së nëpunësve të administratës publike, sipas standardeve të kërkuara, i ndihmon ata për arritjen e këtyre standardeve si dhe vë në dijeni publikun për sjelljen që duhet të ketë nëpunësi i administratës publike. Kjo ndikon në mbarëvajtjen e funksionimit të institucionit, duke mos lejuar cenimin e aktivitetit të tij në çdo aspekt.

## 1.2 Politikat menaxheriale dhe stili i Punës


**a.** Punësimi në Bashkinë Elbasan bëhet në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr. 243/2015 i ndryshuar me VKM nr. 746/2018 Kreu I pika 1,2.

▪ Kjo procedurë rregullohet nga vet Strukturat e Bashkisë Elbasan:

- Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore [DABNJ] është përgjegjëse për zbatimin e hapave të procedurës së punësimit sipas nenit 10 pika 1 e Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM nr. 243/2015 i ndryshuar Kreu II;

- Komiteti i Përhershëm i Pranimit [KPP] në zbatim të përcaktimeve në Kreun III të VKM nr. 243/2015 i ndryshuar ;

- Kryetari i Bashkisë në zbatim të nenit 64 pika e,ë,f,g të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.



Skema e procedurës së punësimit në NJVQV

Struktura përgjegjëse e çdo bashkie harton në fillim të çdo viti “Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” në zbatim të Ligjit nr. 152/2015 “Për nëpunësin civil” neni 18 dhe 69, VKM nr. 108/2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, si edhe të atyre me Kontratë Pune konform Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë” i ndryshuar, VKB “Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të tyre” si dhe Vendimeve të Kryetarit “Për miratimin e strukturave organizative të Bashkisë Elbasan”. Nga verifikimi i dokumentacionit që iu vu në dispozicion grupit të auditimit, rezultoi se për vitin 2022 me VKB nr. 117 dt. 14.12.2021 dhe nr. 6032 prot., dt. 16.12.2021 është miratuar “numri maksimal i punonjësve të Bashkisë dhe Institucioneve vartëse të saj, si dhe niveli i pagave për vitin 2022”; gjithashtu është hartuar Plani vjetor i pranimit në shërbimin civil, i cili bazohet mbi nevojat e institucionit për vitin e ri ushtrimor, duke detajuar emërtimin e pozicionit dhe të njësive përbërëse në strukturë. Publikimi i vendeve vakante nga ana e Bashkisë Elbasan, bëhet në faqen zyrtare të saj si dhe në Portalin Kombëtar të Punësimit të AKPA, konform Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 19 pika 1, 2; VKM nr. 108/2014 “Për Planin vjetor të Pranimit në Shërbimin Civil” pika 13; VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar Kreu II pika 6.

**b.** Përshkrimin e punës të çdo pozicioni si dhe kriteret që duhet të plotësohen nga kandidatët, duhet të jenë të përshkruara në Formularin e Përshkrimit të Pozicionit të Punës. Ato janë pjesë e rëndësishme e politikave dhe praktikave që lidhen me burimet njerëzore. Si të tilla *Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë kritere dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit*. Për këto arsye, kriteret duhet të jenë pjesë në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë, neni “përshkrimet e punës” si dhe e dosjes së personelit. [DABNJ] nga ana e saj pasi harton planin vjetor të punësimit,

ndjek procedurën nga shpallja e njoftimit deri në përfundimin e saj, praktikë e cila në përfundim bëhet pjesë e dosjes së personelit; Kjo procedurë realizohet në zbatim të përcaktimit ligjor në fuqi, Ligjit nr. 152/2015 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar; Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; VKM nr. 108/2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”; VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar.

Gjithashtu DABNJ harton Formularët e Përshkrimit të Pozicionit të Punës të çdo pozicioni në strukturë sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, Ligjit nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar dhe “Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, duke e bërë pjesë të dosjes në zbatim të VKM nr. 142 datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar. Ky formular është pjesë përbërëse e manualit të procedurave të njësisë publike.

Duke qenë se Bashkia Elbasan funksionon me Rregullore të Brendshme *të papërditësuar*, në mospërputhje me strukturën e re të miratuar me Vendim të Kryetarit nr. 04 dt. 20.01.2022, ka në përbërjen e saj përshkrimet e punës: kompetencat, funksionet dhe të drejtat e çdo njësie e pozicioni të strukturës organizative, kriteret e veçanta për çdo pozicion etj të papërshtatura me Strukturën e re organizative.

**Konstatim:** Nga auditimi rezultoi se Formularët e përshkrimit të pozicioneve të punës nuk janë bërë pjesë e Rregullores së brendshme të bashkisë, në kundërshtim kjo me VKM nr. 142 datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

- Në Bashkinë Elbasan struktura organizative ka pësuar ndryshime, të cilat janë miratuar me Vendim të Kryetarit së Bashkisë, të pa pasqyruara në Rregulloren e Brendshme të funksionimit të saj. Drejtoria e Administrimit të Burimeve Njerëzore si struktura përgjegjëse për personelin, harton çdo fillim viti Planin Vjetor të pranimit në shërbimin civil për Bashkinë Elbasan, mbështetur në nevojat që pasqyrohen në Strukturat organizative të çdo viti, të miratuara nga Kryetari i Bashkisë me emërtimet e pozicioneve përkatëse. Vendimet janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan.
- Struktura organizative e Bashkisë Elbasan për dy vitet 2021 dhe 2022 ka këtë kompozim:

Nr	Viti	Numri drejtorive	Numri sektorëve	Numri punonjësve plan/ fakt	Diferenca
1	2021	21	47	388 364	24
2	2022	21	48	445 437	8

Burimi: Bashkia Elbasan

Shpërndarja e pozicioneve në strukturën organizative për vitin 2022 sipas ligjit që rregullon marrëdhëniet e punës, pasqyrohet si më poshtë:

Niveli pozicionit	Status i Nëpunësit Civil	Vende Vakante	Kodi i Punës	Vende Vakante
Kategori e lartë	7	1	-	
E mesme drejtuese	18	0	20	1
E ulët drejtuese	43	1	7	1
Ekzekutive	139	2	211	2
<b>Totali</b>	<b>207</b>	<b>4</b>	<b>238</b>	<b>4</b>

Burimi: Bashkia Elbasan

- Nga të dhënat e pasqyruara në tabelë për aparatën e bashkisë rezulton se *për vitin 2021* janë planifikuar në strukturë 388 punonjës dhe numri i tyre faktik ka qenë 364; *për vitin 2022* janë planifikuar në strukturë 445 punonjës dhe numri faktik i tyre ka qenë 437; Ndërsa për aparatën e bashkisë bashkë me njësitë e varësisë pasqyrohen si më poshtë:

Nr	EMERTIMI	Nr. Punonjës
1	Kryetar	1
2	Sekretar i Pergjithshem	1
3	Zv/Kryetar	4
4	Sekretar i Keshillit Bashkiak	1
5	Kabineti Kryetarit	9
6	Drejtorja e Auditit te Brendshem	5
7	Drejtorja e Integritimit Europian , Projekteve Strategjike dhe Inovacionit	8
8	<b>Drejtorja e Pergjithshme e Sherbimeve Organizative</b>	<b>54</b>
	Drejtor i Pergjithshem	1
	Drejtorja Juridike	9
	Drejtorja Administrates dhe Burimeve njezore	11
	Drejtorja e Informacionit, Statistikave dhe Koordinimit	33
9	<b>Drejtorja e pergjithshme e te Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Finances</b>	<b>70</b>
	Drejtor i Pergjithshem	1
	Drejtorja Buxhert Finances	13
	Drejtorja Taksave dhe tarifave Vendore	47
	Drejtorja e Aseteve dhe Strehimit	9
10	<b>Drejtorja e Pergjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban</b>	<b>27</b>
	Drejtor i Pergjithshem	1
	Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit	13
	Drejtorja e Projektimit dhe Azhornimit Topografik	13
11	<b>Drejtorja e pergjithshme e Politikave Sociale, Sherbimeve Komunitare</b>	<b>44</b>
	Drejtor i Pergjithshem	1
	Drejtorja e Teknologjise se Informacionit dhe medias	14
12	<b>Drejtorja e pergjithshme e politikave te Arsimit, Trashegimise kulturore dhe Turizmit</b>	<b>26</b>
	Drejtor i Pergjithshem	1
	Drejtorja e politikave te Sportit, Rinise dhe Aktiviteteve	10
	Drejtorja e Politikave te Arsimit, Trashegimise Kulturore dhe Turizmit	15
13	<b>Drejtorja e pergjithshme e Sherbimeve Infrastrukturore dhe Prokurimeve Publike</b>	<b>32</b>
	Drejtor i Pergjithshem	1
	Drejtorja e prokurimeve Publike	8
	Drejtorja e Poltikave te Sherbimit urban	13
	Drejtorja e Emergjencave Civile	10
	Inspektoriati i Kontrollit dhe Mbrojtjes se Territorit	9
	Inspektoriati Mjedisit	10
	Policia Bashkiake	39
	Drejtorja e Sherbimeve Pyjore, Bujqesore, Veterinare dhe Mjedisore	20
14	<b>Lagjet e qytetit</b>	<b>23</b>
	Lagja Nr. 1	3
	Lagja Nr. 2	4
	Lagja nr. 3	4
	Lagja nr. 4	4
	Lagja nr. 5	4
	Lagja nr. 6	4
	Sherbimi i deleguar QKL,QKR	2
	Njesite Administrative - 12	60
15	<b>Institucionet vartese</b>	<b>998</b>
	Agjensia e Sherbimeve publike	282
	Qendra Ekonomike Arsimit	93
	Klubi Shumesportesh	41
	Qendra Artit	40
	Qendra Sociale balashe	48
	Qendra e Trashegimise Kulturore	22

Nr	EMERTIMI	Nr. Punonjës
	Njesia e Menaxhimit te Banesave Sociale	4
	MZSH	30
	Arshiva	10
	Arsimi	416
<b>50</b>	<b>Totali</b>	<b>1437</b>

Burimi: Bashkia Elbasan/DABNJ

- Nga informacioni shkresor i vënë në dispozicion, rezultoi se numri i largimeve të punonjësve për arsye të ndryshme në Bashkinë Elbasan ka qenë i konsiderueshëm. Nga auditimi rezultoi se nuk ka procese gjyqësore nga punonjësit e larguar gjatë vitit 2022; ndërsa ka procese gjyqësore të nisura në vitin 2022 për punonjësit e larguarit nga puna para periudhës audituese ( 2022) si më poshtë:

Nr	Emër Mbiemër	Statusi Juridik	
1.	Xh.Sh	Shkalla e I – Pranuar pjesërisht	Shkallë e II – Në proces
2.	Sh.S	Shkalla e I – Në proces	-
3.	D.S	Shkalla e I - Pranuar	Shkalla e II – Në proces

Burimi: Bashkia Elbasan/DABNJ

**Konstatim:** Nga verifikimet dhe informacioni i pasqyruar në tabelë rezulton se largimet nga puna janë bërë pa respektuar kriteret apo afatet ligjore, duke sjellë rritjen artificiale të numrit të kreditorëve ndaj bashkisë dhe rrjedhimisht edhe përdorim pa efikasitet të buxhetit të saj për likuidimin e tyre si dëmshpërblim nga ndërprerja e marrëdhënies së punës.

Një pasqyrim më i detajuar i numrit me arsyen e largimeve, jepet në tabelën e mëposhtme:


Nr	Arsyeja e lirimit të vendeve	2022	Punësimi 2022
1	KMCAP	-	
2	Pension	1	
3	Largim me dëshirë/dorëheqje	26	
4	Shkurtime/ristrukturime	-	
5	Zgjidhje Kontrate/përfundim	-	
6	Largim për mosparaqitje në punë/ shkelje të përsëritura	1	
7	Ndërruar jetë	-	
8	Refuzim të vendit të punës	-	
<b>TOTALI</b>		<b>28</b>	<b>39</b>

Burimi: Bashkia Elbasan/DABNJ

Numri i përgjithshëm i personelit në Bashkinë Elbasan (aparati) për vitin 2022, referuar strukturave organizative në planifikim është 332 punonjës.

### 1.3 Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Nga auditimi konstatohet se Bashkia Elbasan funksionon me një Strukturë që bazohet në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”. Nga auditimi rezulton se Strukturat Organizative shoqërohen edhe me Organigramën përkatëse për tu miratuar nga kryetari i Bashkisë:



**A. Organi Përfaqësues i Bashkisë - Këshilli Bashkiak**

**B. Organi Ekzekutiv i Bashkisë - Kryetari i Bashkisë**

Gjatë periudhës audituese – vitit 2022, struktura organizative e Bashkisë Elbasan ka pësuar ndryshime nga ajo e mëparshme, të cilat miratohen me Vendim të Këshillit Bashkiak. Një pasqyrim të kompozimit të Strukturës organizative të Bashkisë Elbasan paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Viti	VKB / Vendim Kryetari	Njësi Administrative	Drejtori	Sektor	Punonjës sipas strukturës
2021	VKB nr.169 dt.24.12.2020	12	21	47	332
2022	VKB nr.117dt.14.12.2021 ≠	12	21	48	445

Burimi: Bashkia Elbasan/DABNJ

- Ndërsa shpërndarja e punonjësve në strukturën organizative sipas njësive përbërëse të saj, pasqyrohen si më poshtë:

STRUKTURA		2021
1	Administrata e Bashkisë	360
2	Lagjet e Qytetit & QKR/QKL	25
3	Njësitë Administrative	60
<b>Nëntotali</b>		<b>445</b>
4	Njësi Varësie	998
<b>TOTALI</b>		<b>1443</b>

Burimi: Bashkia Elbasan/DABNJ

- Referuar Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore” mbi funksionet e bashkive, po japim një pasqyrim se si është kompozuar Struktura e Bashkisë Elbasan për vitin 2022, në zbatim të funksioneve që i jep ky ligj.

Emërtimi i funksionit	Shërbimet	Njësia përgjegjëse në Strukturë/ Njësi Varësie
<b>1.</b> Infrastruktura dhe Shërbimet Publike - neni 23	- Për Ujin e pijshëm	- Ujësjetës SHA
	- Ujërat e ndotura, ujërat e shiut, mirëmbajtje e rrugëve, varrezat publike, etj	- Agjencia e Shërbimeve Publike
	- Dekori, gjelbërimi, etj.	- Drejtoria e Politikave të Shërbimit Urban
	- Shërbimi urban	
	- Mbetjet e ngurta,	
	- Planifikim, zhvillim, kontrolli i territorit	- Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Territorit,
	- Sistemi arsimor parashkollor dhe bazë	- Drejtoria e politikave të Arsimit, trashëgimisë kulturore dhe turizmit
	- Shërbimi parësor shëndetësor	
<b>2.</b> Shërbimet sociale neni 24	- Shërbimet sociale	- Drejtoria e Shërbimit të kujdesit Social dhe komunitar
<b>3.</b> Kultura, sporti dhe shërbimet argëtuese - neni 25	- Trashëgimia kulturore, identiteti lokal, biblioteka, Sporti, kopshte, çerdhe etj	- Drejtoria e Politikave të sportit, rinisë, dhe aktiviteteve - Drejtoria e Politikave të arsimit, trashëgimisë kulturore, dhe turizmit
<b>4.</b> Mjedisi - neni 26	- Ajri, toka, uji, zhurmat, aktivitete edukuese	
<b>5.</b> Bujqësi, pyje, kullota, natyre,	- Infrastruktura e ujitje kullimit, toka bujqësore,	- Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, veterinarisë dhe mjedisit



biodiversitet - neni 27	informimi bujqësor e blegtoral, skemat e granteve, pyje & kullota, natyra & biodiversiteti	
6. Ekonomia vendore - neni 28	- Plane strategjike, tregjet, biznesi i vogël, grante për biznesin, informim publik etj.	- Drejtoria e të Ardhurave - Sektori i Zyrës me një Ndalesë
7. Siguria publike - neni 29	- Mbrojtja civile, parandalim dhe zgjidhje konflikti, kundërvajtjet administrative, - Shërbimi zjarrfikës	- Policia Bashkiake - MZSH - Mbrojtja Civile - IMTV - IM
8. Kompetenca të Deleguara - neni 30		- QKB - Gjendja Civile

*Punoi: Grupi i Auditimit*

Nga auditimi i strukturave organizative që ka kompozuar Bashkia Elbasan, nga verifikimet e dokumentacionit dhe analiza e informacionit të pasqyruar edhe në tabelë, rezultoi se për funksionin “Mbrojtja e Mjedisit” neni 26, nënfunkcionin “shërbimi parësor shëndetësor” i funksionit “Infrastruktura dhe Shërbime publike” neni 23, në strukturën e Bashkisë Elbasan, ky funksion nuk mbulohet nga një njësi e veçantë, por DSHPBVM<sup>8</sup>, ndonëse në emërtimin e saj ka termin mjedis, nuk ka sektor apo dhe një specialist mjedisi që të mbulojë problemet mjedisore të territorit të bashkisë; Nga auditimi **u konstatua se nga struktura përgjegjëse për mjedisin- Inspektorati i mjedisit është hartuar plani vendor i mbrojtjes së mjedisit për periudhën 2020-2022, por nuk ka raporte mbi zbatimin e monitorimin e tij.** Pra bashkia Elbasan në fillim të vitit 2022 e në vijim nuk ka funksionuar me një strukturë që i mbulon të gjitha funksionet/nënfunkcionet për të ofruar shërbimet komunitetit, duke ushtruar kompetencat që i atribuon Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Kreu VII në nenet 23-30; Ligji nr. 10431/2010 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar; Ligji nr. 9587/2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”; Ligji nr. 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar; Ligji nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”; VKM nr. 123/2011 “Për miratimin e planit kombëtar të veprimtimit të zhurmave në mjedis”.

#### **1.4 Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.**

Bashkia Elbasan aktivitetin e saj funksional e mbështet në Rregulloren e Brendshme, e miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 55 datë 08.02.2017 dhe nr. 1117 prot., datë 08.02.2017, e cila i përket Strukturës Organizative miratuar për vitin 2017.

Rregullorja e Brendshme përmban: bazën ligjore dhe fushën e zbatimit, strukturën organizative, funksionet menaxheriale, rregulla të përgjithshme, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e çdo njësie dhe pozicioni, të drejtat dhe detyrat e personelit, trajnimet, shkeljet disiplinore, orarin dhe kohën e punës, etj. Bashkia Elbasan deri më sot nuk disponon “Listën (Hartën) e proceseve/Manualin e Procedurave”, ku të jenë pasqyruar të gjitha proceset e punës dhe “Gjurmët e auditimit” për njësitë kryesore të Strukturës.

**Konstatim:** Bashkia Elbasan nuk ka përditësuar Rregulloren e funksionimit të Brendshëm sipas strukturave organizative të miratuara.

#### **1.5 Aftësitë profesionale të punonjësve.**

Për të audituar dosjet e personelit, përzgjedhëm dosjet e të punësuarve për vitet 2021 në aparatit e bashkisë dhe në ndërmarrjet e varësisë për kategoritë: ngritje në detyrë, pranim në shërbimin civil, me Kod pune; si dhe dosjet e punonjësve të larguar nga Bashkia Elbasan. Emërimet/largimet

<sup>8</sup> Drejtoria e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore

i janë nënshtruar, Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe Ligjit nr. 7961/1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”.

**a.** *Mbi rregullsinë dhe plotësinë e dosjeve të personelit* kërkua dosjet e punonjësve të emëruar në bashkinë Elbasan për vitin 2022 për të gjitha kategoritë, lëvizjeve të personelit /ngritjet në detyrë si dhe të punonjësve të larguar të periudhës nën auditim. Nga ana e sektorit të burimeve njerëzore na u bë me dije se po rikontrollohen të gjitha dosjet e personelit lidhur me dokumentacionin e dorëzuar nga punonjësit ndër vite apo dhe me përditësimin e tyre sipas rastit.

**Konstatim:** Nga testimi me zgjedhje të dosjeve të personelit (kampioni që përzgjedhëm), emëruar/larguar në 2022 rezultoi se përgjithësisht dosjet e personelit përmbanin dokumentacionin përkatës të dosjeve, por u konstatuan edhe këto mangësi:

- Në *dosjet e personelit* mungonin praktika e plotë e punësimit nga shpallja e pozicionit deri në emërimin e tij; nuk ishin bërë pjesë e dosjes vlerësimi 6 dhe 12 mujor; formulari i vetëdeklarimit; formulari i përshkrimit të punës për pozicionet me Kod pune.

- *Dosjet e punonjësve të larguar* në praktikën e plotë të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës nga njoftimi deri në vendimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, mungonte procesverbali i dorëzimit të bazës materiale që ka patur punonjësi në ngarkim;

Për të gjitha këto konstatime, nuk janë zbatuar: Ligji nr. 152/2013 i ndryshuar “Për nëpunësin civil” neni 17 pika 1,4; VKM nr. 117, datë 5.3.2014 Lidhja 1 e 2; VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar; Ligji nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” Kreu VII, XIV.

**b.** *Mbi trajnimin e punonjësve në Bashkinë Elbasan.*

Stafi administrativ ka zhvilluar trajnime sipas programeve të detyrueshëm ofruar nga ASPA pjesë e procedurës për përfitim të statusit të nëpunësit civil dhe jo vetëm. Nga auditimi **u konstatua** se nga Bashkia Elbasan, struktura përgjegjëse e saj [DBNJSHB] *nuk ka hartuar* Plane dhe Programe vjetore trajnimesh për punonjësit e saj, por trajnimet e punonjësve realizohen nga përzgjedhja fakultative që bëjnë nga programet që ofron ASPA, duke mos patur kështu një orientim mbi rëndësinë në përzgjedhjen e atyre temave që lidhen ngushtë me proceset e punës të përditshmërisë; saj nuk përfshinte të gjithë stafin dhe të gjitha njësitë e strukturës, me qëllim njohja nga ana e tyre me Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe Manualin për MFK.

Trajnimi i punonjësve është i nevojshëm për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe për të kuptuar se direktivat e dhëna prej menaxherëve të njësisë kuptohen dhe arrihen nga punonjësit.

Trajnime të Buxhetuara/Parashikuara			Trajnime të realizuara në 2022		
Nr. i trajnimeve	Kosto totale	Nr i personelit pjesëmarrës	Nr. i trajnimeve	Kosto totale	Nr i personelit pjesëmarrës
50		53	20		50

» Përgjegjësia e menaxhimit në garantimin e profesionalizmit të punonjësve të tij fillon me miratimin e politikave dhe praktikave të duhura që lidhen me burimet njerëzore dhe që reflektojnë angazhimin për: • Caktimin e nivelit të njohurive dhe aftësive që kërkohen për çdo pozicion pune; • Verifikimin e kualifikimeve të kandidatëve për vendet e punës; • Marrjen në punë dhe ngritjen në detyrë vetëm të atyre personave që kanë njohuritë dhe aftësitë në nivelet më të larta; • Futjen e programeve të trajnimit që ndihmojnë punonjësit të zgjerojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre; • Kryerjen e analizave periodike për njohuritë dhe aftësitë e kërkuesve për çdo pozicion pune dhe mbështetur në këto analiza, hartimin e planeve periodike për trajnimin e punonjësve; • Zhvillimin e profesionalizmit menaxherial nëpërmjet trajnimeve dhe marrjes në konsideratë të aftësive menaxhuese gjatë procesit.

## **2. Menaxhimi i Riskut**

**2.1 Regjistri i Riskut** Grupi i auditimit lidhur me menaxhimin e riskut, kërkoi t'i vihet në dispozicion Regjistri i riskut, ku jepet një pasqyrim i identifikimit të risqeve të çdo njësie të strukturës dhe masat që duhen marrë për parandalimin apo minimizimin e pasojave Bashkia Elbasan ka hartuar dhe miratuar Regjistrin e Riskut, ku është bërë i mundur identifikimi i risqeve që vijnë nga burime të brendshme dhe atyre që vijnë nga burime të jashtme, në zbatim të Ligjit 10296 dt. 08.07.2010, Kreu III, neni 10 ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015 si dhe Udhëzimit nr. 16 dt. 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

Regjistri i Riskut është i bazuar në analizën e riskut të çdo drejtorie dhe ka si *Synim* “Planifikimin dhe Përdorimin me efikasitet, efikasitet dhe transparencë të fondeve buxhetore në përputhje me misionin e Bashkisë, për arritjen e objektivave”. Ky regjistër përmban përshkrimin e risqeve për çdo drejtori/sector, nivelin e risqeve, kontrollat ekzistuese, veprimet e ndërmarra për të adresuar risqet, zotëruesi i riskut si dhe situatën e riskut pas detyrës së fundit, si dhe mënyrën apo rrugëzgjdhjen e situatës në rastin e ndodhjes apo konstatimit të dukurisë.

- Bashkia Elbasan ka ngritur *Grupin e Menaxhimit Strategjik* [GMS] me Urdhrin e kryetarit nr. 1111 datë 30.10.2019, por nga auditimi rezultoi janë zhvilluar vetëm takimet për diskutimet e tavaneve buxhetore dhe përgatitjet e PBA dhe Projekt planeve vjetore dhe se nuk ka takime të dokumentuara të aktivitetit të tij për problematika të aktivitetit të Bashkisë, që tregon për mosfunksionim të tij konform përcaktimeve në Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” Kreu II neni 8, pika 8/b; nenit 27 pika 1,2; dhe “Manualit të Menaxhimit financiar dhe kontrollin” Kapitulli II pika 2.2.6, ku dhe citohet se “Grupi për Menaxhimin Strategjik duhet të mbledhet të paktën katër herë në vit. Vendimet e Grupit duhet të merren në mënyrë kolegjiale dhe objektive duke patur në vëmendje interesin publik dhe në përputhje me standardet etike të sektorit publik. Vendimet e Grupit duhet të pasqyrohen në dokumente dhe t'i vihen në dispozicion menaxhimit të njësisë” Gjithashtu me rikompozimet e strukturës organizative, menaxherët e nivelit të mesëm të njësisë të saj, kanë ndryshuar gjë që duhet të ishte pasqyruar nëpërmjet akteve të miratuara nga Titullari në cilësinë e kryetarit të GMS dhe Koordinatorit të riskut.

**2.2 Strategjia e riskut** përcakton mënyrën se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t'u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre.

Duhet theksuar se në procesin e miratimit të planeve vjetore të punës, duhet të merren parasysh risqet më të rëndësishme që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara. Gjithashtu e rëndësishme është që të ketë një lidhje në mes të planeve vjetore të punës me planin strategjik të njësisë publike. Lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike. Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut

Nga auditimi rezulton se në lidhje me *identifikimi i riskut, vlerësimi i riskut, adresimi i riskut dhe shqyrtimi i riskut është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut.*

**2.3 Gjurmët e auditimit** janë një instrument mbështetës për menaxhimin e njësisë. Gjurmët e Auditimit përfshijnë operacione të cilat nisin dhe përfundojnë brenda një strukture organizative, por që mund të përshkojnë gjatë rrugës së tyre, disa struktura organizative, dhe madje disa njësi. Gjurma e Auditimit informon mbi: Përshkrimin e qartë të ecurisë së operacionit; Gjurmimin e operacionit prej fillimit në fund; Të gjithë dokumentet që janë marrë ose janë gjeneruar gjatë procesit; Aktivitetet e rëndësishme të kontrollit, që garantojnë ecurinë e duhur të operacionit; Kush e merr një vendim të caktuar gjatë ecurisë së operacionit; Sistemet e IT-së që mbështesin

operacionin; Kush mban përgjegjësinë finale për procesin – veçanërisht në rastet kur në kryerjen e një operacioni marrin pjesë disa njësi organizative.

Nga sa më sipër nga ana e Bashkisë Elbasan, grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion Gjurmët e Auditimit , kjo pasi Titullari i Bashkisë në cilësinë e NA, *nuk ka miratuar* gjurmët e auditimit.

Lidhur me *Menaxhimin dhe Mirëmbajtjen e Sistemeve IT*, nga specialisti IT i Bashkisë Elbasan, u vu në dispozicion ky informacion si më poshtë:

Nr	Sistemi	Pronesia	Njësitë që e perdorin	Kujt i shërben	Administrimi
1	TAIS	Bashkia Elbasan	Taksat Vendore	Bashkise Bizneseve	E.H
2	Strehimit	Ministria e Financave	Strehimit	Bashkise Individeve	E.H
3	E-Leje	Ministria e infrastruktures	Urbanistika Financa Projektet Zjarrfikesja	Bashkise Bizneseve Individeve	E.H
4	HelpDesk	Bashkia Elbasan	Bashkia	Bashkise	E.H
5	SQDNE	Kryeministria	1 specialist	Ministrive	Kryeministria
6	Afmis	Ministria e Financave	Financa	Bashkise	Ministria e Financave
7	SIFQ	Ministria e Financave	Financa	Bashkise	Ministria e Financave
8	O.S.SH	Qeveria	Bashkia	Bashkise Qytetareve	Spektori IT
9	Microsoft Office		Bashkia	Bashkisë	Të gjitha

**Burimi:** *Bashkia Elbasan/SIT*

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe komunikimi mbi implementimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe programeve IT rezultoi se: Ka dhomë serverash dhe servera të hostuar, ka rregullore për përdoruesit e sistemeve, kryhet back-up i sistemeve; por **u konstatua** se *nuk ka* dokumentim të procedurave dhe veprimeve që kryhen në sistem, *nuk janë* zhvilluar programe trajnimi për përdoruesit e sistemeve IT, *nuk është mundësuar* pjesëmarrja për trajnim të specialistëve IT.

Për sa më lart, në moszbatim të VKM nr. 710/2013 “Për Krijimin dhe Funkcionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”; “Rregullore për ndërtimin e dhomës së serverave” hartuar nga AKSHI/2008; Udhëzimit nr.115 dt.17.03.2014 “Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit; Ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 9 pika 4/dh; “Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” Kapitulli III pika 3.1

**b.Lista (Harta) e Proceseve/Manuali i Procedurave të punës.** Pamja e përgjithshme e procesit përmban një vështrim të përgjithshëm të aktiviteteve dhe procedurave që parashikojnë mënyrën e realizimit të proceseve të veçanta, sikurse dhe dokumentacionin që përdoret gjatë ecurisë së tyre. Ajo garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit, që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të procesit; shkresat/ formularët tip si dhe disa Seksione të tjera plotësuese të tyre (procedurave).

**Konstatim:** Bashkia Elbasan nuk ka hartuar listën (hartën)/manualin e proceseve të punës, në moszbatim të Ligjit nr. 10296 /2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980 datë 15.07.2010 dhe Manualin e ri me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108/2016 Kapitulli III pika 3.3.

### 3. Veprimtaritë e Kontrollit

Veprimtaritë e Kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në rregulloren e brendshme ku në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave.

Për të qenë efektive, aktivitetet e kontrollit duhet të jenë: Të përshtatshme; Efektive nga pikëpamja e kostos; Të gjithanshme; Të dokumentuara qartë etj.

- Në Bashkinë Elbasan për realizimin e objektivave me efikasitet, ekzistojnë dhe përdoren manuale për proceset kryesore operacionale dhe financiare, të cilët specifikojnë qarkullimin e dokumentacionit:

Nr.	Sektorët	Manualet që përdoren
1	Sektori i Financës	» Manuali i Klasifikimit të llogarive
		» Manuali i pasqyrave financiare
2	Drejtoria e Shërbimit Urban dhe Shërbimeve Publike	» Manuali teknik i punimeve të ndërtimit në fuqi, miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015” Për miratimin e manualeve teknike të punimeve të ndërtimit dhe të analizave të tyre.
3	Njësia e Prokurimit	» Manuali mbi prokurimin elektronik në SPE të blerjeve me vlerë të vogël
		» Manuali mbi përdorimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE)

Lloji i Kontrollit që duhet të zbatohen në çdo njësi publike janë: parandalues dhe pas faktit. Në Bashkinë Elbasan kontrollet pas faktit realizohen nga NJAB të Bashkisë etj., pra jo nga personat përgjegjës apo personat që marrin pjesë në kontrollet para faktit; ndërsa ato parandaluese janë dhe paraqiten si më poshtë vijon:

- a. Kontrolle në shqyrtimin e dokumentacionit që nënshkruhet, praktika e saj dhe verifikohet saktësia e materialit;
- b. Ekzekutimi dhe regjistrimi i transaksioneve financiare nuk bëhen nga i njëjti person (NA-NZ);
- c. Të gjitha angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA&NZ (sistemi i dy firmave);
- d. Çdo dalje e Aktiveve afatgjata autorizohet dhe monitorohet nga NA; kontroll i dokumenteve të inventarëve, regjistrave financiarë, librat e kontabilitetit etj.;
- Bashkia Elbasan *nuk disponon* rregullore të veçantë për menaxhimin e aktiveve të saj;
- e. Rregulloret për Sistemet IT i vihen në dispozicion çdo përdoruesi, por *nuk janë hartuar plane* vjetore për trajnimin e specialistit IT dhe të përdoruesve të sistemeve IT;
- f. Parashikuar procedura të qarta mbi komunikimin e shkresave brenda dhe jashtë Bashkisë: hyrja, trajtimi, mbajtja e dokumentacionit lidhur me depozitimin e protokollimin, komunikimin shkresor elektronik;
- g. Komunikimi dhe trajtimi i urdhrave të brendshëm dhe udhëzimeve përshtatur sipas përgjegjësive individuale të çdo pozicioni;
- h. Ndarja e detyrave i referohet strukturës organizative institucionale, ku secili punonjës kryen detyrën sipas akt emërimit dhe Formularit të përshkrimit të punës;
- i. Institucioni përgjithësisht zbaton rregullat e përcaktuara në “Normat tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të shërbimit arkivor” për ruajtjen e dokumenteve, për trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin gjatë punës, por *nuk ka një rregullore të veçantë* dhe një plan veprimesh për mirëfunksionimin e arkivit dhe të shërbimeve që ajo ofron, të miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë;
- j. Bashkia Elbasan ka ngritur Njësinë e Sinjalizimit, ka hartuar dhe miratuar Rregulloren “Për hetimin administrativ të sinjalizuesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve nga njësia e sinjalizimit”, Rregullore “Për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja nga njësia e sinjalizimit”, në zbatim të Ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”
- k. Bashkia Elbasan ka faqen e saj zyrtare në ëeb me adresë <https://www.bashkiaElbasan.gov.al/> dhe pasaportën e Bashkisë në Portalin Porta Vendore me adresë

<https://portavendore.al/bashkia-Elbasan/pasaporta-e-bashkise-Elbasan/>, të cilat përdorin një lidhje të sigurt (connection security) *HTTPS* (Hyper Text Transfer Protocol Secure), që do të thotë se serveri i faqes së internetit përdor një certifikatë sigurie, për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletuesit e ndryshëm;

Plani i Kontrollit të Brendshëm është një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit (kush, kur dhe si të kontrollosh) me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen. Mungesa e planeve të kontrollit kanë ndikuar dhe në mos monitorimin e detyrave që menaxherët i ngarkojnë stafit, mbi cilësinë dhe afatet e përmbushjes së tyre;

Veprimtaritë e kontrollit, përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut.

**Konstatim:** Nga Bashkia Elbasan nuk është hartuar/miratuar një Plan i Kontrollit të Brendshëm periodik apo vjetor, kjo në moszbatim të nenit 22, pika 1 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, “Manualit për Menaxhimin financiar dhe kontrollin” Kapitulli III pika 3.3.

#### **4. Informacioni dhe Komunikimi**

Drejtuesit e institucionit (NA & NZ të të gjitha niveleve) kanë informacion të pamjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit; pasi nga ana e menaxherëve të të gjitha niveleve dhe niveli ekzekutiv, nuk kanë kryer mjaftueshëm trajnime mbi Ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të organizuar nga ASPA.

Mungesa e realizimit të takimeve të GMS, e trajnimeve të stafit për njohjen dhe zbatimin e ligjit “Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” si dhe Rregullore e Brendshme e pa përditësuar ka riskuar harmonizimin në bashkëpunimin dhe bashkërendimin e detyrave gjatë procedurave apo proceseve brenda sektorëve/drejtorive si dhe ndërmjet sektorëve/drejtorive me drejtorinë ligjore, me qëllim ruajtjen e komunikimit ndërmjet njësisë brenda strukturës së Bashkisë, Bashkisë me njësitë Administrative dhe Bashkisë me institucione të tjera publike dhe jo vetëm. Informacioni shkëmbehet në nivel Horizontal dhe Vertikal.

**a.** Në Bashkinë Elbasan me anë të Urdhrit administrativ nr. 565 datë 07.04.2016 dhe me nr. prot., 2607 datë 07.04.2016, është caktuar znj. A.T me detyrën edhe të Koordinatorit për Informim dhe Koordinatori i Transparencës konform Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 15, 16 dhe Ligjit nr. 119/2014 “Për Informimin Publik”. Koordinatori për Informim dhe Koordinatori i Transparencës sipas nenit 10 ka për detyrë: Trajtimin e kërkesave të qytetarëve; Krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve; Bashkërendimin e përpjekjeve për të koordinuar të drejtën e informimit. Koordinatori për Informim përpilon raporte periodike 6 mujore dhe i përcjellë te titullari. Pra një detyrim i vërtetë i Koordinatorit është se ai krijon, mban, publikon dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve sipas shkronja b, pika 2 e nenit 10. Çdo informacion dhe njoftim publikohen në WEB-in e Bashkisë Elbasan.

Mos hartimi dhe mos miratimi i Manualit të Procedurave dhe i Gjurmëve të Auditimit, mungesa e raportimeve me informacion të plotë e të detajuar, riskon të pasurit e një komunikimi jo shumë efektiv e harmonik, si dhe paqartësi në ndarjen e detyrave dhe monitorimin e zbatimit të tyre;

**b.** Buxheti diskutohet në të gjitha nivelet e Institucionit (edhe ato të varësisë);

**c.** Zhvillohen analiza vjetore të arritjeve të objektivave të Bashkisë Elbasan;


**d.** Drejtoria e Burimeve Njerëzore, është përgjegjëse për komunikimin me Subjektet kryesore të jashtme (ka korrespondencë shkresore zyrtare dhe elektronike sipas rastit) si dhe e çdo dokumenti administrativ (operacional e financiar) në institucion; ajo përzgjedh formën e komunikimit (shkresor të protokolluar apo elektronik) sipas rastit. Duhet të aplikohet rregullisht komunikimi elektronik ose shkresor (komunikim i brendshëm), duke evituar komunikimin verbal me qëllim forcimin e gjurmës së auditimit;

e. Çdo muaj bëhet akt rakodimi me Degën e Thesarit dhe raportimi i bëhet Titullarit të Bashkisë (NA);

f. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për çdo problem apo paqartësi, në rrugë shkresore të protokolluar dhe elektronike.

## 5. Monitorimi

Mungesa e takimeve të GMS me Koordinatorin e Riskut, mos hartimi i gjurmëve të auditimit, një Rregullore e funksionimit të NJVQV/ Bashkia Elbasan e papërditësuar, mungesa e Rregullores së menaxhimit të aktiveve të njësisë, ka sjellë mos efektivitet në procesin e monitorimit, pasqyruar kjo në mos hartimin e raporteve vjetore nga GMS, të raporteve periodike të menaxherëve të nivelit të ulët, të mesëm mbi ecurinë dhe realizimin e produkteve të njësisë publike (bashkisë), si dhe identifikimin e fushave të cilat nuk janë realizuar në masën e pritshme, duke analizuar dhe shkaqet përkatëse. Ky raportim bëhet nga personeli përgjegjës i çdo drejtorie tek eprori dhe eprorët ia përcjellin titullarit, në cilësinë e NA dhe Kryetarit të GMS. Raportimi mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë, përmban informacione dhe evidenca të ndryshme, ku bazohet dhe Raporti 4 mujor dhe vjetor i monitorimit, i cili i dërgohet Ministrisë së Financave.



Skema e Monitorimit në NJVQV/Bashkia

- Ky Raportim bëhet në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 68 /2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, nenit 65 të ligjit nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë” e të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22/2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësisve të Vetëqeverisjes Vendore” dërgohet në Këshillin Bashkiak dhe MFE; Nga Drejtoria e Buxhetit dhe e Financës Bashkia Elbasan, nga auditimi rezultoi se janë dërguar zyrtarisht raportet e monitorimit të buxhetit të vitit 2022 dhe Pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të MFK për vitin 2022, Deklaratën e cilësisë dhe Raportin vjetor të funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm” me shkresën nr. 1631 prot., datë 15.02.2023.

Duke analizuar me kujdes të gjitha procedurat që ndiqen në funksion të arritjes së objektivave të Bashkisë Elbasan, **u konstatua** se baza rregullatore mbi të cilën mbështetet aktiviteti funksional i saj, është e paplotë për rrugët që duhen ndjekur në konturimin dhe forcimin e sistemeve të kontrollit, duke e parë si sistem dinamik (të jetë koherent me çdo akt ligjor apo nënligjor që miratohet). Kjo arrihet duke forcuar aktivitetin e GMS, si një rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të punës për çdo drejtori dhe njësi varësie dhe atë të koordinatorit të MFK dhe të Riskut, në zbatim të Ligjit nr. 10296 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Manualit MFK, Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të riskut”, me qëllim që të mund të kontrollojnë, të konstatojnë dhe të sistemojnë në kohë reale edhe parregullsinë më të vogël të procedurave të përditshme, duke minimizuar riskun e kthimit të tyre në fenomen.

**Pretendime të subjektit:** Në observacionin mbi akt Konstatimin nr. 7 që subjekti Bashkia Elbasan/Agjencia e Pyjeve, Bujqësisë dhe Mjedisit/Inspektorati i Mjedisit ka dërguar me shkresën

nr. 4474/29 prot., dt. 20.11.2023 dhe me nr. 767/3 prot., (i KLSH) dt. 24.11.2023, lidhur me konstatimin e fq.9 ndër të tjera shprehet” nga auditimi u konstatua se nga strukturat përgjegjëse për mjedisin, nuk janë hartuar plane masash parandaluese dhe edukuese në veçanti për mbrojtjen e mjedisit...” ju informojmë se: struktura përgjegjëse për mjedisin e konkretisht Inspektorati i mjedisit, ka hartuar planin vendor i mbrojtjes së mjedisit për vitin 2020-2022, ku në brendësi të saj ka planifikuar masa edukuese dhe ndërgjegjësuese, si dhe veprime konkrete për mbrojtjen e mjedisit. (bashkëngjitur plani )

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Lidhur me pretendimin tuaj, ju sjellim në vëmendje si më poshtë vijon:

1. Rregullorja e Brendshme (e papërditësuar) e miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 55 datë 08.02.2017 dhe nr. 1117 prot., datë 08.02.2017 dhe që i përket strukturës organizative të vitit 2017, nuk ka të përcaktuar strukturën që ka për detyrë hartimin e planit dhe masat për mbrojtjen e mjedisit ku përfshihen hartimi, përcaktimi i strukturave zbatuese dhe monitorimi i planeve mjedisore për gjithë elementët e tij (mjedisit), kjo në moszbatim të nenit 9 pika1/c të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” ku ndër të tjera citohet./...“Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: Të drejtën dhe përgjegjësinë e vetëqeverisjes, sipas së cilës krijojnë struktura administrative për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tyre, sipas ligjeve në fuqi”; nenit 26 “Funksionet e bashkive në fushën e mbrojtjes së mjedisit”: Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

- Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja.
- Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen nga ndotja akustike.
- Zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit;

nenit 27 pika6 “Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit”: Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

- Mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Inspektoratet e mjedisit në rastin konkret, kanë për detyrë të kontrollojnë zbatimin e akteve ligjore e nënligjore nga ato subjekte ushtrimi i aktivitetit të të cilave mbartin risk në ndotjen e mjedisit, pra kanë rol verifikues dhe ndëshkues ndaj subjekteve kundërvajtëse

3. Plani vendor që i keni bashkëngjitur observacionit, nuk është i shoqëruar edhe me dokumentacionin përkatës justifikues, mbi angazhimet apo aktivitetet konkrete të realizuara nga njësitë përgjegjëse për cdo pikë të tij. Kështu që nuk mund të japim një vlerësim objektiv mbi zbatimin e planit dhe monitorimin e tij.

Për sa më lart grupi i auditimit të KLSH lidhur me hartimin e planit vendor të mbrojtjes së mjedisit për vitin 2020-2022 e merr pjesërisht në konsideratë observacionin e subjektit, ndërsa për mungesën e dokumentacionit justifikues mbi zbatimin e planit dhe monitorimin nuk e merr në konsideratë observacionin e subjektit.

**Titulli i Gjetjes:** Mbi implementimin dhe zbatimin e Menaxhimit Financiar dhe të Kontrollit të Brendshëm

**Situata:** Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera në Bashkinë Elbasan u konstatua si mëposhtë vijon:

**Mjedisi i kontrollit:**

1. Bashkia Elbasan nuk ka hartuar dhe miratuar “Rregulloren e Posaçme për Parandalimin e konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksioneve publike” me nr. 1612 prot., datë 24.01.2022, në moszbatim të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”



neni 9, pika 1/1 germa 'b', neni 46; Ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 "Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" i ndryshuar.

**2.** Nga auditimi i strukturave organizative që ka kompozuar Bashkia Elbasan, nga verifikimet e dokumentacionit dhe analiza e informacionit të pasqyruar edhe në tabelë, rezultoi se për funksionin "Mbrojtja e Mjedisit" neni 26, nënfunkcionin "shërbimi parësor shëndetësor" i funksionit "Infrastruktura dhe Shërbime publike" neni 23, në strukturën e Bashkisë Elbasan, ky funksion nuk mbulohet nga një njësi e veçantë, por DSHPBVM<sup>9</sup>, ndonëse në emërtimin e saj ka termin mjedis, nuk ka sektor apo dhe një specialist mjedisi që të mbulojë problemet mjedisore të territorit të bashkisë.

- Gjithashtu nga struktura përgjegjëse për mjedisin- Inspektorati i mjedisit, është hartuar Plani vendor i mbrojtjes së mjedisit për periudhën 2020-2022, por nuk ka analiza dhe raporte mbi zbatimin e monitorimin e tij. Pra Bashkia Elbasan në fillim të vitit 2022 e në vijim nuk ka funksionuar me një strukturë që i mbulon të gjitha funksionet/nënfunkcionet për të ofruar të gjitha shërbimet komunitetit, duke ushtruar kompetencat që i atribuon Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" Kreu VII në nenet 23-30.

**3.** Bashkia Elbasan nuk ka përditësuar Rregulloren e funksionimit të Brendshëm sipas strukturave organizative të miratuara.

**4.** Nga testimi me zgjedhje të dosjeve të personelit (kampioni që përzgjedhëm), emëruar/larguar në 2022 rezultoi se përgjithësisht dosjet e personelit përmbanin dokumentacionin përkatës të dosjeve, por u konstatuan edhe këto mangësi:

- Në *dosjet e personelit* mungonin praktika e plotë e punësimit nga shpallja e pozicionit deri në emërimin e tij; nuk ishin bërë pjesë e dosjes vlerësimi 6 dhe 12 mujor; formulari i vetëdeklarimit mbi vërtetësinë e të dhënave/ mbi verifikimin e gjendjes gjyqësore apo ai në zbatim të ligjit nr. 138/2015 (sipas rastit); formulari i përshkrimit të punës për pozicionet me Kod pune.

- *Dosjet e punonjësve të larguar* në praktikën e plotë të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës nga njoftimi deri në vendimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, mungonte procesverbali i dorëzimit të bazës materiale që ka patur punonjësi në ngarkim;

Për të gjitha këto konstatime, nuk janë zbatuar: Ligji nr. 152/2013 i ndryshuar "Për nëpunësin civil" neni 17 pika 1,4; VKM nr. 117, datë 5.3.2014 Lidhja 1 e 2; VKM nr. 243/2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive" i ndryshuar; Ligji nr. 7961 /1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë" Kreu VII, XIV.

**5.** Nëpunësi Autorizues dhe struktura përgjegjëse e bashkisë Elbasan/Drejtoria e Administrimit dhe Burimeve Njerëzore, nuk kanë hartuar dhe miratuar plane dhe programe vjetore *efektive* për trajnimin e detyrueshëm të të gjithë punonjësve në zgjerimin e njohurive të tyre për proceset e punës dhe të aftësive për t'i kryer me efikasitet ato, dhe kryesisht për njohjen nga stafi dhe menaxherët e njësisë mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, në moszbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 64 pika h, Ligjit nr. 10296 /2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar dhe "Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" Kapitulli III pika 3.1

#### Menaxhimi i riskut:

**4** Bashkia Elbasan deri më 31.12.2022 nuk ka realizuar takime të dokumentuara të GMS për rolin dhe aktivitetin e tij në shërbim të Njesisë publike, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, Kreu II neni 8, pika 8/b; nenit 27 pika 1,2; dhe "Manualin e Menaxhimit financiar dhe kontrollin" miratuar nga Ministri MFE me nr. 8980 /2010 dhe ai i ri me nr. 108/2016 Kapitulli II pika 2.2.6.

**5.** Nga auditimi rezulton se, gjurmët standarde të auditimit nuk janë hartuar dhe miratuar nga titullari i njësisë, si një dokument i unifikuar për të gjitha proceset e Bashkisë Elbasan, në

<sup>9</sup> Drejtoria e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore

kundërshtim kjo me ligjin nr. 10296/2010 i ndryshuar, neni 16 pika 2; Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” kapitulli V; Udhëzimit nr. 30 dt. 27.12.2011 i ndryshuar, neni 121 e122.

**6.** Nga verifikimi i dokumentacionit dhe komunikimi mbi implementimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe programeve IT, u konstatua se:

**1.** Dhoma e serverëve nuk është sipas standardeve të përcaktuara në aktet nënligjore dhe rregulloret përkatëse të miratuara nga AKSHI;

**2.** Nuk ka rregullore për përdoruesit e tjerë të këtyre sistemeve, ku të përcaktohet dhe ndarja e detyrave, siguria në komunikim;

**3.** Dokumentacion mbi procedurat e backup (për ato programe e sisteme të hostuara fizikisht në ambientet e bashkisë/dhomës së serverëve), mangësi të Marrëveshje Nivel Shërbimit (MNSH) dhe dokumentacioni mbi procedurat e veprimeve në sistem, regjistër për dokumentimin e problematikave të tyre etj, ku mundësohet gjurma e auditimit të aktivitetit dhe efienca e tyre. Përdorimi i IT në këto kushte cenon aktivitetin ekonomik e financiar të bashkisë dhe paraqet risk në komprometimin e të dhënave që këto sisteme ruajnë dhe administrojnë. Të gjitha këto në moszbatim të VKM nr. 710/2013 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”; “Rregullore për ndërtimin e dhomës së serverëve” hartuar nga AKSHI/2008; Udhëzimit nr. 115 dt. 17.03.2014 “Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit”.

**7.** Bashkia Elbasan nuk ka hartuar listën (hartën)/manualin e proceseve të punës, në moszbatim të Ligjit nr. 10296 /2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980 datë 15.07.2010 dhe Manualin e ri me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108/2016 Kapitulli III pika 3.3;

*Veprimtaritë e kontrollit:*

**8.** Nga Bashkia Elbasan nuk është hartuar/miratuar një Plan i Kontrollit të Brendshëm periodik apo vjetor, kjo në moszbatim të nenit 22, pika 1 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, “Manualit për Menaxhimin financiar dhe kontrollin” Kapitulli III pika 3.3. (sipas Aneksit nr. 11).

**9.** Mungesa e aktivitetit të GMS në Bashkinë Elbasan ka bërë që njësia të ushtrorë funksionet e veta pa hartuar/pa miratuar një strategji dhe një rregullore për menaxhimin dhe ruajtjen e aktiveve afatgjata materiale si dhe për minimizimin e risqeve ndaj tyre, në moszbatim të Ligjit nr. 10296/2011 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 27, Manualit MFK pika 2.2.6; Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”.

*Informimi dhe komunikimi:*

**11.** Drejtuesit e institucionit (NA & NZ të të gjitha niveleve) kanë informacion të pamjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit si dhe nuk kanë kryer trajnime mbi Ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të organizuar nga ASPA. Mungesa e realizimit të takimeve të GMS dhe e trajnimeve të stafit për njohjen dhe zbatimin e ligjit “Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ka riskuar harmonizimin në bashkëpunimin dhe bashkërendimin e detyrave gjatë procedurave apo proceseve brenda sektorëve/drejtorive si dhe ndërmjet sektorëve/drejtorive me drejtorinë ligjore, me qëllim pasjen dhe ruajtjen e një komunikimi me efektivitet, ndërmjet njësisve brenda strukturës së Bashkisë, Bashkisë me ndërmarrjet në varësi të saj dhe Bashkisë me institucione të tjera publike dhe jo vetëm.

*Monitorimi:*

**12.** Nga auditimi i procedurave që ndiqen në funksion të arritjes së objektivave të Bashkisë, u konstatua se baza rregullatore mbi të cilën mbështetet aktiviteti funksional i saj, është e paplotë për rrugët që duhen ndjekur në konturimin dhe forcimin e sistemeve të kontrollit, duke e parë si sistem dinamik (të jetë koherent me çdo akt ligjor apo nënligjor që miratohet). Kjo arrihet duke forcuar aktivitetin e GMS që është rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të punës për çdo drejtori dhe njësi varësie dhe atë të koordinorit të MFK dhe të riskut, në zbatim të Ligjit

nr. 10296 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Manualit MFK, Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të riskut”;

**Kriteri:** Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; Udhëzimin nr. 16, dt. 20.07,2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Udhëzimi nr. 21/2016 “Për menaxherët e të gjitha niveleve”; Ligji nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” Kreu VI, neni 32 pika 2/a,b,c; Ligji nr. 152 datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin civil në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 7961 dt. 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 9 / 3,4 5; neni 11 pika 1/c, e, f; neni 12; neni 19/1,2,3; neni 20; Ligji nr. 10325/2010 “Për bazën e të dhënave shtetërore”; VKM nr. 117 dt. 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” Lidhja 1 e 2; VKM nr. 243/2014 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar; VKM nr. 142 /2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”; me VKM nr. 746/2018 VKM nr. 639 dt. 07.09.2016 ndryshuar me VKM nr. 596 dt. 04.09.2019 “Për përcaktimin e rregullave të procedurave e të llojeve të testeve ekzaminuese mjekësore, që do të kryhen në varësi të punës së punëmarrësit, si dhe të mënyrës së funksionimit të shërbimit mjekësor në punë”; Ligji nr. 9887 dt. 10.03.2003 ose ligji nr. 138 dt. 17.12.2015; Ligji nr. 9049/2003 i ndryshuar, Ligji nr. 9367/2005 dhe Udhëzimi nr. 1 dt. 7.06.2014 të Inspektorit të Përgjithshëm të “Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”; Ligji nr. 119/2014 “Për informimin publik” dhe Udhëzimi i viti 2016 “Mbi detyrat e Koordinatorit të Informimit dhe transparencës”.

**Ndikimi:** Nga Bashkia Elbasan nuk janë zbatuar rigorozisht elementët nga të cilët përbëhen 5 (pesë) Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. duke riskuar kështu sigurinë e arritjes së objektivave të Bashkisë nëpërmjet përdorimit me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore.

**Shkaku:** Gjatë periudhës nën auditim Bashkia Elbasan nuk ka treguar vëmendjen dhe përgjegjshmërinë e duhur për plotësimin e aktiviteteve të kontrollit me dokumentacionin përkatës (manuali i procedurave, gjurmët e auditimit, plan vjetor kontrolli të brendshëm, si dhe hartimin e planeve vjetore për rritjen profesionale të stafit dhe njohjen nga ana e tij dhe e menaxherëve të njësisë me ligjin për MFK, miratimin e tyre nga NA – Kryetar i Bashkisë, të cilat orientojnë në zbatueshmërinë e procedurave të saj konform dispozitave ligjore në fuqi.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Elbasan, marrë masa për njohjen nga menaxhimi dhe nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, të rritjes dhe forcimit të aktivitetit GMS, të koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut, të përditësojë Rregulloren e brendshme sipas strukturave organizative të miratuara, të miratojë gjurmët e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, forcimin dhe standardizimin në menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe programeve IT, për forcimin e aktiviteteve të kontrollit, informimit dhe monitorimit në bashki.

-GMS dhe Koordinatorin i menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe Koordinatorit të riskut, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e planit strategjik dhe planit vjetor për aktivitetet dhe çështjet që duhet të analizojë dhe grafikun e takimeve që do realizojë, për hartimin e raporteve vjetore, si një rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të punës për çdo drejtori dhe njësi varësie, për të arritur objektivat institucionale në shërbim të komunitetit.

- Nëpunësi Autorizues, Nëpunësi Zbatues dhe GMS të marrin masa për miratimin e një rregulloreje për menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e aktiveve afatgjata të njësisë nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, në zbatim të akteve ligjore në fuqi.

-Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme të marrë masa për të hartuar plane dhe programe trajnimi për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë; të kontribuojë në krijimin e një strukture organizative sa më efektive, plotësimin me personel të saj, për të rritur efektivitetin e shërbimeve dhe funksioneve që i atribuon ligji në dobi të komunitetit.

## **I/2-Vlerësimi dhe aktivitetit i Auditit të brendshëm në sektorin publik.**

Njësia e auditimit të brendshëm - [NJAB] në bashkinë Elbasan, është e organizuar në nivel drejtorie miratuar me VKB nr. 117 datë 14.12.2021 “Miratimin e Strukturës Organizative të Bashkisë së Elbasan për vitin 2022”, në përbërjen e të cilës janë pozicionuar 5 auditues të brendshëm në strukturën e bashkisë (1 përgjegjës + 4 auditues), konform kërkesave të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe pikat 3 dhe 6 të, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, rëndësia e të cilës konsiston në faktin se “Njësia e Auditimit të Brendshëm” ka funksion kryesor mbështetjen e menaxhimit të lartë në zbatimin e objektivave, për Bashkinë Elbasan, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, germa “c” si dhe nenit 64, germa “a” të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

**b. Plani strategjik** 2021- 2023 dhe ai vjetor 2021 i veprimtarisë së NJAB është dërguar në Ministrinë e Financave/Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm me shkresën nr. 4640/1 prot., datë 19.10.2020;

Plani 2022-2024 dhe ai vjetor 2022 i veprimtarisë së NJAB është dërguar në Ministrinë e Financave/Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm me shkresën nr. 4171 prot., datë 18.10.2021

Planet dhe të NJAB të Bashkisë Elbasan, janë dërguar në Ministrinë e Financave brenda afateve të përcaktuara në Ligjin 114/2015 “Për e në ”, në “Manualin e të në ”.

**c. Plani strategjik i** në njësitë e sektorit publik/ NJVQV, mbështetet në programet dhe objektivat e NJQV-së (dhe të ) ku ushtron veprimtarinë audituese, si dhe në *identifikimin dhe vlerësimin e risqeve* që ndikojnë në (mos)realizimin e objektivave të këtyre njësive. NJAB mbi bazën e njohjes dhe të studimit të objektivave strategjike dhe të risqeve të njësive publike, evidenton jo vetëm subjektet dhe fushat e auditimit që do të realizohen në (PSA), por edhe frekuencën e realizimit të këtyre auditimeve. Planifikimi i auditimit bëhet duke patur parasysh anën funksionale e organizative të subjekteve që janë objekt auditimi, raportet vjetore të institucionit, raportet e mëparshme të auditimit të brendshëm, rekomandimet e auditimit të jashtëm (KLSH), regjistrat e riskut dhe këshillat/opinionet e drejtuesve të njësive respektive në strukturë. Nga NJAB janë hartuar të aktivitetit të saj ose e sigurimit të dhe i riskut *për vitin 2022* miratuar nga i me nr. 1631 datë 15.02.2023, të cilat janë dorëzuar në Drejtorinë e Ptë Htë Ktë BFPnë MFE/Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm *brenda afatit* të përcaktuar në “Manualin i Auditit të Brendshëm”, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 100/2016;

**Baza rregullatore** mbi të cilën mbështetet aktiviteti i NJAB Bashkia Elbasan;

✓ “Kodi i Etikës së Audituesit të Brendshëm” hartuar nga Përgjegjësi i NJAB dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Elbasan me nr. 278 prot., datë 19.01.2021;

✓ “Kartën e Auditimit të Brendshëm” hartuar nga Përgjegjësi i NJAB dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Elbasan me nr. 6124/1 prot., datë 08.01.2021;

✓ Rregullorja e funksionimit të NJAB të Bashkisë së Elbasan miratuar me Vendim të Kryetarit nr. 277 datë 19.01.2021;

**d. Struktura e n:** Situata e strukturës së NJAB-së në Bashkinë Elbasan nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

NjAB	Drejtor	Specialist Auditues	Kualifikimi profesional	Emëruar	Numri i punonjesve Plan / Fakt
Viti 2021/2022	1	4		Me /pa certifikatë	5 5
G.P	deri më 26.08.2022		Menaxhim biznesi	Po / 2011	x
B.H	nga 31.08.2022		ekonomik	Po / 2023	x
S.B		x	Juridik	Po / 2013	x
A.S		x	Financë kontabel	Po /2023	x
A.Q		deri më 26.09.2022	Financë	Po / 2017	x
A.A		x	Financë kontabel	Po / 2017	x
M.C		nga 01.10.2022	Financë kontabel	Jo /	x
N.Z		nga 07.11.2022	Ekonomi dhe e drejta	Jo /	x

Burimi :Bashkia Elbasan

Referuar ligjit nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm“ në çdo institucion bazuar në disa kritere të përcaktuara në VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Mbi Miratimin e Kritereve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, me VKB nr. 117 datë 14.12.2021 “Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Elbasan dhe institucioneve vartëse të saj si dhe miratimin e nivelit të pagave për vitin 2022” dhe Vendimit të Kryetarit të Bashkisë nr. 866 datë 04.10.2021 “Për miratimin e Strukturës/Organikën/Kategoritë e Nivelin e pagave/Klasën e pagave për çdo pozicion të administratës së Bashkisë dhe Njësive shpenzuese në varësi të Bashkisë Elbasan për vitin 2022” i ndryshuar.

Nga verifikimi i Strukturave organizative dhe tabela përmbledhëse rezulton se NJAB e Bashkisë Elbasan është krijuar dhe miratuar me VKB në rang drejtorie me 5 auditues (1+4) dhe vazhdon të funksionojë me po këtë strukturë, konform ligjit nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik“ dhe VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Mbi Miratimin e Kritereve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”; Drejtori i NJAB G. P. dhe 3 audituesit A.Q, A.A dhe S.B, gjatë vitit 2022 rezultojnë të pajisur me certifikatën e “Audituesit të brendshëm”, ndërsa B. Tashi në cilësinë edhe të drejtorit të NJAB (nga 31.08.2022 deri më 24.02.2023), specialistët e auditimit A.S, N.Z, M.C, rezultojnë të pa certifikuar si “Auditues të brendshëm” por në proces certifikimi. Gjatë periudhës në auditim NJAB ka funksionuar me këtë personel:

Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni	Vjetërsia në NJAB	Miratuar/Emëruar	Larguar/Liruar	Gjendja në 31.12.2022
1	G.P	Drejtor	13 vjet	Akt nr. 712 datë 23.10.2014	Akt nr. 937 datë 26.08.2022	
2	S. B	Auditues	11 vjet	Akt nr. 441 datë 04.11.2011	Akt nr. 296 datë 31.01.2023	√
3	A.S	-//-	1.5 vjet	Akt nr. 705 datë 02.08.2021		√
4	A.Q	-//-	6 vjet	Akt nr. 562 datë 07.04.2016	Akt nr. 928/2 datë26.08.2022	
5	A.A	-//-	6 vjet	Akt nr. 441 datë 16.03.2016	Akt nr. 1179 datë 07.11.2022	
6	M.C	-//-	3 muaj	Akt nr. 1074 datë 30.09.2022		√
7	N.Z	-//-	3 muaj	Akt nr. 1178 datë 07.11.2022		√

8	B.T	-//-	4 muaj	Akt nr. 955 datë 31.08.2022	Akt nr. 1043 datë 24.02.2023	√
<b>Totali sipas strukturës</b>						<b>5</b>

Burimi: Bashkia Elbasan

#### e. Trajnimet e n

Referuar Ligjit nr. 10296/2010, Manualit të MFK miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave . 8980, 15.07.2010, Manualit të me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108/2016 të MFK, Ligjit nr. 114/2015 “Mbi e ” dhe “Manualit të të në ”, nga Bashkia Elbasan është hartuar një plan vjetor trajnimesh për audituesit e NJAB, referuar planit vjetor të Drejtorisë me Urdhrin nr. 248 datë 31.12.2021; Për vitin 2022 NJAB ka kryer trajnimet si më poshtë vijon:

Nr	Tema e Trajnimit	Viti
1	Qasja audituese bazuar në risk	2022
2	Prokurimi publik dhe auditimi i partneritetit publik	
3	Auditimi i asistencës së para anëtarësimit në BE (IPA)	
4	Auditimi i njërive të vetëqeverisjes vendore	
5	Auditimi i brendshëm në sistemin e shëndetit publik	
6	Auditimi me bazë sistemi (ABS/System Based Audit)	
7	Auditimi i brendshëm në qeverisje	
8	Auditimi i shoqërive aksionare publike	
<b>Totali</b>		<b>40 orë</b>

Burimi: NJAB Bashkia Elbasan

Ndërsa është zhvilluar edhe trajnim rajonal tre ditor, për auditët e brendshëm vendore me temë ”Auditim i Detyrimeve të Prapambetura”, organizuar nga MFE dhe Projekti “Financat Lokale”, në të cilin kanë marrë pjesë dhe janë pajisur me Certificate edhe audituesit në proces certifikimi. Trajnimi i audituesve duhet të përmbushë planin vjetor prej 40 orëve në vit për çdo auditues (80 orë në 2 vjet), përcaktuar dhe programuar nga Drejtoria e Harmonizimit dhe realizuar nga ASPA. Për mirëfunksionimin e auditit të brendshëm, NJAB duhet të mbështeten në zbatimin me korrektësi të 7 (shtatë) parimeve të përgjithshme, të cilat janë:

**a)** ligjshmëria, **b)** paanësia, **c)** integriteti,  
**ç)** pavarësia dhe objektiviteti, **d)** profesionalizmi & zhvillimi i vazhdueshëm profesional,  
**dh)** kompetenca **e)** konfidencialiteti

Nga sa më lart përshkruam, rezulton se audituesit e NJAB të Bashkisë Elbasan, i kanë zhvilluar orët e plota të trajnimit të detyrueshëm të Drejtorisë së harmonizimit në MFE me shkresën nr. 23075 prot., datë 16.12.2022, në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në aktet ligjore/nënligjore në fuqi.

## II. Planifikimi dhe realizimi i auditimeve.

**2.1** NJAB e Bashkisë Elbasan ka hartuar të miratuara nga , konform përcaktimeve ligjore, i ka dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit në MFE/ brenda afatit kohor 20 Tetor. Çdo (2020-2022 2021-2023), përmban këto 5 (pesë) pasqyra :

*Pasqyra Nr. 1-* Plani i subjekteve të synuara për tu audituar për vitet, 2020-2022 2021-2023

*Pasqyra Nr. 2 -* Plani i të NJAB për vitet, 2020 2021

*Pasqyra Nr. 3-* Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NJAB për vitet 2020, 2021

*Pasqyra Nr. 4 -* Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitet 2020, 2021

*Pasqyra Nr. 5 -* Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet që auditohen për vitet 2020, 2021.

- Referuar Planeve Strategjike [2022-2024] dhe atij Vjetor [2022], planifikimi dhe grafiku i shpërndarjes së misioneve audituese për tu realizuar nga [NJAB] e Bashkisë Elbasan me nivelin e riskut, është sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Subjekte që Auditohen/Fusha	Plani Auditimit 2022
<b>I</b>	<b>Bashkia Elbasan</b>	<b>Niveli i riskut</b>
<b>1</b>	<b>Drejtoria e Integritimit Evropian, Projekteve strategjike dhe Inovacionit</b>	<b>I ulët</b>
<b>2</b>	<b>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Administrative</b>	
*	<b>Drejtoria Juridike</b>	<b>I mesëm</b>
	Performanca e detyrave funksionale, administrimi i tyre dhe përfaqësimi në proceset gjyqësore	
*	<b>Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore</b>	<b>I mesëm</b>
	Dosjet e personelit; pozicioni i punës sipas diplomës; bashkëpunimi në përlllogaritjen e vjetërsisë së pagueshme.	
*	<b>Drejtoria e Informacionit, statistikave dhe koordinimit</b>	<b>I ulët</b>
	Performanca dhe përputhshmëria në realizimin e objektivave	
<b>3</b>	<b>Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës</b>	
*	<b>Drejtoria e Buxhetit dhe e Financës</b>	<b>I mesëm</b>
	Sistemet në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, raportimit financiar dhe kontabilitetit;	
*	<b>Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore</b>	<b>I lartë</b>
	Sistemi i të ardhurave nga taksat, plotësia, saktësia dhe procedurat në ndjekjen e detyrimeve tatimore	
*	<b>Drejtoria e Aseteve, Pronave dhe Strehimit</b>	<b>I mesëm</b>
	Inventarizimi i pronave, menaxhimi i tyre dhe vlerësimi në kryerjen e procedurave dhënie/marrje me qira	
<b>4</b>	<b>Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban</b>	
*	<b>Drejtoria e Planifikimit dhe zhvillimit të Territorit</b>	<b>I mesëm</b>
*	<b>Drejtoria e Projektimit dhe Azhornimit Topografik</b>	<b>I mesëm</b>
<b>5</b>	<b>Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Strategjike, Sociale, Shërbimeve komunitare</b>	
*	<b>Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe medias</b>	<b>I ulët</b>
	Performanca dhe përputhshmëria në realizimin e objektivave	
*	<b>Drejtoria e Shërbimit të kujdesit social dhe komunitar</b>	<b>I ulët</b>
	Funksionimi i sistemit të shërbimit social ndaj shtresave në nevojë dhe ndihmës ekonomike	
<b>6</b>	<b>Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Arsimit parashkollor, Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Sportit</b>	
*	<b>Drejtoria e Politikave të Arsimit dhe Edukimit</b>	<b>I ulët</b>
	Performanca në realizimin e objektivave	
*	<b>Drejtoria e Politikave të Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Sportit</b>	<b>I ulët</b>
	Performanca në realizimin e objektivave	
<b>7</b>	<b>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe Prokurimeve Publike</b>	
*	<b>Drejtoria e Prokurimeve publike</b>	<b>I Lartë</b>
	Përputhshmëria, kryerja e proceseve, përcaktimi specifikimeve teknike-vlerësuese, zbatimi nga sektori i investimeve.	
*	<b>Drejtoria e Politikave të Shërbimit Urban</b>	
*	<b>Drejtoria e Emergjencave Civile</b>	<b>I mesëm</b>
	Realizimi i objektivave në evidentimin, monitorimin dhe ofrimin e shërbimit	
*	<b>Drejtoria e Shërbimeve Pyjore, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mjedisore</b>	<b>I mesëm</b>
	Lejet e shfrytëzimit, të ardhurat nga prodhimet dytësore dhe performanca në realizimin e detyrave dhe objektivave	
*	<b>Inspektorati i Mjedisit</b>	<b>I mesëm</b>
	<b>Inspektorati i Pyjeve</b>	
	Performanca në realizimin e objektivave, kryerja e funksioneve dhe të ardhurat nga vendosja e gjobave	
<b>8</b>	<b>Njësitë Administrative &amp; Lagjet e Qytetit</b>	<b>I mesëm</b>

	Funksionimi i sistemit të adresave, adresimi dhe zgjidhja e shqetësimeve/ankesave komunitare, vlerësimi i taksave/tarifave vendore familjare dhe niveli i realizimit/gjendjes debitore	
<b>II</b>	<b>Njësitë e Varësisë</b>	<b>Niveli i Riskut</b>
<b>1</b>	<b>Qendra Ekonomike e Arsimit</b>	<b>I mesëm</b>
	Shtimi i pagesave dhe niveli i shpenzimeve, respektimi i kuotës ushqimore, prokurimet, inventarizimet, veprimet me magazinën, analiza e detyrimeve të prapambetura	
<b>2</b>	<b>Qendra e Artit Teatri “Skampa”</b>	<b>I mesëm</b>
	Rregullsia e veprimeve financiare (sistemi i pagesave dhe prokurimeve), aktivitetet artistike dhe të ardhurat prej tyre.	
<b>3</b>	<b>Qendra e Trashëgimisë Kulturore</b>	<b>I mesëm</b>
	Sistemi i administrimit, planifikimit, pagesa e shpenzimeve, si dhe kryerja e veprimeve të menaxhimit financiar	
<b>4</b>	<b>Qendra Sociale “Balashe dhe Rome”</b>	<b>I mesëm</b>
	Procedurat e pranimit të përfituesve, sistemi i pagesave, prokurimeve, kryerja e veprimeve të raportimit financiar dhe analiza e detyrimeve të prapambetura	
<b>5</b>	<b>Klubi shumësportësh “Tomor Sinani” dhe mirëmbajtja e terreneve sportive</b>	<b>I mesëm</b>
	Sistemi i pagesave, menaxhimi i burimeve, prokurimet, niveli i shpenzimeve dhe respektimi i normativave të miratuara.	
<b>6</b>	<b>Agjencia e Shërbimeve Publike</b>	<b>I lartë</b>
	Sistemi i pagesave, pozicionimi në strukturë, prokurimet, niveli i shpenzimeve, menaxhimi i aktiveve, respektimi i normativave, analiza e detyrimeve të prapambetura	
<b>7</b>	<b>Njësia e Menaxhimit të Banesave Sociale</b>	<b>I mesëm</b>
	Raportimi financiar, sistemi i procedurave në kontraktimin e dhënies me qira, ndjekja dhe realizimi i të ardhurave	
<b>8</b>	<b>Institucioni i Shërbimit zjarrfikës</b>	<b>I ulët</b>
	Sistemi i pagesave dhe shpenzimeve, funksionimi i sistemit zjarrfikës, menaxhimi i aktiveve sipas normativave.	
<b>10</b>	<b>Misione Audituese të Planifikuara</b>	
<b>7</b>	<b>Misione Audituese të Realizuara</b>	

Punoi: Grupi i Auditimit

Nga tabela rezulton se për vitin 2022 janë vlerësuar me koeficientin e riskut “i lartë” – 3 njësi, “i mesëm” – 16 njësi dhe “i ulët” – 6 njësi, njësi të strukturës organizative /fushat/ sistemet e Bashkisë Elbasan, plotësia dhe saktësia e të cilave orienton NJAB për të hartuar një plan strategjik dhe plan vjetor sa më real dhe në shërbim të institucionit, për përmbushjen e detyrave funksionale që i atribuon ligji. Për vitin 2022 Plani vjetor i punës në NJAB është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Elbasan me nr. 4171/1 prot., datë 18.10.2021 dhe përmban 9 misione audituese të planifikuara dhe 1 zbatim rekomandimesh. Në total në vitin 2022 janë realizuar 7 misione audituese nga 10 misione të planifikuara. Për ndryshimin në programin dhe realizimin e planit vjetor 2022, NJAB ka vënë në dijeni zyrtarisht Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm [ DHAB] në MFE me shkresën nr. 16986/1 datë 19.10.2022.

- Planifikimi dhe grafiku i shpërndarjes së misioneve audituese është bërë mbi bazë risku dhe paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Viti	2021			2022		
Numri i auditimeve plan	10			10		
Numri i auditimeve fakt	11			7		
Niveli i riskut	lartë	mesëm	ulët	lartë	mesëm	ulët
Numri për cdo nivel fakt	3	8	-	4	3	-
Shprehur në % (ndaj planit)	<b>27.3</b>	<b>72.7</b>		<b>40</b>	<b>30</b>	

Punoi: Grupi i Auditimit

Nga auditimi rezultoi se për vitin 2021 nga 10 misione audituese të planifikuara janë realizuar 11; për vitin 2022 janë realizuar 7 misione audituese nga 10 të planifikuara dhe miratuar në Planin



vjetor të vitit 2022.

**2.2** Auditimet e planifikuara dhe realizuar nga NJAB e Bashkisë Elbasan, të klasifikuara sipas llojit, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga të realizuarat, sipas llojit				
				Përputh	Financiar	Kombinuar	Performa	Tjera
<b>1</b>	Viti 2021	10	11	1	-	9	-	1
<b>2</b>	Viti 2022	10	7	1	-	5	-	1

Burimi: NJAB/ Bashkia Elbasan

- Nga auditimi i raportimeve vjetore hartuar nga NJAB mbi aktivitetin e saj për çdo vit ushtrimor, të dhënat mbi gjetjet/rekomandimet dhe statusin e zbatimit të tyre, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS				RAPORTIMIT			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim dëmi)			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar	Gjithsej në vlerë	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar
<b>1</b>	Viti 2021	68	36	32	-	2	x	0	
<b>2</b>	Viti 2022	33	15	18	-	1	x	0	
	Trendi	↗	↘	↘					
	<b>Totali</b>	<b>101</b>	<b>51</b>	<b>50</b>	<b>0</b>	<b>3</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	

Burimi :NJAB/Bashkia Elbasan

- Realizim i auditimeve nga NJAB Bashkisë Elbasan për periudhën 2020-2021-2022, në tabelën më poshtë:

Nr	Subjekte të Planifikuara dhe të Audituar/Fusha	Realizimi i Auditimeve
		2022
<b>1</b>	Program Auditimi “Drejtoria e të ardhurave, taksa e tarifave vendore” Nr. prot., 176 dt. 17.01.2022	√
<b>2</b>	Program Auditimi “Zbatimi i rekomandimeve të auditimeve të vitit 2021” nr. Prot., 1208 dt.04.03.2022	√
<b>3</b>	Program Auditimi “Qendra Ekonomike Arsimore” nr. prot., 2091 dt. 26.04.2022	√
<b>4</b>	Program Auditimi “Qendra e Artit teatri Skampa” nr. prot., 2090 dt. 26.04.2022	√
<b>5</b>	Program Auditimi “Agjencia e Shërbimeve Publike” nr. prot., 3818 dt. 08.08.2022	√
<b>6</b>	Program Auditimi “Policia Bashkiake” nr. prot., 4923 dt. 20.10.2022	√
<b>7</b>	Program Auditimi “Detyrimet e prapambetura” nr. prot., 5502 dt. 22.11.2022	√
<b>8</b>	Drejtoria e Administratës dhe Burimeve njerëzore	-
<b>9</b>	Drejtoria e Prokurimeve Publike	-
<b>10</b>	Inspektoratet	-
<b>11</b>	Përballimi i Situatës covid 2019	-
<b>12</b>	Program Auditimi “Drejtoria e Financës” nr. prot., 2581 dt. 05.04.2022	-
	<b>Totali i Auditimeve vjetore të realizuara</b>	<b>7</b>

Punoi: Grupi i Auditimit

Nga auditimi rezultoi se NJAB nuk ka realizuar numrin e angazhimeve audituese të miratuara në “Planin vjetor dhe Strategjik” për vitet 2021 dhe 2022; Në Raportin vjetor që NJAB e Bashkisë Elbasan ka paraqitur në DPHKBFP/DHAB në MFE, ka dhënë sqarime mbi arsyet e mosrealizimit të planit vjetor, por nuk ka hartuar dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Programin e ndryshuar

vjetor;

**2.3** Nga auditimi i 7 (shtatë) dosjeve të që NJAB ka audituar për vitin 2022, rezultoi si më poshtë:

1. Fletë inventari të dosjes - me nënshkrimin e përgjegjësit të grupit/drejtorit
2. Autorizimi i - në dosje
3. Takimi fillestar me subjektin - realizuar / në dosje
4. Evidencat/dokumentacioni/testet/ - në dosje
5. Projekt Raporti - në dosje
6. Observacione - sipas rastit/në dosje
7. Raporti Përfundimtar - në dosja;
8. Memo Kryetarit - në dosje;
9. Plani i veprimit nga subjekti i audituar - mungon në 3 raste
10. Raportim nga subjekti i audituar mbi statusin e rekomandimeve të lëna – nuk ka /mungon

- Nga auditimi i dosjeve të auditimit rezultoi se: për auditimin e “Qendra e Artit teatri Skampa” një deklaratë e pavarësisë pa nënshkrimin e anëtares së grupit A. A.;

- A. Q. ka refuzuar të nënshkruajë dokumentin “deklaratë e pavarësisë” datë 21.04.2022, edhe pse pa dhënë arsyet e refuzimit, është vijuar me Urdhrin e brendshëm të kryetarit për dalje të grupit në terren të datës 28.04.2022 dhe me autorizimin e datës 28.04.2022, programi i auditimit pa nënshkruar prej tij;

- te korrespondenca me NJAB dhe subjektit “reagimet” pa nënshkrimin e një anëtari të grupit auditues;

- nga ana e **3** subjekteve të audituara, nuk janë hartuar planet e veprimit brenda afatit 30 ditor nga marrja në dorëzim e Raportit Përfundimtar të Auditimit, me anë të të cilit vihet në dijeni NJAB mbi pranimin ose jo të rekomandimeve të lëna dhe personat përgjegjës për zbatimin e tyre;

- gjithashtu rezultoi edhe mungesë e monitorimit të NJAB për zbatimin e rekomandimeve nga ana e subjekteve të audituara brenda afateve të përcaktuara, në zbatim të përcaktimeve në kreun 4.1.13.1 dhe 2 “Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit” paragrafi 3 dhe “Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve” paragrafi 4. Kjo si pasojë e mungesës së raportimit nga ana e subjekteve të audituara, në moszbatim këto të kreut 4.1.13.3 “Përgjegjësitë e njësisë për të zbatuar rekomandimet e AB”.

### **III. Sigurimi i cilësisë në auditimet e kryera dhe kontrolli i zbatimit të detyrave të lëna**

Në njësinë e auditimit të brendshëm, Sigurimi i Cilësisë në të gjitha angazhimet e Auditimit të Brendshëm të kryera gjatë periudhës objekt auditimi është kryer nga grupi i punës që ka realizuar angazhimin e auditimit, pra nga NJAB të Bashkisë Elbasan. Sigurimi i cilësisë është pjesë e procesit që bën të mundur zbatimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” me emërtesën “Njësia e Auditimit të Brendshëm”. Për periudhën 2021-2022 nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të Bashkisë së Elbasan janë lënë **101 [68/33]** rekomandime, nga të cilat janë pranuar dhe “zbatuar” plotësisht **51 [36/15]** rekomandime, “në proces zbatimi” janë **50 [32/18]** rekomandime dhe **0** janë “pa zbatuar”; Ndërsa vetëm në vitin 2022 janë lënë dhe pranuar **33** rekomandime nga të cilat **15** janë “zbatuar”, **18** janë “në proces zbatimi” dhe **0** janë “pazbatuar”.

**3.2** Bashkia Elbasan ka raportuar në DHAB/MFE<sup>10</sup> me shkresën nr. 1631 prot., 15.02.2023 me subjekt: “Mbi dërgimin e Raportit vjetor të veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Elbasan për vitin 2022” konform kërkesave të akteve ligjore në fuqi.

<sup>10</sup> Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Nga sa më lart grupi i auditimit thekson se lëvizjet dhe rekrutimi i personelit të strukturës së NJAB gjatë vitit 2022 përbën pengese për mirëfunksionimin dhe në performancën e [NJAB] së Bashkisë Elbasan. Kjo rezulton në: numrin relativisht të ulët në planifikimin vjetor të misionëve auditues në raport kjo me numrin e audituesve të NJAB; përzgjedhjen e sektorëve/fushave në planifikim në mungesë të një vlerësimi real dhe për çdo fushë/sistem; mosrealizimin e numrit vjetor të misionëve auditues të planifikuara; mos hartimin nga ana e drejtorit të NJAB dhe miratimit nga titullari të “planit vjetor të ndryshuar”; numrit në rënie nga viti 2021 në vitin 2022 të rekomandimeve me statusin “i zbatuar” si dhe në moszbatimin e plotë të misionëve auditues; në mospërmbushjen dhe mosrealizimin e plotë të Skemës së Procesit të Auditimit → Hapi 4 [Ndjekja e Rekomandimeve], veprime këto në kundërshtim me ligjin 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe “Manualine Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

**Titulli i gjetjes:** Mbi mangësitë e konstatuara në Njësinë e Auditit të Brendshëm

**Situata:**

Nga auditimi mbi vlerësimin e veprimtarisë së Njësisë së të në Bashkinë Elbasan, për periudhën e audituar 2022 u konstatua se:

1. Struktura e NJAB mbi emërimet dhe certifikimet e audituesve, rezultoi se drejtuesi i NJAB i emëruar 6 mujorin e dytë, rezultoi edhe i pa certifikuar si auditues i brendshëm, në kundërshtim me Ligjin 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 11, pika 2/b; “Manualin i Auditit të Brendshëm”, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 100/2016; Aktualisht NJAB po funksionon pa drejtues që prej datës 24.02.2023 dhe me 3 auditues, nga të cilët një auditues i certifikuar si “Auditues i brendshëm” dhe dy janë në proces certifikimi;
2. Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e auditimeve rezultoi se nuk është hartuar nga drejtuesi i NJAB dhe miratuar nga kryetari i Bashkisë Elbasan “Plani i ndryshuar vjetor për vitin 2022” në kundërshtim kjo me Ligjin 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 14/ç,i; Manuali i Auditimit të Brendshëm Kap.III, Rubrika 3.5;
3. Nga auditimi i vlerësimit me koeficient risku të njëjësive të strukturës organizative objekt auditimi dhe planifikimit/realizimit të misionëve auditues mbi bazën e vlerësimit të riskut, rezultoi se për vitin 2021 raporti mes fushave/sistemeve me koeficient risku të lartë ndaj atyre me koeficient risku të mesëm /të ulët është [2:8] ose në mosrespektim të raportit [60%:40%] - (është më i ulët); për vitin 2022 është [5:5] ose në mosrespektim të raportit [60%/40%] – (më i ulët); Mos respektimi i këtij raportit është në kundërshtim të ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” Kapitulli III paragrafi 3 pika 3.1.2;
4. Nga auditimi mbi rekomandimet e lëna nga NJAB në misionet audituese të realizuara në 2 vitet e fundit, rezultoi se numri i tyre vjen në rënie; i atyre me status “zbatuar” *për vitin 2021* janë 36 ose 53% të totalit të rekomandimeve të lëna; *për vitin 2022* janë 15 ose 45.5% të totalit të rekomandimeve; rekomandimet me status “pa zbatuar” nuk ka; rekomandime të shprehura në vlerë janë lënë 2 nga të cilat një është zbatuar dhe një është në proces. Pra numri i rekomandimeve “të zbatuara” ka ardhur në rënie nga viti 2021 në vitin 2022;
5. Nga verifikimet e dokumentacionit, analiza e informacionit të pasqyruar në tabela dhe raportet vjetore që NJAB ka dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, rezultoi se: numri i auditimeve të planifikuara është *për vitin 2021* me 11 misionë auditues dhe *për vitin 2022* me 10 auditime; nuk janë përfshirë në planet strategjike dhe ato vjetore të gjitha njësitë e strukturës me referim koeficientin e riskut, kjo pasi në gjykimin tonë ka ardhur si rezultat i një vlerësimi jo real dhe një analize të pa studiuar të nivelit të riskut për çdo njësi të strukturës, ku ato me risk të lartë auditohen çdo vit, me risk të mesëm në çdo 3 vjet dhe ato me risk të ulët në çdo 5 vjet, të gjitha këto në moszbatim të ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” Kapitulli III, pika 3.1.2;

6. Nga auditimi rezultoi se në dosjet e misioneve audituese rezultuan dokumente standarde pa nënshkrimin e anëtarëve të grupit auditues, pa praktikën e nevojshme dokumentare në rastin e refuzimit të një prej anëtarëve të grupit auditues, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” Kapitulli IV – 4.1.1/1 dhe Formatet standard të tij;

7. Nga ana e subjekteve të audituara, nuk janë hartuar Planet e veprimit të cilat i dërgohen NJAB jo më vonë se 30 ditë pune pas dërgimit nga ana e saj të Raportit Përfundimtar, duke mos përmbushur detyrimin nr. 5 e skemës finale të auditimit, në moszbatim të kreut 4.1.12 hapi 11” i “Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

8. nuk ka ndjekur hapat e procesit të monitorimit, për zbatimin e rekomandimeve nga ana e subjekteve të audituara brenda afateve të përcaktuara, në mos zbatim të përcaktimeve të kreut 4.1.13.1 dhe 4.1.13.2 “Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit” paragrafi 3 si dhe “Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve” paragrafi 4; mos raportimit të subjekteve të audituara në moszbatim të kreut 4.1.13.3 “Përgjegjësitë e njësisë për të zbatuar rekomandimet e AB”.

#### **Kriteri:**

Ligji nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe “Manualin i Auditit të Brendshëm”, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 100/2016, datë 25.10.2016; Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar” i ndryshuar; VKM nr. 83/2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”; Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

#### **Ndikimi:**

Lëvizjet e stafit të njësisë së dhe e menaxherit të saj në mospërputhje me kërkesat ligjore, përbën pengesë për mirëfunksionimin dhe performancën e bashkisë si dhe në dhënien e sigurisë titullarit të saj për përmbushjen e objektivave të bashkisë.

**Shkaku:** Moszbatimi i bazës ligjore në fuqi, e cila rregullon aktivitetin e në Bashkinë Elbasan.

**Rëndësia:** E mesme

#### **Rekomandimi:**

1. Kryetari i Bashkisë Elbasan, të marrë masa për të strukturuar NJAB, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin, për të përmbushur misionin e saj në arritjen e objektivave.

2. Njësia e Auditit të Brendshëm të bëjë një vlerësim real të koeficientit të riskut për fushat/sistemet objekt i misioneve audituese, për të përfshirë në planet strategjike dhe vjetorë sektorët e fushave me risk, siç janë: zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, menaxhimin e burimeve njerëzore etj., duke respektuar raportin mes sistemeve /fushave vlerësuar me koeficient të lartë ndaj atyre me koeficient të mesëm/ulët në hartimin e planeve strategjike e vjetor të njësisë.

3. Njësia e Auditit të Brendshëm të ndjekë me korrektësi çdo fazë të misionit auditues duke e plotësuar me praktikën dokumentare përkatëse; pas dërgimit të raportit përfundimtar në subjektin e audituar, t’i kërkojë menaxherit të tij të reagojë në lidhje me rekomandimet e lëna dhe të raportojë periodikisht, sipas afateve të përcaktuara në planin e veprimit.

## **2.Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.**

**Buxheti.** Bashkia Elbasan për vitin 2022 ka hartuar dhe miratuar buxhetin e saj, në zbatim të kërkesave: të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ndryshuar, të ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, të UMF nr. 8, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor afat mesëm vendor 2023-2025” dhe UMF nr. 23, datë 30.07.2018, të UMF

nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, të shkresës 22922/203 date 08.02.2022 te DPESHM dhe te VKB nr. 137 date 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit Bashkisë Elbasan për vitin 2022”. Detajimi i shpenzimeve dhe ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre janë miratuar me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar e ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit.

## **2.1. Programimi i PBA dhe programimi i buxhetit vjetor 2022**

Programimi buxhetor i vitit 2022 i Bashkisë Elbasan parashikon një mbulim sa me te plote te territorit me shërbime publike cilësore, me qellim përmirësimin e jetës komunitetit, përmirësimin dhe modernizimit te infrastrukturës rrugore urbane dhe rurale , përmirësimin e pastrimit qytetit, rritjes sipërfaqeve te gjelbëruara, zhvillimin e mirëmbajtjen e tregjeve, zhvillimin e turizmit, mbështetjen e insiativave për zhvillimin e zonave te biznesit, mbrojtjen e tokave bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, mbulimin e territorit me shërbime sociale, zhvillimin e aktiviteteve kulturave e sportive, menaxhimin e situatave natyrore, etj. Bashkia Elbasan administron dhe menaxhon fondet, sipas 34 programeve te miratuara, sa vijon:

Programi i planifikim-menaxhim-administrim Programi i ceshtje financiare dhe fiskale Programi i shërbimit gjendjes civile Programi i zgjedhjeve përgjithshme e lokale Programi i borxhit brendshëm Programi i shërbimit policisë vendore Programi i mbrojtjes nga zjarri e civile Programi i mbështes për zhvillim ekonomik Programi i shërbimit tregjeve dhe inspektimit Programi shërbimeve bujqësore, siguria ushqimore Programi i kujdesit social për familje dhe fëmijë Programi menaxhimit mbetjeve, shërbime publike Program arsimi, parauniversitar dhe edukimit Programi i arsimit, parashkollor dhe arsimit bazë Programi i arsimit mesëm, profesional	Programi mbrojtjes nga zjarri dhe emergjencave Programi i administrimit të pyjeve Program infrastrukturës, kullimit, ujitjes Programi i transportit publik (rrugët rurale) Programi i strehimit dhe urbanistikës Programi i furnizimit me ujë Programi i ndriçimit rrugëve Programi i trashëgimisë kult-artistike Programi i kujdesit social për sëmurët dhe paftës Programi i strehimit social Programi i emergjencave civile Programi për te moshuarit Programi fondit rezerve e kontigjenca Programi i kujdesit shëndetësor Programi mbrojtjes mjedisit
--	--

Nëpërmjet grupit të punës për menaxhimin strategjik (GMS), ngritur nga Kryetari i Bashkisë, është hartuar dhe miratuar me vendimin e KB PBA për periudhën 2023-2025 dhe për periudhën 2020-2022, raportuar në Ministrinë e Financave, bazuar ne udhëzimin e MF nr. 10 date 28.02.2020 “Për përgatitjen e PBA vendor 2021-2023, bazuar ne udhëzimin e MF nr. 8 dhe 9 date 28.02.2022, ne udhëzimit 23 date 08.07.2022 etj. Janë zbatuar fazat e hartimit të PBA duke dokumentuar procesin e hapave të punës që duhet të ndiqen nga EMP dhe GMS.

Për hartimin e PBA 2022 te programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin sipas dëgjesës publike dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore dhe sektorëve Bashkisë, nëpërmjet procesit të “Buxhetimit me pjesëmarrje”, në përputhje me shkronjën “ç”, neni 5 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”. Tavanet buxhetore kane konfirmimin e Prefekurës dhe VKB.

Hartimi i PBA (Program Buxheti Afatmesëm 2020-2022) është kryer dhe audituar me pare nga grupi i auditimit. Për hartimin e buxhetit të vitit 2022 është ngritur grup pune nga titullari Bashkisë. Ky dokument është hartuar nga Drejtoria Financës dhe Buxhetit. Në Bashkinë Elbasan buxheti i vitit 2022 është hartuar kryesisht mbi bazën e disa programeve, te cituara me lart. Për vitin 2022 buxheti vjetor është planifikuar dhe krijuar nga ardhurat vendore, transfertat pakushtëzuar dhe ajo specifike, nga transfertat dhe ardhurat trashëguara. Fondi veçante ne buxhetin vitit 2022 është planifikuar 9,000 mije lekë dhe është përdorur 5,400 mije lekë (100 mije lekë për mbështetjen financiare nxënësve ekselent dhe 5,300 mije lekë për ndihme ushqimore për sportistët Ukrainas VKB 55 date 11..04.2022 . Ndërsa fondi i kontigjences 10,000 mije lekë dhe nuk është përdorur.

Po kështu emergjenca civile për 64,439 mije lekë nuk është përdorur. Në buxhetin e vitit 2022 bëjnë pjesë të ardhurat dhe shpenzimet e trashëguara nga viti i kaluar të cilat në hartimin e PBA nuk planifikohen. Buxheti është hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë dhe institucionet vartëse, drejtoritë shkollave, drejtoritë Bashkisë, njësitë administrative. Plani ardhurave e shpenzimeve për buxhetin është planifikuar duke përcaktuar fushat prioritare përkatëse.

***Pasqyra e planit të buxhetit të vitit 2022 krahasuar me planin e PBA.***

	Emërtimi	Buxhet 2022 sipas VKB 137 dt 23.12.2021
600	Paga	933,152,370
601	Sigurime Shoqërore	153,361,000
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	816,082,206
603	Subvencione	5,000,000
604	Transferta Korrente te Brendshme	44,257,000
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	17,517,403
166	Sherbimi i borxhit ( Principal)	94,100,000
651	Sherbimi i borxhit ( interesa)	13,000,000
609	Fond rezerve,kontigjence dhe emergjenca civile	83,439,000
<b>I</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>2,159,908,979</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	25,494,415
231	Kapitale të Trupëzuara	646,015,987
<b>II</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>671,510,402</b>
	<b>I+II Totali I Shpenzimeve</b>	<b>2,831,419,381</b>

Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2022 është miratuar me VKB nr. 137, datë 23.12.2021, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Elbasan me aktin 1390/1 datë 07.01.2022. Ndërsa miratimi i buxhetit faktik është bere sipas vendimit KB 14 date 28.02.2023. Buxheti Bashkisë Elbasan dhe PBA, në përgjithësi është miratuar në përputhje me dispozitat ligjore/nënligjore.

***Programimi i buxhetit për vitin 2022 dhe realizimi i tij në total sipas artikujve (bashkë me shtesat që janë miratuar me vendim të këshillit Bashkiak, përkatësisht sipas VKB 60 datë 04.05.2022, 101 datë 02.08.2022 dhe 117 datë 26.09.2022 si dhe ndryshimet miratuar me VKB 11 datë 31.01.2022, 55 datë 11.04.2022, 71 datë 30.05.2022, 82 datë 26.06.2022, 116 dhe 118 datë 26.09.2022 dhe nr. 131 datë 12.10.2022) , paraqitet:***

Nr.	EMERTIMI	Plani vjetor	Fakti	Realizimi %
1	600 Paga	967,612,069	900,496,780	93.06%
2	601 Sig.Shoq.Sh	164,017,263	150,634,177	91.84%
3	602 Shpenz.operative	912,083,563	654,548,080	71.76%
4	603 Subvencione	5,000,000	0	0%
5	230 Studime, projektme	25,494,415	9,064,413	35.55%
6	231 Investime	863,865,297	300,725,700	34.81%
7	604 Transferta	61,978,931	40,016,589	64.56%
8	605 Transferta me jashte	30,500	29,760	97.57%
9	606 Transferta	2,045,381,037	2,027,751,336	99.14%
10	166 Principal	89,686,180	83,111,480	92.66%
11	651 Interesa	11,837,520	8,293,290	70.06%
12	609 Fond rez, kontigj,emergj.	78,039,000	0	
	<b>Shuma</b>	<b>5,225,025,775</b>	<b>4,174,671,605</b>	<b>80 %</b>

***Buxheti i programuar dhe realizuar për vitin 2022 i permblodhur ne 4 zëra: ne 000/lekë.***

Nr.	EMERTIMI	Plani 2022	Fakti 2022	Realizimi %
1	Paga+sig. (600+601)	1,131,630	1,051,130	93 %
2	Shpenzime operative(602+651+166)	1,013,608	745,954	74 %
3	Transferta (604+605+606+609)	2,190,429	2,067,797	94 %
4	Investime (230 +231)	889,358	309,790	35 %
	<b>Shuma</b>	<b>5,225,025</b>	<b>4,174,671</b>	<b>80 %</b>

**Burimet e financimit** buxhetit Bashkisë Elbasan për 2022 vijnë nga 2 drejtime, përkatësisht:

\* *Nga burimet e veta vendore*, ku përfshihen të ardhurat nga taksat e tarifave vendore, të ardhura tjera, donacione dhe të ardhura trashëguara.

\* *Nga burimet qendrore*, ku përfshihen transferata e pakushtëzuar, transferua specifike për funksione reja (sektoriale), transferua të kushtëzuara dhe investime nga FZSHH.

**Pasqyra ardhurave përgjithshme në total, nga burimet e veta dhe burimet qendrore,**

1	Taksat tarifave vendore	887,466,573
2	Donacione	5,727,100
3	Transferua e pakushtëzuar	736,685,468
4	Transferua specifike	477,331,860
5	Transferua kushtëzuar	2,183,317,961
6	Trashguara nga 2021	332,981,386
7	Huamarrje	2,726,382
	<b>TOTALI</b>	<b>4,626,236,730</b>

## **2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;**

Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2022 është miratuar me VKB nr. 137 date 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit Bashkisë Elbasan për vitin 2022”. Miratimi i buxhetit nga njësi vendore për vitin 2022 është bërë brenda afateve ligjore, në përputhje me kërkesat e nenit 32 të ligjit 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit, e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. Plani i të ardhurave dhe shpenzimeve për buxhetin e vitin 2022 është planifikuar duke përcaktuar fushat prioritare përkatëse. Në varësi të vlerave të fondeve të çelura në thesar në fillim të vitit ushtrimor janë bërë edhe miratimet e buxhetit fillestar të Bashkisë. Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të granteve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, granteve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit. Gjatë vitit 2022 buxheti ka pësuar ndryshime shtesa/paketime, sipas VKB të cituara më sipër.

**Kontrolli i realizimit të shpenzimeve.** Referuar situacionit shpenzimeve të Bashkisë Elbasan për vitin 2022, lidhur me planifikimin dhe realizimin e tyre, rezultojnë se:

Nr.	EMERTIMI	Plani vjetor	Fakti	Realizimi %
1	<b>600 Paga</b>	<b>967,612,069</b>	<b>900,496,780</b>	93.06%
2	601 Sig.Shoq.Sh	164,017,263	150,634,177	91.84%
3	<b>602 Shpenz.operative</b>	<b>912,083,563</b>	<b>654,548,080</b>	71.76%
4	603 Subvencione	5,000,000	0	0%
5	230 Studime, projekte	25,494,415	9,064,413	35.55%
6	<b>231 Investime</b>	<b>863,865,297</b>	<b>300,725,700</b>	34.81%
7	604 Transferata	61,978,931	40,016,589	64.56%
8	605 Transferata me jashte	30,500	29,760	97.57%

9	606 Transferta	2,045,381,037	2,027,751,336	99.14%
10	166 Principal	89,686,180	83,111,480	92.66%
11	651 Interesa	11,837,520	8,293,290	70.06%
12	609 Fond rezerve,..	78,039,000	0	
	<b>Shuma</b>	<b>5,225,025,775</b>	<b>4,174,671,605</b>	<b>80 %</b>

**Shpenzimet sipas artikujve për vitin 2022 te përmbledhura, paraqiten: 000/lekë.**

Nr.	E M E R T I M I	Plani 2022	Fakti 2022	Realizimi
1	<b>600+601 Paga + Sigurime</b>	1,131,630	1,051,130	93 %
2	<b>602 +651+166 Shpenz.operative</b>	1,013,608	745,954	74 %
3	<b>604 +605+606+609 Transferta</b>	2,190,429	2,067,797	94 %
4	<b>230+231 Investime</b>	889,358	309,790	35 %
	<b>Shuma</b>	<b>5,225,025</b>	<b>4,174,671</b>	<b>80 %</b>

Shpenzimet sipas artikujve për vitin 2022 nuk kane tejkalime ne total, pasi këto kanë qenë dhe nën kontrollin e degës thesarit. Shpenzimet e buxhetit për 2022 janë realizuar 80 % ose 4,174,671,605 lekë nga 5,225,025,775 lekë planifikimi. Nga auditimi i tyre, rezultoi se:

**a. Shpenzimet për investime** janë realizuar ose ne vlere absolute 35 % për 300 milion lekë nga 863 milion lekë planifikimi. Investimet e realizuara 300 milion për 2022 **zënë 7% ndaj shpenzimeve totale** 4,174 milion. Mos realizimi i investimeve vjen si rezultat i mos likuidimeve për mungese fondeve, i mbartjeve nga vitet e mëparshme si dhe një pjese e tyre janë ne proces investimi. Burimet e financimit për 863 milion lekë investime te planifikuara, llogaria 230= (683+18+82+89-9 llogaria 231 projekte) për vitin 2022, përbehen nga:

\* 71 % transferta e pakushtëzuar dhe ardhurat e veta ose 683 milion lekë gjithsej ( 114 milion transferua pakushtëzuar +93 milion ardhurat 2021 trashëguara + 386 milion ardhurat veta 2022 dhe 89 milion ardhura huaja).

\* 2 % transferta specifike ose 18 milion lekë.

\* 27 % transferta e kushtëzuar ose 82 milion lekë.

Një pjese e **investimeve janë ne proces**, përkatësisht: *Rikonstruksion i palestrave dhe terreneve sportive, shkollat e mesme Luigj Gurakuqi, Konstadin Kristoforidhi, Onufri etj. (Rreth 6 prej tyre ne proces legalizimi, përkatësisht: “Përmirësimi i kushteve banimit komunitetit te pa favorizuar, “Rikonstruksion minikalceto dhe rrethimi me kangjella i kompleksit “Sh.L”, “Përmirësimi i infrastrukturës ne zona informate” e tjerë).*

\* **Hua (kredi)** ose ardhura te huaja kane qene ndihme dhe burim financimi nga BKT për 89 milion lekë vitin 2022 për shpenzime shpronësimi dhe investime infrastrukture rrugore.

**b. Shpenzimet për ndihmën ekonomike** dhe paaftësisë **zënë peshën kryesore për 48 % ndaj shpenzimeve totale** (4,174 milion), ose ne vlere absolute 2,027 milion lekë, **çka bën të domosdoshme nxitjen e punësimit dhe përmirësimin e politikave sociale**, për të zbutur papunësinë dhe varfërinë. Ndihma sociale ne vitin 2022 paraqet tendence rritje nga viti 2021.

Prandaj lind domosdoshmëri hapja e vendeve te reja pune, stimulimi dhe subvencionimi i fermerëve bujqësore dhe fermave blegtorale, ngritja e qendrave prodhuese industriale, koordinimi me kompanitë private etj, ne mënyre qe këta te tërheqin sa me shume forca pune.

**c. Shpenzimet për paga** prej 900 milion lekë te realizuara **zënë 21 % ndaj shpenzimeve totale** (4,174 milion) dhe 93 % nga ato te planifikuara (967 milion).

**A.** Niveli i i shpenzimeve për paga rezulton shume i larte, ku **ndikim negativ ka pasur numri i larte i punonjësve prej 418** të Bashkisë Elbasan , pasi rritja e numrit punonjësve ka rritur dhe shpenzimet për paga. Kështu për vitin 2022 janë shtuar 32 punonjës dhe 11 larguar, pra 21 veta shtuar, sipas të dhënave të bilancit financiar 2022, formati nr. 8.

**B. Problem paraqet raporti midis numrit punonjësve dhe ngarkesës punës tyre, për disa pozicione pune**, pasi nuk justifikohen me dokumente dhe programe pune, konkretisht:



\* *Drejtoria e auditit* përbehet nga 5 punonjës, të cilët për vitin 2022 kane kryer 7 auditime gjithsejtë ose 1,5 auditime në vit për çdo auditues, çka tregon se audituesit nuk kane ngarkesën e duhur të punës. Po kështu dhe planifikimi i auditimeve ka qene minimal për 10 auditime të planifikuara ose nga 2 auditime/auditues.

\* *Drejtoria e integritit evropian projekteve strategjike dhe inovacionit* përbehet nga 8 punonjës, e pajustificuar kjo me dokumente e programe pune për disa raste.

\* *Drejtoria e e përgjithshme e shërbimeve organizative* përbehet nga 10 punonjës, ku vetëm ankimi administrativ dhe përfaqësimi ne gjykate ka ne vete 5 punonjës, qe kane mbuluar 5 vendime gjyqësore për 2022 ose 1 vendim/punonjës.

\* *Drejtoria e administratës dhe burimeve njerëzore* përbehet nga 11 punonjës, ku vetëm arkiv-protokolli paraqet më vete 5 punonjës.

\* *Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore* përbehet nga 33 punonjës.

\* *Drejtoria e aseteve dhe strehimit* përbehet nga 9 punonjës, ku administron mbi 10,000 prona e asete brenda juridiksionit të Bashkisë, të cilat nuk janë pajisur me certifikate pronësie.

\* *Drejtoria e politikave arsimit parashkollor, trashëgimisë kulturore, turizmit e sportit* përbehet nga 25 punonjës, në një kohë që paralel funksionojnë më vete njësite shpenzuese si Qendra Ek-Arsimit, Klubi Shumsporte, Qendra Artit, Qendra Trashëgimisë Kulturore.

\* *Drejtoria e Emergjencave civile dhe mjedisit* përbehet nga 20 punonjës.

\* *Njësite Shpenzuese* paraqesin numër të lartë të punësuarve sipas të dhënave të bilancit financiar 2022, konkretisht:-295 punonjës Agjencia Shërbimeve Publike etj.

**Sa sipër**, Numri i larte i punonjësve ne raport me ngarkesën e punës nuk e justifikojnë punën e tyre me dokumente dhe programe pune, në kundërshtim me ligjin 10296 datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” dhe UMF 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin aktiveve sektorit publik*”, çka ngarkon me përgjegjësi Kryetarin Bashkisë G.LL, Drejtoreshën e Burimeve Njerëzore E.T.

Marrëdhëniet e punës për punonjësit e Bashkisë Elbasan rregullohen sipas kriterëve të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “*Për statusin nëpunësit civil*” ndryshuar me ligjin nr. 152-2013,, sipas ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “*Kodi Punës*” për **207 punonjës me status nëpunësit civil dhe - 268 punonjës me Kod Pune** , ndërsa 6 punonjës me kohe te pjesshme.

**Pagat dhe ndalesat tatimit mbi pagat personale e sigurime shoqërore e shëndetësore.**

Bashkia ka planifikuar dhe miratuar pagat për vitin 2022 për çdo vend pune sipas strukturave organizative, mbështetur në Vendimet e Këshillit Bashkiak, ne ligjin nr. 10405 datë 24.3.2011, “*Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve*”, i ndryshuar, ne VKM 598 datë 27.4.2009 “*Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësite të qeverisjes vendore, për efekt page, e përcaktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore*” ndryshuar me VKM nr. 518, datë 16.8.2012 dhe VKM nr. 586, datë 17.7.2013, ne VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “*Për Pagat e Vetëqeverisjes Vendore*”, ne VKM nr. 187 datë 08.03.2017, “*Për Miratimin e Strukturës dhe të Niveleve të Pagave të Nëpunësve Civilë*”, i ndryshuar, bazuar në klasat, kategoritë, pagën e grupit dhe shtesën për vjetërsi e pozicion. Pagat dhe shtesat mbi paga si vjetërsia e punës etj janë përlllogaritur drejtë, sipas tabelës së pagave, në përputhje me VKM-të e sipërcituara. Janë llogaritur dhe ndaluar sistematikisht për çdo muaj, detyrimet për tatimin mbi të ardhurat personale dhe sigurime shoqërore e shëndetësore. Pagesat për punonjësit bëheshin për çdo muaj mbi bazën e kohëshënuesit që lëshohej nga përgjegjësi i administratës. Kjo listprezence konfirmohej nga kryetari dhe dërgohej sektorit të financës për të kryer veprimet. U audituan pagesat e kryera për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të Bashkisë dhe u konstatua se kjo pagesë është kryer në masën 10 për qind të pagës së kryetarit të Bashkisë. Numri 51 i Këshilltareve Bashkiak është bazuar në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*”, neni 24 “*Numri i anëtarëve te Këshillit Bashkiak*” ndryshuar me ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”.

#### d. Shpenzimet operative

Shpenzimet operative janë realizuar prej 654 milion lekë dhe *zënë 15 % ndaj totalit* shpenzimeve (4,174 milion), ose 72 % nga planifikimi (912 milion). **Problem paraqet raporti i zhdrejte i shpenzimeve operative me shpenzimet për pagat për 73 %, çka tregon mungese efektiviteti, eficence dhe ekonomiciteti te shpenzimeve operative ne funksion te aktivitetit kryesore Bashkisë.** Theksojmë se ne përbërje te shpenzimeve operative nuk bëjnë pjese shpenzimet për shërbimet publike, pasi mbulohen nga ASHP me bilanc më vete. Ky tregues flet për një planifikim të pa studiuar, me rezerva dhe pa kriter në disa zëra, *ku me raste të veçanta do të trajtohen me poshtë dhe tek banka akti 3.*

**2 zëra shpenzimesh kane peshën kryesore tek shpenzimet operative,** konkretisht:

**shpenzime pastrimi.** zënë vendin e pare 18 % (120:654) ndaj shpenzimeve operative gjithsej dhe janë realizuar 120 milion lekë nga 144 milion te planifikuara dhe përbehet nga 2 pjese:

- *pastrim me sipërmarrje*, planifikuar 77,273 mije lekë dhe realizuar 66,531 mije lekë,

- *Inceratori*, planifikuar 66,800 mije lekë dhe realizuar 53,275 mije lekë.

Shërbimi i pastrimit qytetit për vitin 2022 është mbuluar nga te ardhurat e veta te Bashkisë ose nga tarifa e pastrimit prej 145 milion lekë e realizuar, sipas akt rakordimit vjetor te ardhurave me thesarin (*bashkëngjitur*).

**shpenzime për energjinë elektrike.** zënë vendin e dyte 15,2 % (100:654) ndaj shpenzimeve operative dhe janë realizuar 100 milion lekë nga 124 milion te planifikuara.

Shpenzimet për energjinë elektrike sipas njësave shpenzuese zbërthehen, sa vijon:

Nr.	E M E R T I M I	Plani 2022 000/lekë	Fakti 2022 000/lekë
1	Bashkia	8,175	5,725
2	Qendra ekonomike e arsimit	22,677	16,342
3	Qendra Artit	916	565
4	Sportklubi	600	460
5	<b>ASH Publike</b>	<b>89,700</b>	<b>75,596 (ndriçimi publik)</b>
6	Q.S. Balashe	1,870	1,704
7	Q. Trashg. Kulturore	630	461
	<b>Totali</b>	<b>124,568</b>	<b>100,853</b>

Shpenzimet për automjetet janë realizuar 50 milion lekë nga 68 milion planifikuara, ose 8 % ndaj shpenzimeve gjithsej (50:654). Shpenzimet për automjetet 50 milion lekë te harxhuara për 2022, ndahen: (*shpenzime për pjese këmbimi, goma bateri 9,985 mijë lekë,- shpenzime për karburant dhe vaj 36,013 mijë lekë,- shpenzime për mirëmbajtje mjetesh 530 mijë lekë,- shpenzime transporti tjera 434 mijë lekë,- shpenzime siguracion mjetesh 3,062 mijë lekë*).

**Titulli gjetjes:** Niveli i larte i shpenzimeve të buxhetit për paga, shpenzime operative dhe ndihmën ekonomike dhe raporti i zhdrejtë midis tyre.

**Situata:** Nga auditimi shpenzimeve te buxhetit Bashkisë Elbasan vitit 2022, u konstatua se:

a. Shpenzimet për ndihmën ekonomike dhe paaftësisë zënë peshën kryesore për 48 % ose 2,027 milion lekë ndaj shpenzimeve gjithsejtë 4,174 milion lekë, çka bën të domosdoshme përmirësimin e politikave sociale për të zbutur papunësinë dhe varfërinë.

b. Shpenzimet për paga paraqiten te larta 900 milion lekë dhe zënë 21 % ndaj shpenzimeve gjithsej 4,174 milion lekë. Ndikim ka pasur numri i madh i te punësuarve, me i larte se bashkitë tjera simotra qe mbulojnë popullsi te njëjte brenda juridiksionit tyre. Gjithashtu paraqitet raport i zhdrejte midis numrit punonjësve prej 418 veta me ngarkesën e punës tyre, për disa pozicione pune, pasi nuk justifikohen me dokumente dhe programe pune, konkretisht: *Drejtoria e auditit përbehet nga 5 punonjës, te cilët kane kryer 7 auditime gjithsej ose rreth 1 auditim/ vit, çka tregon se audituesit nuk kane ngarkesën e duhur. Drejtoria e përgjithshme e shërbimeve organizative përbehet nga 10 punonjës, ku vetëm ankimimi administrativ dhe përfaqësimi ne gjykate ka ne vete*

5 punonjës, te cilët kane mbuluar 5 vendime gjyqësore për 2022 ose 1 vendim/punonjës. Drejtoria e administratës dhe burimeve njerëzore përbehet nga 11 punonjës, ku vetëm arkiv- protokolli paraqet ne vete 5 punonjës. Drejtoria e aseteve dhe strehimit përbehet nga 9 punonjës, ku mbi 10,000 prona e asete brenda juridiksionit te Bashkisë nuk janë pajisur me certifikate pronësie. Drejtoria e politikave arsimit parashkollor, trashëgimisë kulturore, turizmit e sportit përbehet nga 25 punonjës, ne një kohe qe paralel funksionojnë ne vete njësite shpenzuese si Qendra Ekonomike Arsimit, Klubi Shumsporte, Qendra Artit, Trashëgimisë Kulturore. Drejtoria e Emergjencave civile dhe mjedisit përbehet nga 20 punonjës. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe me UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitë publik”.

c. Shpenzimet operative janë realizuar prej 654 milion lekë dhe zënë 15 % ndaj totalit shpenzimeve 4,174 milion lekë. Problem paraqet raporti i zhdrejte i shpenzimeve operative me shpenzimet për pagat, ose ne masën 73 %, çka tregon mungese efektiviteti, eficence dhe ekonomiciteti te shpenzimeve operative ne funksion aktivitetit kryesore Bashkisë. Ky tregues flet për një planifikim te pa studiuar, me rezerva dhe pa kriter ne disa zëra. U konstatua 2 zëra shpenzimesh qe kane peshën kryesore tek shpenzimet operative, ku menaxhimi dhe kontrolli i tyre është prioritar, konkretisht: *Shpenzimet e pastrimit* zënë vendin e pare 18 % ndaj shpenzimeve operative gjithsej dhe janë realizuar 120 milion lekë.

*Shpenzime për energjinë elektrike* zënë vendin e dyte 15,2 % ndaj shpenzimeve operative dhe janë realizuar 100 milion lekë.

**Kriteri:** ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitë publik”, ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”.

**Shkaku:** raporti i zhdrejte i shpenzimeve për paga dhe operative, numri i madh i te punësuarve ne raport me ngarkesën dhe dokumentet e punës.

**Efekt:** Shpenzime të larta për paga dhe për shpenzime operative me ndikim në buxhet.

**Rëndësia:** I Mesëm.

**Rekomandimi:** Bashkia Elbasan në miratim të buxhetit të vitit 2024 të marre masa:

- a. Për uljen e numrit të familjeve me ndihme ekonomike dhe paaftësisë, duke përmirësuar politikat sociale për të zbutur papunësinë dhe varfërinë.
- b. Për rishikimin dhe shkurtimin e organikes, me qellim vendosjen e një raporti të drejte midis numrit të punësuarve me ngarkesën e punës tyre.
- c. Për uljen e shpenzimeve operative, veçanërisht shpenzimet e pastrimit dhe të energjisë elektrike dhe shpenzimeve tjera, duke i planifikuar dhe menaxhuar drejt dhe duke ushtruar kontroll periodik ndaj tyre, në mënyre që të vendoset një raport i drejte midis shpenzimeve operative me shpenzimeve për paga, duke siguruar kështu eficencen e tyre.

- ***Shpenzimet për qiramarrje janë jo efektive*** për ambientet dhe 3 automjetet private. Kështu, për vitin 2022 ato janë realizuar 6,294 mije lekë, në vend që ato të shmangeshin, duke shfrytëzuar rezervat e ambienteve të veta bosh dhe mjetet e veta të Bashkisë dhe njësisë ASHP qe disponohen, ndaj të cilave janë kryer shërbime dhe ndërrim pjese këmbimi për 1,468 mije lekë, me qellim që ato të jenë funksionale gjatë gjithë periudhës vjetore 2022.

- ***shpenzimet për shërbimet e mjeteve Bashkisë*** janë planifikuar 4,241 mije lekë ndërsa janë realizuar për 3,386 mije lekë, sipas zërave analitik, konkretisht:

- *shpenzime për pjese këmbimi, goma bateri plan 1,751 lekë, fakt 984 mijë lekë,*
- *shpenzime për karburant dhe vaj plan 1,650 mijë lekë, fakt 1,650 mijë lekë,*
- *shpenzime për mirëmbajtje mjetesh plan 235 mijë lekë, fakt 170 mijë lekë,*
- *shpenzime transport tjera plan 335 mijë lekë, fakt 314 mije lekë,*
- *shpenzime siguracion mjetesh plan 270 mijë lekë, fakt 268 mije lekë,*

- *shpenzime gjyqësore*. zbatimi i vendimeve gjyqësore ne 1 rast nuk është kryer vullnetarisht, por me ndërmjetësinë e Zyrave Përmbartimore, çka ka sjelle pagesën e tarifës përmbartimore prej 48 mijë lekë, në vend që të likuidohet në kohën e duhur brenda afatit ligjor, në kundërshtim me pikën 62 të Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” dhe pikën 38 të Udhëzimit të MB nr. 459, datë 16.08.2013 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit në sistemin e MB”, çka ngarkon me përgjegjësi e sektorin juridik dhe shërbimeve financiare dhe nëpunësin autorizues për periudhën përkatëse.

-*shpenzime tjera energjisë elektrike, shërbimeve postare, ujit, telefonisë fikse*. Për periudhën e audituar rezultoi se: ishin likuiduar faturat për shpenzimet operative si të energjisë elektrike, shërbimeve postare, ujit, telefonisë fikse, pa kryer kontrollin paraprak të saktësisë së tyre nga një strukturë kontrolluese e shërbimeve mbështetëse mbi shërbimin e marrë sipas kushteve të kontratës, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në germën “f” pika 4 e nenit 9, germën “e” pika 3 e nenit 12 dhe 22 të ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

### **2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit;**

Sipas situacioneve të shpenzimeve të rakorduara me thesarin për vitin 2022 shpenzimet buxhetore në Bashkinë Elbasan janë planifikuar dhe realizimi paraqitet në masën 80%.

Është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Elbasan, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordime përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik.

Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me degën e thesarit Elbasan duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me VKB, ose të diktuar nga grantet e deleguara nga pushteti qendror. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se është respektuar disiplina buxhetore. Nga auditimi në lidhje me planifikimin dhe realizimin e investimeve në Bashkinë Elbasan u konstatua se për vitin 2022, me financim nga buxheti i Bashkisë dhe nga transfertat e pushtetit qendrorë janë planifikuar investime në vlerën 863 milion lekë dhe realizuar në vlerën 300 milion lekë ose në masën 35 %. Për shpenzimet e reja kapitale janë zbatuar hallkat e miratimit për përfshirjen në buxhet, pasi janë bazuar në prioritetet e caktuara, në kërkesat e paraqitura dhe verifikimit në vend të problemit. Nga Bashkia është bërë miratimi në kohë i buxhetit. Në çdo rast janë ndjekur hapat për realizimin e pagesave të shpenzimeve, duke nxjerre urdhrin e prokurimit, është zhvilluar procedura e prokurimit, është lidhur kontrata, pune apo shërbime, janë marrë në dorëzim në çdo rast nga grupi i kolaudimit i ngritur për këtë qëllim, ndërsa për investimet grupi i ngritur nga Zyra e Urbanistikës.

Në çdo procedure prokurimi janë dokumentet nga urdhri i prokurimit, kontrata, fatura tatimore, situacioni në rastet e punëve apo shërbimeve, fletë hyrja e magazinës etj. Për çdo procedure prokurimi, urdhri është regjistruar në kohë dhe kanë vulën dhe datën e depozitimit të tyre në Degën e Thesarit Elbasan. Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në Degën e Thesarit dhe të shtrira në kohë sipas financimit. Për çdo rast të depozitimit kontratave thesar është hartuar shkresë përcjellëse ku është cilësuar vlera plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit, ku është e shtrirë në disa vite, vlera për secilin vit.

### **2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli i realizimit të ardhurave; (Faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi, sipas raportimit në**

MF, ku te evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit te grandeve si FZHR, Ministrinë linjës etj.

**a. Fatura të pa likuiduara.**

Fatura të pa likuiduara për investime dhe shpenzime operative deri më datë 31.12.2022, Bashkia Elbasan paraqet një detyrim ndaj të tretëve për vlerën **67 milion lekë**, bazuar në të dhënat e pasqyrave financiare në datën 31.12.2022 (llogaria 401-408, furnitor e llogari të lidhura me to). Vlera e faturave te pa likuiduara te prapambetura prej 67,102,981 lekë, sipas llojit te detyrimit, përbëhet:

- vlera **16,908,200 lekë**, llogaria 401 detyrim për shpenzime operative (602).

- vlera **50,194,781 lekë**, llogaria 486 detyrim për shpenzime investimesh (231).

Stoku i detyrimeve të Bashkisë është raportuar i sakte dhe sipas klasave të buxhetit për të gjitha detyrimet e prapambetura, të cilat janë pasqyruar në aktiv të bilancit në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe sipas llogarive 231 dhe 602.

Bashkia Elbasan ka përfshirë ne buxhetin e vitit 2023 shlyerjen e plote te detyrimeve prapambetura prej 67 milion lekë për periudhën 2023, bazuar në udhëzimin e MFE nr. 1 date 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit 2022”, kreu III, pika 126 dhe udhëzimin MFE nr. 37 date 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin e detyrimeve prapambetura” dhe aktin normativ 34 date 03.12.2021, Pasqyra detyrimeve Bashkisë dhe Njësive Administrative deri 31.12.2022, paraqitet:

Nr	Detyrimi	Vlera
1	Detyrime me hyrje 602	16,450 (401)
2	Detyrime pa hyrje 602	15,433,213 (401)
3	Detyrime pa hyrje njesite 602	1,458,537 (401)
4	Investime 2016 Njesite 231	224,405 (486)
5	Investime Bashkia 231	49,970,376 (486)
	<b>Totali</b>	<b>67,102,981</b>

Sa sipër,

a. Vlera e faturave te pa likuiduara prej 67 milion lekë do të rëndojë në fondet e vitit 2023 dhe në vazhdim krahas likuidimeve të radhës të vitit ushtrimor.

b. Peshën me te madhe te detyrimeve e zënë zëri “faturat e pa likuiduara për investimet” prej 50 milion lekë ose ne masën 75 % ndaj totalit detyrimeve prapambetura.

c. Bashkia Elbasan në disa raste nuk ka shlyer detyrimet e subjekteve ne kohen dhe afatin e duhur prej 30-60 dite, çka ka bërë që ato të mbarten nga vitit në vit duke fryre vlerën e faturave të pa likuiduara, konkretisht:

- fatura 733 date 25.10.2019 “B.N” shpk, për “Rikonstruksion e 3 rrugëve dhe shesheve te pallateve 579,579/3, 579/4, 579/5, 580/1”, është likuiduar pjesërisht me vonese mbi 2 vjet, sipas urdhër shpenzimit nr. 425 date 10.06.2022.

- fatura 37 date 10.06.2021 “E ” shpk është likuiduar me vonese 1 vit, sipas urdhër shpenzimit 426 date 10.06.2022, për 6,607,470 lekë, pasi afati i shlyerjes ka qene 09.07.2021.

- Raste tjera janë trajtuar tek veprimet e bankës 2022,.

Mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj operatorëve ekonomik është në kundërshtim me nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, me UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, me Udhëzimin plotësues “Për buxhetin e vitit ” etj. pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura Njësive Vetëqeverisjes Vendore”.

Neni 52: Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik.

Njëkohësisht, u konstatua se ne disa raste paraqitet mosrespektim i radhës se likuidimit, çka ka krijuar diferencime midis subjekteve, konkretisht:

\* Ne 7 raste për Bashkinë Elbasan, përkatësisht:

- subjekti i pa likuiduar B.Sh, sipas faturës date 06.08.2017 për 4,400 lekë,
- subjekti i pa likuiduar F. shpk, sipas faturës date 14.02.2011 për 50,000 lekë,
- subjekti i pa likuiduar K.B shpk, sipas faturës date 17.11.2006 për 286,819 lekë,
- subjekti i pa likuiduar E. 2000, sipas faturës date 08.12.2006 për 54,991 lekë,
- subjekti i pa likuiduar R. shpk sipas faturës date 23.08.2018 për 69,745 lekë,
- subjekti i pa likuiduar Sh.N, sipas faturës date 02.10.2017 për 25,857 lekë,
- subjekti i pa likuiduar G.Sh, shpronësime nga viti 2015 për 1,589,088 lekë.

**Titulli i gjetjes:** Mos marrja e masave të duhura për uljen e vlerës detyrimeve prapambetura.

**Situata:** Bashkia Elbasan paraqet 67 milion lekë fatura të pa likuiduara deri më datë 31.12.2022, sipas llojit të detyrimit, sa vijon: *vlera 16,908,200 lekë, llogaria 401 detyrim për shpenzime operative (602) dhe vlera 50,194,781 lekë, llogaria 486 detyrim për shpenzime investimesh (231)*, keta të fundit zëne peshën me të madhe 75 % ndaj totalit detyrimeve prapambetura. Bashkia ka përfshirë në buxhetin vitit 2023 shlyerjen e plote të detyrimeve prapambetura prej 67 milion lekë, bazuar në UMFE 1 date 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit 2022”, kreu III, pika 126 dhe udhëzimin MFE 37 date 06.10.2020 “Për monitorimin, publikimin detyrimeve prapambetura” dhe aktin normativ 34 date 03.12.2021. Bashkia Elbasan në disa raste nuk ka shlyer detyrimet e subjekteve në kohën e afatit duhur prej 30-60 dite, dhe ka shkelur radhën e likuidimeve, në kundërshtim me nenin 52 ligjit 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin sistemit buxhetor” ndryshuar, me Udhëzimin plotësues pikat 82-91. Për sa më sipër rezulton se marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura. Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Kriteri:** UMFE 1 date 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit 2022”, kreu III, pika 126, UMFE 37 date 06.10.2020 “Për monitorimin, publikimin detyrimeve prapambetura”, Akti normativ 34 date 03.12.2021, Neni 52 të ligjit 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Ndikimi:** Likuidimi jo në kohë të detyrimeve të prapambetura, përveçse është moszbatim i kuadrit rregullator në fuqi, e vë në njësinë vendore në kushtet e palës përgjegjëse ndaj kreditorëve. Ndodhur në kushtet e shkeljes marrëveshjes të përcaktuar në kontratë me kreditorët për afatin e kryerjes së këtyre pagesave, krijohen premisa që kreditorët nëpërmjet proceseve gjyqësore, përveç vlerës së detyrimit sipas situacionit dhe kontratës, të kërkojnë edhe përqindje të interesave etj., gjë e cila rrit kostot financiare në mënyrë artificiale.

**Shkaku:** Mos vendosja e fondeve buxhetor në masën e duhur në likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe krijimi i detyrimeve të reja gjatë vitit buxhetor.

**Rëndësia:** E Lartë

**Rekomandim:** Bashkia Elbasan të marre masa:

- a. Të shlyej faturat e pa likuiduara të prapambetura për vlerën 67 milion lekë.
- b. Të marre masa për shlyerjen e detyrimit të subjekteve brenda afatit ligjor dhe të zbatojë radhën e likuidimeve, për efekt të mos diferencimit tyre.

## **b. Vendime gjyqësore.**

Për vitin 2022 vendimet gjyqësore paraqiten në 4 raste për vlerën 3,4 milion lekë, me efekte negative në buxhet, përkatësisht: 2 vendime shpronësimi dhe 2 vendime për shërbime telefonike. Nga titullari i Bashkisë nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, në kundërshtim me kërkesat e pikës 62 të udhëzimit nr. 2, datë 06.02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit buxhetit”, me ndryshime, me udhëzimin 4 datë 27.01.2011 “Për zbatimin buxhetit” pika 6.1 “Vendimet gjyqësore”. Zyra

juridike ka apeluar vendimet e shkallës së parë. Për vitin 2022 nuk paraqitet asnjë rast për shpenzime gjyqësore të fituara nga ish-punonjësit për largime nga puna, për rrjedhojë nuk ka dublim pagese për të njëjtin vend pune.

## **2.5. Celja, ekzekutimi fondeve përfituar nga FZHR, saktësia raportimit buxhetor tyre**

Nuk ka pasur fonde të çelura nga FZHR për vitin 2022, por ka pasur fonde të çelura nga:

- MASH 133 milion lekë çelur dhe likuiduar 68 milion lekë për disa investime 2022 me objekt rikonstruksione, përkatësisht:

\* “Rikonstruksion palestrave, terren:e sportive, shkollat e mesme bashkuar “Luigj Gurakuqi”,

\* Rikonstruksion shkolla e mesme “Konstadin Kristoforidhi”, shkolla artistike “Onufri”.

\* Rikonstruksion “minikalçet” dhe rrethimi me kangjella i kompleksit “Shefqet Lamce”.

- MEF 14 milion lekë të çelura dhe të likuiduara për disa objekte investimesh për përmirësim kushteve komunitetit në nevoje, përkatësisht:

\* “Përmirësimi i kushteve banimit komunitetit të pa favorizuar,

\* “Përmirësimi i infrastrukturës në zona informate” që janë në proces legalizimi (Ndërtim KUZ ne lagjen 5 Maji, rruga Arif Dardha dhe rruga Xhaferr Belegu).

Gjithsej janë çelur 148 milion lekë dhe janë likuiduar 82 milion lekë për vitin 2022, sipas të dhënave të drejtorisë finance-buxhetit.

**Sa sipër, lidhur me buxhetin:**

Kryetari i Bashkisë z. G.LL, Zv/kryetar Bashkisë A.B, Drejtoresha burimeve njerëzore E.T, Drejtor i përgjithshëm i planifikimit ardhurave e asetëve financës e buxhetit Q.T dhe Drejtorë financës e buxhetit A.M.

## **II. AGJENSIA E SHERBIMEVE PUBLIKE ELBASAN (ASHP)**

**Buxheti ASHP.** për vitin 2022 ka hartuar dhe miratuar buxhetin e saj, në zbatim të kërkesave: të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ndryshuar, të ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, të UMF nr. 8, datë 28.02.2022, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”. Detajimi i shpenzimeve dhe ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre janë miratuar me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar e ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit.

Buxheti i ASHP Elbasan për vitin 2022 është miratuar me VKB nr. 137, datë 23.12.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me aktin nr. 1390/1, datë 07.01.2022. Miratimi i buxhetit faktik 2022 është bere sipas vendimit KB nr. 14, date 28.02.2023.

**Sipas bilancit te vitit 2022** buxheti i realizuar, formati 2 paraqitet, sa vijon:

\* **shpenzimet gjithsejtë** pasqyrohen për vlerën 405,112,611 lekë,

\* **burimi i financimit** pasqyrohet për vlerën 410,158,301 lekë, përkatësisht: - 44 milion lekë, nga buxheti, - 355 milion lekë, nga pushteti vendor, - 11 milion lekë, nga te ardhura jo tatimore e tarifa administrative dhe rregullator.

\* **rezultati (teprica ose deficioni)** pasqyrohet për 5,045,690 lekë.

**Për vitin 2022 planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve në total sipas artikujeve,** paraqitet:

Nr.	E M E R T I M I	Plani 2022	Fakti 2022	Realizimi %
1	600 Paga	150,032,301	143,382,507	95.56%
2	601 Sig.Shoq.Sh	25,738,000	23,949,380	93.05%
3	602 Shpenzime operative	294,833,847	233,540,891	79.21%
4	606 Mbeshtetje financiare	5,820,000	5,800,000	99.65%
5	231 Investime	172,732,786	59,507,827	34.45%

6	606 Transferta	638,000	638,000	100%
	<b>Shuma</b>	<b>649,794,934</b>	<b>466,818,605</b>	<b>71.84%</b>

**- Sipas situacionit te shpenzimeve te vitit 2022** te ASHP Elbasan, rezulton se:

**a. Shpenzimet për paga** për vitin 2022 pasqyrohen ne vlerën 143,382,507 lekë, ndërsa sipas bilancit formati 2 për 145,364,856 lekë.

- Për vitin 2022 **struktura dhe organika e ASHP Elbasan paraqet numër te larte punonjësish prej 295 punonjës**, nga 266 punonjës ne vitin e mëparshëm 2021, pra me tendence rritje nga viti i mëparshëm. Gjithashtu rezultuan 19 punonjës te përkohshëm me fond page 3,114,082 lekë. Kështu:

**a. Për disa punonjës për pozicionet e punës qe mbulojnë paraqiten ne mospërputhje me ngarkesën e punës tyre**, pasi nuk e justifikojnë punën me dokumente dhe programe pune.

**b. Për 5 sektor numri i stafit drejtues-profesional rezulton i barabarte dhe ne 1 rast (8 shofere) me i madh se numri punonjësve.** Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitë publik”. **Sa sipër**, me konkretisht:

\* **sektori juridik** e personeli prej 13 veta: 1 përgjegjës, 1 protokollues, 1 sekretare, 2 specialiste, 8 shofere, ose më shumë shofere se stafi drejtues-specialiste.

\* **sektori mirëmbajtje rrugës** qytet 23 veta: 1 përgjegjës, 2 teknik, 2 specialist, 12 punëtor, 6 shofer, pra numri punëtorëve i përafërt me numrin stafit drejtues-teknik-shofer.

\* **sektori i ndriçimit, sinjalistikes dhe dekorit** 17 veta: 1 përgjegjës, 2 specialiste, 4 teknik, 8 punëtor, 2 shofer, ose numri i punëtorëve është i barabarte me numrin stafit drejtues-teknik.

\* **sektori agronomik, ujitje kullim** 24 veta: 1 përgjegjës, 1 teknik, 3 specialiste, 10 agronom, 6 punëtor, 3 shofer, ose me shume agronome se specialistë e punëtorë.

\* **sezonale** prej 20 veta.

**b. Shpenzimet operative** për vitin 2022 për vlerën **233,540,891 lekë dhe paraqesin problem, pasi janë ne raport te zhdrejte me shpenzimet për paga** prej 143 milion lekë, ka i bën ato pa efektivitet. Kështu, shpenzimet operative paraqiten me te larta për diferencën 90 milion lekë se shpenzimet për paga, ne vend qe te ndodhte e kundërta. Gjithashtu shpenzimet operative prej 233 milion zëne 50 % ndaj shpenzimeve gjithsej 466 milion. **Përfundimisht**, disa zëra te shpenzimeve operative janë përdorur dhe menaxhuar pa efektivitet si dhe kontrolli periodik i tyre ne terren ka qene i pjesshëm nga struktura e vete ASHP, ndërsa forca goditëse e auditit brendshëm ka qene pa efekte.

**Sipas pasqyrës analitike te shpenzimeve operative (602) te vitit 2022, rezulton se shumicën e shpenzimeve e zëne 3 zëra shpenzimesh** ose ne masën **86 %** ne vlere 202 milion lekë ndaj shpenzimeve operative totale prej 233 milion lekë, përkatësisht:

\* **Shpenzimet për roje** paraqiten te realizuara për vlerën **83 milion lekë dhe zëne peshën kryesore prej 35 %** ndaj totalit shpenzimeve operative. Gjithashtu dhe planifikimi për 88 milion lekë ka qene i pa studiuar dhe me rezerva. Për rrjedhoje reduktimi i këtij zëri është domosdoshmëri ne hartimin e projektbuxhetit te vitit 2024.

\* **Shpenzimet e energjisë elektrike** paraqiten për vlerën **76 milion lekë dhe zëne 33 %** ndaj totalit shpenzimeve operative. Kontrolli i sasisë se energjisë te harxhuar te faturuara nga OSHE (FSHU) nuk ka qene periodik për çdo muaj por është mjaftuar ne fund te vitit.

**Ne faturat e energjisë te FSHU padrejtësisht janë përfshire edhe tarifa prej 100 lekë për çdo muaj për aparatura (televizorë), te cilët nuk ekzistojnë**, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në germën “F” pika 4 e nenit 9, germën “e” pika 3 e nenit 12 dhe 22 të ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

\* **Shpenzimet për automjetet** paraqiten për vlerën 43 milion lekë **zëne 18 %** ndaj totalit shpenzimeve operative (karburant, pjese këmbimi, vajra-lubrifikante, goma, bateri, shërbime,



*siguracion makine*). Ndikim kane pasur numri i madh i automjeteve ndryshme dhe veçanërisht automjetet e renda, për te cilat ne fund te vitit 2022 duhej bere një analize ekonomike lidhur me efektivitetin e çdo makinerie rende, nëse janë rentabël ose jo. Gjithashtu, ne kushtet e disponimit gjendje te ekskavatorëve, ASHP ka blere edhe 1 Ekskavator për 5,986,800 lekë, sipas urdhër shpenzimit 20 date 10.02.2022, kontratës 2524/9 date 08.07.2021, ndërsa ka bere kalim kapital Bashkisë Dropull 1 Ekskavator me zinxhirë (prodhim i 1993 për 6,6 milion lekë), sipas fletëdaljes 928 date 29.12.2022, VKB173 date 22.12.2022, procesverbalit komisionit 29.12.2022 dhe konfirmimin nr. 138/1 date 03.02.2023 Bashkisë Dropull për marrjen ne dorëzim mjetit.

**Titulli gjetjes:** Shpenzimet e buxhetit per paga, operative dhe ndihmën ekonomike, niveli i larte i tyre dhe raporti i zhdrejte midis tyre tek ASHP Elbasan.

**SITUATA:** Nga auditimi shpenzimeve te buxhetit te ASHP Elbasan vitit 2022, u konstatua se:

a. Shpenzimet për paga pasqyrohen ne vlerën 143,382,507 lekë, me një organike prej 295 punonjës dhe 19 punonjës përkohshëm me fond page 3,114,082 lekë. Kështu:

- Për disa punonjës për pozicionet e punës qe mbulojnë, paraqitet mospërputhje me ngarkesën e punës tyre, pasi nuk e justifikojnë me dokumente dhe programe pune.

- Për 5 sektor numri i stafit drejtues-profesional rezulton i barabarte dhe ne 1 rast me i madh se numri punonjësve, ne vend qe te ndodhte e kundërta, konkretisht:

\**sektori juridik* e personeli prej 13 veta: 1 përgjegjës, 1 protokollues, 1 sekretare, 2 specialiste, 8 shofere, ose më shumë shofere se stafi drejtues-specialiste.

\**sektori mirëmbajtje rrugës* qytet 23 veta: 1 përgjegjës, 2 teknik, 2 specialist, 12 punëtor, 6 shofer, pra numri punëtorëve i përafërt me numrin stafit drejtues-teknik-shofer.

\**sektori i ndriçimit, sinjalistikes* dhe dekorit 17 veta: 1 përgjegjës, 2 specialiste, 4 teknik, 8 punëtor, 2 shofer, ose numri i punëtorëve është i barabarte me numrin stafit drejtues-teknik.

\* *sektori agronomik, ujitje kullim* 24 veta: 1 përgjegjës, 1 teknik, 3 specialiste, 10 agronom, 6 punëtor, 3 shofer, ose me shume agronome se specialistë e punëtorë.

b. Shpenzimet operative prej 233,540,891 lekë janë me te larta se shpenzimet për paga 143 milion lekë, ne vend qe te ndodhte e kundërta, çka i bën ato pa efektivitet dhe pa eficence. Shpenzimet operative prej 233 milion zëne 50 % ndaj shpenzimeve gjithsej 466 milion. Peshën kryesore e zëne 3 zëra shpenzimesh për 202 milion lekë ose 86 % ndaj totalit, përkatësisht: shpenzime roje 35 %, shpenzime energjie 33 % dhe shpenzime automjete 18 %.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitë publik”.

**Kriteri:** ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitë publik”, ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”.

**Shkaku:** Raporti i zhdrejte i shpenzimeve për paga dhe operative, ku këta të fundit janë me të larta se pagat si dhe numri i madh i të punësuarve në raport me ngarkesën e punës.

**Efekt:** shpenzime të larta për paga dhe për shpenzime operative me ndikim në buxhet.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandim:** ASHP Elbasan të marre masa për rishikimin dhe shkurtimin e organikes në disa sektor, me qellim vendosjen e një raporti të drejte, midis numrit të punëtorëve me stafin tekniko-drejtues, midis pozicionit punës me ngarkesën e punës tyre si dhe të shmang punonjësit e përkohshëm. Gjithashtu të marre masa për uljen e shpenzimeve operative, veçanërisht shpenzimet e pastrimit, të energjisë elektrike dhe shpenzimeve tjera, duke i planifikuar, menaxhuar dhe kontrolluar periodikisht ne mënyre që të vendoset një raport të drejtë midis shpenzimeve operative dhe shpenzimeve për paga.

**Fatura te pa likuiduara.** ASHP Elbasan në fund vitit 2022 paraqet fatura pa likuiduara 34,480,444 lekë. Ne ASHP janë lenë rekomandime për “shlyerjen faturave në afat duke respektuar radhën

*dhe kohën krijimit sipas parimit FIFO”, nga auditimi brendshëm, por gjendja pjesërisht ka ndryshuar, pasi janë likuiduar detyrimet e 2021 e 2022, ku është shkelur përsëri radha e likuidimeve duke krijuar fatura të palikuiduara 18 milion lekë, në kundërshtim me UMF 4 datë 25.01.2021 dhe UMF 01 datë 10.01.2022 që bëjnë fjalë për ”detyrimet e prapambetura” si dhe me Udhëzimin nr. 31 datë 18.11.2021. Llogaria (401-408) furnitor të pa likuiduar pasqyrohet në bilanc formati 2 për 34,480,444 lekë, nga këto: mirëmbajtje 7,431,258 lekë, investime 6,417,476 lekë, mallra 20,631,710 lekë.*

**Titulli i gjetjes:** *Mos marrja e masave të duhura për uljen e vlerës detyrimeve prapambetura.*

**Situata:** ASHP Elbasan paraqet 34 milion lekë fatura të pa likuiduara deri më datë 31.12.2022. Në ASHP janë lenë rekomandime për “shlyerjen e faturave në afat duke respektuar radhën dhe kohën e krijimit sipas parimit FIFO”, nga auditimi brendshëm në dhjetor 2022, por gjendja pjesërisht ka ndryshuar, pasi është shkelur përsëri radha e likuidimeve duke krijuar fatura të pa likuiduara prej 18 milion lekë për vitin 2022, në kundërshtim me UMF 4 datë 25.01.2021 dhe UMF 01 datë 10.01.2022 që bëjnë fjalë për ”detyrimet e prapambetura” si dhe me Udhëzimin nr. 31 datë 18.11.2021.

**Kriteri:** UMFE 1 datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit 2022”, kreu III, pika 126, UMFE 37 datë 06.10.2020 “Për monitorimin, publikimin detyrimeve prapambetura”, Akti normativ 34 datë 03.12.2021, neni 52 të ligjit 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Ndikimi:** Likuidimi jo në kohë të detyrimeve të prapambetura, përveçse është moszbatim i kuadrit rregullator në fuqi, e vë ASHP në kushtet e palës përgjegjëse ndaj kreditorëve, pasi krijohen premisa që kreditorët nëpërmjet proceseve gjyqësore, përveç vlerës së detyrimit të kërkojnë edhe përqindje të interesave, çka rrit kostot financiare në mënyrë artificiale.

**Shkaku:** Mos vendosja e fondeve buxhetor në masën e duhur në likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe krijimi i detyrimeve të reja gjatë vitit buxhetor.

**Rëndësia:** E Mesme.

**Rekomandim:** Agjensia e Shërbimeve Publike Elbasan të marrë masa:

- Të shlyej faturat e pa likuiduara të prapambetura për vlerën 34 milion lekë,
- Të marrë masa për shlyerjen e detyrimit të subjekteve brenda afatit ligjor dhe të zbatojë radhën e likuidimeve, për efekt të mosdiferencimit tyre.

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Bashkia Elbasan, ka paraqitur observacionin nr. 4474/45 prot., datë 22.11.2023, protokolluar KLSH nr.767/4 prot., datë 30.11.2023, pretendojnë, si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

***Observacioni i ASHP Elbasan për buxhetin 2022, thotë:***

*-Shoferët e sektorit juridik në ASHP, shërbejnë edhe në funksion administratës dhe drejtorive tjera, për drejtimin mjeteve Policisë Bashkiake, transportin juristëve në gjyqe, lëvizjen inspektorëve pyjeve, inspektorëve tatimeve, inxhinierëve në terren, mjeteve të rënda .*

*-Specialistët dhe teknikët mbulojnë dhe bëjnë punë në terren së bashku me punëtorët. Ky sektor mbulon shërbimin ujitjes, kullimit gjatë muajve Mars - Dhjetor në mbështetje të 20 punëtorëve sezonal. Agronomet janë në mbështetje të fermerëve për këshillim bujqësor.*

*-Rojet janë në 17 objekte Bashkisë për ruajtje fizike si: Pallati Sportit, thertorja, QEA, ASHP, teatri “Stampa”, muzeu, Galeria Arteve, Konviktet, zyrrat Bashkisë, tregu fruta perimeve, biblioteka, varrezat, qendra sociale dhe komunitare romëve, Kompleksi sportiv.*

*-Për kontrollin dhe inspektimin e matësive energjisë elektrike është dërguar shkresë FSHU për bashkëpunim e rakordim përbashkët. Struktura bën kontrollin e faturimeve fund cdo viti.*

**Qëndrimi i grupit auditimit:**

***Observacioni i ASHK Elbasan për buxhetin 2022.***

-Observacioni i ASHK Elbasan **merret parasysh pjesërisht**, pasi ai paraqet arsyet e numrit të lartë punonjëset sipas sektorëve, duke i justifikuar se janë marre me pune të tjera, madje dhe si shofere ne policinë Bashkiake, lëvizjen e juristeve etj, por kjo bie ndesh me përcaktimin e tyre ne organiken e miratuar ne KB, (Bashkia dhe ASHP janë institucione me bilanc vete).

-Për rojet e objekteve **qëndron pjesërisht observacioni**, por ka rezerva ne numrin e rojeve dhe reduktimin e orëve te ruajtjes objekteve,.

-Për shpenzimet e energjisë elektrike **qëndron pjesërisht observacioni**. Por kontrolli i tyre duhet te kryhet periodik çdo muaj dhe jo vetëm ne fund te vitit. Tek ndriçimi i qytetit si zë me peshe duhet rishikuar kursimi i energjisë dhe materialeve, me qellim uljen e shpenzimeve.

-Për disa vërejtje tjera teknike pa peshe, pa efekte ose me efekte te vogla, u bene rregullimet përkatëse duke mos i rekomanduar, me qellim te përmirësimit e tyre ne ardhmen.

## 2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

### Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

Për vitin 2022 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan është miratuar me VKB-në nr. 119, datë 14.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave në Bashkinë Elbasan për vitin 2022”.

Tabela nr.II.6.1: Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave në Bashkinë Elbasan, viti 2022

000 lekë

Nr.	EMËRTIMI	PLAN	FAKT	%
<b>I</b>	<b>TË ARDHURA NGA TATIMET</b>	<b>6,000</b>	<b>1,879</b>	<b>31%</b>
1	Tatimi thjeshtuar mbi fitimin e BV	6,000	1,879	31%
<b>II</b>	<b>TË ARDHURA NGA TAKSAT</b>	<b>530,920</b>	<b>287,407</b>	<b>54%</b>
1	Taksa biznesi vogël	-	-	-
2	Taksa mbi ndërtesat	214,600	171,865	80%
3	Taksa mbi tokën bujqësore	26,400	16,319	62%
4	Taksa mbi truallin	27,000	19,371	72%
5	Taksa mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier	7,000	8,896	127%
6	Taksa e ndikimit në infrastrukturë	255,170	69,638	27%
7	Taksa e tabelës	750	1,318	176%
<b>III</b>	<b>TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA</b>	<b>109,000</b>	<b>116,432</b>	<b>107%</b>
1	Taksa mbi kalimin e pronësisë	7,000	10,436	149%
2	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	70,000	61,145	87%
3	Taksa e Rentës minerare	2,000	572	29%
4	Tatimi mbi të ardhurat personale	30,000	44,279	148%
<b>IV</b>	<b>TË ARDHURA NGA TARIFAT</b>	<b>462,740</b>	<b>356,966</b>	<b>77%</b>
1	Tarifë për zënien e hapësirës publike	38,000	29,940	79%
2	Tarifë pastrimi	185,000	145,249	79%
3	Tarifë gjelbërimi	45,000	33,748	75%
4	Tarifë ndriçimi	81,000	50,625	63%
5	Tarifë reklame	8,000	6,965	87%
6	Tarifë parkim automjete	40,000	11,993	30%
7	Tarifë embleme bashkie	100	74	74%
8	Tarifë leje, certifikatë transporti	2,000	2,306	115%
9	Tarifë autorizim tregtim karburanti+lëndë djegëse	9,000	8,400	93%
10	Tarifë lëshimin e vërtetimeve	2,200	1,564	71%
11	Tarifë autorizimi, zgjatje orari, etj.	2,200	2,013	92%
12	Tarifë formularë të pastrehë	30		0%
13	Tarifë shërbimi karrotresh	500	57	11%
14	Tarifë leje përdorimi për objekte biznesi	2,000	1,034	52%
15	Tarifë leje përdorimi për banim	1,200	1,391	116%
16	Tarifë certifikim relievi	1,000	712	71%

17	Tarifë deklarim paraprak	1,300	2,651	204%
18	Tarifë trajtimi fasadës ndërtesave	1,200	959	80%
19	Tarifë shqyrtim dok. leje ndërtimi	3,000	2,268	76%
20	Tarifë kantier ndërtimi për objekt mbi 4 kat	5,500	4,627	84%
21	Tarifë lëshimin e dok. nga arkiva	200	87	44%
22	Tarifë rrjetin e tubacion. ujërave bardha	2,200	2,197	100%
23	Tarifë rrjetin e tubacion. ujërave të zeza	290	283	98%
24	Tarifë shërbimi për rrjetin kabllor	4,000	854	21%
25	Tarifë uji pijshëm	100	27	27%
26	Tarifë ndotjes mjedisit	19,000	18,642	98%
27	Tarifë mirëmbajtje infrastrukture në Njësi Administrative	5,220	3,744	72%
28	Tarifë aplikim leje zhvillimi	1,500	903	60%
29	Tarifë depozitim i mbetjeve të ngurta	-	11,601	-
30	Tarifë hartimi e PDV për sipërfaqen e pronës	2,000	11,096	555%
31	Kontributi subjekteve private në fondin publik të banesave sociale	-	956	-
<b>V</b>	<b>TË ARDHURA JO-TATIMORE</b>	<b>183,000</b>	<b>46,167</b>	<b>25%</b>
1	Qira objekti	3,000	904	30%
2	Qira trualli (operatorë telefonike)	2,500	2,714	109%
3	Qira toke bujqësore	500	230	46%
4	Qira toke pyjore	5,000	10,920	218%
5	Gjoha ndërtimi	20,000	10,102	51%
6	Gjoha biznesi	10,000	9,701	97%
7	Të ardhura nga legalizimet	97,000	6,843	7%
8	Të ardhura nga shitja e asetëve (FK)	45,000		0%
9	Të ardhura nga shitja e tokës (troje, terrene)	-	2,093	-
10	Të ardhura nga shitja ndërtime	-	2,644	-
11	Sekuestri dhe zhdëmtime	-	16	-
<b>VI</b>	<b>TË ARDHURA FUNKSIONET SPECIFIKE</b>	<b>29,560</b>	<b>26,561</b>	<b>90%</b>
1	Të ardhura nga Shërbimi Pyjor	22,500	19,510	87%
2	Të ardhura Ujitja dhe Kullimi	4,760	5,886	124%
3	Të ardhura nga Zjarrfikësja	2,300	1,165	51%
<b>VII</b>	<b>Të ARDHURA JASHTË LIMITI</b>	<b>0</b>	<b>5,731</b>	
1	Taksa e akteve dhe pullës		324	
2	Sponsorizime		969	
3	Grant nga Këshilli i Qarkut		4,438	
	<b>TOTALI (I+II+III+IV+V+VI+VII)</b>	<b>1,321,220</b>	<b>841,143</b>	<b>64%</b>

Burimi: Bashkia Elbasan

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër për periudhën nën auditim realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan për vitin 2022 janë realizuar në masën **63%** (pa përfshirë zërin sponsorizime dhe grante) nga 1,321,220 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 835,088 mijë lekë (diferencë 486,132 mijë lekë). Gjithsej 20 zëra janë realizuar në masën mbi ose 85%, 18 zëra janë realizuar në masën mbi ose 50%, 8 zëra është realizuar në masën mbi ose 25% dhe 5 zëra nën masën 25%.

**Titulli i gjetjes:** Nivel i ulët i realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore referuar planit vjetor të të ardhurave.

**Situata:** Për vitin 2022 në Bashkinë Elbasan niveli i realizimit të të ardhurave është 63%, duke sjellë diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit të bashkisë për sa i takon pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve. Niveli i ulët i realizimit të të ardhurave ka ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të bashkisë dhe marrjen e angazhimeve buxhetore pa patur burime financimi reale.

**Kriteri:**

- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Udhëzimi i MFE nr. 7, datë 27.02.2019 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2020-2022";
- Për vitin 2022 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan është miratuar me VKB-në nr. 119, datë 14.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave në Bashkinë Elbasan për vitin 2022”.

**Ndikimi:** Niveli i ulët i realizimit të të ardhurave ndikon në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të bashkisë.

**Shkaku:** Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Elbasan nuk ka qenë efektive në punën e saj për të mbledhur të ardhurat e parashikuara nga tatimpaguesit fizik/juridik si dhe ato familjarë.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Elbasan të angazhohet në marrjen e masave gjatë gjithë vitit me qëllim mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në nivelet më të larta sipas planifikimit.

### Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3.c<sup>11</sup> dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “ Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5<sup>12</sup>.

Në Bashkinë Elbasan struktura që administron dokumentacionin dhe përlllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë referuar kërkesave ligjore të sipër cituara për subjektet dhe qytetarët që pajisen me certifikatën e pronësisë është Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Lidhur me ecurinë në procesin e legalizimeve për vitin 2022 rezulton se, janë legalizuar 136 objekte me vlerë totale 6,570,962 lekë si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. II.6.2 Taksa e ndikimit në infrastrukturë viti 2022 sipas muajve, në lekë

MUAJI	SIPËRFAQE	DETYRIMI	PAGESA	DEBITORË
Janar	2,659.7	463,902	445,005	18,897
Shkurt	3,429.7	1,180,438	1,180,438	-
Mars	4,603.4	1,464,417	1,464,417	-
Prill	2,674.6	432,363	398,674	33,689
Maj	1,904.5	350,867	297,780	53,087
Qershor	2,748.3	644,893	632,025	12,868
Korrik	930.6	215,359	137,571	77,788
Gusht	1,901.1	308,916	308,916	-
Shtator	1,904.4	307,858	208,860	98,998
Tetor	1,874.2	395,500	362,395	33,105
Nëntor	3,292.3	528,903	429,744	99,159
Dhjetor	1,716.9	277,546	209,926	67,620
<b>TOTALI</b>	<b>29,639.7</b>	<b>6,570,962</b>	<b>6,075,751</b>	<b>495,211</b>

<sup>11</sup> Ligji nr. 95.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3.c “për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi”.

<sup>12</sup> VKM nr. 860, datë 10.12.2014, pika 5: “Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njërive të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi”.

**Titulli i gjetjes:** Mos arkëtim i taksës së ndërtimeve të reja që pajisen me certifikatën e pronësisë (taksa e legalizimeve).

**Situata:** Lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë rezulton se për vitin 2022 janë debitor 13 qytetarë me vlerë totale 495,211 lekë dhe nga vitet e mëparshme në vlerë totale 15,195,508 lekë, që përbën në total 15,690,719 lekë, të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Elbasan.

**Kriteri:** Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27.

Ligji nr. 95/2018 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c.

Ligji nr. 98/2020 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 1, “në nenin 27, pika 3, shkronja “c”.

VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “ Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5.

**Ndikimi:** Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Elbasan, nga mos arkëtimi i vlerës prej **15,690,719 lekë** për ndërtimet e reja që legalizohen.

**Shkaku:** Mos marrje e masave efektive nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për të bërë të mundur pagesën e taksës së legalizimeve.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit duhet të bashkëpunojnë dhe të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për vlerën **15,690,719 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen.

### Administrimi i taksave dhe tarifave vendore

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Elbasan kryhet në programin Excel dhe sistemin IBS-TAIS. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore gjithashtu kryen edhe regjistrim manual të të dhënave (regjistra fizik) dhe të çdo informacioni lidhur me subjektet apo familjet objekt i taksave dhe tarifave vendore.

Tabela nr.II.6.3: Bizneset që ushtrojnë aktivitetet në Bashkinë Elbasan 2022

Nr.	Lloji Biznesit	Gjendja në fillim	Regjistrime të reja	Mbyllur aktiviteti	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi Vogël	5 016	494	601	4 909
2	Biznesi Madh	1 712	35	114	1 633
	Gjithsej	6 728	529	715	<b>6 542</b>

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Bashkia Elbasan, ka paraqitur observacionin nr. 4474/45 prot., datë 22.11.2023, protokolluar KLSH nr.767/4 prot., datë 30.11.2023, pretendojnë, si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** Sektori i Vlerësimit kryen vlerësimin e taksave dhe tarifave vendore bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave e tarifave vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin



e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, i ndryshuar; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 119, datë 14.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan për vitin 2022”, dhe administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik kryhet në sistemin IBS-TAIS, në të cilin pasqyrohen regjistrat e taksapaguesve fizik/juridik, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj. Gjithashtu sqarojmë se Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, përkatësisht Sektori i Vlerësimit nuk është struktura përgjegjëse për administrimin e taksave dhe tarifave vendore për familjarët për vitin 2022.

Ne lidhje me subjektet debitore fizik/juridik ndaj Bashkisë Elbasan, sqarojmë se:

Nga 5024 subjekte debitore fizik/juridike me 31.12.2022, 2247 subjekte nuk janë në statusin aktiv ne QKB/DRT në vlerën 259,617,761.51 leke, ose 35.44% e vlerës së debisë, nga të cilët 455 subjekte biznes i madh në vlerën 172,789,454.03 leke ose 30.85% dhe 1792 subjekte biznes i vogël në vlerën 86,828,307.48 leke ose 50.33%, ndaj të cilëve janë marre masa shtrënguese për mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore të prapambetura.

Ndër subjektet debitore ndaj Bashkisë Elbasan janë edhe disa ndërmarrje shtetërore që zënë një pjesë të konsiderueshme të vlerës së debisë 156,892,887.42 lekë ose 21.4% të vlerës së debisë.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** lidhur me sistemin elektronik që Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore përdor grupi i auditimit bën ndryshimet e nevojshme ne Projekt Raportin e Auditimit, ndërsa për menaxhimin e borxhit tatimor, pavarësisht pretendimeve të lartpërmendura konstatimet e grupit të auditimit qëndrojnë.

## Menaxhimi i borxhit

**Titulli i gjetjes:** Mbi nivelin e borxhit tatimor në Bashkinë Elbasan dhe masat e marra për uljen e tij.

### **Situata:**

*Subjektet Debitorë*

Nga auditimi i dokumentacionit të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore u konstatua se gjendja e debitorëve për vitin 2022 është 2 703 subjekte për vlerën 139,229,606 lekë, ndërkohë që debitorët progres për subjektet fizik/juridik në fund të vitit 2022 rezultojnë, 5 024 subjekte në vlerën 732,528,023 lekë, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.II.6.4: Subjektet debitorë progresiv për vitin 2022

lekë

Nr.	BM/BV	TOTALI	
		Nr.	VLERE
1	Biznes i Madh	1,203	560,013,297
2	Biznes i Vogël	3,821	172,514,725
	<b>TOTALI</b>	<b>5,024</b>	<b>732,528,022</b>

*Burimi: Bashkia Elbasan*

Në fund të vitit 2022 gjendja e debitorëve është në vlerën 139,229,606 lekë ndërsa progresiv deri në 31.12.2022 për subjektet fizik/juridik është **732,528,022 lekë, vlerë kjo që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Elbasan.**

### *Taksat dhe Tarifat Familjare*

Në Bashkinë Elbasan familjarët ngarkohen me detyrime vendore për taksën e tokës, taksën e ndërtesës, tarifën e pastrimit, ndriçimit dhe të gjelbërimit, Truall dhe Mirëmbajtje kanal Kullimi, rruge, paraqiten në tabelat si më poshtë:

Tabela nr. II.6.5: Familjarët debitorë progresiv për vitin 2022

Nr	FAMILJARE	Nr. Familje	Viti 2021	Shtesë	Pakësim	Viti 2022
1	Taksa e tokës bujqësore	9,287	68,821,323	16,407,000	23,152,825	75,567,148
2	Tarifë pastrimi	9,698	49,239,300	5,980,000	14,182,337	57,441,637
3	Tarifë gjelbërimiti	10,211	13,576,100	586,000	2,324,272	15,314,372
4	Tarifë ndriçimi	6,070	28,707,850	1,443,000	7,966,250	35,231,100
5	Taksë ndërtese (objekt banimi)	11,697	74,187,220	15,069,000	29,752,317	88,870,537
6	Taksë trualli	9,324	3,504,277	1,081,000	1,590,983	4,014,260
7	Tarifë Mirëmbajtje Sistemit Ujitës + Kullues	2,741	6,228,994	3,879,000	6,393,808	8,743,802
8	Tarifë Mirëmbajtje Ruge	8,670	7,745,600	3,743,000	6,568,930	10,571,530
	<b>TOTAL</b>	<b>16,488</b>	<b>252,010,664</b>	<b>48,188,000</b>	<b>91,931,722</b>	<b>295,754,386</b>

Burimi: Bashkia Elbasan

Në fund të vitit 2022 gjendja e debitorëve e familjarëve është në vlerën 91,931,722 lekë ndërsa progresiv deri në 31.12.2022 për subjektet fizik/juridik është **295,754,386 lekë, vlerë kjo që sjell të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Elbasan.**

*Debitorët nga shërbimi i zjarrfikëses (Drejtoria e SHMZSH)*

Për shërbimin e zjarrfikëses Drejtoria e ShMZSh në Bashkinë Elbasan ka funksionuar sipas VKM nr. 707, datë 12.10.2016, “Për tarifën e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, të ofruar nga bashkitë e pajisura me stacione të këtij shërbimi, në territorin e bashkive që nuk kanë stacione të shërbimit të MZSh-së”, debitorët ndaj kësaj drejtorie janë si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. II.6.6: Debitorët ndaj Drejtorisë së ShMZSh-së progresive deri në 31.12.2022

NR.	Emërtimi	Përshkrimi	Vlera në lekë
	<b>Lista e debitorëve për vitin 2016 ndaj Drejtorisë së SHMZSH-se</b>		
1	Bashkia Cërrik	Të tjera nga shitja e shërbimeve	63,750
	<b>Lista e debitorëve për vitin 2017 ndaj Drejtorisë së SHMZSH-se</b>		
1	Drejtoria Vendore e Policisë Tirane	Akt Ekspertize Nr. 33	25,000
2	Bashkia Cërrik	Të tjera nga shitja e shërbimeve	459,750
3	Bashkia Belsh	Të tjera nga shitja e shërbimeve	162,000
4	Bashkia Gramsh	Të tjera nga shitja e shërbimeve	98,250
	<b>Lista e debitorëve për vitin 2018 ndaj Drejtorisë së SHMZSH-së</b>		
1	Bashkia Cërrik	Të tjera nga shitja e shërbimeve	85,250
2	Bashkia Belsh	Të tjera nga shitja e shërbimeve	80,250
3	Nikolla Bardhi	Miratim objekti	20,000
	<b>Lista e debitorëve për vitin 2020 ndaj Drejtorisë së SHMZSH-së</b>		
1	Klubi Futbollit Laçi	Të tjera nga shitja e shërbimeve	37,500
	<b>Lista e debitorëve për vitin 2021 ndaj Drejtorisë së SHMZSH-së</b>		
1	Klubi Futbollit Laçi	Të tjera nga shitja e shërbimeve	37,500
	<b>TOTAL</b>		<b>1,069,250</b>

Burimi: Bashkia Elbasan, përpunoi grupi i auditimit

Në fund të vitit 2022 gjendja e debitorëve ndaj drejtorisë së ShMZSh-së progresiv deri në 31.12.2022 është **1,069,250 lekë, vlerë kjo që sjell të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Elbasan.**

Nga auditimi i dokumentacionit të Sektorit të Tatim Taksave, vlera totale borxhit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Elbasan paraqitet:

1. Taksa dhe tarifa familjare në vlerë 295,754,386 lekë.
2. Biznese Debitorë në vlerë 732,528,023 lekë.
3. Debitor ndaj Drejtorisë së ShMZSh në vlerë 1,069,250 lekë.



**Në total borxhi tatimor në Bashkinë Elbasan rezulton në vlerë 1,029,351,659 lekë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Elbasan.**

### **Taksa mbi tokën bujqësore**

Taksa mbi tokën bujqësore llogaritet në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23<sup>13</sup>.

Sipas Aneksit 2 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, Bashkia Elbasan klasifikohet në kategorinë e dytë ku çmimi lekë/ha në vit për tokën bujqësore është si në tabelën më poshtë:

*Tabela nr.II.6.7: Vlera e taksës së tokës së tokës bujqësore në lekë/hektar/vit*

Kategoria e tokës bujqësore	Niveli i taksës së tokës bujqësore sipas VKB-ve (lekë/ha/vit)
I	4,200
II	3,500
III	2,800
IV	2,300
V	1,900
VI	1,600
VII-X	1,400

Referuar VKB-në nr. 119, datë 14.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave në Bashkinë Elbasan për vitin 2022”, toka bujqësore në Bashkinë Elbasan klasifikohet sipas aneksit 2 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006.

*Tabela nr.II.6.8: Debitorët për taksën e tokës bujqësore për vitin 2022*

Nr	Subjekti	Nj.A.	Afati në vite	Sipërfaqe në Hektarë	DETYRIMI	PAGESA	DIFERENCE
1	A.Xh	Gjergjan	99 Vjet	17.5295	53,641	53,641	0
2	F.R				53,641	53,641	0
3	P.Q	Shirgjan	99 Vjet	4.29	30,030	30,030	0
4	E.D	Paper	99 Vjet	1	10,240	10,240	0
5	Sh.B	Paper	99 Vjet	10.7453	69,952	69,952	0
6	V.B	Shushice	99 Vjet	2.2927	16,280	16,400	120
7	A.Q	Shushice	99 Vjet	4.1674	29,171.8	29,200	28.2
8	E.B	Shushice	99 Vjet	3.8764	27,134.8	27,183.7	48.9
9	A.D	Shushice	99 Vjet	3.2775	22,942.5	23,200	257.5
	<b>TOTALI</b>				<b>313,033.1</b>	<b>313,487.7</b>	<b>454.6</b>

*Burimi: Bashkia Elbasan*

*Tabela nr.II.6.9: Debitorët për taksën e tokës sipas njësive administrative për vitin 2022*

Nr.	Njësia	T. Tokë Bujqësore	
		Shuma	Nr. Familje
1	Bradashesh	9,575,428	1,496
2	Shushicë	9,679,920	1,194
3	Shirgjan	6,547,000	1,096
4	Papër	8,052,430	666
5	Gjergjan	6,736,817	806
6	Labinot-Fushë	3,557,775	867
7	Labinot-Mal	5,247,420	957

<sup>13</sup> Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, aneksi 2.

8	Gjinar	4,726,479	560
9	Tregan	3,644,544	430
10	Funar	6,719,727	453
11	Gracen	8,174,646	423
12	Zavalinë	2,903,499	338
*	Σ e 12 Njësi Administrative	75,565,685	9,286
*	Σ e 6 Lagjeve	1,463	1
**	Totali Bashkisë	75,567,148	9,287

*Burimi: Bashkia Elbasan*

Referuar të dhënave të tabelës më sipër në Bashkinë Elbasan për taksën e tokës bujqësore për vitin 2022 janë debitore 9 287 familjeve me vlerë të detyrimit 23,152,825 lekë, ndërsa vlera progresive deri me 31.12.2022, **që përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Elbasan është në vlerën 75,567,148 lekë.**

**Masat e marra për uljen e borxhit**

Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Elbasan është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara.<sup>14</sup>

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Tatim Taksave lidhur me zbatimin e hapave që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar bizneset debitorë sipas Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4 pika 1 dhe 2, Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 89, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore të Republikës së Shqipërisë”, pika 89, i ndryshuar. Pas kalimit të afatit për pagimin në mënyrë vullnetare të këtyre detyrimeve, Drejtoria e Tatimeve Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave ka urdhëruar bllokimin e llogarive bankare apo llogarive depozitë për 2079 subjekte në vlerën 417,628 mijë lekë. Gjithashtu, janë hartuar 37 Urdhra ekzekutimi në vlerën 3,446 mijë lekë, me shkresat përkatëse; Me shkresën nr. 336 prot, datë 03.03.2022 u është dërguar kërkesë për bashkëpunim institucioneve në lidhje me mos ofrimin e shërbimeve subjekteve debitore ndaj Bashkisë Elbasan: DRT, ASHK, DRSHTRR, DEGA DOGANES Elbasan, Dega Thesarit Elbasan, QKB Tiranë; me shkresën nr. 346 prot, datë 04.03.2022 është dërguar shkresa drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Tiranë për kërkim informacioni në lidhje me të dhënat e mjeteve në pronësi të 106 subjekteve debitore, për të vazhduar me procedurën e vendosjes së barrës siguroese pranë Regjistrimit të Barrëve Siguroese; Me shkresën nr. 530 dhe 638 prot, datë 20.04.2022 dhe 12.05.2022 i është kërkuar informacion DPSHTRR, Tiranë në lidhje me të dhënat e mjeteve në pronësi për 106 dhe 213 subjekte juridike debitore; me shkresat nr. 400-425 prot, datë 24.03.2022 është dërguar vendosja e barrës siguroese për mjetet në pronësi të 25 subjekteve debitore (për 87 mjete në pronësi të tyre) pranë Regjistrimit të Barreve Siguroese, Tiranë; janë dërguar në rrugë zyrtare njoftimet për vendosjen e barrës siguroese dhe hipotekore për 272 subjekte juridike debitore (shkresat 267 prot, date 16.02.2022, nr. 393 prot, datë 18.03.2022, nr. 393 prot datë 23.03.2022); me shkresën nr. 1573/1 prot, datë 12.12.2022 i është kërkuar Drejtorisë Buxhet – Financë, Sektorit të Buxhetit kërkesa për parashikimin e fondit në buxhetin e vitit 2023 në vlerën 200,000 leke, shpenzime operative në lidhje me tarifatat për vendosjen e barrës siguroese dhe hipotekore, përkatësisht në RBS dhe ASHK. Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet e vitit 2022, nuk janë nxjerrë urdhrat përkatës për të gjithë subjektet debitore për të ndërmarrë hapa

<sup>14</sup>Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 89, 90, 91, 93.

të tjera bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor të sipër cituar, shkresa drejtuar bankave të nivelit të dytë për bllokim e llogarive bankare të debitorëve ndaj bashkisë.

**Kriteri:** Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93.

**Ndikimi:** Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Elbasan.

**Shkaku:** Mos zbatimi efektiv i kërkesave ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifafat vendore nga debitorët.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Elbasan, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifafat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën:

4. Taksa dhe tarifa familjare në vlerë 295,754,386 lekë;

5. Biznese Debitorë në vlerë 732,528,023 lekë;

6. Debitor ndaj Drejtorisë së ShMZSh në vlerë 1,069,250 lekë

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Tatim Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Tatim Taksave, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Sektori i Tatim Taksave të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Elbasan, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

### **Mbi realizimit e të ardhurave nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit**

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Elbasan ushtron aktivitet bazuar në kuadrin ligjor si më poshtë:

- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”.

**Titulli i gjetjes:** *Mos pagesë e gjobave të vendosura nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Elbasan*

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit që administrojnë IMTV-ja në Bashkinë Elbasan u konstatua se për vitin 2022 janë mbajtur në total 87 proces verbale për konstatimin e kundërvajtjes. Është dhënë 1 masë për “Pezullim të punimeve”, 80 masa për “Prishje të objekteve të kundërligjshëm” si dhe 83 masa “Dënim me gjobë”. Vlera e gjobave për vitin 2022 është 41,100,000 lekë, nga të cilat është paguar vlera 3,600,000 lekë nga 8 subjekte. Nuk kanë paguar 75 subjekte vullnetarisht me vlerë totale të gjobave të vendosura 37,500,000 lekë për periudhën 01.01.2022-31.12.2022. (Për më shumë informacion shiko Aneksin nr. II.6.1)

Drejtoria e IMTV ka ndjekur hapat e nevojshëm për të dërguar në gjykatë vendimet për të nxjerrë Urdhrin e Ekzekutimit për të gjithë gjobat e vendosura të këtij viti, sipas kërkesave të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, pika 4.

**Për vitin 2022 të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV janë në vlerën totale 37,500,000 lekë.**

**Kriteri:** Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” i ndryshuar, neni 5.

Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 9, neni 22.

**Ndikimi:** Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Elbasan nga mos pagesa e gjobave të vendosura nga IMTV.

**Shkaku:** Mos zbatim i legjislacionit nga IMTV për ndjekjen e hapave ligjorë për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për vlerën totale **37,500,000 lekë**. Gjithashtu, IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrin ligjor në fuqi.

### **Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve**

Në territorin e Bashkisë Elbasan për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë për vitin 2022, janë 43 subjekte me 60 pika që ushtrojnë këtë aktivitet. Grupi i auditimit auditoi dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi<sup>15</sup> dhe pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore për vitet 2022.

**Titulli i gjetjes:** *Mbi pajisjen me autorizim për ushtrimin e aktivitetit të subjekteve që tregtojnë lëndë djegëse.*

**Situata:** Nga informacioni dhe dokumentacioni që bashkia disponon, rezultojnë 43 subjekte që ushtrojnë aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë (në 60 pika karburanti), nga të cilat 33 pika kanë licenca me afat më të shkurtër se 5 vjet dhe me pagesa pjesore dhe 27 pika kanë licenca 5-vjeçare, ndërsa 35 subjekte për 50 pika karburanti janë të autorizuar dhe kanë paguar detyrimet sipas kërkesave ligjore dhe për 10 pika karburanti për 8 subjekte janë pa autorizim për periudha të ndryshme me një efekt financiar me vlerë totale **1,197,832 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Elbasan.** (Për më shumë informacioni shiko Aneksin nr. II.6.2)

**Kriteri:** Ushtrimi i aktivitetit nga këto subjekte sipas dokumentacionit që bashkia disponon dhe janë të pa pajisur me autorizim, bie në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, Neni 20-Autorizimet pika 2.

**Ndikimi:** Mos pagesa e detyrimeve për autorizimin ka sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2022 në vlerën **1,197,832 lekë**.

---

<sup>15</sup>Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 20, pika 2.

**Shkaku:** Mos zbatim i detyrimeve ligjore nga Drejtoria e Tatim Taksave për pajisjen me autorizim për ushtrimin e aktivitetit të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Drejtoria e Tatim Taksave të marrë masa që subjektet të pajisen menjëherë me autorizimin përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke paguar detyrimet ndaj Bashkisë Elbasan me vlerë vjetore **1,197,832 lekë** secili sipas aneksit nr. II.6.2 bashkëlidhur raportit të auditimit. Gjithashtu Drejtoria e Tatim Taksave të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet me qëllim që të kryhen pagesat e plota brenda afateve.

### Asetet e dhëna me qira

Dhënia e aseteve të bashkisë me qira bëhet bazuar në kuadrin ligjor si më poshtë:

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840;
- Ligjin nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore;
- VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar;
- VKM nr. 391, datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

**Titulli i gjetjes:** *Të ardhura të munguara nga mos pagesa e detyrimeve për sipërfaqen e tokës së marrë me qira.*

**Situata:** Bashkia Elbasan në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi<sup>16</sup> për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre ka lidhur 6 kontrata për dhënien me qira të aseteve në territorin e Bashkisë Elbasan. Këto kontrata janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës në vijimësi me subjekte të ndryshëm fizik/juridik që kanë shprehur interes, për afate kohore deri në 5 vit. Në mënyrë të përmbledhur kontratat paraqiten në tabelat në vijim:

*Tabela nr.II.6.10: Kontratat e lidhura nga Bashkia Elbasan për dhënien me qira të aseteve*

*lekë*

Nr.	Subjekti	Kontrata	Data	Afati në vite	Objekti	Sipërfaqja në m2	Faturuar	Pagesa	Debitor
1	E.S	3626/1	18.01.2022	1	Bodrum	73.16	176,784	176,784	
2	A.C	3584/1	18.01.2022	1	Bodrum	64.67	155,208	155,208	
3	Sh.T	3596/1	18.01.2022	1	Farmaci + depo	39.02	140,636	140,636	
4	E.D	5155/3	02.05.2018	5	Hapësirë publike <sup>17</sup>	45	133,920		133,920
5	D.T	626/1	24.02.2020	5	Ndërtesë	37.21	97,014	97,014	
6	O.Sh K/2	1867/1	16.05.2022	1	Ambient “kuzhinë”	153	277,795	277,795	
<b>TOTALI</b>							<b>981,357</b>	<b>847,437</b>	<b>133,920</b>

*Burimi: Bashkia Elbasan, përpunoi grupi i auditimit*

Nga auditimi i pagesave të 6 kontratave të qirasë, rezulton se 5 subjekte kanë paguar detyrimin, ndërsa subjekti E.D me kontratë nr. 5155/3, datë 02.05.2018 për sipërfaqen 45 m<sup>2</sup>, nuk ka paguar detyrimin për vlerën 133,920 lekë.

<sup>16</sup> Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjin nr. 139.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

<sup>17</sup> Objekti i kontratës - Dhënien në përdorim të hapësirës publike për shërbimin e prodhimit, të furnizimit dhe shitjes së ujit të pijshëm, të filtruar dhe të gazuar, me kosto të ulët për qytetarët me sipërfaqe 45 m2 në pesë pika të ndryshme të qytetit me sipërfaqe 9 m2 secila.

Nga pagesa e kontratës së qirasë rezulton se qiramarrësi E.D për vlerën 133,920 lekë nuk kanë paguar detyrimet e kontratës. Detyrimi që subjektet kanë ndaj Bashkisë Elbasan për vitin 2022 në vlerën **133,920 lekë përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Elbasan.**

**Kriteri:** Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840.

Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36.

VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar.

VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

VKB nr. nr. 119, datë 14.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave në Bashkinë Elbasan për vitin 2022”.

**Ndikimi:** Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Elbasan nga mos arkëtimi i detyrimeve nga qiramarrësit në vlerën **133,920 lekë.**

**Shkaku:** Strukturat e Bashkisë Elbasan nuk kanë qenë efektive në mbledhjen e detyrimeve të qirave nga subjektet qiramarrëse si dhe nuk kanë respektuar përcaktimet ligjore për dhënien me qira të aseteve të tyre.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Drejtoria Tatim Taksave në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë të marrin masa dhe të ndjekin të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës **133,920 lekë** nga qiramarrësit z. E.D që nuk kanë paguar detyrimet për tokën e marrë me qira.

Rezultoi se në territorin e Bashkisë Elbasan janë pajisur me kontratë 7 Shoqëri Koncesionare të cilat kanë lidhur kontratë me bashkinë për ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të hidro energjisë si dhe 5 subjekte të cilat kanë lidhur kontratë me Bashkinë në fond pyjor për ndërtimin e paneleve fotovoltaike, sipas aneksit nr. 3 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Nga dokumentacioni i vëne në dispozicion rezulton se KLSH me shkresën nr. 258/16 datë. 26.09.2022 ka dërguar raportin përfundimtar në bashkinë Elbasan, ku pjesë integrale e saj është dhe auditimi i kontratave koncesionare të cilat kanë lidhur kontratë me bashkinë për ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të hidro energjisë për periudhën 2018-2021. Gjendja e tyre paraqitet si vijon;

A- Kontrata qiraje nr.1919/2, datë 13.05.2020, HEC Bukaniku

Rillogaritja e tarifës vjetore sipas Grupit të KLSH-së, HEC Bukaniku

Përdorimi I Territorit	Kanal/tuacion uji			Ndërtim/përdorim rruge			Linjë tensioni			Shesh depozitimi përkohshëm të materialeve			Shuma Totale
	Kanal	Tarifa lekë/km	Vlera lekë	Rrugë	Tarifa lekë/km	Vlera lekë	Linja	Tarifa lekë/km	Vlera lekë	sheshi	Tarifa lekë/km	Vlera lekë	
Trungishte	0.05	175,000	8,400	0.433	70,000	30,310	3.8	60,000	227,760	-	-	-	266,470
Cungishte	0.672	145,000	97,440	1.604	50,000	80,200	0.19	35,000	6,545	-	-	-	184,185
Shkurre	0.605	145,000	87,725	0.627	35,000	21,945	3.801	25,000	95,025	-	-	-	204,695
Kullotë	-	-	-	-	-	-	1.07	25,000	26,750	-	-	-	26,750
Bimësi pyjore+ Djerr	-	-	-	-	-	-	0.49	25,000	12,250	-	-	-	12,250
Improduktive	1.768	110,000	194,480	0.337	25,000	8,425	1.518	25,000	37,950	1.2	100,000	120,000	360,855
Bimë mjeksore Medicinale	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjuetia	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Investime/realizuar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Shuma Totale</b>			388,045			140,880			406,280			120,000	1,055,205

Nga rillogaritje sipas tabelës vijuese rezulton se, tarifa vjetore arrin vlerën 1,055,205 lekë. Duke zbritur pas vitit të dytë, dhe vlerën e tarifës së përdorimit të rrugës që lidh sipërfaqes së dhënë në përdorim (140,880 lekë), si dhe vlerën e sheshit të depozitimit të përkohshëm (120,000 lekë), tarifa vjetore nga viti i tretë dhe në vazhdim do të jetë 794,325 lekë.

Sipas llogaritjeve të Bashkisë Elbasan, tarifa vjetore si dhe tarifa pas vitit të tretë janë po të njëjta pra, 1,055,205 lekë dhe 794,325 lekë pas vitit të tretë. **Nuk konstatohen diferenca**

*B - Kontrata qiraje nr.1616, datë 02.04.2021, HEC Kotorri*

Rillogaritja e tarifës vjetore sipas Grupit të KLSH-së, HEC Kotorri

<b>HEC Kotorri</b>		Kanal/tuabcion uji			Shuma Totale
Përdorimi I Territorit	Kanal	Tarifa lekë/km	Vlera lekë		
<b>Trungishte</b>		175,000	-	-	-
<b>Cungishte</b>		145,000	-	-	-
<b>Shkurre</b>		145,000	-	-	-
<i>Kullotë</i>			-	-	-
<i>Bimësi pyjore+ Djerr</i>		-	-	-	-
<b>Improduktive</b>	2.583	110,000	284,130		284,130
<i>Bimë mjeksore Medicinale</i>		-	-	-	-
<i>Gjuetia</i>		-	-	-	-
<i>Investime/realizuar</i>		-	-	-	-
<b>Shuma Totale</b>				284,130	284,130

Nga rillogaritjet sipas tabelës rezulton se tarifa vjetore arrin vlerën 284,130 lekë. Sipas llogaritjeve të Bashkisë Elbasan, tarifat vjetore janë po të njëjta pra, 284,130 lekë. **Nuk konstatohen diferenca.**

*C - Kontrata qiraje nr.1671/3, datë 22.08.2018, HEC Stroti*

Rillogaritja e tarifës vjetore sipas Grupit të KLSH-së, HEC Stroti

<b>HEC Stroti</b>		Kanal/tuabcion uji			Dhenia ne perdorim e tokes			Shuma Totale
Përdorimi I Territorit	Kanal	Tarifa lekë/km	Vlera lekë	Siperf	Tarifa lekë/km	Vlera lekë		
<b>Trungishte</b>		175,000	-		175,000	-	-	
<b>Cungishte</b>		145,000	-		145,000	-	-	
<b>Shkurre</b>		145,000	-		145,000	-	-	
<i>Kullotë</i>			-		-	-	-	
<i>Bimësi pyjore+ Djerr</i>		-	-	-	-	-	-	
<b>Improduktive</b>	2.700	110,000	297,000	0.017	175,000	2,975	299,975	
<i>Bimë mjeksore Medicinale</i>		-	-	-	-	-	-	
<i>Gjuetia</i>		-	-	-	-	-	-	
<i>Investime/realizuar</i>		-	-	-	-	-	-	
<b>Shuma Totale</b>			297,000			2,975	299,975	

Nga rillogaritjet sipas tabelës rezulton se, tarifa vjetore arrin vlerën 299,975 lekë. Sipas llogaritjeve të Bashkisë Elbasan, tarifat vjetore janë po të njëjta pra, 299,975 lekë. **Nuk konstatohen diferenca në vlerësim.**

*D - Kontrata qiraje nr.2589, datë 10.06.2021, HEC Gostima*

Rillogaritja e tarifës vjetore sipas Grupit të KLSH-së, HEC Gostima

<b>HEC Gostima</b>		Kanal/tuabcion uji			Ndërtim/përdorim rruge			Shuma Totale
Përdorimi I Territorit	Kanal	Tarifa lekë/km	Vlera lekë	Rrugë	Tarifa lekë/km	Vlera lekë		
<b>Trungishte</b>	4.199	175,000	734,825		70,000	-	734,825	
<b>Cungishte</b>	3.313	145,000	480,385	0.503	50,000	25,150	505,535	
<b>Shkurre</b>		145,000	-		35,000	-	-	
<i>Kullotë</i>		0.909	145,000	131,805	1.8	35,000	63,000	194,805
<i>Bimësi pyjore+ Djerr</i>		-	-	-	-	-	-	
<b>Improduktive</b>	1.218	110,000	133,980		25,000	-	133,980	
<i>Bimë mjeksore Medicinale</i>		-	-	-	-	-	-	
<i>Gjuetia</i>		-	-	-	-	-	-	
<i>Investime/realizuar</i>		-	-	-	-	-	-	
<b>Shuma Totale</b>		9.639		1,480,995	2.303	88,150	<b>1,569,145</b>	

Nga rillogaritjet sipas tabelës rezulton se , tarifa vjetore arrin vlerën 1,569,145 lekë. Duke zbritur pas vitit të dytë, dhe vlerën e tarifës së përdorimit e rrugës që lidh sipërfaqes së dhënë në përdorim (88,150 lekë), tarifa vjetore nga viti i tretë dhe në vazhdim do të jetë 1,480,955 lekë. Sipas llogaritjeve të Bashkisë Elbasan, tarifa vjetore si dhe tarifa pas vitit të tretë janë po të njëjta pra, 1,569,145 lekë dhe 1,480,955 lekë pas vitit të tretë. **Nuk konstatohen diferenca.**



*E - Kontrata qiraje nr.1323, datë 28.02.2018, HEC Arcova*  
 Rillogaritja e tarifës vjetore sipas Grupit të KLSH-së, HEC Arcova

HEC Arcova	Kanal/taucion uji			Ndërtim/përdorim rruge përkohshme Viti I dhe II			Vlera bimësisë pyjore/viti I			Shuma Totale
	Kanal	Tarifa lekë/km	Vlera lekë	Rrugë	Tarifa lekë/km	Vlera lekë	Volumi m <sup>3</sup>	Lekë/m <sup>3</sup>	Vlera	
Përdorimi I Territorit	0.610	175,000	106,750	0.315	70,000	22,051	18.14	2,300	41,725	176,651
<b>Trungishte</b>							12.25	500	6,125	
<b>Cungishte</b>		145,000	-		50,000	-				-
<b>Shkurre</b>	1.686	145,000	244,470	0.143	35,000	5,016				249,486
<i>Kullotë</i>	1.724	145,000	249,980	0.147	35,000	5,129	8.75	500	4,375	259,484
<i>Bimësi pyjore+ Djerr</i>		-	-	-	-	-	0.03	500	15	15
<b>Improduktive</b>	1.213	110,000	133,430	0.103	25,000	2,578				136,008
<i>Bimë mjeksore Medicinale</i>	-	-	-	-	-	-				-
Gjuetia	-	-	-	-	-	-				-
Investime/realizuar	-	-	-	-	-	-				-
<b>Shuma Totale</b>	5.233		734,630	0.708		34,773			52,240	<b>821,643</b>

Nga rillogaritjet sipas tabelës rezulton se, tarifa vjetore arrin vlerën 821,643 lekë për vitin e parë. Në vitin e dytë kësaj tarife i zbritet vlera e bimësisë pyjore (52,240 lekë) dhe arrin 769,403 lekë. Pas vitit të dytë, kësaj tarife i zbritet dhe përdorimi i fondit pyjor për përdorimin e rrugës së përkohshme (34,773 lekë), duke rezultuar kështu në një tarif konstante **prej vitit të tretë dhe në vazhdim në vlerën 734,638 lekë.**

Referuar kontratës, vlera për vitin e parë dhe të dytë do të jetë 803,225 lekë si dhe për vitin e tretë dhe në vazhdim, kjo vlerë do të jetë 587,630 lekë. Sic shihet kemi diferenca për vitin e parë, të dytë, si dhe për vitin e tretë dhe në vazhdim si më poshtë:

<b>Diferenca në Tarifim Qeraje</b>	Sipas Grupit të Auditimit	Sipas Kontratës	Diferenca
Tarifa viti I	821,643	803,225	18,418
Tarifa Viti II	769,403	587,630	181,773
Tarifa Viti III dhe në vazhdim	734,638	587,630	147,008

Formulimi i kësaj kontrate, sipas këtyre kushteve, **që nga momenti i fillimit të efekteve financiare do të sjellë për 9 vite jetgjatësi të ardhura më pak për Bashkinë e Elbasanit në vlerën 1,229,247 lekë.** (18,418 lekë vitin e parë, 181,773 lekë vitin e dytë si dhe 7 vite x 147,008 lekë vitet e tjera). Pra konstatohen diferenca të dukshme midis vlerës së përlllogaritur sipas VKM-së nr.1064 datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të këshillit të ministrave "për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave" dhe sipas përlllogaritjes së Bashkisë Elbasan.

*F - Kontrata qiraje nr.1322, datë 28.02.2018, HEC Kamiçani.*

Rillogaritja e tarifës vjetore sipas Grupit të KLSH-së, HEC Kamiçani.

HEC Kamiçani	Kanal/taucion uji			Ndërtim/përdorim rruge përkohshme Viti			Vlera bimësisë pyjore/viti I			Shuma Totale
	Kanal	Tarifa lekë/km	Vlera lekë	Rrugë	Tarifa lekë/km	Vlera lekë	Volumi m <sup>3</sup>	Lekë/m <sup>3</sup>	Vlera	
Përdorimi I Territorit	0.331	175,000	57,925	0.026	70,000	1,854	0.43	2,300	989	61,398
<b>Trungishte</b>							1.26	500	630	
<b>Cungishte</b>		145,000	-		50,000	-				-
<b>Shkurre</b>	0.716	145,000	103,820	0.057	35,000	2,005				105,825
<i>Kullotë</i>	0.840	145,000	121,800	0.067	35,000	2,352	2.40	500	1,200	125,352
<i>Bimësi pyjore+ Djerr</i>	1.842	110,000	202,620	-	-	-				202,620
<b>Improduktive</b>		110,000	-	0.147	25,000	4,421				4,421
<i>Bimë mjeksore Medicinale</i>	-	-	-	-	-	-				-
Gjuetia	-	-	-	-	-	-				-
Investime/realizuar	-	-	-	-	-	-				-
<b>Shuma Totale</b>	3.729		486,165	0.298		10,631			2,819	<b>499,615</b>

Nga rillogaritjet sipas tabelës në aneksin 2.6.12, tarifa vjetore arrin vlerën 499,615 lekë. Duke zbritur pas vitit të dytë, dhe vlerën e tarifës së përdorimin e rrugës që lidh sipërfaqes së dhënë në përdorim si dhe bimësinë pyjore (10,631+2,819 lekë), tarifa vjetore nga viti i tretë dhe në vazhdim do të jetë 486,165 lekë.

Sipas llogaritjeve të Bashkisë Elbasan, tarifa vjetore si dhe tarifa pas vitit të tretë janë po të njëjta pra, 499,615 lekë dhe 486,165 lekë pas vitit të tretë. **Nuk konstatohen diferenca**



Sa më sipër në vijim të auditimit të mëparshëm dhe verifikimit të pagesave sipas kontratave të nënshkruara me bashkinë rezulton se nga 7 Shoqëri Koncesionare të cilat kanë lidhur kontratë me bashkinë për ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të hidro energjisë kanë paguar detyrimet sipas kontratave 3 Shoqëri Koncesionare sipas kontratave të nënshkruara me bashkinë si dhe nuk kanë paguar detyrimin 4 Shoqëri Koncesionare konkretisht:

1. *Kontrata qiraje nr.1616, datë 02.04.2021, HEC Kotorri e nënshkruar ndërmjet Bashkisë Elbasan, e përfaqësuar nga Kryetari i saj, z. G.LL dhe Shoqërisë "A " sh.p.k., e regjistruar si person juridik në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS L.....T me përfaqësues ligjor z. D.G*

2. *Kontrata qiraje nr.1322, datë 28.02.2018, HEC Kamiçani e nënshkruar ndërmjet Bashkisë Elbasan, e përfaqësuar nga Kryetari i saj, z.Q.S dhe shoqërisë "I " Sh.p.k e regjistruar si person juridik në Qendrën Kombëtare të Bimesit me NUIS K.....N me përfaqësues ligjor z. P.K.*

3. *Kontrata qiraje nr.1323, datë 28.02.2018, HEC Arcova e nënshkruar ndërmjet Bashkisë Elbasan, e përfaqësuar nga Kryetari i saj, z.Q.S dhe shoqërisë "I " Sh.p.k e regjistruar si person juridik në Qendrën Kombëtare të Bimesit me NUIS K.....N me përfaqësues ligjor z. P.K.*

4. *Kontrata qiraje nr.1919/2, datë 13.05.2020, HEC Bukaniku e nënshkruar ndërmjet Bashkisë Elbasan, e përfaqësuar nga Kryetari i saj, z. G.LL dhe Shoqërisë "B.N" sh.p.k., e regjistruar si person juridik në Qendrën Kombëtare të Bimesit me NUIS K.....O me përfaqësues ligjor z. N.B. Pasi referuar Nenit 3 të kontratave respektive citohet togfjalëshi "kontratat i fillojnë efektet e saj ligjore dhe financiare në momentin e pajisjes së Shoqërisë. me lejen e ndërtimit të Hidrocentralit. Afati i dhënies në përdorim është 9 (nëntë) vjeçar, duke filluar nga e nesërmja e marrjes së lejes së ndërtimit nga organet përkatëse.*

*Një muaj përpara përfundimit të afatit të mësipërm, secila Palë duhet të njoftojë palën tjetër për të negociuar shtyrjen e afatit të kontratës për të njëjtën periudhë ose për përfundimin e saj.*

*Në mungesë të këtij njoftimi ose të ndonjë komunikimi midis palëve, kontrata do të konsiderohet e zgjidhur në përfundimin e afatit të përcaktuar në këtë kontratë" si dhe Nenit 5 (pika 5.2) të tyre ku citohet "Pagesa për vitin e parë të qiramarrjes do të bëhet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate, ndërsa për periudhën vijuese pas çdo 12 muajsh".*

Përcaktimi i Nenit 3 dhe Nenit 5 (pika 5.2) të tyre bie në kundërshtim me pikën 20 të Udhëzimit të Ministrisë të Mjedisit Nr.01, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik" i ndryshuar ku citohet "Pagesa e qirasë është vjetore, duke u llogaritur nga data e lidhjes së kontratës dhe shlyhet në momentin e lidhjes së kontratës dhe në të njëjtën datë në vitin pasardhës".

Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 Për Rregullat, Procedurat e Kërimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për dhënie në Përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullor Publik; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja "g" në pikën 1 në nenin 17, shkronja "c" e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja "a" e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 "Për pyjet".

**Kriteri:** Udhëzim Nr. 1, datë 9.6.2016 Për Rregullat, Procedurat e Kërimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për dhënie në Përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullor Publik; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja "g" në pikën 1 në nenin 17, shkronja "c" e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja "a" e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 "Për pyjet" VKM-së nr.1064 datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të këshillit të ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave".

**Ndikimi:** Hartimi i kontratave të qerave jo në përputhje me çmimet e përcaktuara në VKM-së nr.1064 datë 22.12.2010, do të sjellë të ardhura të munguara në momentin e fillimit të efekteve financiare të kontratës.

**Shkaku:** Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

**Rëndësia:** E Lartë

**Rekomandimi:** Nga Bashkia Elbasan si dhe nga Drejtoria e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinarisë dhe Mjedisit, të merren masa që kontrata e qirasë nr.1323, datë 28.02.2018, ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe qiramarrësit "I" SHPK, ti bashkëngjitet një amendament, ku të rishikohet neni i llogaritjes së tarifës vjetore, pasi në kushtet aktuale, që nga momenti i fillimit të efekteve financiare, kjo kontratë do të sjellë për 9 vite jetëgjatësi të ardhura më pak për Bashkinë e Elbasanit në vlerën 1,229,247 lekë.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Elbasan të analizojë sitatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për rishikimin e Nenit 3 dhe Nenit 5 (pika 5.2) të kontratave të sipërcituara si dhe llogaritjen e detyrimeve.

**Titulli i gjetjes:** *Për dhënien me qira të pyjeve kullotave për antena të telefonisë celulare si dhe për prodhim energjie nga fotovoltaiçet, në territorin e Bashkisë Elbasan dhe 12 njësive administrative.*

**Situata:** Nga auditimi i pagesave të kontratave të nënshkruara ndërmjet bashkisë Elbasan dhe 5 Shoqërive koncesionare të cilat kanë nënshkruar kontratë për marrjen në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullor për prodhim energjie nga fotovoltaiçet nuk u konstatuan diferenca. Të paraqitura në tabelën e sipërcituar.

Referuar kontratave të qirave për shoqëritë të telefonisë celulare u konstatua se, nga 13 kontrata të nënshkruara më bashkinë kanë likuiduar vlerën 2,293,750 lekë, kanë likuiduar detyrimet 11 kontrata në vlerën 1,748,750 lekë si dhe nuk kanë kryer pagesën 2 subjekte në vlerën 545,000 lekë për vitin 2022 e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Elbasan. Paraqitur në formë tabele në aneksin nr. 4 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

**Kriteri:** VKM nr.1064 datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të këshillit të ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave".

**Ndikimi:** Të ardhura të munguara për shkak të mos mbledhjes së tarifës kontraktuale.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kontratës së qerasë.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** Nga Bashkia Elbasan si dhe nga Drejtoria e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinarisë dhe Mjedisit, të merren masa që të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimit të prapambetur për tarifën e qerasë prej **545,000 lekë** nga operatori V. sh.a.

**Titulli i gjetjes:** *Për realizimin e të ardhurave të institucionit nga dhënia me qira e fondit pyjor e kullor publik për Lejet Minerare (Guroret) të Bashkisë Elbasan.*

Në territorin e Bashkisë Elbasan ushtrojnë aktivitet privat 5 subjekte të pajisura me leje minerare nga ish-Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (sot MIE), të cilat nuk kanë lidhur kontratë qiraje për sipërfaqet pyjore dhe kullorë që kanë në përdorim, por që i shfrytëzojnë këto pasuri për qëllime biznesi.

Bazuar në informacionin e marrë nga Agjencia e Shërbimit Pyjor Bashkia Elbasan si dhe nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, është bërë me dije statusi i aktivitetit të këtyre subjekteve në terren, pra nëse janë aktiv apo jo këto subjekte që operojnë në territorin e bashkisë Elbasan.

Në vijim paraqiten subjektet e pajisur me leje minerare nga MIE dhe statusi i tyre për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 dhe në se janë lidhur kontratat qiraje ose jo.

*Pasqyra e subjekteve me aktivitet gurorë, pjesë e fondit pyjor të bashkisë, statusi i tyre periudha 2019-2022.*

Nr	Emërtimi	NIPT	Kontrata qiraje	Statusi i aktivitetit Viti 2019	Statusi i aktivitetit Viti 2020	Statusi i aktivitetit Viti 2021	Statusi i aktivitetit Viti 2022
1	SH - G SHPK	K.....D	nuk ka	aktiv	aktiv	aktiv	aktiv
2	U.Q SHPK	J.....Q	nuk ka	aktiv	aktiv	aktiv	aktiv
3	V.H SHPK	K.....C	nuk ka	aktiv	aktiv	aktiv	aktiv
4	Rr.U.A Nr.2 Elbasan sha	J.....O	nuk ka	aktiv	aktiv	aktiv	aktiv
5	Y. S Sh p k	L.....T	nuk ka	aktiv	aktiv	aktiv	aktiv
6	V.H SHPK	K.....C					aktiv

Për periudhën e viteve 2019-2022, janë gjithsej 11 subjekte që ushtrojnë aktivitet në fushën e nxjerrjes dhe të përpunimit të gurit gëlqeror dhe të mermerizuar në pronat e bashkisë, nga të cilat janë me status aktiv që punojnë në terren 11 subjekte, por 5 prej të cilave kanë detyrimin për marrëdhënie kontraktuale qiraje me Bashkinë Elbasan, pasi përdorin fondin pyjor të saj, për të ushtruar aktivitetin ekonomik të tyre.

U auditua dokumentacioni për periudhën 01.01.2019 deri më datën 31.12.2022, në lidhje me dhënien me qira të sipërfaqeve pyjore dhe kullimore dhe Inproduktive, nga ku konstatohet se nga Bashkia Elbasan, nuk është vepruar për hartimin e kontratave për të dhënë me qira sipërfaqet pyjore dhe kullimore me 5 subjektet fizike të mësipërme, edhe pse këto subjekte janë pajisur me leje shfrytëzimi të miratuar ish-Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (sot MIE). Në vijim paraqiten subjektet e pajisur me leje minerare dhe statusi i tyre për vitet 2019, 2020, 2021, 2022 paraqitet në aneksin nr. 5 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

#### **Situata: A - Për subjektin “Y.S” SHPK me NIPT L.....T**

Nga auditimi i dokumentacionit të studimit tekniko ekonomik së bashku me anekset e përcaktuara dhe në udhëzimin nr.1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të Fondit Pyjor Dhe Kulloror Publik”, **nuk ka dalë asnjë VKM për heqjen nga Fondi Pyjor/Kulloror për 12 hektar shfrytëzim nga subjekti ekonomik “Y.S” SHPK, aq më tepër të kemi dhe një ndryshim të zërit kadastral për këto 12 hektar.** Nisur nga QKB si dhe duke parë aktivitetin dhe pagesën e taksave të subjektit “Y.S” SHPK me NIPT L.....T, ndër to dhe Tarifën për Mbrojtjen dhe Përmirësimin e Mjedisit siç referohet nga Inspektoriati i Mjedisit të Bashkisë Elbasan, duket qartë që ky subjekt ekonomik, **po ushtron aktivitet të plotë duke shfrytëzuar lejen minerare PN-3593-05-2012 që prej vitit 2013.** Konkluzioni është që ky subjekt po ushtron veprimtarin ekonomike duke shfrytëzuar sipërfaqen prej 12 hektarësh, pa pasur një kontratë përdorimi të Fondit Pyjor/Kulloror të këtyre 12 hektarëve në pronësi të Bashkisë Elbasan, që prej vitit 2012.

#### **B - Për subjektin “SH.G” SHPK me NIPT K.....D**

Nga auditimi është konstatuar se në dosje administrohen disa kontrata qiraje 1 vjeçare për përdorimin e fondit pyjor/kulloror me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, për vitin 2007, si dhe me Komunën Shushicë për vitet 2011, 2012 dhe 2013. Megjithatë subjekt ekonomik, shfrytëzon sipërfaqen prej 5 hektarësh që prej vitit 2014 pa kontratë qiraje si dhe nuk ka përmblusur detyrimet për heqjen nga fondi pyjor/kulloror të cilin e shfrytëzon dhe ky fond është aset i Bashkisë Elbasan.

#### **C - Për subjektin “Rr.U.A” SHPK me NIPT J.....O**

Nga auditimi është konstatuar se në dosje administrohen disa kontrata qiraje 1 vjeçare për përdorimin e fondit pyjor/kulloror me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, për vitin 2013, 2014 të cilat janë ripërsëritur. Në konkluzion, ky subjekt ekonomik, shfrytëzon sipërfaqen prej 0,5 hektarësh që prej vitit 2015 pa kontratë qiraje si dhe nuk ka përmblusur detyrimet për heqjen nga fondi pyjor/kulloror të cilin e shfrytëzon dhe ky fond është aset i Bashkisë Elbasan.

#### **D - Për subjektet U.Q SHPK me NIPT J.....Q dhe V.H SHPK me NIPT K.....C**

Për këto subjekte ekonomike, nga Bashkia Elbasan, Agjencia e Shërbimeve Pyjore, nuk administrohet asnjë dosje subjekti, pra praktikisht Bashkia Elbasan nuk ka asnjë informacion për aktivitetin e ***U.Q SHPK dhe V.H SHPK në territorin e saj dhe nuk ka asnjë informacion për sa i përket shfrytëzimit të aseteve të saj (fondit pyjor/kullosornë total prej 4,58 ha) për efekt të nxjerrjes së gurit gëlqeror*** siç parashikohet në aktet e miratimit të lejes minerare, përkatësisht nr. 922/1 datë 10.05.2016 për U.Q SHPK dhe nr. 1304/3 datë 26.01.2009 për V.H SHPK.

**E- Për subjektin V.H SHPK me NIPT K.....C**

Për këto subjekte ekonomike, nga Bashkia Elbasan, Agjencia e Shërbimeve Pyjore, nuk administrohet asnjë dosje subjekti, pra praktikisht Bashkia Elbasan nuk ka asnjë informacion për aktivitetin e ***V.H SHPK në territorin e saj dhe nuk ka asnjë informacion për sa i përket shfrytëzimit të aseteve të saj (fondit pyjor/kullosor në total prej 100 ha) për efekt të nxjerrjes së gurit gëlqeror*** siç parashikohet në aktet e miratimit të lejes minerare, përkatësisht nr. 1932 datë 18.05.2022 për V.H SHPK.

**Kriteri:** Ligji nr. 9385 datë 04.05.2005 “Per pyjet dhe shërbimin Pyjor” , neni 17 si dhe neni 19 pika 3, si dhe nenin 801 dhe 802 të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 “për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” i përditësuar, si dhe nenin 24, pika 10 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, dhe VKM 1353 datë 10.10.2008, i ndryshuar “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar.

**Ndikimi:** Përdorimi i fondit pyjor në pronësi të Bashkisë Elbasan në kundërshti me ligjin, që sjell tjetërsimin e aseteve të saj, pa pasur asnjë të drejtë mbi pronësinë apo kontratë mbi përdorimin e tyre. Përdorimi i fondit pyjor në mungesë të kontratave të qirave, gjithashtu sjell të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Elbasan.

**Shkaku:** Mos njohja dhe zbatimi i dispozitave ligjore të përdorimit të fondit pyjor dhe ligjit të sektorit minerar.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** Nga Bashkia Elbasan, të merren masa në mënyrë të menjëhershme që të bllokohet aktiviteti ekonomik i këtyre guroreve, deri në momentin e përfundimit të procedurave ligjore, në lidhje me heqjen nga fondi pyjor dhe ndryshimi i zërit kadastral i sipërfaqeve përkatëse të guroreve të sipërcituara. Gjithashtu, para momentit të zhbllokimit, pasi të jenë kryer të gjitha procedurat ligjore për heqjen nga fondi pyjor, Bashkia Elbasan të bëjë një vlerësim për dëmin e shkaktuar nga përdorimi i paligjshëm i sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullosor, dhe t’jua faturojë subjekteve përkatëse private.

Në observacionin e subjektit të audituar Bashkia Elbasan mbi Akt konstatimin nr.14 dërguar me shkresën nr. 4474/44 prot., dt. 22.11.2023 dhe me nr. 767/4 prot., (i KLSH) dt. 30.11.2023, shprehur si më poshtë vijon:

**Pretendimi i subjektit:**

1.- Bashkia Elbasan ka përgatitur Amendimin e kontratës dhe ia ka dërguar subjektit për nënshkrimin e saj me shkresën nr.3566/1, datë 30.06.2023. *Amendamneti i kontratës së qirasë nr.3566 prot., datë 30.06.2023 gjendet bashkëlidhur.(nga kontrolli i meparshem i KLSH kur përgatiti raportin për zbatimin e masave e ka quajtur të zbatuar si mase të cilat ndodhet bashkëlidhur ketij observacioni)*

2. Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, pranë Bashkisë Elbasan për zgjidhje të situatës në fjalë i është drejtuar për bashkëpunim Drejtorisë Juridike të Bashkisë Elbasan ku kjo e fundit me shkresën nr.605/2, datë 05.07.2022 ka bërë argumentimin juridik për grumbullimin e të ardhurave të prapambetura nga shoqëria V. sh.a, por sërish kjo shoqëri ka refuzuar në mënyrë kategorike shlyerjen e këtyre detyrimeve me shkresën nr.042, datë 19.07.2022. Menjëherë pas kësaj përgjigje Drejtoria e Shërbimit Pyjor i është drejtuar zyrtarisht me shkresën nr.605/2, datë

22.05.2023, Drejtorisë së Buxhet-Financës pranë Bashkisë Elbasan për zgjidhje të ngërçit, ku nga ana e kesaj Drejtorie në Konsultim me Drejtorinë Rajonale Tatimore dhe Drejtorinë e Thesarit kanë argumentuar që nuk mund të lëshojne fatura të fiskale sepse Bashkia Elbasan nuk është objekt i tatimit në burim Por është subjekt që mbledh të ardhura dhe tarifat te miratuara më parë me Vendim Këshilli Bashkiak. Pra theksojmë se Struktura e Pyjeve pranë Bashkisë Elbasan ka nisur të gjithë procedurat përkatëse ligjore te cilat do ti vazhdojme për vjeljen e të ardhurave të prapambetura nga shoqëria V. sh.a. *Korrespondencat e mësipërme i gjeni bashkëlidhur.*

3. Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave në varësi të Bashkisë Elbasan ka njoftuar subjektet me Leje Minerare që ushtrojnë aktivitetin ekonomik në fondin pyjor publik të bashkisë Elbasan të marrin masa të menjëherëshme për përfundimin e procedurave ligjore në lidhje me heqjen nga fondi pyjor dhe ndryshimin e zërit kadastral të sipërfaqes përkatëse të gurorës (*shkresat nr.1607 prot., nr.1608 prot., nr.1609 prot., nr.1610 prot., 1611 prot, datë 14.02.2023*) duke u lënë një afat 45 (dyzet e pesë) ditë pune për të na vendosur në dispozicion dokumentacion tekniko-ligjor me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), në lidhje me procedurat e ndjekura për heqjen nga fondi pyjor për sipërfaqen ku ushtron aktivitetin minerar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Por në përfundim të afatit të mësipërm përveç subjektit ‘V’ sh.p.k për objektin ‘Rrezlik’ që ka bërë kërkesë për heqje nga fondi pyjor pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe kjo e fundit me shkresën nr.2034/1, datë 12.04.2023 i ka kërkuar bashkisë Elbasan për përgatitjen e raportit tekniko-ekonomik për kryerjen e aktivitetit ekonomik e cila është konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, të gjithë subjektet tjerë nuk kanë vendosur në dispozicion të bashkisë Elbasan asnjë dokument provues që janë në linjë të procedurave për heqjen nga fondi pyjor, me qëllim ushtrimin e aktivitetit të tyre minerar. Për arsyet e sipërcituar Bashkia Elbasan i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës (MIE) dhe AKBN si autoritet qëndror që ka si objektiv të veprimtarisë së saj, zhvillimin, mbikqyrjen e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, në bazë të politikave qeverisëse, dhe monitorimin e postshfrytëzimit të tyre, në sektorin minerar, hidrokarbur dhe energjetik, ***që të kryej të gjithë procedurat përkatëse ligjore për verifikimin dhe bllokimin e aktivitetit të tyre minerar deri në momentin e përfundimit të të gjithë procedurave për heqjen nga fondi pyjor dhe të pagesës së vlerës së dëmëve të shkaktuara nga përdorimi i paligjshëm i fondit pyjor dhe kullor publik nën juridiksionin e bashkisë Elbasan, në llogari të bashkisë Elbasan.*** *(nga kontrolli i meparshem i Klsh kur përgatiti raportin për zbatimin e masave e ka quajtur në proces zbatimi si mase të cilat ndodhet bashkangjitur këtij observacini)* Shkresa nr.5998, datë 27.10.2023 gjendet bashkëlidhur.

**4. - Në pikën 13 për situatën E-Per subjektin V.H sh.p.k (fq.9)** ku ndër të tjerat shprehet *.pra praktikisht Bashkia Elbasan nuk ka asnjë informacion për sa i perket shfrytëzimi të aseteve të saj (fond pyjor kullor në total 100 ha).*

**Për këtë pikë ju sqarojmë se:** Për rastin në fjalë Bashkia Elbasan, Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave disponon dosjen e plote dhe të dhënat e plota për këtë subjekt ku Ministria e Mjedisit me shkresën nr 7545/3 prot date 4/11/2022 ka sjellë për përgatitjen e raportit teknik ku bashkëlidhur ka dokumentacionin ligjor dhe teknik e konkretisht lejen e shfrytëzimit për mineralin gëlqeror, shkresën përcjellëse dhe akt-miratimin nr 1932 datë 18/05/2022, hartat dhe kordinatat, njoftim garancie, vendim nr 51/2021 date 28/12/2021, akt-verifikim date 24/12/2021 ora 12, leje mjedisi tipi B, Akt miratim Leje Mjedisit tipi B ndodhur para fakteve të mësipërme Bashkia Elbasan përgatiti raportin Teknik dhe Relacionin për në Këshillin Bashkiak ku këshilli mori Vendimin nr 36 date 20/04/2023 Për Heqjen nga Fondi Pyjor dhe Kullor Publik dhe Pakësimin në volum të sipërfaqeve që do të perdoren nga shoqëria “V. H.” sh.p.k dhe pas kësaj iu kthye përgjigje Ministrisë së Mjedisit me shkresën nr 5220/1 prot date 04/09/2023 ku bashkëlidhur u dergua raporti teknik dhe vendimi i Këshillit Bashkiak. (Bashkëlidhur ju dërgojme fotokopje dokumentave të përmendura më sipër).

5. Krijimi i marrëdhënieve juridike me tokën për subjektet që aplikojnë për ndertimin e burimeve të reja gjeneruese të energjisë elektrike, është detyrim për keto subjekte parashikuar aktualisht në

nenin 7 të vkm 822 datë 7/10/2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni. Në këto kushte duke qenë se subjekti qeramarrës nuk mund ta përdorte sipërfaqen e marrë me qira deri në momentin e miratimit të lejes përkatëse të ndërtimit. Ndodhur para këtyre kushteve kontratave të qerasë është lënë që të hyjnë në fuqi në momentin e pajisjes me leje ndërtimi pra në momentin kur subjektet do ta përdornin relativisht sipërfaqen.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Lidhur me pretendimet tuaja mbi konstatimet e grupit të auditimit lënë në Akt konstatimin nr. 14 dt. 13.11.2023, do të meren në konsideratë përsa i takon pikës 1 dhe 4 të sipërcituar ndërsa përsa i përket pikave 2, 3 dhe 5 të sipërcituara nuk merren në konsideratë pasi:

2.- Grupi i auditimit referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana juaj i është referuar arkëtimit të detyrimit si pasojë e kontratës cituar “ Aneksi nr 2 pika 2.6 bashklidhur raportit. Referuar VKM nr.1064 datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të këshillit të ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave".

3.- Referuar procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave në varësi të Bashkisë Elbasan e cila ka njoftuar subjektet me Leje Minerare që ushtrojnë aktivitetin ekonomik në fondin pyjor publik të bashkisë Elbasan të marrin masa të menjëherëshme për përfundimin e procedurave ligjore në lidhje me heqjen nga fondi pyjor dhe ndryshimin e zërit kadastral të sipërfaqes përkatëse të gurorës (*shkresat nr.1607 prot., nr.1608 prot., nr.1609 prot., nr.1610 prot., 1611 prot, datë 14.02.2023*) duke u lënë një afat 45 (dyzet e pesë) ditë pune për të na vendosur në dispozicion dokumentacion tekniko-ligjor me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), në lidhje me procedurat e ndjekura për heqjen nga fondi pyjor për sipërfaqen ku ushtron aktivitetin minerar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe shkresat drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës (MIE) dhe AKBN si autoritet qëndror që ka si objektiv të veprimtarisë së saj, zhvillimin, mbikqyrjen e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, në bazë të politikave qeverisëse, dhe monitorimin e postshfrytëzimit të tyre, në sektorin minerar, hidrokarbur dhe energjetik, që të kryejë të gjithë procedurat përkatëse ligjore për verifikimin dhe bllokimin e aktivitetit të tyre minerar deri në momentin e përfundimit të të gjithë procedurave për heqjen nga fondi pyjor dhe të pagesës së vlerës së dëmëve të shkaktuara nga përdorimi i paligjshëm i fondit pyjor dhe kullor publik nën juridiksionin e bashkisë Elbasan, në llogari të bashkisë Elbasan. . Janë konsideruar në proces zbatimi si mase të cilat ndodhet bashkangjitur ketij observacini Shkresa nr.5998, datë 27.10.2023. duke ju argumentuar se:

Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave në varësi të Bashkisë në bashkëpunim me Policinë Bashkiake si dhe Inspektoriatin, kanë të drejtë ligjore për verifikimin në teren të subjekteve të cilat ushtrojnë aktivitet pa përfunduar procesin e heqës nga fond Pyjor dhe bllokimin e aktivitetit deri në plotësimin me të gjitha dokumentacionin e nevojshëm sipas dispozitave ligjore të ligjit nr. 139/ 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

5.- Referuar pretendimeve të pikës 5 ju sqaroj se Përcaktimi i Nenit 3 dhe Nenit 5 (pika 5.2) të kontratave të lidhura me subjektet e Heceve bie në kundërshtim me pikën 20 të Udhëzimit të Ministrisë të Mjedisit Nr.01, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik" i ndryshuar ku citohet “Pagesa e qirasë është vjetore, duke u llogaritur nga data e lidhjes së kontratës dhe shlyhet në momentin e lidhjes së kontratës dhe në të njëjtën datë në vitin pasardhës”.

#### **Konkluzion: të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë janë:**

◇ Nga taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet në vlerën 15,690,719 lekë, ndërsa për vitin 2022 është në vlerën 495,211 lekë;

◇ Nga familjet për taksat dhe tarifën e tokës, ndërtesës, pastrimit, ndriçimit, etj., në vlerën 295,754,386 lekë, ndërsa për vitin 2022 është në vlerën 91,931,722 lekë;

- ◇ Nga bizneset debitore, në vlerën 732,528,023 lekë ndërsa për vitin 2022 është në vlerën 139,229,606 lekë;
- ◇ Nga gjoba të vendosura nga IMTV në vlerën totale 37,500,000 lekë për vitin 2022;
- ◇ Nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve në vlerën 1,197,832 lekë për vitin 2022;
- ◇ Nga kontrata e qirasë në vlerën 133,920 lekë nga asetet e dhëna me qira për vitin 2022.

### **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. Z. G.LL, me detyrë Kryetar i Bashkisë Elbasan;
2. Z. Q.T, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës;
3. Z. K.Ç, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave, Tarifave Vendore;
4. Zj. E.B, me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Borxhit;
5. Z. A.K, me detyrë përgjegjës i Sektorit të Terrenit;
6. Zj. A.S, me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Aseteve dhe Strehimit;
7. Z. D.M, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit Urban;
8. Zj. A.M, me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

### **Tarifë parkim automjete**

Taksa e parkimit për vitin 2022 është realizuar në masën 30%, nga 40,000,000 lekë të planifikuara janë arkëtuar 11,992,500 lekë, mos arkëtim në vlerën 28,007,500 lekë. Nga shqyrtimi i materialeve të vëna në dispozicion të grupit të auditimit rezulton se, për vitin 2022:

Bashkia Elbasan me VKB nr. 60, datë 18.06.2020, “Për miratimin e kriterëve dhe përcaktimin e rrugëve dhe shesheve publike për administrimin e shërbimit të parkimit me pagesë të Bashkisë Elbasan” ndryshuar me VKB nr. 86, datë 31.08.2021 dhe VKB nr. 23, datë 04.03.2022, është miratuar ofrimi i shërbimit të parkimit me pagesë orare, në 8 rrugë dhe 3 sheshe, si dhe struktura përkatëse për administrimin e parkimit është Sektori i Tregjeve Fruta-Perime dhe Menaxhimit të Parkimit në Bashkinë Elbasan. Vjelja e tarifës së parkimit do të realizohet nga agjentët tatimorë dhe do të mbikëqyret nga sektori i lartpërmendur, me miratimin e një marrëveshje model tip për angazhimin e subjekteve në cilësinë e agjentit tatimor. Tarifa e parkimit në Bashkinë Elbasan është 50 lekë për një orë parkimi me bileta parkimi, të cilat shpërndahen tek agjentët sipas kontratave të lidhura, si dhe specialistëve të Bashkisë me proces verbale nga Sektori i Buxhetit dhe Financës në Bashkinë Elbasan.

**Titulli i gjetjes:** Planifikim jo i saktë i taksës së parkimit.

**Situata:** Kontratat e lidhura për vitin 2022 për vjeljen e tarifës orare të parkimit me Bashkinë Elbasan dhe Agjentët tatimorë janë protokolluar me të njëjtin numër dhe të njëjtën datë përkatësisht nr. 17/3 prot., datë 17.03.2022, për vitin 2022.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Sektori i Tregjeve Fruta-Perime dhe Menaxhimit të Parkimit janë 43,980 bileta të shpërndara në total për vitin 2022 në vlerën 2,199,000 lekë, janë kthyer 49 bileta parkimi me proces verbalin e mbajtur në datë 17.03.2022 nga Agjenti Sh. K. dhe 49 bileta parkimi me proces verbalin e mbajtur në datë 24.03.2022 nga Agjenti Xh. B.. Nga shqyrtimi i dokumentacionit vihet re se biletat e parkimit të shpërndara nuk janë sipas numrit serial me kronologji, për arsye të kthimeve dhe mos rakordimit midis dy sektorëve të bashkisë, përkatësisht Sektori i Tregjeve Fruta-Perime dhe Menaxhimit të Parkimit dhe Sektori i Buxhetit dhe Financës.

Ndërsa nga parkimi i rezervuar për bizneset për vitin 2022, janë arkëtuar 9,793,500 lekë për 187 biznese.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur me taksën e parkimit rezulton se Bashkia Elbasan nuk ka të miratuar me VKB sipërfaqe për parkimin e mjeteve me pagesë. Gjithashtu, nuk është e qartë si bëhet llogaritja e kësaj takse nga Sektori i Tregjeve Fruta-Perime dhe Menaxhimit të Parkimit kur nuk janë miratuar m<sup>2</sup> që janë të disponueshme për parkim.

**Kriteret:** Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 32. VKB nr. 60, datë 18.06.2020, “Për miratimin e kriterëve dhe përcaktimin e rrugëve dhe shesheve publike për administrimin e shërbimit të parkimit me pagesë të Bashkisë Elbasan” ndryshuar me VKB nr. 86, datë 31.08.2021 dhe VKB nr. 23, datë 04.03.2022.

**Ndikimi/Efekti:** Mos planifikim i saktë i të ardhurave nga taksa e parkimit, rezulton në mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Elbasan.

**Shkaku:** Mungesa e një Vendimi të KB për përcaktimin e sipërfaqes së disponueshme për parkimin e automjeteve me pagesë.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:**

Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me strukturat e tjera në Bashkinë Elbasan të identifikojnë sipërfaqen që është në dispozicion për parkim me pagesë dhe të nxjerrin aktet e nevojshme për miratimin e kësaj sipërfaqe si të disponueshme për parkim. Sipërfaqe kjo që duhet të jetë baza për llogaritjen e taksës së parkimit, si dhe rakordimin e vlerës së biletave të parkimit të shpërndara, duke i shpërndare dhe ndjekur sipas numrit serial kronologjik, duke pasqyruar me rigorozitet kthimet dhe procedurat e rakordimit midis dy sektorëve të Bashkisë, përkatësisht Sektori i Tregjeve Fruta-Perime dhe Menaxhimit të Parkimit dhe Sektori i Buxhetit dhe Financës.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. Z. G.LL, me detyrë Kryetar i Bashkisë Elbasan;
2. Z. Q.T, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës;
3. Z. F.D, agjent parkimi, përgjegjës për tërheqjen dhe dorëzimin nga arka për biletat e parkimit.

**3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike- Asetet.**

**3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.**

***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare:***

Për vitin 2022 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Elbasan” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Thesari dhe nuk ka patur kontestime.

***Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.***

-Për vitin 2022 janë hartuar pasqyrat financiare për njësinë shpenzuese Bashkia Elbasan dhe 12 njësite administrative, perkatesisht: Funar, Labinot-Fushe, Labinot Mal, Gjergjan, Bradashesh, Tregan, Paper, Gracen, Gjinar, Shirgjan, Zavaline, Shushice dhe Reparti Zjarrfikses. Nuk ka pasqyra financiare të konsoliduara.

- Ndersa 7 njësite të tjera shpenzuese në varësi të Bashkisë kanë bilanc në vete, përkatësisht: Axhensia Shërbimeve Publike, Qendra Ekonomike Arsimit, Qendra Artit, Qendra Trashëgimisë Kulturore, Klubi Shumsporte, Qendra Balashe dhe Njësia Banesave Sociale.

***Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare.***

Është zbatuar afati ligjor për mbylljen dhe dorëzimin e bilancit 2022 të Bashkisë Elbasan. Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Elbasan për vitin ushtrimor 2022 me shkresën përcjellëse nr. 2347 datë 31.03.2023 konfirmuar nga dega e thesarit me datë 31.03.2023.



Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është zv/Kryetari e Bashkisë Elbasan A.B dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori i Financës e Buxhetit A.M.

**Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.** Për vitin 2022, nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (*dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj*) për shumat për çdo llogari në total, mujore dhe vjetore rezultoi se nuk ka diferenca.

Ditari i bankës është mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (*çeljet*) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

**Rakordimi i llogarive aktiv pasiv me pasqyrat financiare (anekset) ose formatet përkatëse.**

\* Rezultati i veprimtarisë ushtrimore 2022 për vlerën 322,206,955 lekë evidentuar në *“pasqyrën e pozicionit financiar”* referenca e llogarisë 85 (formati 1) rakordon me Teprica ose deficitin e periudhës në *“pasqyrën e performances financiare”* (formati 2).

\* Teprica e *“likuiditeteve në fund të vitit ushtrimore 2022”* për vlerën 518,058,184 lekë evidentuar në *“pasqyrën e flukseve monetare”* (formati 3) rakordon me *“mjetet monetare dhe ekuivalent tyre”* pozicionit financiar referenca e llogarisë 85 (formati 1) rakordon me *“pasqyrën e performances financiare”* (formati 2).

\* Fondi i konsoliduar 3,956,627,523 lekë i evidentuar tek formati 1 *“pasqyra e pozicionit financiar”* pika (D) rakordon me vlerën gjithsej të fondeve tek *“pasqyra e ndryshimeve të fondeve”* 2022 (formati 4).

\* Huamarrja (kredia) për vlerën 133,871,985 lekë me date 31.12.2022 evidentuar tek formati 6 *“Investimet dhe Burimet e Financimit”* rakordon me formatin 1 *“pasqyra e pozicionit financiar”* (B) dhe paraqet ulje të vlerë saj si rezultat i shlyerjes saj gjatë vitit 2022 prej 67 milion lekë nga 200 milion lekë me 31.12.2021.

\* Fondi i pagave i pasqyruar në formatin 2, pika B *“shpenzimet”*, llogaria 600 paraqitet për vlerën 348 milion lekë, e cila rakordon me formatin 8 *“numri punonjësve e fondi i pagave”*.

\* Aktivët afatgjatë materiale dhe jo materiale për 2,963,298,089 lekë në formatin 1 *“pasqyra pozicionit financiar”* kuadron me formatin 7/b *“Gjendja ndryshimeve aktiveve afatgjatë”*.

**Mënyra e mbajtjes kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.**

Regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore. Kështu u kryen testimet në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara për vlefshmërinë për t'u pranuar në kontabilitet (*vlerësimi kontabël*); Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve të kryera dhe e mbartësve të tyre; Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor. Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet: - shqyrtimit vlefshmërisë regjistrimit fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë ; - kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur; - verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (*barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive*) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

**Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë.**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se: Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues. Kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel”. Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin. Azhurnimet e veprimeve ekonomike në partitarët analitik janë kryer në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë

kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, pagave, të ndryshme etj. Është mbajtur libri i madh apo centralizator duke kaluar veprimet e llogarive nga ditarët përkatës në center, duke nxjerre saldot debitorë dhe kreditore të kuadruara, mbi bazën e të cilave është hartuar bilanci kontabël 2022. Kalimet e llogarive nga ditarët në center dhe në bilanc janë pa gabime dhe të kuadruara debia me kredinë. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese. Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet. Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues në përgjithësi është bërë i plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkaktuesin e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu:

Dokumentet vërtetues si urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj. Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (*ose në bazë të drejtave të konstatuara*), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

### **3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2022 deri më datën 31.12.2022. Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës. Janë mbartur saktë tepricat e llogarive 2021 në çeljen vitit pasardhës për bilancin vitin 2022 dhe rakordojnë. Nga verifikimi i gjendjes së llogarive bilancit të vitit ushtrimor 2022 rezulton se llogaritë Aktivitet dhe Pasivitet kuadrojnë me formatet anekse pjese e Pasqyrave Financiare.

**Nga verifikimi i disa llogarive të aktivitetit të bilancit 2022, rezultoi se:**

1. llogaria 212 “*ndërtesa e konstruksione*” gjendja kontabël në aktiv është 658,874,826 lekë dhe kuadron me pasqyrimin e kësaj llogarie tek aneksi i PF formati 7/b.
2. llogaria 213 “*rruge, rrjete, vepra ujore*” gjendja kontabël në aktiv është 1,762,951,078 lekë, kuadron me pasqyrimin e kësaj llogarie tek aneksi i PF formati 7/b.
3. llogaria 215 “*mjete transporti*” gjendja kontabël në aktiv është 8,042,807 lekë, kuadron me aneksin e PF formati 7/b, e cila pasqyron shtesat dhe pakesimet. Po kështu gjendja kontabël rakordon me inventarin kontabël të automjeteve dhe mjeteve zjarrfikëse.
4. llogaria 215 “*mjete transporti*” gjendja kontabël në aktiv është 8,042,807 lekë, kuadron me aneksin e PF formati 7/b, e cila pasqyron shtesat dhe pakesimet.
5. llogaria 210 “*toka, troje, terrene*” gjendja kontabël në aktiv është 455,533,190 lekë dhe është zbërthyer në mënyrë analitike dhe kuadron me pasqyrimin e kësaj llogarie formati 7/a.

Llogaria 210 paraqet shtesa për 2022 në vlerën 4,282,027 lekë.

6. llogaria 231 “*investime*” gjendja kontabël në aktiv është 265,467,504 lekë dhe është zbërthyer në mënyrë analitike me kuadrature të rregullt.

Llogaria 231 “*investime*” në aktivin e bilancit formati nr. 1 kuadron me formatin nr. 6 “*investimet dhe burimet e financimit*”. Vlera e shpenzimeve për investime “*aktive afatgjata materiale*” për 265,467,504 lekë mbulohet nga **Burimet e financimeve** si:

\*grandet e brendshme kapitale për 20,369,635 lekë,

\*grandet kapitale për investime për të tretë 199,730,693 lekë,

\* fonde te tjera te vetat 45,367,176 lekë,

(Gjithashtu burim ka gene dhe rezultati i mbartur prej 38,768,644 lekë si dhe hua marrja për 133,871,985 lekë, për aktive afatgjata financiare).

**7. llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”**, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 908,046,023 lekë.

Gjate vitit 2022 kjo llogari debitorësh është rritur dhe në mbyllje të 2022 pasqyrohet për vlerën 1,056,298,715 lekë. Tek pasivi llogari të pagueshme, llogaria “kreditor të ndryshëm” pasqyrohet për vlerën **1,064,539,415 lekë**. Nga financa e Bashkisë llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” është zbërthyer në mënyre analitike sipas subjekteve, llojit, personave debitorë:

**Pasqyra e debitorëve e llog: 468, sipas llojit dhe rasteve për vitin 2022.**

NR.	EMERTIMI Llog: 467	Debitor deri 31.12.2022
1.	Vërtetime, pulla parkimi, bileta tregu dhe veterinare dhe gjoha policie trashëguara	9,400,300
2.	Qira objektsh debitor për 12 subjekte fizike dhe juridike sipas pasqyrës ngjitur	1,028,436
3.	Debitor nga KLSH për 44 subjekte fizike dhe juridike sipas pasqyrës ngjitur	24,759,020
4.	Subjekte debitor Bashkia	699,078,139
5.	Subjekte debitor Njesite Administrative	295,754,386
6.	Subjekte debitor ish-komuna Bradashesh	33,449,883
7.	Debitor nga SHMZSH	1,069,250
	<b>TOTALI</b>	<b>1,064,539,414</b>

**Sa sipër**, u bë verifikimi i hollësishëm i kësaj llogarie debitorësh, pasi paraqet problem mos-arkëtimi i tyre me një vlere të larte 1,064,539,414 lekë, përkatësisht:

**a. vlere 9,400,300 lekë** përfaqëson **letra me vlere të pa shitura gjendje arke në fund vitit 2022** si: pulla gjendjes civile, bileta tregu, tarifa veterinare, pulla parkimi dhe vërtetime tjera, për të cilat ka procesverbale rakordimi për gjendjen fizike tyre me gjendjen kontabël.

Problem paraqet numri dhe vlere e madhe e pullave dhe biletave në fund të vitit në duart e agjenteve terrenit, në vend që ato të tërhiqeshin në masën e duhur për përdorimin e tyre në procesin e mbledhjes tarifave përkatëse, duke rezultuar pa gjendje në fund të vitit.

Mbikëqyrja nga auditi i Bashkisë ka munguar, ndaj agjenteve terrenit, për efekt të administrimit letrave me vlere, pasi nuk disponohen dokumente për këtë qellim.

**b. vlere 1,028,436 lekë** përfaqëson **detyrimet kontraktore të pashlyera nga 6 subjekte qiramarrëse**, të cilët kanë marre me qira ambiente dhe objekte të Bashkisë. Bashkia Elbasan nuk ka marre masa për arkëtimin e qirave në vlerën 1,028,436 lekë, në mos zbatim të kushteve kontratave dhe ka përdorur **2 standarde për vjeljen qirave**, pasi:

- **ka likuiduar periodikisht qiratë për mjetet e marra** në përdorim për nevojat e saj, sipas kushteve të kontratave, konkretisht: për 2 automjetet Wolzswagen dhe Fadroma.

- **nuk ka vjelur qiratë për vlerën 1,028,436 lekë për objektet e dhëna** në përdorim nga ana e saj si dhe **nuk ka ndjekur të gjitha hapat ligjore deri në prishjen e kontratave**, për arkëtimin e qirave të pashlyera, duke shkelur kështu kushtet e kontratave dhe mos respektimin e afateve ligjore, konkretisht: **6 objekte dhëne me qira subjekteve qiramarrëse**, përkatësisht: subjektet C shpk 87,750 lekë, I, F.B 98,700 lekë, V.I shpk 41,426 lekë, Ujësjellësi fshat 666,648 lekë, E.D 133,920 lekë. Veprime në kundërshtim me kushtet e kontratave respektive, me VKM nr. 693 datë 05.10.2016 “Për përcaktimin kritereve, të procedurës dhe mënyrës dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata tjera pasurisë shtetërore”, me ligjin 10296 datë 08.07.2010, me UMF 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njesitë sektorit publik”, me ligjin 7850 date 29.07.1994 “Kodi Civil RSH”, çka bën përgjegjës drejtoreshën aseteve A.S, përgjegjës in aseteve G.P, specialistet I.M , A.P, A.B, drejtori juridik A.H.

**c. vlere 24,759,020 lekë** përfaqëson **debitorët e lënë nga KLSH ndaj 42 subjekteve** fizike dhe juridike, të cilët nuk kanë shlyer detyrimet ( 2009 deri 2022). Bashkia Elbasan **nuk ka bere ndalesa dhe nuk ka ndjekur të gjitha hapat ligjore**, për arkëtimin e vlerës 24,759,020 lekë lënë nga KLSH, **detyrime të pranuar dhe kontabilizuara** nga Bashkia, madje **në disa raste ka pasur mundësi arkëtimi**, pasi **disa punonjës janë në marrëdhënie pune me Bashkinë**, disa

**subjekte juridike kane marrëdhënie kontraktore me Bashkinë**, e cila ka kryer likuidime ndaj tyre për vitin 2022, konkretisht:

\* **anëtareve këshillit Bashkiak** debitor për vlerën **2,657,507 lekë** nuk u janë bere ndalesa ne shpërblimet mujore tyre të vitit 2022, sipas urdhër shpenzimeve përkatëse.

\* **punonjësi V.B përgjegjës i sektorit gjelbërimit** pranë ASHP debitor për vlerën **63,755 lekë** nuk i janë bere ndalesa ne borderotë e vitit 2022.

\* **subjekti “B.N”** shpk debitor **2,508,627 lekë** (131,800 +100,532 +748,020 +1,528,275), nuk i janë bere ndalesa, ndërsa i janë kryer likuidime për vlerën 3,932,182 lekë, sipas urdhër shpenzimit 425 datë 10.06.2022 etj.

\* **subjektit “E”** shpk debitor **554,020 lekë**, nuk i janë bere ndalesa, ndërsa i janë likuiduar 3,229,113 lekë sipas urdhër shpenzimit nr. 843 date 14.09.2022 dhe 44,694,828 lekë sipas urdhër shpenzimit nr. 1242 date 27.12.2022 etj.

\* **subjektit “E”** shpk debitor **658,590 lekë**, nuk i janë bere ndalesa.

Veprime në kundërshtim me UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitë sektorit publik”, pika 93, me ligjin 139/ 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21 dhe 33 dhe me ligjin 44/2015 datë 30.04.2015 “K P A në RSH” nenet 98 dhe 102.

Ngarkohen me përgjegjësi drejtoresha e financë-buxhetit ne cilësinë e Nëpunësit Zbatues zj. A.M, zv/kryetarja e Bashkisë dhe ne cilësinë e Nëpunësit Autorizues zj. A.B si dhe kryetari Bashkisë z. G.LL.

**d. debitorët tjerë te ish-komunave, te njërive administrative dhe te Bashkisë te mbartur** nga e kaluara, rezultojnë se zënë një peshe me vlere te larte. Këto 3 zëra debitorësh janë te zbërthyer ne emra dhe subjekte konkrete me kuadrature te rregullt, ku problem mbetet ndjekja dhe arkëtimi i tyre trajtuar tek pika e programit debitorët e taksave vendore.

**Titulli gjetjes:** Mos arkëtimi i vlerës 1,064,539,415 te llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

**Situata:** Në bilancin e vitit 2022 paraqet aktiv-pasivin në total të rakorduar për vlerën 5,272,532,072 lekë, por nuk rakordon në aktiv llogaria analitike 468 “Debitor ndryshëm” për 1,056,298,715 lekë me llogarinë analitike në pasiv 467 “Debitorë ndryshëm” për 1,064,539,415 lekë (kjo e fundit është e zbërthyer dhe e kuadruar).

- Bashkia nuk ka ndjekur të gjitha hapat ligjor për arkëtimin e debitorëve, madje ka pasur mundësi arkëtimi për disa punonjës dhe subjekte juridike, me të cilët ka marrëdhënie pune dhe kontraktore, konkretisht:

**a.** vlere 1,028,436 lekë, detyrimet kontraktore të pashlyera nga 6 subjekte qiramarrëse, të cilët kane marre me qira ambiente dhe objekte të Bashkisë, ndërsa Bashkia nuk ka marre masa për arkëtimin e qirave deri në zgjidhjen e kontratave, për moszbatimin e kushteve të kontratave. Bashkia ka përdorur 2 standarde për vjeljen e qirave, pasi ka likuiduar qiratë e 2 mjeteve Wolzagen e Fadroma te marra ne përdorim, ndërsa nuk ka arkëtuar vlerën 1,028,436 lekë për objektet e dhëna me qira, përkatësisht: subjektet C. ShPK 87,750 lekë, I.B 98,700 lekë, V.I ShPK 41,426 lekë, Ujësjiellësi fshat 666,648 lekë dhe E.D 133,920 lekë.

**b.** vlere 24,759,020 lekë, debitorë lëne nga KLSH ndaj 42 subjekteve fizike dhe juridike, detyrime të pranuar dhe kontabilizuara nga bashkia, madje disa punonjës dhe subjekte kanë marrëdhënie pune dhe kontraktuale me bashkinë për vitin 2022 dhe ndaj tyre bashkia nuk ka bere ndalesa, konkretisht:

-V.B, përgjegjës i sektorit gjelbërimit ASHP debitor për vlerën 63,755 lekë,

- anëtarët e këshillit Bashkiak debitor për vlerën 2,657,507 lekë,

-subjekti “B.N” ShPK debitor për 2,508,627 lekë, ndërsa është likuiduar pa i bere ndalesa, sipas urdhër shpenzimit 425 datë 10.06.2022 etj.

- subjekti “E ” ShPK debitor 554,020 lekë, ndërsa është likuiduar pa i bere ndalesa, sipas urdhër shpenzimit nr. 843 datë 14.09.2022 dhe nr. 1242 datë 27.12.2022 etj.

-subjektit “E” ShPK debitor 658,590 lekë, nuk i janë bërë ndalesa,

c. vlera 1,038,751,959 lekë, debitorët prapambetur ish-komunave, njësjive e bashkisë.

Veprime në kundërshtim me kushtet e kontratave respektive, me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitë sektorit publik” pika 93, me ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil RSH”, me ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “KPA në RSH” nenet 98 dhe 102, me ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21 dhe 33 si dhe Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

**Kriteri:** VKM nr. 693 datë 05.10.2016 “Për përcaktimin kriterëve, të procedurës dhe mënyrës dhënies qira, enfitozë kontrata tjera pasurisë shtetërore”, ligji 10296 datë 08.07.2010, UMF 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitë publik”, pika 93, ligji 7850 date 29.07.1994 “KC RSH”, ligji 139/ 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21 e 33, ligji 44/2015 datë 30.04.2015 “KPA RSH” nenet 98 dhe 102.

**Ndikimi:** Mos funksionimi i kësaj llogarie sipas parimeve kontabël pranuar, përbën risk në saktësinë e aktiveve bilancit me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare lidhur me të drejtat të arkëtueshme nga të tretët, duke paraqitur shmangie dhe mbartje të debitorëve nga viti në vit dhe mungese të ardhurash nga mosvjelja e debitorëve.

**Shkaku:** Mos zbatimi i legjislacionit dhe VKM në fushën e llogarive debitorë.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Drejtoria Ekonomike dhe Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Elbasan të marrë masa për:

a. Sistemimin, kuadrimin e llogarisë aktive 468 “Debitorë ndryshëm” për vlerën 1,056,298,715 lekë me llogarinë pasive 467 “Debitorë ndryshëm” 1,064,539,415 lekë.

b. Zbatimin e të gjitha hapave ligjore për arkëtimin e vlerës 1,064,539,415 lekë, llogaria 467.

c. Arkëtimin e vlerës 6,442,499 lekë, për personat dhe subjektet debitorë të punësuar dhe me marrëdhënie kontraktore me Bashkinë Elbasan, konkretisht:

- anëtareve këshillit Bashkiak debitor për 2,657,507 lekë, sipas listës përkatëse.

- V.B debitor për vlerën 63,755 lekë,

-subjekti “B.N” ShPK debitor për vlerën 2,508,627 lekë,

- subjekti “E” ShPK debitor për vlerën 554,020 lekë,

-subjekti “E” ShPK debitor për vlerën 658,590 lekë,

d. Arkëtimin e vlerës 1,028,436 lekë, detyrimet kontraktore pashlyera nga 6 subjekte qiramarrëse, konkretisht: shoqëria “C” ShPK 87,750 lekë, z. I.F.B 98,700 lekë, shoqëria “V.I” 41,426 lekë, Ujësjetllësi fshat 666,648 lekë dhe z. E.D 133,920 lekë.

### **TE ARDHURAT DHE SHPENZIMET 2022.**

Te ardhurat dhe shpenzimet janë pasqyruar sakte tek pasqyra shpjeguese për raportimin e Pasqyrave Financiare vjetore 2022, formati 2, përkatësisht:

a. **Ardhurat** total pasqyrohen 4,105 milion lekë dhe kuadrojnë me ardhurat sipas grupeve:

\* Te ardhura nga taksat dhe tatimet për 567 milion lekë,

\* Te ardhura jo tatimore për 220 milion lekë,

\* grante korente për 3,284 milion lekë,

\* Te ardhura tjera për 34 milion lekë,

b. **Shpenzimet** total prej 3,783 milion lekë kuadrojnë me shpenzimet sipas grupeve:

\* paga dhe përfitime punonjësve për 348 milion lekë,

\* kontribute të sigurimeve për 58 milion lekë,

\* blerje mallra e shërbime për 230 milion lekë,

\* transferime korente për 3,139 milion lekë,

\* shpenzime financiare për 8 milion lekë,

\* ndryshim i gjendjes inventarit për - 0,052 milion lekë (-52,225),

c. **Teprica dhe deficit** i periudhës 322 milion lekë (4,105 milion lekë - 3,783 milion lekë).

### Pasqyra e lëvizjes numrit punonjësve dhe fondit pagave.

Pasqyra e lëvizjes fondit pagave formati 8 rakordon me pasqyrën e shpenzimeve për paga dhe kontribute sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2022, tabela sa vijon:

*Në lekë*

KATEGORTE	Nr. pun	Te rinj	Larguar	Gjend.Fund	Fondi pagave gjithës	Kontrib. sig.shoq. shend	Tatim mbi ardhurat
b	1	2	3	4	5	8	10
<b>Nr. pun. gjithsejt</b>	<b>460</b>	<b>32</b>	<b>11</b>	<b>481</b>	<b>348,135,801</b>	<b>104,096,724</b>	<b>17,394,991</b>
(1+2+3+4+5)							
<b>Drejtues</b>	98	11	2	107	103,595,392	30,903,114.37	9,195,250
<b>Specialiste larte</b>	275	17	3	289	199,665,405	57,706,648	6,545,754
<b>Teknike</b>	83	1	1	83	42,549,815	13,871,398.39	1,653,987
<b>Punëtore</b>	4	3	5	2	2,325,189	1,615,563.252	
<b>Punonjës perkoh</b>	0	0	0	0	0		

### 3.3. Rregullshmëria e veprimeve te kryere nëpërmjet bankës dhe arkës.

#### Arka 2022

Veprime e arkës për vitin 2022 kane përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin” ndryshuar me ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”. Është respektuar limiti i arkës për vitin 2022, pasi arka paraqitet me të holla brenda limitit saj dhe derdhen në bankë periodikisht, sipas kërkesave pikës 3 të VKM-së nr. 290, datë 14.6.1993 “Për limitin e arkës”. Në çdo rast hyrje dhe dalje te letrave me vlere janë mbajtur dhe prerë mandatpagesat dhe mandat arkëtimet përkatëse. Mandatpagesat janë prerë numrit kronologjik dhe nuk kanë mangësi në plotësimin e tyre. Mandatpagesat janë kontabilizuar periodikisht në ditarin e arkës dhe shoqërohen me dokumentet bazë dhe justifikuese. Mandatpagesat janë prerë dhe nënshkruar nga financierja qe mbulon arkën Z. B. dhe drejtoresha financës dhe ne çdo rast me urdhër titullarit.

Janë bere azhurnimet përkatëse ne mënyre analitike, sipas llojit te letrave me vlere. Për hyrjet e daljet nëpërmjet veprimeve me arkën te te hollave dhe letrave me vlere si: pulla gjendjes civile, bileta tregu, tarifa veterinare, pulla parkimi dhe vërtetime tjera, rezulton se janë kryer rakordimet për gjendjen kontabël me gjendjen fizike te arkës me 31.12.2022, llogaria 532 “vlere tjera” për shumën 10,564,600 lekë, ne mënyre analitike e zbërthyer ne këto zëra: vërtetime 740,000 lekë, pulla gjendja civile 1,638,000 lekë, bileta tregu 620,000 lekë, tarifë veterinare 3,506,600 lekë dhe pulla parkimi mbartura 3,570,000 lekë, pulla parkimi 2022 per 490,000 lekë. Totali i llogarisë 532 “vlere tjera” paraqitet për vlerën 10,564,600 lekë, e cila pasqyrohet sakte tek akti i bilancit 2022, formati nr. 1, zëri “mjete monetare” dhe ka rakordim midis gjendjes kontabël me gjendjen fizike. Në fund të çdo muaji dhe ne fund te vitit 2022 libri i arkës mbyllet për gjendjen fizike të të hollave dhe letrave me vlere sipas llojit tyre, bashkëngjitur rakordimet përkatëse date 30.12.2022. Te hollat e krijuara ne arke, përbehen nga: arkëtimi i pullave, biletave tregut, bileta parkimit, bileta tarifës veterinare, pulla gjendja civile, vërtetimet për administratorët e rajoneve tjera.

#### BANKA 2022.

Auditimi mbi veprimet e bankës kryhet për vitin 2022, ku rezultoi:

Auditimi u krye me metodën hap pas hapi, me teknikën e auditimit të shqyrtimit të dokumentacionit justifikues të veprimtarisë së këtij sistemi për të vlerësuar që kontrollët e brendshme nëse kanë qenë efektive. Ne fakt auditimi i brendshëm nuk kane qene efektiv, pasi nuk ka prekur problemet, shkeljet me efekte financiare për te njëjtën periudhe 2022 te trajtuara me poshtë nga KLSH, çka e bën atë jo funksional dhe pa force godiste ndaj risqeve dhe anomalive te konstatuara, sipas raporteve tij. Për periudhën e audituar veprimet e kryera nëpërmjet bankës janë të dokumentuara me urdhërpagesat përkatëse, të nënshkruara nga nëpunësi zbatues dhe janë

konfirmuar nga dega e thesarit të rrethit. Urdhër shpenzimet mbajnë numra rendor progresiv dhe veprimet ekonomike janë hedhur rregullisht në ditarin e bankës dhe ditarin e shpenzimeve sipas nën zërave përkatës. Vlera e urdhër shpenzimeve të likuiduara përputhet me vlerën e detyrimit për shërbimet dhe mallrat e kontraktuara. Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si: urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklaratimet e tatimit mbi ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve. Llogaritë janë në pozicionin e duhur në përputhje me kërkesat ligjore, sipas kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin” ndryshuar me ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë Qeverisjes Përgjithshme”, i ndryshuar dhe me Udhëzimet Ministrisë Financave. Nga auditimi i veprimeve me bankën për vitin 2022, **u konstatuan disa mangësi dhe shkelje ligjore me efekte financiare**, konkretisht:

**Shpenzime për pastrimin e qytetit.**

**1.** Për pastrim e qytetit Elbasanit 2022 Bashkia ka lidhur kontratën nr. 1186/17 date 14.12.2021 për vlerën 74,755,140 lekë me TVH me subjektin “A” shpk me administrator A.B, me afat kohor 383 dite ose për periudhën 14.12.2021 deri 31.12.2022. Kjo kontrate përmban 25 mije ton mbetje urbane, përkatësisht: 21,831 ton mbetje nga kontejnerët + 3,064 ton mbetje nga shtëpitë + 459 ton mbetje voluminoze. Firma e pastrimit mbetjet urbane i dërgon pranë vendit të depozitimit i quajtur Landfilli i ri Elbasan, administruar nga shoqëria koncesionare “A.E” me administrator A.A, për menaxhimin (*trajtimin, përpunimin, djegien me imjantit incenerimit*) të mbetjeve. Për vitin 2022 bazuar në kontratën 1186/17 date 14.12. 2021 dhe anekseve saj është likuiduar periodikisht subjekti “A”, sipas urdhër shpenzimeve përkatëse, faturave, situacioneve etj, të shoqëruara me dokumentacionin teknik: si procesverbalet mujore supervizoreve, grafiket sipas datave, vendeve dhe zonave, evidenca e peshimit mbetjeve se bashku me flete peshimet ditore për mbetjet urbane. **Nga auditimi i dokumentacionit pastrimit për mbetjet urbane, për 2022**, u konstatua se:

**a.** Në situacionet e pastrimit të vitit 2022 sipas urdhër shpenzimeve përkatëse, rezultojnë **2 zëra pune të paguara në mënyrë pajustificuar** dhe pa mbështetje ligjore për vlerën 2,221,400 lekë për “A” shpk, konkretisht:

\* zëri “*transport dhe largim i mbetjeve urbane direkt nga shtëpitë e qytetareve për çdo ditë*” për vlerën **1,899,680 lekë mosefektivitet** për 3,064 ton mbetje (*për 4032 familje baras me 16,128 banor*), pasi është detyrë e qytetareve dhe fakt është se nuk aplikohet në bashkitë tjera.

\* zëri “*transport i mbetjeve voluminoze, parku Rinia*” për vlerën **321,720 leke dem ekonomik** për 459 ton, përfitohet padrejtësisht nga subjekti i pastrimit “A, në kundërshtim me ligjin nr. 10463 date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane” dhe me VKM nr. 319 date 31.05.2018 “Për miratimin masave për koston menaxhimit integruar mbetjeve urbane”, me shtojcën nr. 1, ku thuhet:

***Shtojca nr 1. Udhëzues për llogaritjen e koston të menaxhimit mbetjeve, miratuar me VKM 319/2018, ku citohet: Mbetjet të gjeneruara u referohen vetëm mbetjet shtëpiake, duke mos përfshirë mbetjet e rrezikshme, bujqësore, inerte dhe mbetjet voluminoze.....***

***Mbetjet që prodhohen nga ekonomitë familjare, por që nuk përfshihen mbetjet ...voluminoze... transportohen nga vete prodhuesit e tyre në fushat përkatëse të depozitimit të përcaktuara nga bashkia, në rast të kundërt përben shkelje dhe është objekt ndëshkimi nga institucionet kompetente tjera.***

**b.** **Supervizoret** e bashkisë që mbikëqyrin pastrimin e qytetit S.B, I.Sh dhe B.L paraqesin **mangësi** në mbajtjen e dokumentacionit për verifikimet e pastrimit në terren, konkretisht:

- Në procesverbalet ditore **nuk pasqyrohen vërejtjet për cilësinë e shërbimeve** sipas zërave pastrimit, por është mjaftuar në gjitha rastet për vitin 2022, ku citohet i njëjti model:

janë kryer sipas kërkesave të kontratës dhe aneksit saj.

- **Kane munguar penalitetet** për punë të pakryera të konstatuara nga vete supervizoret.  
- Për punimet e pakryera zbritjet kanë qenë në vlera papërfillshme deri 3000 leke/muaj (sipërfaqe totale 8,013,824 m<sup>2</sup> fshirje plote dhe 16,520,700 m<sup>2</sup> sip. pjesëshme).

- Supervizoret për vitin 2022 **nuk kanë zbritur sipërfaqet e zënë nga rikonstruksionet** rrugëve, shesheve, trotuareve qytetit kryer në vitin 2022, për rrjedhojë vlera **568,428 leke** pagesa për **punë pakryer** për “A” shpk konkretisht:

\* Nuk është zbritur sipërfaqja rruge 5100 m<sup>2</sup> “shtresa cakulli e stabilizant” dhe sipërfaqja trotuar 950 m<sup>2</sup> “vendosje pllaka” në objektin “sistemim asfaltim rrugëve Xh.D, G.N dhe H.K, në lagjen 5 Maj” nga B.N shpk), sipas urdhër shpenzimit nr. 727 date 16.08.2022 dhe situacionit nr. 1 viti 2022 si dhe kontratës 1288/6 date 10.06.2022 me afat 12 muaj. Llogaritja e efekteve: 225,060 leke zëri “fshirje rruge dhe trotuare” ( 5100+950=6050 m<sup>2</sup> x 0,10 leke/m<sup>2</sup> x 31 dite x 12 muaj=225,060 leke).

\* Nuk është zbritur sipërfaqja rruge 3500 m<sup>2</sup> “shtresa cakulli e stabilizant” në objektin “.....ndërtim i sheshit parkimit të varrezave publike, nga I shpk), sipas urdhër shpenzimit nr. 795 date 07.09.2022 dhe nr. 1261 date 29.12.2022, situacionit nr. 1, viti 2022 si dhe kontratës 5457/6 date 07.03.2022 me afat 5 muaj. Llogaritja e efekteve: 54,250 leke zëri “fshirje rruge” (3500 m<sup>2</sup> x 0,10 leke/m<sup>2</sup> x 31 dite x 5 muaj=54,250 leke).

\* Nuk është zbritur sipërfaqja rruge 4,021 m<sup>2</sup> “shtresa cakulli e stabilizant” në objektin “asfaltim rrugëve Sh.A dhe shesheve pallateve 580/16, 580/16, 580/17, 580/19, 580/30 në lagjen 11 Nëntori, nga E shpk), sipas urdhër shpenzimit nr. 855 date 19.09.2022 dhe situacionit nr. 2. Llogaritja e efekteve: 149,581 leke zëri “fshirje rruge” (4021 m<sup>2</sup> x 0,10 leke/m<sup>2</sup> x 31 dite x 12 muaj=149,581 leke).

\* Nuk është zbritur sipërfaqja sheshe 3,401 m<sup>2</sup> shtresa “rërë dhe pllaka betoni” dhe sipërfaqen trotuar 350 m<sup>2</sup> vendosje “shtresa rërë” në objektin “rikonstruksion i shesheve të pallateve 650, 651,652, 653 në lagjen Partizani, ), sipas urdhër shpenzimit nr. 862 date 21.09.2022 (6,000,000 leke) dhe situacionit 1, kontratës 5237/8 date 24.01.2022. Llogaritja e efekteve: 139,537 leke zëri “fshirje rruge e trotuare” (3401+350=3751 m<sup>2</sup> x 0,10 leke/m<sup>2</sup> x 31 dite x 12 muaj=139,537 ).

Veprime në kundërshtim me kontratën nr. 1186/17 date 14.12. 2021, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik dhe me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”,

Ngarkohen me përgjegjësi zv/kryetaret e bashkisë dhe në cilësinë e AK, I.S dhe A.B, S. M DPSHI, T.S DPSHU, S.B, I.Sh, B.L supervizore.

(Praktika dokumentare pagesës pastrimit i përket urdhër shpenzimeve të vitit 2022, konkretisht USH nr. 88 date 18.02.2022, konkretisht: faturat elektronike subjektit, situacionet , kontrata dhe anekset, aktmarrëveshja me sipërmarrësin 1186/15 date 14.12.2021, njoftimi i fituesit 1186/14 date 13.12.2021, struktura e zërave shërbimit e shprehur në ton mbeturina etj.).

**Titulli gjetjes:** Mangësi dhe shkelje në dokumentacionin e pastrimit mbetjeve urbane 2022.

**Situata:** Nga auditimi rezultoi se për vitin 2022 Bashkia Elbasan ka lidhur kontratë pastrimit e qytetit me subjektin “A” ShPK, për të cilën rezultuan mangësi dhe shkelje, sa vijon:

a. Në 1 rast, Bashkia ka likuiduar padrejtësisht vlerën 321,720 lekë dem ekonomik për subjektin “A” ShPK, konkretisht zëri “transport mbetjeve voluminoze” për 459 ton, përfituar nga subjekti i pastrimit, në kundërshtim me ligjin nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin integruar mbetjeve urbane” dhe me VKM nr. 319 datë 31.05.2018 “Për miratimin masave për koston menaxhimit integruar mbetjeve urbane” si dhe me shtojcën 1 miratuar me këtë VKM.

b. Në 4 raste nuk janë zbritur sipërfaqet e zëna nga rikonstruksionet e rrugëve, shesheve, trotuareve, gjatë vitit 2022, përkatësisht:



- Nuk është zbritur vlera 225,060 lekë për sipërfaqen rruge 5100 m<sup>2</sup> “shtresa çakulli stabilizant” dhe sipërfaqen trotuar 950 m<sup>2</sup> “vendosje pllaka” objekti “sistemim *asfaltim rrugëve Xhaferr Duhanxhiu, Grigor Nosi, Hasan Kopili, lagje 5 Maj*”, sipas urdhër shpenzimit 727 datë 16.08.2022, situacionit 1, kontratës 1288/6 datë 10.06.2022, afat 1 muaj.

- Nuk është zbritur vlera 54,250 lekë për sipërfaqen rruge 3500 m<sup>2</sup> “shtresa çakulli e stabilizant” në objektin “Ndërtim i sheshit parkimit të varrezave publike”, sipas urdhër shpenzimit 795 datë 07.09.2022 dhe 1261 datë 29.12.2022, situacionit 1, kontratës 5457/6 datë 07.03.2022 me afat 5 muaj.

- Nuk është zbritur vlera 149,581 lekë për sipërfaqen rruge 4,021 m<sup>2</sup> “Shtresa çakulli e stabilizant” në objektin “Asfaltim rrugëve Shpëtim Arapi dhe shesheve pallateve 580/16, 580/16, 580/17, 580/19, 580/30 ne lagjen 11 Nëntori”, sipas urdhër shpenzimit 855 datë 19.09.2022 dhe situacionit nr. 2.

\* Nuk është zbritur vlera 139,537 lekë për sipërfaqen sheshe 3,401 m<sup>2</sup> shtresa “rërë dhe pllaka betoni” dhe sipërfaqen trotuar 350 m<sup>2</sup> vendosje “shtresa rërë” në objektin “Rikonstruksion i shesheve të pallateve 650, 651,652, 653 në lagjen Partizani”, sipas urdhër shpenzimit 862 datë 21.09.2022 dhe situacionit 1, kontratës 5237/8 datë 24.01.2022. Në total vlera e paguar tepër për vitin 2022 është vlera 568,428 lekë e cila përbën dëm ekonomik, pagesa për pune pakryer për subjektin e pastrimit “A” ShPK.

Veprime në kundërshtim me kontratën nr. 1186/17 datë 14.12. 2021, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik dhe me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. **Kriteri:** ligji nr. 10463 date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane”, VKM 319 date 31.05.2018 “Për miratimin masave për koston menaxhimit integruar mbetjeve urbane” ,Shtojca nr. 1, UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Ligji 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, kontrata 1186/17 date 14.12. 2021.

**Ndikimi:** Ndikim negativ në shpenzimet e pastrimit dhe shpenzimet operative, si të pajastrifikuara, pa mbështetje ligjore dhe të pakryera.

**Shkaku:** Mos zbatimi i legjislacionit dhe VKM në fushën e pastrimit mbeturinave urbane.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandim:** Bashkia Elbasan të marrë masa për arkëtimin e vlerës **890,148 lekë** nga firma pastrimit “A” ShPK, përkatësisht:

a. vlera 321,720 lekë, për zërin “transport i mbetjeve voluminoze” si shpenzim pa baze ligjore dhe të ndërprerë pagesën e këtij zëri për vitin 2024;

b. të rishikoje zërin “transport dhe largim i mbetjeve urbane direkt nga shtëpitë e qytetareve për çdo dite” me mbarimin e afatit kontraktor, pasi është shpenzim i pajustifikuar;

c. vlera 568,428 lekë, pagesa për pune të pakryer në zërin “Fshirje mbetjeve urbane”, për sipërfaqet e zëna nga rikonstruksionet rrugëve, shesheve, trotuareve qytetit të vitit 2022.

Me shkresën nr. 4474/50 prot., datë 30.01.2024 Bashkia Elbasan ka paraqitur observacionet protokolluar në KLSH me shkresën nr. 767/7 prot., datë 01.02.2024 ku parashtron:

**Pretendimi i subjektit:**

Në 2 raste janë likuajduar padrejtësisht 2 zëra pune të pastrimit të mbetjeve urbane pa mbështetje ligjore me efekte financiare për vlerën 2,221,400 lekë për “A” shpk, pavaresisht se janë përfshirë në procedurën e prokurimit dhe kontratën e pastrimit për vitin 2022 konkretisht:

\* **Zëri** “Transporti i mbetjeve voluminoze” për vlerën 321720 lekë dëm ekonomik për 459 ton përfithen padrejtësisht nga subjekti i pastrimit, në kundërshtim me ligjin Nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane” dhe në VKM Nr. 319 datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për koston e menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane” Ju sqarojmë se:

Në mbështetje të VKM Nr. 319 datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për koston e menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane”, Vendimit Nr. 538 datë 22.09.2021 PËR DISA NDRYSHIME

NË VNDIMIN NR. 687 DATË 29.07.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR MBAJTJEN, PËRDITËSIMIN DHE PUBLIKIMIN E STATISTIKAVE TË MBETJEVE”, Në Mbështetje të Rregullores për Administrimin e Mbetjeve Bashkia Elbasan për vitet 2020-2025 kreu IV nene 16, 20, 22, 25, kreu V Neni 28, 30, kreu VI neni 31, 32 e miratuar në KB Nr. 110 datë 03.09.2020 me Nr Prot 4083/1 Prot, dhe e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me Nr. 1156/1 datë 11.09.2020.

Zëri “Transport i mbetjeve voluminoze” bën pjesë në të dhënat për planifikimin e menaxhimit të mbetjeve pika 3 Sasia e mbetjeve shtëpiake të prodhuara në bashki [Kg/ ose ton/vit], pika 2.2.3 Llogaritja normës së gjenerimit duke përdoruar të dhënat e impianteve të trajtimit-Norma e gjenerimit III dhe bën pjesë në rrymat e mbetjeve të rrezikëshme.

Në mbetjet voluminoze bëjnë pjesë mbetjet shtëpiake urbane (mobilje të ndrrshme si karrike, dyshek, divane etj, degat e pemëve dhe barishtet që gjenerohen nga prona e banoreve), këto mbetje nuk mund të transportohen me mjete teknologjike pasi specifikimet teknik të këtyre mjeteve nuk bëjnë të mundur grumbullimin dhe transportimin e këtyre mbetjeve, për këtë arsye parashikohen si një zë i veçantë.

Mbetjet voluminoze banorët i hedhin rreth 357 pikave të kontenierëve në zonën e kontratës dhe në enklavat që realizohet shërbimi derë më derë. Për këtë arsyeje grupi i punës nga monitorimi ka konstatuar dhe planifikuar mbledhjen dhe largimin e këtyre mbetjeve me një zë të vacant në proceset e shërbimit të pastrimit me anë të një mjeti scifikisht për këto mbetje.

**\*Zëri “Transport i mbetjeve voluminoze” me vlerën 321,720 lekë për 459 ton** nuk ka dëm ekonomik pasi ky shërbim është realizuar cdo ditë sipas specifikimeve teknike të kontratës duke mbajtur cdo ditë Proces-Verbale ditore nga mbikqyrësit me volume e punës të shoqëruara me flet peshoret dhe vertetimin mujor nga Inceneratori për volume e kryera. Transportim të mbetjeve voluminoze për vitin 2022 në parkun rinia nuk ka të planifikuara në kontratë por ka të planifikuara fshirjen me fshesë me krah dhe me auto-fshesë rrugët.

Realizimi i transportit të mbetjeve voluminoze për vitin 2022 është:

426 ton x 700 leke = 298200 leke.

**\*Zëri “Transport dhe largim i mbetjeve urbane direkt nga shtëpitë e qytetarëve për cdo ditë”** për vlerën 1,899,680 lekë mos efektivitet i fondeve për 3064 ton mbetje për (4032 familje baraz me 16128 banorë), pasi nuk justifikohet dhe nuk ka përcaktim ligjor për këtë zë shërbimi. Largimi i mbetjeve nga shtëpitë deri tek pika e grumbullimit është detyre e familjarëve. Sqarojme se:

Shërbimi i transportimit të mbetjeve urbane direkt nga shtëpitë e qytetareve, ka për qëllim kryerjen e këtij shërbimi në ato Njesi Administrative, shtëpitë e të cilave janë në ato zona banimi ku infrastruktura rrugore nuk lejon qarkullimin e mjeteve transporti teknologjike me kapacitet deri në 10, 7, 5, 3 ton.

Për këtë qëllim; paraprakisht grupi i punës ka studiuar, zonën e kontratës dhe territorin urban duke përcaktuar në ato Njesi Administrative: numrin e familjeve, rrugët, lagjet (enklavat) ku do të kryhet ky shërbim e cila arrin afërsisht në 4000 familje.

Planifikimin e saktë të familjevë në të cilat infrastruktura rrugore, nuk lejon grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane me kontenierë dhe makina teknologjike.

Për transportimin e mbetjeve urbane direkt nga shtëpitë e qytetarëve, nevoiten mjete të thjeshta transportuese vetëshkarkuese me kapacitet deri në 3 ton. (me peshë reale deri në 2 ton).

Këto mjete transportuese, në zonat respektive të shërbimit do të transportojnë dhe ato mbetje urbane të cilat janë në vënde të hapura si dhe në spërfaqet publike.

Për përlllogaritjen e kostos për njësi shërbimi me mjete të thjeshta, krahas të dhënave si më lart ne kemi përdorur mënyra analitike tipit dhe numrit të mjeteve që kërkon ky shërbim.

**Pika b.** Në fund të situacioneve të situacioneve të pastrimit pasqyrohen 8% e shpenimeve plotësuese për vlerën 4,195,013 lekë (52,437,669 x 8%) dhe 10% fitimi për vlerën 5,663,268 lekë (56,632,682 x 10%) në vënd të përfshirjes së tyre në analizën e kostove sipas zërave e cila nuk disponohej. Sqarojme se:

Grupi i Punës është mbështetur në VKM 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” si përshmebull në zërin shpenzimet plotësuese 8% karburanti për viet 2020-2022 është parashikuar në Dokumentacionin Tekniko Ekonomik për kryerjen e këtij shërbimi 111 leke litri i naftës dhe gjatë këtyre viteve ka pasur rritje të cmimit të naftës 160-180 leke. Për vitin 2022 në dokumentin tekniko ekonomik për kryerjen e shërbimit të pastrimit në Qytet për të gjitha mjetet janë në shërbim janë parashikuar 118235 litra x 111 leke/litri = 13,124,085 leke kjo vlerë për litër nuk ka ndryshuar deri në Shtator te vitit 2023, mesatarja e ndryshimit të cmimit të naftës sipas instatit, Bordit të Transparencës dhe të testimi të tregurt po ta përlllogarisim me ndryshimin e cmimit të kësaj periudhe me cmimin mesatar prej 160 leke rezulton si më poshtë:

$118235 \text{ litra} \times 160 \text{ leke/litri} = 18,917,600 \text{ leke}$  diferenca e krahasuar me cmimin prej 111 leke e perlllogaritur në 8% shpenzimet plotësuese është  $13,124,085 - 18,917,600 = 5,793,515 \text{ leke}$ . Duke pasur parasysh luhatjet e cmimit të naftës dhe artikuj të tjerë që janë pjesë e këtij dokumenti është vendosur zëri shpenzimeve plotësues në masën 8%, dhe kjo pikë nuk qëndron.

Pika c. 3 Supervizorët e bashkisë që mbikqyrin pastrimin e qytet kanë mbajtur procesverbalet mujore dhe ditore dhe grafikët përkatës për pastrimin e qytet nga firma sipërmarrëse, por paraqesin mangësi dhe shkelje me efekt financiar në mbajtjen e dokumentacioni për verifikimet e pastrimit në terren konkretisht:

-Në process verbalet ditore nuk pasqyrohen vërejtjet për cilësinë e shërbimeve sipas zërave të pastrimit, por është mjaftuar në të gjitha rastet për vitin 2022 ku citohet i njëti model: “janë kryer sipas kërkesave të kontratës dhe aneksit të saj”. Ju sqarojmë se:

Në lidhje me këtë supervizorët e bashkisë kanë mbajtur process verbale ditore dhe mujore sipas grafikëve përkatës të miratuar për shërbimin e pastrimit në qytet flet peshoret ditore të parashikuara në kontratë dhe nuk pasur mangësi dhe shkelje me efekte financiare.

Nuk pasqyrohen zbritjet për ditët me shi, dhe ska zbritje në zërat e fshirjes rrugëve e shesheve dhe freskimi i tyre (Prill-Tetor). Ju sqarojmë se:

Në zërin fshirje rrugë e sheshe në ditë me shi nuk ka zbritje në volume e punës pasi në këto ditë realizohet ky shërbim pasi në dokumentacionin tekniko ekonomik për shërbimin e pastrimit në qytet janë parashikuar veshjet dhe uniformat për puntorët edhe në ditë me shi sepse nqs nuk pastrohet dhe me keto ditë me shit krijohen problematika në rruge e sheshe duke u bllokuar pusetat e ujrave të bardha.

Në zërin e freskimit të rrugëve (Prill-Tetor) në ditët me shi janë pasqyruar në procesverbalet ditore, mujore dhe situacionin mujor janë bërë ndalesat përkatëse në cdo muaj për ditë me shi. Kjo vërejtje nuk qëndron.

-Kanë munguar penalitetet për punë të pakryera të konstatuara nga vetë supervizorët. Ju sqarojmë se:

Nuk ka pasur nevojë për penalitete pasi vërejtjet që janë konstatuar gjatë mbikqyrjes ditore janë korigjuar në kohë nga sipermarrësit.

- Pavarësisht se supervizorët kanë zbritur zërin e punës së pa kryer “Pastrim dhe fshirja e shesheve dhe rrugëve të qytetit”, për sipërfaqet e zëna nga parkimi i autoveturave, kamionëve dhe autobuzëve, por kjo sipërfaqeve nuk argumentohet sipas zonave, hartave dhe planimetrive me përmasime të drejtorisë Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, ju sqarojmë se:

Grupi i punës pasi ka bërë studimin ne lidhje me sipërfaqen e parkimeve të zëna ne gjashtë rrugë kryesore, ku në këto rrugë parkimi është i shpeshtë dhe me orare të kufizuara ku realizohet shërbimi në zërin e pastrimit, këto sipërfaqe janë zbritur në dokumentin tekniko-ekonomik për kryerjen e shërbimit të pastrimit.

-Për punimet e pa kryera zbritjet kanë qenë me vlera të pa përfillshme nga 1,500 leke/muaj deri në 3,000 lekë/muaj (ndaj sipërfaqes totale 8,013,824 m<sup>2</sup> fshirje e plotë dhe 16,520,700 m<sup>2</sup> fshirje e pjesëshme). Ju sqarojmë se:

Për vitin 2022 në zërin fshirje me fshesë me krah e parashikuar ne kontratë 286,208 m<sup>2</sup>/ditë është zbritur zipërfaqia 92,008 m<sup>2</sup>/ditë e cila është në rikonstruksion sheshi “Bashki – Prefekturë dhe sheshet për rreth).

Për vitin 2022 në zërin fshirje e pjesëshme fshesë me krah e parashikuar ne kontratë 590025m<sup>2</sup>/ditë dhe është zbritur zipërfaqia 92,008 m<sup>2</sup>/ditë e cila është në rikonstruksion sheshi “Bashki – Prefekturë dhe sheshet për rreth)

- Supervisorët për vitin 2022 kanë vepruar me dy standarte, pasi kanë zbritur vetëm sipërfaqen e sheshit Prefekturë-Bashki zenë nga investimi “ Ndertimi i ri i godinës së Bashkisë Elbasan” dhe ndonjë rast tjetër, por nuk kanë zbritur sipërfaqet e tjera të zëna nga “rikonstruksionet e rrugëve, shesheve dhe trotuarëve të qytetit” (të miratuara nga K.B), për rrjedhojë vlera prej 608,157 lekë përfaqëson pagesa për punë të pa kryera për subjektin sipërmarrës të pastrimit “A” shpk konkretisht:

-Nuk është zbritur sipërfaqja rruge 5 100 m<sup>2</sup>”shtresa cakulli e stabilizant” dhe sipërfaqja trotuar 950m<sup>2</sup> “ vendosje pllaka” në objektin “Sistemim asfaltim rrugëve Xhaferr Duhaxhiu, Grigor Nosi dhe Hasan Kopili, në lagjen 5 Maj” nga B.N shpk”, sipas urdhër shpenzimit nr. 727 datë 16.08.2022 dhe situacionit nr.1 viti 2022 si dhe kontratës 1288/6 datë 10.06.2022 me afat 12 muaj. Llogaritja e efekteve: 225,060 lekë zëri “fshirja rrugë dhe trotuare” (5100+950= 6050 m<sup>2</sup> x 0,10 lekë/m<sup>2</sup> x 31 ditë x 12 muaj= 225,060)

-Nuk është zbritur sipërfaqja e rrugës 3500 m<sup>2</sup> “shtresë cakulli e stabilizant” në objektin “Ndërtim i sheshit parkimit të varrezave publike”, nga I shpk), sipas urdhër shpenzimit Nr. 795 datë 07.09.2022 dhe Nr. 1261 datë 29.12.2022, situacioni Nr. 1, viti 2022 si dhe kontratës 5557/6 datë07.03.2022 me afat 5 mujor.

Llogaritja efektive: 54250 zëri “fshirje rrugë” (3 500 x0.10 leke/m<sup>2</sup> x 31 ditë x 5 muaj= 54,250 leke”.

-Nuk është zbritur sipërfaqja rrugë 4021 m<sup>2</sup> “shtresë cakulli e stabilizant” dhe sipërfaqe trotuari 1068m<sup>2</sup> “vendosje pllakash” në objektin “asfaltim i rrugëve Shpëtim Arapi dhe shesheve të pallateve 580/16, 580/17, 580/19, 580/30 në lagjen 11 nëntori, nga E shpk), sipas urdhër shpenzimit Nr. 855 datë 19.09.2022 dhe situacionit Nr. 2.

-Llogaritja efektive: 189310 leke zëri “fshirje rrugë trotuar” (4021+168=5089m<sup>2</sup>x0.10leke/m<sup>2</sup> x 31 ditë x 12 muaj=189 310 leke).

-Nuk është zbritur sipërfaqja sheshe 3401m<sup>2</sup> shtresa “rërë dhe pllaka betoni” dhe sipërfaqen trotuar 350m<sup>2</sup> vendosje “shtresa rërë” në objektin rikonstruksion i shesheve të pallateve 650, 651, 652, 653 në lagjen Partizani), sipas urdhër shpenzimit Nr. 862 datë 21.09.2022 (6,000,000lekë) dhe situacionit Nr. 1, kontratës 5237/8 datë 24.01.2022.

-Llogaritja e efekteve: 139,537 leke zëri “Fshirje rruge e trutuarë” (3401+350=3751m<sup>2</sup> x 0.10 leke/m<sup>2</sup> x 31 ditë x 12 muaj= 139,537 leke); Ju sqarojmë se :

Supervisorët për vitin 2022 nuk kanë vepruar me 2 standarte sepse sipërfaqet e rrugëve, shesheve, trotuarëve të cituara si më sipër nga ana juaj nuk janë pjesë e kontratës dhe strukturës së shërbimit të pastrimit për vitin 2022, përveç rrugës Shpëtim Arapi me sipërfaqe 1704m<sup>2</sup> ka qenë në strukturën e shërbimit të pastrimit dhe është kryer shërbimi. Pra dëmi-ekonomik nuk qëndron për rrugët, sheshet dhe trotuarët e mëpipërme.

II. Në pikën 15 ku citohet se: “ Janë kryera shpenzime 2,000,000 lekë për qira objekti privat 176 m<sup>2</sup> për strehimin e qenve endacak, sipas urdhër shpenzimeve dhe kontratës 856/11 datë 20.04.2022 me nga 50,000 lekë/muaj rezulton se : shpenzimi nuk duhej kryer për strehimin e qenve endacak pasi interes public është strehimi I qytetarëve të pa strehë, ndaj qenve endacak duhej të ndiqeshin standartat për këto loj kafshësh dhe aplikimin e standarteve të bashkive të tjera simotra.” observojmë si më poshtë:

Njësia e qeverisjes vendore ka ndër funksionet e saj edhe sigurinë e qytetarëve e cila në një nga format çënohet nga prezenca e qenve të rrugës. Sot ky është një fenomen shumë shqetësues dhe menaxhimi i këtij fenomeni realizohet sipas standarteve të kërkuara duke kaluar në proceset e

kapjes, vaksinimit dhe sterilizimit të tyre . për kryerjen e këtyre proceseve qentë strehohen në këtë qëndër. Miratimi i kësaj qëndre është bërë me vendim të këshillit Bashkiak i cili ka miratuar dhe fonde të vecanta për këtë qëllim si një detyrim i njësisë së qeverisjes vendore për menaxhimin e këtij fenomeni. Fondet që përdoren për këtë program nuk çënojnë parashikimet buxhetore për strehimin social të qytetarëve , të cilit Bashkia Elbasan i ka dhënë një focus të vecantë.

**Qëndrimi i grupit auditimit:** *Observacioni nuk qëndron dhe nuk merret parasysh, pasi ky observim njëherë është marre pjesërisht parasysh dhe është trajtuar tek projektraporti, pra është kopje e observacionit të parë, madje ngrihen disa probleme të cilat janë marre parasysh (krahaso aktkonstatimin 3 me projekt raportin), me hollësisht:*

**a.** bashkia për vitin 2022 ka likuiduar padrejtësisht vlerën 321,720 leke dem ekonomik për subjektin “A” shpk, pavarësisht se janë përfshirë në procedurën prokurimit dhe kontratë, pasi zëri “transport i mbetjeve voluminoze” për 459 ton, bie në kundërshtim me ligjin nr. 10463 date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane” dhe me VKM nr. 319 date 31.05.2018 “Për miratimin masave për koston menaxhimit integruar mbetjeve urbane” si dhe me shtojcën nr. 1 miratuar me këtë VKM.

**b.** bashkia për vitin 2022 ka likuiduar padrejtësisht vlerën 1,899,680 leke mos efektivitet për 3,064 ton mbetje (për 4032 familje), për zërin “transport dhe largim i mbetjeve urbane direkt nga shtëpitë e qytetareve për çdo dite”, pasi ky zë shërbimi nuk justifikohet sepse largimi mbetjeve nga shtëpitë deri pika grumbullimit është detyrë e familjareve dhe kështu është vepruar dhe në bashkitë tjera simotra..

**c.** bashkia për vitin 2022 ka likuiduar vlerën 568,428 leke dem ekonomik, për punë pakryer për subjektin e pastrimit “A” shpk, pasi në 4 raste nuk janë zbritur sipërfaqet e zëna nga rikonstruksionet e rrugëve, shesheve, trotuareve, gjate vitit 2022, në kundërshtim me kontratën nr. 1186/17 date 14.12. 2021, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik dhe me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

### **Shpenzime për qira automjete.**

**I.** Bashkia Elbasan për transportin e administratës dhe kryerjen e shërbimeve publike të Bashkisë, ka marre subjektin “E” shpk **3 automjete me qira** për një periudhë **1-3 vjeçare** (2021-2022-2023 ose 06.11.2020 deri 05.11.2021, 06.11.2021 deri 05.11.2022, 06.11.2022 deri 05.11.2023), sipas kontratave respektive nr. 9034/16 date 06.11.2020, nr. 4567/2 date 04.11.2021, nr. 6444/12 date 27.05.2022, miratuar me VKB nr. 161 date 24.10.2019, nr. 100 date 25.10.2021, nr. 138 date 09.11.2022, VKB nr. 18 date 04.02.2022.

Bashkia ka likuiduar dhe vazhdon likuidimin e qirasë të 3 mjeteve subjektit për 3,9 milion në vit ose **9,5 milion për 3 vjet** (Land-Rover 1 vit), sipas kushteve kontraktore, përkatësisht:

- 1 “Wolzvagen” 60,000 lekë/muaj x 12 muaj=720,000 lekë/vit x 3 vite=2,160,000 lekë,
- 1 Fadrome , tarifa 178,000 lekë/muaj x12 muaj=2,136,000 lekë/vit x 3 vite=6,408,000 lekë,
- 1 “Land-Rover” me tarife 75,000 lekë/muaj x 12 muaj=900,000 lekë/vit,

Kontratat nr. 9034/16 date 06.11.2020 dhe nr. 4567/2 date 04.11.2021 janë nënshkruar nga 2 palët subjekti “E” shpk dhe zv/kryetari z. A. Q., ndërsa kontrata nr. 6444/12 date 27.05.2022 e nënshkruar nga 2 palët subjekti “A.-K.” shpk dhe zv/kryetari z. A.B. Nga auditimi i kësaj praktike qiraje automjete, rezultoi:

**a. Shpenzimi i qirasë prej 9,5 milion lekë nuk është eficient** dhe paraqet mos efektivitet në fondet publike, pasi me këtë vlerë 3 mjetet mund të bliheshin të reja.

**b. Nuk argumentohen tarifat e larta të qirasë për 3 mjetet**, përkatësisht: autovetura 60,000 lekë/ muaj, Fadroma 178,000 lekë/muaj dhe Foristrada 75,000 lekë/muaj

**c. Nuk justifikohet arsyeja e marrjes me qira të mjeteve**, për transportin e administratës dhe kryerjen e shërbimeve publike të Bashkisë, pasi Bashkia dhe ASHP disponon mjetet e veta, madje

vetëm ASHP disponon 50 mjete te gjitha llojeve, konkretisht: 15 autovetura (*vetura, furgona dhe foristrada etj*), 8 fadroma, 2 borëpastruese, 1 traktor, 5 ekskavator, 16 kamionë te ndryshëm dhe mjete tjera ekzistuese dhe te blera gjate vitit 2022 (1 ekskavatorë).

Veprime ne kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", çka ngarkon me përgjegjësi zv/kryetaret z. A. Q. dhe zj. A.B.

**Titulli gjetjes:** Shpenzime qiraje për 3 automjete (3 vjet) për 9,5 milion lekë pa efektivitet.

**Situata:** Nga auditimi konstatohet se Bashkia Elbasan për transportin e administratës dhe kryerjen e shërbimeve publike të Bashkisë, ka nënshkruar kontratë qiraje me subjektin "E" ShPK për 3 automjete, për një periudhë 1-3 vjeçare (2021-2022-2023) sipas kontratave respektive të miratuara me VKB. Bashkia ka likuiduar dhe vazhdon likuidimin e qirasë të 3 mjeteve, përkatësisht:

- 1 autoveture "*Wolzvagen Sharan*" me 60,000 lekë/muaj, ose lekë/ 3 vite,
- 1 Fadrome "*Caterpillar*" me 178,000 lekë/muaj x 12 muaj x 3 vite = 6,408,000 lekë,
- 1 automjet "*Land-Rover*" me 75,000 lekë/muaj x 12 muaj=900,000 lekë/vit.

Shpenzimi i qirasë prej 9,5 milion lekë paraqet mos efektivitet të fondeve, pasi me këtë vlerë 3 mjetet mund të bliheshin të reja. Gjithashtu nuk argumentohen tarifat e larta të qirasë për 3 mjetet dhe nuk justifikohet arsyeja e marrjes me qira te 3 mjeteve, pasi Bashkia dhe ndërmarrja e shërbimeve publike për kryerjen e këtyre shërbimeve disponon mjetet e veta, madje te këtyre llojeve, konkretisht: 15 autovetura (*vetura, furgona dhe foristrada etj*), 8 fadroma, 2 borëpastruese, 1 traktor, 3 eskavator, kamionë të ndryshëm, mjete tjera të blera në 2022. Veprime në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*".

**Kriteri:** Ligjin 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*".

**Ndikimi:** Ndikim negativ per 9,5 milion lekë ne shpenzimet operative, pasi nuk justifikohen marrja me qira e 3 automjeteve ne kushtet e disponimit gjendje te automjeteve saj.

**Shkaku:** Mos zbatimi i legjislacionit.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandim:** Bashkia Elbasan të ndërpresë likuidimin dhe kontratat me subjektet qiradhënëse "E" ShPK me mbarimin e afateve kontraktore janar 2024, për 3 automjetet e marra me qira, përkatësisht: "*Wolzvagen Sharan*", Fadrome "*Caterpillar*" dhe 1 "*Land-Rover*", pasi këto shpenzime qiraje nuk janë efektive për buxhetin, sepse Bashkia dhe ASHP disponon mjetet e veta.

### **Oponenca teknike te pa administruara nepermjet magazinës.**

**1. Ne 9 raste për vlerën 1,768,894 lekë nuk janë bere hyrje oponencat teknike,** për rikonstruksionin e 2 shkollave, palestrave, terreneve sportive, rrugëve, mbikalimit hekurudhor dhe argjinaturës mbrojtëse lumit Shkumbin, te kryera nga Instituti Ndërtimor Tirane, oponenca te cilat nuk disponohen ngjitur urdhër shpenzimeve përkatëse për efekt të justifikimit të shpenzimit, konkretisht:

- vlera 200,000 lekë, për shërbime oponence teknike te 2 shkollave Konstandin Kristoforidhi dhe Tregan për rikonstruksionin e tyre, sipas urdhër shpenzimeve nr. 110 datë 02.03.2022, kontratës 3931/1 date 13.08.2021 dhe faturës nr. 436 date 07.10.2021.

- vlera 448,883 lekë, për shërbime oponence teknike te mbikalimi hekurudhor kryqëzimi Elbasan-Librazhd, sipas urdhër shpenzimeve nr. 118 datë 03.03.2022, kontratës 59 date 05.01.2022 dhe faturës 14 date 12.01.2022, urdhrit 355 date 03.03.2022 zv/kryetares.

- vlera 254,222 lekë, për shërbime oponence teknike te ndërtimit argjinaturës mbrojtëse nga lumi Shkumbin, sipas urdhër shpenzimeve nr. 119 datë 03.03.2022, kontratës 6433 date 31.12.2021 dhe faturës nr. 02 date 10.01.2022.

- vlera 70,000 lekë, për shërbime oponence për objektin "*rikonstruksion i palestrave dhe terreneve sportive te shkollës bashkuar L.Gurakuqi pedagogjike Elbasan*", sipas urdhër shpenzimit 543 datë 07.07.2022, Aktmarrëveshja 1140/1 date 20.06.2022 date 31.12.2021.

- vlera 339,152 lekë, për shërbime oponente për “argjinaturës mbrojtëse lumit Shkumbin “, sipas urdhër shpenzimit 749 datë 24.08.2022, Aktmarrëveshja 1461/1 date 15.08.2022.
- vlera 231,265 lekë, për shërbime oponente për “argjinaturës mbrojtëse lumit Shkumbin”, sipas urdhër shpenzimit 752 datë 24.08.2022, Aktmarrëveshja 1460/1 date 15.08.2022.
- vlera 253,172 lekë, për shërbime oponente për “ndërtim rrugës Zija Luniku, segmenti I“, sipas urdhër shpenzimit 750 datë 24.08.2022, Aktmarrëveshja 1459/1 date 15.08.2022.
- vlera 100,000 lekë, për shërbime oponente “objekt 3-kat”, sipas urdhër shpenzimit 753 datë 24.08.2022, Aktmarrëveshja 630/2 date 05.04.2022.
- vlera 70,000 lekë, për shërbime oponente për “rikonstruksion rrugës Grigor Nosi, Hasan Kopili, Xhaferr Duhaxhi lagje 5 Maji njësia 6”, sipas urdhër shpenzimit nr. 1192 datë 16.12.2022, Aktmarrëveshja 918/1 date 16.05.2022.

Financa ne administrimin e 5 oponentave ka aplikuar **2 standarde**, pasi ndryshe ka vepruar me Plan mbarështimin e ekonomisë pyjore Kushe 2, i cili është administruar ne magazine, sipas fletëhyrjes nr. 8 date 01.03.2022 dhe urdhër shpenzimit nr. 260 date 28.04.2022 për vlerën 3,478,796 lekë. Veprime ne kundërshtim me UMF 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitet sektorit publik”, me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Magazinieri A.K dhe financa A.M.

**Titulli gjetjes:** Mos administrim nëpërmjet magazinës ne 9 raste për vlerën 1,768,894 lekë te oponentat teknike për investimet 2022.

**Situata:** Bashkia Elbasan për 9 raste në vlerën 1,768,894 lekë nuk janë bërë hyrje oponentat teknike, për rikonstruksionin e 2 shkollave, palestrave, terreneve sportive, rrugëve, mbikalimit hekurudhor dhe argjinaturës mbrojtëse lumit Shkumbin, te kryera nga Instituti Ndërtimor Tirane. Veprime në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitet publik”.

**Kriteri:** UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitet publik”, ligji 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

**Ndikimi:** Mos administrim nëpërmjet magazinës i projekteve 9 oponenta teknike.

**Shkaku:** Mos zbatimi i UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitet publik” dhe ligjit 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

**Rëndësia:** E Lehte

**Rekomandim:** Bashkia Elbasan të administroje duke i bërë hyrje 9 oponentat teknike për vlerën 1,768,894 lekë, për rikonstruksionin e 2 shkollave, palestrave, terreneve sportive, rrugëve, mbikalimit hekurudhor dhe argjinaturës mbrojtëse lumit Shkumbin, të kryera nga Instituti Ndërtimor Tirane, sipas kërkesave ligjore.

### **Shpenzime për TVSH**

**Në 6 raste**, për vlerën **654,268 lekë**, përfituar nga subjektet juridike, **TVSH 2-herë** për “**pajisjet elektrike e hidraulike**”, pasi në situacionet subjekti i ka llogaritur me gjithë vlerën e tvsh, në mospërputhje me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, pra nuk është ndarë veças vlera e “montimit” të pajisjeve pa tvsh dhe veças vlera e “pajisjeve” me gjithë vlerën e tvsh dhe vihet në fund të situacionit, për rrjedhojë është përfituar padrejtësisht nga subjektet , konkretisht:

**1. vlera 23,587 lekë** (117,963 x20%), subjekti “**B.N**” shpk, për zërin ne situacion “Pajisje elektrike e hidraulike”, për objektin “përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetet e varfra dhe te pafavorizuara”, sipas urdhër shpenzimit nr. 295 dhe nr. 296 datë 11.05.2022 likuiduar vlera 321,399 lekë dhe 4,621,213 lekë.

**2. vlera 244,886 lekë** (1,224,434 x20%), subjekti “**B.N**” shpk, për zërin ne situacion “Pajisje elektrike e interneti”, për objektin “Rikonstruksion e 3 rrugëve dhe shesheve te pallateve 579,579/3, 579/4, 579/5, 580/1”, sipas urdhër shpenzimit nr. 425 datë 10.06.2022 është likuiduar

për vlerën 3,932,182 lekë. Situacioni përfundimtar nënshkruar nga përfaqësuesit e zyrës investimeve të Bashkisë Elbasan: ing. E.H, ing: G.P, ing: A.M dhe zv/kryetare V.L si dhe mbikëqyrësi ing: N.P.

**3. vlera 85,315 lekë** (426,583 x20%), subjekti “**B**” shpk, për zërin në situacion “Pajisje elektrike”, për objektin “Rikonstruksion i fushës minikalçetos dhe rrethim i kompleksit sportiv Sh.Lamcja”, sipas urdhër shpenzimit nr. 430 datë 10.06.2022 është likuiduar për vlerën 4,811,123 lekë. Në situacionin përfundimtar kane nënshkruar përfaqësuesit e zyrës investimeve të Bashkisë ing: G.P, ing: E.H dhe zv/kryetare A.B si dhe mbikëqyrësi ing: Gj.D. Theksojmë se fondi rezerve është zbërthyer analitikisht në situacionin përfundimtar, sipas zërave punës, në sasi, në mime dhe vlera përkatëse në zbatim të kërkesave ligjore.

**4. vlera 13,400 lekë** (670,000 x20%), subjekti “**E**” shpk, për zërin në situacion 1 “Pajisje elektrike hidrosanitare”, objekti “Rikonstruksion shtese kati dhe palestër Shkolla Artistike Onufri”, sipas urdhër shpenzimit 1242 date 27.12.2022 likuiduar vlera 44, 694,828 lekë.

**5. vlera 180,000 lekë** (900,000 x20%), subjekti “**S.**” shpk, për zërin në situacion “Pajisje elektrike”, objekti “Rehabilitim sheshit urban lindje rrugës Iljaz”, sipas urdhër shpenzimit 1152 date 07.12.2022 likuiduar 321,399 lekë dhe 4,621,213 lekë.

**6. vlera 107,080 lekë** (535,400 x20%), subjekti “**E**” shpk, për zërin në situacion “Pajisje elektrike”, për objektin “Rikonstruksion i rrugës Abdyl Kajanaku”, sipas urdhër shpenzimit nr. 426 datë 10.06.2022 është likuiduar për vlerën 6,607,470 lekë.

Gjithashtu u konstatua se, **fondi rezerve 5 % nuk është zbërthyer analitikisht në situacionin përfundimtar**, sipas zërave punës, në sasi, në çmime dhe vlera përkatëse, në zbatim të kërkesave ligjore, por është pasqyruar vetëm në vlerë absolute prej 752,120 lekë, për rrjedhojë nuk argumentohet ky shpenzim, veprim në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik “ neni 36, me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe me UKM nr. 3 datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin punimeve ndërtimit” ndryshuar.

Pra Bashkia ka pranuar situacionet me **2 standarde**, pasi ndryshe është vepruar tek situacioni i subjektit “B” shpk, pasi fondi rezerve është pasqyruar sipas zërave, volumeve, çmimeve dhe vlerave përkatëse. Situacioni përfundimtar i subjektit “E” shpk është nënshkruar nga përfaqësuesit e zyrës investimeve të Bashkisë ing. E.H, ing: G.P , ing: A.M dhe zv/kryetari I.S dhe mbikëqyrësi ing: G.I .

**Titulli gjetjes:** Përfituar TVSH 2-herë për “pajisjet elektrike e hidraulike” nga 6 subjekte investuese, për vlerën 654,268 lekë.

**Situata:** Në 6 raste, për vlerën 654,268 lekë, përfituar nga subjektet juridike, TVSH 2-herë për “pajisjet elektrike e hidraulike”, pasi në situacionet subjekti i ka llogaritur me gjithë vlerën e tvsh, në mospërputhje me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, pra nuk është ndarë veças vlera e “montimit” të pajisjeve pa tvsh dhe veças vlera e “pajisjeve” me gjithë vlerën e tvsh dhe vihet në fund të situacionit, për rrjedhojë është përfituar padrejtësisht nga subjektet konkretisht: “B.N” shpk 23,587 lekë dhe 244,886 lekë, “B ” shpk 85,315 lekë, “E ” shpk 107,080 lekë dhe 13,400 lekë dhe subjekti “S.” shpk 180,000 lekë,

**Kriteri:** UKM 2 datë 08.05.2003 “Për klasifikimin e strukturën kostos punimeve ndërtimit”.

**Ndikimi:** likuidim tepër TVSH për vlerën 654,268 lekë në situacionet e investimeve.

**Shkaku:** Mosnjohja e UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, që bën fjale për “pajisjet elektrike e hidraulike”.

**Rëndësia:** E Lehte.

**Rekomandim:** Bashkia Elbasan të arkëtoje vlerën 654,268 lekë dem ekonomik, për likuidim 2 here TVSH, në 6 raste, konkretisht:-vlera 23,587 lekë, për subjektin “B.N” shpk, -vlera 244,886 lekë, për subjektin “B.N” shpk, -vlera 85,315 lekë, për subjektin “B” shpk, -vlera 107,080 lekë,



për subjektin “E” shpk, -vlera 13,400 lekë, për subjektin “E” shpk dhe vlera 180,000 lekë, për subjektin “S.” shpk.

### **Shpenzime me mangësi ne dokumentacion.**

**1.** Bashkia Elbasan ka likuiduar për vitin 2022 shpenzimet e energjisë elektrike, sipas urdhër shpenzimeve përkatëse (nr. 487 date 27.06.2022, nr. 37 date 31.01.2022, nr. 593 date 20.07.2022. e tjerë), por pa disponuar televizorë në faturat e OSHE (FSHU) është shtuar padrejtësisht për çdo muaj si zë shpenzimi taksa aparateve (televizorit) prej 100 lekë/rasti, konkretisht për tregun e lire, linjat e ndriçimit rrugor, thertorja dhe 12 njësite administrative e tjerë, çka ka shkaktuar një efekt negativ financiar për vlerën **22,800 lekë** (19 njësi x 100 lekë /muaji x 12 muaj), duke rënduar padrejtësisht shpenzimet e institucionit, ku Bashkia nuk ka kundërshtuar këtë problem, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, date 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 9, pika 4, neni 12 pika 3.

### **Shpenzime me mangësi ne 1 rast, ne prokurime vogla**

**Në 1 rast në prokurime vogla u konstatuan vlera 20,000 lekë TVSH (100,000+20,000 TVSH=120,000)**, pasi nuk është shitje tende por është qira tënde me aktmarrëveshje provizore, e cila nuk i nënshtrohet aplikimit të TVSH por tatimit burim, në kundërshtim me legjislacionin fiskal. Kështu, sipas urdhër shpenzimit nr. 1058 date 10.11.2022 për vlerën 120,000 lekë është likuiduar subjekti “I.C ”, për qira tende (18 m2 me kapacitet 3 karrige, 1 kolltuk dhe 1 tavoline) për nevoja panairit disa ditore te Bashkisë.

### **Shpenzime për pagesën e lejeve zakonshme .**

**1. Ne 2 raste**, Bashkia Elbasan ka paguar **76,600 lekë dëm ekonomik, leje vjetore të pakryera të vitit 2022, në vend të kompensimit tyre me pushime** duke qene e mundur kryerja e tyre deri ne fund të 3-mujorit pare 2023 ose brenda afatit kohor të lejuar, në kundërshtim me VKM nr. 568 date 06.10.2021 “Për miratimin rregullave për kohëzgjatjen punës dhe pushimit, orët shtese dhe kompensimin tyre institucionet shtetërore, pavarura dhe njësite vetëqeverisjes vendore”, kap III, pika 8, konkretisht:

- vlerën **42,732 lekë, A.Q** auditues, urdhër shpenzimit nr. 771 datë 02.09.2022,
  - vlerën **33,869 lekë, L.Z** gjendja civile, urdhër shpenzimit 771 datë 02.09.2022,
- Drejtores e financë- buxhetit A.M dhe përgjegjësjë e financës V.Z.

**Titulli gjetjes:** Përfitim i paligjshëm takse, tvsh, page për leje zakonshme për 119,400 lekë.

### **Situata:**

- Në faturat e OSHE është shtuar padrejtësisht për çdo muaj si zë shpenzimi taksa aparateve (televizorit) prej 100 lekë/rasti, pa disponuar televizorë, konkretisht për tregun e lire, linjat e ndriçimit rrugor, thertorja dhe 12 njësite administrative e tjerë, çka ka shkaktuar vlerën 22,800 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, date 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 9, pika 4, neni 12 pika 3.

- Në 1 rast përfituar padrejtësisht vlera 20,000 lekë TVSH subjekti “I.C ”, për qira tende me aktmarrëveshje provizore, e cila nuk i nënshtrohet aplikimit te TVSH, pasi nuk është shitje tende, sipas urdhër shpenzimit nr. 1058 date 10.11.2022 për vlerën 120,000 lekë, ne kundërshtim me legjislacionin fiskal.

- Në 2 raste, përfituar vlera 76,600 lekë, per pagese pushime vjetore te vitit 2022, ne vend te kompensimit tyre me pushime, në kundërshtim me VKM nr. 568 date 06.10.2021, kap III, pika 8, konkretisht: 42,732 lekë A.Q dhe 33,869 lekë L.Z , sipas urdhër shpenzimit 771 datë 02.09.2022,

**Kriteri:** ligji nr. 10296, date 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 9, pika 4, neni 12 pika 3 dhe VKM nr. 568 date 06.10.2021, kap III, pika 8,

**Ndikimi:** likuidim tepër nga fondet i vlerës 119,400 lekë takse, tvsh, leje zakonshme.

**Shkaku:** Pakujdesia ose mosnjohja ligjore.

**Rekomandim:** Bashkia Elbasan të mare masa për arkëtimin e vlerës 119,400 lekë, për përfitim tepër 22,800 lekë takse televizori nga OSHE, për përfitim tepër 20,000 lekë tvsh nga "I.C" dhe për pagese të paligjshme 76,600 lekë të pushimeve vjetore në vend të kompensimit tyre me pushime, A.Q 42,732 lekë dhe L.Z 33,869 lekë.

**Shpenzime udhëtim jashtë shtetit.** Në 1 rast, për vitin 2022 Bashkia Elbasan ka shpenzuar vlerën **1,120,359 lekë**, për **dieta jashtë vendit** në Budva, për **50 pjesëmarrës** përfshirë dhe anëtar KB, në kuadër të bashkëpunimit me Bashkinë Tivar për forcimin vlerave kulturore historike, sipas urdhër shpenzimit nr. 936 dhe nr. 937 date 12.10.2022, rezulton se shpenzimet për dietat me jashtë shtetit nuk justifikohen, pasi: trajtimi me dietë jashtë shtetit të anëtareve të KB, të cilët nuk janë pjese e administratës, bien ndesh me çdo lloj pagese tjetër, përveç 10% pagës titullarit dhe është në papajtueshmëri me funksionin këshilltarit dhe konflikt interesi, me ligjin 139/2015 date 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", me ligjin 9367 datë 7.4.2005 "Për parandalimin konfliktit interesit në ushtrimin funksioneve publike" i ndryshuar neni 4/d. Gjithashtu mungojnë rezultatet dhe analiza e shërbimit si dhe relacioni, për efekt justifikimi dietave si dhe nuk justifikohet numri i larte prej 50 vetash me burim financimi nga taksapaguesit. Keto veprime janë në kundërshtim me VKM 870 datë 14.02.2011 "Për trajtimin financiar punonjësve dërgohen shërbim jashtë vendit", me UMF 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Drejtore e financë-buxhetit znj. A.M dhe kryetari i Bashkisë z. G.LL.

**Titulli gjetjes:** Mos efektivitet shpenzime 1,120,359 lekë, dieta jashtë vendit pa rregullta.

**Situata:** Nga auditimi rezulton se për vitin 2022 Bashkia Elbasan ka shpenzuar vlerën 1,120,359 lekë mos efektivitet shpenzimesh, për dieta jashtë vendit në Budva, për 50 pjesëmarrës përfshirë dhe anëtar KB, në kuadër të bashkëpunimit me Bashkinë Tivar për forcimin vlerave kulturore historike, sipas urdhër shpenzimit nr. 936 dhe nr. 937 date 12.10.2022, rezulton se shpenzimet për dietat me jashtë shtetit nuk justifikohen, pasi: trajtimi me diete jashtë shtetit të anëtareve të KB, të cilët nuk janë pjese e administratës, bien ndesh me çdo lloj pagese tjetër, përveç 10% pagës titullarit dhe është në papajtueshmëri me funksionin këshilltarit dhe konflikt interesi, me ligjin 139/2015 date 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", me ligjin 9367 datë 7.4.2005 "Për parandalimin konfliktit interesit në ushtrimin funksioneve publike" i ndryshuar neni 4/d. Gjithashtu mungojnë rezultatet dhe analiza e shërbimit si dhe relacioni, për efekt justifikimi dietave si dhe nuk justifikohet numri i larte prej 50 vetash me burim financimi nga taksapaguesit. Veprime në kundërshtim me VKM 870 datë 14.02.2011 "Për trajtimin financiar punonjësve dërgohen shërbim jashtë vendit", me UMF 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

**Kriteri:** VKM 870 datë 14.02.2011 "Për trajtimin financiar punonjësve shërbim jashtë".

**Ndikimi:** Ndikim negativ në shpenzimet operative.

**Rekomandim:** Bashkia Elbasan të shmang shpenzimet jo eficiente, për dieta me jashtë vendit të pa justifikuar, me numër të lartë prej 50 pjesëmarrës përfshirë dhe anëtar KB, sipas urdhër shpenzimit nr. 936 dhe nr. 937 date 12.10.2022.

### **Shpenzime për shpronësime.**

Për vitin 2022 në total për Bashkinë Elbasan janë miratuar 9,7 milion lekë shpronësime të pasurive private me interes publik, që preken nga projekti i zgjerimit varrezave publike, bazuar në VKM nr. 576 date 31.08.2022, sipas pronareve fizik të ZK 8527, sa vijon:

- Trashëgimtarët S. likuiduar 2,726,382 lekë sipas urdhër shpenzimit 1262 date 29.12.2022 (are=17,860 m<sup>2</sup>) dhe certifikatës pronësisë, dokument që shpreh titull pronësie.
- familjet D., H., S., L.dhe M. gjithsejtë 449,550 lekë ( are=5,193 m<sup>2</sup>).
- personi O.K gjithsejtë 2,504,160 lekë ( are=12,900 m<sup>2</sup>).
- Trashëgimtarët K. dhe T. 3,916,080 lekë ( are=17,640 m<sup>2</sup>).

-familjet P., D., H., S., L.dhe M. 117,660 lekë ( are=2,594 m2).

Sa sipër, Disponohet dokumentacioni me te dhënat për çdo pasuri objekt shpronësimi e shoqëruar me KPP dhe HTR, sipas shkresës te ASHK nr. 227/6, date 28.02.2022. Pjesa tjetër e pasurive rezultojnë shtet, për pasoje nuk ka shpronësim, konkretisht: -pasuria 223/2, vol 4 faqe 147, - pasuria 332/3, vol 6 faqe 157, -pasuria 222/2, vol 8 faqe 145 dhe pasuria 222/1, vol 8 faqe 146.

### **Veprimet nëpërmjet magazinës**

Nga auditimi u konstatua se në Bashkinë Elbasan, mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si flet-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë. Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara. Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve.

### **Inventarizimi i pasurisë.**

-Për vitin 2022 për inventarizimin e institucionit, njërive administrative, gjendjeve civile, shkollave, kopshteve, konvikteve, titullari i institucionit me urdhrin nr. 1335, datë 28.12.2022 ka ngritur komisionet e inventarizimit fizik, Komisionet kanë kryer inventarizimet, fletët e inventarizimit ishin plotësuar në gjithë ekstremitetet e tyre, dhe ishin nënshkruar nga anëtarët e komisionit dhe personi përgjegjës që i kishte në ngarkim, sipas kërkesave të pikës 82 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Janë inventarizuar kartelat personale për materialet dhe pajisjet që kanë në ngarkim sipas zyrave dhe sektorëve, ku nuk kanë rezultuar diferenca, dhe flet-inventari është nënshkruar nga 2 palët komisioni dhe personi përgjegjës. Janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre si: viti i krijimit, shtesat dhe pakësimit për to, pra është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara, sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me kap III pika 30 të UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Financa ka përpiluar gjendjen kontabël të aktiveve, mjeteve e materialeve qarkulluese sipas llojit tyre duke i grupuar sipas llogarive përkatëse. Gjate fazës së inventarizimit rezultoi se në fillim është përcaktuar numri rendor i fletëhyrjes nr. 45 date 16.12.2022 dhe fletëdaljes së fundit nr. 450 date 30.12.2022 në procesverbalet e komisionit date 03.01.2023 para fillimit të inventarizimit, në përputhshmëri me pikën 83 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Në përfundim të inventarizimit nuk kanë rezultuar diferenca dhe komisioni ka bërë relacion në adrese të Kryetarit Bashkisë për inventarizimin fizik të pasurisë, sipas shkresës nr. 6116/11 date 15.02.2023, bazuar në kërkesat e pikës 87, 88, 89,90, 91 dhe 92 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” .

### **Nxjerrjet jashtë përdorimit, në Bashkinë Elbasan dhe SHMZSH.**

-Për vitin 2022 për vlerësimin e materialeve për nxjerrjet jashtë përdorimit të Bashkisë Elbasan, sipas urdhrin titullarit 6435/1, datë 22.09.2022 është ngritur komisioni prej 5 veta.

-Për vitin 2022 për vlerësimin e materialeve për nxjerrjet jashtë përdorimit të SHMZSH, sipas urdhrin titullarit nr. 1340, datë 30.12.2022 është ngritur komisioni prej 5 veta. Komisioni ka vlerësuar dhe evidentuar materialet, të cilat kanë humbur vlerën e përdorimit, për disa pajisje zyrash, shkollash, aparatura, tavolina, karrike, dollapë, kompjutra, printerë, laptop, kompjuter fotografi, veshje policisë Bashkiake, e tjerë. Në përfundim të nxjerrjes jashtë përdorimit të materialeve komisioni ka bërë relacion, sipas shkresës nr. 6435/2 date 26.09.2022. Magazinieri

Altin Kofsha për Bashkinë ka shkarkuar materialet e asgjësuarra, sipas fletëdaljes 32 date 23.11.2022 për vlerën 15,754,283 lekë, sipas artikujve dhe llogarive përkatëse (llog. 327=1,646,513lekë, llog.214=6,549,224 lekë, llog, 218=5,390,770 lekë, llog,3277=984,260 lekë dhe llogaria 312 I,183,514 lekë), ndërsa për SHMZSH për vlerën 2,012,826 lekë sipas flet daljes nr. 33 date 30.12.2022. Në bilancin 2022 të Bashkisë Elbasan tek pasqyra financiare aneksi formati 7/a, nxjerrjet jashtë përdorimit pasqyrohen për vlerën 13,297,184 lekë, nga 15,754,283 lekë të bëra dalje, ku diferenca justifikohet me llog. 327 “objekte inventari” në përdorim (veshmbathje policisë Bashkiake., rroba pune, goma , karroca, celsa e priza dhe materiale në përdorim në kartelat personale etj).

Për vlerësimin e materialeve për nxjerrjet jashtë përdorimit paraqiten këto mangësi teknike në fletët e inventarit si:

- nuk ka pasqyruar vitin e blerjes të aparaturave elektronike, për të saktësuar amortizimin e plotë sipas tarifave ligjore. Mungesa e përcaktimit të vitit blerjes shmang afatin e amortizimit dhe krijon shteg për nxjerrje jashtë përdorimi të tyre para kohe dhe në gjendje punë, pasi mund të jenë funksionale nga riparimet e tyre.

- nuk disponohet fletëhyrja dhe fletëdalja për materialet e asgjësuarra, ashtu siç është vepruar tek QEA, ku kjo e fundit materialet e shkatërruara drusore janë bërë hyrje nr. 121 date 30.12. 2022 për 4,5 m3 dhe janë bërë dalje shkollave për ngrohje nr. 1515 date 30.12.2022. Veprime në kundërshtim me pikën 95 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**2.5. Rregjistrimi asetëve të Bashkisë në Agjencinë Shtetërore Kadastrës (ASHK).** Bashkia Elbasan ka miratuar listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të saj dhe njërive administrative prej 166 flete, sipas kërkesave të VKM nr. 416, datë 11.07.2007 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Elbasan”, i ndryshuar. Ka përfunduar procesi i transferimit në pronësi ose përdorim të pasurive të paluajtshme për 12 Njësitë Administrative në vitin 2016. Për çdo Njësi Administrative janë ngritur grupe pune për evidentimin dhe verifikimin në terren për pasuritë e transferuara.

Administrimi, marrja në dorëzim, menaxhimi i asetëve është bërë në zbatim të ligjit 8743 datë 22.02.2001 “Për pronat paluajtshme shtetit”, të ligjit 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin pronave paluajtshme publike Njësitë Qeverisjes Vendore”, VKM 500 datë 14.8.2001 “Për inventarizimin PP Shtetërore dhe transferimin pronave Qeverisjes Vendore”.

**Aplikimi.** Bashkia Elbasan ka aplikuar periodikisht gjatë vitit 2022 pranë ASHK, për hipotekimin dhe pajisjen me certifikate pronësie të asetëve të saj, sipas urdhër shpenzimeve nr. 52 date 08.02.2022, nr. 89 date 18.02.2021, nr. 152 date 24.03.2022, nr. 174 date 31.03.2022, nr. 218 date 14.04.2022, nr. 219 date 15.04.2022, nr. 269 date 29.04.2022, nr. 281 date 09.05.2022, nr. 299 date 11.05.2022, nr. 423 dhe nr. 424 date 10.06.2022, nr. 541 dhe nr. 542 date 06.07.2022, nr. 644 date 28.07.2022, nr. 708 date 08.08.2022, nr. 737 date 22.08.2022, nr. 885, nr. 886, nr. 8887 dhe nr. 888 date 28.09.2022, nr. 900 date 04.10.2022, nr. 981, 982, 983 date 21.10.2022, nr. 985 date 24.10.2022, nr. 1036 date 08.11.2022.

Pavarësisht aplikimeve të kryera pranë ASHK Elbasan, pasuritë e paluajtshme të Bashkisë dhe njërive administrative pjesërisht janë certifikuar me dokument që shpreh titull pronësie, madje grafiku i regjistrimit të tyre është në rënie nga viti i mëparshëm, konkretisht: Për vitin 2021 janë pajisur me certifikate pronësie 81 Pasuri Paluajtshme, ndërsa për 5 njësi administrative janë pajisur me certifikate pronësie 44 Pasuri.

- **Për Bashkinë Elbasan për vitin 2022 janë pajisur me certifikate pronësie 22 Pasuri** Paluajtshme, ndërsa nuk ka për njësi administrative. Në mënyrë të zbrërthyer 22 pasuritë e paluajtshme të regjistruara për vitin 2022 në ASHK, paraqiten: 15 apartamente, 1 zyrat arsimore, 5 pasuri e llojit are (vjen nga shpronësimet e privateve me interes publik, varreza publike) dhe 1 pasuri llojit truall me sipërfaqe 4,355 m2, Me hollësisht sipas aneksit nr. 11.

### **Prona të paregjistruara.**

**Bashkia Elbasan paraqet 10,086 prona pa certifikate pronësie deri me 31.12.2022:**

\* *Bashkia Elbasan paraqet 3,508 prona pa certifikate pronësie,*

\* *12 Njësiti Administrative paraqesin 6,578 prona pa certifikate pronësie.*

Drejtoria e aseteve dhe Bashkia Elbasan nuk disponon shkresa në drejtim të ASHK, për zgjidhjen e problemit të regjistrimit pasurisë saj, pasi ky proces është neglizhuar dhe nuk ka ecur periodikisht krahasuar me aplikimet e bëra. Pa mohuar punën e bërë (*dhe pavarësisht pengesave dhe vonesave nga ASHK në regjistrimin e pasurive paluajtshme, nën pretekstin se disa zona janë të pazhurnuara, disa pasuri kanë mbivendosje, pasaktësi në të dhëna dhe problematika tjera*), funksionimi i drejtorisë aseteve Bashkisë nuk ka qene në nivelin e duhur në drejtim të pajisjes me dokument pronësie të 10,086 pronave paluajtshme saj, të cilat nuk janë regjistruar pranë kadastrës. Drejtoresha Aseteve e strehimit znj. A.S, përgjegjësi z. G.P, specialistet znj. A.B dhe znj.

**Titulli gjetjes:** Mos pajisje me certifikate pronësie të 10,086 pronave të Bashkisë Elbasan.

**Situata:** Nga auditimi i Aseteve të Bashkisë Elbasan, rezulton se Drejtoria e aseteve nuk ka pajisur me dokument pronësie 10,086 prona të paluajtshme, të cilat nuk janë regjistruar pranë ASHK, nga këto: *Bashkia 3,508 prona dhe 12 Njësiti Administrative 6,578 prona pa certifikate pronësie, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 20/2020 “Për kadastrën”.* Drejtoria e Aseteve nuk disponon shkresa në drejtim të ASHK, për zgjidhjen e problemit të regjistrimit pasurive të saj, pasi ky proces është neglizhuar dhe nuk ka ecur periodikisht krahasuar me aplikimet e bëra.

- Drejtoria e Aseteve nuk ka regjistruar në kontabilitet 22 prona paluajtshme pajisur me certifikate pronësie në 2022 (*15 apartamente, 5 are, 1 truall dhe 1 ish-zyre arsimore*), sipas aneksit 11 pika 3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit në kundërshtim me Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, I ndryshuar.

**Kriteri:** ligji nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

**Ndikimi:** ndikim tek asetet, pasi pronat janë pa dokument që shpreh titull pronësie.

**Shkaku:** Mos bashkëpunimi institucional, neglizhenca dhe pengesa artificiale tjera.

**Rekomandim:** Bashkia Elbasan të marrë masa për regjistrimin e 10,086 pronave të saj, krijimin e regjistrimit pronave, pajisjen e tyre me certifikatë pronësie, duke bashkëpunuar me institucionet tjera si dhe regjistrimin në kontabilitet 22 prona paluajtshme, pajisur me certifikate pronësie në vitin 2022 (*15 apartamente, 5 are, 1 truall dhe 1 ish-zyre arsimore*), sipas aneksit 11 pika 3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

***Sa sipër, Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. G.LL Kryetar i Bashkisë, znj. A.B Zv/Kryetare Bashkisë dhe nëpunës autorizues, znj. A.M drejtore e financë- buxhetit dhe nëpunës zbatues, z. I.S zv/kryetar Bashkisë, znj. V.L zv/kryetare, z. A.Q zv/kryetari, znj. A.S drejtoresha e aseteve, z. G.P përgjegjës i aseteve, znj. A.B dhe znj. A.P specialiste e aseteve, z. S.M DPSHI, z. T.S DPSHU, z. S.B, I.Sh dhe B.L supervizor i pastrimit, E.H, G.P, z. A.M ing. investimesh, z. A.H drejtori juridik.***

## **II. AGJENSIA E SHERBIMEVE PUBLIKE ELBASAN (ASHP)**

### **Banka.**

Auditimi me zgjedhje mbi veprimet e bankës të ASHP Elbasan kryhet për vitin 2022, bazuar në programin e auditimit, rezultoi: Për periudhën e audituar veprimet e kryera nëpërmjet bankës janë të dokumentuara me urdhërpagesat përkatëse, të nënshtruara nga nëpunësi zbatues dhe janë konfirmuar nga dega e thesarit të rrethit. Urdhër shpenzimet mbajnë numra rendor progresiv dhe veprimet ekonomike janë hedhur rregullisht në ditarin e bankës dhe ditarin e shpenzimeve sipas

nën zërave përkatës. Vlera e urdhër shpenzimeve të likuiduara përputhet me vlerën e detyrimit për shërbimet dhe mallrat e kontraktuara. Urdhër pagesat, kishin bashkëlidhur dokumentacionin justifikues sipas natyrës së shpenzimit si: dokumentacionin e procedurave të prokurimit, kontratat, faturat tatimore për shitje, proces-verbale të marrjes në dorëzim të mallit, flete-hyrjet e mallit në magazinë etj. Veprimet e bankës janë kontabilizuar, azhurnuar periodikisht në ditarin përkatës. Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët. Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si: urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklarimet e tatimit mbi ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Likuidimet në përgjithësi janë të shoqëruara me dokumentacion justifikues. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve. Llogaritë janë në pozicionin e duhur në përputhje me kërkesat ligjore, sipas kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin” ndryshuar me ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë Qeverisjes Përgjithshme”, i ndryshuar dhe me Udhëzimet Ministrisë Financave. Nga **auditimi i ASHP Elbasan me zgjedhje të veprimeve të bankës 2022**, rezultoi se:

**1. ASHP për vitin 2022 ka likuiduar 20 punonjës të përkohshëm** mbi organike, në mënyrë pa justifikuar dhe pa ngarkesë pune, pasi: shërbimi i ujitjes dhe kullimit gjatë sezonit ujitjes është detyrë e sektorit “*agronomik, ujitje kullim*” prej 24 veta i miratuar në organike, dhe 12 njësi administrative të 12 fshatrave si dhe bordin e kullimit. Gjithashtu këta 20 punonjës janë difinitiv dhe jo provizorë, sepse mbulojnë afërsisht gjithë vitin 2022 (mars-dhjetor).

\* ASHP për vitin 2022 ka likuiduar 83 milion lekë **punonjës roje** për sigurinë fizike të objekteve ndërtesave, aseteve, makinerive renda, me punonjës shërbimi e sistem vëzhgimi, rezultoi se: ky zë përbën shpenzime të larta ose 35 % e totalit shpenzimeve operative, çka mund të reduktohej në numër dhe në vlerë me të ulët dhe me të leverdishme, konkretisht: sipas kontratës date 23.07.2018 janë likuiduar 1154 cope kamera dhe aksesori tjerë për vlerën rreth 5,873,693 lekë sipas urdhër shpenzimit nr. 19 date 10.02.2022, çka tregon se aplikimi me kamera sigurië minimizon rojet fizike, në fakt ka ndodhur e kundërta. Këtij zëri i është shtuar edhe ruajtja e 4 mjeteve renda parkuar në objekt, sipas kontratës nr. 519 date 09.06.2022 për 5 mujin 2022 likuiduar 994,844 lekë.

**2. Në 4 raste**, u konstatuan **vonesa për likuidimin e faturave** (nr. 91/gusht, nr. 100/shtator, nr. 109/ tetor të vitit 2021 të “U shpk”, sipas urdhër shpenzimeve nr. 21, nr. 22, nr. 23 date 10.02.2022, nr. 88 datë 11.05.2022), ku mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj operatorit ekonomik bie në kundërshtim me nenin 52 ligjit 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” ndryshuar, me UMF 5 datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve prapambetura”, me Udhëzimin plotësues pikat 82-91 “Detyrimet prapambetura Njësive Vetëqeverisjes Vendore”.

Neni 52: *Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik.*

**3. ASHP Elbasan ka likuiduar OSHE për vlerën 536,678 lekë për kamat vonesa energjisë elektrike** të papaguar për periudhën **para Qershorit 2022**, sipas urdhër shpenzimeve 164 datë 15.08.2022, **ne vend të personave përgjegjës që kanë shkelur afatet ligjore**. Mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj operatorit ekonomik FSHU është në kundërshtim me nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, me UMF nr. 5, datë

27.12.2014 “Për shlyerjen detyrimeve prapambetura”, me Udhëzimin plotësues “Për buxhetin vitit”, pikat 82-91 “Detyrimet prapambetura Njësive Vetëqeverisjes Vendore”.

**4. ASHP për vitin 2022 ka kryer shpenzime për vlerën 2,000,000 lekë, për qira objekti privat 176 m2 për strehimin e qenve endacake, sipas urdhër shpenzimit nr. 127 date 01.07.2022, nr. 288 date 07.12.2022, e tjerë dhe kontratës nr. 856/11 date 29.04.2022 me afat 1 vit, me nga 50,000 lekë/ muaj, nënshkruar nga 2 palët: subjekti Besnik Nasufi dhe zj. A.B për Bashkinë, miratuar ne KB dhe konfirmuar ne Prefekturë, rezulton se:**

**a.** shpenzimi nuk duhej kryer për strehimin e qenve endacake, pasi prioritet dhe interes publik është strehimi i qytetareve te pa strehe.

**b.** Ndaj qenve endacake duhej ndjekur standardet për këtë lloj kafshësh dhe praktikat e aplikuara ne bashkitë tjera simotra.

**5. ASHP ka likuiduar 332,280 lekë një subjekt sipas urdhër shpenzimit nr. 142 date 21.07.2022, për blerjen e 5 pompave zhytëse dhe elektrike për nevoja te saj, rezulton se: komisioni i blerjeve disponon oferta testim tregu te parregullta (korrigjuar çmimet) pra konkurrimi ka qene formal, ne kundërshtim me nenin 36 te UMF 30 datë 27.12.2011“Për menaxhimin aktiveve njësitë sektorit publik” dhe me VKM 285 date 19.05.2021 “Për miratimin rregullave prokurimit publik”. Subjekti fizik “A.B ” ka përfituar padrejtësisht **55,380 lekë TVSH** e “pajisjeve hidraulike ” pasi vlere e TVSH është përfshire bashke me çmimin e blerjes pajisjeve hidraulike dhe nuk është ndare veças, veprim ndesh me UKM 2 datë 08.05.2003 “Për klasifikimin e strukturën kostos punimeve ndërtimit”.**

**Titulli gjetjes:** ASHP Elbasan paraqet disa raste shkelje teknike ne shërbimet dhe blerjet e vogla me efekte me vlere te ulet, përkatësisht: *punësim punonjësve përkohshëm* pa ngarkesë pune, *numër i shumte i rojeve te objekteve* me efekt negativ ne shpenzimet operative, *vlere 536,678 lekë kamat vonesa* energjisë elektrike, *kontratë qirasë për strehimin qenve endacake* e pajustificuar për 2 milion lekë, *përfitim 2-here tvsh* për “pajisjet hidraulike” vlere 55,380 lekë tvsh dhe *oferta parregullta* në 2 blerje vogla (*minikoshat dhe pompa uji*).

#### **SITUATA:**

Nga auditimi i shpenzimeve të Agjensia Shërbimeve Publike Elbasan për vitin 2022, janë konstatuar parregullsi në buxhetin e saj, si vijon;

**a.** Shpenzimet për paga pasqyrohen ne vlerën 143,382,507 lekë, me një organike prej 295 punonjës dhe 19 punonjës përkohshëm me fond page 3,114,082 lekë.

- Për disa punonjës për pozicionet e punës që mbulojnë, paraqitet mospërputhje me ngarkesën e punës tyre, pasi nuk e justifikojnë me dokumente dhe programe pune.

- Për 5 sektor numri i stafit drejtues-profesional rezulton i barabarte dhe në 1 rast më i madh se numri punonjësve, në vend që të ndodhte e kundërta.

Sa sipër, konkretisht:

\* sektori juridik e personeli prej 13 veta: 1 përgjegjës, 1 protokollues, 1 sekretare, 2 specialiste, 8 shofere, ose më shumë shofere se stafi drejtues-specialiste.

\* sektori mirëmbajtje rrugës qytet 23 veta: 1 përgjegjës, 2 teknik, 2 specialist, 12 punëtor, 6 shofer, pra numri punëtoveve i përafërt me numrin stafit drejtues-teknik-shofer.

\* sektori i ndriçimit, sinjalistikes dhe dekorit 17 veta: 1 përgjegjës, 2 specialiste, 4 teknik, 8 punëtor, 2 shofer, ose numri i punëtoveve është i barabarte me numrin stafit drejtues-teknik.

\* sektori agronomik, ujitje kullim 24 veta: 1 përgjegjës, 1 teknik, 3 specialiste, 10 agronom, 6 punëtor, 3 shofer, ose me shume agronome se specialistë e punëtorë,

\* sezonale prej 20 veta.

**b.** Shpenzimet operative prej 233,540,891 lekë janë me të larta se shpenzimet për paga 143 milion lekë. Shpenzimet operative prej 233 milion zëne 50 % ndaj shpenzimeve gjithsej 466 milion. Peshën kryesore e zëne 3 zëra shpenzimesh për 202 milion lekë ose 86 % ndaj totalit, përkatësisht: shpenzimet për roje 35 %, shpenzimet energjisë elektrike 33 % dhe shpenzimet për automjetet 18

% Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitë publik”.

**Kriteri:** ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitë publik”, VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave prokurimit publik”. UKM 2 datë 08.05.2003 ,“Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

**NDIKIMI:** Shkelje në blerje e shërbime të vogla dhe me efekte me vlera ulëta.

**SHKAKU:** Neglizhenca.

**Rekomandim:** ASHP Elbasan të marre masa:

Nga Agjensia Shërbimeve Publike Elbasan të marre masa:

a. Për rishikimin dhe shkurtimin e organikes për disa sektorë dhe të shmang punonjësit e përkohshëm, me qëllim vendosjen e një raporti të drejte midis numrit të punëtorëve me stafin drejtues-tekniko-profesional si dhe me ngarkesën e punës.

b. Për uljen e shpenzimeve operative, veçanërisht shpenzimet për roje, shpenzimet energjisë elektrike dhe shpenzimet për automjetet, në mënyre që të vendoset një raport i drejte midis shpenzimeve operative me shpenzimeve për pagat, duke realizuar kështu efektshmerinë dhe eficienten e tyre.

### **Magazina**

Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si flet-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë. Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara. Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

### **Inventarizimi i pasurisë.**

-Për vitin 2022 për inventarizimin e institucionit, titullari i institucionit ka ngritur komisionin e inventarizimit fizik. Komisioni kanë kryer inventarizimet, fletët e inventarizimit ishin plotësuar në gjithë ekstremitetet e tyre, dhe ishin nënshkruar nga anëtarët e komisionit dhe personi përgjegjës që i kishte në ngarkim, sipas kërkesave të pikës 82 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Janë inventarizuar kartelat personale për materialet dhe pajisjet që kanë në ngarkim sipas zyrave dhe sektorëve, ku nuk kanë rezultuar diferenca, dhe flet-inventari është nënshkruar nga 2 palët komisioni dhe personi përgjegjës. Janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre si: viti i krijimit, shtesat dhe pakësimet për to, pra është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara, sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të pasur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me kap III pika 30 të UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Financa ka përpiluar gjendjen kontabël të aktiveve, mjeteve e materialeve qarkulluese sipas llojit tyre duke i grupuar sipas llogarive përkatëse. Gjate fazës së inventarizimit rezultoi se në fillim është përcaktuar numri rendor i fletëhyrjes dhe fletëdaljes së fundit në procesverbalet e komisionit para fillimit të inventarizimit, në përputhshmëri me pikën 83 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publik”. Në përfundim inventarizimit nuk kanë rezultuar diferenca dhe komisioni ka bërë relacion kryetarit institucionit për inventarizimin fizik pasurisë, bazuar në kërkesat e pikës 87, 88, 89,90, 91 dhe 92 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” .



### **Nxjerrjet jashtë përdorimit.**

-Për vitin 2022 ASHP ka ngritur komisionin e përbërë nga 5 veta sipas urdhrit 61 date 30.11.2022, për inventarizimin e pasurisë dhe për vlerësimin e materialeve për nxjerrjet jashtë përdorimit. ASHP ka bërë relacion nr. 179 date 13.02.2023 në Këshillin Bashkiak për vlerësimin e materialeve për nxjerrjet jashtë përdorimit, sipas llogarive dhe fletëdaljeve për vlerën 20,436,803 lekë, sa vijon:  
-llogaria 212 për vlerën 2,543,399 lekë, sipas fletëdaljes nr. 929 date 30.12.2022,  
-llogaria 214 për vlerën 15,027,680 lekë, sipas fletëdaljes nr. 930 date 30.12.2022,  
-llogaria 218 për vlerën 1,001,004 lekë, sipas fletëdaljes nr. 931 date 30.12.2022,  
-llogaria 327 “objekte inventari” 1,864,720 lekë, sipas fletëdaljes nr. 932 date 30.12.2022.

Në bilancin 2022 të ASHP nxjerrjet jashtë përdorimit pasqyrohen për vlerën 18,572,083 lekë tek pasqyra financiare aneksi formati 7/a, ku diferenca 1,864,720 lekë (20,436,803- 18,572,083) justifikohet me llogarinë 327 “objekti inventari” në përdorim si (veshmbathje policisë Bashkiake, rroba pune, goma, karroca, çelësa e prizat dhe materiale në përdorim në kartelat personale etj). Në asgjësimin e materialeve të listuar pasqyrohet viti blerjes dhe amortizimi i plotë sipas viteve dhe tarifave ligjore. Në asgjësimin e materialeve të listuar pasqyrohet mënyra e asgjësimit shoqëruar me foto sipas artikujve dhe pajisjeve ndryshme. Inventarizimi dhe nxjerrjet jashtë përdorimit të materialeve është kryer sipas udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

**Sa sipër**, Mangësitë e mësipërme të konstatuara në ASHP Elbasan bëjnë përgjegjës z. E.P Drejtor i ASHP Elbasan, zj. L.T përgjegjëse e financës.

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Bashkia Elbasan, ka paraqitur observacionin nr. 4474/45 prot., datë 22.11.2023, protokolluar KLSH nr.767/4 prot., datë 30.11.2023, pretendojnë, si më poshtë:

#### **I. Pretendimi i subjektit: Bashkia Elbasan.**

*Observacionet e Bashkisë Elbasan për pasqyrat financiare, pika 3 e programit, thotë:*

- Për pushimet vjetore të vitit 2022 të paguara janë sipas kërkesave të VKM 568/6.10.2021,
- Për formatin 2 dhe 8 se janë pasqyruar dhe kuadrojnë për 6 punonjesit provizor,
- Për justifikimin e gjendjes së lartë në duart e agjenteve terrenit në fund të vitit 2022 të letrave me vlerë (biletat, pullat, vërtetime e tjerë),
- Për justifikimin e vlerës 2,508,627 lekë B shpk, nën pretekstin se ka padi gjyqësore.
- Për sqarimin e vlerës 1,212,610 lekë të subjektit E shpk, se ajo ndahet në 2 subjekte, përkatësisht: subjekti “E” shpk debitor për vlerën 658,590 lekë dhe subjekti “E” shpk debitor për vlerën 554,020 lekë ( thuhet se është arkëtuar në 2023),
- Për justifikimin e dietave në Budva për 1,120,359 lekë nën pretekstin e shkëmbimeve kulturore historike, me pjesëmarrjen e 50 vetave dhe KB.
- Për pastrimin e mbetjeve urbane,
- Për 3 mjetet me qira,
- Për TVSH përfituar 2 here, për OSHE, për blerjet e vogla.

#### **Qëndrimi i grupit auditimit:**

*Vlerësojmë përmbajtjen e observimeve të Bashkisë Elbasan.*

**Observacionet e Bashkisë Elbasan qëndrojnë dhe merren parasysh duke u reflektuar në projekt raportin auditimit, konkretisht për 3 çeshtje:**

- \* Per kuadrin pasqyrimit në formatin 2 dhe 8, lidhur me vlerën e 6 punonjesvet provizor.
- \* Për arsyet e gjendjes lartë të letrave me vlerë në fund 2022 tek agjentet e terrenit.
- \* Për sqarimin e vlerës 1,212,610 lekë se ajo ndahet në 2 subjekte, përkatësisht: subjekti “E” shpk 658,590 lekë dhe “E” shpk 554,020 lekë (ndërsa arkëtimi i kësaj të fundit në 2023 është objekt i zbatimit rekomandimeve që do kryhet në një periudhë të mëvonshme),

**Observacionet qëndrojnë pjesërisht, konkretisht për 4 raste:**

- \* *Observacionet lidhur me pastrimin e qytetit qëndrojnë pjesërisht (pa prekur vlerat) dhe merren parasysh pjesërisht ,sipas reflektimit ne projekt raportin e auditimit.*
  - \* *Observacionet lidhur me disa mangësi ne dokumentacionin plotësues (tjera) dhe blerje vogla qëndrojnë pjesërisht dhe merren parasysh.*
  - \* *observacione për probleme tjera teknike ose të vogla sistemohen dhe nuk rekomandohen.*
  - \* *Për OSHE, për blerjet e vogla, i qëndrojmë pjesërisht trajtimit tone në akt konstatimin 3.*
- Observacionet qe nuk qëndrojnë dhe nuk merren parasysh, konkretisht për 5 ceshtje:**
- \* *Për lejet zakonshme 2022 te paguara, pasi pika 8 te VKM 568/2021 thotë: përjashtuar rastet e përfundimit marrëdhënieve punës dhe kryerja e pushimeve është e pamundur, ku ne fakt është e mundur sepse është brenda afatit kohor ligjor për kryerjen e tyre.*
  - \* *Për vlerën debitorë 2,508,627 lekë ndaj subjektit “B shpk”, pasi padia gjyqësore nuk pengon ekzekutimin e shumës debitorë, por vendimi i formës prere.*
  - \* *Për dietat ne Budva për 1,120,359 lekë, pasi i qëndrojmë akt konstatimit nr. 3, por do te trajtohet si mos efektivitet shpenzimesh pasi është pa shprese arkëtimi për 50 punonjës, sepse janë me urdhër të eprorit Bashkisë.*
  - \* *Për 3 mjetet me qira, pasi qëndron se mjetet janë te vjetra, por nuk ka munguar riparimi i tyre, çka bie ndesh me marrjen me qira te mjeteve tjera sidomos vlere e larte e tyre, pra i qëndrojmë akt konstatimit nr. 3.*
  - \* *Për TVSH përfituar 2 here, nuk ka lidhje komenti juaj, pasi bën fjale për moszbatim te UKM nr. 2, datë 08.05.2003 vetëm për pajisjet e aparateve hidraulike, elektrike e tjerë, ku duhej ndare ne fund te situacionit vlere e pajisjes pa tvsh dhe me tvsh dhe ne fund vendoset TVSH për gjithë zërat, çka nuk është bere. Ky standard është ngritur me përpara ne gjitha bashkitë dhe është pranuar dhe zbatuar rekomandimi përkatës.*

## **II. PRETENDIMI I SUBJEKTIT: ASHP ELBASAN.**

*Observacionet e ASHP Elbasan për pasqyrat financiare, pika 3 e programit, thotë:*

- *Punonjësit përkohshëm janë miratuar me VKB 117 date 14.12.2021 dhe çdo vit i kontraktos Bashkia për ti shërbyer sektorit Agronomik-Ujitje-Kullim gjatë sezonit ujitjes.*
- *observacioni për ceshtjet tjera të ngritura, për blerjet e vogla , konkurimin, ofertat, konfliktin e interesit, tvsh etj.*

### **Qëndrimi i grupit auditimit:**

- *Nuk qëndron observacioni për 20 punonjësit e përkohshëm, nen pretekstin se i shërbejnë Ujitje-Kullimit gjatë sezonit ujitjes, pasi këtë shërbim e ka detyre sektori “agronomik, ujitje kullim” prej 24 veta i miratuar ne organike si dhe marrja e 20 punonjësve përkohshëm nxjerre jashtë funksioni sektorin agronomik-Ujitje-Kullim, 12 njësite administrative dhe bordin e kullimit, madje këta punonjës janë definitiv pasi mbulojnë gati gjithë vitin (mars-dhjetor 2022),*
- *Qëndrojnë pjesërisht observacioni për ceshtjet tjera të ngritura dhe vlerësojmë përmbajtjen e tyre. Për rrjedhoje vërejtjet janë sistemuar për ata që qëndrojnë, ndërsa për ata qe nuk qëndrojnë mbeten duke bere ndonjë shkurtim ose mos pasqyrim tek rekomandimet, për rastet teknike pa peshe( inventarizime, nxjerrje j/përdorimi etj).*

## **4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.**

### **4.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.**

Nga auditimi ka rezultuar se, janë hartuar regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022. Mbas miratimit në sistem të regjistrit nga APP, me shkresa përcjellëse janë dërguar në Degën e Thesarit, regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitet objekt auditimi mbështetur në VKB përkatëse "Mbi miratimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Elbasan". Gjithashtu në të gjitha rastet e shtesave dhe pikësimeve është dërguar regjistri përkatës. Në këto regjistra janë pasqyruar shtesat dhe ndryshimet e bëra sipas VKB –ve përkatëse, në përputhje me VKM nr. 285

datë 19.05.2021 “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik”, është bërë brenda afateve të përcaktuara.

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Elbasan (regjistrat e parashikimit dhe realizmit), për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

**Tabela nr. 1. Të dhënat mbi regjistrin e realizmit të procedurave periudha 01.01.2022 – 2022, në lekë**

Lloji i procedurës	Nr. Proc	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	Fondi total i kursyer pa TVSh	% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit
Viti 2022					
Procedurë e hapur;	9	618,809,473	562,764,805	56,044,668	9%
Procedurë e hapur e thjeshtuar	23	80,773,744	73,756,762	7,016,982	9%
Procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;	1	4,586,535	4,526,000	60,535	1%
Shërbim konsulence;	1	13,691,110	13,691,110	0	0
<b>SHUMA</b>	<b>34</b>	<b>717,860,862</b>	<b>654,738,677</b>	<b>63,122,185</b>	<b>9%</b>

**Burimi** i të dhënave: Bashkia Elbasan punoi grupi i Auditimit.

Në mënyrë të detajuar procedurat e zhvilluara nga Bashkia Elbasan së bashku me ndërmarrjen e varësisë ASHP si vijon:

**Procedurat e prokurimit të audituara për vitin 2022 janë si më poshtë vijon:**

1. Të dhëna mbi objektin e prokurimit: “Rikonstruksion i shkollës mesme Kostandin Kristoforidhi, (rikonstruksion dhe shtesë anësore 4 kate dhe palestër)”

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i shkollës mesme Kostandin Kristoforidhi, (rikonstruksion dhe shtesë anësore 4 kate dhe palestër)”			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF- 39818-08-25-2022 Urdhri nr. 3938 prot., datë 18.08.2022	<b>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit</b> Urdhri nr. s’ka, datë 25.08.2022 1. z.O.K 2. z. E.S 3. z. A.B	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> 1. z.O.K 2. z. E.S 3. z. A.B	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 3938/2 prot., datë 25.08.2022. 1. znj A.M 2. z. K.H 3. z. Y.K
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 130,818,929 lekë	<b>5. Oferta fituese, vlera fituese:</b> Operatori Fitues: “B.N ” Sh.p.k 119,492,640 lekë pa tvsh.		<b>6. Diferenca me fondin limit</b> 11,326,289 lekë pa tvsh
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 12.09.2022	<b>8. Burimi Financimit</b> Buxheti i shtetit.		<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender, <b>3 OE</b> b) S’kualifikuar <b>2 B/OE</b> , OE “BE-IS” Sh.p.k BOE “M & Sh” Sh.p.k c) Kualifikuar <b>1 B/OE</b> “B.N ” Sh.p.k
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 8 muaj</b>			
<b>10. Ankimime</b> AK-s’ka APP-s’ka KPP-s’ka	<b>11. Data e lidhjes të kontratës:</b> Nr. 3938/8 prot., datë 12.10.2022		<b>12. Përgjigje</b> Ankesës nga APP, AK apo KKP: <b>AK Ska</b>

**a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.**

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se:

***AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit” :***

Me urdhër të zv. Kryetarit (Personi i Autorizuar) të Bashkisë Elbasan znj. A.B është ngritur një komision me urdhrin nr. 3938 prot., datë 18.08.2022 “Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit 130,818,929 lekë” me objekt: **“Rikonstruksion i shkollës mesme Kostandin Kristoforidhi, (rikonstruksion dhe shtesë anësore 4 kate dhe palestër)”** Në zbatim të këtij urdhri, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga, z. O.K dhe z. A.B dhe z. E.S .

***AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit” :***

Fondet janë miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë mbi fituesit e projekteve të reja për vitin 2022 në bashkëfinancim me Bashkinë Elbasan ku MAS do mbulojë 70% të vlerës dhe bashkia 30% e cila do financohet në dy vite 2022-2023. Çmimet e vendosura janë në përputhje me VKM-në nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”.

**Mbi ndryshimin e dokumentave standarte të tenderit**

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Elbasan, bazuar në rekomandimet e bëra nga Agjensia e Prokurimit Publik, vendosi që të bëjë ndryshime në dokumentet standarte të tenderit me objekt: “Rikonstruksion i shkollës mesme "Kostandin Kristoforidhi (rikonstruksion + shtesë anësore 4-kat dhe palestër”, me fond limit 130,818,926 lekë pa t.v.sh sipas shtojcës nr. 3938/3 datë 31.08.2022.

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve të vendosura.

**Situata 1:** Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej z.O.K , E.S dhe z. A.B, të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 25.08.2022. Në lidhje me kriteret e vendosura, u konstatuar kriteret të ekzagjeruara dhe të paargumentuara. Në mënyrë të detajuar kriteret e konstatuara si të pa argumentuara paraqiten si vijon:

**Kërkesat e pikës 2.3.2 e DST** e cila kërkon ndër të tjera Liçensa profesionale **N.P - 11 A** Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike dhe **N.S - 9 A** Punime strukturore speciale *nuk është e argumentuar ligjërisht dhe për më tepër nuk është në përputhje me zbatueshmërinë dhe objektin e kontratës pasi projekti dhe preventivi i punimeve janë hartuar dhe procedohet për OE i cili do të marrë përsipër realizimin e objektit dhe kontratës së zbatimit të punimeve. Kriter i cili konsiderohet kufizues.*

**Kërkesat e pikës 2.3.4 e DST** e cila kërkon, një punësim mesatar **për periudhën Maj 2022 - Korrik 2022**, i të paktën **100** (njëqind) personave. *Kriteri për stafin mbështetës dhe për punonjësit e kërkuar, përveç se nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, konsiderohet diskrimues pasi sjell pabarazi ndërmjet OE. Referuar listës së punonjësve të kërkuar, janë rreth 39 duke filluar nga Drejtues projekti me licencën e shoqërisë si drejtues teknik, inxhinierë dhe punonjës të natyrave të ndryshme për të përmbushur detyrimet kontraktuale, ndërkohë që një numër mesatar jo më pak se 100 punonjës me kohë të plotë për periudhën Maj 2022 – Korrik 2022, që i është kërkuar OE ofertues, ndikon në kufizimin e pjesëmarrjes së tyre.*

**Kërkesat e pikës 2.3.6 e DST** e cila kërkon që Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf dhe punonjës të kualifikuar, 1 (një) Arkitekt dhe 4 (katër) Shofere;

**1.** *Kërkesa për arkitekt në këtë procedurë nuk është e argumentuar ligjërisht dhe për më tepër nuk është në përputhje me zbatueshmërinë dhe objektin e kontratës pasi projekti dhe preventivi i punimeve janë hartuar dhe procedohet për OE i cili do të marrë përsipër realizimin e objektit dhe kontratës së zbatimit të punimeve. Kriter i cili konsiderohet kufizues.*

**2.** *Kërkesa e pikës 2.3.6 e DST e cila kërkon nga OE të kenë të punësuar minimalisht 4 shofere është kërkesë e paargumentuar teknikisht dhe jo në përputhje me numrin e mjeteve të rënda për të cilën kërkohen shofer. Konkretisht, në pikën 2.3.10 të DST, kërkohet 2 Automjete vetëshkarkuese me mase maksimale të autorizuar 7.5-18 ton, 2 Automjete vetëshkarkuese me mase maksimale të*

autorizuar mbi 18 ton, 2 Autobetoniere, 2 Kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5-5 Ton, 1 Kamion vinç dhe 1 Autobot uji. Sa më sipër, kërkesa për 4 shofer nuk përputhet me mjetet e kërkuar.

**Kërkesat e pikës 2.3.7 e DST** e cila kërkon që Operatori ekonomik të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikate “Përgjegjës për dëmet në mjedis” Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish për ekspërt mjedisi në lidhje e në funksion të objektit të kontratës.

**Kërkesat e pikës 2.3.8 e DST** e cila kërkon që Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim i mbetjeve jo te rrezikshme” ose të ketë kontrate shërbimi noteriale për objektin konkret me shoqëri të licencuara. *Këto kërkesa për licenca nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërish në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës. Nuk është e nevojshme licenca e mësipërme, pasi shërbimin e grumbullimit të mbetjeve e ofron Bashkia Elbasan dhe për subjektet që kryejnë punime ndërtimit aplikon tarifën ndotjes, shërbimit, për kohëzgjatjen e kantierit të ndërtimit.*

**Kërkesat e pikës 2.3.10 e DST** e cila kërkon që Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. 2 Automjete vetëshkarkuese me mase maksimale të autorizuar 7.5-18 ton, 2 Automjete vetëshkarkuese me mase maksimale te autorizuar mbi 18 ton, 2 Eskavator me goma, 1 Minieskavator me goma dhe 1 Fadrom me goma. *Ky kriter për makineritë nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish pasi mungon përlllogaritja dhe analiza, nuk argumentohet diferenca e vogël në kapacitetin e kërkuar. Kërkesat me diferenca minimaliste nuk i shërbejnë AK, por mund të përbejnë kufizim për OE.*

Gjithashtu theksojmë se transportimi i materialeve hidraulike, elektrike, pllakave, gërmim dheu, etj ... nuk do të kryhet brenda të njëjtës ditë, pasi janë punime të cilat shtrihen në kohë të ndryshme dhe në këto kushte një kamion/kamionçinë mund të kryej disa rrugë dhe të realizohet qëllimi, referuar grafikut dhe preventivit të punimeve

**Kërkesat e pikës 2.3.11 e DST** e cila kërkon që operatorët ekonomike duhet të kenë në pronësi/kontrate qereje/kontrate furnizimi 1 (një) fabrike betoni, e cila duhet te jete e pajisur me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për të cilën duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qerese/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B.

**Kërkesat e pikës 2.3.12** e cila kërkon që operatorët ekonomike duhet të kenë në pronësi/kontrate qereje/kontrate furnizimi 1 (një) fabrike të prodhimit të elementeve të betonit - bordurave dhe pllakave, e cila duhet të jete e pajisur me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për të cilën duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qerese/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B.

Kriteret e vendosura në kërkesat e pikës 2.3.11/12 nuk janë të argumentuar teknikisht dhe ligjërish pasi në rastet kur fabrika e betonit - elementeve të betonit - bordurave dhe pllakave nuk janë në pronësi të ofertuesit rezulton se kërkesa për paraqitjen me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për te cilën duhet te paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qerese/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, u drejtohet personave të tretë që nuk janë konkurrent në këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës” .

Sa më sipër mbanë përgjegjësi njësin e prokurimit me përbërje z. O.K , z. A.B dhe z. E.S.

**b.Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.**

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. s'ka të datës 21.09.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	"B.N" sh.p.k me Nipt: K.....O	119,492,640	<b>Kualifikuar</b>
2	"BE-IS" sh.p.k me Nipt: K.....A	129,268,270	<p><b>S'kualifikuar</b></p> <p>1. Nuk keni paraqitur kontrate noteriale furnizimi me prodhuesin/t ose distributorin/ët zyrtare te tyre për furnizimin me produktin "Kamera" duke mos përmbushur kërkesën e parashikuar ne pikën 2.3.14 te kapacitetit teknik, te kritereve te veçanta për kualifikim ku kërkohet:</p> <p><i>2.3.14 Ne përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit përkatës te publikuar ne SPE, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkëpunimi/furnizimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë produktin KAMERA. Në rast paraqitjeje te autorizimit nga Distributori duhet te paraqitet dokumentacioni qe verteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit te autorizuar.</i></p> <p>2. Nuk keni paraqitur raport analizimi për produktin "Bojë për lyerjen e godinave" duke mos përmbushur kërkesën e parashikuar ne pikën 2.3.15 te kapacitetit teknik, te kritereve te veçanta për kualifikim ku kërkohet:</p> <p>Nuk keni paraqitur katalogë nga prodhuesi/distributor i autorizuar,deklarate konformiteti EN 303-5:2012 ekuivalente/barazvlefshme nga nje laborator i autorizuar për pajisjet e ngrohjes, të cilat duhet të jenë të çertifikuara sipas standarteve ISO 9001: 2015 mbi "Sistemet e menaxhimit të cilësisë", e vlefshme, ose ekuivalente/e barazvlefshme, duke mos përmbushur kërkesën e parashikuar ne pikën 2.3.16 te kapacitetit teknik, te kritereve te veçanta për kualifikim ku kërkohet:</p> <p><i>2.3.16 Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit përkatës, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrate bashkëpunimi/furnizimi noteriale,për pajisjet e ngrohjes, pajisjur me katalogë nga prodhuesi/distributor i autorizuar,deklarate konformiteti EN 303-5:2012 ekuivalente/barazvlefshme nga nje laborator i autorizuar për pajisjet e ngrohjes, të cilat duhet të jenë të çertifikuara sipas standarteve ISO 9001: 2015 mbi "Sistemet e menaxhimit të cilësisë", e vlefshme, ose ekuivalente/e barazvlefshme. Në rast paraqitjeje te autorizimit nga Distributori duhet te paraqitet dokumentacioni qe verteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit te autorizuar.</i></p>
3	BOE "M." sh.p.k me Nipt: L.....C & "SH." sh.p.k me Nipt: K.....N	107,303,679	<p><b>S'kualifikuar</b></p> <p><u>1. Subjekti "M. " sh.p.k. ka marrë përsipër që të kryejë 40 % të të gjitha llojeve të punimeve sipas preventivit.</u></p> <p>Në pikat 2 dhe 3 të nenit 88 të VKM 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, parashikohet se:</p> <p>2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet</p>

		<p>së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.</p> <p>3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.</p> <p>2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf dhe punonjës të kualifikuar, si mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 (një) inxhinier Mekanik</li> <li>• 1 (një) inxhinier Elektronik</li> <li>• 1 (një) Hidroizolues</li> </ul> <p>Në pikat 2 dhe 3 të nenit 88 të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:</p> <p>2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.</p> <p>3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.</p> <p>2.3.7 Operatori ekonomik të ketë në stafin e tij:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 2 (dy) punonjës/specialistë të çertifikuar për “<i>Punime në lartësi</i>”, sipas VKM-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, e dhënë nga një organizëm i licencuar çertifikimi shqiptar ose i huaj.</li> </ul> <p>Sa më sipër, në përputhje me zërat e punimeve që keni marrë përsipër të kryeni, nuk keni deklaruar ne shtojcën 8 të vetëdeklarimit/nuk keni paraqitur asnjë dokumentacion që te vertetoje se dispononi mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës, duke mos përmbushur kërkesën e parashikuar ne piken 2.3.10 te kapacitetit teknik, te kriterëve te veçanta për kualifikim e konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>1 Minieskavator me goma</li> <li>1 Fadromë me goma</li> <li>1 Kamionçinë me kapacitet mbajtes 3.5-5 Ton</li> <li>1 Aparat topogjeodezik me GPS</li> <li>1 Pompë suvatimi</li> <li>1 Nivelues Helikopter</li> <li>1 Mjet APV me kosh</li> <li>Skeleri</li> <li>1 Tranxh Hekuri</li> <li>1 Gazogjen/Aparat Gazogjen</li> </ul> <p>2.3.12 Operatoret ekonomike duhet të kenë në pronësi/kontrate qereje/kontrate furnizimi 1 (një) fabrike te prodhimit te elementeve te betonit - bordurave dhe pllakave, e cila duhet te jete e pajisur me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për te cilën duhet te</p>
--	--	--

		<p>paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qerases/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B.</p> <p>Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetë deklaramit.</p> <p>Dokumentacioni provues, që OE i disponon mjetet e mësipërme, do të dorëzohet nga operatori ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.</p> <p>2.3.13 Ne përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin përkatës të publikuar ne SPE, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkëpunimi/furnizimi nga prodhuesi/distributori, për produktin Hekur.</p> <p>Në rast paraqitjeje te autorizimit nga Distributori duhet te paraqitet dokumentacioni qe vërteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit te autorizuar.</p> <p>2.3.14 Ne përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit përkatës të publikuar ne SPE, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkëpunimi/furnizimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë produktin KAMERA. Në rast paraqitjeje te autorizimit nga Distributori duhet te paraqitet dokumentacioni qe vërteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit te autorizuar.</p> <p>2.3.16 Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit përkatës, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrate bashkëpunimi/furnizimi noteriale, për pajisjet e ngrohjes, pajisur me katalogë nga prodhuesi/distributor i autorizuar, deklarate konformiteti EN 303-5:2012 ekuivalente/ barazvlefshme nga një laborator i autorizuar për pajisjet e ngrohjes, të cilat duhet të jenë të çertifikuara sipas standarteve ISO 9001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, e vlefshme, ose ekuivalente/e barazvlefshme.</p> <p>Në rast paraqitjeje te autorizimit nga Distributori duhet te paraqitet dokumentacioni qe vërteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit te autorizuar.</p> <p><b>1. Subjekti "SH. " sh.p.k. ka marrë përsipër që të kryejë 60 % të të gjitha llojeve të punimeve sipas preventivit.</b></p> <p>Subjekti juaj nuk përmbush kërkesën e parashikuar ne piken 2.3.3 te kapacitetit teknik.</p> <p>Subjekti juaj ka deklaruar se drejtues teknik për realizimin e objektit do të jetë <u>ing. Mjedisi znj. S.J.</u>, e cila nuk është e angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë e pranishme gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, çka bie në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2. “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, i cili përcakton se: <i>Për vlera me vlerë të plotë të preventuar mbi 30,000,000 lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë të plotë në objekt i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.</i></p> <p>2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të cilët duhet të figurojnë në licencën si dhe listëpagesat e shoqërisë për për periudhën Maj 2022 - Korrik 2022, si mëposhtë:</p> <p>- Inxhinier Ndërtimi I(një)</p> <p>2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf dhe punonjës të kualifikuar, si mëposhtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 (një) Hekurkthyes</li> </ul>
--	--	---



			<p>në përputhje me zërat e punimeve që keni marrë përsipër të kryeni, nuk keni deklaruar ne shtojcën 8 të vetëdeklarimit/nuk keni paraqitur asnjë dokumentacion qe te vërtetojë se dispononi mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës, duke mos përmbushur kërkesën e parashikuar ne pikën 2.3.10 te kapacitetit teknik, te kritereve te veçanta për kualifikim e konkretisht:</p> <p>1 Eskavator me goma 1 Platformë Ngritese automatike me kosh</p> <p>2.3.14 <i>Ne përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit përkatës te publikuar ne SPE, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkëpunimi/furnizimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë produktin KAMERA. Në rast paraqitjeje te autorizimit nga Distributori duhet te paraqitet dokumentacioni që vërteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit te autorizuar.</i></p> <p>2.3.16 <i>Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit përkatës, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrate bashkëpunimi/furnizimi noteriale, për pajisjet e ngrohjes, pajisur me katalogë nga prodhuesi/distributor i autorizuar, deklarate konformiteti EN 303-5:2012 ekuivalente /barazvlefshme nga një laborator i autorizuar për pajisjet e ngrohjes, të cilat duhet të jenë të çertifikuara sipas standarteve ISO 9001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, e vlefshme, ose ekuivalente/e barazvlefshme.</i></p>
--	--	--	--

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 21.09.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 3 operatorë pjesëmarrës janë s’kualifikuar 2 OE, janë kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 27.09.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “**“B.N” sh.p.k me Nipt: K.....O**” për të cilën është lidhur kontrata nr. 3938/8 prot., datë 12.10.2022 për vlerën **119,492,640 lekë pa TVSH** dhe vlera **140,255,606 lekë me TVSH**, dhe me afat 8 (tetë) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

***Situata 2: Nga shqyrtimi i ofertës fituese, rezulton se OE nuk përmbush të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe konkretisht:***

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.6 të DST** e cila kërkon

- 4 (katër) Shofere
- 4 (katër) Manovrator

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i renditur në vend të parë, dhe i shpallur fitues, rezulton se referuar vetdeklarimit dhe sipas listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatami mbi të ardhurat nga punësimi OE B.N ka të punësuar në kompani 2 punonjës të profilit shofer konkretisht

1. Z.L.B i punësuar pranë Shoqërisë "B.N." Shpk me Kontrate Individuale Pune date 05.01.2022 (e rinovuar) ne rolin Shofer Manovrator pajisur me Certificate te Sigurimit Teknik (IQT) Nr.019552 date certificate 06.05.2022 date skadimi 05.05.2023 ne profesionin Manovrator dhe Deshmi Profesionale leshuar me Nr.3552 date 23 .06.2020, date lëshirni 23.06.2020 dhe date skadimi 22.06.2025 për Eskavatoriste.

2. Z. F. C. me profesion Shofer i punësuar pranë Shoqërisë "B.N" Shpk me Kontrate Individuale Pune ne date 05.01.2022 (e rinovuar) pajisur me Certificate Sigurimit Teknik Nr.001548 date

certifikate 02.03 .2022 date skadimi, O 1.03 .2023 Patente(Leje Drejtimi) dhe Certificate Aftësisë Profesionale (CAP) dhe jo 4 Shofer sic është kërkuar pikën 2.3.6 të DST.

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i renditur në vend të parë, dhe i shpallur fitues, rezulton se ka deklaruar manovratorët z. L.B i cili figurojnë në listë pagesa me Kod punësimi 8332.14 – *shofer kamioni* në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve LKP të Rishikuar”.

2. OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.10 të DST të deklaruar në shtojcën 8, si dhe për vërtetimin e disponimit të tyre ka dorëzuar dokumentacionin fizik, ku një pjesë e zotëron nëpërmjet qiramarrjes dhe një pjesë të tyre e ka në pronësi, konstatohet se për mjetet e mara me qira janë për përdorim vetiak konkretisht:

1. Minieskavatori me goma me targa AJMT62 siguracioni i dorëzuar fizikisht në muajin shtator 2022, nëpërmjet kontratës së qirasë Nr.Rep:2974 dhe Nr.Kol:1539 me subjektin “S. ” Sh.p.k, por ky subjekt nuk disponon certifikatë për dhënien me qira të mjeteve për të tretë.

2. Referuar kontratës së qirasë Nr.Rep:2946 dhe Nr.Kol:1524 me subjektin “Z. ” Sh.p.k, për Mjetin Eskavator me goma me targa AEMT 08 nuk janë paraqitur dokumentacioni justifikues bashkëlidhur kontratës ku të vërtetohet gjendja fizike e mjetit dhe përdorimi i lejuar.

Lidhur me sa më sipër, për certifikatat e transportit sqarojmë se: Në nenin 81, pika 1, 2, 3, 4, 5 dhe 7, 8 “Destinacioni dhe përdorimi i mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se:

1. Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike.
2. Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik
3. Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët.
4. Quhet përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit.
5. Përdorimi nga të tretët përfshin:
  - a) dhënien me qira pa drejtues mjeti;
  - b) dhënien me qira me drejtues mjeti dhe shërbimi taksi për transport njerëzish;
  - c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh;
  - d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të treteve;
  - e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave;
  - f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të treteve.
7. Në aktet në zbatim janë përcaktuar karakteristikat konstruktive të mjetit në lidhje me destinacionin ose përdorimet, për të cilat ai mund të caktohet.
8. Duke përjashtuar dispozitat e ligjeve të posaçme, cilido që shfrytëzon një mjet me një destinacion ose për një përdorim të ndryshëm nga ato të treguara në lejen e transportit, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë”.

Në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se:

- 3.13. Transport për vete: transporti i mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi.
- 3.14. Transport për të tretë dhe me qira: transporti i mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira.

Në nenin 41, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse”.

Pra, ligji “Për Transportet Rrugore”, bën qartësisht ndarjen midis çertifikatës së lëshuar për “Transport për vete” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet, ku në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi; si edhe çertifikatës së lëshuar për “Transport për të tretë dhe me qira” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira.

Në rastin konkret përmes dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se, çertifikatat janë dhënë në përdorim të vet pronarëve të mjeteve për kryerjen e transportit të mallrave me kamion (vetëm për llogari të veprimtarisë së vet). Në këtë mënyrë, kryerja e transportit nga ana e OE të mallrave me mjetet e mësipërme do të jenë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa çertifikatën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për Transportet Rrugore” është i ndaluar. Mungesa e certifikatave të mësipërme, vërteton faktin se përdorimi i tij nga të tretë do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”.

### **Konkluzion**

Sa më sipër OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE “B.N ” shpk, si dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. Në këto kushte, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:

- nenin 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3:

*“3.Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.*

-nenin 99 “Anulimi i një procedure prokurimi, pika 1, germa (b):

*1.Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:  
b)në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;*

*Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje znj A.M , z. K.H dhe z. Y.K*

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

**Ndikimi/Efekti:** Ndikon në paraqitjen e ofertave nga operatorët ekonomikë.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Në observacionin e subjektit të audituar Bashkia Elbasan mbi Akt konstatimin nr.15 dërguar me shkresën nr. 4474/44 prot., dt. 22.11.2023 dhe me nr. 767/4 prot., (i KLSH) dt. 30.11.2023, shprehur si më poshtë vijon:

### **Pretendimi i subjektit: Njësia e Prokurimit**

**Observim:** Kërkesa për pasjen ne licensën e shoqërise kategorinë NP-11 (Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike), është bazuar tek zerat e preventivit të projektit e konkretisht: Punime elektrike ne ambjentet e jashtem tek lulishtja (F.V Shtylla metalike per ndricim H=7m, d=160mm; F.V Tuba Metalike D=140mm; F.V ne toke kablllo Al fuqie +1000V,me izolim gome; F.V Pusete elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm; F.V Elektrode togzimi te nxiguar L=150cm; F.V ndricues projektor me llampe SAP-T 250Ë etj.) **Në VKM Nr. 42, datë 16.01.2008 "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË LICENCAVE PROFESIONALE TË ZBATIMIT, KLASIFIKIMIT DHE DISIPLINIMIT TË SUBJEKTEVE JURIDIKE, QË USHTROJNË VEPRIMTARI NDËRTIMI", i ndryshuar, lidhja 3- Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme përcaktohet si mëposhtë: N.P.11**

**Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.** Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, **shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.** Kërkesa për pasjen në licensën e shoqërisë kategorinë NS-9 A (Punime strukturore speciale), është bazuar tek zerat e preventivit të projektit për punimet për ndërtimin e objektit të ri dhe palestrës e konkretisht: Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 25/30; Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 20/25; kollona b/a monolite C 25/30 h ~ 4m; Trare e arkitrare b/a C25/30 h ~ 4m; Arkitrare b/a C - 16/20, h ~ 4 m

**Në VKM Nr. 42, datë 16.01.2008 "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË LICENCAVE PROFESIONALE TË ZBATIMIT, KLASIFIKIMIT DHE DISIPLINIMIT TË SUBJEKTEVE JURIDIKE, QË USHTROJNË VEPRIMTARI NDËRTIMI", i ndryshuar, lidhja 3- Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme përcaktohet si mëposhtë: N.S- 9 Punime strukturore special**

Konsiderohet ndërtimi i objektit i destinuar për transmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuara për t'u ndërtuar në terrene rezistente dhe jo të deformueshme, por me parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotëve të çfarëdolloj tipi, **të themeleve nëntokësore me pilotë ose me mure mbajtëse,** me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale, përshirë edhe marrjen e kampioneve për analiza laboratorit nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve. Impermeabilizzazione dhe konsolidimin e terreneve. **Observim:** Numri i punonjësve është vendosur duke u bazuar në grafikun e punimeve të hartuar nga inxhinierët e Drejtorisë së Projektimit dhe Azhurnimit Topografik të Bashkisë Elbasan në përputhje me VKM-në nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, ku për çdo zë të punime janë përcaktuar edhe orët e punës për njësi sipas përcaktimeve të nenit 78, pika 1 dhe 4 të Kodit të Punës, që përcakton kohëzgjatjen normale të ditës së punës 8 orë, nenit 83 që përcakton kohëzgjatjen javore të punës, jo më shumë se 40 orë dhe nenit 92 e vijues mbi pushimet vjetore që i takojnë punëmarrësit. Sipas këtij grafiku numri i ditëve të punës që do të duheshin një punonjësi për të kryer punimet është **15794 ditë pune.** Duke u nisur nga kompleksiteti dhe rëndësia e projektit dhe interesave të AK për përfundimin e veprës është menduar që punimet të përfundojnë brenda një afati prej **8 muajsh.** Sa më sipër bazuar në afatin prej 8 muajsh si dhe numrin e ditëve të punës të llogaritura si më sipër, del që për të përfunduar projektin brenda 8 muajve do të nevojiteshin minimalisht 90 punonjës. (15794/22/8=90), ndërkohë që AK ka kërkuar 100 punonjës duke përfshirë edhe të gjithë stafin teknik dhe administrativ.

Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për arkitektin lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, rëndësinë dhe përmasat e objektit si dhe zbatimin e projektit arkitektonik.

Arkitekti është përcaktuar pasi ndryshimet e ambienteve, të përshtaten sa më mirë funksionalitetit dhe estetikës, e cila mund të jetë variabël nga kërkesat e autoriteti kontraktor gjatë zbatimit të punimeve.

**Observim:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. **Kriteri që OE të kenë të punësuar 4 shoferë është bazuar në numrin e mjeteve të nevojshme për zbatimin e projektit, grafikun e punimeve të nenit 78, pika 1 dhe 4 të Kodit të Punës, që përcakton kohëzgjatjen normale të ditës së punës 8 orë, nenit 83 që përcakton kohëzgjatjen javore të punës, jo më shumë se 40 orë dhe nenit 92 e vijues mbi pushimet vjetore që i takojnë punëmarrësit. Janë një sërë mjesh të cilat kërkojnë shorë të kualifikuar në drejtimin e tyre si kamionët vetëshkarkues të tonazhit të lartë (4 të tillë), autobot uji, autobetoniere, autopompë betoni si dhe mjete të tjera si kamioçina, mjet apv me kosh.**

**Observim:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Punonjësi përgjegjës për dëmet në mjedis sqarojmë se kriteri është vendosur në përputhje të plotë me klauzolat e Ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” me qëllim marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese për mbrojtjen e mjedisit. **Nga ana e AK nuk është kërkuar ekspert mjedisi, por një punonjësi i AK, i cili duhet të ketë bërë një kurs trajnimi për marrjen e masave parandaluese për mbrojtjen e mjedisit gjatë kryerjes së punime, siç janë: transporti i materialeve të imëta apo materialeve që mund të krijojnë pluhur; lagia rregullisht me ujë për të eliminuar pluhurin e shkaktuar nga kryerja e punimeve; menaxhimi i pajsjeve me nivel të lartë zhurmues; menaxhimi i materialeve të rrezikshme si karburante, vajra, çimento etj.**

**Observim:** **Kërkesa e mësipërme bazohet në ligjin nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimin nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar; ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar; VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për Miratimin e kërkesave për Menaxhimin e Mbetjeve Inerte”.**

Në nenin 5 të ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se: “Ushtimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.”

Në pikat 8 dhe 9 të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar parashikohet se: “ Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.” Në pikat 4, 5 dhe 6 të VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për Miratimin e kërkesave për Menaxhimin e Mbetjeve Inerte” parashikohet se:

Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorur në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 107, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

Termi “Zotëruesi i mbetjeve inerte”, në kuptimin e këtij vendimi, është person fizik ose juridik, i cili, gjatë aktivitetit të tij të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objekteve, prodhon, transporton ose trajton mbetje inerte të cilat janë të renditura në kapitullin 17, të vendimit nr. 99, datë 18.2.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, të ndryshuar. Zotëruesi i mbetjeve inerte, i cili kryen përpunim paraprak, përzierje apo procese të tjera, që ndryshojnë natyrën ose përbërjen e këtyre mbetjeve, është i detyruar t’i ruajë, t’i transportojë dhe t’i dorëzojë ato në

lendfill apo në venddepozitimim e përkohshëm në mënyrë të diferencuar, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 371, datë 11.6.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, si dhe vendimit nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”.

Zotëruesi i mbetjeve inerte është i detyruar t'i dorëzojë këto mbetje tek operatorët, të cilët janë të pajisur me leje mjedisore, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, dhe me licencë të tipit III.2.B, sipas vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

Në nenet 21 dhe 57 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar; parashikohet se:

**Neni 21 :** Krijuesi ose zotëruesi fillestar i mbetjeve e kryen trajtimin e tyre vetë ose përmes një tregtari a personi tjetër që kryen operacione trajtimi të mbetjeve, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 448 ,datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”. **Neni 57:1.** Transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve. 2. Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri. 3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, të ministrit përgjegjës për ekonominë dhe të ministrit përgjegjës për transportin, miraton rregullat për zbatimin e këtij neni.

**Observim: Kriteri që OE të disponojnë mjetet e kërkuara është bazuar në preventivin, grafikun natyrën e punimeve është kërkuar** 1 autobetoniere, 1 pompë betoni, pompë suvatimi, nivelues helikopter për të gjitha punimet e betonit të parashikuara në preventiv si: Kollona monolite betoni C 25/30; Shtresë betoni C 16/20; Plinta e bazamente b/a monolite deri 20 m3 C - 16/20; Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m; Plinta e bazamente b/a monolite deri 20 m3 C - 16/20; Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 25/30 etj.

**Është kërkuar kamion me vinç për punime të parashikuara në preventiv si** Vendosi në vepër tuba betoni; F.V Shtylla metalike per ndricim H=7m , d=160mm; f.v kaldaëj.

**Janë kërkuar kamionë** me kapacitet mbi 18 ton dhe 7.5-18 ton për arsye të sasisë së konsiderueshme të materialeve të ndërtimit, mbeturinave e dherave që do të transportohen e konkretisht: mbi 600 m3; materiale të ndryshme që do të nevojiten për ndërtimin e objekteve të reja apo për ato ekzistuese. Janë kërkuar kamionë me tonazh edhe më të vogël se 18 ton për arsye të hyrje daljeve në kantier pasi rruga nga njëra anë e kantierit nuk lejon hyrjen e mjeteve me tonazh mbi 18 ton.

**Janë kërkuar** kamionçina për arsye të transportit të materialeve dhe të pajisjeve e veglave të punës; punëtorëve etj.

**Janë kërkuar** mjete gjurmimi për punimet e gjurmimit sipas preventivit. Sasia e mjeteve të kërkuar është në përputhje me volumin e konsiderueshëm të gjurmimeve, mbi 2000 m3. Llojet e ndryshme të mjeteve të gjurmimit janë kërkuar për arsye të hapësirave të ngushta në brendësi të kantierit.

**Është kërkuar** fadromë për largimin e mbeturinave që krijohen nga gjurmimet apo prishjet, sistemin e ambientit. Llojet e ndryshme janë kërkuar për arsye të hapësirave të ngushta në brendësi të kantierit.

**Observim:** AK ka përcaktuar që këto kritere do të përmbushen nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i disponon mjetet e mësipërme, do të dorëzohet nga operatori ofertues i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Pra OE ekonomike nuk kanë detyrim paraqitjen e lejes mjedisore në momentin e ofertimit duke mos ndikuar kështu në kufizimin e pjesëmarrjes së OE. Paraqitja e këtij dokumentacioni do të bëhet vetëm nga OE i i kualifikuar i pari. Pavaresisht se është një dokument

i personave te trete, ai i sherben AK per te vleresuar nese furnizuesi ka fabriken e kekuar dhe se e ushtron aktivitetin ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, duke e vene keshtu edhe ne pozita te barabarta me OE pjesemarres qe keto fabrika mund ti kene ne pronesi. Për më tepër nëse një OE disponon me qira një impiant të tillë duhet patjetër të ketë edhe lejen mjedisore QKL Kodi III.1.B, [pa të cilën nuk mund të ushtrojë aktivitetin.

Për analogji kërkesa për paraqitjen e këtij dokumentacioni është e njëjtë si ajo për paraqitjen e dokumentacionit nga OE i kualifikuar i pari në rastet e marrjes me qira të mjeteve.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj Në aktkonstatimin nr. 15 dhe në Projektraport është cituar që kriteret nuk janë të justifikuar teknikisht, bazuar në preventivin e punimeve, pasi nisur edhe nga tabela e hartuar nga ana juaj për llojet e makineri/pajisjeve për zëra të ndryshëm pune, duket qartë që janë vendosur pajisje jo në propocion me zërat e punës duke ju referuar Kërkesat e veçanta të kualifikimit të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 25.08.2022. të cilat nuk janë të argumentuara teknikisht.

- Kërkesa për arkitekt në këtë procedurë nuk është e argumentuar ligjërisht dhe për më tepër nuk është në përputhje me zbatueshmërinë dhe objektin e kontratës pasi projekti dhe preventivi i punimeve janë hartuar dhe procedohet për OE i cili do të marrë përsipër realizimin e objektit dhe kontratës së zbatimit të punimeve.

- Kërkesat e pikës 2.3.8 e DST –së Këto kërkesa për licenca nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës. Nuk është e nevojshme licenca e mësipërme, pasi shërbimin e grumbullimit të mbetjeve e ofron Bashkia Elbasan dhe për subjektet që kryejnë punime ndërtimit aplikon tarifën ndotjes, shërbimit, për kohëzgjatjen e kantierit të ndërtimit.

Kriteret e vendosura në kërkesat e pikës 2.3.11/12 nuk janë të argumentuar teknikisht dhe ligjërisht pasi në rastet kur fabrika e betonit - elementeve të betonit - bordurave dhe pllakave nuk janë në pronësi të ofertuesit rezulton se kërkesa për paraqitjen me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për të cilën duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qerase/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, u drejtohet personave të tretë që nuk janë konkurrent në këtë procedurë prokurimi.

### **Pretendimi i subjektit: KVO**

#### **Observim: 1. OE "B.N" shpk ka vetëdeklaruar 4 punonjës shoferë, e konkretisht:**

**1. Z. B.H me profesion Shofer** i punësuar prane Shoqerise "B.N" Shpk me Kontrate Individuale Pune ne date 05.01.2022 (e rinovuar) pajisur me Certifkate Sigurimit Teknik (IQT) Nr.000049 date certifikate 10.09.2021 date skadimi 09.09.2022 ne profesionin Shofer, Patente (Leje Drejtimi) dhe Certifikate Aftesise Profesionale (CAP).

**2. Z. P.Z me profesion Shofer** i punesuar prane Shoqerise "B.N" Shpk me Kontrate Individuale Fune ne date 05.01.2022 (e rinovuar) paj isur me Certifikate Sigurimit Teknik Nr.000051 date certifikate 10.09.2021 date skadimi 09.09.2022, Patente (Leje Drejtimi) dhe Certifikate Aftesise Profesionale (CAP).

**3. Z. A.K me profesion Shofer** i punesuar prane Shoqerise "B.N" Shpk me Kontrate Individuale Fune ne date 05.01.2022 (e rinovuar) pajisur me Certifikate Sigurimit Teknik Nr.001549 date certifikate 02.03 .2022 date skadimi O 1.03 .2023, Patente(Leje Drejtimi) dhe Certifikate Aftesise Profesionale (CAP).

**4. Z. F.C me profesion Shofer** i punesuar prane Shoqerise "B.N" Shpk me Kontrate Individuale Pune ne date 05.01.2022 (e rinovuar) paj isur me Certifikate Sigurimit Teknik Nr.001548 date certifikate 02.03 .2022 date skadimi,O 1.03 .2023 Patente(Leje Drejtimi) dhe Certifikate Aftesise Profesionale (CAP).

#### **2. OE "B.N" shpk ka vetëdeklaruar 4 punonjës manovratorë, e konkretisht:**

**1. z. E.V me profesion Manovrator** i punesuar prane Shoqerise "B.N" Shpk me Kontrate Individuale Pune ne date 05.01.2022 (e rinovuar) pajisur me Certifikate Sigurimit Teknik

Nr.011560 date certifikate 01.11.2021 date skadimi 31.10.2022 dhe Deshmi Aftesise Profesionale leshuar nga DPSHTR Nr.1059/9 Date 27.07.2007 date leshimi 05.10.2020 dhe date skadimi 04.10.2025 per Eksvatorist.

**2. Z. R.Sh me profesion Manovrator** i punesuar prane Shoqerise "B.N" Shpk me Kontrate Individuate Pune ne date 05.01.2022(e rinovuar) pajisur me Certifikate Sigurimit Teknik Nr.O 11561 date certifikate O 1.11.2021 date skadimi 31.10.2022 dhe Deshmi Aftesise Profesionale leshuar nga DPSHTR 2693 date 18.09.2015 date leshimi 29.09.2020 dhe date skadimi 28.09.2025 per Eksvatorist.

**3. Z. E.Ll me profesion Manovrator** i punesuar prane Shoqerise "B.N" Shpk me Kontrate Individuale Pune ne date 05.01.2022 (e rinovuar) pajisur me Certifikate Sigurimit Teknik Nr.019721 datecertifikimi 19.05.2022 date skadimi 18.05.2023 dhe Deshmi Aftesise Profesionale leshuar nga DPSHTR Nr.762 date 07.06.2012 date leshimi 12.08.2022 dhe date skadimi 11.08.2027 per Automakinist.

**4. Z. L.B i punesuar prane Shoqerise "B.N" Shpk me Kontrate Individuale Pune date 05.01.2022 (e rinovuar) ne rolin Shofer Manovrator** pajisur me Certifikate të Sigurimit Teknik (IQT) Nr.019552 date certifikate 06.05.2022 date skadimi 05.05.2023 ne profesionin Manovrator dhe Deshmi Profesionale leshuar me Nr.3552 date 23 .06.2020, date leshimi 23.06.2020 dhe date skadimi 22.06.2025 per Eskavatorist.

Përsa i përket konstatimit të parashtruar nga ana juaj se z. L.B figuron në listë pagesa me Kod punësimi 8332.14 – shofer kamioni në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve LKP të Rishikuar”, ju sqarojmë se:

Në kriterin e pikës **2.3.6 të DST** nuk është kërkuar që punonjësit të figurojnë në listë pagesa me Kod punësimi sipas kualifikimit të kërkuar. KVO vlerëson ofertat vetëm mbi kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit. OE i është kërkuar që të kenë punonjës të kualifikuar duke përcaktuar edhe dokumentacionin konkret që duhet të paraqesin (kontratën e punës së vlefshme, dëshminë e drejtimit të vlefshme, lëshuar nga institucionet përkatëse, dëshmitë e drejtimit të lëshuara nga D.P.SH.T Rrugore), dokumentacion të cilin OE e ka paraqitur. Pra OE ka përmbushu kërkesat e e pikës **2.3.6 të DST. Vlen të theksohet se një punonjës mund të ketë një apo më shumë kualifikime dhe është në diskrecionin e OE deklarimi i profesionit në listëpagesë.**

**Observim: 1.** Përsa i përket konstatimit të parashtruar nga ana juaj se Minieskavatori me goma me targa AJMT62 siguracioni i dorëzuar fizikisht në muajin shtator 2022, nëpërmjet kontratës së qirasë Nr.Rep:2974 dhe Nr.Kol:1539 me subjektin “S. ” Sh.p.k, por ky subjekt nuk disponon certifikatë për dhënien me qira të mjeteve për të tretë, ju sqarojmë se certifikatë për dhënien me qira të mjeteve për të tretë është vetëm për kamion për transport mallrash, siç edhe përcaktohet në parashikimet ligjore të cituara nga ana juaj. Mjeti minieskavator nuk është mjet për transport mallrash por mjet gjermimi.

**2.** Përsa i përket konstatimit të parashtruar nga ana juaj se për Mjetin Eskavator me goma me targa AEMT 08 nuk janë paraqitur dokumentacioni justifikues bashkëlidhur kontratës ku të vërtetohet gjendja fizike e mjetit dhe përdorimi i lejuar, ju sqarojmë se OE ka vetëdeklaruar dhe paraqitur dokumentacion për Eskavatorin me goma me targa AAMT22 të marrë me qira nga subjekti "B." shpk si dhe eskavatorin me goma me targë AA 910 YT në pronësi, duke përmbushur kërkesën e parashikuar në pikën **2.3.10 të DST.**

**Oëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj nuk meren në konsiderat pasi është detyre e KVO të bëjë verifikimin fizik të dokumentacionit të OE të shpallur fituaes. Gjithashtu persa i përket kriterit të pikës **2.3.6 të DST** OE B.N ka të punësuar në kompani 2 punonjës të profilit shofer **dhe jo 4 Shofer sic është kërkuar.**



*2. Të dhëna mbi objektin e prokurimit: Ndërtim rjeti KUZ në zonat Informale*

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim rjeti KUZ në zonat Informale”.</b>			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “Kërkesë për Propozim” REF- 50469-11-18-2022 Urdhri nr. 4763 prot., datë 11.10.2022	<b>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit</b> Urdhri nr. Ska datë 11.10.2022 1. z.O.K 2. z. E.S 3. z. A.B	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> 1. z.O.K 2. z. E.S 3. z. A.B	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 4763/2 prot., datë 18.11.2022. 1. znj A.M 2. z. K.H 3. z. Y.M
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 58,393,976 lekë	<b>5. Oferta fituese, vlera fituese:</b> Operatori Fitues: Boe “Xh” Sh.P.K Me Nipt: K.....i & “D-05” Sh.P.K Me Nipt: K.....b” 57,339,845 lekë pa tvsh.		<b>6. Diferenca me fondin limit</b> 1,054,131 lekë pa tvsh
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 06.12.2022	<b>8. Burimi Financimit</b> Buxheti i Bashkisë		<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender, <b>4 OE</b> b) S’kualifikuar <b>1 B/OE</b> , c) Kualifikuar <b>3 B/OE</b>
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj</b>			
<b>10.Ankimime</b> AK-s’ka APP-s’ka KPP-s’ka	<b>11. Data e lidhjes të kontratës:</b> Nr. 4763/7 prot., datë 20.02.2023		<b>12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK S’ka</b>

**a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.**

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

**AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit” :**

Me urdhër të zv. Kryetarit (Personi i Autorizuar) të Bashkisë Elbasan znj. A.B është ngritur një komision me urdhrin nr. 4763 prot., datë 11.10.2022 “Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit 58,393,976 lekë” me objekt: “Ndërtim rjeti KUZ në zonat Informale”. Në zbatim të këtij urdhri, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga, z. O.K, z.A.B dhe z. E.S. Fondet janë miratuar VKB nr. 82 datë 23.06.2022 mbi fituesit e projekteve për vitin 2022 në e cila do financohet në katër vite 2022-2025. Çmimet e vendosura janë në përputhje me VKM-në nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”.

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve të vendosura.

**Situata 1:** Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej z.O.K, E.S dhe z. A.B , të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 18.11.2022. Në lidhje me kriteret e vendosura, u konstatuar kriteret të ekzagjeruara dhe të paargumentuara. Në mënyrë të detajuar kriteret e konstatuara si të pa argumentuara paraqiten si vijon:

**Kërkesat e pikës 2.3.2 e DST** e cila kërkon ndër të tjera Liçensa profesionale N.P - 5 “Punime nëntokësore, ura, vepra arti”, nuk është e argumentuar ligjërisht dhe për më tepër nuk është në përputhje me zbatueshmërinë dhe objektin e kontratës pasi projekti dhe preventivi i punimeve janë hartuar dhe procedohet për OE i cili do të marrë përsipër realizimin e objektit dhe kontratës së zbatimit të punimeve. Kriteri i cili konsiderohet kufizues.

**Kërkesat e pikës 2.3.5 e DST** e cila kërkon që operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf dhe punonjës të kualifikuar *4 shofere është kërkesë e paargumentuar dhe jo në përputhje me numrin e mjeteve të rënda për të cilën kërkohen shofer. Konkretisht, në pikën 2.3.8 të DST, kërkohet 3 Automjete vetëshkarkuese me mase maksimale të autorizuar 7.5-18 ton, 2 Automjete vetëshkarkuese me mase maksimale të autorizuar mbi 18 ton, 1 Autobetoniere, 2 Kamionçinë me kapacitet mbajtes deri në 5 Ton, 2 Kamion vinc dhe 1 Autobrumatriçei. Sa më sipër, kërkesa për 4 shofer nuk përputhet me mjetet e kërkuara.*

*Kërkesa e pikës 2.3.5 e DST e cila kërkon nga OE të kenë të punësuar 4 manovratore të mjeteve të rënda është kërkesë e paargumentuar dhe jo në përputhje me numrin e mjeteve të rënda për të cilën kërkon manovratorët. Konkretisht, në pikën 2.3.8 të DST, kërkohet 2 Eskavator me goma, 1 miniekskavator, 1 Eskavator me zinxhir, 1 Fadrome me goma, 1 Rrul hekur–hekur me kapacitet 4 ton - 7 ton, 1 Rrul hekur –hekur me kapacitet mbi 10 ton dhe 1 Rrul hekur –gome me kapacitet mbi 18 ton mjetet të cilat drejtohet nga manovratorët. Sa më sipër, kërkesa për 4 manovratorë nuk përputhet me mjetet e kërkuara.*

**Kërkesat e pikës 2.3.7** e cila kërkon, një punësim mesatar për periudhën Gusht 2022 - Tetor 2022, i të paktën 60 (gjashtedhjetë) personave. Kriteri për stafin mbështetës dhe për punonjësit e kërkuar, përveç se nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish, konsiderohet diskrimues pasi sjell pabarazi ndërmjet OE. Referuar listës së punonjësve të kërkuar, janë rreth 39 duke filluar nga Drejtues projekti me licencën e shoqërisë si drejtues teknik, inxhinierë dhe punonjës të natyrave të ndryshme për të përmbushur detyrimet kontraktuale, ndërkohë që një numër mesatar jo më pak se 60 punonjës me kohë të plotë për periudhën Gusht 2022 - Tetor 2022, që i është kërkuar OE ofertues, ndikon në kufizimin e pjesëmarrjes së tyre.

**Kërkesat e pikës 2.3.8 e DST** e cila kërkon që operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës 3 Automjete vetëshkarkuese me mase maksimale të autorizuar 7.5-18 ton, 2 Automjete vetëshkarkuese me mase maksimale të autorizuar mbi 18 ton, 2 Eskavator me goma, 2 Eskavator me goma, 1 Eskavator me zinxhire, 1 Fadrome me goma, 2 Kamion me vinc, 2 Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri 5 Ton. Mungon përlllogaritja dhe analiza për të përcaktuar këto kapacitete për kamionët, ku në disa raste janë përcaktuar edhe kufinj të ngushtë mes kapacitetit minimal dhe maksimal të lejuar 7.5-18 Ton, dhe pastaj kërkohet me kapacitet mbi 18 Ton. Ndërkohë, që kërkesa për 2 Eskavator me goma, 2 Eskavator me goma, 1 Eskavator me zinxhire, 1 Fadrome me goma, 2 Kamion me vinc, 2 Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri 5 Ton nuk argumentohet diferenca e vogël në kapacitetin e kërkuar. Ky kriter për makineritë nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish pasi Në procesverbalin përkatës nuk argumentohet numri i mjeteve. Gjithashtu theksojmë se transportimi i materialeve hidraulike, elektrike, pllakave, gërmim dheu, etj ... nuk do të kryhet brenda të njëjtës ditë, pasi janë punime të cilat shtrihen në kohë të ndryshme dhe në këto kushte një kamion/kamionçinë mund të kryej disa rrugë dhe të realizohet qëllimi, referuar grafikut dhe preventivit të punimeve.

**Kërkesat e pikës 2.3.9** e cila kërkon që operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme” ose të ketë kontrate shërbimi noteriale për objektin konkret me shoqëri të licensuara. Kërkesa për licenca nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërish në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës.

**Kërkesat e pikës 2.3.11** e cila kërkon që operatorët ekonomike duhet të kenë në pronësi/kontratë qeraje/kontrate furnizimi 1 (një) fabrikë betoni, e cila duhet të jete e pajisur me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për të cilën duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qeraje/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B.

**Kërkesat e pikës 2.3.12** e cila kërkon që operatorët ekonomike duhet të kenë në pronësi/kontrate qeraje/kontrate furnizimi 1 (një) fabrike inertesh, e cila duhet të jetë e pajisur me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për të cilën duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qeraje/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B.

**Kërkesat e pikës 2.3.13** e cila kërkon që operatorët ekonomike duhet të kenë në pronësi/kontrate qeraje/kontrate furnizimi 1 (një) fabrike prodhim asfalti, e cila duhet të jete e pajisur me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për të cilën duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qeraje/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B.

Kriteret e vendosura në kërkesat e pikës 2.3.11/12/13 nuk janë të argumentuar teknikisht dhe ligjërish pasi në rastet kur fabrika e betonit - elementeve të betonit - bordurave dhe pllakave nuk janë në pronësi të ofertuesit rezulton se kërkesa për paraqitjen me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B,

për te cilën duhet te paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qerases/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, u drejtohet personave të tretë që nuk janë konkurrent në këtë procedurë prokurimi.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me kërkesat e nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës” .

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

**Ndikimi/Efekti:** Ndikon në paraqitjen e ofertave nga operatorët ekonomikë.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

### ***b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 4763/4, të datës 10.02.2023, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	B.N. Sh.p.k me Nipt: K.....O	50,962,900	Kualifikuar
2	“BE - IS SH.P.K me Nipt: K.....A	54,851,829	Kualifikuar
3	BOE “XH.” SH.P.K me Nipt: K.....I & "D-05" Sh.p.k me Nipt: K.....B	57,339,845	Kualifikuar
4	SH. Sh.p.k me Nipt: K.....N	49,589,896	S’kualifikuar; Subjekti juaj ka deklaruar se drejtues teknik për realizimin e objektit do të jetë <b><i>ing. Mjedisi zni. S.J. e cila nuk është e angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë e pranishme gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt</i></b> , çka bie në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2. “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, i cili përcakton se: <i>Për vlera me vlerë të plotë të preventuar mbi 30,000,000 lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë të plotë në objekt i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.</i> <b>Sa më sipër, subjekti juaj nuk përmbush kërkesën e parashikuar në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik</b>

Sa me sipër KVO sipas procesverbaleve të vlerësimit të datës 11.01.2023 ka shpallur fitues Operatori ekonomik “**B.N” sh.p.k. me vlerë 50,962,900** (pesëdhjete milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dymijë e nëntëqind) **lekë (pa tvsh)** i cili nuk ka paraqitur dokumentacionin në afatin e kërkuar siç parashikohet në pikën 6, të nenit 26, të V.K.M.-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar. Me procesverbalin e ri-vlersimit të datës 11.01.2023 ka shpallur fitues Operatori ekonomik “**BE - IS” SH.P.K me Nipt: K.....A me vlerë 54,851,829** (pesëdhjetë e katërmilion e tetëqind e pesëdhjetë e një mijë e tetëqind e njëzet e nëntë) **lekë (pa tvsh)** i cili nuk ka paraqitur dokumentacionin në afatin e kërkuar siç parashikohet në pikën 6, të nenit 26, të V.K.M.-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës me nr. 4763/4 më datë 10.02.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës

dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 4 operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar 3 OE, janë kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 10.02.2023 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë **BOE "XH. " SH.P.K me Nipt: K....I & "D-05" Sh.p.k me Nipt: K....B**" për të cilën është lidhur kontrata nr. 4763/7 datë 20.02.2023 për vlerën **57,339,845** lekë pa TVSH dhe vlera 68,807,814 lekë me TVSH, dhe me afat 6 (gjashtë) nga data e lidhjes së kontratës.

Në observacionin e subjektit të audituar Bashkia Elbasan mbi Akt konstatimin nr.15 dërguar me shkresën nr. 4474/44 prot., dt. 22.11.2023 dhe me nr. 767/4 prot., (i KLSH) dt. 30.11.2023, shprehur si më poshtë vijon:

**Pretendimi i subjektit: Njësia e Prokurimit**

**Observim:** Kërkesa për pasjen ne licensën e shoqërisë kategorinë NP-5 (Punime nëntokësore, ura e vepra arti), është bazuar tek zerat e preventivit të projektit e konkretisht: Punime për kalimin e zaranikes (Germim themel (gropa) sip10-30m<sup>2</sup>, shkemb bute, h= 2.5 m, makineri; F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm; Plinta e bazamente b/a monolite deri 20 m<sup>3</sup> C - 16/20; F.V. tuba perfshi pjeset speciale me saldim me llamarine te zeze te kalandruar te vendosur ne estakada >φ600 etj), të cilat hyjne në llojet e punimeve që konsiderohen vepra arti **Në VKM Nr. 42, datë 16.01.2008** "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", **i ndryshuar, lidhja 3- Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme përcaktohet si mëposhtë:** N.P. 5 Punime nëntokësore, ura e vepra arti Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntoke që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi "goma" ose mbi "hekur", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele.

**Observim:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

**Kriteri që OE të kenë të punësuar 4 shoferë është bazuar në numrin e mjeteve të nevojshme për zbatimit e projektit, grafikun e punimeve të nenit 78, pika 1 dhe 4 të Kodit të Punës, që përcakton kohëzgjatjen normale të ditës së punës 8 orë, nenit 83 qe përcakton kohëzgjatjen javore të punës, jo më shumë se 40 orë dhe nenit 92 e vijues mbi pushimet vjetore që i takojnë punëmarrësit. Janë një sërë mjetsh të cilat kërkojnë shorë të kualifikuar në drejtimin e tyre si kamionët vetëshkarkues të tonazhit të lartë (5 të tillë), autobot uji, autobetoniere, autopompë betoni si dhe mjete të tjera si kamioçina, mjet apv me kosh. Theksojmë që numri i mjeteve dhe shoferëve i përgjigjet grafikut të punimevë, volumit dhe shpërndarjes gjeografike të punimeve. **Do të punohet në 11 rrugë në zona të ndryshme të qytetit, çka e bën të domosdoshme kërkesën për numrin e mjeteve dhe shoferëve.****

**Kriteri që OE të kenë të punësuar 4 manovratorë është bazuar në numrin e mjeteve të nevojshme për zbatimit e projektit, grafikun e punimeve të nenit 78, pika 1 dhe 4 të Kodit të Punës, që përcakton kohëzgjatjen normale të ditës së punës 8 orë, nenit 83 qe përcakton kohëzgjatjen javore të punës, jo më shumë se 40 orë dhe nenit 92 e vijues mbi pushimet vjetore që i takojnë punëmarrësit. Janë një sërë mjetsh të cilat kërkojnë shorë të kualifikuar në drejtimin e tyre si mjete germimi eskavatorë (4 të tillë), fadromë me goma, grejder, rrula (3 të tillë), asfaltoshtrues, autobitumatriçe. Theksojmë që numri i mjeteve dhe manovratorëve i përgjigjet**

grafikut të punimevë, volumit dhe shpërndarjes gjeografike të punimeve. **Do të punohet në 11 rrugë në zona të ndryshme të qytetit, çka e bën të domosdoshme kërkesën për numrin e mjeteve dhe shoferëve.**

**Observim:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimi. Numri i punonjësve është vendosur duke u bazuar në grafikun e punimeve të hartuar nga inxhinierët e Drejtorisë së Projektimit dhe Azhurnimit Topografik të Bashkisë Elbasan në përputhje me VKM-në nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, ku për çdo zë të punime janë përcaktuar edhe orët e punës për njësi sipas përcaktimeve të nenit 78, pika 1 dhe 4 të Kodit të Punës, që përcakton kohëzgjatjen normale të ditës së punës 8 orë, nenit 83 që përcakton kohëzgjatjen javore të punës, jo më shumë se 40 orë dhe nenit 92 e vijues mbi pushimet vjetore që i takojnë punëmarrësit. Sipas këtij grafiku numri i ditëve të punës që do të duheshin një punonjësi për të kryer punimet është **11343 ditë pune**. Duke u nisur nga kompleksiteti dhe rëndësia projektit dhe interesave të AK për përfundimin e veprës është menduar që punimet të përfundjnë brenda një afati prej **6 muajsh**. Theksojmë që numri i punonjësve i përgjigjet grafikut të punimevë, volumit dhe shpërndarjes gjeografike të punimeve. **Do të punohet në 11 rrugë në zona të ndryshme të qytetit, çka e bën të domosdoshme kërkesën për numrin e punonjësve.** Sa më sipër bazuar në afatin prej 6 muajsh si dhe numrin e ditëve të punës të llogaritura si më sipër, del që për të përfunduar projektin brenda 6 muajve do të nevojiteshin minimalisht 85 punonjës. ( $11343/22/6=85$ ), ndërkohë që AK ka kërkuar 60 punonjës duke përfshirë edhe të gjithë stafin teknik dhe administrativ.

**Observim:** Kriteri që OE të disponojnë mjetet është bazuar në preventivin, grafikun e punimeve, natyrën dhe shpërndarjen gjeografike të punimeve. Theksojmë që do të punohet në 11 rrugë në zona të ndryshme të qytetit, çka e bën të domosdoshme kërkesën për numrin dhe llojin e mjeteve të kërkuara. Konkretisht janë kërkuar mjete vetëshkarkuese 7.5-15 ton dhe mbi 18 ton duke u bazuar në volumet e konsiderueshme për tu transportuar dhe shtrirjen gjeografike të punimeve. Janë mbi 8,000 m<sup>3</sup> dhera të dala nga gërmimet që do transportohen; rreth 3500 m<sup>3</sup> inerte të llojit zhavor; mbi 10,000 m<sup>2</sup> inerte të llojeve të ndryshme si çakull, stabilizant, rere, asfalt; rreth 7600 ml tubo betoni etj.

Përsa i përket kapaciteteve të kërkuara thksojmë se janë kërkuar të tilla për arsye të sasisë së konsiderueshme të materialeve që do të transportohen por edhe duke u bazuar në gjerësinë rrugëve ku do të kalojnë apo punojnë mjete të tilla. Në konsideratën tonë kufiri 7.5-18 nuk është i ngushtë. Përsa i përket kërkesës për mjetet e gërmimit bazohet në zërat e preventivit sipas manualit, volumit dhe shpërndarjes gjeografike në 11 rrugë. Konkretisht kemi zërat : 1. Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m<sup>3</sup>, ne kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne tok ku janë rreth 11,000 m<sup>3</sup> gërmime dhe janë parashikuar 2 mjete të tilla gërmimi 2. Gërmim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m<sup>3</sup>, ne kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet ku janë rreth 1200 m<sup>3</sup> dhe është parashikuar një mjet i tillë. Fadroma me goma është parashikuar një mjet i tillë duke u bazuar në zërat e preventivit sipas manualit, volumit. Konkretisht kemi zërat: Hedhje, rrafshim, Mbushje me material te dale nga gërmimi; Mbushje me zhavor te kanaleve. Kamion me vinç janë kërkuar 2 të tilla duke pasur parasysh punimet konkrete sipas preventivit, volumin dhe shpërndarjes gjeografike në 11 rrugë. Konkretisht për vendosjen në vepër të tubave të betonit rreth 7600 ml tubo betoni. Kamionçianat janë kërkuar për transportin e materialeve të punës apo dhe punonjesve në kantier. Janë kërkuar dy të tilla duke pasur parasysh kryesisht shpërndarjen gjeografik të punimeve.

**Observim:** Kërkesa e mësipërme bazohet në ligjin nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimin nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të

ndryshuar; ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar; VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”. Në nenin 5 të ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se: “Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.” Në pikat 8 dhe 9 të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar parashikohet se:“ Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.” Në pikat 4, 5 dhe 6 të VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” parashikohet se: Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorur në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 107, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. Termi “Zotërues i mbetjeve inerte”, në kuptimin e këtij vendimi, është person fizik ose juridik, i cili, gjatë aktivitetit të tij të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objekteve, prodhon, transporton ose trajton mbetje inerte të cilat janë të renditura në kapitullin 17, të vendimit nr. 99, datë 18.2.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, të ndryshuar. Zotëruesi i mbetjeve inerte, i cili kryen përpunim paraprak, përzierje apo procese të tjera, që ndryshojnë natyrën ose përbërjen e këtyre mbetjeve, është i detyruar t’i ruajë, t’i transportojë dhe t’i dorëzojë ato në lëndfill apo në venddepozitimin e përkohshëm në mënyrë të diferencuar, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 371, datë 11.6.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, si dhe vendimit nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”. Zotëruesi i mbetjeve inerte është i detyruar t’i dorëzojë këto mbetje tek operatorët, të cilët janë të pajisur me leje mjedisore, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, dhe me licencë të tipit III.2.B, sipas vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”. Në nenet 21 dhe 57 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar; parashikohet se: **Neni 21** : Krijuesi ose zotëruesi fillestar i mbetjeve e kryen trajtimin e tyre vetë ose përmes një tregtari a personi tjetër që kryen operacione trajtimi të mbetjeve, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”. **Neni 57**: 1. Transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve. 2. Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri. 3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, të ministrit përgjegjës për ekonominë dhe të ministrit përgjegjës për transportin, miraton rregullat për zbatimin e këtij neni.

**Observim:** AK ka përcaktuar qe keto kritere do të përmbushen nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i disponon mjetet e mësipërme, do të dorëzohet nga operatori ofertues i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Pra OE ekonomike nuk kane detyrim paraqitjen e lejes mjedisore ne momemtin e ofertimit duke mos ndikuar keshtu ne kufizimin e pjesemarrjes se OE. Paraqitja e ketij dokumentacioni do te behet vetem nga OE i i kualifikuar i pari. Pavaresisht se eshte nje dokument i personave te trete, ai i sherben AK per te vleresuar nese furnizuesi ka fabriken e kekuar dhe se e ushtron aktivitetin ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, duke e vene keshtu edhe ne pozita te barabarta me OE pjesemarrës qe keto fabrika mund ti kene ne pronesi. Për më tepër nëse një OE

disponon me qira një impiant të tillë duhet patjetër të ketë edhe lejen mjedisore QKL Kodi III.1.B, [pa të cilën nuk mund të ushtrojë aktivitetin. Për analogji kërkesa për paraqitjen e këtij dokumentacioni është e njëjtë si ajo për paraqitjen e dokumentacionit nga OE i kualifikuar i pari në rastet e marrjes me qira të mjeteve.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj Në aktkonstatimin nr. 15 dhe në Projektraport është cituar që kriteret nuk janë të justifikuar teknikisht, bazuar në preventivin e punimeve, pasi nisur edhe nga tabela e hartuar nga ana juaj për llojet e makineri/pajisjeve për zëra të ndryshëm pune, duket qartë që janë vendosur pajisje jo në propocion me zërat e punës duke ju referuar Kërkesat e veçanta të kualifikimit të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 18.11.2022. të cilat nuk janë të argumentuara teknikisht.

- Kërkesat e pikës 2.3.2 e DST e cila kërkon ndër të tjera Liçensa profesionale N.P - 5 “Punime nëntokësore, ura, vepra arti”, nuk është e argumentuar ligjërisht dhe për më tepër nuk është në përputhje me zbatueshmërinë dhe objektin e kontratës pasi projekti dhe preventivi i punimeve janë hartuar dhe procedohet për OE i cili do të marrë përsipër realizimin e objektit dhe kontratës së zbatimit të punimeve.

- Kriteret e vendosura në kërkesat e pikës 2.3.11/12/13 nuk janë të argumentuar teknikisht dhe ligjërisht pasi në rastet kur fabrika e betonit - elementeve të betonit - bordurave dhe pllakave nuk janë në pronësi të ofertuesit rezulton se kërkesa për paraqitjen me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për te cilën duhet te paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qerases/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, u drejtohet personave të tretë që nuk janë konkurrent në këtë procedurë prokurimi.

### 3. Të dhëna mbi objektin e prokurimit: Sistemim asfaltim i rrugëve “Grigor Nosi, Xhafer Duhanxhiu, Hasan Kopili” në lagjen 5 Maji

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Sistemim asfaltim i rrugëve “Grigor Nosi, Xhafer Duhanxhiu, Hasan Kopili” në lagjen 5 Maji</b>			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF- 21864-03-11-2022 Urdhri nr. 1288 prot., datë 10.03.2022	<b>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit</b> Urdhri nr.ska, datë 10.03.2022 1. z. E.S 2. z.O.K 3.znj A.M	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> 1. z. E.S 2. z.O.K 3.znj A.M	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 1288 prot., datë 11.03.2022. 1.z. K.L 2.z. K.H 3.z. Y.M
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 46,518,160 lekë	<b>5. Oferta fituese, vlera fituese:</b> Operatori Fitues: B.N Sh.p.k 43,635,704 lekë pa tvsh.		<b>6. Diferenca me fondin limit</b> 2,882,456 lekë pa tvsh
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 30.03.2022 ora 10:00	<b>8. Burimi Financimit</b> Buxheti i shtetit.		<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender, <b>4 OE</b> b) S’kualifikuar <b>1 BOE</b> “M.I.G & XH.” sh.p.k c) Kualifikuar <b>3 OE</b> 1. “B.N” sh.p.k 2. “BE – IS” Sh.p.k 3. “ ” Sh.p.k
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 3 muaj</b>			
<b>10.Ankimime</b> AK-s’ka	<b>11. Data e lidhjes të kontratës:</b> <b>Nr. 1288/6 prot., datë 10.06.2022</b>		<b>12.Përgjigje</b> Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK S’ka

#### ***a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.***

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se:

**AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit” :**

Me urdhër të zv. Kryetarit (Personi i Autorizuar) të Bashkisë Elbasan znj. A.B është ngritur një komision me urdhrin nr. 1288 prot., datë 10.03.2022 “Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit 46,518,160 lekë” me objekt: **“Sistemim asfaltim i rrugëve Grigor Nosi, Xhafer Duhanxhiu, Hasan Kopili” në lagjen 5 Maji** Në zbatim të këtij urdhri, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga, z. O.K, znj A.M dhe z. E.S.

Fondet janë miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë mbi fituesit e projekteve të reja për vitin 2022 e cila do financohet në dy vite 2022-2023. Çmimet e vendosura janë në përputhje me VKM-në nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”.

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve të vendosura.

**Situata 1:** Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej z.O.K , E.S dhe znj. A.M, të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 14.09.2022. Në lidhje me kriteret e vendosura, u konstatuar kriteret të ekzagjeruara dhe të paargumentuara. Në mënyrë të detajuar kriteret e konstatuara si të pa argumentuara dhe kriteret e argumentuara paraqiten si vijon:

**Kërkesat e pikës 2.3.2** cila kërkon ndër të tjera Liçensa profesionale N.P - 5 “Punime nëntokësore, ura, vepra arti” dhe **NP-11 A** “Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e te mesëm dhe shpërndarjen e energjisë” nuk është e argumentuar ligjërisht dhe për më tepër nuk është në përputhje me zbatueshmërinë dhe objektin e kontratës pasi projekti dhe preventivi i punimeve janë hartuar dhe procedohet për OE i cili do të marrë përsipër realizimin e objektit dhe kontratës së zbatimit të punimeve. Kriter i cili konsiderohet kufizues.

**Kërkesat e pikës 2.3.6 e DST** e cila kërkon që Ofertuesi duhet te disponoje ne pronësi apo me qira, keto makineri:

Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
Kamiona me kapacitet mbajtes minimalisht 20 ton	Cope	2	Ne pronësi ose me qira
Kamioncine me kapacitet mbajtes deri ne 3.5 ton	Cope	1	Ne pronësi ose me qira
Kamioncine me kapacitet mbajtes 1deri ne 2 ton	Cope	1	Ne pronësi ose me qira
Kamion me vinc	Cope	1	Ne pronësi ose me qira
Autobitumatrice	Cope	1	Ne pronësi ose me qira
Asfaltoshtruese	Cope	1	Ne pronësi ose me qira
Fadrome	Cope	1	Ne pronësi ose me qira
Eskavator me goma	Cope	3	Ne pronësi ose me qira
Eskavator me zinxhir	Cope	1	Ne pronësi ose me qira
Minieskavator me goma	Cope	1	Ne pronësi ose me qira
Minifadrome	Cope	1	Ne pronësi ose me qira
Autobetoniere	Cope	1	Ne pronësi ose me qira
Autopompe betoni	Cope	1	Ne pronësi ose me qira
Rrul hekur – gome me kapacitet 12 t	Cope	1	Ne pronësi ose me qira
Rrul hekur – gome me kapacitet 18 t	Cope	1	Ne pronësi ose me qira
Rrul asfalti me gome-gome 5 kapaciteti 5t	Cope	1	Ne pronësi ose me qira
Autobetoniere	Cope	1	Ne pronësi ose me qira
Greider me goma	Cope	1	Ne pronësi ose me qira
Autobot uji	Cope	1	Ne pronësi ose me qira
Kontenier stacioner	Cope	1	Ne pronësi ose me qira
Vibrator betoni	Cope	1	Ne pronësi ose me qira
Fabrike prodhimi inertesh	Cope	1	Ne pronësi,me qera ose kontrate furizimi
Fabrike prodhimi betoni	Cope	1	Ne pronësi,me qera ose kontrate furizimi



Fabrike prodhimi elemente betoni - bordura dhe pllaka betoni	Cope	1	Ne pronësi, me qera ose kontrate furizimi
Elekrosaldatrice	Cope	1	Ne pronësi ose me qira
Makine vijezi	Cope	1	Ne pronësi ose me qira

*Ky kriter për makineritë nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, mungon përlllogaritja dhe analiza, nuk argumentohet diferenca e vogël në kapacitetin e kërkuar. Kërkesat me diferenca minimaliste nuk i shërbejnë AK, se për çfarë u janë kërkuar OE pjesëmarrës, referuar grafikut dhe preventivit të punimeve.*

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me kërkesat e nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”.

*Sa më sipër mbanë përgjegjësi njësinë e prokurimit me përbërje z. O.K, znj A.M dhe z. E.S.*

***b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. ska, të datës 08.04.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	“B.N ” Sh.p.k	43,635,704	Kualifikuar
2	“BE-IS” Sh.p.k	43,731,445	Kualifikuar
3.	“V.H ” Sh.p.k	45,928,310	Kualifikuar
4	“M.I.G & X ” Sh.p.k	41,663,785	S’kualifikuar; 1. Referuar kontratës së bashkëpunimit të lidhur midis dy operatorëve ekonomikë "M.I " sh.p.k. dhe "XH." sh.p.k., me nr. Rep 1354, nr. Kol 251, me datë 29.03.2022, operatorët marrin përsipër realizimin e punimeve në raport 54% OE "XH. " sh.p.k. dhe 46% OE "M.I " sh.p.k., ndarje e cila është shprehur sipas zerave në preventivin e paraqitur në oferte. Gjatë shqyrtimit të preventivit, rezulton në fakt se OE "XH. " sh.p.k. do të realizojë 52.5 % të zërave të preventivit dhe OE "M.I " sh.p.k. dotë realizojë 47.4 % të realizimit, raporte keto të cilat nuk përputhen me raportet e përcaktuara në kontratën e bashkëpunimit. 2. Operatori ekonomik "XH." sh.p.k., ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit i cili ka pasaktesi, pasi në seksionin B: Deklarata për dorëzimin e ofertave të pavarura, pikat 6, 7, 8, 9, 10 ka deklaruar se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakortësi me ndonjë konkurent tjetër, ka deklaruar që kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesëve të tjerë në asnjë mënyrë, nderkohe që operatori ekonomik "XH. " sh.p.k. ka lidhur kontratë bashkëpunimi me operatorin ekonomik "M.I " sh.p.k., referuar kontratës së bashkëpunimit me nr. Rep 1354, nr. Kol 251, me datë 29.03.2022, duke u konsultuar e duke e përgatitur ofertën kështu, jo në mënyrë të pavarur. 3. BOE "M.I " sh.p.k. dhe "XH." sh.p.k., nuk përmbushin pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik: <b>2.3.1</b> Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**b)** punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet...}

Në përmbushje të këtij kriteri, OE "XH." sh.p.k. ka paraqitur 2 (dy) kontrata të lidhura me institucione shtetërore, konkretisht me objekte : "Mirëmbajtje me performancë Tiranë - Dajt - Qafë Mollë" si dhe "Mirëmbajtje me performancë Tiranë - Dajt - Qafë Mollë - Bizë - Qafë Priskë - Shkallë - Shëngjergj - Uzina e Traktorit - Lanabregas, Sauk, Farkë, me nr. 3 protokolli, datë 10.02.2021, ku ka qenë si BOE me operatorët "A-Sh" sh.p.k. dhe "M." sh.p.k..

Të dyja këto kontrata kanë mangësi në dokumentacion, pasi, që OE të vërtetonte përvojën e suksesshme, këto dy kontrata duhet t'i shoqëronte bashkë me Formularët e Vlerësimit, situacionet përfundimtare, aktet e kolaudimit, si dhe me procesverbalet e marrjes në dorëzim të punimeve të kryera.

Gjithashtu, OE "M.I" sh.p.k. ka paraqitur 4 (katër) kontrata, si mëposhte:

1. Kontrata "Ndërtim tombino dhe kanali në aksin rrugor Tiranë-Elbasan (aksi i vjetër) dhe ndërtimi i tombinos në aksin rrugor Uzina Traktori - Lanabregas.

2. Kontrata "Ndërtim godine industriale dhe shërbimi 3 kat me 1 kat nëntokë dhe mur rrethues".

3. Kontrata "Ndërtim trotuari dhe sistemim kanali "Gomsiqë", Shkodër.

4. Kontrata "Ndërtim pike logjistike agrobiznesi, zyra dhe ambiente ndihmëse për kompaninë Albaseed".

3(tre) nga kontratat e mesipërme (nr.2, nr.3 dhe nr.4) nuk konsiderohen si punime të ngjashme me objektin e prokurimit, pasi janë kontrata për objekte civile (ndertesa), dhe sistemim kanalesh, ndersa kontrata nr.1 e cila edhe pse ka punime te cilat konsiderohen te ngjashme me objektin e prokurimit, kjo kontrate nuk përmbush vleren e përcaktuar ne germen a) te pikes 2.3.1, vlere e cila duhet te jete sa 50% e vleres se fondit limit, pasi OE "M.I " sh.p.k. eshte kryesuesi i bashkimit te operatoreve, sic parashikohet ne VKM-ne nr.285, date 19.05.2021, neni 88, pika 3.

**4.** BOE "M.I " sh.p.k. dhe "XH." sh.p.k., nuk përmbushin pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik, në të cilën është kërkuar që operatorët duhet të paraqesin në formularin përmbledhës të vetedeklarimit, një deklaratë në lidhje me stafin që disponon, sipas formatit të mëposhtëm:

- Operatori ekonomik te paraqese deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesoni	Data e fillimit te marrdhenieve te punes	Nr/amzes/ekuivalent diplomes/certificates profesionale

Asnjëri nga operatorët nuk e ka deklaruar stafin teknik që disponon, sipas formatit të kërkuar.

**5.** BOE "M.I " sh.p.k. dhe "XH." sh.p.k., nuk përmbushin pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik, në lidhje me disponimin e mjeteve, si mëposhtë:

a) Kamionçina me kapacitet mbajtës deri ne 3.5 ton, nuk është deklaruar ne formularin përmbledhës te vetedeklarimit nga asnjëri prej operatorëve, madje asnjë dokumentacion qe vërteton disponimin e këtyre mjeteve.

b) Kamionçina me kapacitet mbajtes 1 deri ne 2 ton, nuk është deklaruar ne formularin përmbledhës te vetedeklarimit nga asnjëri prej operatorëve, madje asnjë dokumentacion qe vërteton disponimin e ketyre mjeteve.

c) Autobitumatriçe, është deklaruar vetëm nga OE "XH." sh.p.k., nuk është deklaruar ne formularin e vetedeklarimit, por nuk është deklaruar targa e këtij mjeti.

		<p>ç) Referuar preventivit të punimeve, zëri i analizës nr. 3.222/2 nr. 3.307, nr. 3.212/b-An, janë marrë përsipër të realizohen nga operatori "M.I" sh.p.k.. Për të realizuar këto zëra, kërkohen mjetet rrul, autobitumatrice dhe asfaltoshtruese, grejder me goma dhe autobot. Operatori ekonomik "M.I" sh.p.k., ka deklaruar ne formularin e vetedeklarimit, disponimin vetëm te mjetit grejder, por nuk ka deklaruar targën e këtij mjeti, ndërsa për mjetet e tjera te lartpërmendura nuk ka deklaruar as disponimin si dhe nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion tjetër.</p> <p>ç) AK ka kërkuar disponimin e 3(tre) eskavatorëve me goma, të dy operatorët kanë deklaruar që disponojnë vetëm nga 1(një) eskavator me goma, pra vetëm 2 dhe jo 3 që janë kërkuar, si dhe nuk kanë deklaruar asnjë targë për këto mjeteve.</p> <p>d) Minieskavatori me goma është deklaruar nga OE "XH." sh.p.k., por nuk ka deklaruar targën e këtij mjeti.</p> <p>dh) Rruli hekur – gomë me kapacitet 18 t dhe rruli asfalti me gome-gome kapacitet 5t, nuk është deklaruar disponimi, ne formularin përmbledhës te vetedeklarimit nga asnjëri prej operatorëve, madje asnjë dokumentacion qe vërteton disponimin e këtyre mjeteve.</p> <p>e) Vibratori i betonit nuk është deklaruar disponimi nga asnjë nga operatorët.</p> <p>ë) Për fabrikën e prodhimit të inerteve, fabrikën e prodhimit të betonit, fabrikën e prodhimit të elementëve të betonit si bordura dhe pllaka, si dhe për tubat e betonit Ø 200 mm dhe Ø 300 mm, OE "XH." sh.p.k. ka deklaruar se ka lidhur kontrata furnizimi. Nga dokumentacioni që ky OE ka ngarkuar në SPE rezulton se:  Për fabrikën e prodhimit të inerteve, është lidhur kontratë me shoqërinë "A." sh.p.k., por nuk është dorëzuar asnjë leje shfrytëzimi, planvendosje, leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, të kësaj fabrike.  Për fabrikën e prodhimit të betonit, është lidhur kontratë me shoqërinë "BIOBETON" sh.p.k., por nuk është dorëzuar asnjë leje shfrytëzimi, planvendosje, leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, të kësaj fabrike.  Për fabrikën e prodhimit të elementëve të betonit si bordura dhe pllaka, është lidhur kontratë me shoqërinë "B" sh.p.k., por nuk është dorëzuar asnjë skemë teknologjike e makinerisë, leje shfrytëzimi, planvendosje, leje mjedisore QKL, të kësaj fabrike.</p> <p>6. BOE "M.I" sh.p.k. dhe "XH." sh.p.k. nuk përmbushin pikën <b>2.3.7.</b> të Kapacitetit Teknik ku AK ka kërkuar: Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur (ne pronësi ose kontrate shërbimi) me leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis Kodi III.2.B. Asnjë nga OE nuk ka dorëzuar leje mjedisore siç është kërkuar në këtë pikë të veçantë të kapacitetit teknik.</p> <p><b>Sa mesipër, BOE "M.I" sh.p.k. dhe "XH." sh.p.k. nuk kualifikohet në lidhje me këtë kriter.</b></p>
--	--	--

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 08.04.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 4 operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar 3 OE, janë kualifikuar 1 BOE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 20.04.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë "B.N" Sh.p.k për të cilën është lidhur kontrata nr. 1288/6 prot datë 10.06.2022 për vlerën 43,635,704 lekë pa TVSH dhe vlera 52,362,845 lekë me TVSH, dhe me afat 3 (tre) muaj/deri më 10.09.2022 nga data e lidhjes së kontratës.

**Situata 2: Nga shqyrtimi i ofertës fituese, rezulton se OE nuk përmbush të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe konkretisht:**

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.5 të DST** e cila kërkon:

- 8 (tetë) Manovrator

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i renditur në vend të parë, dhe i shpallur fitues, rezulton se referuar vetdeklarimit dhe sipas listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat nga punësimi OE B.N ka të punësuar në kompani 2 punonjës të profilit shofer konkretisht

1. Z. L.B i punësuar pranë Shoqërisë "B.N" Shpk me Kontrate Individuale Pune date 05.01.2022 (e rinovuar) ne rolin Shofer Manovrator pajisur me Certificate te Sigurimit Teknik (IQT) Nr.019552 date certificate 06.05.2022 date skadimi 05.05.2023 ne profesionin Manovrator dhe Dëshmi Profesionale lëshuar me Nr.3552 date 23 .06.2020, date lëshimi 23.06.2020 dhe date skadimi 22.06.2025 për Eskavatoriste.

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i renditur në vend të parë, dhe i shpallur fitues, rezulton se ka deklaruar manovratorët z. L.B i cili figurojnë në listë pagesa me Kod punësimi 8332.14 – *shofer kamioni* në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve LKP të Rishikuar”.

**2. OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.6 të DST** pasi ka deklaruar mjeteve të transportit/ndërtimit sipas rastit, të deklaruar në shtojcën 8, si dhe për vërtetimin e disponimit të tyre ka dorëzuar dokumentacionin fizik, ku një pjesë e zotëron nëpërmjet qiramarrjes dhe një pjesë të tyre e ka në pronësi, konstatohet se për mjetet e mara me qira janë për përdorim vetiak konkretisht:

1. Mjeti Ekskavator me goma “KOMATSU” me targa AA014XP dhe mjeti Ekskavator me goma “ORESTEIN” me targa AA795SA dhe Kamionçina me targa AA208SA të dorëzuar fizikisht në muajin mars të 2022, nëpërmjet kontratës së qirasë Nr.Rep:805 dhe Nr.Kol:411 me subjektin “B ” Sh.p.k, por ky subjekt nuk disponon certifikatë për dhënien me qira të mjeteve për të tretë.

2. Referuar kontratës së qirasë Nr.Rep:816 dhe Nr.Kol:419 me subjektin “Z.” Sh.p.k, për Mjetin Ekskavator me goma me targa AFMT 65 nuk disponon certifikatë për dhënien me qira të mjeteve për të tretë.

Lidhur me sa më sipër, për certifikatat e transportit sqarojmë se: Në nenin 81, pika 1, 2, 3, 4, 5 dhe 7, 8 “Destinacioni dhe përdorimi i mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se:

1. Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike.
2. Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik.
3. Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët.
4. Quhet përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit.
5. Përdorimi nga të tretët përfshin:
  - a) dhënien me qira pa drejtues mjeti;
  - b) dhënien me qira me drejtues mjeti dhe shërbimi taksi për transport njerëzish;
  - c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh;
  - d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të treteve;
  - e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave;
  - f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të treteve.
- 7.Në aktet në zbatim janë përcaktuar karakteristikat konstruktive të mjetit në lidhje me destinacionin ose përdorimet, për të cilat ai mund të caktohet.
8. Duke përjashtuar dispozitat e ligjeve të posaçme, cilido që shfrytëzon një mjet me një destinacion ose për një përdorim të ndryshëm nga ato të treguara në lejen e transportit, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë”.

Në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se:

3.13. Transport për vete: transporti i mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi.

3.14. Transport për të tretë dhe me qira: transporti i mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira.

Në nenin 41, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse”. Pra, ligji “Për Transportet Rrugore”, bën qartësisht ndarjen midis çertifikatës së lëshuar për “Transport për vete” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet, ku në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi; si edhe çertifikatës së lëshuar për “Transport për të tretë dhe me qira” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira.

Në rastin konkret përmes dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se, çertifikatat janë dhënë në përdorim të vet pronarëve të mjeteve për kryerjen e transportit të mallrave me kamion (vetëm për llogari të veprimtarisë së vet). Në këtë mënyrë, kryerja e transportit nga ana e OE të mallrave me mjetet e mësipërme do të jenë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa certifikatën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për Transportet Rrugore” është i ndaluar. Mungesa e certifikatave të mësipërme, vërteton faktin se përdorimi i tij nga të tretë do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”.

### **Konkluzion**

Sa më sipër OE **nuk** plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE “B.N” shpk, si dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. Në këto kushte, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:

- nenin 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3:

*“3.Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.*

-nenin 99 “Anulimi i një procedure prokurimi, pika 1, germa (b):

*1.Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:  
b)në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;*

*Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje z. K.L , z. K.H dhe z. Y.K*

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

**Ndikimi/Efekti:** Ndikon në paraqitjen e ofertave nga operatorët ekonomikë.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Në observacionin e subjektit të audituar Bashkia Elbasan mbi Akt konstatimin nr.15 dërguar me shkresën nr. 4474/44 prot., dt. 22.11.2023 dhe me nr. 767/4 prot., (i KLSH) dt. 30.11.2023, shprehur si më poshtë vijon:

**Pretendimi i subjektit: Njësia e Prokurimit**

**Observim:** Kërkesa për pasjen ne licensën e shoqërise kategorinë NP-11 (Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e

energjisë elektrike), është bazuar tek zerrat e preventivit të projektit e konkretisht: Punimet elektrike të ndriçimit urban (F.V Shtylla metalike per ndricim H=7m, d=160mm; F.V Tuba Metalike D=140mm; F.V ne toke kablllo Al fuqie +1000V, me izolim gome 4\*4mm<sup>2</sup>; F.V Pusete elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm; F.V Elektrode togzimi te nxiguar L=150cm; F.V ndricues projektor me llampe SAP-T 250Ë etj. ) Në VKM Nr. 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar, lidhja 3- Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme përcaktohet si mëposhtë: N.P.11 Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore. Kërkesa për pasjen ne licensën e shoqërisë kategorinë NP-5 (Punime nëntokësore, ura e vepra arti), është bazuar tek zerrat e preventivit të projektit e konkretisht: Punime për ndërtimin e tombinove BOX (Shtresë zhavorri nëntombino t=10cm b=270cm l=11ml; parmakë ure, kolona B.A; fugë me gomë speciale me kanal të gjerë në ura etj). Në VKM Nr. 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar, lidhja 3- Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme përcaktohet si mëposhtë: N.P. 5 Punime nëntokësore, ura e vepra arti Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntoke që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi "goma" ose mbi "hekur", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo vepre lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele.

**Observim:** Kriteri që OE të disponojnë mjetet e kërkuara është bazuar në preventivin, grafikun natyrën e punimeve dhe numrin e rrugëve ku do të ndërhyet, gjithsej tre të tilla. Konkretisht : Është kërkuar 1 Rrul hekur – gome me kapacitet 12 t, 1 Rrul hekur – gome me kapacitet 18 t, 1 Rrul asfalti me gome-gome kapaciteti 5t dhe 1 grejder për punimet sipas preventivit: shtresë çakëlli, shtresë stabilizanti, shtresë binderi e shtresë asfaltobetonit. Është kërkuar 1 autobetoniere, 1 pompë betoni, vibrator betoni, fabrike prodhimi betoni për të gjitha punimet e betonit të parashikuara në preventiv si: Struktura monolite betoni te holla C 20/25 per borduren monolite me permasat 20 cm x 30 cm; Struktura monolite betoni/arme C 16/20 kunete betoni me gjeresi 40 cm me trashesi; Betonim themeli + xogli me buto/ beton C 12 / 15 me 20 % gure ( 0.4\*0.6+0.4\*0.4); Kollona betoni monolite C - 16/20 h~ 4 m (Kollona b/a monolite C - 12/15, pra 222 cope 0.2m x 0.25m x 1.2 m çdo 4 m ) etj. Është kërkuar 1 Fabrike prodhimi inertesh dhe 1 Fabrike prodhimi elemente betoni - bordura dhe pllaka betoni për shkak të sasisë së konsiderueshme të produkteve në preventiv, 4170 m<sup>2</sup> pllaka betoni, 1745 ml bordura betoni, mbi 20,000 m<sup>2</sup> inerte etj. Ështe kërkuar 1 kamion me vinq për punime të parashikuara në preventiv si Spostim shtylla b/arme H=7 m; Vendosije në vepër të Tombinove me tuba betoni; F.V Shtylla metalike per ndricim H=7m , d=160mm. Ështe kërkuar 1 makinë vijëzimi për punimet e sinjalistikës të parashikuara në preventiv konkretisht: Vijezim i rruges per kembesoret me boje bikomponente 54 m<sup>2</sup>; Vijezim i rruges anesor dhe i aksit me boje bikomponente me gjeresi 15 cm, gjithsej 777 ml. Janë kërkuar kamionë me kapacitet 20 ton për arsye të sasisë së konsiderueshme të materialeve që do të transportohen e konkretisht: mbi 2000 m<sup>3</sup> dheu; 26,000 m<sup>2</sup> inerte dhe asfalt, mbi 4700 m<sup>2</sup> pllaka betoni, mbi 1700 m<sup>2</sup> bordura betoni etj. Janë kërkuar

kamionçina për arsye të transportit materialeve të ndryshme si ato elektrike; të sinjalistikës, të pajisjeve e veglave të punës; punëtorëve etj. **Janë kërkuar** mjete gjurmimi për punimet e gjurmimit sipas preventivit. Sasia e mjeteve të kërkuar është në përputhje me volumin e konsiderueshëm të gjurmimeve, mbi 2000 m<sup>3</sup>.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj Në aktkonstatimin nr. 15 dhe në Projektraport është cituar që kriteret nuk janë të justifikuar teknikisht, bazuar në preventivin e punimeve, pasi nisur edhe nga tabela e hartuar nga ana juaj për llojet e makineri/pajisjeve për zëra të ndryshëm pune, duket qartë që janë vendosur pajisje jo në propocion me zërat e punës duke ju referuar Kërkesat e veçanta të kualifikimit të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 14.09.2022. të cilat nuk janë të argumentuara teknikisht.

- **Kërkesat e pikës 2.3.2** cila kërkon ndër të tjera Liçensa profesionale N.P - 5 “Punime nëntokësore, ura, vepra arti” dhe **NP-11 A** “Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e te mesëm dhe shpërndarjen e energjisë” nuk është e argumentuar ligjërisht dhe për më tepër nuk është në përputhje me zbatueshmërinë dhe objektin e kontratës pasi projekti dhe preventivi i punimeve janë hartuar dhe procedohet për OE i cili do të marrë përsipër realizimin e objektit dhe kontratës së zbatimit të punimeve.

### **Pretendimi i subjektit: KVO**

**Observim:** **1. OE "B.N" shpk ka vetëdeklaruar 2 punonjës shoferë, e konkretisht: 1. z.B.H me profesion Shofer** i punësuar pranë Shoqërisë "B.N" Shpk me Kontrate Individuale Pune ne date 05.01.2022 (e rinovuar) pajisur me Certificate Sigurimit Teknik (IQT) Nr.000049 date certificate 10.09.2021 date skadimi 09.09.2022 ne profesionin Shofer, Patente (Leje Drejtimi) dhe Certificate Aftesise Profesionale (CAP). **2. z. B.H me profesion Shofer** i punësuar pranë Shoqërisë "B.N" Shpk me Kontrate Individuale Pune ne date 05.01.2022 (e rinovuar) pajisur me Certificate Sigurimit Teknik (IQT) Nr.021822 date certificate 10.09.2021 date skadimi 09.09.2022 ne profesionin Shofer, Patente (Leje Drejtimi) dhe Certificate Aftesise Profesionale (CAP). **2. OE "B.N" shpk ka vetëdeklaruar 8 punonjës manovratorë, e konkretisht: 1. E. V. me profesion Manovrator** i punësuar pranë Shoqërisë "B.N" Shpk me Kontrate Individuale Pune ne date 05.01.2022 (e rinovuar) pajisur me Certificate Sigurimit Teknik Nr.011560 date certificate 01.11.2021 date skadimi 31.10.2022 dhe Deshmi Aftesise Profesionale leshuar nga DPSHTR Nr.1059/9 Date 27.07.2007 date leshimi 05.10.2020 dhe date skadimi 04.10.2025 per Eksvatorist. **2. Z.R.Sh me profesion Manovrator** i punësuar pranë Shoqërisë "B.N" Shpk me Kontrate Individuale Pune ne date 05.01.2022 (e rinovuar) pajisur me Certificate Sigurimit Teknik Nr.011561 date certificate 01.11.2021 date skadimi 31.10.2022 dhe Deshmi Aftesise Profesionale leshuar nga DPSHTR 2693 date 18.09.2015 date leshimi 29.09.2020 dhe date skadimi 28.09.2025 per Eksvatorist. **3. Z. E.Ll me profesion Manovrator** i punësuar pranë Shoqërisë "B.N" Shpk me Kontrate Individuale Pune ne date 05.01.2022 (e rinovuar) pajisur me Certificate Sigurimit Teknik Nr.019721 date certificate 19.05.2022 date skadimi 18.05.2023 dhe Deshmi Aftesise Profesionale leshuar nga DPSHTR Nr.762 date 07.06.2012 date leshimi 12.08.2022 dhe date skadimi 11.08.2027 per Automakinist. **4. Z.L.B i punësuar pranë Shoqërisë "B.N" Shpk me Kontrate Individuale Pune date 05.01.2022 (e rinovuar) ne rolin Shofer Manovrator** pajisur me Certificate te Sigurimit Teknik (IQT) Nr.019552 date certificate 06.05.2022 date skadimi 05.05.2023 ne profesionin Manovrator dhe Deshmi Profesionale leshuar me Nr.3552 date 23.06.2020, date leshimi 23.06.2020 dhe date skadimi 22.06.2025 per Eskavatorist. **5. Z. R.S i punësuar pranë Shoqërisë "B.N" Shpk me Kontrate Individuale Pune date 05.01.2022 (e rinovuar) ne rolin Shofer Manovrator** pajisur me Certificate te Sigurimit Teknik (IQT) Nr.013673 date certificate 12.01.2022 date skadimi 11.01.2023 ne profesionin Manovrator dhe Leje Manovrimi per Automakiniste. **6. Z. M.B me profesion Manovrator i punësuar pranë Shoqërisë "B.N" Shpk me Kontrate Individuale Pune ne date 05.01.2022 (e rinovuar) ne rolin Drejtues te makinave te renda** pajisur me Certificate Sigurimit Teknik Nr.022104 date certificate

01.11.2021 date skadimi 31.10.2022 dhe Deshmi Aftesise Profesionale leshuar nga DPSHTR Nr.2442 Date 17.06.2015 date leshimi 15.09.2020 dhe date skadimi 14.09.2025 per Eskavatorist **7. Z. S.Z me profesion Manovrator** i punesuar me kontrate pune kontraktuale per objektin e prokurimit ne rast fitimi nga Shoqeria "B.N" Shpk i pajisur me Certificate te Sigurimit Teknik (IQT) Nr. 02848 date certificate 17.03.2022 date skadimi 16.03.2023 ne profesionin Manovrator dhe Deshmi Profesionale Nr.223 date 25.10.1982, date leshimi 12.11.2021 dhe date skadimi 11.11.2026 per Buldozeriste. **8. Z. R.K me profesion Manovrator** i punesuar me kontrate pune kontraktuale per objektin e prokurimit ne rast fitimi nga Shoqeria "B.N" Shpk i pajisur me Certificate te Sigurimit Teknik (IQT) Nr.013672 date certificate 17.03.2022 date skadimi 16.03.2023 ne profesionin Manovrator dhe Deshmi Profesionale Nr.1495 date 30.05.2014, date leshimi 06.06.2019 dhe date skadimi 05.06.2024 per Buldozerist. Përsa i përket konstatimit të parashtruar nga ana juaj se z. L.B figuron në listë pagesa me Kod punësimi 8332.14 – shofer kamioni në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve LKP të Rishikuar”, ju sqarojmë se: Në kriterin e pikës **2.3.6 të DST** nuk është kërkuar që punonjësit të figurojnë në listë pagesa me Kod punësimi sipas kualifikimit të kërkuar. KVO vlerëson ofertat vetëm mbi kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit. OE i është kërkuar që të kenë punonjës të kualifikuar duke përcaktuar edhe dokumentacionin konkret që duhet të paraqesin (kontratën e punës së vlefshme, dëshminë e drejtimit të vlefshme, lëshuar nga institucionet përkatëse, dëshmitë e drejtimit të lëshuara nga D.P.SH.T Rrugore), dokumentacion të cilin OE e ka paraqitur. Pra OE ka përmbushu kërkesat e e pikës **2.3.6 të DST**. **Vlen të theksohet se një punonjës mund të ketë një apo më shumë kualifikime dhe është në diskrecionin e OE deklarimi i profesionit në listëpagesë.**

**Observim: 1.** Përsa i përket konstatimit të parashtruar nga ana juaj se Mjeti Eskavator me goma “KOMATSU” me targa AA014XP dhe mieti Eskavator me goma “ORESTEIN” me targa AA795SA dhe Kamioncina me targa AA208SA të dorëzuar fizikisht në muajin mars të 2022, nëpërmjet kontratës së qirasë Nr.Rep:805 dhe Nr.Kol:411 me subjektin “B ” Sh.p.k, por ky subjekt nuk disponon certifikatë për dhënien me qira të mjeteve për të tretë, ju sqarojmë se certifikatë për dhënien me qira të mjeteve për të tretë është vetëm për kamion për transport mallrash, siç edhe përcaktohet në parashikimet ligjore të cituara nga ana juaj. Mjeti eskavator nuk është mjet për transport mallrash por mjet gërmimi. **2.** Përsa i përket konstatimit të parashtruar nga ana juaj se Referuar kontratës së qirasë Nr.Rep:816 dhe Nr.Kol:419 me subjektin “Z.” Sh.p.k, për Mjetin Eskavator me goma me targa AFMT 65 nuk disponon certifikatë për dhënien me qira të mjeteve për të tretë, ju sqarojmë se se certifikatë për dhënien me qira të mjeteve për të tretë është vetëm për kamion për transport mallrash, siç edhe përcaktohet në parashikimet ligjore të cituara nga ana juaj. Mjeti eskavator nuk është mjet për transport mallrash por mjet gërmimi, duke përmbushur kërkesën e parashikuar në pikën **2.3.10 të DST**.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj nuk meren në konsiderat pasi është detyre e KVO të bëjë verifikimin fizik të dokumentacionit të OE të shpallur fituaes. Gjithashtu persa i përket kriterit të pikës **2.3.6 të DST** OE B.N ka deklaruar mjeteve të transportit/ndërtimit sipas rastit, të deklaruar në shtojcën 8, si dhe për vërtetimin e disponimit të tyre ka dorëzuar dokumentacionin fizik, ku një pjesë e zotëron nëpërmjet qiramarrjes dhe një pjesë të tyre e ka në pronësi, konstatohet se për mjetet e mara me qira janë për përdorim vetiak.

4. *Të dhëna mbi objektin e prokurimit: Rikonstruksion, shtesë 4-kat dhe palester Shkolla Artistie Onufri (e mesme e bashkuar)*

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *“Rikonstruksion, shtesë 4-kat dhe palester Shkolla Artistie Onufri” (e mesme e bashkuar)*



<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “E Hapur REF- 41709-09-14-2022 Urdhri nr. 4305 prot., datë 14.09.2022	<b>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit</b> Urdhri nr. S’ka, datë 14.09.2022 1. z.O.K 2. z. E.S 3. z. A.B	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> 1. z.O.K 2. z. E.S 3. z. A.B	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 4305/2 prot., datë 14.09.2022. 1. znj A.M 2. z. K.H 3. z. Y.M
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 173,252,378 lekë	<b>5. Oferta fituese, vlera fituese:</b> Operatori Fitues: 159,373,270 lekë pa tvsh.		<b>6. Diferenca me fondin limit</b> 13,879,108 lekë pa tvsh
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 30.09.2022	<b>8. Burimi Financimit</b> Buxheti i shtetit.		<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender, <b>3 OE</b> b) S’kualifikuar <b>2 OE</b> , “B.N ” Sh.p.k “BE – IS” Sh.p.k c) Kualifikuar <b>1 OE</b> ; “E ” Sh.p.k
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 11 muaj</b>			
<b>10. Ankimime</b> AK-s’ka APP-s’ka KPP-s’ka	<b>11. Data e lidhjes të kontratës:</b> Nr. 4305/6 prot., datë 26.10.2022		<b>12. Përgjigje</b> Ankesës nga APP, AK apo <b>KKP: AK S’ka</b>

***a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.***

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

**NJËSIA E PROKURIMIT**

Me urdhër të zv. Kryetarit (Personi i Autorizuar) të Bashkisë Elbasan znj. A.B është ngritur një komision me urdhrin nr. 4305 datë 14.09.2022 “Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit 173,252,378 lekë” me objekt: **“Rikonstruksion, shtesë 4-kat dhe palester Shkolla Artistike Onufri” (e mesme e bashkuar.**

Në zbatim të këtij urdhri, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga, z. O.K, z. A.B dhe z. E.S.

***AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit” :***

Fondet janë miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë mbi fituesit e projekteve të reja për vitin 2022 në bashkëfinancim me Bashkinë Elbasan ku MAS do mbulojë 70% të vlerës dhe bashkia 30% e cila do financohet në dy vite 2022-2023. Çmimet e vendosura janë në përputhje me VKM-në nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”.

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve të vendosura.

**Situata:** Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej z.O.K, E.S dhe z. A.B , të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 14.09.2022. Në lidhje me kriteret e vendosura, u konstatuar kriteret e ekzagjeruara dhe të paargumentuara. Në mënyrë të detajuar kriteret e konstatuara si të pa argumentuara dhe kriteret e argumentuara paraqiten si vijon:

**Kërkesat e pikës 2.3.2 e DST** e cila kërkon ndër të tjera Liçensa profesionale **N.P - 11 A** “Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike” dhe **N.S - 9 A** Punime strukturore speciale *nuk është e argumentuar ligjërisht dhe për më tepër nuk është në përputhje me zbatueshmërinë dhe objektin e kontratës pasi projekti dhe preventivi i punimeve janë hartuar dhe procedohet për OE i cili do të*

*marrë përsipër realizimin e objektit dhe kontratës së zbatimit të punimeve. Kriter i cili konsiderohet kufizues.*

**Kërkesat e pikës 2.3.4 e DST** e cila kërkon, një punësim mesatar **për periudhën Qershor 2022 - Gusht 2022**, i të paktën **100** (njëqind) personave, *nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, konsiderohet diskrimues pasi sjell pabarazi ndërmjet OE. Referuar listës së punonjësve të kërkuar, janë rreth 38 duke filluar nga Drejtues projekti me licencën e shoqërisë si drejtues teknik, inxhinierë dhe punonjës të natyrave të ndryshme për të përmbushur detyrimet kontraktuale, ndërkohë që një numër mesatar jo më pak se 100 punonjës me kohë të plotë për periudhën Qershor 2022 - Gusht 2022, që i është kërkuar OE ofertues, ndikon në kufizimin e pjesëmarrjes së tyre.*

**Kërkesat e pikës 2.3.6 e DST** e cila kërkon që operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf dhe punonjës të kualifikuar, 1 (një) Arkitekt. *Kërkesa për arkitekt në këtë procedurë nuk është e argumentuar ligjërisht dhe për më tepër nuk është në përputhje me zbatueshmërinë dhe objektin e kontratës pasi projekti dhe preventivi i punimeve janë hartuar dhe procedohet për OE i cili do të marrë përsipër realizimin e objektit dhe kontratës së zbatimit të punimeve. Kriter i cili konsiderohet kufizues.*

**2. Kërkesa e pikës 2.3.6 e DST** e cila kërkon nga OE të kenë të punësuar minimalisht 4 punonjës manovratorë të mjeteve të rënda, është kërkesë e paargumentuar dhe jo në përputhje me numrin e mjeteve të rënda për të cilën kërkohen manovratorët. Konkretisht, në pikën **2.3.10 të DST**, kërkohet 2 Eskavator me goma, 1 miniekskavator, 1 Eskavator me zinxhir dhe 1 Fadrome me goma mjetet të cilat drejtohet nga manovratorët. Sa më sipër, kërkesa për 4 manovratorë nuk përputhet me mjetet e kërkuara.

**3. Kërkesa e pikës 2.3.6 e DST** e cila kërkon nga OE të kenë të punësuar minimalisht 4 shofere është kërkesë e paargumentuar dhe jo në përputhje me numrin e mjeteve të rënda për të cilën kërkohen shofer. Konkretisht, në pikën **2.3.10 të DST**, kërkohet 3 Automjete vetëshkarkuese me mase maksimale të autorizuar 7.5-18 ton, 2 Automjete vetëshkarkuese me mase maksimale të autorizuar mbi 18 ton, 2 Autobetoniere, 1 Kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5-5 Ton, 1 Kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 Ton, 1 Autobot uji dhe 2 Kamion vinc. Sa më sipër, kërkesa për 4 shofer nuk përputhet me mjetet e kërkuara.

**Kërkesat e pikës 2.3.7 e DST** e cila kërkon që operatori ekonomik të ketë në stafin e tij:

- 2 (dy) punonjës/specialistë të çertifikuar për “*Punime në lartësi*”, sipas VKM-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, e dhënë nga një organizem i liçencuar çertifikimi shqiptar ose i huaj.

*Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht për ekspert mjedisi në lidhje e në funksion të objektit të kontratës.*

- 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikate “Përgjegjës për dëmet në mjedis” gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, (I ndryshuar). *Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht për ekspert mjedisi në lidhje e në funksion të objektit të kontratës.*

**Kërkesat e pikës 2.3.8 e DST** e cila kërkon që Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme” ose të kete kontrate sherbimi noteriale për objektin konkret me shoqeri të licensuara, *nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht në lidhje dhe në funksion.*

**Kërkesat e pikës 2.3.10 e DST** e cila kërkon që operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion të cilat janë si më poshtë vijon:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Automjete vetëshkarkuese me mase maksimale të autorizuar 7.5-18 ton	Pronësi/Qera	copë	3
2	Automjete vetëshkarkuese me mase maksimale të autorizuar mbi 18 ton	Pronësi/Qera	cope	2
3	Eskavator me goma	Pronësi/Qera	copë	2
4	Eskavator me zinxhir	Pronësi/Qera	copë	1
5	Minieskavator	Pronësi/Qera	copë	1
6	Fadrome me goma	Pronësi/Qera	copë	1
7	Autobetoniere	Pronësi/Qera	copë	2
8	Autopompe Betoni	Pronësi/Qera	copë	1
9	Kamionçinë me kapacitet mbajtes 3.5-5 Ton	Pronësi/Qera	copë	1
10	Kamionçinë me kapacitet mbajtes 3.5 Ton	Pronësi/Qera	copë	1
11	Autobot uji	Pronësi/Qera	copë	1
12	Kamion vinc	Pronësi/Qera	copë	2
13	Badibald/Kompator	Pronësi/Qera	copë	1
14	Vinç Kullë	Pronësi/Qera	copë	1
15	Pompë suvatimi	Pronësi/Qera	copë	2
16	Nivelues Helikopter	Pronësi/Qera	copë	1
17	Saldatriçe	Pronësi/Qera	copë	1
18	Gjeneratorë	Pronësi/Qera	copë	2
19	Vibrator betoni	Pronësi/Qera	copë	2
20	Armaturë (dërrasë ose panele)	Pronësi/Qera	m <sup>2</sup>	1500
21	Skeleri	Pronësi/Qera	m <sup>2</sup>	1500
22	Pirun teleskopik	Pronësi/Qera	copë	2
23	Tranxh Hekuri	Pronësi/Qera	copë	1

*Ky kriter për makineritë nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish, se për çfarë u janë kërkuar OE pjesëmarrës, referuar grafikut dhe preventivit të punimeve.*

*Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me kërkesat e nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:*

*“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”.*

*Sa më sipër mbanë përgjegjësi njësin e prokurimit me përbërje z. O.K dhe z. A.B dhe z. E.S .*

### **b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.**

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. s’ka të datës 10.10.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	“E ” sh.p.k	159,373,270 lekë	Kualifikuar
2	“B.N .” sh.p.k	167,624,913 lekë	<p><b>1.</b> Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës në kundërshtim me parashikimet e neneve 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe me kërkesën e parashikuar në pikën 1/b të kriteve të veçanta për kualifikim ku kërkohet:</p> <p>1. Ofertuesi duhet të paraqesë:</p> <p><i>b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.</i></p> <p>2. Asnjë nga kontratat e paraqitura nuk e ka vlerën sa minimumi 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Gjithashtu vlera totale e kontratave të paraqitura është më e vogël se dyfishi i vlerës limit</p>

		<p>të kontratës që prokurohet, duke mos përmbushur kërkesën e parashikuar ne pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik, të kritereve të veçanta për kualifikim ku kërkohet:</p> <p><b>2.3.1</b> Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:</p> <p><b>a)</b> punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.</p> <p><b>b)</b> punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.</p> <p><b>3.</b> Nuk ka deklaruar në shtojcën 8 të vetëdeklarimit/nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të vërtetojë se keni të punësuar staf dhe punonjës të kualifikuar, si mëposhtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 2 (dy) pllakashtrues</li> </ul> <p>duke mos përmbushur kërkesën e parashikuar ne pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik, të kritereve të veçanta për kualifikim.</p> <p><b>4.</b> Nuk ka deklaruar në shtojcën 8 të vetëdeklarimit/nuk keni paraqitur asnjë dokumentacion që të vërtetojë se dispononi mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës, duke mos përmbushur kërkesën e parashikuar ne pikën 2.3.10 të kapacitetit teknik, të kritereve të veçanta për kualifikim e konkretisht:</p> <p>1 Kamion me vinç 1 Vibrator betoni 1 Pirun teleskopik</p> <p><b>5.</b> Nuk ka deklaruar në shtojcën 8 të vetëdeklarimit/nuk keni paraqitur asnjë dokumentacion që të vërtetojë se dispononi 1 (një) fabrike betoni, duke mos përmbushur kërkesën e parashikuar ne pikën 2.3.11 të kapacitetit teknik, të kritereve të veçanta për kualifikim ku kërkohet:</p> <p><b>2.3.11</b> <i>Operatorët ekonomikë duhet të kenë pronësi/kontrate qeraje/kontrate furnizimi 1 (një) fabrike betoni, e cila duhet të jetë e pajisur me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për të cilën duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qeraje/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B.</i></p> <p><b>6.</b> Nuk ka paraqitur autorizim/kontrate bashkëpunimi/furnizimi nga prodhuesi/distributori, për produktin Hekur, duke mos përmbushur kërkesën e parashikuar ne pikën 2.3.13 të kapacitetit teknik, të kritereve të veçanta për kualifikim ku kërkohet:</p> <p><b>2.3.13</b> <i>Ne përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin përkatës të publikuar në SPE, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkëpunimi/furnizimi nga prodhuesi/distributori, për produktin Hekur.</i></p> <p><i>Në rast paraqitjeje të autorizimit nga Distributori duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit të autorizuar.</i></p> <p><b>7.</b> Nuk ka paraqitur kontratë noteriale furnizimi me prodhuesin/t ose distributorin/ët zyrtare të tyre për produktin Bojë për lyerjen e godinave, duke mos përmbushur kërkesën e parashikuar ne pikën 2.3.14 të kapacitetit teknik, të kritereve të veçanta për kualifikim ku kërkohet:</p> <p><b>2.3.14</b> <i>Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë noteriale furnizimi me prodhuesin/t ose distributorin/ët zyrtare të tyre për produktin Bojë për lyerjen e godinave, ambienteve të brendshme dhe të jashtme, shoqëruar me EN ISO 9001:2015, EN ISO 14001:2015, ISO 45001:2015 dhe PASS 99:2012, raport analizimi për bojë lyerje muri, lëshuar nga inspektoriati shtetëror teknik dhe industrial ose institucione të tjera të</i></p>
--	--	---

			<p>akredituara. Ne rastin e kontratës me distributorin te dokumentohet lidhja e tij me prodhuesin.</p> <p><b>8.</b> Nuk ka paraqitur kontrate bashkëpunimi/furnizimi noteriale, për pajisjet e ngrohjes, duke mos përmbushur kërkesën e parashikuar ne pikën 2.3.15 te kapacitetit teknik, te kriterëve te veçanta për kualifikim ku kërkohet:</p> <p><b>2.3.15</b> Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit përkatës, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrate bashkëpunimi/furnizimi noteriale, për pajisjet e ngrohjes, pajisur me katalogë nga prodhuesi/distributor i autorizuar, deklarate konformiteti EN 303-5:2012 ekuivalente/barasvlershme nga një laborator i autorizuar për pajisjet e ngrohjes, të cilat duhet të jenë të çertifikuara sipas standarteve ISO 9001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, e vlefshme, ose ekuivalente/e barasvlefshme. Në rast paraqitjeje te autorizimit nga Distributori duhet te paraqitet dokumentacioni qe verteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit te autorizuar.</p>
3	“BE-IS” sh.p.k	167,802,189 lekë	<p><b>1.</b> Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës në kundërshtim me parashikimet e neneve 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe me kërkesën e parashikuar ne pikën 1/b te kriterëve te veçanta për kualifikim ku kërkohet:</p> <p><b>1. Ofertuesi duhet të paraqesë:</b></p> <p><i>b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.</i></p> <p><b>2.</b> Nuk ka deklaruar ne shtojcën 8 të vetëdeklarimit/nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion qe te vërtetojë se dispononi mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës, duke mos përmbushur kërkesën e parashikuar ne piken 2.3.10 te kapacitetit teknik, te kriterëve te veçanta për kualifikim e konkretisht:</p> <p>2 Automjete vetëshkarkuese me mase maksimale te autorizuar 7.5-18 ton</p> <p>1 Eskavator me zinxhir</p> <p>1 Kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5</p> <p>1 Kamion me vinç</p> <p>1 Vinç kullë</p> <p>1 Vibrator betoni</p> <p>Armaturë (dërrasë ose panele)</p> <p>2 Pirun teleskopik</p> <p><b>3.</b> Nuk ka deklaruar ne shtojcën 8 të vetëdeklarimit/nuk keni paraqitur asnjë dokumentacion qe te vërtetojë se dispononi 1 (një) fabrike te prodhimit te elementeve te betonit - bordurave dhe pllakave, duke mos përmbushur kërkesën e parashikuar ne piken 2.3.12 te kapacitetit teknik, te kriterëve te veçanta për kualifikim ku kërkohet:</p> <p><b>2.3.12</b> Operatoret ekonomike duhet te kenë ne pronësi/kontrate qiraje/kontrate furnizimi 1 (një) fabrike te prodhimit te elementeve te betonit - bordurave dhe pllakave, e cila duhet te jete e pajisur me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për te cilën duhet te paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qerases/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B.</p> <p><b>4.</b> Nuk ka paraqitur autorizim/kontrate bashkëpunimi/furnizimi nga prodhuesi/distributori, për produktin Hekur, duke mos përmbushur kërkesën e parashikuar ne pikën 2.3.13 te kapacitetit teknik, te kriterëve te veçanta për kualifikim ku kërkohet:</p> <p><b>2.3.13</b> Ne përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin përkatës te publikuar ne SPE, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkëpunimi/furnizimi nga prodhuesi/distributori, për produktin Hekur.</p>

		<p><i>Në rast paraqitjeje te autorizimit nga Distributori duhet te paraqitet dokumentacioni qe vërteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit te autorizuar.</i></p> <p><b>5.</b> Nuk ka paraqitur kontratë noteriale furnizimi me prodhuesin/t ose distributorin/ët zyrtare te tyre për produktin Bojë për lyerjen e godinave, duke mos përmbushur kërkesën e parashikuar ne pikën 2.3.14 te kapacitetit teknik, te kriterëve te veçanta për kualifikim ku kërkohet:</p> <p><b>2.3.14</b> <i>Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë noteriale furnizimi me prodhuesin/t ose distributorin/ët zyrtare te tyre për produktin Bojë për lyerjen e godinave, ambienteve të brendshme dhe të jashtme, shoqëruar me EN ISO 9001:2015, EN ISO 14001:2015, ISO 45001:2015 dhe PASS 99:2012, raport analizimi për bojë lyerje muri, lëshuar nga inspektoriat shtetëror teknik dhe industrial ose institucione të tjera të akredituara. Ne rastin e kontratës me distributorin te dokumentohet lidhja e tij me prodhuesin.</i></p> <p><b>6.</b> Nuk ka paraqitur kontrate bashkëpunimi/furnizimi noteriale, për pajisjet e ngrohjes, duke mos përmbushur kërkesën e parashikuar ne pikën 2.3.15 te kapacitetit teknik, te kriterëve te veçanta për kualifikim ku kërkohet:</p> <p><b>2.3.15</b> <i>Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit përkatës, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrate bashkëpunimi/furnizimi noteriale, për pajisjet e ngrohjes, pajisjur me katalogë nga prodhuesi/distributor i autorizuar, deklarate konformiteti EN 303-5:2012 ekuivalente/barazvlefshme nga një laborator i autorizuar për pajisjet e ngrohjes, të cilat duhet të jenë të çertifikuara sipas standarteve ISO 9001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, e vlefshme, ose ekuivalente/e barazvlefshme.</i></p> <p><i>Në rast paraqitjeje te autorizimit nga Distributori duhet te paraqitet dokumentacioni qe vërteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit te autorizuar.</i></p>
--	--	---

***c- Në lidhje me procedurën shqyrtimit të ankimeve. (Nuk ka patur ankime)***

Në lidhje me klasifikimin dhe vlerësimin e OE për procedurën e sipërcituar, ndër të tjera, rezulton se nuk janë paraqitur ankesa nga OE, duke kundërshtuar skualifikimin dhe pretendimet e AK.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më nr. 4305/4 datë 19.10.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 3 operatorë pjesëmarrës janë s’kualifikuar 2 OE, janë kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 19.10.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “E” Sh.P.K për të cilën është lidhur kontrata nr. 4305/6 prot., datë 26.10.2022 për vlerën 159,373,270 lekë pa TVSH dhe vlera 191,247,923 lekë me TVSH, dhe me afat 11 (Njëmbëdhjetë muaj nga data e lidhjes së kontratës.

***Situata 2: Nga shqyrtimi i ofertës fituese, rezulton se OE nuk përmbush të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe konkretisht:***

1.OE fitues, nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** e cila kërkon nga OE të paraqesë një dokument që ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Pushteti Vendor për vitin 2021. Në dokumentacionin e ngarkuar në SPE, OE ka deklaruar si punë të ngjashme kryerjen e punimeve për objektin “Rindërtim i njërive të banimit në ndërtesa (pallate) për zonën e re për zhvillim Manëz, Objekti (A1, A2, B1 dhe B3) njësi banimi në ndërtesa (pallat) njësia administrative Manëz, Bashkia Durrës. Sa më sipër, rezulton se OE nuk ka pasqyruar në

QKB punimet e mësipërme të cilat shtrihen gjatë vitit 2021, duke shmangur detyrimet përkatëse për taksat dhe tarifatat vendore në vendin ku ushtrojnë aktivitetin.

2. OE fitues, nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.10 të DST** e cila kërkon 2 Eskavator me goma Në dokumentacionin e ngarkuar në SPE, OE ka deklaruar 1 Eskavator me goma respektivisht me targa AA 917 BY.

3. OE fitues, nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.12 të DST** e cila kërkon nga OE të jenë të pajisur me licencë për "Grumbullim dhe transportim i mbetjeve në mjedis", (Kodi III.1.B). Rezulton se OE nuk e disponon këtë licencë apo ndonjë kontrat të ngjashme e cila duhet te jete e pajisur me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për të cilën duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qerases/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B.

### **Konkluzion**

Sa më sipër OE **nuk** plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE "E" shpk, si dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. Në këto kushte, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:

- nenin 92 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3:

*"3.Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.*

-nenin 99 "Anulimi i një procedure prokurimi, pika 1, germa (b):

*1.Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:  
b)në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;*

*Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje znj A.M , z. K.H dhe z. Y.M*

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

**Ndikimi/Efekti:** Ndikon në paraqitjen e ofertave nga operatorët ekonomikë.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Në observacionin e subjektit të audituar Bashkia Elbasan mbi Akt konstatimin nr.15 dërguar me shkresën nr. 4474/44 prot., dt. 22.11.2023 dhe me nr. 767/4 prot., (i KLSH) dt. 30.11.2023, shprehur si më poshtë vijon:

### **Prendimi i subjektit: Njësia e Prokurimit**

**Observim:** Kërkesa për pasjen ne licensën e shoqërise kategorinë NP-11 (Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike), është bazuar tek zerat e preventivit të projektit e konkretisht: Punime elektrike ne ambientet e jashtem tek lulishtja (F.V Shtylla metalike per ndricim H=7m, d=160mm; F.V Tuba Metalike D=140mm; F.V ne toke kablllo Al fuqie +1000V,me izolim gome; F.V Pusete elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm; F.V Elektrode togzimi te nxiguar L=150cm; F.V ndricues projektor me llampe SAP-T 250Ë etj. ) Në VKM Nr. 42, datë 16.01.2008 " Për Miratimin e Rregullores për Kriteret dhe Procedurat e Dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit Dhe Disiplinimit Të Subjekteve Juridike, Që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi", i ndryshuar, lidhja 3-Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme përcaktohet si mëposhtë: .P.11 Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për

transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore. Kërkesa për pasjen në licensën e shoqërisë kategorinë NS-9 A (Punime strukturore speciale), është bazuar tek zerat e preventivit të projektit për punimet për ndërtimin e objektit të ri dhe palestrës e konkretisht: Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 25/30; Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 20/25; kollona b/a monolite C 25/30 h ~ 4m; Trare e arkitrare b/a C25/30 h ~ 4m; Arkitrare b/a C - 16/20, h ~ 4 m Në VKM Nr. 42, datë 16.01.2008 "Për Miratimin e Rregullores për Kriteret dhe Procedurat e Dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit Dhe Disiplinimit Të Subjekteve Juridike, Që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi", i ndryshuar, lidhja 3- Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme përcaktohet si mëposhtë: N.S- 9 Punime strukturore special Konsiderohet ndërtimi i objektit i destinuar për transmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuara për t'u ndërtuar në terrene rezistente dhe jo të deformueshme, por me parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotëve të çfarëdolloj tipi, të themeleve nëntokësore me pilotë ose me mure mbajtëse, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale, përshtirë edhe marrjen e kampioneve për analiza laboratoriale nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve. Impermeabilizzazione dhe konsolidimin e terreneve.

**Observim:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Numri i punonjësve është vendosur duke u bazuar në grafikun e punimeve të hartuar nga inxhinierët e Drejtorisë së Projektimit dhe Azhurnimit Topografik të Bashkisë Elbasan në përputhje me VKM-në nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre", ku për çdo zë të punime janë përcaktuar edhe orët e punës për njësi sipas përcaktimeve të nenit 78, pika 1 dhe 4 të Kodit të Punës, që përcakton kohëzgjatjen normale të ditës së punës 8 orë, nenit 83 që përcakton kohëzgjatjen javore të punës, jo më shumë se 40 orë dhe nenit 92 e vijues mbi pushimet vjetore që i takojnë punëmarrësit. Sipas këtij grafiku numri i ditëve të punës që do të duheshin një punonjësi për të kryer punimet është **24021 ditë pune**. Duke u nisur nga kompleksiteti dhe rëndësia e projektit dhe interesave të AK për përfundimin e veprës është menduar që punimet të përfundojnë brenda një afati prej **11 muajsh**. Sa më sipër bazuar në afatin prej 8 muajsh si dhe numrin e ditëve të punës të llogaritura si më sipër, del që për të përfunduar projektin brenda 8 muajve do të nevojiteshin minimalisht 99 punonjës. (24021/22/8=99), ndërkohë që AK ka kërkuar 100 punonjës duke përfshirë edhe të gjithë stafin teknik dhe administrativ.

**Observim:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për arkitektin lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, rëndësinë dhe përmasat e objektit si dhe zbatimin e projektit arkitektonik. Arkitekti është përcaktuar pasi ndryshimet e ambienteve, të përshtaten sa më mirë funksionalitetit dhe estetikës, e cila mund të jetë variabël nga kërkesat e autoriteti kontraktor gjatë zbatimit të punimeve.

**Observim:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. **Kriteri që OE të kenë të punësuar 4 shoferë është bazuar në numrin e mjeteve**



**të nevojshme për zbatimin e projektit, grafikun e punimeve** të nenit 78, pika 1 dhe 4 të Kodit të Punës, që përcakton kohëzgjatjen normale të ditës së punës 8 orë, nenit 83 që përcakton kohëzgjatjen javore të punës, jo më shumë se 40 orë dhe nenit 92 e vijues mbi pushimet vjetore që i takojnë punëmarrësit. Janë një sërë mjesh të cilat kërkojnë shorë të kualifikuar në drejtimin e tyre si kamionët vetëshkarkues të tonazhit të lartë (5 të tillë), autobot uji, autobetoniere, autopompë betoni si dhe mjete të tjera si kamioçina. **Kriteri që OE të kenë të punësuar 4 manovratorë është bazuar në numrin e mjeteve të nevojshme për zbatimin e projektit, grafikun e punimeve** të nenit 78, pika 1 dhe 4 të Kodit të Punës, që përcakton kohëzgjatjen normale të ditës së punës 8 orë, nenit 83 që përcakton kohëzgjatjen javore të punës, jo më shumë se 40 orë dhe nenit 92 e vijues mbi pushimet vjetore që i takojnë punëmarrësit. Janë një sërë mjesh të cilat kërkojnë shorë të kualifikuar në drejtimin e tyre si mjete gërmimi eskavatore (3 të tillë), kamion me vinç, fadrome, minieskavator. Për më tepër që AK i ka lënë opsion OE që për mjetet me qira nuk është e detyrueshme që manovratorin ta kenë në listëpagesë për periudhën e kërkuar.

**Observim:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Duke marrë në konsideratë që ka një pjesë të konsiderueshme të punimeve që do të kryhen në lartësi mbi 8 m OE duhet të ketë punonjëes të trajnuar për këto punime të cila e ekspozojnë punonjësit ndaj rrezikut të rënies Në nenin 6 të ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë, i ndryshuar parashikohet: ”**Detyrime të përgjithshme të punëdhënësve** 1. Punëdhënësi, për sigurimin e mbrojtjes së punëmarrësve në të gjitha aspektet, që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë, merr masat e nevojshme nëpërmjet: ) parandalimit të rreziqeve për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale; b) informimit dhe formimit profesional të punëmarrësve e të përfaqësuesve të tyre; c) organizimit të mbrojtjes kolektive dhe individuale; ç) sigurimit të organizimit të vendit të punës e të mjeteve të nevojshme. 2. Punëdhënësi kujdeset për përditësimin e masave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duke marrë parasysh ndryshimet e rrethanave, për përmirësimin e situatave ekzistuese. Në pikën 15 të V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, ndër të tjera parashikohet: 15.1 Përkufizime Në aplikimin e këtyre rregullave, kërkesave, me termat e mëposhtëm kuptojmë: a) pajisje pune është çdo makinë, aparat, instalim që përdoret në punë; b) përdorim i një pajisje pune: çdo operacion pune i lidhur me një pajisje pune në përdorim ose jo, transporti, riparimi, transformimi, mirëmbajtja, pastrimi, çmontimi; c) zonë e rrezikshme: çdo zonë brenda ose në afërsi të një pajisje pune, në të cilën prania e një punëmarrësi përbën rrezik për shëndetin ose sigurinë e tij. ç) **puna në lartësi: aktivitet pune e cila ekspozon punëmarrësin ndaj rrezikut të rënies nga një lartësi më e madhe se 2 metra, referuar një niveli të palëvizshëm.**

**Observim:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Punonjësi përgjegjës për dëmet në mjedis sqarojmë se kriteri është vendosur në përputhje të plotë me klauzolat e Ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” me qëllim marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese për mbrojtjen e mjedisit. Nga ana e AK nuk është kërkuar ekspert mjedisi, por një punonjëes i AK, i cili duhet të ketë bërë një kurs trajnimit për marrjen e masave parandaluese për mbrojtjen e mjedisit gjatë kryerjes së punime, siç janë: transporti i materialeve të imëta apo materialeve që mund të krijojnë pluhur; lagia rregullisht me ujë për të eliminuar pluhurin e shkaktuar nga kryerja e punimeve; menaxhimi i pajisjeve me nivel të lartë zhurmues; menaxhimi i materialeve të rrezikshme si karburante, vajra, çimento etj.

### **Observim:**

**Kërkesa e mësipërme bazohet në ligjin** nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimin nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar; ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar; VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për Miratimin e kërkesave për Menaxhimin e Mbetjeve Inerte”.

Në nenin 5 të ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se: “Ushtimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.”

Në pikat 8 dhe 9 të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar parashikohet se:“ Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.”

Në pikat 4, 5 dhe 6 të VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për Miratimin e kërkesave për Menaxhimin e Mbetjeve Inerte” parashikohet se:

Termet e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termet e përdorur në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 107, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

Termi “Zotërues i mbetjeve inerte”, në kuptimin e këtij vendimi, është person fizik ose juridik, i cili, gjatë aktivitetit të tij të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objekteve, prodhon, transporton ose trajton mbetje inerte të cilat janë të renditura në kapitullin 17, të vendimit nr. 99, datë 18.2.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, të ndryshuar. Zotëruesi i mbetjeve inerte, i cili kryen përpunim paraprak, përzierje apo procese të tjera, që ndryshojnë natyrën ose përbërjen e këtyre mbetjeve, është i detyruar t’i ruajë, t’i transportojë dhe t’i dorëzojë ato në lëndfill apo në venddepozitim të përkohshëm në mënyrë të diferencuar, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 371, datë 11.6.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, si dhe vendimit nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”.

Zotëruesi i mbetjeve inerte është i detyruar t’i dorëzojë këto mbetje tek operatorët, të cilët janë të pajisur me leje mjedisore, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, dhe me licencë të tipit III.2.B, sipas vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

Në nenet 21 dhe 57 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar; parashikohet se: **Neni 21** : Krijuesi ose zotëruesi fillestar i mbetjeve e kryen trajtimin e tyre vetë ose përmes një tregtari a personi tjetër që kryen operacione trajtimi të mbetjeve, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 448 ,datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”. **Neni 57:** 1. Transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve. 2. Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri. 3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, të ministrit përgjegjës për ekonominë dhe të ministrit përgjegjës për transportin, miraton rregullat për zbatimin e këtij neni.

**Observim:** Kriteri që OE të disponojnë mjetet e kërkuara është bazuar në preventivin, grafikun natyrën e punimeve. Është kërkuar 1 autobetoniere, 1 pompë betoni, vibrator betoni, pompë suvatimi, nivelues helikopter për të gjitha punimet e betonit të parashikuara në preventiv si: Kollona monolite betoni C 25/30; Shtresë betoni C 16/20; Shtrese betoni C 12/15 t=20 cm) etj. **Është kërkuar kamion me vinç për punime të parashikuara në preventiv si** Vendosje në vepër tuba betoni; F.V Shtylla metalike per ndricim H=7m , d=160mm. **Janë kërkuar kamionë** me kapacitet mbi 18 ton dhe 7.5-18 ton për arsye të sasisë së konsiderueshme të materialeve të ndërtimit, mbeturinave e dherave që do të transportohen e konkretisht: mbi 2000 m<sup>3</sup>; materiale të ndryshme që do të nevojiten për ndërtimin e objekteve të reja apo për ato ekzistuese. Janë kërkuar kamionë me tonazh edhe më të vogël se 18 ton për arsye të hyrje daljeve në kantier pasi rruga nga njëra anë e kantierit nuk lejon hyrjen e mjeteve me tonazh mbi 18 ton. **Janë kërkuar** kamionçina për arsye të transportit të materialeve dhe të pajisjeve e veglave të punës; punëtorëve etj. **Janë kërkuar** mjete gjurmimi për punimet e gjurmimit sipas preventivit. Sasia e mjeteve të kërkuar është në përpthje me volumin e konsiderueshëm të gjurmimeve, mbi 2000 m<sup>3</sup>. Llojet e ndryshme të mjeteve të gjurmimit janë kërkuar për arsye të hapësirave të ngushta në brendësi të kantierit. **Është kërkuar** fadromë për largimin e mbeturinave që krijohen nga gjurmimet apo prishjet, sistemimin e ambientit. Llojet e ndryshme janë kërkuar për arsye të hapësirave të ngushta në brendësi të kantierit.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj Në aktkonstatimin nr. 15 dhe në Projektraport është cituar që kriteret nuk janë të justifikuar teknikisht, bazuar në preventivin e punimeve, pasi nisur edhe nga tabela e hartuar nga ana juaj për llojet e makineri/pajisjeve për zëra të ndryshëm pune, duket qartë që janë vendosur pajisje jo në propocion me zërat e punës duke ju referuar Kërkesat e veçanta të kualifikimit të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 14.09.2022. të cilat nuk janë të argumentuara teknikisht.

- **Kërkesat e pikës 2.3.6 e DST** e cila kërkon që operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf dhe punonjës të kualifikuar, 1 (një) Arkitekt. Kërkesa për arkitekt në këtë procedurë nuk është e argumentuar ligjrisht dhe për më tepër nuk është në përputhje me zbatueshmërinë dhe objektin e kontratës pasi projekti dhe preventivi i punimeve janë hartuar dhe procedohet për OE i cili do të marrë përsipër realizimin e objektit dhe kontratës së zbatimit të punimeve. Kriteri i cili konsiderohet kufizues.

#### **Pretendimi i subjektit: KVO**

1. Përsa i përket konstatimit të parashtruar nga ana juaj se në dokumentacionin e ngarkuar në SPE, OE ka deklaruar si punë të ngjashme kryerjen e punimeve për objektin “Rindërtim i njësisë të banimit në ndërtesa (pallate) për zonën e re për zhvillim Manëz, Objekti (A1, A2, B1 dhe B3) njësi banimi në ndërtesa (pallat) njësi administrative Manëz, Bashkia Durrës. Sa më sipër, rezulton se OE nuk ka pasqyruar në QKB punimet e mësipërme të cilat shtrihen gjatë vitit 2021, duke shmangur detyrimet përkatëse për taksat dhe tarifave vendore në vendin ku ushtrojnë aktivitetin, **ju sqarojmë se KVO vlerëson ofertat vetëm mbi kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit.** Në pikën 2.2.3 të DST është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të paraqese një vërtetim që ka paguar **taksat dhe tarifave vendore për vitin 2022 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. OE i ka paraqitur deklaratën mbi punimet në proces gjatë vitit 2022, duke paraqitur edhe vërtetimet përkatëse me të cilat vërteton pagesën e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022, **duke përmbushur kërkesën e parashikuar në pikën 2.2.3 të DST.** 2. OE fitues, nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.10 të DST** e cila kërkon 2 Eskavator me goma Në dokumentacionin e ngarkuar në SPE, OE ka deklaruar 1 Eskavator me goma respektivisht me targ AA 917 BY. 3. OE fitues, nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.12 të DST** e cila kërkon nga OE të jenë të pajisur me licencë për “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve në mjedis”, (Kodi III.1.B). Rezultoni se OE nuk e disponon këtë licencë apo ndonjë kontratë të ngjashme e cila duhet të jetë e pajisur me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për të cilën

duhet të paraqesin dokumentacionin e pronesisë/kontraten e qerases/kontraten e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B. Përsa i përket konstatimit të parashtruar nga ana juaj se OE fitues, nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.12 të DST** e cila kërkon nga OE të jenë të pajisur me licencë për “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve në mjedis”, (Kodi III.1.B). Rezulton se OE nuk e disponon këtë licencë apo ndonjë kontratë të ngjashme e cila duhet të jetë e pajisur me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për të cilën duhet të paraqesin dokumentacionin e pronesisë/kontraten e qerases/kontraten e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, **ju sqarohet se OE ka paraqitur në SPE kontratën e furnizimit me objekt: furnizimi me inerte, rërë, betone, pllaka, bordura etj. lidhur me subjektin "V" shpk e shoqëruar me Licencën në emër të subjektit "V" shpk me nr.PN-0172-06-2015, me datë lëshimi 01.06.2015, me kod III.1.B e me objekt "Leje mjedisi e tipit B për aktivitetin: "Prodhim i produkteve abrazive dhe produkteve të tjera minerale jo metalike" lëshuar nga QKL, duke përmbushur kërkesën e parashikuar në pikën 2.3.12 të DST.**

**Oëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj do të merret në konsideratë pjesërisht përsa i përket kriterin e pikës 2.3.12 të DST ndërsa përsa i përket pikave 2.2.3 të DST dhe 2.3.10 të DST nuk merren në konsideratë sipas argumentimit të sipërcituar.

*5. Të dhëna mbi objektin e prokurimit: “Rionstruksioni i palestrave dhe tavaneve sportive, Shkolla e Mesme e Bashkuar Luigj Gurakuqi”, Elbasan*

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rionstruksioni i palestrave dhe tavaneve sportive, Shkolla e Mesme e Bashkuar Luigj Gurakuqi”, Elbasan</b>			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF-39680-08-24-2022 Urdhri nr. 3927 prot., datë 18.08.2022	<b>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit</b> Urdhri nr. S’ka, datë 24.08.2022 1. z.O.K 2. z. E.S 3. z. A.B	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> 1. z.O.K 2. z. E.S 3. z. A.B	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 3927/2 prot., datë 24.08.2022. 1. z. Y.K 2. z. K.H 3. zj F.Q
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 41,069,986 lekë	<b>5. Oferta fituese, vlera fituese:</b> Operatori Fitues: B Sh.p.k 37,000,000 lekë pa tvsh.		<b>6. Diferenca me fondin limit</b> 4,069,986 lekë pa tvsh
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 09.09.2022	<b>8. Burimi Financimit</b> Buxheti i shtetit.		<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender, <b>2 OE</b> b) S’kualifikuar 1 OE, “B.N” Sh.p.k c) Kualifikuar 2 OE
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 5 muaj</b>			
<b>10.Ankimime</b> AK-s’ka APP-s’ka KPP-s’ka	<b>11. Data e lidhjes të kontratës:</b> Nr. 3927/8 prot., datë 03.10.2022		<b>12.Përgjigje</b> Ankesës nga APP, AK apo <b>KKP: AK S’ka</b>

***a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.***

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se:

***AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit” :***

Me urdhër të zv. Kryetarit (Personi i Autorizuar) të Bashkisë Elbasan znj. A.B është ngritur një komision me urdhrin nr. 3927 prot., datë 18.08.2022 “Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit 41,069,986 lekë” me objekt: **“Rikonstruksioni i palestrave dhe tavaneve sportive, Shkolla e Mesme e Bashkuar Luigj Gurakuqi”, Elbasan.** Në zbatim të këtij urdhri, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga, z. O.K dhe z. A.B dhe z. E.S.

Fondet janë miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë mbi fituesit e projekteve të reja për vitin 2022 në bashkëfinancim me Bashkinë Elbasan ku MAS do mbulojë 70% të vlerës dhe bashkia 30% e cila do financohet në dy vite 2022-2023. Çmimet e vendosura janë në përputhje me VKM-në nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”.

### **Mbi ndryshimin e dokumentave standarte të tenderit**

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Elbasan, bazuar në rekomandimet e bëra nga Agjensia e Prokurimit Publik, vendosi që të bëjë ndryshime në dokumentat standarte të tenderit me objekt: **“Rikonstruksion i palestrave dhe terreneve Sportive, Shkolla e Mesme e Bashkuar "Luigj Gurakuqi", Elbasan”**, me fond limit **41,069, 986** (dyzet e njëmilion e gjashtëdhjetë e nëntëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë) **lekë pa t.v.sh sipas shkresës nr. 3927/3 datë 31.08.2022.**

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve të vendosura.

**Situata 1:** Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej z.O.K, E.S dhe z. A.B , të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 14.09.2022. Në lidhje me kriteret e vendosura, u konstatuar kriteret e ekzagjeruara dhe të paargumentuara. Në mënyrë të detajuar kriteret e konstatuara si të pa argumentuara dhe kriteret e argumentuara paraqiten si vijon:

**Kërkesat e pikës 2.3.4 e DST** e cila kërkon që operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të cilët duhet të figurojnë në licencën si dhe listëpagesat e shoqërisë për periudhën Maj 2022 - Korrik 2022, 1 (një) inxhinier Mekanik. *Kërkesa për 1 (një) inxhinier Mekanik nuk është e argumentuar teknikisht dhe ligjërish për ekspert mjedisi në lidhje e në funksion të objektit të kontratës.*

**Kërkesat e pikës 2.3.5 e DST** e cila kërkon që operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf dhe punonjës të kualifikuar 1 (një) punonjës Arkitekt. *Kërkesa për arkitekt në këtë procedurë nuk është e argumentuar ligjërish dhe për më tepër nuk është në përputhje me zbatueshmërinë dhe objektin e kontratës pasi projekti dhe preventivi i punimeve janë hartuar dhe procedohet për OE i cili do të marrë përsipër realizimin e objektit dhe kontratës së zbatimit të punimeve. Kriter i cili konsiderohet kufizues.*

**Kërkesat e pikës 2.3.6 e DST** e cila kërkon që operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ certifikuar 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikate “Përgjegjës për dëmet në mjedis” gjatë kryerjes së veprimtarisë. *Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish për ekspert mjedisi në lidhje e në funksion të objektit të kontratës.*

**Kërkesat e pikës 2.3.8** e cila kërkon që operatori ekonomik duhet të disponojë në pajisjet/kapacitetet e meposhtme teknike, qe nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

<b>Nr</b>	<b>Lloji i Makinerive</b>	<b>Pronësia</b>	<b>Sasia</b>
1	Eskavator me goma	Pronësi ose qera	copë 1
2	Fadrome me goma	Pronësi ose qera	copë 1
3	Kamion me kapacitet mbajtes 10 deri 15 ton	Pronësi ose qera	copë 2
4	Kamionçine me kapacitet mbajtes 3 deri ne 5 ton	Pronësi ose qera	copë 1
5	Kamionçine me kapacitet mbajtes deri ne 1.5 ton	Pronësi ose qera	copë 1
6	Makine me kosh	Pronësi ose qera	copë 1
7	Minidampër	Pronësi ose qera	copë 1
8	Minifadrome	Pronësi ose qera	copë 1
9	Rrul gome-hekur 8 deri 10 ton	Pronësi ose qera	copë 1
10	Rrul asfalti hekur-hekur 4 deri 6 ton	Pronësi ose qera	copë 1
11	Asfaltoshtruese	Pronësi ose qera	copë 1
12	Motobetoniere	Pronësi ose qera	copë 2
13	Vibrator betoni	Pronësi ose qera	copë 2
14	Matrapik	Pronësi ose qera	copë 1
15	Helikopter për sipërfaqe betoni	Pronësi ose qera	copë 1

16	Saldatrice	Pronësi ose qera	copë 1
17	Gjenerator	Pronësi ose qera	copë 1

*Ky kriter për makineritë nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish, se për çfarë u janë kërkuar OE pjesëmarrës, referuar grafikut dhe preventivit të punimeve.*

**Kërkesat e pikës 2.3.9 e DST** e cila kërkon që Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim i mbetjeve jo te rrezikshme” ose te ketë kontrate shërbimi noteriale për objektin konkret me shoqëri licensuara. *Këto kërkesa për licenca nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërish në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës.* Nuk është e nevojshme licenca e mësipërme, pasi shërbimin e grumbullimit të mbetjeve e ofron Bashkia Elbasan dhe për subjektet që kryejnë punime ndërtimit aplikon tarifën ndotjes, shërbimit, për kohëzgjatjen e kantierit të ndërtimit.

*Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me kërkesat nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:*

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës” .

*Sa më sipër mbanë përgjegjësi njësin e prokurimit me përbërje z. O.K dhe z. A.B dhe z. E.S.*

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

**Ndikimi/Efekti:** Ndikon në paraqitjen e ofertave nga operatorët ekonomikë.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

***b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. s’ka, të datës 29.09.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	“B ” sh.p.k	37,000,000	Kualifikuar
2	“B.N” sh.p.k me Nipt: K.....O	40,122,291	S’kualifikuar; 1. Nuk ka deklaruar ne shtojcen 8 te vetedeklarimit/nuk ka paraqitur asnje dokumentacion qe te vertetoje se ka te punesuar si punonjës te kualifikuar 2 saldatorë , duke mos përmbushur kërkesën e parashikuar ne piken 2.3.5 te kapacitetit teknik, te kriterëve te veçanta për kualifikim ku nder te tjera kërkohet: <b>2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf dhe punonjës të kualifikuar, si më poshtë:</b> • <b>2 (dy) punonjës saldator</b> <i>Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetedeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.</i> 2. Nuk ka paraqitur kontrate noteriale furnizimi me prodhuesin/t ose distributorin/ët zyrtare te tyre për furnizimin me tapet rezine sintetike për fushe basketbolli, parket për palester, rrjete teli e plastifikuar, profile metalike, boje hidroplastike, polisterol kompakt, pllaka trotuari duke mos

			<p>përbushur kërkesën e parashikuar ne2.3.11 te kapacitetit teknik, te kriterëve te veçanta për kualifikim ku kërkohet:</p> <p><b>2.3.11 Operatori Ekonomik ofertues duhet te paraqesë :</b>  Për materialet kryesore te preventivit si tapet bari për fushe minifutboll, tapet rezine sintetike për fushe basketboll, parket për palester, rrjete teli e plastifikuar, profile metalike, boje hidroplastike, polisterol kompakt, pllaka trotuari, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontrate noteriale furnizimi me prodhuesin/ ose distributorin/ët zyrtare te tyre për furnizimin me materialet e mesipërme gjate zbatimit te kontratës, Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen dhe të jenë paraqitur dhe markuar të dhënat teknike për mallrat objekt prokurimi. Ne rastin e kontratës me distributorin te dokumentohet lidhja e tij me prodhuesin.</p>
--	--	--	--

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më nr. 3927/6 prot datë 30.09.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 2 operatorë pjesëmarrës është s'kualifikuar 1 OE, është kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më nr. 3927/7 datë 30.09.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “**B**” **sh.p.k** për të cilën është lidhur kontrata nr. **3927/8 prot., datë 03.10.2022** për vlerën 37,000,000 lekë pa TVSH dhe vlera 44,400,000 lekë me TVSH, dhe me afat 5 (pesë) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

**Konkluzion:** Arrihet në përfundimin se ky operator i plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DST dhe vendimi i KVO për shpalljen fitues të këtij operatori është i drejtë.

Në observacionin e subjektit të audituar Bashkia Elbasan mbi Akt konstatimin nr.15 dërguar me shkresën nr. 4474/44 prot., dt. 22.11.2023 dhe me nr. 767/4 prot., (i KLSH) dt. 30.11.2023, shprehur si më poshtë vijon:

**Pretendimi i subjektit: Njësia e Prokurimit**

**Observim:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar dhe VKM Nr.943 Dt.28.12.2016 “Struktura metalike”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratë. Referuar preventivit te punimeve kemi 6.7 ton konstruksione metalike, te cilat paraqesin produkte te dala nga saldimi i profileve te ndryshme metalike. Duke qene se kemi te bejme me konstruksione me lartesi te konsiderueshme 6 metra, ne mjedise shkollore ne prezence femijesh, Autoriteti Kontraktor kerkon garanci ne drejtim te sigurise/qendrueshmerise dhe cilesise se tyre.

**Observim:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses

të kontratës. Kriteri për arkitektin lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, rëndësinë dhe përmasat e objektit si dhe zbatimin e projektit arkitektonik. Arkitekti është përcaktuar pasi ndryshimet e ambienteve, të përshtaten sa më mirë funksionalitetit dhe estetikës, e cila mund të jetë variabël nga kërkesat e autoriteti kontraktor gjatë zbatimit të punimeve.

**Observim:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Punonjesi përgjegjës për dëmet në mjedis sqarojmë se kriteri është vendosur në përputhje të plotë me klauzolat e Ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” me qëllim marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese për mbrojtjen e mjedisit. **Nga ana e AK nuk është kërkuar ekspert mjedisi, por një punonjësi i AK, i cili duhet të ketë bërë një kurs trajnimi për marrjen e masave parandaluese për mbrojtjen e mjedisit gjatë kryerjes së punime, siç janë: transporti i materialeve të imëta apo materialeve që mund të krijojnë pluhur; lagia rregullisht me ujë për të eliminuar pluhurin e shkaktuar nga kryerja e punimeve; menaxhimi i pajisjeve me nivel të lartë zhurmues; menaxhimi i materialeve të rrezikshme si karburante, vajra, çimento etj.**

**Observim:** Kriteri që OE të disponojnë mjetet e kërkuara është bazuar në preventivin, grafikun dhe natyrën e punimeve. **Është kërkuar 1 Rrul gome-hekur 8 deri 10 ton, për punimet sipas preventivit:** Cilindrim kasonete me rul (fusha e minifutbollit) Cilindrim kasonete me rul (fusha e basketbollit) Shtrese çakelli mbeturine kave t=10cm, ngjeshur makineri (fusha e gjimnastikes) Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, ngjeshur makineri (fusha e basketbollit) Shtrese çakelli mbeturine kave t=10cm, ngjeshur makineri (fusha e minifutbollit) **Per arsye se vibrimi do te kryet prane objekteve ekzistuese te amortizuara dhe mund te ti demtoje ato nuk do te lejohen rrula mbi tonazhin e kerkuar Rrul asfalti hekur-hekur 4 deri 6 ton për punimet sipas preventivit:** Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 5cm, me makineri (fusha e minifutbollit) **Është kërkuar** asfaltoshtruese për punimet sipas preventivit:Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 5cm, me makineri (fusha e minifutbollit) **Është kërkuar** motobetoniere, vibrator betoni, helikopeter betoni për të gjitha punimet e betonit të parashikuara në preventiv si: Shtrese betoni C 12/15 t=10 cm nen traun lidhes dhe nen plita; Trare themeli monolit b/a C - 16/20 (trau lidhes); Shtrese betoni C 16/20 ( L = 42 m x B =1.2 m x t =0.1 m ); Shtrese lluster cimento 1:2 t = 20 mm etj. **Ështe kërkuar 1 kamion me vinç për punime të parashikuara në preventiv si** Spostim shtylla b/arme H=7 m; Vendosje në vepër të Tombinove me tuba betoni; F.V Shtylla metalike per ndricim H=7m , d=160mm. **Ështe kërkuar 1 saldatriçe për** Saldimin dhe pergatitjen e konstruksioneve metalike **Janë kërkuar kamionë** me kapacitet 10-15 ton për arsye të sasisë së konsiderueshme të materialeve që do të transportohen si: materiale ndërtimi e dheu; çakull, binder, asfalt, etj. Per arsye se hyrja ne kantier realizohet vetem nepermjet nje rruge te brendshme e cila eshte pjese e sheshit midis shkolles dhe institucionit te Bashkise Elbasan, ne menyre qe te shmangen demtimet nga tonazhet e renda nuk do te lejohen mjete mbi kapacitetin e kërkuar **Janë kërkuar** kamionçina për arsye të transportit materialeve të ndryshme si ato elektrike; të sinjalistikës, të pajisjeve e veglave të punës; punëtorëve etj. **Ështe kërkuar** mjet gjermimi për punimet e gjermimit sipas preventivit: Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m<sup>3</sup>, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet (fusha e minifutbollit) Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m<sup>3</sup>, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet (fusha e basketbollit) Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m<sup>3</sup>, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet (fusha e gjimnastikes) Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m<sup>3</sup>, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet (sistemimi i sheshit). **Ështe kërkuar** fadromë për punimet sipas preventivit: Shtrese çakelli mbeturine kave t=10cm, perhapur me makineri (fusha e minifutbollit) Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, perhapur me makineri (fusha e basketbollit) Shtrese çakelli mbeturine kave t=10cm, perhapur me makineri (fusha e gjimnastikes) **Ështe**



**kërkuar** fmakinë me kosh për punimet sipas preventivit: Hidroizolim taracash, saldim konstruksionesh ne lartesi, rrethim me rrjete ne lartesi, vendosje Ndricules per fushat jashte 250 wat led IP67 etj.

**Observim:** **Kërkesa e mësipërme bazohet në ligjin** nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimin nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar; ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar; VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”. Në nenin 5 të ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se: “Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.” Në pikat 8 dhe 9 të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar parashikohet se:“ Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.” Në pikat 4, 5 dhe 6 të VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” parashikohet se: Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorur në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 107, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. Termi “Zotërues i mbetjeve inerte”, në kuptimin e këtij vendimi, është person fizik ose juridik, i cili, gjatë aktivitetit të tij të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objekteve, prodhon, transporton ose trajton mbetje inerte të cilat janë të renditura në kapitullin 17, të vendimit nr. 99, datë 18.2.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, të ndryshuar. Zotëruesi i mbetjeve inerte, i cili kryen përpunim paraprak, përzjerje apo procese të tjera, që ndryshojnë natyrën ose përbërjen e këtyre mbetjeve, është i detyruar t’i ruajë, t’i transportojë dhe t’i dorëzojë ato në lëndfill apo në venddepozitimin e përkohshëm në mënyrë të diferencuar, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 371, datë 11.6.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, si dhe vendimit nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”. Zotëruesi i mbetjeve inerte është i detyruar t’i dorëzojë këto mbetje tek operatorët, të cilët janë të pajisur me leje mjedisore, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, dhe me licencë të tipit III.2.B, sipas vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”. Në nenet 21 dhe 57 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar; parashikohet se: **Neni 21** : Krijuesi ose zotëruesi fillestar i mbetjeve e kryen trajtimin e tyre vetë ose përmes një tregtari a personi tjetër që kryen operacione trajtimi të mbetjeve, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 448 ,datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”. **Neni 57:** 1. Transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve. 2. Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri. 3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, të ministrit përgjegjës për ekonominë dhe të ministrit përgjegjës për transportin, miraton rregullat për zbatimin e këtij neni.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj Në aktkonstatimin nr. 15 dhe në Projektraport është cituar që kriteret nuk janë të justifikuar teknikisht, bazuar në preventivin e

punimeve, pasi nisur edhe nga tabela e hartuar nga ana juaj për llojet e makineri/pajisjeve për zëra të ndryshëm pune, duket qartë që janë vendosur pajisje jo në propocion me zërat e punës duke ju referuar Kërkesat e veçanta të kualifikimit të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 14.09.2022. të cilat nuk janë të argumentuara teknikisht.

- **Kërkesat e pikës 2.3.5 e DST** e cila kërkon që operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf dhe punonjës të kualifikuar 1 (një) punonjës Arkitekt. Kërkesa për arkitekt në këtë procedurë nuk është e argumentuar ligjërisht dhe për më tepër nuk është në përputhje me zbatueshmërinë dhe objektin e kontratës pasi projekti dhe preventivi i punimeve janë hartuar dhe procedohet për OE i cili do të marrë përsipër realizimin e objektit dhe kontratës së zbatimit të punimeve. Kriter i cili konsiderohet kufizues

**6. Të dhëna mbi objektin e prokurimit: Rivitalizimi urban i qendrës së Gjinarit dhe Fushëkuqës**

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rivitalizimi urban i qendrës së Gjinarit dhe Fushëkuqës”</b>			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF-51384-11-25-2022 Urdhri nr. 4796/1 prot., datë 25.11.2022	<b>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit</b> Urdhri nr. S’ka, datë 25.11.2022 1. z.O.K 2. z. E.S 3. z. A.B	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> 1. z.O.K 2. z. E.S 3. z. A.B	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 4796/3 prot., datë 12.12.2022 1. znj A.M 2. z. K.H 3. z. Y.M
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 83,555,051 lekë	<b>5. Oferta fituese, vlera fituese:</b> Operatori Fitues: BOE “M.”. Sh.p.k me Nipt: L.....C & "SH." Sh.p.k me Nipt: K.....N 81,050,738 lekë pa tvsh.		<b>6. Diferenca me fondin limit</b> 2,504,313 lekë pa tvsh
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 28.12.2022	<b>8. Burimi Financimit</b> Buxheti i shtetit.		<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender, <b>2 OE</b> c) Kualifikuar <b>2 B/OE</b>
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 8 muaj</b>			
<b>10.Ankimime</b> AK-s’ka/ka; ka APP-s’ka/ka; KPP-s’ka/ka	<b>11. Data e lidhjes të kontratës:</b> Nr. 4796/10 prot., datë 03.04.2023		<b>12.Përgjigje</b> Ankesës nga APP, AK apo <b>KKP: AK</b>

**a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.**

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

**AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit” :**

Me urdhër të zv. Kryetarit (Personi i Autorizuar) të Bashkisë Elbasan znj. A.B është ngritur një komision me urdhrin nr. 4796/1 prot., datë 25.11.2022 “Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit 83,555,051 lekë” me objekt: **“Rivitalizimi urban i qendrës së Gjinarit dhe Fushëkuqës”** Në zbatim të këtij urdhri, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga, z. O.K dhe z. A.B dhe z. E.S.

Fondet janë miratuar VKB nr 146 datë 09.11.2022 e cila do financohet në tre vite 2022-2024. Çmimet e vendosura janë në përputhje me VKM-në nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”.

**Ndryshimi i kriterëve**

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Elbasan, bazuar në rekomandimet e Agjensisë së Prokurimit Publik, vendosi që të bëjë ndryshime/saktësime në dokumentet standarte të tenderit me objekt: **“Rivitalizim urban i qendrës së Gjinarit dhe Fushëkuqës”**, me fond limit **83,555,051** (tetëdhjetë e tremilion e pesëqind e pesëdhjetë e pesëmijë e pesëdhjetë e një) **lekë pa t.v.sh.**, sipas shkresës nr. 4796/4 prot datë 28.12.2022 si vijon;

ISHTE	BËHET
<p><b>2.3.5</b> Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf dhe punonjës të kualifikuar, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 (një) inxhinier</li> </ul>	<p><b>2.3.5</b> Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf dhe punonjës të kualifikuar, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 (një) inxhinier ndërtimi</li> </ul>
<p><b>2.3.10</b> Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me leje/licencë të lëshuar nga QKL/QKB, Kodi III.1.A , Tipi C , Për prerjen, gdhendjen dhe lustrimin e gurit.</p>	<p><b>2.3.10</b> Operatori ekonomik ofertues duhet të ushtrojë aktivitet/të ketë kontratë furnizimi për përpunimin, prerjen dhe lustrimin e mermerit dhe gurëve dekorativë.</p>
<b>3. Kudo në preventiv fjalët "Importi" hiqen.</b>	

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve të vendosura.

**Situata:** Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej z.O.K , E.S dhe z. A.B , të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 12.12.2022. Në lidhje me kriteret e vendosura, u konstatuar kriteret e ekzagjeruara dhe të paargumentuara. Në mënyrë të detajuar kriteret e konstatuara si të pa argumentuara dhe kriteret e argumentuara paraqiten si vijon:

**Kërkesat e pikës 2.3.4 e DST** e cila kërkon që Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të cilët duhet të figurojnë në licencën si dhe listëpagesat e shoqërisë për periudhën Shtator 2022 - Nëntor 2022, 1 (një) inxhinier Mjedisi. *Kërkesa për 1 (një) inxhinier Mjedisi si drejtues teknik në këtë procedurë nuk është e argumentuar ligjërisht dhe për më tepër nuk është në përputhje me zbatueshmërinë dhe objektin e kontratës. Kriter i cili konsiderohet kufizues.*

**Kërkesat e pikës 2.3.5** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf dhe punonjës të kualifikuar 1 (një) arkitekt dhe 3 (tre) punonjës karpentiere

*1. Kërkesa për arkitekt në këtë procedurë nuk është e argumentuar ligjërisht dhe për më tepër nuk është në përputhje me zbatueshmërinë dhe objektin e kontratës pasi projekti dhe preventivi i punimeve janë hartuar dhe procedohet për OE i cili do të marrë përsipër realizimin e objektit dhe kontratës së zbatimit të punimeve. Kriter i cili konsiderohet kufizues*

*2. Kërkesave për 3 (tre) punonjës karpentierë nuk është e argumentuar ligjërisht përse i përket numrit të kërkuar dhe punës që do të kryejnë.*

**Kërkesat e pikës 2.3.7 e DST** e cila kërkon, një punësim mesatar për periudhën Shtator 2022 - Nëntor 2022, i të paktën 80 (tetëdhjetë) personave. *Kriteri për stafin mbështetës dhe për punonjësit e kërkuar, përveç se nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, konsiderohet diskrimues pasi sjell pabarazi ndërmjet OE. Referuar listës së punonjësve të kërkuar, janë rreth 37 duke filluar nga Drejtues projekti me licencën e shoqërisë si drejtues teknik, inxhinierë dhe punonjës të natyrave të ndryshme për të përmbushur detyrimet kontraktuale, ndërkohë që një numër mesatar jo më pak se 80 punonjës me kohë të plotë për periudhën Shtator 2022 - Nëntor 2022, që i është kërkuar OE ofertues, ndikon në kufizimin e pjesëmarrjes së tyre.*

**Kërkesat e pikës 2.3.8 e DST** e cila kërkon që Operatori ekonomik duhet të disponojë pajisjet/kapacitetet e meposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamiona vetshkarkues kapaciteti mbajtes mbi 18 Ton	në pronësi ose me qera	copë	3
2	Kamiona vetshkarkues kapaciteti mbajtes 10 - 18 Ton	në pronësi ose me qera	copë	3
3	Eskavator me goma	në pronësi ose me qera	copë	2
4	Eskavator me zinxhire	në pronësi ose me qera	copë	1
5	Fadrome me goma	në pronësi ose me qera	copë	1
6	Freze asfalti	në pronësi ose me qera	copë	1
7	Majineri vijezi	në pronësi ose me qera	copë	1
8	Grejder	në pronësi ose me qera	copë	1
9	Rimorkio për transportin mjeteve te renda mbi 25 Ton	në pronësi ose me qera	copë	1

10	Autobetoniere	në pronësi ose me qera	copë	2
11	Autopompe Betoni	në pronësi ose me qera	copë	1
12	Kamionçinë me kapacitet mbajtes deri 2-5 Ton	në pronësi ose me qera	copë	2
13	Kamion me vinc	në pronësi ose me qera	copë	2
14	Autobot uji	në pronësi ose me qera	copë	1
15	Rrul hekur-hekur me kapacitet 4 ton - 7 ton	në pronësi ose me qera	copë	1
16	Rrul hekur-hekur me kapacitet mbi 10 t	në pronësi ose me qera	copë	1
17	Rrul hekur-gome me kapacitet mbi 18	në pronësi ose me qera	copë	2
18	Automjet me kosh	në pronësi ose me qera	copë	1
19	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qera	copë	1
20	Autobitumatrice	në pronësi ose me qera	copë	1
21	Tokmak	në pronësi ose me qera	copë	1
22	Vibrator betoni	në pronësi ose me qera	copë	2
23	Gjenerator	në pronësi ose me qera	copë	2

*Ky kriter për makineritë nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish, se për çfarë u janë kërkuar OE pjesëmarrës, referuar grafikut dhe preventivit të punimeve.*

**Kërkesat e pikës 2.3.9 e DST** e cila kërkon që Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim i mbetjeve jo te rrezikshme” *Këto kërkesa për licenca nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërish në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës. Nuk është e nevojshme licenca e mësipërme, pasi shërbimin e grumbullimit të mbetjeve e ofron Bashkia Elbasan dhe për subjektet që kryejnë punime ndërtimit aplikon tarifën ndotjes, shërbimit, për kohëzgjatjen e kantierit të ndërtimit.*

**Kërkesat e pikës 2.3.12 e DST** e cila kërkon që operatorët ekonomike duhet të kenë pronësi/kontrate qeraje/kontrate furnizimi 1 (një) fabrike betoni, e cila duhet të jete e pajisur me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për të cilën duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qeraje/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B.

**Kërkesat e pikës 2.3.13 e DST** e cila kërkon që operatorët ekonomike duhet të kenë pronësi/kontrate qeraje/kontrate furnizimi 1 (një) fabrike inertesh, e cila duhet të jete e pajisur me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për të cilën duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qeraje/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B.

**Kërkesat e pikës 2.3.14 e DST** e cila kërkon që Operatorët ekonomike duhet të kenë pronësi/kontrate qeraje/kontrate furnizimi 1 (një) fabrike prodhim asfalti, e cila duhet të jete e pajisur me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për të cilën duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qeraje/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B. Kriteret e vendosura në kërkesat e pikës 2.3.12/13/14 nuk janë të argumentuar teknikisht dhe ligjërish pasi në rastet kur fabrika e betonit - elementeve të betonit - bordurave dhe pllakave nuk janë në pronësi të ofertuesit rezulton se kërkesa për paraqitjen me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për të cilën duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qeraje/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, u drejtohet personave të tretë që nuk janë konkurrent në këtë procedurë prokurimi.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës” .

*Sa më sipër mbanë përgjegjësi njësinë e prokurimit me përbërje z. O.K dhe z. A.B dhe z. E.S.*

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

**Ndikimi/Efekti:** Ndikon në paraqitjen e ofertave nga operatorët ekonomikë.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

**b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.**

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. s”ka, të datës 19.01.2023, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	BOE “M.” Sh.p.k me Nipt: L.....C & "SH." Sh.p.k me Nipt: K.....N	81,050,738	Kualifikuar
2	“L.K” Sh.p.k me Nipt: K.....I	81.056,456	Kualifikuar

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 02.02.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 2 operatorë pjesëmarrës, janë kualifikuar 2 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 02.02.2023 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “BOE “M.” Sh.p.k me Nipt: L.....C & "SH." Sh.p.k me Nipt: K.....N për të cilën është lidhur kontrata datë 03.04.2023 për vlerën 81,050,738 lekë pa TVSH dhe vlera 97,260,885 lekë me TVSH, dhe me afat 8 (tetë) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

**Konkluzion:** Arrihet në përfundimin se ky operator i plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DST dhe vendimi i KVO për shpalljen fitues të këtij operatori është i drejtë.

Në observacionin e subjektit të audituar Bashkia Elbasan mbi Akt konstatimin nr.11 dërguar me shkresën nr. 4474/44 prot., dt. 22.11.2023 dhe me nr. 767/4 prot., (i KLSH) dt. 30.11.2023, shprehur si më poshtë vijon:

**Pretendimi i subjektit: Njësia e Prokurimit**

**Observim:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratë. **Është kërkuar inxhinier mjedisi në përputhje me kategorinë NP.12 A të licensës për puimet sipas preventivit: Punimet ne siperfaqe te gjelberta, mbjellje bari ne skarpate, f.v peme dhe shkurre dekorative etj**

**Kërkesa sa më sipër, bazohet edhe në rekomandimet e APP.**

**Observim:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative,

reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratë. **Është kërkuar Arkitekt** pasi është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të projektit kryesisht persa i përket aspektit të rivitalizimit dhe mobilimit urban të qendres së Gjinarit. **Karpiertierët** janë kërkuar për punimet si: prerjen dhe montimin e strukturave prej druri e metali si dhe ndërtimin e kornizave dhe strukturave të tjera përforcuese prej druri, bashkimin dhe montimin e elementeve metalik apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e objektit që do të ndërtohet.

**Observim:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimi. Numri i punonjësve është vendosur duke u bazuar në grafikun e punimeve të hartuar nga inxhinierët e Drejtorisë së Projektimit dhe Azhurnimit Topografik të Bashkisë Elbasan në përputhje me VKM-në nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, ku për çdo zë të punime janë përcaktuar edhe orët e punës për njësi sipas përcaktimeve të nenit 78, pika 1 dhe 4 të Kodit të Punës, që përcakton kohëzgjatjen normale të ditës së punës 8 orë, nenit 83 që përcakton kohëzgjatjen javore të punës, jo më shumë se 40 orë dhe nenit 92 e vijues mbi pushimet vjetore që i takojnë punëmarrësit. Sipas këtij grafiku numri i ditëve të punës që do të duheshin një punonjësi për të kryer punimet është **15,034 ditë pune**. Duke u nisur nga kompleksiteti dhe rëndësia e projektit dhe interesave të AK për përfundimin e veprës është menduar që punimet të përfundojnë brenda një afati prej **8 muajsh**. Sa më sipër bazuar në afatin prej 8 muajsh si dhe numrin e ditëve të punës të llogaritura si më sipër, del që për të përfunduar projektin brenda 8 muajve do të nevojiteshin minimalisht 85 punonjës. ( $15,034/22/8=99$ ), ndërkohë që AK ka kërkuar 80 punonjës duke përfshirë edhe të gjithë stafin teknik dhe administrativ.

**Kriteri që OE të disponojnë mjetet e kërkuara është bazuar në preventivin, grafikun dhe natyrën e punimeve.**

**Është kërkuar 1 Rrul hekur -gomë mbi 18 ton, për punimet sipas preventivit:** Shtrese çakelli  $t=10\text{cm}$ , përhapur e ngjeshur makineri, Shtrese çakelli  $t=15\text{cm}$ , përhapur e ngjeshur makineri **Rrul hekur-hekur 4 deri 7 ton** për punimet sipas preventivit: Per ngjeshjen e asfaltit para apo pas ngjeshjes me rul me kapacitet mbi 10 t ne varesi te kohes si dhe per te perhapur e ngjeshur shtresat e çakullit ne segmente te ngushta rruge. **Rrul hekur-hekur mbi 10 ton** për punimet sipas preventivit: Per ngjeshjen e asfaltit para apo pas ngjeshjes me rul me kapacitet mbi 4-7 t ne varesi te kohes **Është kërkuar** asfaltoshtuese për punimet sipas preventivit: Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri **Është kërkuar** autobitumatriçe për punimet sipas preventivit: Per sperkatjen me emulsion bituminoz. **Është kërkuar** autobetoniere, vibrator betoni, autopompë betoni për të gjitha punimet e betonit të parashikuara në preventiv si: Struktura monolite betoni C 12/15 (nen bordura); Struktura monolite betoni C 16/20 (nen kunete); Struktura monolite betoni C 16/20; Struktura monolite betoni C 16/20 (muret mbajtes) etj. **Është kërkuar kamion me vinq për punime të parashikuara në preventiv si:** Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 1x1x1 m; FV shtylla metalike konike ndricimi  $H=4000\text{m}$  (3500m); shkarkim materialesh në kantier etj. **Është kërkuar 1 makineri vijëzimi për** Vijëzime me bojë bikomponente sipas preventivit **Janë kërkuar kamionë** vetëshkarkues me kapacitet 10-18 dhe mbi 18 ton për arsye të sasisë së konsiderueshme të materialeve që do të transportohen si: 2300 m<sup>3</sup> materiale ndërtimi e dheu; mbi 20,000 m<sup>2</sup> çakull, binder, asfalt, mbi 5000 m<sup>2</sup> pllaka guri, bordura guri, dërrasa etj. Vlen të theksohet se kantieri është në një distancë prej 22 km nga qyteti i elbasani dhe në një laartësi prej 900 m mbi nivelin e detit realizohet vetem nepermjet nje rruge te brendshme e cila eshte pjese e sheshit midis shkolles dhe institucionit te Bashkise Elbasan, ne menyre qe te shmangen demtimet nga tonazhet e renda nuk do te lejohen mjete mbi kapacitetin e kërkuar **Janë kërkuar** kamionçina për arsye të transportit materialeve të ndryshme si ato elektrike; të sinjalistikës, të pajisjeve e

veglave të punës; punëtorëve etj. **Është kërkuar** mjet gjurmimi për punimet e gjurmimit sipas preventivit: Gjurmim dhe me ekskavator me zinxhire 0.5 m<sup>3</sup>, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV sipas preventivit Gjurmim dhe me ekskavator me goma 0.25 m<sup>3</sup>, ne kanale gjeresi deri apo > 2 m, toke zak, sipas preventivit Gjurmim themele e plinta sipas preventivit. **Është kërkuar** fadromë për punimet sipas preventivit: Hedhje, rrafshim, mbushje me cakell, me material te dale nga gjurmimi. **Është kërkuar** makinë me kosh për punimet sipas preventivit: vendosjen e ndriçuesve ne shtylla etj.

**Observim:** **Kërkesa e mësipërme bazohet në ligjin** nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimin nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar; ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar; VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”. Në nenin 5 të ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se: “Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.” Në pikat 8 dhe 9 të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar parashikohet se:“ Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.” Në pikat 4, 5 dhe 6 të VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” parashikohet se: Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorur në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 107, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. Termi “Zotëruesi i mbetjeve inerte”, në kuptimin e këtij vendimi, është person fizik ose juridik, i cili, gjatë aktivitetit të tij të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objekteve, prodhon, transporton ose trajton mbetje inerte të cilat janë të renditura në kapitullin 17, të vendimit nr. 99, datë 18.2.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, të ndryshuar. Zotëruesi i mbetjeve inerte, i cili kryen përpunim paraprak, përzierje apo procese të tjera, që ndryshojnë natyrën ose përbërjen e këtyre mbetjeve, është i detyruar t’i ruajë, t’i transportojë dhe t’i dorëzojë ato në lëndfill apo në venddepozitimin e përkohshëm në mënyrë të diferencuar, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 371, datë 11.6.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, si dhe vendimit nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”. Zotëruesi i mbetjeve inerte është i detyruar t’i dorëzojë këto mbetje tek operatorët, të cilët janë të pajisur me leje mjedisore, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, dhe me licencë të tipit III.2.B, sipas vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”. Në nenet 21 dhe 57 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar; parashikohet se: **Neni 21** : Krijuesi ose zotëruesi fillestar i mbetjeve e kryen trajtimin e tyre vetë ose përmes një tregtari a personi tjetër që kryen operacione trajtimi të mbetjeve, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 448 ,datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”. **Neni 57:** 1. Transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve. 2. Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri. 3. Këshilli

i Ministrave, me propozimin e ministrit, të ministrit përgjegjës për ekonominë dhe të ministrit përgjegjës për transportin, miraton rregullat për zbatimin e këtij neni.

**Observim:** Përsa i përket kërkesës që OE pjesëmarrëes duhet të jenë të pajisur me leje/licencë të lëshuar nga QKL/QKB, Kodi III.1.A , Tipi C , Per prerjen, gdhendjen dhe lustrimin e gurit, ju bëjmë me dije se kjo kërkesë me shtojcën nr. nr. 4796/4 prot datë 28.12.2022 "Për një ndryshim në dokumentat standarte të tenderit" është hequr si kriter kualifikues.

**Observim:** AK ka percaktuar qe keto kriteret do të përmbushen nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i disponon mjetet e mësipërme, do të dorëzohet nga operatori ofertues i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Pra OE ekonomike nuk kane detyrim paraqitjen e lejes mjedisore ne momentin e ofertimit duke mos ndikuar keshtu ne kufizimin e pjesemarrjes se OE. Paraqitja e ketij dokumentacioni do te behet vetem nga OE i i kualifikuar i pari. Pavaresisht se eshte nje dokument i personave te trete, ai i sherben AK per te vleresuar nese furnizuesi ka fabriken e kekuar dhe se e ushtron aktivitetin ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, duke e vene keshtu edhe ne pozita te barabarta me OE pjesemarrës qe keto fabrika mund ti kene ne pronesi. Për më tepër nëse një OE disponon me qira një impiant të tillë duhet patjetër të ketë edhe lejen mjedisore QKL Kodi III.1.B, [pa të cilën nuk mund të ushtrorë aktivitetin. Për analogji kërkesa për paraqitjen e këtij dokumentacioni është e njëjtë si ajo për paraqitjen e dokumentacionit nga OE i kualifikuar i pari në rastet e marrjes me qira të mjeteve.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj Në aktkonstatimin nr. 15 dhe në Projektraport është cituar që kriteret nuk janë të justifikuar teknikisht, bazuar në preventivin e punimeve, pasi nisur edhe nga tabela e hartuar nga ana juaj për llojet e makineri/pajisjeve për zëra të ndryshëm pune, duket qartë që janë vendosur pajisje jo në propocion me zërat e punës duke ju referuar Kërkesat e veçanta të kualifikimit të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 14.09.2022. të cilat nuk janë të argumentuara teknikisht.

- Kërkesat e pikës 2.3.9 e DST, nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës. Nuk është e nevojshme licenca e mësipërme, pasi shërbimin e grumbullimit të mbetjeve e ofron Bashkia Elbasan dhe për subjektet që kryejnë punime ndërtimit aplikon tarifën ndotjes, shërbimit, për kohëzgjatjen e kantierit të ndërtimit.

- Kërkesavepër 3 (tre) punonjës karpentierë nuk është e argumentuar ligjërisht përsa i përket numrit të kërkuar dhe punës që do të kryejnë.

- Kriteret e vendosura në kërkesat e pikes 2.3.12/13/14 nuk janë të argumentuar teknikisht dhe ligjërisht pasi në rastet kur fabrika e betonit - elementeve të betonit - bordurave dhe pllakave nuk janë në pronësi të ofertuesit rezulton se kërkesa për paraqitjen me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për të cilën duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qerasë/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, u drejtohet personave të tretë që nuk janë konkurrent në këtë procedurë prokurimi.

7. Të dhëna mbi objektin e prokurimit: Rikonstruksion i gjendjes faktike të rrugës Azmi Stringa dhe 10 Korriku, lagja V. Xhuvani.

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i gjendjes faktike të rrugës Azmi Stringa dhe 10 Korriku, lagja V. Xhuvani".</b>			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> "E hapur" REF-51387-11-25-202 Urdhri nr. 4795 prot., datë 12.10.2022	<b>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit</b> Urdhri nr. s'ka, datë 12.10.2022 1. z.O.K 2. z. E.S	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> 1. z.O.K 2. z. E.S 3. z. A.B	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 4795/2 prot., datë 14.12.2022. 1. znj A.M 2. z. K.H 3. z. Y.M



	3.z. A.B	
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 14,538,801 lekë	<b>5. Oferta fituese, vlera fituese:</b> Operatori Fitues: "H" Sh.p.k 14,392,605 lekë pa tvsh.	<b>6. Diferenca me fondin limit</b> 146,196 lekë pa tvsh
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 30.12.2022	<b>8. Burimi Financimit</b> Buxheti i bashkisë	<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender, <b>2 OE</b> c) Kualifikuar <b>2 B/OE</b>
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 3 muaj</b>		
<b>10. Ankimime</b> AK-s'ka APP-s'ka KPP-s'ka	<b>11. Data e lidhjes të kontratës:</b> Nr. 4795/9 prot datë 20.02.2023	<b>12. Përgjigje</b> Ankesës nga APP, AK apo <b>KKP: AK S'ka</b>

***a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.***

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

***AK në lidhje me "Hartimin e Specifikimeve Teknike" dhe "Përlllogaritjen e Fondit Limit" :***

Me urdhër të zv. Kryetarit (Personi i Autorizuar) të Bashkisë Elbasan znj. A.B është ngritur një komision me urdhrin nr. 4795 prot., datë 12.10.2022 "Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit 14,538,801 lekë" me objekt: **"Rikonstruksion i gjendjes faktike të rrugës Azmi Stringa dhe 10 Korriku, lagja V. Xhuvani"**. Në zbatim të këtij urdhri, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga, z. O.K, z. A.B dhe z. E.S.

Fondet janë miratuar VKB nr. 82 datë 23.06.2022 mbi fituesit e projekteve për vitin 2022 në e cila do financohet në katër vite 2023-2024. Çmimet e vendosura janë në përputhje me VKM-në nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre".

**Mbi ndryshimin e dokumentave standarte të tenderit**

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Elbasan, bazuar në rekomandimet e Agjencisë së Prokurimit Publik, vendosi që të bëjë ndryshime në dokumentet standarte të tenderit me objekt: **"Rikonstruksion i gjendjes faktike të rrugës Azmi Stringa dhe 10 Korriku, lagja V. Xhuvani"**, me fond limit **14,538,801** (katërmbehdhjetë milion e pesëqind e tridhjetë e tetëmijë e tetëqind e një) lekë pa t.v.sh sipas shtojcës me nr. 4795/3 datë 21.12.2022 si vijon;

ISHTE	BËHET
<p>2.3.2 Liçensa profesionale e shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• N.P -1 A Punime gjermimi në tokë</li> <li>• N.P-4 A (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale)</li> <li>• N.P- 7 A Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje.</li> <li>• N.P-11 A (Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë).</li> <li>• N.P-12 A Punime të inxhinierisë mjedisore</li> <li>• N.S-1 A Punime për prishjen e ndertimeve</li> <li>• N.S-6 A Sinjalistika rrugore jondriçuese</li> <li>• N.S-18 A Punime topogjeodezike</li> <li>• Sipas modelit të leshuar nga institucioni përgjegjës për dhenien e licensave profesionale sipas legjislativitetit në fuqi .</li> </ul> <p><i>-Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës , ne plotesimin të licensave profesionale të kerkuara për ekzekutimin e kontratës .</i></p>	<p>2.3.2 Liçensa profesionale e shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>N.P -1 A</b> Punime gjermimi në tokë</li> <li>• <b>N.P- 4 A</b> (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale)</li> <li>• <b>N.P- 7 A</b> Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje.</li> <li>• <b>N.P-11 A</b> (Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë).</li> <li>• <b>N.S-6 A</b> Sinjalistika rrugore jondriçuese</li> <li>• <b>N.S-18 A</b> Punime topogjeodezike</li> <li>• Sipas modelit të leshuar nga institucioni përgjegjës për dhenien e licensave profesionale sipas legjislativitetit në fuqi .</li> </ul> <p><b><i>-Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës , ne plotesimin të licensave profesionale të kerkuara për ekzekutimin e kontratës .</i></b></p>

<p>2.3.4 Nje punësim mesatar për periudhen Shtator 2022 - Nentor 2022, i të paktën 45 (dyzet e pesë) personave të vërtetuar me :</p> <p><b>a)</b> Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;</p> <p><b>b)</b> Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhen e kërkuar.</p> <p>Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.</p> <p>Dokumentacioni provues qe OE i disponon punonjësit e mesipërmdo të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.</p>	<p><b>2.3.4 Nje punësim mesatar për periudhen Shtator 2022 - Nentor 2022, i të paktën 35 (tridhjetë e pesë) personave të vërtetuar me :</b></p> <p><b>a)</b> Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;</p> <p><b>b)</b> Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhen e kërkuar.</p> <p>Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.</p> <p>Dokumentacioni provues qe OE i disponon punonjësit e mesipërmdo të dorëzohet nga <b>ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.</b></p>
<p>2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të cilët duhet të figurojnë në licencën si dhe listëpagesat e shoqërisë për periudhen Shtator 2022 - Nentor 2022, si mëposhtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)</li> <li>- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)</li> <li>- Inxhinier Elektrik 1 (një)</li> <li>- Inxhinier Mjedisi 1 (një)</li> <li>- Inxhinier Gjeodet 1 (një)</li> </ul> <p>Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës noteriale e vlefshme dhe diploma.</p> <p>Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit. Për kete arsye te paraqitet deklarate përkatëse nga Administratori i shoqërisë.</p> <p>Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues qe OE i disponon punonjësit e mesipërm do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.</p>	<p><b>2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të cilët duhet të figurojnë në licencën si dhe listëpagesat e shoqërisë për periudhen Shtator 2022 - Nentor 2022, si mëposhtë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)</li> <li>- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)</li> <li>- Inxhinier Elektrik 1 (një)</li> <li>- Inxhinier Gjeodet 1 (një)</li> </ul> <p>Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës noteriale e vlefshme dhe diploma.</p> <p>Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit. <b>Për kete arsye te paraqitet deklarate përkatëse nga Administratori i shoqërisë.</b></p> <p>Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues qe OE i disponon punonjësit e mesipërm do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.</p>

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve të vendosura.

**Situata:** Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej z.O.K , E.S dhe z. A.B , të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 12.10.2022. Në lidhje me kriteret e vendosura, u konstatuar kriteret e ekzagjeruara dhe të paargumentuara. Në mënyrë të detajuar kriteret e konstatuara si të pa argumentuara dhe kriteret e argumentuara paraqiten si vijon:

**Kërkesat e pikës 2.3.2 e DST** e cila kërkon ndër të tjera Liçensa profesionale **NP-11 A** “Ndërtime për N/stacionet, kabinat e trasformatereve linja e TN e te mesëm dhe shpërndarjen e energjisë” *nuk është e argumentuar ligjërisht dhe për më tepër nuk është në përputhje me zbatueshmërinë dhe objektin e kontratës pasi projekti dhe preventivi i punimeve janë hartuar dhe procedohet për OE i cili do të marrë përsipër realizimin e objektit dhe kontratës së zbatimit të punimeve. Kriter i cili konsiderohet kufizues.*

**Kërkesat e pikës 2.3.8 e DST** e cila kërkon që Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme” ose të ketë kontratë shërbimi noteriale për objektin konkret me shoqëri të licensuara. *Këto kërkesa për licenca nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës. Nuk është e nevojshme*

licenca e mësipërme, pasi shërbimin e grumbullimit të mbetjeve e ofron Bashkia Elbasan dhe për subjektet që kryejnë punime ndërtimit aplikon tarifën ndotjes, shërbimit, për kohëzgjatjen e kantierit të ndërtimit.

**Kërkesat e pikës 2.3.11 e DST** e cila kërkon që Operatorët ekonomike duhet të kenë në pronësi/kontrate qeraje/kontrate furnizimi 1 (një) fabrike të prodhimit të elementeve të betonit - bordurave dhe pllakave, e cila duhet të jete e pajisur me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për të cilën duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qeraje/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B.

**Kërkesat e pikës 2.3.12 e DST** e cila kërkon që Operatorët ekonomike duhet të kenë në pronësi/kontrate qeraje/kontrate furnizimi 1 (një) fabrike inertesh, e cila duhet të jete e pajisur me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për të cilën duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qeraje/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B. Kriteret e vendosura në kërkesat e pikës 2.3.11/12 nuk janë të argumentuar teknikisht dhe ligjërishit pasi në rastet kur fabrika e betonit - elementeve të betonit - bordurave dhe pllakave dhe fabrikë I nuk janë në pronësi të ofertuesit rezultojnë se kërkesa për paraqitjen me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për të cilën duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qeraje/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, u drejtohet personave të tretë që nuk janë konkurent në këtë procedurë prokurimi.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës” .

*Sa më sipër mbanë përgjegjësi njësinë e prokurimit me përbërje z. O.K dhe z. A.B dhe z. E.S .*

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

**Ndikimi/Efekti:** Ndikon në paraqitjen e ofertave nga operatorët ekonomikë.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

#### ***b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. s’ka, të datës 13.01.2023, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	“B.N.” Sh.p.k me Nipt: K.....O	12,735,583	Kualifikuar
2	H” Sh.p.k me Nipt: J.....B	14,392,605	Kualifikuar

Sa më sipër KVO sipas procesverbaleve të vlerësimit të datës 13.01.2023 ka shpallur fitues Operatori ekonomik “B.N” sh.p.k. me vlerë 12,735,583 lekë i cili nuk ka paraqitur dokumentacionin në afatin e kërkuar siç parashikohet në pikën 6, të nenit 26, të V.K.M.-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar. Me procesverbalin e ri-vlerësimit të datës 13.01.2023 ka shpallur fitues Operatori ekonomik “H” Sh.p.k me Nipt: J.....B me vlerë oferte 14,392,605 lekë

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më nr. 4795/6 datë 03.02.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 2 operatorë pjesëmarrës janë kualifikuar 2 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 03.02.2023 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “H” Sh.p.k për të cilën është lidhur kontrata nr. 4795/9 datë 20.02.2023

për vlerën **14,392,605** lekë pa TVSH dhe vlera 17,271,126 lekë me TVSH, dhe me afat 3 (tre) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

**Konkluzion:** Arrihet në përfundimin se ky operator i plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DST dhe vendimi i KVO për shpalljen fitues të këtij operatori është i drejtë.

**c- Në lidhje me procedurën shqyrtimit të ankimeve. (Nuk ka patur ankime)**

Në lidhje me klasifikimin dhe vlerësimin e OE për procedurën e sipërcituar, ndër të tjera, rezultojnë se nuk janë paraqitur ankesa nga OE, duke kundërshtuar skualifikimin dhe pretendimet e AK.

Në observacionin e subjektit të audituar Bashkia Elbasan mbi Akt konstatimin nr.11 dërguar me shkresën nr. 4474/44 prot., dt. 22.11.2023 dhe me nr. 767/4 prot., (i KLSH) dt. 30.11.2023, shprehur si më poshtë vijon:

**Pretendimi i subjektit: Njësia e Prokurimit**

**Observim:** Kërkesa për pasjen në licensën e shoqërise kategorinë NP-11 (Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike), është bazuar tek zerrat e preventivit të projektit, seksioni VI, e konkretisht: Punime elektrike (FV shtylla metalike konike ndricimi H=4000m (3500m); F.V. Kabell FG7OR , S = 4\*16mm<sup>2</sup>; F.V. Kabell bakri me izolim FG7-OR ; S=3x1.5 mm<sup>2</sup>; F.V.kabllo kontrolli Cu te armuar, ne toke, 4x4 mm<sup>2</sup>; Tub kanalizimi pvc Ø 200 mm; FV pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+108(kapak metalik)etj. ) **Në VKM Nr. 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar, lidhja 3-Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme përcaktohet si mëposhtë: N.P.11 Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.** Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, **shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.**

**Observim:** Kërkesa e mësipërme bazohet në ligjin nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimin nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar; ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar; VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”. Në nenin 5 të ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se: “Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.” Në pikat 8 dhe 9 të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar parashikohet se:“ Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.” Në pikat 4, 5 dhe 6 të VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” parashikohet se: Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorur në ligjin

nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 107, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. Termi “Zotërues i mbetjeve inerte”, në kuptimin e këtij vendimi, është person fizik ose juridik, i cili, gjatë aktivitetit të tij të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objekteve, prodhon, transporton ose trajton mbetje inerte të cilat janë të renditura në kapitullin 17, të vendimit nr. 99, datë 18.2.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, të ndryshuar. Zotëruesi i mbetjeve inerte, i cili kryen përpunim paraprak, përzierje apo procese të tjera, që ndryshojnë natyrën ose përbërjen e këtyre mbetjeve, është i detyruar t’i ruajë, t’i transportojë dhe t’i dorëzojë ato në lëndfill apo në venddepozitimin e përkohshëm në mënyrë të diferencuar, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 371, datë 11.6.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, si dhe vendimit nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”. Zotëruesi i mbetjeve inerte është i detyruar t’i dorëzojë këto mbetje tek operatorët, të cilët janë të pajisur me leje mjedisore, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, dhe me licencë të tipit III.2.B, sipas vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”. Në nenet 21 dhe 57 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar; parashikohet se: **Neni 21** : Krijuesi ose zotëruesi fillestar i mbetjeve e kryen trajtimin e tyre vetë ose përmes një tregtari a personi tjetër që kryen operacione trajtimi të mbetjeve, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 448 ,datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”. **Neni 57**: 1. Transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve. 2. Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri. 3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, të ministrit përgjegjës për ekonominë dhe të ministrit përgjegjës për transportin, miraton rregullat për zbatimin e këtij neni.

**Observim:** AK ka përcaktuar qe keto kritere do të përmbushen nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i disponon mjetet e mësipërme, do të dorëzohet nga operatori ofertues i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Pra OE ekonomike nuk kane detyrim paraqitjen e lejes mjedisore ne momemtin e ofertimit duke mos ndikuar keshtu ne kufizimin e pjesemarrjes se OE. Paraqitja e ketij dokumentacioni do te behet vetem nga OE i i kualifikuar i pari. Pavaresisht se eshte nje dokument i personave te trete, ai i sherben AK per te vleresuar nese furnizuesi ka fabriken e kekuar dhe se e ushtron aktivitetin ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, duke e vene keshtu edhe ne pozita te barabarta me OE pjesemarrres qe keto fabrika mund ti kene ne pronesi. Për më tepër nëse një OE disponon me qira një impiant të tillë duhet patjetër të ketë edhe lejen mjedisore QKL Kodi III.1.B, [pa të cilën nuk mund të ushtrorë aktivitetin. Për analogji kërkesa për paraqitjen e këtij dokumentacioni është e njëjtë si ajo për paraqitjen e dokumentacionit nga OE i kualifikuar i pari në rastet e marrjes me qira të mjeteve.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj Në aktkonstatimin nr. 15 dhe në Projektraport është cituar që kriteret nuk janë të justifikuar teknikisht, bazuar në preventivin e punimeve, pasi nisur edhe nga tabela e hartuar nga ana juaj për llojet e makineri/pajisjeve për zëra të ndryshëm pune, duket qartë që janë vendosur pajisje jo në propocion me zërat e punës duke ju referuar Kërkesat e veçanta të kualifikimit të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 12.10.2022. të cilat nuk janë të argumentuara teknikisht.

- Kërkesat e pikës 2.3.8 e DST, janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërish në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës. Nuk është e nevojshme licenca e mësipërme, pasi shërbimin e

grumbullimit të mbetjeve e ofron Bashkia Elbasan dhe për subjektet që kryejnë punime ndërtimit aplikon tarifën ndotjes, shërbimit, për kohëzgjatjen e kantierit të ndërtimit.

- Kriteret e vendosura në kërkesat e pikës 2.3.11/12 nuk janë të argumentuar teknikisht dhe ligjërisht pasi në rastet kur fabrika e betonit - elementeve të betonit - bordurave dhe pllakave dhe fabrikë I nuk janë në pronësi të ofertuesit rezultojnë se kërkesa për paraqitjen me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për të cilën duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qerases/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, u drejtohet personave të tretë që nuk janë konkurent në këtë procedurë prokurimi.

## Mbi Procedurat e prokurimit për blerje me vlerë të vogël për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022

### ➤ Nga auditimi i dokumentacionit të sipërcituar, u konstatua si më poshtë vijon:

Bashkia Elbasan çdo vit realizon blerje të punëve, furnizimit me mallrave ose shërbime nëpërmjet edhe procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, në zbatim të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe paketës së Udhëzimeve të MF – APP18 në periudhën 2021-2022.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga Njësia e Prokurimit për blerje të vogla dhe Drejtoria e buxhetit dhe financës, rezultoi si më poshtë vijon:

- Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël për vitin 2022 është ngritur me Urdhrin e Kryetarit nr. 101 prot., datë 12.01.2022 dhe ka këtë përbërje:

Komisioni i Blerjeve të vogla Viti 2022		
Emër Mbiemër	Pozicioni në komision	Njësia në strukturë
A.L	kryetar	DPSHIPB/DPP/SNJP
O.K	anëtar	-//-
A.M	anëtar	-//-

Punoi: Grupi auditimit

- Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion, nga Njësia e Prokurimit dhe Drejtoria Ekonomike për periudhën raportuese objekt i procesit të auditimit (nga data 01 janar deri 31 dhjetor 2022), lidhur me regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël dhe atyre të realizuara, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Tipi i kontratës	Planifikimi 2022		Realizimi 2022		Mbetur nga plani	
	Numri	Fondi limit	Numri	Vlera e kontratës	Numër	vlerë
Mallra	19	7,784,995	6		13	5,061,196
Shërbime	20	10,699,158	5/8		15	9,181,672
Punë	-	0	-	0	-	0
<b>Nentotali</b>	<b>39</b>	<b>19,400,819</b>	<b>11/14</b>	<b>4,059,545.4</b>	<b>28</b>	<b>15,341,273.6</b>
Shtuar	2	172,541	2	197,534	-	0
<b>Totali</b>	<b>41</b>	<b>19,573,360</b>	<b>13/16</b>	<b>4,257,079.4</b>	<b>28</b>	<b>15,316,280.6</b>

Burimi: Bashkia Elbasan/KBVV

Për periudhën objekt auditimi periudha raportuese (nga data 01 janar deri 31 dhjetor 2022), AK ka planifikuar në fillim të vitit **39** procedura me vlerë të fondit limit 19,400,819 lekë; ka ndryshuar regjistrin në **41** procedura në vlerën e fondit limit prej 19,573,360 lekë; më hollësisht procedurat e

<sup>18</sup> MF Ministria e Financave  
APP Agjencia e prokurimit publik

prokurimit të parashikuara dhe të realizuara me “vlerë e vogël”, sipas urdhër prokurimit si më poshtë;

Nr	Urdhër prokurimi	Objekti i Prokurimit		Tipi i Kontratës	Burimi i financimit	Fondi	
		Parashikuar	Realizuar			Limit	Vl.kontratës
1		Blerje pajisje zyre		mall	Buxh.Bashkia	185,833	
2	357 dt.26.01.2022	Blerje pajisje borëpastruese (1)	√	-/-	Grant specifi	833,333	888,888
3		Kartolina për fundviti		-/-	Buxh.Bashki	166,666	
4	4566 dt.28.09.2022	Riparime printera dhe fotokopje (2)	√	shërbime	-/-	500,000	474,000
5		Buxhetimi me pjesëmarrje		mall	-/-	333,333	
6		Shpenzime për CAL për user për active directory		shërbime	-/-	833,333	
	1714 dt.11.05.2022	Blerje biletë udhëtimi me avion Tiranë – Bruksel-Tiranë (3)	√				69,212
	2380 dt.11.05.2022	Blerje biletë udhëtimi me avion Tiranë – Varshavë-Tiranë (4)	√				54,200
	5115 dt.01.11.2022	Blerje biletë udhëtimi me avion Tiranë – Oslo-Tiranë (5)	√				41,365
	5237 dt.08.11.2022	Blerje biletë udhëtimi me avion Tiranë – Pragë-Tiranë (6)	√				55,660
7		Shpenzime për rinovim licenca FIREËALL		-/-	-/-	666,666	
8		Help desk Ticketing softëare 10 përdorues 2500l/m user 3 vjet		-/-	-/-	750,000	
	4581 dt.13.09.2022	Blerje materiale për sektorin IT (7)	√	-/-		918,333	597,600
9		Blerje volume Licensing Microsoft 365 biznes basic 100 user		-/-	-/-	833,333	
10		Njoftime në TV		-/-	-/-	416,666	
11		Shpenzime për riparim kondicioneri		-/-	-/-	500,000	
12		Shpenzime për riparim kondicioneri		-/-	-/-	500,000	
13		Mirëmbajtje e faqes së bashkisë		-/-	-/-	66,666	
14		Materiale të ndryshme (hidraulike,elektrike, dryna, brava etj)		mallra	-/-	833,333	
15		Shërbime të ndryshme (noterizime, kontrata, blerje çeqe etj)		shërbime	-/-	833,333	
	3369 dt.13.07.2022	Shtypshkrime (8)	√	-/-		468,800	468,000
16		Blerje dhurata ceremoniale, flamuj, korniza etj		mallra	-/-	833,333	
17		Shpenzime për shërbime dhe marrje dokumentacioni hartografik		shërbime	-/-	166,666	
18		Kuti për ruajtjen e përhershme të dokumenteve RHK (40x20x18)		mallra	-/-	174,166	
19		Dosje për ruajtjen e përhershme të dokumenteve (36x24)		-/-	-/-	815,000	
20		Njoftime në media për mbledhjet dhe aktivitetet e K.Bashkiak		shërbime	-/-	469,166	
21		Materiale të tjera Policia bashkiake		Mallra	-/-	166,666	
	2244 dt.12.05.2022	Blerje shirita bllokues për policinë bashkiake (9)	√			140,000	105,600
22		Mirëmbajtje sistemi monitorimi i ambientit		Shërbime	-/-	356,666	
23		Blerje kondicionerë për SHMZSH		mallra	-/-	166,667	

24		Të tjera materiale dhe shërbime speciale shkume		-/-	-/-	833,333	
25		Pjesë këmbimi goma, bateri, vaj etj		-/-	-/-	260,000	
26		Furnizim/vendosje pjesë këmbimi		shërbime	-/-	323,333	
27		Shpenzime siguracioni mjete transporti		-/-	-/-	225,000	
	4222 dt.12.09.2022	Shpenzime për sigurimin e mjeteve të transportit (10)	√			270,000	268,480
28		Shpenzime të tjera transporti		-/-	-/-	279,166	
29		Shpenzime për mirëmbajtje mjete transporti		-/-	-/-	416,666	
30		Shpenzim për sigurim jete të SHMZSH		-/-	-/-	479,166	
	4223 dt.12.09.2022	Shpenzime për sigurimin e jetës së punonjësve të SHMZSH (11)	√			575,000	575,000
31		Blerje depozite uji+pompë elektrike		mallra	-/-	183,333	
	5025 dt.26.10.2022	Blerje depozite uji+pompë elektrike (12)	√			183,333	195,360
32		Goma		-/-	-/-	833,333	
	5238 dt. 08.11.2022	F.V. goma për mjetet e SHMZSH (13)	√	mallra		180,000	214,560
33		Vajra lubrifikantë		-/-	-/-	833,333	
34		Vajra mishel		-/-	-/-	833,333	
35		Shërbim mirëmbajtje rrugë rurale, riparime dhe mirëmbajtje vepra arti		shërbime	-/-	833,333	
	777 dt.10.02.2022	Mbikqyrja e objektit për "F.V.barriera rrugore mbrojtëse (14)	√	-/-		54,446	52,508.4
36		Blerje medikamente dhe ushqim për qentë pa pronar		Mallra/shërbim	-/-	833,333	
<b>Gjendja civile</b>							
1		Shpenzime për mirëmbajtje godine (mirëmbajtje + lyerje)		shërbime	-/-	416,666	
2		Blerje materiale të përgjithshme zyre		mallra	-/-	250,000	
3		Blerje uniforme për stafin		mallra		166,666	
39		<b>14</b>				<b>19,400,819</b>	<b>4,059,545.4</b>
<b>Procedura të realizuara por të paplanifikuara</b>							
1	1984 dt.20.04.2022	Kolaudim i objektit "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra e të pafavorizuara (15)	√	shërbime	-/-	30,874	29,534
2	5849 dt.14.12.2022	Transporti për uniforma të SHMZSH (donacion Holanda) (16)	√	mallra	-/-	141,667	168,000
2		<b>2</b>				<b>172,541</b>	<b>197,534</b>
41		<b>16</b>				<b>19,573,360</b>	<b>4,257,079.4</b>

**Burimi: Bashkia Elbasan/NJP**

Nga auditimi i evidencave dokumentare dhe informacionit të pasqyruar në tabelë, rezulton se në fillim të vitit janë parashikuar **39** procedura prokurimi në vlerën totale të fondit limit 19,400,819 lekë; nga të cilat janë realizuar **14** procedura në vlerën 2,681,750 lekë; janë shtuar jashtë parashikimit vjetor **2** procedura: "Kolaudim i objektit "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra e të pafavorizuara" dhe "Transporti për uniforma të SHMZSH (donacion Holanda)", fondet e të cilave me Urdhrin nr. 1255 datë 05.12.2022 "Për ndryshim plani janë nga shpenzimet korrente" në programin 03280 është pakësuar artikulli 602/ shpenzime ujë dhe shtuar artikulli 602/shpenzime transporti për SHMZSH në vlerën 170,000 lekë; dhe që në total janë



llogaritur si fond limit në vlerën 172,541 lekë pa tvsh dhe realizuar në vlerën 197,534 lekë; Pra gjatë vitit 2022 në total janë **16** procedura të realizuara në vlerën sipas kontratës prej 4,257,079.4 lekë. Ndryshimet në regjistrin e prokurimeve janë bërë konform akteve ligjore në fuqi.

- Gjithashtu referuar regjistrin të parashikimeve, u konstatua se nuk jepet përshkrim i qartë mbi procedurën nëse përfshin përvec mallrat dhe shërbimin nga OE edhe magazinimin apo jo në ambientet e tij apo në ato të bashkisë, si në rastin e "Blerje medikamente dhe ushqim për qentë pa pronar" në kundërshtim me nenin 1 pika 2 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

- Një informacion mbi planifikimin e procedurave për blerje me vlerë të vogël për mallra/grupmallra dhe shërbime/grupshërbime të të njëjtës natyrë, funksioni apo subjektet në cilësinë e OE me të njëjtën fushë aktiviteti, pasqyrohen në tabelën më poshtë:

			<b>Objekti i prokurimit në parashikim</b>				
1	1		Blerje pajisje zyre	mallra	Buxh.Bashkia	185,833	435,833
	2		Blerje materiale të përgjithshme zyre		-/-	250,000	
2	11		Shpenzime për riparim kondicioneri	shërbime	-/-	500,000	1,000,000
	12		Shpenzime për riparim kondicioneri		-/-	500,000	
3	8		Help desk Ticketing softëare 10 përdorues 2500l/m user 3 vjet	Mallra/shërbime	-/-	750,000	1,583,333
	9		Blerje volume Licensing Microsoft 365 business basic 100 user		-/-	833,333	
4	10		Njoftime në TV	shërbime	-/-	416,666	885,832
	20		Njoftime në media për mbledhjet dhe aktivitetet e K.Bashkiak		-/-	469,166	
5	18		Kuti për ruajtjen e përhershme të dokumenteve RHK (40x20x18)	mallra	-/-	174,166	1,989,165
	19		Dosje për ruajtjen e përhershme të dokumenteve (36x24)		-/-	815,000	
	16		Blerje dhurata ceremoniale, flamuj, korniza etj		-/-	833,333	
	3		Kartolina për fundviti		Buxh.Bashki	166,666	
6	25		Pjesë këmbimi goma, bateri, vaj etj	Mallra/shërbime	-/-	260,000	3,499,998
	26		Furnizim/vendosje pjesë këmbimi		-/-	323,333	
	29		Shpenzime për mirëmbajtje mjete transporti		-/-	416,666	
	32		Goma		-/-	833,333	
	33		Vajra lubrifikantë		-/-	833,333	
	34		Vajra mishel		-/-	833,333	

Punoi: Grupi i auditimit

Nga auditimi mbi regjistrin e parashikimeve dhe atë të realizimit të prokurimeve për blerje me vlerë të vogël pasqyruar në tabelat më lart, u konstatua se: për mallra/grupmallra dhe shërbime/grupshërbime të njëjta, janë parashikuar me copëzim të fondit në 6 raste, prej të cilave në 3 raste me vlera në tejkalim të vlerës limit prej 1,000,000 lekë, konkretisht:

1. - ["Help desk Ticketing softëare 10 përdorues 2500l/m user 3 vjet" & "Blerje volume Licensing Microsoft 365 busines basic 100 user"] me vlerë totale të fondit limit (pa tvsh) prej 1,583,333 lekë;
2. - ["Kuti për ruajtjen e përhershme të dokumenteve RHK (40x20x18)" & "Dosje për ruajtjen e përhershme të dokumenteve (36x24)"& "Blerje dhurata ceremoniale, flamuj, korniza etj" & "Kartolina për fundviti"] me vlerë totale të fondit limit (pa tvsh) prej 1,989,165 lekë;
3. - ["Pjesë këmbimi goma, bateri, vaj etj" & "Furnizim/vendosje pjesë këmbimi" & " Shpenzime për mirëmbajtje mjete transporti" & "Goma" & " Vajra lubrifikantë" & "Vajra mishel"] me vlerë totale të fondit limit (pa tvsh) prej 3,499,998 lekë. Për sa më lart rezulton në kundërshtim me nenin 56 pika 11 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Udhëzimi nr. 4 datë 18.06.2021 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, Udhëzimi nr.5 datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, Udhëzimi nr. 05, datë 29.07.2022 “Për disa ndryshime në manualin teknik që shoqëron Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike".

**Konstatim:** Nga auditimi i **16** dosjeve të procedurave të prokurimit me blerje të vogël të realizuara gjatë vitit 2022 dhe të pasqyruara në tabelën e mësipërme, *rezultuan mungesa dokumentacioni* të cilat referuar Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285/2021 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 2 pikat 1 dhe 2, neni 13, neni 15 si dhe Udhëzimeve përkatëse, duhet të jenë domozdoshmërisht pjesë e dosjes së procedurës dhe konkretisht:

- Për moszbatim të hapave proceduriale nga ana e KBVV në 2 raste rezultuar kjo me mungesë të dokumentit përkatës - procesverbalit përmbledhës i ofertave të testuara, mbi të cilin komisioni vendos cmimin për njësi dhe vlerën e fondit limit në Urdhrin e Prokurimit për  
- dosjen nr. 12 “Blerje depozite uji+pompë elektrike” me UP nr. 5025 dt. 26.10.2022;  
- dosjen nr. 1319 “F.V. goma për mjetet e SHMZSH” me UP nr. 5238 dt. 08.11.2022;

- Për moszbatim të hapave proceduriale nga ana e KBVV në 2 raste rezultuar kjo me mungesë të dokumenteve përkatës, për  
- dosjen nr. 10 “Shpenzime për sigurimin e mjeteve të transportit” me UP nr. 4222 dt. 12.09.2022 dhe USH nr. 873 dt. 26.09.2022;  
- dosjen nr. 11 “Shpenzime për sigurimin e jetës së punonjësve të SHMZSH” me UP nr. 4223 dt. 12.09.2022 dhe me USH nr. 868 dt. 22.09.2022 ;

për të cilat nga auditimi rezultoi se nga KBVV nuk është bërë testimi i tregut, por për përcaktimin e vlerës së fondit limit të secilës procedurë, janë mbështetur te vlera e fondit të vitit paraardhës, *duke anashkuar hapat e procedurës të përcaktuara dhe si rrjedhojë fillimin e procedurës pa vlerësuar paraprakisht ofertat dhe përcaktuar vlerën e fondit limit për secilën procedurë, gjithashtu edhe me mangësi të dokumentacionit të OE fitues* (dokumentacion jo i plotë i Sigal Unica Group) me nr. NIPT-i J....H, në kundërshtim kjo me nenet 2 dhe 3 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 pika 2/c,ç, neni 13 e neni 15 të VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe që ka rezultuar vetëm me një OE si aplikues dhe automatikisht edhe fitues.

<sup>19</sup> Numri korrespondon me numrin e vendosur te procedura e tabelës së parashikimeve dhe realizimeve të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël

- Për moszbatim të kërkesave ligjore mbi marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve *nga ana e Titullarit të Njësisë (NA) në 2 raste* rezultuar kjo me mungesën e dokumentit përkatës në dosje dhe në Urdhër shpenzimet përkatëse të NZ, për

- dosjen nr. 14 "Mbikqyrja e objektit për "F.V.barriera rrugore mbrojtëse" me UP nr. 777 dt. 10.02.2022 dhe USH nr. 1105 dt. 24.11.2022;

- dosjen nr. 16 "Transporti për uniforma të SHMZSH (donacion Holanda)" me UP nr. 5849 dt. 14.12.2022 dhe USH nr. 98 dt. 22.02.2023;

Mallrat e blera kanë kaluar nga furnitori duke u bërë hyrje në magazinë, pa pasur një filtër kontrolli mbi sasinë, llojin dhe cilësinë e kërkuar sipas kriterëve të procedurës e prokuruar, kjo në kundërshtim me pikat 42,43 (për NA), 52,53,54 (për NZ) të Udhëzimit nr. 30/ 2011 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik";

**Konkluzion:** Nga verifikimi i dosjeve të procedurave të prokurimit për blerjet me vlerë të vogël, të pasqyruara në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mësipërme, rezulton se :

**1.** Në 2 raste (dosje) procedurash nga 16 dosje gjithsej, ka mungesa në dokumentacione apo mangësi në përmbajtje si: Ftesa për ofertë në të gjitha rastet nuk kishin të plotësuar tabelën tip me informacionin e nevojshëm financiar; testimi i tregut nuk është bërë në çdo rast dhe si rrjedhojë as procesverbali përmbledhës apo dhe vendimi mbi cmimin e mallit/shërbimit, në rastet kur është bërë nuk ka të regjistruar datën kur është dokumentuar testimi;

- Lista e OE që i janë përgjigjur ftesës apo klasifikimi përfundimtar i tyre, si dhe mangësi në dokumentacionin e OE fitues, në kundërshtim këto me ligjin nr. 162 datë 23.12.2020; VKM nr. 285 datë 19.05.2021 dhe paketa e Udhëzimeve të MFE - APP përkatësisht: nr. 05 datë 25.06.2021; nr. 05 datë 29.07.2022; nr. 04 datë 20.05.2022; nr. 03 datë 18.06.2021 etj.

Nr	Emërtimi	Sasia	Cmimi per njesi	Çmimi ne total	Afati
	xxxx	xx	xx	xx	xx
	Shuma pa tvsh				
	TVSH 20%				
	<b>Totali</b>				

Tabela tip e Ftesës për ofertë

**2.** Në 2 raste mungon Urdhri i titullarit për ngritjen e komisioni të marrjes në dorëzim të mallit apo shërbimit, dhe si rrjedhojë dhe as ngritjen e komisionit dhe procesverbalit të hartuar prej tij mbi përputhshmërinë e tyre sipas kërkesave të prokurimit, në kundërshtim me pikat 42,43 (për NA), 52,53,54 (për NZ) të Udhëzimit nr. 30/ 2011 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik".

- Nga verifikimi i praktikave dokumentare të procedurave me bankën, rezultoi se 14 procedurat *ishin të plota në dokumentacion*, konform Udhëzimit nr. 30 /2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" kapitulli III, paragrafi 2 pika 35/a,b,c;

- Një përmbledhje e dokumentacionit autorizues, vërtetues/konfirmues dhe atij likuidues, pasqyrohet si vijon:

Nr.	Urdhër Prokurimi	Marrje në dorëzim	Urdhër Shpenzimi	Vlera në lekë	Nipt-i i OE
1	2244 dt. 12.05.2022	2417/2 dt. 23.05.2022	516 dt. 30.06.2022	105,600	L.....H
2	3369 dt. 13.07.2022	3369/9 dt. 29.07.2022	856 dt. 20.09.2022	468,000	J.....M
3	4581 dt. 13.09.2022	4581/2 dt. 19.10.2022	1051 dt. 10.11.2022	597,600	J.....C
4	1714 dt. 05.04.2022	dt. 11.05.2022	605 dt. 22.07.2022	69,212	L.....L
5	2380 dt. 11.05.2022	dt. 05.05.2022	278 dt. 05.05.2022	54,200	L.....L
6	5115 dt. 01.11.2022	dt. 01.11.2022	1106 dt. 24.11.2022	41,365	M.....F
7	5237 dt. 08.11.2022	dt. 14.11.2022	1107 dt. 24.11.2022	55,660	K.....N
8	1984 dt. 20.04.2022	1984/1 dt. 26.04.2022	867 dt. 22.09.2022	29,534	L.....I
9	4566 dt. 28.09.2022	4566/2 dt. 17.10.2022	1202 dt. 19.12.2022	474,000	M.....G

10	777 dt. 10.02.2022	dt. 22.03.2022	296 dt. 14.12.2022	52,508	K.....K
11	357 dt. 26.01.2022	dt. 28.03.2022	166 dt. 28.03.2022	888,000	M.....U
12	4223 dt. 12.09.2022	dt. 16.09.2022	868 dt. 22.09.2022	575,000	J.....H
13	4222 dt. 12.09.2022	dt. 16.09.2022	873 dt. 26.09.2022	268,480	J.....H
14	5025 dt. 26.10.2022	mungon në dosje	1105 dt. 24.11.2022	195,360	K.....G
15	5238 dt. 08.11.2022	5238/2 dt. 14.11.2022	1102 dt. 23.11.2022	214,560	M.....G
16	5849 dt. 14.12.2022	mungon në dosje	98 dt. 22.02.2023	168,000	K.....I-

- Nga auditimi rezultoi se Autoriteti Kontraktor (*Bashkia Elbasan*) në cilësinë e njësisë shpenzuese publike vendore, nuk ka kryer shpenzime me fonde publike me objekt "blerje mallra, punë dhe shërbime publike" *me natyrë të njëjtë* në tejkallim të vlerës limit prej 1,000,000 lekë.
- Kërkesa për prokurim në të gjitha rastet është miratuar nga Nëpunësi i Autorizuar i AK, si është përcaktuar në ligj.

Në observacionin e subjektit të audituar Bashkia Elbasan mbi Akt konstatimin nr.10 dërguar me shkresën nr. 4474/44 prot., dt. 22.11.2023 dhe me nr. 767/4 prot., (i KLSH) dt. 30.11.2023, shprehur si më poshtë vijon:

**Pretendimi i subjektit:**

1. Në lidhje me konstatimin për mallra/grup mallra dhe shërbime/grup shërbime të njëjta, janë parashikuar me copëzim të fondit në 3 raste ku është tejkalluar vlera prej 1,000,000, ju bëjmë me dije se:

- Objekti i prokurimit "Help desk Ticketing softëare 10 perdorues 2500 l/m user 3 vjet", nuk është hedhur si element i parashikuar tek regjistri i prokurimeve në sistemin elektronik (SPE) si dhe as nuk është zhvilluar si procedurë prokurimi.

- Objekti i prokurimit "Blerje volume Licensing Microsoft 365 biznes basic 100 user" nuk është hedhur si element i parashikuar tek regjistri i prokurimeve në sistemin elektronik (SPE) si dhe as nuk është zhvilluar si procedurë prokurimi.

- Objektet e prokurimit "Kuti për ruajtjen e përhershme të dokumentave RHK (40x20x18)" dhe objekti "Dosje për ruajtjen e përhershme të dokumentave (36x24)", nuk janë hedhur si elemente të parashikuara tek regjistri i prokurimeve në sistemin elektronik (SPE), nuk kanë qenë të parashikuara për tu zhvilluar si procedura prokurimi me vlerë të vogël dhe as nuk janë realizuara si të tilla.

Autoriteti Kontraktor në lidhje me këto dy objekte ka lidhur thjeshtë një kontratë me objekt "Blerje Kuti dhe Dosje për ruajtje të përhershme" dhe procedura është e zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

- Objekti i prokurimit "Kartolina per fundviti" nuk është hedhur si element i parashikuar tek regjistri i prokurimeve në sistemin elektronik (SPE) si dhe as nuk është zhvilluar si procedurë prokurimi.

- Proçedurat e prokurimit që kanë si objekt malli pjesë këmbimi, shërbime mirëmbajtje dhe vajra janë zhvilluar si procedura të hapura të thjeshtuara dhe jo blerje me vlerë të vogël dhe si rrjedhojë nuk është bërë copëzim i fondit. Bashkëngjitur keni dhe urdhrat e prokurimit për procedurat përkatëse.

Sa me sipër në lidhje me konstatimin e bërë nga ana juaj në lidhje me copëzimin e fondeve ju bëjmë me dije se, pavarësisht se elementet e parashikuara në buxhet janë miratuar në zera të vecanta, Autoriteti Kontraktor në momentin që do të hedhë zerat në regjistrin e parashikimeve në SPE për mallra/grup mallra dhe shërbime/grup shërbime me natyrë të ngjashme, i bashkon elementet përkatëse duke mbajtur parasysh dhe mos tejkallimin e fondit të parashikuar prej 1,000,000 leke për gjatë gjithë vitit buxhetor. Nisur sa me sipër, AK gjatë vitit 2022 nuk ka zhvilluar procedurë prokurimi me vlerë të vogël të cilat kanë patur natyrë të ngjashme dhe të jenë realizuara si procedura me vete apo të kene tejkalluar vlerën limit prej 1,000,000 leke, e si pasojë nuk ka copëzuar fondet.

Konstatimi në lidhje me mangesitë në dokumentacione:

-Mungesa e kerkeses se njesise ne lidhje me proceduren me objekt : Kolaudimi i objektit "Permiresim i banesave ekzistuese per komunitete e varfera dhe ta pafavorizuara"- ju bejme me dije se per kete lloj objekti nuk ka kerkese specifik te vecante pasi vlera per kete ze eshte e percaktuar qe ne preventivin e projektit te lartpermendur dhe per keto lloje procedurash nuk ka kerkese.

Gjithashtu eshte konstatuar dhe mungesa e dosjes se operatorit fitues, bashkelidhur keni kopjet te dokumentave perkates.

-Per procedurat e prokurimit te cilat kane patur si objekt bileta udhetimi (4 bileta udhetimi) nuk jane mbajtur proces-verbale per testimin e tregut sepse per kete lloj sherbimi eshte e pamundur te behet nje testim real pasi cmimet e biletave ndryshojne ne menyre te shpejte dhe nuk mund te percaktohet nje cmim mesatar. Ne manualin teknik "Për zhvillimin e procedurës së prokurimit Sistem Dinamik për Blerje e Biletave të Transportin Ajror Ndërkombëtar", në Sistemin e Prokurimit Elektronik" bazuar ne udhezimin nr.03, date 18.06.2021, shprehet qarte se tek seksioni " Kohëzgjatja dhe vlera e parashikuar" ne fushen "Vlera e përafërt (LEK)" duhet vendosur vlera 0,0 leke, pra nuk mund te percaktohet qarte nje vlere e sakte fondi limit.

Ne lidhje me praktiken e dokumentave per keto procedura, OE nuk dorezon dokumenta fizike prane institucionit. Ne ftesen per oferte, OE i kerkohet rezervimi i biletës dhe certifikata e akreditimit te cilat dergohen nga operatori ekonomik fitues ne sistemin e prokurimit elektronik dhe cdo komunikim eshte bere me ane te sistemit dhe email-it.

Bashkengjitur keni certifikaten e akreditimit dhe komunikimet me email.

-Për proceduren me objekt "Blerje materiale për sektorin e IT" është konstatuar se mungon në dosje klasifikimi perfundimtar. Ju bëjmë me dije se klasifikimi perfundimtar ndodhej në dosjen fizike të prokurimit, bashkelidhur keni klasifikimin perfundimtar të procedurës.

-Për proceduren me objekt "Blerje shtypshkrime" eshte konstatuar se mungon ne dosje deklarata e konfliktit te interesit shtojca II dhe praktika dokumentave te OE fitues. Ju bejme me dije se deklarata e konfliktit te interesit shtojca II dhe praktika dokumentave te OE ndodhej ne dosjen fizike te prokurimit, bashkelidhur keni kopjet te dokumentave perkates.

-Për proceduren me objekt "Blerje shirata bllokues per policine bashkiake" eshte konstatuar se mungon ne dosje praktika dokumentave te OE fitues. Bashkelidhur keni kopjet te dokumentave perkates.

-Për proceduren me objekt "Shpenzime të siguracionit te mjeteve të transportit" është konstatuar se mungon në dosje praktika dokumentave të OE fitues. Bashkelidhur keni kopjet të dokumentave perkates.

-Per proceduren me objekt "Shpenzime te siguracionit te mjeteve te transportit" eshte konstatuar se mungon ne dosje praktika dokumentave te OE fitues. Bashkelidhur keni kopjet te dokumentave perkates.

-Per proceduren me objekt "Mbikëqyrje e objektit "F.V. barriera rrugore mbrojtëse"eshte konstatuar se mungon ne dosje praktika dokumentave te OE fitues si dhe nuk eshte mbajtuar urdher per ngritjen e komisionit te marrjes ne dorezim.

Per kete procedure nuk ngrihet nje grup komisioni per marrjen ne dorezim pasi eshte vete operatori fitues personi pergjegjes qe do te mbikqyri te gjithe procesin e punes.Natyra e sherbimit eshte vete e tille qe nuk ngrihet nje urdher komisioni per marrjen ne dorezim.

Ne lidhje me dokumentat e operatorit fitues keni bashkelidhur kopjet e dokumentave perkates.

-Per proceduren me objekt "Transporti per SHMZSH-ne (uniforma donacion Holanda)" eshte konstatuar se mungon ne dosje praktika dokumentave te OE fitues. Bashkelidhur keni kopjet te dokumentave perkates.

3.Ne lidhje me konstatimin se Ftesa per oferte ne te gjitha rastet nuk eshte plotesuar sipas tabelës tip ju shpjegojme se: Ftesa per oferte eshte bazuar ne modelin e percaktuar ne Udhezimin nr.05, date 25.06.2021 "Mbi perdorimin e procedures me vlere te vogel dhe e saj me mjete elektronike", Formulari Nr.3, ne te cilen afati i levrimit eshte i percaktuar ne cdo ftese per oferte.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Lidhur me pretendimet tuaja mbi konstatimet e grupit të auditimit lënë në Akt konstatimin nr. 10 dt. 13.11.2023, ju sjellim në vëmendjen tuaj si mëposhtë vijon:

**1.** Konstatimet janë rezultat i verifikimit të dokumentacionit të kërkuar prej nesh dhe të vëna në dispozicion nga ju: Regjistrin e parashikimeve; Regjistrin e realizimeve, të gjitha dosjeve fizike të procedurave të BVV të realizuara në viti 2022 dhe dokumentacionin bankar të vitit 2022. Lidhur me pretendimin tuaj nr.1, të regjistri i parashikimeve që ju na keni vënë në dispozicion grupimi i mallrave apo shërbimeve pasqyruar edhe në tabelë, rezulton në kundërshtim me nenin 56 pika 11 të VKM nr. 285/2021 në të cilin citohet: “Në asnjë rast, autoriteti/enti kontraktor **në momentin e planifikimit të nevojave të tij**, nuk duhet të përdorë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës për shmangien nga procedurat e prokurimit”; Udhëzimit nr. 04 datë 18.06.2021 Krei I pika 1 Paragrafi 2, paragrafi 4 ku citohet “.. hartimi dhe plotësimi i saktë i të dhënave në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit është mjaft i rëndësishëm, pasi ky regjistër është baza e të dhënave mbi të cilën fillon një procedurë prokurimi në sistemin e prokurimit elektronik”. Për sa cituar, pretendimi juaj për këtë pikë **nuk merret parasysh** nga grupi i auditimit.

**2.** Lidhur me pretendimin mbi procedurat e blerjeve të biletave të udhëtimit, është lapsus dhe pretendimi juaj **merret parasysh** nga grupi i auditimit.

**3.** Lidhur me mungesa të dokumenteve të ndryshme të domosdoshme për tu dorëzuar nga OE fitues kryesisht, konstatimi është mbështetur **mbi verifikimin fizik të dosjeve**, që janë shprehur simbolikisht edhe në tabelën përmbledhëse: me X janë shënuar dokumentet që duhet dhe që gjenden në dosje; me M janë shënuar ato dokumente që duhet por që nuk gjenden në dosje; me NA janë shënuar dokumentet që nuk janë pjesë e asaj procedure. Dokumentacioni që i është bashkëngjitur observacionit duhej të gjendej fizikisht në dosje. Për sa sqaruam, pretendimi juaj **nuk merret parasysh** nga grupi i auditimit.

**4.** Lidhur me pretendimin tuaj mbi komisionet e marrjes në dorëzim në 2 raste, ju sjell në vëmendje se në asnjë akt ligjor/nënligjor nuk ka raste përjashtimore. Ndaj dhe pretendimi juaj duke mos patur mbështetje ligjore, **nuk merret parasysh** nga grupi i auditimit.

**Titulli i gjetjes 1: Moszbatim i kërkesave ligjore mbi hapat e procedurës së prokurimit për blerjet me vlerë të vogël dhe dokumentimit të dosjeve të tyre**

**4. Situata: 1.** Nga auditimi mbi regjistrin e parashikimeve dhe atë të realizimit të prokurimeve për blerje me vlerë të vogël pasqyruar në tabela, u konstatua se: për mallra/grupmallra dhe shërbime/grupshërbime të njëjta, janë parashikuar me copëzim të fondit në 6 raste, prej të cilave në 3 raste me vlera në tejkallim të vlerës limit prej 1,000,000 lekë, respektivisht vlera totale të fondit limit pa tvsh prej 1,583,333 lekë, 1,989,165 lekë dhe 3,499,998 lekë. sipas tabelës se sipërcituar. Për sa më lart veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 56 pika 11 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Udhëzimi nr. 4 datë 18.06.2021 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, Udhëzimi nr.5 datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, Udhëzimi nr. 05, datë 29.07.2022 “Për disa ndryshime në manualin teknik që shoqëron Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike";

**5. 2.** Nga verifikimi i dosjeve të procedurave të prokurimit të pasqyruara në mënyrë të përmbledhur në tabelën përkatëse, rezulton se në 4 dosje procedurash nga 16 dosje gjithsej, ka mungesë të dokumentacionit apo mangësi në përmbajtje si: Ftesa për ofertë në të gjitha rastet nuk kishin të plotësuar tabelën tip me informacionin e nevojshëm financiar; testimi i tregut nuk është bërë në çdo rast dhe si rrjedhojë as procesverbali përmbledhës apo dhe vendimi mbi cmimin e mallit/shërbimit, në rastet kur është bërë nuk ka të regjistruar datën kur është dokumentuar testimi;

lista e OE që i janë përgjigjur ftesës apo klasifikimi përfundimtar i tyre, si dhe mungesë të dokumentacionit të OE fitues, në kundërshtim këto me ligjin nr. 162 datë 23.12.2020; VKM nr. 285 datë 19.05.2021 dhe paketa e Udhëzimeve të MFE - APP përkatësisht: nr. 05 datë 25.06.2021; nr. 05 datë 29.07.2022; nr. 04 datë 20.05.2022; nr. 03 datë 18.06.2021 etj;

**3.** Referuar regjistrin të parashikimeve, u konstatua se nuk jepet përshkrim i qartë mbi procedurën nëse përfshin përvec mallrave dhe shërbimin nga OE edhe magazinimin apo jo në ambientet e tij apo në ato të bashkisë, si në rastin e "Blerje medikamente dhe ushqim për qentë pa pronar" në kundërshtim me nenin 1 pika 2 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Udhëzimit nr. 04 datë 18.06.2021 Kreu I pika 1;

**Kriteri:** Ligji nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Udhëzimi nr. 4 datë 18.06.2021 "Për hartimin e regjistrin të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrin të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik", Udhëzimi nr. 5 datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", Udhëzimi nr. 05, datë 29.07.2022 "Për disa ndryshime në manualin teknik që shoqëron Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", Udhëzimit nr. 04 datë 20.05.2022, Udhëzimit nr. 1 dt 21.01.2022; Udhëzimit nr. 04 dt. 18.06.2021; Udhëzimit nr. 08.dt 01.09.2021 etj.

**Ndikimi/Efekti:** Ka cenuar eficientë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik për blerjet me vlerë të vogël.

**Shkaku:** Mosndjekja e gjithë hapave proceduralë të prokurimit për blerjet me vlerë të vogël, sjell mosnxitjen e pjesëmarrjes dhe konkurrencës mes OE në treg.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Drejtoria/ sektori i Prokurimit Publik dhe Komisioni i Blerjeve me vlerë të vogël si pjesë përbërëse e saj, të marrin masa për të zbatuar rigorozisht në çdo procedurë gjithë hapat përkatës sipas kërkesave që përcaktojnë aktet ligjore e nënligjore mbi procedurat e prokurimit publik në përgjithësi dhe ato për blerjet me vlerë të vogël në veçanti.

## Titulli i gjetjes 2: Mos zbatim i kërkesave ligjore mbi marrjen në dorëzim të mallrave e shërbimeve

**Situata:** Nga verifikimi i dosjeve të procedurave të prokurimit të pasqyruara në mënyrë të përmbledhur në tabelën përkatëse, rezulton se në 2 raste (dosje) procedurash nga 16 dosje gjithsej, mungon Urdhri i titullarit për ngritjen e komisioni të marrjes në dorëzim të mallit apo shërbimit, dhe si rrjedhojë dhe ngritja fizike e komisionit dhe e procesverbalit të hartuar prej tij mbi përputhshmërinë e karakteristikave të mallit apo shërbimit të dorëzuar nga OE me ato të kërkesave të prokurimit, në kundërshtim me pikat 42,43 (për NA), 52,53,54 (për NZ) të Udhëzimit nr. 30/2011 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik".

*(Për më shumë informacion në Akt Konstatimin nr. 10 datë 13.11.2023)*

**Kriteri:** Moszbatim i pikave 42, 43 për NA dhe pikave 52, 53, 54 për NZ të UMF 30 datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik".

**Ndikimi/Efekti:** Sjell rritjen e nivelit e riskut të keqpërdorimit kundrejt humbjeve apo abuzimeve të mundshme, për mallrat apo shërbimet e blera me fondet publike.

**Shkaku:** Mos ngritja e komisioneve për marrjen e mallrave në dorëzim.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandim:** Titullari i njësisë vendore në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues apo personi i autorizuar prej tij, të miratojë për cdo rast urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave apo shërbimeve për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

(Më Hollsisht trajtuar në Akt Konstatimin nr. 10 dhe 15 datë 13.11.2023)

#### 4.4 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.

Të dhëna për investimet e marra në dorëzim për periudhën 01.01.2022 deri me 31.12.2022 (si investimet e filluara dhe të kryera gjatë 2020, ashtu edhe ato të filluara në vitin 2021, por të përfunduara në vitin 2022.

Nga grupi i auditimit, në bazë të riskut, u përzgjedhën për tu audituar 3 kontrata të punëve publike për tu audituar në vlerën **58,595,150 lekë me TVSH** nga 10 kontrata të punëve publike gjithësej me vlerë **89,595,150 lekë me TVSH**, mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit në investimet publike, përputhshmërinë me projektet e zbatimit, kushteve teknike të zbatimit, kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratës, kolaudimi, zbatimi i afateve të kontratave si dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera.

Nr	Emërtimi I investimit të kryer	Vlera e investimit me TVSH sipas kontratës	Operatori Ekonomik	Data e fillimit të punimeve	Afati I punimeve sipas kontratës	Data e marrjes në dorëzim të investimit
1	Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara	15,760,244.8	B.N SHPK	5/11/2021	3 muaj	27/04/2022
2	Rikonstruksion i fushës së minikalçetos dhe rrethimi me kangjella i murit verior i kompleksit sportiv Shefqet Lamcja	8,400,000	“B ” sh.p.k	16/11/2021	2 muaj	18/02/2022
3	Mirembajtje dhe riparime te kanalit ujtes Karakullak	1,281,885	S shpk	16/03/2022	30 dite	15/04/2022
4	Rikonstruksion në objektet arsimore	16,800,000	B .sh.p.k	31/10/2022	50 dite	30/12/2022
5	F.v vendosje barriera rrugore mbrojtese	2,860,590	A shpk	22/02/2022	30 dite	06/05/2022
6	Ndërtim Lere uji	1,127,880	S 2016	30/03/2021	1 muaj	12/09/2022
7	Mirembajtje,riparime te kanaleve ujites Ku balez e poshtme	1,291,142	S shpk	22/02/2022	1 muaj	12/06/2022
8	Mbrojtja e rruges se lagjes tanush nga perroi i gostimes ne fshatin fushbull	1,964,923	S.shpk	07/11/2022	30 dite	08/01/2023
9	Mbrojtja e lagjes se noneve nga gerryerja e perroit te gostimes. Fshati polis vale njesia administrative shushice	6,317,648.4	B shpk	31/10/2022	60 dite	04/01/2023
10	Rikonstruksion dhe nderhyrje ne linjen K.U.Z dhe ndertim i sheshit te parkimit te varrezave Publike	33,395,150	I shpk	04/07/2022	5 muaj	10/01/2023

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratave për punë publike për vitin 2022, u konstatua si vijon:

1. **Kontrata: Rikonstruksion i fushës së minikalçetos dhe rrethim me kangjella i murit verior të kompleksit sportiv “Shefqet Lamcja” me vlerë kontrate të fituar 8,400,000 lekë me tvsh.**

##### A. Të dhëna mbi objektin

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion i fushës së minikalçetos dhe rrethim me kangjella i murit verior të kompleksit sportiv “Shefqet Lamcja”		
14.Lidhja e kontratës nr. 5269/6 prot., datë 13.12.2021	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 8,400,000 lekë me tvsh OE fitues “B ” sh.p.k.	16.Likuiduar deri dt 21.09.2022 USH. Nr.863 me vlerë 980,000 lekë me t.v.sh.
17- Situacioni Përfundimtar	18.Afati i kontratës në dite (60 ditë)	19. Zgjatja e kontratës



-Vlera me tvsh 8,400,000 lekë me tvsh	Përfundimi punimeve: 16.02.2022			
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> Shoqëria “M”	Licenca Nr: MK 1503/5	Kontrata me nr.4505/14 prot., datë 13.12.2021		
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> “A.Sh Engineering” sh.p.k.	Licenca Nr: MK 2463/6	Kontrata me nr.5269/10 prot., datë 16.02.2022		
<b>22.Akt Kolaudimi</b> datë 18/02/2022	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim</b> datë 21/02/2022			

### Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës sipërmarrjes me nr. 5269/6 prot., datë 13.12.2021 lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan, të përfaqësuar nga zv.Kryetari z.I.S dhe Kontraktorit OE “B” sh.p.k. përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor, me NIPT J.....G, liçencë në zbatim NZ.0416/14. Vlera e kontratës është 8,400,000 lekë me tvsh.

Afati i zbatimit të kësaj kontrate është 2 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata mbikëqyrjes me nr 4505/14 prot., datë 13.12.2021, midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan, të përfaqësuar nga zv.Kryetari z.I.S dhe Mbikëqyrësit Shoqëria “M”, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1503/5, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 112,939.2 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr 5269/10 prot., datë 16.02.2022, midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan, të përfaqësuar nga zv.Kryetare znj. A.B dhe OE “A ”, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2463/6, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 17,300 lekë me tvsh.

### Projekti dhe leja e ndërtimit

Projekti është hartuar nga Drejtorja e Planifikimit Territorit dhe Projektimit, përgjegjës ark. M.A dhe Drejtor ark. A.C. Miratuar nga Kryetari i Bashkisë z. G.LL.

Bashkia Elbasan me anë të vendimit nr. 2210/1, datë 09.12.2021 për miratimin e deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve, për objektin “Rikonstruksion i fushës së minikalçetos dhe rrethim verior i kompleksit sportiv “Shefqet Lamçja””.

### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, proces verbali i fillimit të punimeve dhe akt piketimi, si dhe sipas njoftimeve përkatëse të Mbikëqyrësit të punimeve dhe Sipërmarrësit është bërë në datën 16.12.2021.

Punimet kanë përfunduar me datë 16.02.2022, dy muaj pas fillimit të punimeve, në kundërshtim me nenin nr.5 të KVK të kontratës nr. 5269/6 prot., datë 13.12.2021, ku citohet: “...**Afati i realizimit të punimeve është 2 muaj nga data e lidhjes së kontratës, kjo sipas afatit të përcaktuar në dokumentet e tenderit...**”, data e lidhjes së kontratës është 13.12.2021 dhe afati i përfundimit është deri më 13.02.2022.

Kontraktori i punimeve, me shkresën datë 07.02.2022, ka dërguar kërkesën për përdorimin e fondit rezervë, drejtuar Mbikëqyrësit të punimeve, duke dorëzuar dhe tabelën krahasuese për çdo zë preventivi. Mbikëqyrësi i punimeve ka dorëzuar kërkesën Bashkisë Elbasan me shkresën datë 08.02.2022 duke kërkuar miratimin e këtyre volumeve brenda vlerës së kontratës duke përfshirë fondin rezervë.

Autoriteti Kontraktor përfaqësuar nga zv. Kryetari znj. A.B, me Urdhrin nr.298 datë 21.2.2022 ka miratuar përdorim e fondit rezervë me vlerë 203,883 lekë pa tvsh.

Situacioni fondit rezervë me vlerë 203,883 lekë pa tvsh, dhe situacioni përfundimtar përfshirë fondin rezervë është 7,000,000 lekë pa tvsh, miratuar nga Kontraktori i punimeve përfaqësuar nga

inxh. B. U., Mbikëqyrësi i punimeve përfaqësuar nga inxh. Gj.D dhe Autoriteti Kontraktor përfaqësuar nga Zyra e Investimeve inxh. E.H dhe inxh G.P si dhe zv. Kryetare znj. A.B. Njoftimi i përfundimit të punimeve i kontraktorit të punimeve dhe mbikëqyrësit të punimeve, dhe proces verbali i përfundimit të punimeve është mbajtur më datë 16.02.2022. Akt Kolaudimi është mbajtur më datë 18.02.2022, midis Kontraktorit të punimeve të përfaqësuar nga inxh. B.U, Mbikëqyrësi i punimeve përfaqësuar nga inxh. Gj.D dhe Kolaudatori i punimeve inxh. A.Sh, verifikon se objekti është realizuar sipas kontratës dhe ndryshimeve të miratuara dhe është i gatshëm për shfrytëzim. Akti i marrjes në dorëzim i objektit është mbajtur më datë 21.02.2022, nga Kontraktori i punimeve përfaqësuar nga inxh. B.U, Mbikëqyrësi i punimeve përfaqësuar nga inxh. Gj. D, Kolaudatori i punimeve inxh. A.Sh dhe Autoriteti Kontraktor përfaqësuar nga Zyra e Investimeve inxh. E.H dhe inxh G.P si dhe zv. Kryetare znj. A.B.

**Titulli i gjetjes:** *Pagesa e faturave me vonesë, përtej afateve të përcaktuara në kontratë.*

**Situata:** Nga auditimi dokumentacionit mbi pagesën e faturave u konstatua se kontraktori i punimeve ka dorëzuar faturën nr.4/2022 datë 04.02.2022 me vlerë 6,211,123 lekë me tvsh, nga të cilat garanci punimesh mbahet 420,000 lekë me tvsh dhe totali për tu paguar nga AK kundrejt kontraktorit të punimeve është vlera 5,791,123 lekë me tvsh. Pagesa e kontraktorit është likuiduar me Urdhër Shpenzimin nr. 863 datë 21.09.2022, pagesa është likuiduar e copëzuar me vlerë 980,000 lekë me tvsh. Veprime në kundërshtim me nenin nr.15 të KVK të kontratës nr. 5269/6 prot., datë 13.12.2021, ku citohet: "...Pagesa për punët duhet bërë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data që kontraktori paraqet një dokument (situacionin) që deklaron se objektivi për pagesën është arritur, subjekt ky i konfirmimit të dokumentit nga mbikëqyrësi i punimeve ...", pagesa është kryer rreth 7 muaj pas marrjes në dorëzim të objektit.

**Kriteri:** Kontrata me nr. 5269/6 prot., datë 13.12.2021 midis Bashkisë Elbasan dhe OE "B" sh.p.k.

**Ndikimi:** Mundësi për pagesë fature me kamate në raste se do kërkohej nga OE.

**Shkaku:** Vonesa në pagesën e faturave duke tejkaluar afatet nga Bashkia Elbasan.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, në Bashkinë Elbasan të marrë masat për likuidimin e detyrimeve financiare, sipas afateve të përcaktuara në kontrata.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Drejtoria e buxhetit dhe financës, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë znj.A.M.*

**Titulli i gjetjes:** *Dosjet e zbatimit nuk janë të inventarizuara dhe të numëruara.*

**Situata:** Nga auditimi i dosjes fizike të zbatimit u konstatua se dosja nuk janë të numëruara, të inventarizuara dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit në përfundimit të procesit, veprime në kundërshtim nenin 36, Kreun V, ligji nr.9154 datë 06.11.2003 "Për arkivat" si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, ku citohet: "...1. Dokumentet e numëruara, pavarësisht nga forma e regjistrimit dhe e qarkullimit, kanë vlerë administrative e juridike vetëm nëse janë hartuar e janë ruajtur sipas standardeve të miratuara...".

**Kriteri:** Ligji nr.9154 datë 06.11.2003 "Për arkivat".

**Ndikimi:** Evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi.

**Shkaku:** Mos inventarizimi dhe arkivimi i dosjeve të prokurimeve publike.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** Sektori i Investimeve në Bashkinë Elbasan me qëllim shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentit, të marrë masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, por edhe për të gjitha rastet

në vijim, në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Drejtoria e prokurimeve publike, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë z. O.K dhe Sektori i Investimeve në Drejtorinë e prokurimeve publike, në cilësinë e përgjegjësit të sektorit inxh. E.H.*

Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko ligjor të zbatimit të vënë në dispozicion nga ana e Bashkisë Elbasan dhe verifikimit në terren u konstatohet se janë realizuar punime në objekt të ndryshme nga përcaktimi i tyre në librezat e masave dhe në situacion, të cilat renditen si mëposhtë:

Tabela nr. 1

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
I.9	Rrethimi i fushës minifutbollit me rrjetë teli të plastifikuar jeshile	m2	1,500	630	630.2	630.6	-0.6	-900
I.11	Porta metalike dekorative (2.2x2.7)m hyrja në fushën e minifutbollit	m2	7,000	5.9	5.9	5.5	0.4	2,800
I.2	Cilindrim kasonete me rul	m2	50	323.2	302.12		21.08	1,054
I.3	Shtresë çakëlli mbeturine kave t=10cm, përhapur e ngjeshur makineri	m2	1,000	323.2	302.12		21.08	21,080
I.4	Shtresë stabilizanti t=5 cm	m2	400	323.2	302.12		21.08	8,432
I.5	Shtresë betoni e lëmuar me helikopter C16/20 t=10cm	m3	9,000	32.32	30.212		2.108	18,972
I.13	Trarë themeli monolit b/a C16/20 (trau lidhës)	m3	7,000	12.39	11,4		0.99	6,930
I.15	Shtresë zhavorr lumi t=10cm nën traun lidhës dhe nën plinta	m2	300	75	68.5		6.5	1,950
I.16	Shtresë betoni C12/15 t=10 cm nën traun lidhës dhe nën plinta	m3	6,000	7.5	6.85		0.65	3,900
	<b>Total</b>							<b>64,218</b>

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

**Titulli i gjetjes:** Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikonstrukcion i fushës së minikalçetos dhe rrethim me kangjella i murit verior të kompleksit sportiv “Shefqet Lamcja””.

**Situata:-**Nga auditimi i situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca si më poshtë:

- Zëri Rrethimi i fushës minifutbollit me rrjetë teli të plastifikuar jeshile dhe Porta metalike dekorative (2.2x2.7)m hyrja në fushën e minifutbollit. Vlera prej **1,900 lekë pa tvsh / 2,280 lekë me tvsh**, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
- Zëri Cilindrim kasonete me rul. Vlera prej **1,054 lekë pa tvsh / 1,265 lekë me tvsh** është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
- Zëri Shtresë çakëlli mbeturine kave t=10cm, përhapur e ngjeshur makineri. Vlera prej **21,080 lekë pa tvsh / 25,296 lekë me tvsh** është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
- Zëri Shtresë stabilizanti t=5 cm. Vlera prej **8,432 lekë pa tvsh / 10,118 lekë me tvsh** është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
- Zëri Shtresë betoni e lëmuar me helikopter C16/20 t=10cm. Vlera prej **18,972 lekë pa tvsh / 22,766 lekë me tvsh** është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

- Zëri Trarë themeli monolit b/a C16/20 (trau lidhës). Vlera prej **6,930 lekë pa tvsh / 8,316 lekë me tvsh** është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
- Zëri Shtresë zhavorr lumi t=10cm nën traun lidhës dhe nën plinta. Vlera prej **1,950 lekë pa tvsh / 2,340 lekë me tvsh** është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
- Zëri Shtresë betoni C12/15 t=10 cm nën traun lidhës dhe nën plinta. Vlera prej **3,900 lekë pa tvsh / 4,680 lekë me tvsh** është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Kriteri:**-Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, Neni 7.

Ligjin nr. 120/2020 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për - Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar.

Kontrata sipërmarrjes nr. 5269/6 prot., datë 13.12.2021.

Kontrata e Mbikëqyrjes me nr. 4505/14 prot., datë 13.12.2021.

Librezat e masave, situacioni përfundimtar.

**Ndikimi:**-Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik me vlerë prej **76,062 lekë me tvsh** në fondet e buxhetit të shtetit.

**Shkaku:**-Mungesë e kontrollit të punimeve nga ana e Mbikëqyrësit të punimeve.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Bashkia Elbasan të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **76,062 lekë me tvsh** nga OE “B ” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës me nr. 5269/6 prot., datë 13.12.2021, me objekt “Rikonstruksion i fushës së minikalçetos dhe rrethim me kangjella i murit verior të kompleksit sportiv “Shefqet Lamcja””, vlerë kjo që përbën dëm ekonomik ndaj fondeve të buxhetit të shtetit.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi mbikëqyrësit të punimeve.*

## **2. Kontrata: Rikonstruksioni dhe ndërhyrje në linjën KUZ dhe ndërtimi i sheshit të parkimit të varrezat publike, me vlerë kontrate të fituar 33,395,150 lekë me tvsh.**

### B. Të dhëna mbi objektin

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksioni dhe ndërhyrje në linjën KUZ dhe ndërtimi i sheshit të parkimit të varrezat publike”		
<b>14.Lidhja e kontratës</b> nr. 5457/6 prot., datë 07.03.2022	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 33,395,150 lekë me tvsh <b>OE fitues “I ” sh.p.k.</b>	<b>16.Likuiduar deri dt 22.08.2023</b> USH nr.716 me vlerë 4,702,040 lekë me t.v.sh.
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> -Vlera me tvsh 33,395,004 lekë me tvsh	<b>18.Afati i kontratës në dite (153 ditë)</b> Përfundimi punimeve: 03.12.2022	<b>19. Zgjatja e kontratës</b>
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> Shoqëria “T”	Licenca Nr: MK 1431/15 Kontrata me nr.5944/18 prot., datë 07.03.2022	
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> Inxh. H.Xh	Licenca Nr: MK 1254/4 Kontrata me nr.5957/12 prot., datë 30.12.2022	
<b>22.Akt Kolaudimi</b> datë 10/01/2023	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim</b> datë 13/01/2023	

### Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës sipërmarrjes me nr. 5457/6 prot., datë 07.03.2022 lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan, të përfaqësuar nga zv.Kryetare znj.A.B dhe Kontraktorit OE “I ” sh.p.k. përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor, me NIPT J.....L, liçencë në zbatim NZ.0754/22. Vlera e kontratës është 33,395,150 lekë me tvsh.

Afati i zbatimit të kësaj kontrate është 5 muaj nga data e lidhjes së kontratës (ose zbardhjes së lejes, në rast se leja nuk është zbardhur deri në nënshkrimin e kontratës).

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata mbikëqyrjes me nr. 5944/18 prot., datë 07.03.2022, midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan, të përfaqësuar nga zv.Kryetare

znj.A.B dhe Mbikëqyrësit Shoqëria “T”, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1431/15, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 655,813.2 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr 5957/12 prot., datë 30.12.2022, midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan, të përfaqësuar nga zv.Kryetare znj. A.B dhe inxh. “A.Sh. H.XH, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1254/4, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 67,800 lekë me tvsh.

#### Projekti dhe leja e ndërtimit

Projekti është hartuar nga projektues inxh. A.B, Drejtorja e Planifikimit Territorit dhe Projektimit, përgjegjës ark. M.A dhe Drejtor ark. A.C . Miratuar nga Kryetari i Bashkisë z. G.LL.

Leja infrastrukurore me Vendim nr. 2239/4, datë 10.03.2022 të Këshillit Bashkiak, dhe Leja e ndërtimit nr. 2239/5, datë 10.03.2022.

#### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, proces verbali i fillimit të punimeve dhe akt piketimi, si dhe sipas njoftimeve përkatëse të Mbikëqyrësit të punimeve dhe Sipërmarrësit është bërë në datën 04.07.2022.

Punimet kanë filluar me datë 04.07.2022, rreth 3,5 muaj pas lejes së ndërtimit, në kundërshtim me *nenin nr.5 të KVK të kontratës nr. 5457/6 prot., datë 07.03.2022, ku citohet: “...Afatit për realizimin e punimeve është 5 (pesë) muaj nga data e lidhjes së kontratës, kjo sipas afatit të përcaktuar në dokumentet e tenderit...Nëse deri në datën e nënshkrimit të kontratës nuk është zbardhur ende leja e ndërtimit, atëherë afati prej 5 muajsh për realizimin e punimeve do të fillojë nga data e zbardhjes së lejes së ndërtimit.”*, data e lejes së ndërtimit është 10.03.2022, njoftimi i fillimit të punimeve është 04.07.2022 dhe përfundimi i punimeve është më datë 03.12.2022.

Mungon pezullimi i punimeve nga data e nxjerrjes së lejes së ndërtimit deri në datën e fillimit të punimeve.

Autoriteti Kontraktor përfaqësuar nga zv. Kryetari znj. A.B, me shkresën nr. 3123/2 prot., datë 07.07.2022, ka dorëzuar Sektorit të Investimeve Publike dhe Mbikëqyrësit të punimeve projektin e rishikuar të aprovuar, hartuar nga inxh. DH.P , mbikëqyrësi përfaqësuar nga inxh. I.K dhe Kontraktori i punimeve F.M. Preventivi i Ripunuar i miratuar nga Kontraktori përfaqësuar nga F.M dhe mbikëqyrësi përfaqësuar nga I.K ka vlerë 33,395,004 lekë me tvsh.

**Titulli i gjetjes:** *Pasaktësi në hartimin e zërave të preventivit.*

**Situata:** Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit u konstatua se Drejtorja e Projektimit dhe Azhornimit Topografik, grupi i projektimit gjatë hartimit të preventivit të punimeve ka përfshirë zërin spërkatje me bitum në shtresën e stabilizant, e cilat është përfshirë respektivisht në analizat e çmimeve të shtresave asfaltike, veprime në kundërshtim me VKM nr.629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” analizat e zërave 3.222/2 dhe 3.226/1.

**Kriteri:** VKM nr.629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

**Ndikimi:** Pagesë e zërave të punimeve dy herë ndaj Kontraktorit gjatë zbatimit.

**Shkaku** Mungesa e analizave të hollësishme gjatë hartimit të projekt preventivit, referuar manualit të çmimeve në fuqi.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Drejtorja e Projektimit dhe Azhornimit Topografik, në Bashkinë Elbasan të marrë masat që në hartimin e projekt preventiva në projektet që do të projektohen nga kjo Drejtori, për çdo zë pune të paraqesë sipas analizave të manualeve të çmimeve në fuqi, me qëllim evitimin e llogaritjes në preventiv dy herë të të njëjtit zë pune.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Drejtoria e Projektimit dhe Azhurnimit Topografik, në cilësinë Drejtore ark. A.C. në cilësinë e përgjegjësit të sektorit ark. M.A dhe në cilësinë e projektuesit inxh. A.B .*

**Titulli i gjetjes:** *Mangësi dhe parregullsi në lidhje me rishikimin e projektit.*

**Situata:** Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit u konstatuan mangësitë si më poshtë:

1- Projekti, preventivi i ripunuar dhe procesverbali mbi rakordimin e volumeve janë të pa firmosur dhe vulosur nga AK. Mungon një raport teknik paraprak për ndryshimet në projekt dhe një analizë kosto. Veprime në kundërshtim me nenin 14 të KVK të Kontratës nr. 5457/6 prot., datë 07.03.2022, ku citohet: “...Kontraktuesi nuk ka të drejtë të bëjë ndryshime në preventivin e paraqitur në tender të aprovuar për punimet, përveç atyre të autorizuara me shkrim nga AK, të cilat nuk rrisin vlerën e kontratës...” dhe në kundërshtim me Udhëzimin nr.2, datë 13.05.2005, Kreu I, pika 7, dhe 7.1.

Pika 7, ku citohet: “...Sipërmarrësi nuk mund të ndryshojë me nismën e vet, të subjektit projektues a mbikëqyrës, projektin dhe përshkrimet teknike të tij...” dhe pika 7.1 ku citohet: “...Sipërmarrësi është i detyruar të zbatojë çdo ndryshim të urdhëruar me shkrim nga investitori ose persona të autorizuar prej tij, që nuk ndryshon, në thelb, kushtet kryesore të projektit, të kontratës dhe nuk rrit vleftën e saj...”.

2- Gjatë ndryshimeve në projekt u konstatua se janë hequr në preventivin e ripunuar zërat për ndërtimin e dekantuesit të ujërave të zeza para derdhjes në përrua dhe pusit në sistemin e vaditjes për vaditjen e bimësisë së mbjellë rreth zonës së parkimit.

Në lidhje me ndërtimin e dekantuesit nuk ekziston asnjë korrespondencë ose relacion e Kontraktorit dhe Mbikëqyrësit të punimeve me AK, mbi mos realizimin e tij, ndërtimi i të cilit ka rëndësi mbi ndikimin dhe ndotjen e mjedisit.

Në lidhje me zërin Shpim pusi 20 m, për sistemin e vaditjes, më datë 02.09.2022 është mbajtur midis Mbikëqyrësit dhe Kontraktorit të punimeve procesverbali mbi zërin Shpim pusi 20 m komplet + aksesore me vlerë 68,000 lekë me pretendimin se nga verifikimet me banorët e zonës në terren pusët e hapura në këtë zonë duhet të jenë jo më pak se 40 m, ky proces verbal i miratuar nga Kontraktori dhe Mbikëqyrësi i punimeve, mungon miratimi nga AK. Duke mos realizuar këtë zë pune sistemi i vaditjes është jo funksional duke sjellë dhe tharjen e bimësisë së mbjellë.

Veprime në kundërshtim me nenin 14 të KVK të Kontratës nr. 5457/6 prot., datë 07.03.2022, ku citohet: “...Kontraktuesi nuk ka të drejtë të bëjë ndryshime në preventivin e paraqitur në tender të aprovuar për punimet, përveç atyre të autorizuara me shkrim nga AK, të cilat nuk rrisin vlerën e kontratës...” dhe në kundërshtim me Udhëzimin nr.2, datë 13.05.2005, Kreu I, pika 7, dhe 7.1.

Pika 7, ku citohet: “...Sipërmarrësi nuk mund të ndryshojë me nismën e vet, të subjektit projektues a mbikëqyrës, projektin dhe përshkrimet teknike të tij...” dhe pika 7.1 ku citohet: “...Sipërmarrësi është i detyruar të zbatojë çdo ndryshim të urdhëruar me shkrim nga investitori ose persona të autorizuar prej tij, që nuk ndryshon, në thelb, kushtet kryesore të projektit, të kontratës dhe nuk rrit vleftën e saj...”.

Veprime në kundërshtim me nenin 17 të ligjit nr. 10 431 datë 09.06.2011, Për mbrojtjen e mjedisit, ku citohet: “...1. Mbrojtja e ujërave përfshin masat për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësore, nëntokësore, në tranzicion, të ujërave bregdetare dhe të detit, në tërësi, me qëllim shmangien apo pakësimin e efekteve të dëmshme mbi ekosistemet ujore, mjedisin në tërësi, shëndetin e njeriut dhe cilësinë e jetës. 2. Masat përkatëse për zbatimin e mbrojtjes së ujërave, sipas kategorive të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, përcaktohen në këtë ligj dhe në legjislacionin e posaçëm...”.

**Kriteri:** Ligji nr. 10 431 datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”.

Udhëzimi nr.2, datë 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I, pika 7, dhe 7.1. Kontrata nr. 5457/6 prot., datë 07.03.2022.

**Ndikimi:** Kryerje e punimeve të paaprovuara nga Autoriteti Kontraktor.

Ndotje e mjedisit gjatë derdhjes së ujërave të zeza në përrua, duke sjellë përhapjen e sëmundjeve të ndryshme në komunitet.

**Shkaku** Mungesa e aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.

Mosrealizimi i dekantuesit para derdhjes së ujërave në përrua.

**Rëndësia:** E lartë

**1. Rekomandimi:** Bashkinë Elbasan të marrë masat që të gjitha ndryshimet e realizuara të projekt të aprovohen nga AK, me qëllim që të shprehin dakordësinë dhe aprovimin zyrtar në rolin e Investitorit të punimeve, për çdo ndryshim të kërkuar nga Sipërmarrësi i punimeve dhe më pas certifikimin e këtyre punimeve të miratuara.

**2. Rekomandimi:** Bashkia Elbasan të marrë masa për parashikimin e një investimi në të ardhmen për ndërtimin e dekantuesit, me qëllim evitimin e ndotjeve të mjedisit dhe marrjen e aprovimeve përkatëse.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Bashkia Elbasan, në cilësinë e përfaqësuesit me autorizim zv. Kryetare znj. A.B, Drejtorja e prokurimeve publike, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë z. O.K dhe Sektori i Investimeve në Drejtorinë e prokurimeve publike, në cilësinë e përgjegjësit të sektorit inxh. E.H .*

**Titulli i gjetjes:** Mungesat e dokumenteve kryesorë teknik të zbatimit të punimeve të ndërtimit.

**Situata:** Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit u konstatua mungesa e dokumenteve kryesorë teknik të zbatimit të punimeve të ndërtimit që vërteton kontrollin e cilësisë së punimeve, si certifikatat e cilësisë së materialeve të ndërtimit dhe testet laboratorike, mix design për betonet, veprime në kundërshtim me Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” kreu III, Dokumentacioni Teknik i Punimeve të Ndërtimit ku citohet: “...9.Në kantierin e punimeve krijohet e plotësohet gradualisht dosja teknike e objektit, ku sipas problematikës, mbahen: dh) Certifikatat e cilësisë të materialeve e të produkteve, testimet dhe rezultatet e tyre...”.

**Kriteri:** Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” kreu III.

**Ndikimi:** Mungesa e verifikimit të cilësisë të materialeve e të produkteve.

**Shkaku** Mungesa e dokumentacionit që verifikon kryerjen e punimeve cilësorë dhe sipas specifikimeve të projektit.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** Mbikëqyrësi i punimeve dhe Sektori i Investimeve në Bashkinë Elbasan të marrin masat për administrimin e dokumentacionit të nevojshëm teknik, me qëllim verifikimin e cilësinë e materialeve e të produkteve të përdorura.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Mbikëqyrësi i punimeve në cilësinë e përfaqësuesit inxh. I. K.*

Situacioni përfundimtar përfshirë fondin rezervë është 33,395,004 lekë me tvsh, miratuar nga Kontraktori i punimeve përfaqësuar nga inxh. F.M , Mbikëqyrësi i punimeve përfaqësuar nga inxh. I.K dhe Autoriteti Kontraktor përfaqësuar nga Zyra e Investimeve inxh. E.H dhe inxh G.P si dhe zv. Kryetare znj. A.B.

Njoftimi i përfundimit të punimeve i kontraktorit të punimeve dhe mbikëqyrësit të punimeve, dhe proces verbali i përfundimit të punimeve është mbajtur më datë 03.12.2022.

Akt Kolaudimi është mbajtur më datë 10.01.2023, midis Kontraktorit të punimeve të përfaqësuar nga inxh. F.M , Mbikëqyrësi i punimeve përfaqësuar nga inxh. I.K dhe Kolaudatori i punimeve inxh. H.XH , verifikon se objekti është realizuar sipas projektit dhe fillon garancia e punimeve e cila është 12 muaj nga nënshkrimi i akt kolaudimit.

Akti i marrjes në dorëzim i objektit është mbajtur më datë 13.01.2023, nga inxh. F.M, Mbikëqyrësi i punimeve përfaqësuar nga inxh. I.K dhe Kolaudatori i punimeve inxh. H.XH dhe Autoriteti Kontraktor përfaqësuar nga Zyra e Investimeve inxh. E.H dhe inxh. G.P si dhe zv. Kryetare znj. A.B.

**Titulli i gjetjes:** *Pagesa e faturave me vonesë, përtej afateve të përcaktuara në kontratë.*

**Situata:** Nga auditimi dokumentacionit mbi pagesën e faturave u konstatua se kontraktori i punimeve ka dorëzuar faturën përfundimtare nr.24/2023 datë 29.04.2023 me vlerë 2,671,596 lekë me tvsh. Pagesa e kontraktorit nuk është likuiduar. Fatura e fundit e likuiduar me nr.178/2022 datë 15.08.2022 me vlerë 25,212,724 lekë me tvsh, është likuiduar nga AK në mënyrë pjesore me anë të USH nr. 795 datë 07.09.2022 vlera 15,000,000 lekë me tvsh, USH nr. 716 datë 22.08.2023 me vlerë 4,702,040 lekë me tvsh. Veprime në kundërshtim me nenin nr.15 të KVK të kontratës nr. 5457/6 prot., datë 07.03.2022, ku citohet: "...Pagesa për punët duhet bërë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data që kontraktori paraqet një dokument (situacionin) që deklaron se objektivi për pagesën është arritur, subjekt ky i konfirmimit të dokumentit nga mbikëqyrësi i punimeve ...", pagesa e mbetur e pa likuiduar është 8,182,426 lekë me tvsh.

**Kriteri:** Kontrata me nr. 5457/6 prot., datë 07.03.2022 midis Bashkisë Elbasan dhe OE "I" sh.p.k.

**Ndikimi:** Mundësi për pagesë fature me kamate në raste se do kërkohej nga OE.

**Shkaku** Vonesa në pagesën e faturave duke tejkaluar afatet nga Bashkia Elbasan.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, në Bashkinë Elbasan të marrë masat për likuidimin e detyrimeve financiare, sipas afateve të përcaktuara në kontrata.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Drejtoria e buxhetit dhe financës, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë znj.A.M.*

**Titulli i gjetjes:** *Dosjet e zbatimit nuk janë të inventarizuara dhe të numëruara.*

**Situata:** Nga auditimi i dosjes fizike të zbatimit u konstatua se dosjet nuk janë të numëruara, të inventarizuara dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit në përfundimit të procesit, veprime në kundërshtim nenin 36, Kreun V, ligji nr.9154 datë 06.11.2003 "Për arkivat" si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, ku citohet: "...1. Dokumentet e numëruara, pavarësisht nga forma e regjistrimit dhe e qarkullimit, kanë vlerë administrative e juridike vetëm nëse janë hartuar e janë ruajtur sipas standardeve të miratuara...".

**Kriteri:** Ligji nr.9154 datë 06.11.2003 "Për arkivat".

**Ndikimi:** Evidentimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi.

**Shkaku** Mos inventarizimi dhe arkivimi i dosjeve të prokurimeve publike.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** Sektori i Investimeve në Bashkinë Elbasan me qëllim shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentit, të marrë masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, por edhe për të gjitha rastet në vijim, në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Drejtoria e prokurimeve publike, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë z. O.K dhe Sektori i Investimeve në Drejtorinë e prokurimeve publike, në cilësinë e përgjegjësit të sektorit inxh. E.H .*



Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko ligjor të zbatimit të vënë në dispozicion nga ana e Bashkisë Elbasan dhe verifikimit në terren u konstatohet se janë realizuar punime në objekt të ndryshme nga përcaktimi i tyre në librezat e masave dhe në situacion, të cilat renditen si mëposhtë:

Tabela nr. 2

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
A.I.13	Mbushje me zhavorr e kanaleve	m3	500	4317	4333.5	4192	125	62,500
B.I.6	Puseta beton/arme shiu 40x60 cm h=100 cm + kapak gize	copë	19,000	5	5	0	5	95,000
B.II.2	Shtresë zhavorri nën kunetë	m3	1,400	3.8	3.8	3	0.8	1,120
B.II.3	Struktura monolite betoni/arme C16/20 kunetë betoni me gjerësi 40cm me trashësi 15 cm	m3	8,500	4.75	4.75	0	4.75	40,375
B.II.8	Shtresë stabilizanti t=10 cm +spërkatje me bitum 1kg/m2	m2	250	3,642	3,642.75	3,642	0	0
	Spërkatje me bitum 1kg/m2	m2	35			3,642	3,642	127,470
B.III.1	F.V. në tokë kabllo Al fuqie+1000V, me izolim gome 4x4mm2	ml	500	140	140	0	140	70,000
B.III.2	F.V. në tokë kabllo Al fuqie+1000V, me izolim gome 4x10mm2	ml	550	60	76	0	60	33,000
B.III.3	F.V. në tokë kabllo Al fuqie+1000V, me izolim gome 4x16mm2	ml	550	190	190	0	190	104,500
B.III.4	F.V. kabllo Cu pa armuar, në mure e konstruksioni metalik 4x1.5mm2	ml	400	60	54	0	60	24,000
B.III.6	F.V. pusëtë elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm	copë	250	6	6	0	6	1,500
B.III.8	F.V. përcjellës PV-500 Ø4 mm2, për togëzimin nga shtylla në shtyllë	ml	60	66	210	0	66	3,960
B.III.9	F.V. kuadër komandimi komplet me santeri + foto element	copë	50,000	1	1	0	1	50,000
B.III.10	Përcjellës togëzimi bakri Cu, S=35mm2 i zhveshur	m	340	6	6	0	6	2,040
B.III.12	F.V. Elektroda togëzimi të xinguar L=150cm	copë	1,200	6	6	0	6	7,200
B.III.13	F.V. Automat termo/el manj diferencial 220v, 10A	copë	1,000	6	6	0	6	6,000
B.III.15	F.V. tub betoni Ø200ml	ml	600	6	6	0	6	3,600
B.III.16	Mbushje me beton marka 150 për inkastrim shtyllash	m3	6,900	2	1.5	1.72	0.28	1,932
B.III.17	F.V. Tuba metalik D=140mm	ml	1,000	30	36	0	30	30,000
B.III.19	Ndërtim puseta betoni + kapak gize me përmasat 80cm x 80cm x h=100cm	copë	25,000	1	1	0	1	25,000
B.V.1	Gërmim dheu me krah për gropat tokë te zakonshme me përmasa 0.5x0.5x0.8x4copë	m3	600	0.8	0.8	0	0.8	480

B.V.2	Betonim për fiksimin e tabelave C6/10 (M-100)	m3	6,500	0.8	0.8	0	0.8	5,200
B.V.3	F.V. Tabela të sinjalistikës rrugore rrethor D=60	copë	5,000	2	2	0	2	10,000
B.V.4	F.V. Tabela katrore e vogël me diagonal vertikale 40x25	copë	4,000	2	2	0	2	8,000
B.V.5	Vijëzim i rrugës për këmbësorët me bojë bikomponente	m2	900	30	30	0	30	27,000
<b>Total</b>								<b>739,877</b>

**Titulli i gjetjes:** Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikonstruksioni dhe ndërhyrje në linjën KUZ dhe ndërtimi i sheshit të parkimit të varrezat publike”.

**Situata:** Nga auditimi i situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca si mëposhtë:

- Zëri Mbushje me zhavorr e kanaleve. Vlera prej **62,500 lekë pa tvsh / 75,000 lekë me tvsh**, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
- Zëri Puseta beton/arme shiu 40x60 cm h=100 cm + kapak gize. Vlera prej **95,000 lekë pa tvsh / 114,000 lekë me tvsh** është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
- Zëri Shtresë zhavorri nën kunetë. Vlera prej **1,120 lekë pa tvsh / 1,344 lekë me tvsh** është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
- Zëri Struktura monolite betoni/arme C16/20 kunetë betoni me gjerësi 40cm me trashësi 15 cm. Vlera prej **40,375 lekë pa tvsh / 48,450 lekë me tvsh** është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
- Spërkatje me bitum 1kg/m<sup>2</sup> në stabilizant. Vlera prej **127,470 lekë pa tvsh / 152,964 lekë me tvsh** është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
- Zërat e punimeve elektrike. Vlera prej **362,732 lekë pa tvsh / 435,278 lekë me tvsh** është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
- Zërat e punimeve të sinjalistikës vertikale. Vlera prej **23,680 lekë pa tvsh / 28,416 lekë me tvsh** është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
- Zëri Vijëzim i rrugës për këmbësorët me bojë bikomponente. Vlera prej **27,000 lekë pa tvsh / 32,400 lekë me tvsh** është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Kriteri:** Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, Neni 7.

Ligjin nr. 120/2020 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për - Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

Kontrata sipërmarrjes nr. 5457/6 prot., datë 07.03.2022.

Kontrata e Mbikëqyrjes me nr. 5944/18 prot., datë 07.03.2022.

Librezat e masave, situacioni përfundimtar.

**Ndikimi:** Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik me vlerë prej **887,852 lekë me tvsh** në fondet e buxhetit të shtetit.

**Shkaku** Mungesë e kontrollit të punimeve nga ana e Mbikëqyrësit të punimeve.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Bashkia Elbasan të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **877,852 lekë me tvsh** nga OE “I” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës me nr. 5457/6 prot., datë 07.03.2022, me objekt “Rikonstruksioni dhe ndërhyrje në linjën KUZ dhe ndërtimi i sheshit të parkimit të varrezat publike”, vlerë kjo që përbën dëm ekonomik ndaj fondeve të buxhetit të shtetit.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi mbikëqyrësit të punimeve.*

Mbi sa trajtuar më sipër, grupi i auditimit ka mbajtur Akt konstatimin nr. 4, datë 13.11.2023.

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Bashkia Elbasan, ka paraqitur observacionin nr. 4474/45 prot., datë 22.11.2023, protokolluar KLSH nr.767/4 prot., datë 30.11.2023, pretendojnë, si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

I. Zbatimi i punimeve në këtë objekt ka pasur vonesa në fillimin e punimeve sepse njëkohësisht kanë qenë se linja e KUZ intersektonte me objektin “Ndërtimi i mbikalimit hekurudhor në kryqëzimin e rrugës nacionale Elbasan – Librazhd, në rrugën “Borodin Mitarja””, investim i Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Në shkresat e dërguar nga kontraktori i punimeve të mbikalimit “V” shpk, është kërkuar që punimet e KUZ-së të bashkërendonin me punimet e kanalit të ujërave të zeza, si kalimi i linjës në Unazën rrugore lindore të qytetit, miratimi dhe leja për të cilën jepej nga Autoriteti Rrugor Shqiptar. Një tjetër arsye për mos fillimin e punimeve sipas kontratës mungesa e tubave 1700 mm në treg. Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve është kërkuar zëvendësimi i tyre me box keson 150x150. Miratimi i kësaj kërkesë nga Sektori i Projekteve në Drejtorinë e Projektimit dhe Azhornimit.

II. Në lidhje me konstatimin tuaj se grupi i projektimit gjatë hartimit të preventivit të punimeve ka përfshirë përkatësisht në zërin shtrese stabilizanti  $t = 10 \text{ cm} + \text{spërkatje me bitum } 1 \text{ kg/ m}^2$  ,ju bëjmë me dije se: Ky zë punimesh është vendosur në preventivin e projektit me çmimin e manualit sipas analizës nr.3.212/b, me emërtimin "Shtrese stabilizant  $t=10\text{cm}$ ", me vlere 449 leke/m<sup>2</sup>. Por për një trajtim të sipërfaqes para shtresës me binder është parashikuar që me të njëjtën vlerë të jetë edhe spërkatja me bitum 1 kg/m<sup>2</sup>, kurse shtresa e binderit sipas manualit nr. 3.222\2 ka spërkatjen me bitum 0.5 kg\ m<sup>2</sup> para hedhjes së shtresës së binderit.

Për sa më sipër për këtë zë nuk kemi rritje të cmimit për m<sup>2</sup> duke shtuar vlerën e kontratës, por kërkohet vetëm rritja e cilësisë për shtresat që do të sistemohen nuk kemi shtuar vlerë të pagesës për këtë shtresë.

III. Në lidhje me konstatimin nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit;

1-Projekt-preventivi i ripunuar dhe procesverbali mbi rakordimin e volumeve janë të pavulusor nga AK. Mungon një raport teknik paraprak për ndryshimet në projekt dhe një analizë kosto.

Për sa më sipër ju bëjmë me dije:

Në raport me ndryshimet në projekt, zëvendësimi i zërit tubave 1700 mm me box keson 150x150 është bërë me propozimin e mbikëqyrësit të punimeve, të arsyetuara nga ana e tij dhe me miratimin e autoritetit kontraktor, përkatësisht me shkresën Nr.3123/2 Prot, datë 07/07/2022 nga Sektori i Projekteve në Drejtorinë e Projektimit dhe Azhornimit Topografi i Bashkisë Elbasan.

Këto ndryshime nuk sjellin kosto shtesë në realizimin kontratës dhe nuk sjellin zëra të rinj punimesh që nuk janë të ofertuar në preventivin. Si rrjedhojë preventivi i ripunuar, që në strukturë të tij nuk ka zëra të rinj punimesh, të pa ofertuar, por që ka marrë miratimin nga hartuesit e projektit, nuk është pasqyruar në një preventiv të ripunuar të vulosur dhe firmosur nga AK.

Në lidhje me mungesën e pusit dhe dekantuesit, megjithëse nga konsultimet teknike verbale që kemi pasur me mbikëqyrësin e punimeve dhe kontraktuesin ku kanë parashtruar vështirësitë teknike për realizimin e pusit dhe të dekantuesit si: shpimi me shumë se 45m i pusit dhe mungesa e kuotës për shkarkimin e dekantuesit, pranë AK nuk është paraqitur asnjë kërkesë nga ana e mbikëqyrësit dhe zbatuesit të punimeve për mos realizimin e tyre dhe për rrjedhojë nuk ka patur aprovim nga AK.

Në bazë të udhëzimit Nr.2, datë 13.5.2005 “Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit”, mbikëqyrësi i objektit është përgjegjës për realizimin e të gjitha punimeve sipas projekt- preventivit të ofertuar. Detyra funksionale e Zyrës së Investimeve të Bashkisë Elbasan është kontrolli i dokumentacionit, përputhja e situacionit me faktin, funksionimi i objektit në tërësi etj.

Aprovimi ose mos aprovimi i kërkesave për ndryshimet e projektit nga mbikëqyrësi i punimeve, nuk është kompetencë e saj.

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

I. Pretendimet e subjektit mbi vonesa në fillimin e punimeve në këtë objekt, grupi i auditimit në dosjen e audituar ka konstatuar se mungojnë korrespondencat midis AK, Mbikëqyrësit të punimeve dhe Kontraktorit të punimeve mbi pezullimin e punimeve referuar arsyeve të sipërcituara nga ana juaj në observacion. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

II. Pretendimet e subjektit se zëri shtrese stabilizanti t = 10 cm + spërkatje me bitum 1 kg/m<sup>2</sup>, është vendosur në preventivin e projektit me çmimin e manualit sipas analizës nr.3.212/b, me emërtimin "Shtrese stabilizant t=10cm", me vlerë 449 leke/m<sup>2</sup>, kërkohet vetëm rritja e cilësisë për shtresat që do të sistemohen nuk kemi shtuar vlerë të pagesës për këtë shtresë. Grupi i auditimit konstaton se vendosja e emërtimit të këtij zëri pune duhet përfshirë dhe spërkatja me bitum gjatë zbatimit me qëllim rritjen e cilësisë së shtresave është në kundërshtim me kushtet teknike të miratuar nga autoritetet respektive, të cilët kanë miratuar teknikisht që lidhja midis binderit dhe stabilizantit realizohet teknikisht me sasinë e spërkatjes me bitum 0,5 kg/m<sup>2</sup> referuar dhe analizave në manualet e çmimeve të miratuara. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

III. Pretendimet e subjektit se ndryshimet janë bërë me propozimin e mbikëqyrësit të punimeve i cili është përgjegjës për realizimin e të gjitha punimeve sipas projekt- preventivit të ofertuar nuk qëndron pasi krahas miratimit të Mbikëqyrësit është AK që miraton çdo ndryshim në projekt preventiv. Kontraktuesi nuk ka të drejtë të bëjë ndryshime në preventivin e paraqitur në tender të aprovuar për punimet, përveç atyre të autorizuara me shkrim nga Autoriteti Kontraktor, pra në çdo rast duhet aprovimi i AK, i cili në këtë objekt i ka pranuar ndryshimet e kryera nga kontraktori duke konfirmuar situacionin përfundimtar me ndryshime përkatëse, por nuk i ka miratuar paraprakisht.

**Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.**

### **3. Kontrata: Sistemim asfaltim i rrugëve "Grigor Nosi", "Xhaferr Duhaxhiu", "Hasan Kopili", në lagjen 5 Maji, me vlerë kontrate të fituar 52,362,845 lekë me tvsh.**

#### **C. Të dhëna mbi objektin**

<b>Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Sistemim asfaltim i rrugëve "Grigor Nosi", "Xhaferr Duhaxhiu", "Hasan Kopili", në lagjen 5 Maji"</b>		
<b>14.Lidhja e kontratës</b> nr. 1288/6 prot., datë 10.06.2022	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 52,362,845 lekë me tvsh <b>OE fitues "B.N" sh.p.k.</b>	<b>16.Likuiduar deri dt 22.08.2023</b> USH nr.717 me vlerë 10,048,098 lekë me t.v.sh.
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> -Vlera me tvsh 52,361,854 lekë me tvsh	<b>18.Afati i kontratës në dite (152 ditë)</b> Përfundimi punimeve: 25.04.2023	<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Amendimi i kontratës nr.1288/14 datë 18.04.2023 Afati i realizimit 25.04.2023
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> Shoqëria "D" shpk	Licenca Nr: MK 2010/5	Kontrata me nr.2018/6 prot., datë 10.06.2022
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> H.XH	Licenca Nr: MK 1254/4	Kontrata me nr.1288/14 prot., datë 23.05.2023
<b>22.Akt Kolaudimi</b> datë 26/05/2023	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim</b> datë 29/05/2023	

#### **Kontratat**

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës sipërmarrjes me nr. 1288/6 prot., datë 10.06.2022 lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan, të përfaqësuar nga zv.Kryetare znj. A.B dhe Kontraktorit OE "B.N" sh.p.k. përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor, me NIPT K.....0, liçencë në zbatim NZ.3625/21. Vlera e kontratës është 53,362,845 lekë me tvsh, vlera e financimit do të jetë për 3 vite dhe për vitin 2022 është 18,793,767 lekë me tvsh.

Afati i realizimit të punimeve është 3 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Titullari i AK, përfaqësuar me autorizim nga zv.Kryetare znj.A.B, me shkresën nr.1288/13 prot., datë 18.04.2023, ka urdhëruar miratimin e kërkesës për shtyrje afati të përfundimit të punimeve të objektit: “Sistemim asfaltim i rrugëve “Grigor Nosi”, “Xhaferr Duhaxhiu”, “Hasan Kopili”, në lagjen 5 Maji”.

Amendimi i kontratës së sipërmarrjes nr.1288/14 prot., datë 18.04.2023, është lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan, të përfaqësuar nga zv.Kryetare znj.A.B dhe Kontraktorit OE “B.N” sh.p.k., ku afati përfundimtar i realizimit të kontratës do të jetë data 25.04.2023.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata mbikëqyrjes me nr. 2018/6 prot., datë 10.06.2022, lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan, të përfaqësuar nga zv.Kryetare znj.A.B dhe Mbikëqyrësit Shoqëria “D” shpk, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2010/5, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 565,188 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr 1288/14 prot., datë 23.05.2023, midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan, të përfaqësuar nga zv.Kryetare znj. A.B dhe z. H.XH, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1254/4, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 76,200 lekë me tvsh.

#### Projekti dhe leja

Projekti është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projektimit, përgjegjës ark. M.A dhe Drejtor ark. A.C. Miratuar nga Kryetari i Bashkisë z. G.LL.

Leja infrastrukturore me Vendim nr. 2568/2, datë 13.06.2023 të Këshillit Bashkiak, për Rikonstruksionin e rrugëve ekzistuese “Grigor Nosi”, “Hasan Ali Kopili” dhe “Xhaferr Duhaxhiu”, me afat 3 muaj nga data e fillimit të punimeve.

#### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, proces verbali i fillimit të punimeve dhe akt piketimi, si dhe sipas njoftimeve përkatëse të Mbikëqyrësit të punimeve dhe Sipërmarrësit është bërë në datën 20.07.2022.

Mbikëqyrësi i punimeve dhe kontraktori i punimeve i kanë drejtuar AK Bashkisë Elbasan me shkresat e datës 10.10.2022, kërkesat për lirimin e sheshit ndërmjet progresiveve CS3 deri CS7, dorëzuar me anë të aplikimit nr. AL012008-993322-EL, datë 11.10.2022, duke kërkuar dhe pezullimin e punimeve deri në zgjidhjen e problematikës në procesverbalin e mbajtur nga Mbikëqyrësi i punimeve, Kontraktori i punimeve dhe inxhinierët e sektorit të Investimeve në Bashkinë Elbasan.

AK me shkresën nr.4699 prot., datë 07.10.2022, ka njoftuar pezullimin e punimeve në objektin “Sistemim asfaltim i rrugëve “Grigor Nosi”, “Xhaferr Duhaxhiu” dhe “Hasan Kopili” në lagjen 5 Maji”.

Referuar ditarit të punimeve punimet kanë filluar 20.07.2022 deri 10.10.2022, më datë 10.10.2022 janë pezulluar punimet dhe kanë filluar 18.04.2023 deri 25.04.2023. Punimet kanë filluar me datë 20.07.2022, rreth një muaj pas fillimit sipas kushteve të kontratës, dhe punimet janë pezulluar me datë 11.10.2022, në kundërshtim me *nenin nr.5 të KVK të kontratës nr. 1288/6 prot., datë 10.06.2022, ku citohet: “...Afati i realizimit të punimeve është 3 muaj nga data e lidhjes së kontratës, kjo sipas afatit të përcaktuar në dokumentet e tenderit...”*, data e lidhjes së kontratës është 10.06.2022 dhe afati i përfundimit është deri më 10.09.2022.

Më datë 18.04.2023, Mbikëqyrësi i punimeve ka dorëzuar njoftimin për rifillim punimesh pas lirim të sheshit të ndërtimit, si dhe njoftimin e Sipërmarrësit të punimeve për rifillim punimesh dhe procesverbalin e rifillimit të punimeve të mbajtur nga Mbikëqyrësi dhe Kontraktori i punimeve.

Mbikëqyrësi i punimeve me shkresën përcjellëse nr. Ex. prot., datë 12.04.2023, i ka dorëzuar AK kërkesën për përdorimin e fondit rezervë, preventivin, procesverbalin mbi përdorimin e fondit rezervë.

**Titulli i gjetjes:** *Pasaktësi në hartimin e zërave të preventivit.*

**Situata:** Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit u konstatua se Drejtoria e Projektimit dhe Azhornimit Topografik, grupi i projektimit gjatë hartimit të preventivit të punimeve ka përfshirë zërin spërkatje me bitum në shtresën e stabilizant dhe zërin e transportit të zërave të prishjes të shtresave të betonit, të cilat janë të përfshirë respektivisht në analizat e çmimeve të shtresave asfaltike dhe prishjet e shtresave betonit, veprime në kundërshtim me VKM nr.629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

**Kriteri:** VKM nr.629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”

**Ndikimi:** Pagesë e zërave të punimeve dy herë ndaj Kontraktorit gjatë zbatimit.

**Shkaku** Mungesa e analizave të hollësishme gjatë hartimit të projekt preventivit, referuar manualit të çmimeve në fuqi.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Drejtoria e Projektimit dhe Azhornimit Topografik, në Bashkinë Elbasan të marrë masat që në hartimin e projekt preventiva në projektet që do të projektohen nga kjo Drejtori, për çdo zë pune të paraqesë sipas analizave të manualeve të çmimeve në fuqi, me qëllim evitimin e llogaritjes në preventiv dy herë të të njëjtit zë pune.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Drejtoria e Projektimit dhe Azhornimit Topografik, në cilësinë Drejtore ark. A.C. në cilësinë e përgjegjësit të sektorit ark. M.A dhe në cilësinë e projektuesit inxh. A.B.*

**Titulli i gjetjes:** *Mungesat e dokumenteve kryesorë teknik të zbatimit të punimeve të ndërtimit.*

**Situata:** Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit u konstatua mungesa e dokumenteve kryesorë teknik të zbatimit të punimeve të ndërtimit që vërteton kontrollin e cilësisë së punimeve, si certifikatat e cilësisë së materialeve të ndërtimit dhe testet laboratorike, mix design për betonet, veprime në kundërshtim me Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” kreu III, Dokumentacioni Teknik i Punimeve të Ndërtimit ku citohet: “...9.Në kantierin e punimeve krijohet e plotësohet gradualisht dosja teknike e objektit, ku sipas problematikës, mbahen: dh) Certifikatat e cilësisë të materialeve e të produkteve, testimet dhe rezultatet e tyre...”.

**Kriteri:** Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” kreu III.

**Ndikimi:** Mungesa e verifikimit të cilësisë të materialeve e të produkteve.

**Shkaku** Mungesa e dokumentacionit që verifikon kryerjen e punimeve cilësorë dhe sipas specifikimeve të projektit.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** Mbikëqyrësi i punimeve dhe Sektori i Investimeve në Bashkinë Elbasan të marrin masat për administrimin e dokumentacionit të nevojshëm teknik, me qëllim verifikimin e cilësinë e materialeve e të produkteve të përdorura.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Mbikëqyrësi i punimeve në cilësinë e përfaqësuesit inxh. N.Xh.*

Autoriteti Kontraktor përfaqësuar nga zv. Kryetari znj. A.B, me Urdhrin nr. datë 19.04.2023, shkresa nr. 2597/1 prot., ka miratuar përdorim e fondit rezervë me vlerë 1,058,430 lekë pa tvsh. Preventivi i ripunuar me vlerë 52,361,854 lekë me tvsh, i miratuar nga Kontraktori dhe Mbikëqyrësi i punimeve.

Situacioni i fondit rezervë me vlerë 1,270,116 lekë me tvsh dhe situacioni përfundimtar përfshirë fondin rezervë është 52,361,854 lekë me tvsh, miratuar nga Kontraktori i punimeve përfaqësuar

nga inxh. U.S dhe z. A.P, Mbikëqyrësi i punimeve përfaqësuar nga inxh. N.XH dhe Autoriteti Kontraktor përfaqësuar nga Zyra e Investimeve inxh. E.H dhe inxh G.P si dhe zv. Kryetare znj. A.B.

Njoftimi i përfundimit të punimeve i kontraktorit të punimeve dhe mbikëqyrësit të punimeve, dhe procesi verbal i përfundimit të punimeve është mbajtur më datë 25.04.2023.

Akt Kolaudimi është mbajtur më datë 26.04.2023, midis Kontraktorit i punimeve të përfaqësuar nga inxh. U.S dhe z. A.P, Mbikëqyrësi i punimeve përfaqësuar nga inxh. N.XH dhe Kolaudatori i punimeve inxh. H.XH , verifikon se objekti është realizuar sipas projektit.

Akti i marrjes në dorëzim i objektit është mbajtur më datë 29.05.2023, nga Kontraktorit i punimeve të përfaqësuar nga inxh. U.S dhe z. A.P, Mbikëqyrësi i punimeve përfaqësuar nga inxh. N.XH dhe Kolaudatori i punimeve inxh. H.XH dhe Autoriteti Kontraktor përfaqësuar nga Zyra e Investimeve inxh. E.H dhe inxh G.P si dhe zv. Kryetare znj. A.B.

**Titulli i gjetjes:** *Pagesa e faturave me vonesë, përtej afateve të përcaktuara në kontratë.*

**Situata:** Nga auditimi dokumentacionit mbi pagesën e faturave u konstatua se kontraktori i punimeve ka dorëzuar faturën nr.339/2023 datë 20.04.2023 me vlerë 24,048,098 lekë me tvsh, nga të cilat garanci punimesh mbahet 2,404,810 lekë me tvsh dhe totali për tu paguar nga AK kundrejt kontraktorit të punimeve është vlera 21,643,288 lekë me tvsh. Pagesa e kontraktorit është likuiduar me Urdhër Shpenzimit nr. 717 datë 22.08.2023, pagesa është likuiduar e copëzuar me vlerë 10,048,098 lekë me tvsh. Veprime në kundërshtim me nenin nr.15 të KVK të kontratës nr. 1288/6 prot., datë 10.06.2022, ku citohet: "...Pagesa për punët duhet bërë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data që kontraktori paraqet një dokument (situacionin) që deklaron se objektivi për pagesën është arritur, subjekt ky i konfirmimit të dokumentit nga mbikëqyrësi i punimeve ...", pagesa është kryer rreth 4 muaj pas dorëzimit të faturës nga Kontraktori.

**Kriteri:** Kontrata me nr. 1288/6 prot., datë 10.06.2022 midis Bashkisë Elbasan dhe OE "B.N" sh.p.k.

**Ndikimi:** Mundësi për pagesë fature me kamate në raste se do kërkohej nga OE.

**Shkaku** Vonës në pagesën e faturave duke tejkaluar afatet nga Bashkia Elbasan.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, në Bashkinë Elbasan të marrë masat për likuidimin e detyrimeve financiare, sipas afateve të përcaktuara në kontrata.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Drejtoria e buxhetit dhe financës, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë znj.A.M.*

**Titulli i gjetjes:** *Dosjet e zbatimit nuk janë të inventarizuara dhe të numëruara.*

**Situata:** Nga auditimi i dosjes fizike të zbatimit u konstatua se dosjet nuk janë të numëruara, të inventarizuara dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit në përfundimit të procesit, veprime në kundërshtim nenin 36, Kreun V, ligji nr.9154 datë 06.11.2003 "Për arkivat" si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, ku citohet: "...1. Dokumentet e numëruara, pavarësisht nga forma e regjistrimit dhe e qarkullimit, kanë vlerë administrative e juridike vetëm nëse janë hartuar e janë ruajtur sipas standardeve të miratuara...".

**Kriteri:** Ligji nr.9154 datë 06.11.2003 "Për arkivat".

**Ndikimi:** Evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, me qëllim vendosjen e sanksioneve për personat e ngarkuar me përgjegjësi.

**Shkaku** Mos inventarizimi dhe arkivimi i dosjeve të prokurimeve publike.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** Sektori i Investimeve në Bashkinë Elbasan me qëllim shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentit, të marrë masa për kryerjen e inventarizimit dhe

arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, por edhe për të gjitha rastet në vijim, në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Drejtoria e prokurimeve publike, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë z. O.K dhe Sektori i Investimeve në Drejtorinë e prokurimeve publike, në cilësinë e përgjegjësit të sektorit inxh. E.H .*

Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko ligjor të zbatimit të vënë në dispozicion nga ana e Bashkisë Elbasan dhe verifikimit në terren u konstatohet se janë realizuar punime në objekt të ndryshme nga përcaktimi i tyre në librezat e masave dhe në situacion, të cilat renditen si mëposhtë:

Tabela nr. 3

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
I.6	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m3	250	460.51	460.51	0	460.51	115,128
IV.11	Shtresë stabilizanti t=10cm + spërkatje me bitum 1 kg/m2	m2	421	5738.84	5738.84	5738.84	0	0
	Spërkatje me bitum 1 kg/m2	m2	59			5738.84	5738.84	338,592
V.8	F.V. Përcjellës PV-500 Ø4mm2, për tokëzimin nga shtylla në shtyllë	ml	56	689.9	696,6	0	689.9	38,634
VI.7	Vijëzim i rrugës anësore dhe i aksit me bojë bikomponente me gjerësi 15 cm	ml	362	845	890.3	560	285	103,170
VIII.7	Parmak ure kolona b/a	m2	5,294	10.01	10.01	0	10.01	52,993
							<b>Total</b>	<b>648,517</b>

**Titulli i gjetjes:** Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Sistemim asfaltim i rrugëve “Grigor Nosi”, “Xhaferr Duhaxhiu”, “Hasan Kopili”, në lagjen 5 Maji”.

**Situata:** Nga auditimi i situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca si mëposhtë:

- Zëri Transport dheu me auto deri 5.0 km. Vlera prej **115,128 lekë pa tvsh / 138,154 lekë me tvsh**, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
- Zëri o Spërkatje me bitum 1kg/m2 në stabilizant. Vlera prej **338,592 lekë pa tvsh / 406,310 lekë me tvsh** është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
- Zëri F.V. Përcjellës PV-500 Ø4mm2, për tokëzimin nga shtylla në shtyllë. Vlera prej **38,634 lekë pa tvsh / 46,360 lekë me tvsh** është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
- Zëri Vijëzim i rrugës anësore dhe i aksit me bojë bikomponente me gjerësi 15 cm. Vlera prej **103,170 lekë pa tvsh / 123,804 lekë me tvsh** është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
- Zëri Parmak ure kolona b/a. Vlera prej **52,993 lekë pa tvsh / 63,592 lekë me tvsh** është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Kriteri:** Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, Neni 7.

Ligjin nr. 120/2020 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për - Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.



Kontrata sipërmarrjes nr. 1288/6 prot., datë 10.06.2022.

Kontrata e Mbikëqyrjes me nr. 2018/6 prot., datë 10.06.2022.

Librezat e masave, situacioni përfundimtar.

**Ndikimi:** Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik me vlerë prej **778,220 lekë me tvsh** në fondet e buxhetit të shtetit.

**Shkaku** Mungesë e kontrollit të punimeve nga ana e Mbikëqyrësit të punimeve.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Bashkia Elbasan të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **778,220 lekë me tvsh** nga OE "B.N" shpk, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës me nr. 1288/6 prot., datë 10.06.2022, me objekt "Sistemim asfaltim i rrugëve "Grigor Nosi", "Xhaferr Duhaxhiu", "Hasan Kopili", në lagjen 5 Maji", vlerë kjo që përbën dëm ekonomik ndaj fondeve të buxhetit të shtetit.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi mbikëqyrësit të punimeve.*

Mbi sa trajtuar më sipër, grupi i auditimit ka mbajtur Akt konstatimin nr. 6, datë 13.11.2023.

Për sa trajtuar më sipër, subjekti i audituar Bashkia Elbasan, ka paraqitur observacionin nr. 4474/45 prot., datë 22.11.2023, protokolluar KLSH nr.767/4 prot., datë 30.11.2023, pretendojnë, si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

I. Në lidhje me konstatimin tuaj se grupi i projektimit gjatë hartimit të preventivit të punimeve ka përfshirë përkatësisht në zërin shtrese stabilizanti  $t = 10 \text{ cm} + \text{spërkatje me bitum } 1 \text{ kg/ m}^2$ , ju bëjmë me dije se: Ky zë punimesh është vendosur në preventivin e projektit me çmimin e manualit sipas analizës nr.3.212/b, me emërtimin "Shtrese stabilizant  $t=10\text{cm}$ ", me vlere 449 leke/m<sup>2</sup>. Por për një trajtim të sipërfaqes para shtresës me binder është parashikuar që me të njëjtën vlerë të jetë edhe spërkatja me bitum 1 kg/m<sup>2</sup>, kurse shtresa e binderit sipas manualit nr. 3.222\2 ka spërkatjen me bitum 0.5 kg\ m<sup>2</sup> para hedhjes së shtresës së binderit.

Për sa më sipër për këtë zë nuk kemi rritje të cmimit për m<sup>2</sup> duke shtuar vlerën e kontratës, por kërkohet vetëm rritja e cilësisë për shtresat që do të sistemohen nuk kemi shtuar vlerë të pagesës për këtë shtresë.

II. Në lidhje me vonesën e konstatuar nga ju në pjesën zbatimi i punimeve, faqe 3 e akt -konstatimit nr.6, ju i referoheni nenit nr.5 të KVK-së të kontratës nr.1288/6 Prot, datë 10.06.2022 ku citohet " Afati i realizimit të punimeve është 3 muaj nga data e lidhjes së kontratës ....." kjo sipas afatit të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ju bëjmë me dije se data e lidhjes së kontratës është data 10.06.2022, por referuar nenit Neni 17, të KPK "Disponimi i Kantierit" të kontratës, i cili parashikon se: " Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentet e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentet e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktorit i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.", nisur nga fakti se në këtë objekt për shkak të pronave të cilat prekeshin nga procesi i shpronësimit, lirimi i sheshit të ndërtimit dhe pajisja me leje ndërtimi është realizuar në datë 20.07.2022 me lejen nr 2568/2 datë 20.07.2022. Për këtë arsye afati deri në pajisjen me leje ndërtimi dhe lirimin e sheshit të punimeve nuk është konsideruar vonesë për sipërmarrësin nga ana e AK..

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

I. Pretendimet e subjektit se zëri shtrese stabilizanti  $t = 10 \text{ cm} + \text{spërkatje me bitum } 1 \text{ kg/m}^2$ , është vendosur në preventivin e projektit me çmimin e manualit sipas analizës nr.3.212/b, me emërtimin "Shtrese stabilizant  $t=10\text{cm}$ ", me vlere 449 leke/m<sup>2</sup>, kërkohet vetëm rritja e cilësisë për shtresat që do të sistemohen nuk kemi shtuar vlerë të pagesës për këtë shtresë. Grupi i auditimit konstaton

se vendosja e emërtimit e këtij zëri pune duhet përfshirë dhe spërkatja me bitum gjatë zbatimit me qëllim rritjen e cilësisë së shtresave është në kundërshtim me kushtet teknike të miratuar nga autoritetet respektive, të cilët kanë miratuar teknikisht që lidhja midis binderit dhe stabilizantit realizohet teknikisht me sasinë e spërkatjes me bitum 0,5 kg/m<sup>2</sup> referuar dhe analizave në manualat e çmimeve të miratuara. Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

II. Pretendimet e subjektit mbi mos disponimit të kantierit ka sjellë vonesa, referuar aktit të dorëzimit të sheshit mbajtur midis të gjithë palëve nuk është cituar që sheshi është pjesërisht i lirë. **Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.**

## 5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

### **Lejet e Ndërtimit, Zhvillimit dhe Përdorimit për Periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022**

Referuar të dhënave në sistemin elektronik *e-lejet* për Bashkinë Elbasan, rezulton se për afatin e auditimit **01.01.2022 deri në 31.12.2022**, ka pasur **740 aplikime në sistem për lloje të ndryshme lejesh** si: leje zhvillimi, leje ndërtimi, deklarata për kryerje punimesh, leje për ndryshim funksioni, leje për shtesa në objekte ekzistuese, rikonstruksione dhe çertifikata përdorimi, etj., përkatësisht 57 aplikime për leje zhvillimi, 35 për leje ndërtimi, 42 çertifikata përdorimi, 4 shtyrje afati leje ndërtimi, 322 deklarata paraprake për kryerje punimesh, 7 ndryshime funksioni, 83 rikonstruksione dhe 20 leje infrastrukture, të evidentuara në tabelën përmbledhëse në **Aneksin 1**.

*Aneksi 1 – Viti 2022*

<b>Lloji i lejes</b>	<b>Total</b>	<b>Miratuar</b>	<b>Refuzuar</b>	<b>Në proces</b>
Leje zhvillimi	57	29	28	-
Leje zhvillimi ne rastet e fatkeqesise natyrore	17	8	9	-
Leje ndërtimi mbi 250m <sup>2</sup>	16	9	7	-
Leje ndërtimi deri 250m <sup>2</sup>	19	16	2	1
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	322	153	169	-
Rikonstruksion pa ndryshim funksioni	83	47	36	-
Rikonstruksion me ndryshim funksioni	3	3	0	-
Çertifikatë përdorimi	42	34	8	-
Shtesë në objekt ekzistues deri në 250 m <sup>2</sup>	42	20	20	2
Ndryshim projekti gjatë zbatimit	4	4	0	-
Ndryshim funksioni	7	5	2	-
Njoftim fillim punimesh	69	54	15	-
Shtyrje afati leje ndërtimi	4	1	2	1
Leje infrastrukture	20	14	6	-
Leje ndërtimi, rikonstruksioni pa ndryshim vëllimi	26	10	16	-
Leje ndërtimi, rikonstruksioni me ndryshim vëllimi	9	5	4	-

*Burimi: DPZHT Bashkia Elbasan Përpunoi: Grupi i auditimit*

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga DPKTZH e Bashkisë Elbasan, leje për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup> janë miratuar **9 leje**, leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m<sup>2</sup> janë miratuar **20 leje**, janë miratuar **34 çertifikata përdorimi**, ndërsa leje ndërtimi për ndërtim të ri deri në 250 m<sup>2</sup> janë miratuar **16 leje**, të pasqyruara në tabelën e mësipërme.

Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për t'u audituar rastet e mëposhtme të lejeve të ndërtimit për ndërtime me sipërfaqe deri ose më të madhe se 250 m<sup>2</sup>, çertifikata përdorimi dhe leje rindërtimi, rikonstruksioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar me shtim apo ndryshim vëllimi:

Nr.	Objekti	Zhvilluesi	Data e lëshimit të lejes	Preventivi
1	Leje ndërtimi për objekt shërbimi 1 kat, në pasurinë me nr. 45/1/1, ZK 2124, me sipërfaqe 3400 m <sup>2</sup> e llojit 'arë', në pronësi të z.B.K , znj.V.K , z.A.K znj.S.K me adresë "Bradashesh", Katund i Ri, Elbasan.	z.B.K, znj.V.K, z.A.K znj.S.K	16.03.2022	27,458,626.00 lekë
2	Leje ndërtimi për godinë shërbimi 1 kat në pasurinë me nr.314/41/1 ZK 8526 e llojit arë me sipërfaqe prej 2250 m <sup>2</sup> në pronësi të z.A.H dhe znj.E. H. me adresë "Katund i Ri", Bashkia Elbasan	A.H	25.08.2022	11.346.845,00 lekë
3	Leje ndërtimi për prishje e objektit ekzistues dhe ndërtim i objektit me 4, 6, 8, 10, 11 dhe 12 kat me 2 kate parkim nëntokë, në pasurinë me nr. 3/125, ZK 8523 me sipërfaqe trualli 1565.6 m <sup>2</sup> dhe sipërfaqe objekti 101.2 m <sup>2</sup> , në pronësi të znj. M. H., me zhvillues z. D.S , në lagjen "Dyli Haxhire", Bashkia Elbasan	D.S	07/12/2022	283.591.367,00 lekë
4	Çertifikatë përdorimi për objekt 3 , 5 dhe 8 kat + 1 kat podrum parkim dhe prishje objekteve ekzistuese, në adresën Lagjia "Dyli Haxhire" Bashkia Elbasan	E. ShPK	16.08.2022	-

**Titulli gjetjes:** *Mosrespektimi i kondicioneve urbane.*

**Situata:** Nga auditimi i procedurës së miratimit të "Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe me të madhe se 250 m<sup>2</sup>", me nr. AN200120220033, për të cilën është marrë vendimi për miratim **Nr. 2316/5 Prot; datë 16.03.2022**, të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, për objektin "**Objekt shërbimi 1 kat** ", me adresë në fshatin Katund i Ri, Elbasan, me zhvillues z.B.K, znj.V.K, z.A.K znj.S.K, konstatohet se:

**1. Plani i rilevimit nuk** paraqet konturin e pasurisë si edhe të dhëna të tjera për gjendjen faktike të objektit dhe objekteve kufitare. Gjithashtu ky plan duhet të paraqesë edhe të dhëna mbi rrugët , gjerësinë e tyre, madhësinë e pronës e paraqitur me dimensione, si dhe të dhëna mbi linjat e tensionit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST). Për sa më sipër, rilevimi topografik është i paplotësuar me të gjithë detajet e nevojshme.

**2.** Mungon projekti për instalimet e ngrohje – ftohjes dhe ventilimit (H-VAC), së bashku me dokumentacionin shoqërues, relacionin, vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, licencat profesionale, preventivin e punimeve, si dhe policën dhe deklaratën e përgjegjësisë profesionale.

**3.** Nuk vërtetohet marrëdhënia e punës midis znj. XH.H dhe z. K.H, si hartues të projektit arkitektonik. Projekti arkitektonik është hartuar dhe nënshkruar elektronikisht nga z. K.H dhe z. A.A, ndërsa vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale i referohen vetëm znj. XH.H. Në sistemin *e-lejet* nuk gjendet dokumentacioni i justifikues mbi marrëdhënie e punës midis këtyre profesionistëve, siç janë kontrata e punës, licenca profesionale e subjektit, ekstrakti historik i subjektit, vërtetimet e pagimit të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore etj.

Gjithashtu, referuar informacionit të marrë nga dokumenti i policës së sigurimit të përgjegjësisë profesionale për znj. XH.H, me datë 29.07.2021, shprehemi se sigurimi është i vlefshëm për projektet inxhinierike dhe për auditimin e efikasitetit të energjisë, pra nuk është i vlefshëm për projektimin arkitektonik.

- Mungon dokumentacioni shoqërues i projektit hidraulik, siç janë relacioni, vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, licencat profesionale, preventivin e punimeve, si dhe policën dhe deklaratën e përgjegjësisë profesionale. Ky dokumentacion është kërkuar që të plotësohet edhe nga vet Bashkia Elbasan DPZHT, në kërkesën për plotësim dokumentacioni me nr. 2316/1 prot; datë 08.02.2022, me lëndë "*Njoftim për detyrimin e ndryshimit të projektit*". Edhe pse në këto kushte, DPZHT ka vazhduar me miratimin e lejes së ndërtimit.

**4.** - Nuk është respektuar mendimin dhe kërkesat e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, pasi, referuar Vendimit për VNM paraprake, miratuar me vendim nr. 55 të komisionit, datë 06.12.2021, pika

3.2, ku agjencia shprehet se “Ky Vendim është i vlefshëm pasi subjekti të bej ndryshimin e statusit të tokës, nga tokë arë, në tokë truall, sipas akteve ligjore në fuqi”, si dhe referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistemin *e-lejet* për këtë aplikim, konstatohet se konvertimi i statusit të tokës nuk është realizuar.

- Nuk është kërkuar mendimi i Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT).

- Nuk është marrë siguri e plotë mbi respektimin e distancave nga linjat e tensionit të lartë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), i cili shprehet me anë të kthim-përgjigjes së datës 12.01.2022 (sipas nënshkrimit elektronik) se objekti duhet të respektojë distancat e percaktuara 10 metër nga përcjellësit anësor i linjave. Këto linja janë paraqitur në planvendosjen e miratuar, por nuk dihet se nga është marrë ky informacion, pasi plani i rlevimit, i hartuar nga topograf i licencuar, nuk jep asnjë informacion mbi ekzistencën apo konfigurimin e tyre.

**5. Ky objekt nuk ka filluar ndërtimin brenda afateve të përcaktuara në ligj.** Referuar dokumentit të lejes së ndërtimit, për të cilën është marrë vendimi për miratim Nr. 2316/5 Prot; datë 16.03.2022, të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, pika 3 e tij, ku përcaktohet se “*Afati i fillimit të punimeve është deri në 1 (një) vit nga data e lëshimit të kësaj lejeje. Kjo leje është e pavlefshme nëse zhvilluesi nuk fillon punimet e ndërtimit brenda afatit një vjeçar pas lëshimit të saj, bazuar në nenin 40 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar*”, si dhe Ligjit 107/2014, datë 31.07.2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, i ndryshuar, Neni 40, zhvilluesit e pajisur me leje ndërtimi kanë detyrimin e fillimit të punimeve brenda një afati një (1) vjeçar. Aplikimi për fillimin e punimeve për këtë objekt është kryer në datën 21.03.2023, ndërsa miratimi i kësaj kërkesë është bërë po në këtë datë, me anë të vendimit me nr. 2316/8 prot; pra jashtë afatit (1) vjeçar të parashikuar në ligjin e sipërcituar.

**6. Objekti i miratuar nuk zbaton përcaktimet për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapsira publike,** Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore 3/8, referuar dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Elbasan, KSHR = 12% dhe KSHP = 15%, në këtë leje nuk ka asnjë parashikim për plotësimin e këtyre dy treguesve të zhvillimit.

**7. Tipologjia e objektit të miratuar nuk është në përputhje me përdorimin e lejuar të tokës për njësinë strukturore.** Nga pasaporta e njësisë strukturore 3/8, pjesë e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Elbasan, marrim informacionin se kjo njësi i përket sistemit urban (UB), kategoria shërbime. Në të janë të lejuara ndërtimet e infrastrukturës, natyrorë, ujëra dhe struktura në shërbim të bujqësisë. Referuar informacionit të marrë nga projekti ndërtimor, konstatohet se objekti i miratuar është një kapanon me funksion shërbim. Nga sa më sipër cituar, shprehemi se tipologjia e objektit të miratuar nuk është në përputhje me përdorimin e lejuar të tokës për njësinë strukturore, pasi objektet e tipologjisë kapanon nuk janë të listuara në Shtojcën 3 “*Tabela e sistemeve*” të VKM-së nr. 671, datë 29.07.2015 “*Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit*”. Gjithashtu, në Nenin 2.2.7 të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Elbasan, përcaktohen se cilat janë tipologjitë e objekteve të cilat kategorizohen si shërbime, më konkretisht “*objekte tregëtare, rekreative, restorante e bare*”. Miratimi i këtij objekti në njësinë strukturore 3/8 është në kundërshtim me dispozitat ligjore të sipërcituara.

**Kriteri:** Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 408, datë 13.05.2015, “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, nenet 10, 15, 21, Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Elbasan, Neni 8.1.2, 8.1.3, 8.1.4. **VKM-në nr. 1162, datë 24.12.2020,** “*Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim*”.

**Ndikimi/Efekt:** Mosrespektimi i parametrave urban ndikon në zhvillimin e kontrolluar urban, duke cënuar parametra të përcaktuar në legjislacion dhe rregullore, si dhe duke ndikuar negativisht në standartet ndërtimore, kushtet e sigurisë, higjenës, ato mjedisore dhe urbanistike.

**Shkaku:** Mosrespektim i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi nga ana e funksionarëve të Bashkisë Elbasan.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Nga Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (SPZHT), Bashkia Elbasan të merren masa për respektimin e distancave dhe kondicioneve urbane sipas përcaktimeve ligjore dhe rregullatorë në fuqi, për shqyrtimin e vetëm atyre aplikimeve që kanë informacion të saktë në dokumentacionin shoqëruar, si dhe për të kërkuar në çdo rast evidentimin e përcaktimeve për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapësira publike.

*Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi znj. A.C, në funksionin e drejtorit të DPZHST; znj. K.Q, në funksionin e përgjegjëses së SKL pranë DPZHST; z. M.M, në funksionin e specialistit pranë DPZHST; znj. S.H, në funksionin e juristes pranë DPZHST. Gjithashtu, në zbatim të Ligjit 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Neni 29, pika a), për vendimmarrjen e jashtëligjshme lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Elbasan, ngarkohet me përgjegjësi: z. G.LL, në funksionin e Kryetarit të Bashkisë Elbasan.*

Në observacionin e subjektit të audituar Bashkia Elbasan mbi Akt konstatimin nr.11 dërguar me shkresën nr. 4474/44 prot., dt. 22.11.2023 dhe me nr. 767/4 prot., (i KLSH) dt. 30.11.2023, shprehur si më poshtë vijon:

**Pretendimi i subjektit:** Observacion për nr. regjistri elektronik 2316 në emër të zhvilluesve B.K, V.K, A.K, S.K, më datë 16.03.2022, me nr. çështje në sistemin "e-lejet" AN200120220033, aplikuar më datë 20.01.2022 për "Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup>" për objektin: "Objekt shërbimi 1 kat", me adresë Katund i ri, Bashkia Elbasan, aplikuesi A.A , aplikuar më datë 20.01.2022 me nr. 2316 protokollin, nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve e-albania me anë të prokurës së posaçme nr.1804 REP dhe nr.1017 KOL, datë 18/04/2021, punonjësit A.C, K.Q, M.M, S.H, dhe Kryetar G.LL.

**Për pikën 1 :**Përsa i takon Planit të Rilevimit sipas VKM nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, neni 10, cilëson "Dokumentacioni për pajisjen me leje zhvillimi", pika ç) **planin e rilevimit të pronës, në shkallë 1:500, nga topograf i licencuar**, është dokument që nuk hartohet nga DPZHST, por depozitohet nga aplikuesi në sistemin "e-lejet", i hartuar nga person i licencuar sipas kuadrit ligjor. Sipas planvendosjes së strukturës, ngarkuar në sistemin "e-leje" hartuar nga person i licencuar, cilësohet distanca 1000 cm nga kufiri jug-perëndimor i objektit.Sqarojmë se, sipas VKM nr. 354, datë 11.05.2016, "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", Kreu VI, Shërbimet e rilevimit topografik, neni 63, pika 1, a) *Shërbimet e rilevimit topografik përfshijnë rilevim për planifikimin dhe për projektimin e ndërtesave për veprat inxhinierike dhe për strukturat e transportit dhe qarkullimit.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehem se **Plani i rilevimit nuk** paraqet konturin e pasurisë si edhe të dhëna të tjera për gjendjen faktike të objektit dhe objekteve kufitare. Gjithashtu ky plan duhet të paraqesë edhe të dhëna mbi rrugët , gjerësinë e tyre, madhësinë e pronës e paraqitur me dimensione, si dhe të dhëna mbi linjat e tensionit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST). Për sa më sipër, rilevimi topografik është i paplotësuar me të gjithë detajet e nevojshme. **ky pretendim nuk merret në konsideratë.**

**Për pikën 2 :**Mbështetur në VKM nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, neni 15, "Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi", depozitohet nga aplikuesi në sistemin "e-lejet", të hartuara nga personat e licencuar sipas kuadrit ligjor. Sipas projektit dhe relacionit arkitektonik, ngarkuar në rubrikën "Projekti i ndryshuar", cilësohet se, objekti dy anët e tij do t'i ketë faqe kallkan, ndërsa dy anët e tjera do të ketë derë për aksesimin e objektit dhe dritare për ajrosje. Objekti që do të ndërtohet nuk do të ketë instalime për

ngrohje-ftohje. Ventilimi i objektit do të bëhet në mënyrë natyrale nëpërmjet dritareve dhe dyerve të projektuara sipas projektit arkitektonik. Është zgjidhur në këtë mënyrë dhe për shkak të funksionit që do të ketë objekti, deklaruar me vullnetin e tij të lirë e të pakushtëzuar dhe nën përgjegjësinë e tij të plotë, mbi hartimin e objektit teknik, si projektues i licencuar referuar kuadrit ligjor. Sqarojmë se, sipas Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 4, Punimet e ndërtimit, të përkufizuara në nenin 3, duhet të projektohen dhe të zbatohen në tërësi ose në pjesë të veçanta në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre, duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tyre. Ato duhet të plotësojnë kërkesat që kanë të bëjnë me: 1. rezistencën dhe qëndrueshmërinë mekanike; 2. sigurinë nga zjarri; 3. higjienën, shëndetin dhe mjedisin; 4. sigurinë në përdorim; 5. mbrojtjen nga zhurmat; 6. kursimin e energjisë dhe ruajtjen e ngrohtësisë, ku në vijim Kreu III, "Projektimi, Mbikëqyrja, Zbatimi dhe Kolaudimi i Punimeve të ndërtimit", neni 5, "Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse. Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit.", si dhe neni 6, Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, për të gjitha: pika b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë[...], sipas VKM nr.1055, datë 22.12.2010, "Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit", pika 1, "Për të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, që realizohen në territorin e Republikës së Shqipërisë nga subjekte fizike dhe juridike, vendas ose të huaj, për të cilat vlera e preventivuar e punimeve të ndërtimit është jo më pak se 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, të bëhet oponencë teknike.", konkretisht sipas dokumentacionit të ngarkuar në sistemin "e-leje" nga personi i licencuar, nuk afrohet, as tejkalon vlerën preventivuese për të qenë objekt trajtimi me openencë teknike, si dhe shprehur se objekti është 1 kat, me projekt arkitektonik, inxhinierik konstruktiv me një ulje maksimale themeli -2.30 m nga kuota +/- 0.00, projekt hidro-sanitar, projekt për mbrojtjen nga zjarri, pajisur me certifikatë për performancën e energjisë klasi B 28, si dhe Raport paraprak për VNM, duke shprehur një konstruksion metalik, pa patur detyrimin për studime sizmike apo gjeologjike".

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se Mungon projekti për instalimet e ngrohje – ftohjes dhe ventilimit (H-VAC), së bashku me dokumentacionin shoqëruar, relacionin, vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, licencat profesionale, preventivin e punimeve, si dhe policën dhe deklaratën e përgjegjësisë profesionale.

**ky pretendim nuk merret në konsideratë.**

**Për pikën 3:**Projekti hidraulik dhe dokumentacioni përkatës janë të ngarkuar në sistemin e-leje gjithashtu dhe deklarata e përgjegjësisë profesionale e projektuesit inxh.Seit Pëllumbi e cila është kërkuar në fazën e ndryshimit të projektit dhe është ngarkuar në grupin e dokumentave të projektit të ndryshuar. Nuk janë ngarkuar ekstraktet e QKB-së pasi organi publik sipas kodit të procedurave administrative neni 77 pika 3 dokumentet që vërtetojnë akte, fakte, cilësi apo gjendje subjektive, të nevojshme për zhvillimin e shqyrtimit, administrohen kryesisht nga organi që zhvillon procedurën administrative, kur janë në administrim të tij apo të organeve të tjera publike. Meqënëse Bashkia Elbasan ka akses në portalin e-albania,mund ta kontrollojë vetë ne regjistrat e QKB, cdo ekstrakt të cdo biznesi të regjistruar në QKB. Thënë këtë ekstraktet e QKB sigurohen vetë nga nëpunësi publik në rastet kur palët nuk e kanë dorëzuar në sistemin e-leje. Per pikën ku shpreheni se nuk vërtetohet marrëdhënia e punës midis znj. XH.H dhe z.K.H si hartues i projektit arkitektonik nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-leje çështje në sistemin "e-lejet" AN200120220033, rezulton i ngarkuar në sistem dokumentacioni me nr.T05030877, date 15.11.2021 vertetim i kontributeve të sigurimeve shoqërore, ku vërtetohet që z.K.H është regjistruar si punonjës në personin fizik XH.H pf identifikuar me nipt M.....V.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se Nuk vërtetohet marrëdhënia e punës midis znj. XH.H dhe z. K.H, si hartues të projektit arkitektonik. Projekti arkitektonik është hartuar dhe nënshkruar elektronikisht nga z. K.H dhe z. A.A, ndërsa vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe polica e sigurimit të përgjegjësive profesionale i referohen vetëm znj. XH.H. Në sistemin *e-lejet* nuk gjendet dokumentacion justifikues mbi marrëdhënie e punës midis këtyre profesionistëve, siç janë kontrata e punës, licenca profesionale e subjektit, ekstrakti historik i subjektit, vërtetimet e pagimit të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore etj.

Gjithashtu, referuar informacionit të marrë nga dokumenti i policës së sigurimit të përgjegjësive profesionale për znj. XH.H, me datë 29.07.2021, shprehemi se sigurimi është i vlefshëm për projektet inxhinierike dhe për auditimin e efikasitetit të energjisë, pra nuk është i vlefshëm për projektimin arkitektonik.

- Mungon dokumentacioni shoqëruar i projektit hidraulik, siç janë relacioni, vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, licencat profesionale, preventivin e punimeve, si dhe policën dhe deklaratën e përgjegjësive profesionale. Ky dokumentacion është kërkuar që të plotësohet edhe nga vet Bashkia Elbasan DPZHT, në kërkesën për plotësim dokumentacioni me nr. 2316/1 prot; datë 08.02.2022, me lëndë *“Njoftim për detyrimin e ndryshimit të projektit”*. Edhe pse në këto kushte, DPZHT ka vazhduar me miratimin e lejes së ndërtimit. **ky pretendim nuk merret në konsideratë.**

**Për pikën 4:** Mbështetur në VKM nr. 408, datë 13.05.2015, *“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”*, i ndryshuar, neni 30, Kushtet e përgjithshme të nënndarjes së parcelave për qëllime zhvillimi, pika 1) Kushtet e përgjithshme për lejimin dhe realizimin e nënndarjes së parcelës për qëllime zhvillimi janë: nënpika a), ***Parcela duhet të ndodhet brenda kufijve të sistemit urban (vija e gjelbër), ose në ato pjesë të sistemit natyror dhe bujqësor që janë përcaktuar për t’u konvertuar në tokë “truall” nga dokumenti i planifikimit dhe aktet përkatëse ligjore në fuqi.*** Si dhe sipas VKM nr. 440, datë 03.06.2020, *“Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 410, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”, pika 5, kreu VII/1, me këtë përmbajtje: “VII/1. Kalimi i tokave të resurseve të ndryshme në kategorinë e resursit tokë urbane, truall, sipas planeve të detajuara dhe planeve të përgjithshme vendore. Në rastet kur planet e detajuara për zona të rëndësishme kombëtare, planet e përgjithshme vendore dhe planet e detajuara vendore janë miratuar dhe botuar në regjistrin e planifikimit të territorit, subjektet e interesuara për ndryshimin e kategorive të resurseve paraqesin për regjistrim në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, të qarkut, lejen e zhvillimit ose lejen e ndërtimit. Në këto raste, resursi i tokës ndryshohet sipas lejes së zhvillimit ose lejes së ndërtimit, konform planit të përgjithshëm vendor dhe planit të detajuar vendor. Leja e zhvillimit paraqitet për çdo parcelë.”*. Pra ky status pronësie ndryshon pas pajisjes me Leje ndërtimi të objektit, kundrejt kushteve teknike ligjore, në përputhje me sistemin urban ku përfshihet në Planin e Përgjithshëm Vendor të bashkisë Elbasan. Përsa i përket respektimit të distancave nga linjat e tensionit të lartë, sipas planvendosjes së ngarkuar në sistemin e-leje për të cilën mban përgjegjësi projektuesi arkitekt distanca minimale prej 10 m është respektuar, shprehur nga intitucioni i OST, date 12.01.2022 ne sistemin elektronik e-leje : *“Në truallin tuaj kalojnë linjat e tensionit të lartë 220 kV nën administrimin e OST sh.a. “Distancat e përcaktuara 10 metër nga përcjellësit anësor të linjave në planvendosje janë brenda normave të rregullores së Sigurimit Teknik. Si rrjedhim japim miratimin tonë për vazhdimin e procedurave”*.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se Nuk është respektuar mendimin dhe kërkesat e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, pasi, referuar Vendimit për VNM paraprake, miratuar me vendim nr. 55 të komisionit, datë 06.12.2021, pika 3.2, ku agjencia shprehet se *“Ky Vendim është i vlefshëm pasi subjekti të bej ndryshimin e statusit të tokës, nga*

*tokë arë, në tokë truall, sipas akteve ligjore në fuqi*”, si dhe referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-lejet për këtë aplikim, konstatohet se konvertimi i statusit të tokës nuk është realizuar.

- Nuk është kërkuar mendimi i Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT).

- Nuk është marrë siguri e plotë mbi respektimin e distancave nga linjat e tensionit të lartë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), i cili shprehet me anë të kthim-përgjigjes së datës 12.01.2022 (sipas nënshkrimit elektronik) se objekti duhet të respektojë distancat e percaktuara 10 metër nga përcjellësit anësor i linjave. Këto linja janë paraqitur në planvendosjen e miratuar, por nuk dihet se nga është marrë ky informacion, pasi plani i riveimit, i hartuar nga topograf i licencuar, nuk jep asnjë informacion mbi ekzistencën apo konfigurimin e tyre. **Ky pretendim nuk merret në konsideratë.**

**Për pikën 5 :**Objekti ka aplikuar për njoftim për fillimin e punimeve brenda afatit 1 vjeçar pasi në lejen e ndërtimit Kryetari i Bashkisë ka firmosur elektronikisht në datë 28.03.2022 dhe në këtë datë i ka kaluar vendimi i miratimit në sistemin e-leje aplikuesit.Data e vendimit të lejes konsiderohet data që pala aplikuese merr njoftim nepërmjet sistemit e-albania, që nënkupton datën kur është bërë dE mi i vendimit të nënshkruar elektronikisht dhe ngarkuar ne portalin e-leje. Pra, zhvilluesi mund të aplikonte për njoftim për fillim punimesh nga data 28.03.2022 e në vijim me një afat 1 vjeçar. Gjithashtu gjatë shqyrtimit të aplikimit për njoftim fillim punimesh juristi i DPZHT është konsultuar me drejtorinë juridike të Bashkisë Elbasan ku është vlerësuar si legjitime referimi në datën kur akti ka kaluar tek qytetari (aplikuesi).

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se Ky objekt nuk ka filluar ndërtimin brenda afateve të percaktuara në ligj. Referuar dokumentit të lejes së ndërtimit, për të cilën është marrë vendimi për miratim Nr. 2316/5 Prot; datë 16.03.2022, të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, pika 3 e tij, ku përcaktohet se “*Afati i fillimit të punimeve është deri në 1 (një) vit nga data e lëshimit të kësaj lejeje. Kjo leje është e pavlefshme nëse zhvilluesi nuk fillon punimet e ndërtimit brenda afatit një vjeçar pas lëshimit të saj, bazuar në nenin 40 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar*”, si dhe Ligjit 107/2014, datë 31.07.2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, i ndryshuar, Neni 40, zhvilluesit e pajisur me leje ndërtimi kanë detyrimin e fillimit të punimeve brenda një afati një (1) vjeçar. Aplikimi për fillimin e punimeve për këtë objekt është kryer në datën 21.03.2023, ndërsa miratimi i kësaj kërkesë është bërë po në këtë datë, me anë të vendimit me nr. 2316/8 prot; pra jashtë afatit (1) vjeçar të parashikuar në ligjin e sipërcituar. **Ky pretendim nuk merret në konsideratë.**

**Për pikën 6 :** Sipas pikës 8, të Rregullores së PPV-së, miratuar me Vendim KKT nr. 1, datë 29.12.2016, Rregullat për çdo zonë e njësi strukturore, pika 8.1.2 *Koeficienti i shfrytëzimit të tokës për rrugë (Kshr), sipas rregullores së planifikimit të territorit të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, është raporti midis sipërfaqes së gjurmës që do të zënë rrugët në një njësi ose zonë dhe sipërfaqes bruto të njësisë/zonës.* Pika 8.1.3, në vijim, *Për llogaritjen e Kshr-së në këtë rregullore përfshihen në formulë të gjitha sipërfaqet rrugore që ndodhen brenda kufirit të njësisë strukturore, pavarësisht kategorisë së rrugës sipas Kodit rrugor, apo funksionalitetit të saj.* Përsa kohë nuk ka kusht hartimin e Planit të Detajuar Vendor, as hartimin e Planit Rrugor, ka një koeficient ekzistues që vjen si pasojë e shqyrtimit të njësisë/zonës, tashmë të miratuar me Dokumentin e planifikimit (PPV), Vendim KKT nr. 1, datë 29.12.2016, për Kshr = 12%, pra sipas pasaportës së Njësisë Strukturore 3/8 nga PPV e miratuar. Pika 8.1.4, e Rregullores, shpreh se, *Koeficienti i shfrytëzimit të tokës për hapësira publike (Kshp) është raporti i sipërfaqes së hapësirave publike për njësi/zonë me sipërfaqen bruto të njësisë/zonës. Kshp-ja paraqitet në % dhe përcaktohet për njësi/zonë në dokumentin e planifikimit. Zbatimi i Kshp-së është përgjegjësi e bashkisë dhe realizohet në nivel njësie strukturore.* Konkretisht, sipas ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, i ndryshuar, neni 3, pika 9, “*Dokumente të planifikimit*” janë dokumente zyrtare të planifikimit që hartohen dhe zbatohen në territor, në nivel qendror dhe vendor, në përputhje me nenin 16 të këtij [...], neni 16, Plani i Përgjithshëm



Kombëtar i Territorit. Sqarojmë se, sipas **PPV, Pasaporta e Njesisë Strukturore 3/8 shpreh Kshp = 15%, pra Njësia Strukturore**, përse kohë nuk ka kusht hartimin e Planit të Detajuar Vendor, as hartimin e Planit Krugor, ka një koeficient ekzistues që vjen si pasojë e shqyrtimit të njësisë/zonës, tashmë të miratuar me Dokumentin e planifikimit (PPV), Vendim KKT nr. 1, datë 29.12.2016. Koeficienti i shfrytëzimit të territorit është 24.7 % dhe pjesa tjetër e mbetur e pronës do të shfrytëzohet për rrugë apo për hapësira rekreative.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehem se **Objekti i miratuar nuk zbaton përcaktimet për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapësira publike**, Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore **3/8**, referuar dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Elbasan, KSHR = 12% dhe KSHP = 15%, në këtë leje nuk ka asnjë parashikim për plotësimin e këtyre dy treguesve të zhvillimit. **ky pretendim nuk merret në konsideratë.**

**Për pikën 7 :** Mbështetur në ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 686, datë 22.11.2017, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 80, Kategoritë e përdorimit të tokës, pika 2, Autoriteti i planifikimit i referohet dhe përdor gjatë procesit të zonimit kategoritë e përdorimit të tokës sipas sistemeve territoriale, me kodet përkatëse, [...] nën-pika 2.a, (ii) “*Shërbime (S)*” *përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e shërbimeve tregtare, akomoduese dhe zyre, si dhe sipas SHTOJCA I, Tabela e kategorizimit të përdorimit të tokës, për sistem urban, përfshin kategorinë "Shërbime", në të cilat klasifikohen në S1 - Shërbime Akomodimi dhe Argëtimi, si dhe, S2 - Shërbime Tregtare dhe Biznesi, ku te kjo e fundit përfshihet objekti i lejes S2-5 Treg pakice, S2-7 Dyqane / Profesione të lira.* Sipas nenit 79, të VKM nr. 686, datë 22.11.2017, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar, Kategorizimi i përdorimit të tokës kushteve të zhvillimit, pika 1, Qëllimi i kategorizimit të përdorimit të tokës, pika a) *është të funksionojë si një mjet për planifikimin dhe zhvillimin e territorit; pika b) të unifikojë metodologjinë bazë, terminologjinë dhe kodet e përdorura gjatë zonimit sipas kësaj rregulloreje, pa kufizuar metodologjitë e planifikimit dhe mënyrat e tjera të zonimit; dhe pika c) të krijojë një bazë krahasuese në lidhje me përdorimin e tokës midis dokumenteve të planifikimit të autoriteteve dhe territoreve të ndryshme.* Konkretisht, Rregullorja Plani i Përgjithshëm Vendor të bashkisë Elbasan, miratuar me vendim KKT nr. 1, datë 29.12.2016, “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Elbasan”, *pasaporta për këtë Njësi Strukturore 3/8 nuk kërkon Plan të Detajuar Vendor (PDV), pra është PA (i paaplikueshëm).*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehem se **Tipologjia e objektit të miratuar nuk është në përputhje me përdorimin e lejuar të tokës për njësinë strukturore**. Nga pasaporta e njësisë strukturore **3/8**, pjesë e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Elbasan, marrim informacionin se kjo njësi i përket sistemit urban (**UB**), kategoria shërbime. Në të janë të lejuara ndërtimet e infrastrukturës, natyrorë, ujëra dhe struktura në shërbim të bujqësisë. Referuar informacionit të marrë nga projekti ndërtimor, konstatohet se objekti i miratuar është një kapanon me funksion shërbim. Nga sa më sipër cituar, shprehem se tipologjia e objektit të miratuar nuk është në përputhje me përdorimin e lejuar të tokës për njësinë strukturore, pasi objektet e tipologjisë kapanon nuk janë të listuara në Shtojcën 3 “*Tabela e sistemeve*” të VKM-së nr. 671, datë 29.07.2015 “*Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit*”. Gjithashtu, në Nenin 2.2.7 të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Elbasan, përcaktohen se cilat janë tipologjitë e objekteve të cilat kategorizohen si shërbime, më konkretisht “*objekte tregëtare, rekreative, restorante e bare*”. Miratimi i këtij objekti në njësinë strukturore **3/8** është në kundërshtim me dispozitat ligjore të sipërcituara. **ky pretendim nuk merret në konsideratë.**

## **Titulli gjetjes:** *Mosrespektimi i kondicioneve urbane.*

**Situata** Nga auditimi i procedurës së miratimit të “Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250m<sup>2</sup>”, me nr. AN190220220018, për të cilën është marrë vendimi për miratim Nr. 2369/6 Prot; datë 25.08.2022, të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, për objektin "Godinë shërbimi 1 kat" me adresë "Katund i Ri", Bashkia Elbasan, me subjekt zhvillues z. A.H, u konstatua si më poshtë:

1. Leje e ndërtimi është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 83 ditësh pune.
  2. Nuk është kërkuar ose respektuar mendimi i autoriteteve që duhet të shprehen në lidhje me lejet e ndërtimit, pasi:
    - Nuk është respektuar mendimin dhe kërkesat e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit,
    - Nuk është kërkuar mendimi i Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT).
    - Nuk është kërkuar mendimi i Autoritetit Rrugor Shqipëtar (ARRSH).
  3. Mungon projekti për instalimet e ngrohje – ftohjes dhe ventilimit (H-VAC), së bashku me dokumentacionin shoqërues, relacionin, vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, licencat profesionale, preventivin e punimeve, si dhe policën dhe deklaratën e përgjegjësisë profesionale.
  4. Mungojnë vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe/ose ekstrakti historik i subjekteve që kanë hartuar projektin konstruktiv, elektrik dhe raportin e auditimit të eficientë energjitike.
    - Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e projektit konstruktiv, Gjithashtu, sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e raportit të auditimit të eficientë energjitike është jashtë periudhës së mbulimit, pasi kjo policë është e vlefshme për periudhën 26.01.2021-25.01.2022, ndërsa aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është bërë në datën 19.02.2022.
- Shënim:** Në sistemin elektronik të lejeve gjendet e ngarkuar polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për subjektin N ShPK, por nuk ka dokumentacion që të vërtetojë marrëdhënien e punës me asnjë prej subjekteve që kanë realizuar projektin ndërtimor.
5. Nga këqyrja e projektit ndërtimor, më konkretisht projektit arkitektonik dhe planit të vendosjes së miratuar, konstatohet se objekti i miratuar nuk respekton distancat urbane nga kufiri i pronës në fasadë lindore të objektit sipas përcaktimeve të Nenin 34 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, pika 4. Distanca e miratuar e ndërtesës nga kufiri i pronës është 0.8 m (fasada lindore është kallkan), ndërsa distanca minimale e lejuar sipas dispozitave ligjore është 1 m. Respektimi i kësaj distance është kërkuar në lejen e zhvillimit, në seksionin “*Kushte të veçanta*”, por, edhe pse në këto kushte, Bashkia Elbasan ka vazhduar me miratimin e lejes së ndërtimit në shkelle të distancave urbane nga kufiri i pronës.
  6. Objektet të cilat zhvillohen buzë rrugëve, gëzojnë të drejtën e respektimit të vijës së ndërtimit, pavarësisht nëse respektohet ose jo distanca midis ndërtesave. Për njësinë strukturore në të cilën zhvillohet objekti, nuk ka një plan të detajuar vendor të miratuar. Në sistemin *e-lejet* nuk u gjet asnjë studim pjesor mbi sistemin rrugor dhe përcaktimin e vijave të ndërtimit për njësinë strukturore në fjalë. Gjithashtu, në dokumentat e ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, nuk identifikohet i plotë trupi i rrugës, pra gjerësia e tij. Objekti është zhvilluar sipas disa vijave të ndërtimit, të cilat nuk janë të miratura, rrjedhimisht, nuk mund të shprehemi nëse objekti respekton distancat nga trupi i rrugës ose jo. Për këtë rrugë nuk jepet informacion se nën juridiksionin e kujt autoriteti është, Autoritetit Rrugor Shqipëtar apo Bashkisë Elbasan.
  7. Objekti i miratuar nuk zbaton përcaktimet për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapsira publike. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore 1/180, referuar dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Elbasan, KSHR = 8% dhe KSHP = 8%, në këtë leje nuk ka asnjë parashikim për plotësimin e këtyre dy treguesve të zhvillimit.

8. Tipologjia e objektit të miratuar nuk është në përputhje me përdorimin e lejuar të tokës për njësinë strukturore. Nga pasaporta e njësisë strukturore 1/180, pjesë e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Elbasan, marrim informacionin se kjo njësi i përket sistemit urban (UB), kategori banim (85%) dhe shërbime(15%). Në të janë të lejuara ndërtimet e infrastrukturës, natyrorë, ujëra dhe struktura në shërbim të bujqësisë. Referuar informacionit të marrë nga projekti ndërtimor, konstatohet se objekti i miratuar është një kabanon me funksion shërbim për magazinimin dhe shitjen e lëndëve të drurit dhe derivateve të tij, si dhe ofrimin e shërbimeve në fushën e mobilerisë (informacion i marrë nga relacioni arkitektonik). Nga sa më sipër cituar, shprehemi se tipologjia e objektit të miratuar nuk është në përputhje me përdorimin e lejuar të tokës për njësinë strukturore, pasi objektet e tipologjisë kabanon me funksion magazinimin, shitjen e lëndëve të drurit dhe derivateve të tij, si dhe ofrimin e shërbimeve në fushën e mobilerisë, nuk janë të listuara në përdorimet e lejuara sipas pasaportës së njësisë strukturore, nuk janë të listuara në Shtojcën 3 "Tabela e sistemeve" të VKM-së nr. 671, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit". Gjithashtu, në Nenin 2.2.7 të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Elbasan, përcaktohen se cilat janë tipologjitë e objekteve të cilat kategorizohen si shërbime, më konkretisht "objekte tregëtare, rekreative, restorante e bare". Miratimi i këtij objekti në njësinë strukturore 1/180 është në kundërshtim me dispozitat ligjore të sipërcituara.

**Kriteri:** Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, nenet 10, 15, 21, 36 Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Elbasan, Neni 8.1.2, 8.1.3, 8.1.4.; VKM-në nr. 440, datë 03.06.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës", pika 5.

**Ndikimi/Efekti:** Mosrespektimi i parametrave urban ndikon në zhvillimin e kontrolluar urban, duke cënuar parametra të përcaktuar në legjislacion dhe rregullore, si dhe duke ndikuar negativisht në standartet ndërtimore, kushtet e sigurisë, higjenës, ato mjedisore dhe urbanistike.

**Shkaku:** Mosrespektim i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi nga ana e funksionarëve të Bashkisë Elbasan.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Nga Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (SPZHT), Bashkia Elbasan të merren masa për respektimin e distancave dhe kondicioneve urbane sipas përcaktimeve ligjore dhe rregullatorë në fuqi, për shqyrtimin e vetëm atyre aplikimeve që kanë informacion të saktë në dokumentacionin shoqëruar, si dhe për të kërkuar në çdo rast evidentimin e përcaktimeve për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapsira publike.

*Për miratimin e lejes së ndërtimit me Vendim nr. 2369/6 prot., datë 25.08.2022, si dhe vlerësimit pozitiv të praktikës, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi: znj. A.M, në funksionin e drejtorit të DPZHSTS; znj. K.Q, në funksionin e përgjegjëses së SKL pranë DPZHSTS; z. M.M, në funksionin e specialistit pranë DPZHSTS; znj. M.P, në funksionin e juristes pranë DPZHSTS. Gjithashtu, në zbatim të Ligjit 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Neni 29, pika a), për vendimmarrjen e jashtëligjshme lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Elbasan, ngarkohet me përgjegjësi: z. G.LL, në funksionin e Kryetarit të Bashkisë Elbasan.*

Në observacionin e subjektit të audituar Bashkia Elbasan mbi Akt konstatimin nr.11 dërguar me shkresën nr. 4474/44 prot., dt. 22.11.2023 dhe me nr. 767/4 prot., (i KLSH) dt. 30.11.2023, shprehur si më poshtë vijon:

**Pretendimi i subjektit:** Observacion për Nr. regjistri elektronik 2369, në emër të zhvilluesit z.A.H, me vendim miratimi më datë 25.08.2022, me nr. çështje në sistemin "e-lejet" AN190220220018, për objektin "Godinë shërbimi 1 kat", punonjësit A.M, K.Q, M.M, M.P,

dhe Kryetar G.LL. Sipas raportit të Vlerësimit Teknik Pozitiv nga Zyra e Zhvillimit të Tokës, pranë DPZHT-së, hartuar nga M.M, M.P, K.Q, A.M, objekti 1 kat, me pronar dhe zhvillues A.H, referuar Planit të Përgjithshëm Vendor, miratuar me Vendim nr. 1 të Këshillit Kombëtar të Territorit, pjesë e Njësisë Strukturore 1/180, për të cilën sipas pasaportës me nr. 91, së kësaj njësie NUK KA KUSHT PËR HARTIMIN E PLANIT TË DETAJUAR VENDOR, sipas pikës 2 të Rregullores së PPV Elbasan, faqe 4-5, pika 2.1.2 Përveç termave të legjislacionit, termat e tjerë të përdorur në këtë rregullore kanë kuptimet e mëposhtme: “Të paaplikueshme (PA)” janë treguesit e zhvillimit për të cilët nuk jepen vlera në rregullore, pasi nuk janë të aplikueshëm për rastin në fjalë. Mbështetur në ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 686, datë 22.11.2017, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 58, Rregullorja e Planit, si dhe Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Elbasan, miratuar me vendim KKT nr. 1, datë 29.12.2016, “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Elbasan”, aplikimi shqyrtohet në zbatim të kushteve që përcakton dokumenti i miratuar i PPV, sipas pasaportës përkatëse për kushtet e zhvillimit. Konkretisht, pasaporta për këtë Njësi Strukturore 1/180 nuk kërkon Plan të Detajuar Vendor (PDV), pra është PA (i paaplikueshëm).

**Për pikën 1** :Kjo leje është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 83 ditësh pune, pasi Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit ka qenë me mungesë stafi, gjë që sjell rritjen e fluksit të punës dhe vonesa në shqyrtimin e procedurave.

**Qëndrimi i grupit të auditimit**: Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se janë shkelur kështu përcaktimet ligjore të Nenit 20 dhe 21 të **VKM-së 408/2015** “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar, si dhe Nenin 44, pika 2, të **Ligjit 107/2014** “Për planifikimin dhe zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar. **Ky pretendim nuk merret në konsideratë.**

**Për pikën 2** :Mbështetur në VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 30, Kushtet e përgjithshme të nënndarjes së parcelave për qëllime zhvillimi, pika 1) Kushtet e përgjithshme për lejimin dhe realizimin e nënndarjes së parcelës për qëllime zhvillimi janë: nënpika a), Parcela duhet të ndodhet brenda kufijve të sistemit urban (vija e gjelbër), ose në ato pjesë të sistemit natyror dhe bujqësor që janë përcaktuar për t`u konvertuar në tokë ‘truall’ nga dokumenti i planifikimit dhe aktet përkatëse ligjore në fuqi. Si dhe sipas VKM nr. 440, datë 03.06.2020, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 410, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”, pika 5, kreu VII/1, me këtë përmbajtje: “VII/1. Kalimi i tokave të resurseve të ndryshme në kategorinë e resursit tokë urbane, truall, sipas planeve të detajuara dhe planeve të përgjithshme vendore.

Në rastet kur planet e detajuara për zona të rëndësisë kombëtare, planet e përgjithshme vendore dhe planet e detajuara vendore janë miratuar dhe botuar në regjistrin e planifikimit të territorit, subjektet e interesuara për ndryshimin e kategorive të resurseve paraqesin për regjistrim në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, të qarkut, lejen e zhvillimit ose lejen e ndërtimit. Në këto raste, resursi i tokës ndryshohet sipas lejes së zhvillimit ose lejes së ndërtimit, konform planit të përgjithshëm vendor dhe planit të detajuar vendor. Leja e zhvillimit paraqitet për çdo parcelë.”.

Pra ky status pronësie ndryshon pas pajisjes me Leje ndërtimi të objektit, kundrejt kushteve teknike ligjore, në përputhje me sistemin urban ku përfshihet në Planin e Përgjithshëm Vendor të bashkisë Elbasan.

Sipas VKM nr. 410, datë 27.6.2012, "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës", e ndryshuar, Kreu VII/1. "Kalimi i tokave të resurseve të ndryshme në kategorinë e resursit tokë urbane, truall, sipas Planeve të Detajuara dhe Planeve të Përgjithshme Vendore, në rastet kur planet e detajuara për zona të rëndësisë kombëtare, planet e përgjithshme vendore dhe planet e detajuara vendore janë miratuar dhe botuar në regjistrin e planifikimit të territorit, subjektet e interesuara për ndryshimin e kategorive të resurseve

paraqesin për regjistrim në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, të qarkut, lejen e zhvillimit ose lejen e ndërtimit. Në këto raste, resursi i tokës ndryshohet sipas lejes së zhvillimit ose lejes së ndërtimit, konform planit të përgjithshëm vendor dhe planit të detajuar vendor. Leja e zhvillimit paraqitet për çdo parcelë.”

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se Nuk është kërkuar ose respektuar mendimi i autoriteteve që duhet të shprehen në lidhje me lejet e ndërtimit, pasi: - Nuk është respektuar mendimin dhe kërkesat e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, - Nuk është kërkuar mendimi i Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT). - Nuk është kërkuar mendimi i Autoritetit Rrugor Shqipëtar (ARRSH). **Ky pretendim nuk merret në konsideratë.**

**Për pikën 3:** Nuk është kërkuar projekti i instalimeve të ngrohje-ftohjes pasi referuar projektit arkitektonik nuk do të ketë një instalim të tillë dhe ajrimi do të bëhet në mënyrë natyrale me anë të dritareve.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se Mungon projekti për instalimet e ngrohje – ftohjes dhe ventilimit (H-VAC), së bashku me dokumentacionin shoqërues, relacionin, vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, licencat profesionale, preventivin e punimeve, si dhe policën dhe deklaratën e përgjegjësisë profesionale. **ky pretendim nuk merret në konsideratë.**

**Për pikën 4 :** Nuk janë ngarkuar ekstraktet e QKB-së pasi specialisti mund ta kontrollojë vetë ne faqen zyrtare ne internet për cdo ekstrakt të cdo biznesi të regjistruar. E njëjta gjë ndodh dhe me licencat e projektimit e individëve apo të shoqërive pasi janë të gjitha të regjistruara, të cilat verifikohen online nga specialist përgjegjës për shqyrtimin e dosjes. Përsa i përket policës së sigurimit të inxhinierit konstruktor ajo është e ngarkuar në sistem në grupin e dokumenteve të projektit arkitektonik (konkretisht polica e inxh.R.B ). Gjithashtu Bashkia Elbasan disponon licencën e projektimit të inxh.R.B pasi ndeshet shpesh me projekte të hartuara prej tij.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se Mungojnë vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe/ose ekstrakti historik i subjekteve që kanë hartuar projektin konstruktiv, elektrik dhe raportin e auditimit të efikasitetit energjitike.

- Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e projektit konstruktiv, Gjithashtu, sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e raportit të auditimit të efikasitetit energjitike është jashtë periudhës së mbulimit, pasi kjo policë është e vlefshme për periudhën 26.01.2021-25.01.2022, ndërsa aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është bërë në datën 19.02.2022. **ky pretendim nuk merret në konsideratë.**

**Për pikën 5 :**Objekti e respekton distancën nga kufiri i pronës pasi në dokumentacionin e ngarkuar është deklarata noteriale me nr.5801 REP dhe 3250 KOL datë 28/10/2021 ku shprehet dakordësia me kufitarin e anës lindore për të ndërtuar me faqe kallkan dhe në afërsinë prej 1 m nga njëri tjetri. Në këtë mënyrë distanca prej 0.8 m e objektit nga kufiri i tij i pronës është në përputhje me VKM 408/2015, e ndryshuar.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se Nga këqyrja e projektit ndërtimor, më konkretisht projektit arkitektonik dhe planit të vendosjes së miratuar, konstatohet se objekti i miratuar nuk respekton distancat urbane nga kufiri i pronës në fasadë lindore të objektit sipas përcaktimeve të Nenin 34 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, pika 4. Distanca e miratuar e ndërtesës nga kufiri i pronës është 0.8 m (fasada lindore është kallkan), ndërsa distanca minimale e lejuar sipas dispozitave ligjore është 1 m. Respektimi i kësaj distance është kërkuar në lejen e zhvillimit, në seksionin “*Kushte të veçanta*”, por, edhe pse në këto kushte, Bashkia Elbasan ka vazhduar me miratimin e lejes së ndërtimit në shkelje të distancave urbane nga kufiri i pronës. **ky pretendim nuk merret në konsideratë.**

**Për pikën 6 :** Referuar Planit të Përgjithshëm Vendor, miratuar me Vendim nr. 1 të Këshillit Kombëtar të Territorit, pjesë e Njesisë Strukturore 1/180, për të cilën sipas pasaportës me nr. 91, së kësaj njësie NUK KA KUSHT PËR HARTIMIN E PLANIT TË DETAJUAR VENDOR, AS

PËR PLAN RRUGOR, sipas pikës 2 të Rregullores së PPV Elbasan, faqe 4-5, pika 2.1.2 Përveç termave të legjislacionit, termat e tjerë të përdorur në këtë rregullore kanë kuptimet e mëposhtme: “Të paaplikueshme (PA)” janë treguesit e zhvillimit për të cilët nuk jepen vlera në rregullore, pasi nuk janë të aplikueshëm për rastin në fjalë.

Mbështetur në ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 686, datë 22.11.2017, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 58, Rregullorja e Planit, si dhe Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Elbasan, miratuar me vendim KKT nr. 1, datë 29.12.2016, “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Elbasan”, aplikimi shqyrtohet në zbatim të kushteve që përcakton dokumenti i miratuar i PPV, sipas pasaportës përkatëse për kushtet e zhvillimit. Konkretisht, pasaporta për këtë Njësi Strukturore 1/180 nuk kërkon Plan të Detajuar Vendor (PDV), as Plan Rrugor pra është PA (i paaplikueshëm).

Aksesimi në faqen e Regjistrisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, rubrika "Planifikimi", kategoria “Plane të Përgjithshme Vendore”, "Bashkia Elbasan" për të parë Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas "PPV Fillestare", klikohet "Rregullorja", faqe 105, e cila është sipas linkut:

<https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=3768&token=026c679bbbbaa7fc9a7d8bdaffd7c04c95f1fa626>

The screenshot shows a web browser displaying a table of planning documents. The table has several columns, including 'Kategoria', 'Titulli', 'Lloji', 'Data', and 'Statusi'. The table contains multiple rows of data, with some cells containing text and others containing links or icons. The browser's address bar shows the URL: https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=3768&token=026c679bbbbaa7fc9a7d8bdaffd7c04c95f1fa626.

8bdaffd7c04c95f1fa626 .

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se Objektet të cilat zhvillohen buzë rrugëve, gëzojnë të drejtën e respektimit të vijës së ndërtimit, pavarësisht nëse respektohet ose jo distanca midis ndërtesave. Për njësinë strukturore në të cilën zhvillohet objekti, nuk ka një plan të detajuar vendor të miratuar. Në sistemin *e-lejet* nuk u gjet asnjë studim pjesor mbi sistemin rrugor dhe përcaktimin e vijave të ndërtimit për njësinë strukturore në fjalë. Gjithashtu, në dokumentat e ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, nuk identifikohet i plotë trupi i rrugës, pra gjerësia e tij. Objekti është zhvilluar sipas disa vijave të ndërtimit, të cilat nuk janë të miratura, rrjedhimisht, nuk mund të shprehemi nëse objekti respekton distancat nga trupi i rrugës ose jo. Për këtë rrugë nuk jepet informacion se nën juridiksionin e kujt autoriteti është, Autoritetit Rrugor Shqipëtar apo Bashkisë Elbasan. **Ky pretendim nuk merret në konsideratë.**

**Për pikën 7 :** Sipas pikës 8, të Rregullores së PPV-së, miratuar me Vendim KKT nr. 1, datë 29.12.2016, Rregullat për çdo zonë e njësi strukturore, pika 8.1.2 Koeficienti i shfrytëzimit të tokës për rrugë (Kshr), sipas rregullores së planifikimit të territorit të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, është raporti midis sipërfaqes së gjurmës që do të zënë rrugët në një njësi ose zonë dhe sipërfaqes bruto të njësisë/zonës.

Pika 8.1.3, në vijim, Për llogaritjen e Kshr-së në këtë rregullore përfshihen në formulë të gjitha sipërfaqet rrugore që ndodhen brenda kufirit të njësisë strukturore, pavarësisht kategorisë së rrugës sipas Kodit rrugor, apo funksionalitetit të saj. Përsa kohë nuk ka kusht hartimin e Planit të Detajuar Vendor, as hartimin e Planit Rrugor, ka një koeficient ekzistues që vjen si pasojë e shqyrtimit të njësisë/zonës, tashmë të miratuar me Dokumentin e planifikimit (PPV), Vendim KKT nr. 1, datë 29.12.2016, për Kshr = 8%, pra sipas pasaportës së Njësisë Strukturore 1/180 nga PPV e miratuar. Pika 8.1.4, e Rregullores, shpreh se, Koeficienti i shfrytëzimit të tokës për hapësira publike (Kshp) është raporti i sipërfaqes së hapësirave publike për njësi/zonë me sipërfaqen bruto të njësisë/zonës.

Kshp-ja paraqitet në % dhe përcaktohet për njësi/zonë në dokumentin e planifikimit. Zbatimi i Kshp-së është përgjegjësi e bashkisë dhe realizohet në nivel njësie strukturore. Konkretisht, sipas ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 3, pika 9, “Dokumente të planifikimit” janë dokumente zyrtare të planifikimit që hartohen dhe zbatohen në territor, në nivel qendror dhe vendor, në përputhje me nenin 16 të këtij [...], neni 16, Planit i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit. Sqarojmë se, sipas PPV, Pasaporta e Njesisë Strukturore 1/180 shpreh Kshp = 8%, pra Njësia Strukturore, përse kohë nuk ka kusht hartimin e Planit të Detajuar Vendor, as hartimin e Planit Rrugor, ka një koeficient ekzistues që vjen si pasojë e shqyrtimit të njesisë/zonës, tashmë të miratuar me Dokumentin e planifikimit (PPV), Vendim KKT nr. 1, datë 29.12.2016.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se Objekti i miratuar nuk zbaton përcaktimet për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapsira publike. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore 1/180, referuar dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Elbasan, KSHR = 8% dhe KSHP = 8%, në këtë leje nuk ka asnjë parashikim për plotësimin e këtyre dy treguesve të zhvillimit. **Ky pretendim nuk merret në konsideratë.**

**Për pikën 8 :** Objekti propozohet për përdorim në kategorinë shërbime me funksion magazinim dhe shitjen e lëndëve të drurit në funksion të biznesit të mobilierive, përdorim i cili është në përputhje me PPV-në sipas kategorisë shërbime.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se Tipologjia e objektit të miratuar nuk është në përputhje me përdorimin e lejuar të tokës për njësinë strukturore. Nga pasaporta e njesisë strukturore 1/180, pjesë e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Elbasan, marrim informacionin se kjo njësi i përket sistemit urban (UB), kategori banim (85%) dhe shërbime(15%). Në të janë të lejuara ndërtimet e infrastrukturës, natyrorë, ujëra dhe struktura në shërbim të bujqësisë. Referuar informacionit të marrë nga projekti ndërtimor, konstatohet se objekti i miratuar është një kapanon me funksion shërbim për magazinimin dhe shitjen e lëndëve të drurit dhe derivateve të tij, si dhe ofrimin e shërbimeve në fushën e mobilerisë (informacion i marrë nga relacioni arkitektonik). Nga sa më sipër cituar, shprehemi se tipologjia e objektit të miratuar nuk është në përputhje me përdorimin e lejuar të tokës për njësinë strukturore, pasi objektet e tipologjisë kapanon me funksion magazinimin, shitjen e lëndëve të drurit dhe derivateve të tij, si dhe ofrimin e shërbimeve në fushën e mobilerisë, nuk janë të listuara në përdorimet e lejuara sipas pasaportës së njesisë strukturore, nuk janë të listuara në Shtojcën 3 “*Tabela e sistemeve*” të VKM-së nr. 671, datë 29.07.2015 “*Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit*”. Gjithashtu, në Nenin 2.2.7 të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Elbasan, përcaktohen se cilat janë tipologjitë e objekteve të cilat kategorizohen si shërbime, më konkretisht “*objekte tregëtare, rekreative, restorante e bare*”. Miratimi i këtij objekti në njësinë strukturore 1/180 është në kundërshtim me dispozitat ligjore të sipërcituara. **Ky pretendim nuk merret në konsideratë.**

**Titulli gjetjes:** *Mosrespektimi i kondicioneve urbane.*

**Situata** Nga auditimi i procedurës së miratimit të “Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250m<sup>2</sup>”, me nr. AN131020220037, për të cilën është marrë vendimi për miratim **Nr. 2769/5 Prot; datë 07.12.2022**, të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, për objektin “**Prishje e objektit ekzistues dhe ndërtim i objektit me 4, 6, 8, 10, 11 dhe 12 kat me 2 kate parkim nëntokë**”, me adresë në lagjen “Dyli Haxhire”, Bashkia Elbasan, me subjekt zhvillues z. D.S, u konstatua si më poshtë:

**1. Dokumentacioni shoqërues për projektin ndërtimor nuk është i plotë, pasi:**

- Mungojnë vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe/ose ekstrakti historik i subjekteve që kanë hartuar projektin arkitektonik, konstruktiv, elektrik, raportin e auditimit të efikasitetit energjetic, studimin sismik, studimin gjeologjik dhe rilevimin topografik.

- Mungon licenca profesionale personale e hartuesit të studimit sismik, Për këtë studim, është ngarkuar licenca e subjektit N. ShPK, ku znj. E.V figuron në rolin e drejtueses teknike (informacion i marrë nga licenca profesionale e subjektit), por ky fakt nuk vërteton se znj. E.V është e licencuar për kryerjen e studimeve sismike.

**2. Nuk është respektuar kushti për infrastrukturën, përcaktuar në lejen e zhvillimit.** Referuar dokumentit të lejes së zhvillimit, me nr. 2550/2 prot; datë 30.09.2022, pika 6 “Kushte të veçanta”, nën-pika 3, ku përcaktohet se “Bazuar në Nenin nr.45 ‘Kushti për infrastrukturën’, Ligji nr.107/2014 ‘Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit’, në aplikimin për lejen e ndërtimit të ngarkohet në sistemin e-leje marrëveshja midis Bashkisë Elbasan dhe subjektit zhvillues për sistemin dhe përmirsimin e infrastrukturës në hapësirën urbane ku do të kryhet zhvillimi.”, si dhe referuar auditimit të dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, shprehem se nuk është respektuar dispozita ligjore e sipërcituar.

**3. Objekti nuk respekton përcaktimet ligjore të Vendimit nr.457, datë 29.6.2022.** Referuar Vendimit nr.457, datë 29.6.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 408, datë 13.05.2015, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, të ndryshuar’”, Neni 13, ku kërkohet dorëzimi i projektit ndërtimor në formatin DËG. Një dokument i tillë nuk u gjet në procedurën e aplikimit.

**4. Objekti i miratuar nuk zbaton përcaktimet ligjore në lidhje me kontributin e sektorit privat ndaj fondit publik të banesave sociale.** Që prej hyrjes në fuqi të Ligjit 22/2018 “Për strehim social”, datë 03.05.2018, çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2000 m<sup>2</sup>, siguron kalimin pa shpërbllim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Në procedurën e miratimit të lejes së ndërtimit të marrë nën shqyrtim, nuk u gjet asnjë kontratë që të vërtetojë parashikimin e kësaj sipërfaqeje në favor të fondit publik të banesave sociale. Gjithashtu, në dokumentin e lejes së zhvillimit dhe ndërtimit nuk ka asnjë përcaktim për vendosjen në dijeni të subjektit zhvillues mbi detyrimin që ky subjekt ka ndaj fondit publik të banesave sociale. Nga përlloraritja e grupit të auditimit, sipërfaqja takuese si kontribut i sektorit privat ndaj fondit publik të banesave sociale, rezulton të jetë 5564.32 m<sup>2</sup> (sip. banim) \* 0.03 = **166.93 m<sup>2</sup>**. Bashkia Elbasan ka lidhur një akt marrëveshje me subjektin zhvillues prej 91.3 m<sup>2</sup> me diferenc 75.63 m<sup>2</sup> (166.91-91.3) banim në favor të Bashkisë Elbasan.

**5. Objekti i miratuar nuk zbaton përcaktimet për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapësira publike.** Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore 1/27, marrim informacionin se koeficienti i shfrytëzimit të territorit për rrugë KSHR është 22% dhe koeficienti i shfrytëzimit të territorit për hapësira publike KSHP është 15%. Në këtë procedurë të miratimit të lejes së ndërtimit nuk ka asnjë parashikim për plotësimin e këtyre dy treguesve të zhvillimit.

**6. Parcela dhe njësia strukturore nuk kualifikohen si njësi të urbanizuara në proces konsolidimi.** Nga informacioni i marrë nga dokumenti i lejes së zhvillimit, marrim informacionin se respektimi i kondicioneve urbane, më konkretisht, respektimi i distancave urbane ndërtesë – ndërtesë, është bërë konform përcaktimeve të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, e ndryshuar, Neni 34, pika 3, ku përcaktohet se “Në nën-njësitë strukturore të urbanizuara, në proces konsolidimi urban, distanca minimale midis faqeve që shohin njëra-tjetrën, të dy strukturave që qëndrojnë përballë njëra-tjetrës është 10 (dhjetë) metra dhe jo më pak se 5 (pesë) metra nga kufiri i pronës, pavarësisht numrit të kateve. Kjo distancë aplikohet kur të paktën njëra nga faqet është me dritare ose çarje të çfarëdo lloji ose të dyja faqet janë me dritare dhe/ose çarje të llojeve të ndryshme. Kjo distancë aplikohet kur midis



dy faqeve të dy ndërtesave nuk ka rrugë, në të kundërt distanca është në përputhje me përcaktimin e nenit 36”.

Referuar kësaj VKM-je, në Nenin 2 të saj, pika 10/3, marrim informacionin se: “Konsolidim urban” është procesi i densifikimit dhe i mbushjes urbane të njësisë strukturore apo të një a më shumë pjesëve të saj, të cilat janë të zhvilluara në mënyrë homogjene, sa u përket kushteve të zhvillimit, ndërtimeve në territor, si dhe rrjetit rrugor e infrastrukturor...

Referuar dokumentit të Planit të Detajuar Vendor për njësinë strukturore 1/27, miratuar me vendim nr. 01, datë 28.12.2018 të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, pika 10 “Mënyrat e ndërhyrjes në njësinë strukturore”, marrim informacionin se zona nuk është homogjene dhe se fokusi i zhvillimit të saj do të jetë ndërtimi dhe rihvillimi, dhe jo konsolidimi urban.

Duke marrë në shqyrtim të gjitha përcaktimet e mësipërme, konstatohet se parcela dhe njësia strukturore nuk kualifikohen si njësi të urbanizuara në proces konsolidimi, pasi konsolidimi urban është një mënyrë ndërhyrje në territor, e cila është e vlefshme vetëm kur njësia është e zhvilluar në mënyrë homogjene; nga dokumenti i PDV-së marrim informacionin se zhvillimi i kësaj njësie strukturore nuk është homogjen dhe se fokusi i zhvillimit të saj do të jetë ndërtimi dhe rihvillimi, dhe jo konsolidimi urban. Si rrjedhojë, ky objekt do të duhej të respektonte distancat urbane nga ndërtimet e tjera sipas Nenit 34 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, e ndryshuar, pra  $d = nr.k \text{ obj.A} + nr.k \text{ obj.B} + 2m$ , dhe distancat urbane nga kufiri i pronës sipas Nenit 35 të kësaj VKM-je, pra  $d = nr.k + 1m$ . Si përfundim, shprehemi se objekti i miratuar nuk respekton distancat urbane nga kufiri i pronës dhe nga ndërtimet e tjera.

**Kriteri: Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit** me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), nr. 01, datë 29.12.2016, i rishikuar, në kundërshtim me **Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 408, datë 13.5.2015**, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, **Ligjin 22/2018 “Për strehim social”**, datë 03.05.2018, si dhe në kundërshtim me **Ligjin 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”**.

**Ndikimi/Efekti:** Mosrespektimi i parametrave urban ndikon në zhvillimin e kontrolluar urban, duke cënuar parametra të përcaktuar në legjislacion dhe rregullore, si dhe duke ndikuar negativisht në standartet ndërtimore, kushtet e sigurisë, higjenës, ato mjedisore dhe urbanistike.

**Shkaku:** Mosrespektim i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi nga ana e funksionarëve të Bashkisë Elbasan.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (SPZHT), Bashkia Elbasan të merren të gjitha masat për të kërkuar, në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi, të gjithë dokumentacion e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi, si dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi me mangësi të tilla. SPZHT duhet të kërkojë në çdo rast dokumentacionin që vërteton statusin aktiv dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) të subjekteve që kanë hartuar projektin ndërtimor. SPZHT dhe Bashkia Elbasan të marrin masa për të kontrolluar të gjithë dokumentacionin e dorëzuar mbi saktësinë dhe plotësinë e tij, me qëllim marrjen e të gjithë informacionit të nevojshëm mbi objektin në zhvillim, duke respektuar gjithashtu afatet e përcaktuara në ligj për shqyrtimin e aplikimeve. SPZHT

**Rekomandim:** Drejtorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të marrë të gjitha masat e nevojshme për lidhjen e një Akt-marrëveshjeve me subjektet zhvillues “Z. D.S”, për kalimin e sipërfaqes totale prej 75.63 m<sup>2</sup> (166.91-91.3) banim në favor të Bashkisë Elbasan.

*Për miratimin e lejes së ndërtimit me Vendim nr. 2769/5 prot; datë 07.12.2022, si dhe vlerësimin pozitiv të praktikës, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi: znj. A.M, në funksionin e drejtorit të DPZHTS; z. M.M, në funksionin e kontrolluesit të SKL pranë DPZHTS; z. K.H, në funksionin e specialistit të SKL pranë DPZHTS; znj. M.P, në*

funksionin e juristes pranë DPZHTS. Gjithashtu, në zbatim të **Ligjit 107/2014**, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Neni 29, pika a), për vendimmarrjen e jashtëligjshme lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Elbasan, ngarkohet me përgjegjësi: z. **G.LL**, në funksionin e Kryetarit të Bashkisë Elbasan.

Në observacionin e subjektit të audituar Bashkia Elbasan mbi Akt konstatimin nr.11 dërguar me shkresën nr. 4474/44 prot., dt. 22.11.2023 dhe me nr. 767/4 prot., (i KLSH) dt. 30.11.2023, shprehur si më poshtë vijon:

**Pretendimi i subjektit:** Observacion për nr. regjistri elektronik 2769, në emër të zhvilluesit z. D.S, me vendim miratimi me Nr. 2769/5 prot., date 07.12.2022, AN190220220018, për objektin “Prishje e objektit ekzistues dhe ndërtim i objektit me 4, 6, 8, 10, 11 dhe 12 kat me 2 kate parkim nëntokë”, punonjësit A.M, K.H, M.M M.P, dhe Kryetar G.LL.

**Për pikën 1 :**Për çdo aplikim ne sistem, specialsiti verifikon më vete çdo regjistrim në QKB në faqen zyrtare të internetit për çdo projektues apo ëdo licensë shoqërie. Gjatë verifikimit, rezulton se çdo projektues është i regjistruar si biznes. Në lidhje me licencën profesionale të studimit sizmiologjik, theksohet se Shoqëria “N. C. 2012” ka license aktive për studime të sizmiologjisë inxhinierike, dhe projektuesit që firmosin në projektin sizmik janë drejtues teknik të Shoqërisë “N. C. 2012” e cila e theksuar si më sipër, perfshihet pika për studimet sizmiologjike për objekte.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se **Dokumentacioni shoqëruar për projektin ndërtimor nuk është i plotë**, pasi: - Mungojnë vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe/ose ekstrakti historik i subjekteve që kanë hartuar projektin arkitektonik, konstruktiv, elektrik, raportin e auditimit të efikasitë energjitike, studimin sizmik, studimin gjeologjik dhe rilevimin topografik. - Mungon licenca profesionale personale e hartuesit të studimit sizmik, Për këtë studim, është ngarkuar licenca e subjektit N ShPK, ku znj. E.V figuron në rolin e drejtueses teknike (informacion i marrë nga licenca profesionale e subjektit), por ky fakt nuk vërtetohet se znj. E.V është e licencuar për kryerjen e studimeve sizmike. **Ky pretendim nuk merret në konsideratë.**

**Për pikën 2 :**Bashkia Elbasan ben kontrole te vazhdueshme ne terren me inxhinierët e rajoneve të cilët janë pjesë e drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Gjate fazes së sistemimit dhe para certifikatës së perdorimit të objektit, do të bëhet marrëveshja midis Bashkisë Elbasan dhe zhvilluesit në lidhje me kushtin për infrastrukturën. **Ky pretendim nuk merret në konsideratë.**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se **Nuk është respektuar kushti për infrastrukturën, përcaktuar në lejen e zhvillimit.** Referuar dokumentit të lejes së zhvillimit, me nr. 2550/2 prot; datë 30.09.2022, pika 6 “Kushte të veçanta”, nën-pika 3, ku përcaktohet se “Bazuar në Nenin nr.45 ‘Kushti për infrastrukturën’, Ligji nr.107/2014 ‘Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit’, në aplikimin për lejen e ndërtimit të ngarkohet në sistemin e-leje marrëveshja midis Bashkisë Elbasan dhe subjektit zhvillues për sistemin dhe përmirsimin e infrastrukturës në hapësirën urbane ku do të kryhet zhvillimi.”, si dhe referuar auditimit të dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, shprehemi se nuk është respektuar dispozita ligjore e sipërcituar. **Ky pretendim nuk merret në konsideratë.**

**Për pikën 3 :**Projekti ne format dëg nuk mund te ngarkohet ne sistemin e-Leje pasi pranohen vetem dokumeta në formatin pdf. Ne lidhje e projektin në dëg është marrë projekti në format dëg në rrugë elektronike (me email) nga ku është kontrolluar përputhshmëria e këtij formati me atë pdf, **por që referuar VKM-së datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 13, Veçori të lejes së ndërtimit, nuk shprehet për dorëzimin e projektit ndërtimor në formatin dëg.**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se **Objekti nuk respekton përcaktimet ligjore të Vendimit nr.457, datë 29.6.2022.** Referuar Vendimit nr.457, datë 29.6.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 408, datë 13.05.2015, të Këshillit

të Ministrave, 'Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, të ndryshuar' ", Neni 13, ku kërkohet dorëzimi i projektit ndërtimor në formatin DËG. Një dokument i tillë nuk u gjet në procedurën e aplikimit. **Ky pretendim nuk merret në konsideratë.**

**Për pikën 4 :** Ne lidhje me kontributin e sektorit privat ndaj fondit publik të banesave sociale, ne raportin e vleresimit teknik nr 2769/2, date 01/12/2023 është llogaritur sipërfaqja në m<sup>2</sup> që I takon bashkisë, kjo referuar Ligjit 22/2018, neni 19, ... Çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, siguron

kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t'u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, mund të jepet në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi. Kontrata që nënshkruhet mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme... Kjo sipërfaqe do të kalojë në favor të Bashkisë Elbasan në fazën e pajisjes me Certifikatë Përdorimi, edhe sipas parashikimeve të VKB-së nr. 59, datë 24.05.2021 "Për miratimin e procedurës për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale që kalojnë në pronësi të Bashkisë Elbasan, nga ndërtimet e reja", pika 1.7 ku thuhet se: "Në rast se sipërfaqet takuese në favor të Bashkisë Elbasan, sipas parashikimeve të këtij vendimi, nuk mund të përbëjnë, për shkak të sipërfaqes, një ambient banimi referuar VKM-së nr. 626, datë 15.07.2015, "Për miratimin e normativave të projektimit të banesave", zhvilluesi privat e ofron atë në një objekt tjetër të tij, brenda të së njëjtës njësi administrative ku ai po zhvillon apo edhe do të konvertohet në formulën financiare përfutuese në lekë/m<sup>2</sup>, referuar çmimit të tregut miratuar nga EKB sipas vitit referues për njësinë vendore, nëse mundësitë sipas standarteve të projektimit në zbatim të kuadrit tekniko-ligjor për apartamente banimi nuk zbatohet. Vlera e përfutuar shkon në buxhetin e Bashkisë Elbasan, në programin e strehimit social. **Në rastin konkret është parashikuar** Sipas Vendimit Nr.738/5, datë 31/07/2019, pika 17, Bazuar në nenin 19 të ligjit 22/2018 "Për strehimin social", Zhvilluesi mbart detyrimin të dorëzojë Bashkisë Elbasan 3% të sipërfaqes prej 3042.32 m<sup>2</sup> (përtej sipërfaqes 2000 m<sup>2</sup> banim duke zbritur edhe sipërfaqet e përbashkëta prej 522 m<sup>2</sup>) në një sipërfaqe prej 91.3 m<sup>2</sup>. Sipas aplikimit në fjalë është sipërfaqja funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale si me poshte: Sipërfaqja totale e banimit është 5564.32 m<sup>2</sup>. Sipërfaqe e përbashkët për 11 kate (kati i parë- kati i njëmbëdhjetë) është 522 m<sup>2</sup>. Diferenca sipërfaqe totale banim minus sipërfaqe e përbashkët është = 5042.32 m<sup>2</sup>. Sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2000 metra katrorë del 3042.32 m<sup>2</sup>. Sipërfaqja funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale (3%) del = 3042.32 m<sup>2</sup> \* 0.03 = 91.3 m<sup>2</sup>.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se Objekti i miratuar nuk zbaton përcaktimet ligjore në lidhje me kontributin e sektorit privat ndaj fondit publik të banesave sociale. Që prej hyrjes në fuqi të Ligjit 22/2018 "Për strehim social", datë 03.05.2018, çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2000 m<sup>2</sup>, siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Në procedurën e miratimit të lejes së ndërtimit të marrë nën shqyrtim, nuk u gjet asnjë kontratë që të vërtetojë parashikimin e kësaj sipërfaqeje në favor të fondit publik të banesave sociale. Gjithashtu, në dokumentin e lejes së zhvillimit dhe ndërtimit nuk ka asnjë përcaktim për vendosjen në dijeni të subjektit zhvillues mbi detyrimin që ky subjekt ka ndaj fondit publik të banesave sociale. Nga përlllogaritja e grupit të auditimit, sipërfaqja takuese si kontribut i sektorit privat ndaj fondit publik të banesave sociale, rezulton të jetë 5564.32 m<sup>2</sup> (sip. banim) \* 0.03 = **166.93 m<sup>2</sup>**. Bashkia Elbasan ka lidhur një akt marrvëshje me subjektin zhvillues prej 91.3 m<sup>2</sup> me diferenc 75.63 m<sup>2</sup> (166.91-91.3) banim në favor të Bashkisë Elbasan. **Ky pretendim nuk merret në konsideratë.**

**Për pikën 5 :** Ne lidhje me percaktimet e KSHRR dhe KSHP, koeficienti shfrytëzimit të territorit është 43% dhe pjesa tejte e mbetur e territorit do të jete sheshe rekreative dhe rruge për akses në rampen e podrumit dhe në hyrjen në objekt. Pika 8.1.4, e Rregullores, shpreh se, ***Koeficienti i shfrytëzimit të tokës për hapësira publike (KSHP) është raporti i sipërfaqes së hapësirave publike për njësi/zonë me sipërfaqen bruto të njësisë/zonës. Kshp-ja paraqitet në % dhe përcaktohet për njësi/zonë në dokumentin e planifikimit. Zbatimi i Kshp-së është përgjegjësi e bashkisë dhe realizohet në nivel njësie strukturore.***

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehem se Objekti i miratuar nuk zbaton percaktimet për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapësira publike. Sipas percaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore 1/27, marrim informacionin se koeficienti i shfrytëzimit të territorit për rrugë KSHR është 22% dhe koeficienti i shfrytëzimit të territorit për hapësira publike KSHP është 15%. Në këtë procedurë të miratimit të lejes së ndërtimit nuk ka asnjë parashikim për plotësimin e këtyre dy treguesve të zhvillimit. **Ky pretendim nuk merret në konsideratë.**

**Për pikën 6 :**Në rastin konkret nuk është zbatuar pika 3, e nenit 34, e VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, ... Në nënnyesitë strukturore të urbanizuara, në proces konsolidimi urban, distanca minimale midis faqeve që shohin njëra-tjetrën, të dy strukturave që qëndrojnë përballë njëra-tjetrës është 10 (dhjetë) metra dhe jo më pak se 5 (pesë) metra nga kufiri i pronës, pavarësisht numrit të kateve. Kjo distancë aplikohet kur të paktën njëra nga faqet është me dritare ose çarje të çfarëdo lloji ose të dyja faqet janë me dritare dhe/ose çarje të llojeve të ndryshme. Kjo distancë aplikohet kur midis dy faqeve të dy ndërtesave nuk ka rrugë, në të kundërt distanca është në përputhje me percaktimin e nenit 36..., por janë rëspektuar distancat sipas parashikimeve ligjore të sipërpërmendura (nenet 34,35,36), pasi referuar PDV-së së njësisë strukturore 1/27, zona nuk është homogjene dhe zhvillimi do të jetë ndërtimi dhe rihvillimi dhe jo konsolidimi urban. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, referuar raportit teknik pozitiv nr. 2769/2, datë 01/12/2022, për objektin e propozuar ka rëspektuar distancën nga kufiri i pronës, nga objektet fqinje dhe nga sistemi rrugor duke marrë për bazë VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, nëni 34 “Distancat minimale midis ndërtimeve”, neni 35 “Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës”, si dhe neni 36 “Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe trupit të rrugës” si dhe duke marrë parasysh percaktimet e Nën-Njësisë Strukturore A3 ku bën pjesë objekti në zhvillim. Për distancat objekt-kufi prone, distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga kufiri i pronës është percaktuar si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m ( $d = nr.k + 1m$ ), ku:  $d$  – distanca minimale e ndërtimit nga kufiri i pronës dhe  $nr.k$  – numri i kateve, ndërsa për distancat objekt-objekt, distanca minimale e lejuar midis dy ndërtimeve është matur me shumën e numrit të kateve mbi tokë të ndërtimeve që përballen plus 2m, sipas formulës së mëposhtme:  $d = nr.k \text{ obj.A} + nr.k \text{ obj.B} + 2m$ , ku:  $d$  - distanca minimale midis dy ndërtimeve.  $nr.k$  - numri i kateve.”

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehem se Parcela dhe njësia strukturore nuk kualifikohen si njësi të urbanizuara në proces konsolidimi. Referuar dokumentit të Planit të Detajuar Vendor për njësinë strukturore 1/27, miratuar me vendim nr. 01, datë 28.12.2018 të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, pika 10 “Mënyrat e ndërhyrjes në njësinë strukturore”, marrim informacionin se zona nuk është homogjene dhe se fokusi i zhvillimit të saj do të jetë ndërtimi dhe rihvillimi, dhe jo konsolidimi urban.

Duke marrë në shqyrtim të gjitha percaktimet e mësipërme, konstatohet se parcela dhe njësia strukturore nuk kualifikohen si njësi të urbanizuara në proces konsolidimi, pasi konsolidimi urban është një mënyrë ndërhyrje në territor, e cila është e vlefshme vetëm kur njësia është e zhvilluar në mënyrë homogjene; nga dokumenti i PDV-së marrim informacionin se zhvillimi i kësaj njësie strukturore nuk është homogjen dhe se fokusi i zhvillimit të saj do të jetë ndërtimi dhe rihvillimi, dhe jo konsolidimi urban. **Ky pretendim nuk merret në konsideratë.**

## **Titulli gjetjes: Miratim i çertifikatës së përdorimit jo në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi.**

**Situata** Nga auditimi i procedurës së miratimit të çertifikatës së përdorimit me nr. aplikimi AN130420220009, për të cilën është marrë vendimi për miratim me nr. 2447/4 prot; datë 16.08.2022 të Kryetarit të Bashkisë Elbasan për objektin “**Objekt 3, 5 dhe 8 kat + 1 kat podrum parkim dhe prishje objektesh ekzistuese**”, me adresë në lagjen “Dyli Haxhire”, Bashkia Elbasan, paraqitur nga zhvilluesi E ShPK, u konstatua se:

**1.** Aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit nuk janë përpiluar dhe dorëzuar elektronikisht sipas përcaktimeve të **VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015**, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, Neni 27/1, pika 1. Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar elektronikisht në sistemin *e-lejet* konstatohet se akti i kontrollit “*1. Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues*” nuk ka datë. Gjithashtu, konstatohet se mungojnë “*4. Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin*”; “*5. Përfundimi i fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimet elektrike, të ngrohjes, ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik*”; “*6. Përfundimi i sistemit të jashtëm, në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturën publike ekzistuese*”.

**2.** Mungon akti përkatës i lëshuar nga institucionet kompetente për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, kjo në kundërshtim me **VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015**, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, Neni 27/2, pika 1, nënpika ë).

**3.** Mungon projekti as-built, kjo në kundërshtim me **VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015**, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, Neni 27/2, pika 1, nënpika g). Projekti as-built, duhet të ngarkohet në çdo rast kur objekti nuk ka respektuar projektin arkitektonik të miratuar.

**4.** Mungojnë licencat profesionale të shoqërisë ndërtuese, kjo në kundërshtim me **VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015**, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, Neni 27/2, pika 1, nënpika k).

**5.** Mungon kontrata midis zhvilluesit dhe mbikëqyrësit të punimeve, kjo në kundërshtim me **VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015**, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, Neni 27/2, pika 1, nënpika l).

**6.** Mungon projekti për mirëmbajtjen e objektit, i cili të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara, të gjendjes së të gjitha sistemeve përbërëse, sipas disiplinave përkatëse të zbatimit të punimeve, kjo në kundërshtim me **VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015**, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, Neni 27/2, pika 1, nënpika gj).

**7.** Projekti i zbatuar ka ndryshime nga projekti i miratuar, pasi strehat e ballkoneve në katin e shtatë, në fasadë jugore dhe lindore nuk kanë qenë të parashikuara në projektin e miratuar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Neni 42 të Ligjit 107/2014, “*Për planifikimin e zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, pika 1.

**Kriteri:** **VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015**, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, Neni 27/2 pika 1, nënpika gj, k, g, ë dhe Neni 27/1.

**Ndikimi/Efekti:** Mosrespektimi i parametrave urban ndikon në zhvillimin e kontrolluar urban, duke cënuar parametra të përcaktuar në legjislacion dhe rregullore, si dhe duke ndikuar negativisht në standartet ndërtimore, kushtet e sigurisë, higjenës, ato mjedisore dhe urbanistike.

**Shkaku:** Mosrespektim i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi nga ana e funksionarëve të Bashkisë Elbasan.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:**

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZHT), Bashkia Elbasan të merren të gjitha masat për të kërkuar, në çdo rast që aplikohet për pajisje me çertifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacion e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi, si dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi me mangësi të tilla. SPZHT duhet të kërkojë në çdo rast dokumentacionin që vërteton statusin aktiv dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) të subjekteve që kanë hartuar projektin ndërtimor. SPZHT dhe Bashkia Elbasan të marri masa për të kontrolluar të gjithë dokumentacionin e dorëzuar mbi saktësinë dhe plotësinë e tij, me qëllim marrjen e të gjithë informacionit të nevojshëm mbi objektin në zhvillim

Për miratimin e çertifikatës së përdorimit me Vendim nr. 2447/4 prot; datë 16/08/2022 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi **znj. A.M**, në funksionin e Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, **z. S.R**, në funksionin e nëpunësit pranë DPKZHT, **znj. M.P**, në funksionin e juristes pranë SUL, DPKZHT, si dhe **znj. K.Q**, në funksionin e përgjegjësës pranë SKL, DPKZHT për vlerësimin teknik pozitiv të praktikës në shkresën; ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Elbasan **z. G.LL**, në zbatim të Nenit 29, pika a) e Ligjit 107/2014 “Për planifikimin e zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, për vendimmarrjen e jashtëligjshme lidhur me aplikimin për pajisje me çertifikatë përdorimi në territorin administrativ të Bashkisë Elbasan.

Në observacionin e subjektit të audituar Bashkia Elbasan mbi Akt konstatimin nr.11 dërguar me shkresën nr. 4474/44 prot., dt. 22.11.2023 dhe me nr. 767/4 prot., (i KLSH) dt. 30.11.2023, shprehur si më poshtë vijon:

**Pretendimi i subjektit: Observacion për nr. regjistri elektronik 2447, në emër të zhvilluesit “ E “ sh.p.k., me vendim miratimi me Nr. 2447/4 prot., date 16.08.2022, për objektin “Objekt 3, 5 dhe 8 kat + 1 kat podrum parkim dhe prishje objekteve ekzistuese”, punonjësit A.M, S.R, K.Q, M.P, dhe Kryetar G.LL.**

**Për pikën 1 :** Janë depozituar 15 akte kontrolli të ndërtimit të objektit në faza të ndryshme, të konfirmuara nga inxhinieri i rajonit nr 3 të Bashkisë Elbasan.

**Ketu jane te perfshire edhe aktet e kontrollit për fazat:**

Piketimin në kuotën 0.00 të datës 25.07.2020 , (para hapjes gropes së ndërtimit)

Përfundimin e kuotës 0.00 të datës 20.08.2020.

Përfundim karabinaje, të dates 15.01.2021.

Përfundim total + sistem territori 15.10.2021.

**Për pikën 2 :** Është depozituar në sistemin e -leje , për aplikimin nr. 2447 datë 13.04.2022, dokumenti i Drejtorisë se PMNZSH Elbasan për këtë objekt , me titull “Çertifikate për sigurinë nga zjarri “, me nr. prot 278/1 date 11.10.2021.

**Për pikën 3 :**

Nuk ka projekt as-built, pasi projekti arkitektonik i miratuar është i njëjtë me projektin arkitektonik të zbatuar (nuk ka ndryshime nga projekti i miratuar, që të mund të kishte një projekt as-build (siç është ndërtuar në fakt). Strehat ne soleten e tarraces janë për mbrotjen e ballkoneve në katin e fundit të 8 (tetë) nga shiu, dhe nuk cënojnë projektin arkitektonik të objektit.

**Për pikën 4 :**

Licenca e shoqërisë “E ” me nr. NZ 107/6 është depozituar në sistem në aplikimin për njoftimin për fillimin e punimeve, të miratuar me nr. 1018.9 datë 09.06.2020. Në aplikimin e ri nr. 2447, është depozituar ekstrakti i QKR i subjektit “ E “ , që në këtë rast është njëkohësisht zhvillues dhe subjekt ndërtues zbatues. Licenca është shkarkuar nga sistemi e-leje, dhe bashkëngjitet dokumentacionit për çertifikatë përdorimi.

**Për pikën 5 :** Kontrata e zhvilluesit me mbikqyrësin e datës 02.06.2020, në prani të noterit K.K , është depozituar në sistem në aplikimin për njoftimin për fillimin e punimeve, të miratuar me nr. 1018/ 9, datë 09.06.2020. Në aplikimin për Çertifikatë Përdorimi Nr. 2447 , është depozituar edhe vërtetimi taksave të mbikqyrësit dhe raporti përfundimtar i mbikqyrësit për përfundimin e objektit. Kontrata e mbikqyrësit është shkarkuar nga sistemi e-leje dhe i bashkangjitet dokumentacionit për certifikatë përdorimi.

**Për pikat 6 dhe 7 :** Projekti i mirëmbajtjes periodike nuk është i veçantë, por përfshihet në projektin e plotë arktiktekonik dhe të rrjeteve përkatëse të instalimeve të objektit. Nuk ka project as-built , pasi projekti arkitektonik i miratuar është i njëjtë me projektin arkitektonik të zbatuar. Strehat në soletën e tarracës janë për mbrotjen e ballkoneve në katin e fundit të 8 nga shiu dhe nuk çenojnë projektin arkitektonik të objektit. Bashkalidhur Observacionit janë dhe dokumentacionet vertetues .

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Ky observacion do të meret në konsiderat referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion.

## 6 Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore.

Referuar Strukturës organizative e Bashkisë Elbasan për vitin 2022 dhe informacionit të kërkuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Teknologjisë dhe inovacionit/Spektori i Personelit, në lidhje me organizimin e Inspektoratit Mbrojtjes të Territorit Vendor, është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”i ndryshuar. Në vitin 2022 struktura e IMTV ka në përbërje 9 pozicione pune, nga të cilët **1** Kryeinspektor dhe **8** inspektorë si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Arsimi	Emëruar	Larguar	Gjendja 31.12.2022
	L K	Kryeinspektor		01.01.2020	31.12.2020	
	F M	Kryeinspektor		01.01.2021	05.12.2021	
1.	O D	Kryeinspektor	Drejtësi /Master	Urdhri nr. 1221 dt. 06.12.2021	Urdhri nr.686 dt.23.06.2022	
2.	A Z	Kryeinspektor Urdhri nr.699 dt. 27.06.2022	Administrim Biznesi/Master	Urdhri nr. 253 dt. 17.03.2021	Urdhri nr. 300 dt. 30.01.2023	√
3.	H T	Inspektor/juriste	Juridik/4 vjeçar	Urdhri nr. 90 dt. 22.02.2008	Urdhri nr. 1202 dt. 10.11.2022	
4.	A D	--/	Drejtësi/ Master e drejtë penale	Urdhri nr. 1103 dt. 30.05.2019		√
5.	E B	--/	Biologji-Kimi /Master mbrojtje mjedisi	Urdhri nr. 24 dt. 08.01.2019		√
6.	A L	--/	Drejtësi /Master	Urdhri nr. 252 dt.17.03.2021	Urdhri nr. 903 dt.10.08.2022	
7.	U Q	--/	Juridik /Master	Urdhri nr. 67 dt. 20.01.2022		√
8.	E B	--/	Ekonomiks/Master ekonomi dhe e drejta	Urdhri nr. 462 dt. 16.06.2021	Urdhri nr. 1033 dt. 23.02.2023	√
9	D Z	--/	Psikologji/Master psikologji në institucione	Urdhri nr. 303 dt. 24.03.2021		√
10	M L	--/	Financë-Kontabilitet/ 4 vjeçar	Urdhri nr. 595 dt. 09.05.2022		√
<b>Struktura 1+8</b>				<b>10 inspektor maj -qershor</b>		<b>7</b>

▪ Për periudhën objekt auditim 01.01.2022 deri 31.12.2022, IMTV është drejtuar nga Kryeinspektor O.D , e cila rezulton me profil arsimor “Drejtësi”/ niveli Master profesional, dhe nga data e largimit 22.06.2022 e në vijim, në detyrën e kryeinspektorit me Urdhër nr. 699 datë 27.06.2022 është komanduar Inspektori A.Z me profil arsimor “Administrim Biznesi”/ niveli Master;

Numri në strukturë	Inxhinieri	Juridik	Ekonomi/financë	Të ndryshme
9	0	5	3	2

Punoi: Grupi i auditimit

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën e mësipërme, rezulton se nga Inspektorët që kanë punuar dhe punojnë gjatë kësaj periudhe vetëm **5** (dy) prej tyre plotësojnë kriteret konform kërkesave ligjore për të ushtruar funksionet e Inspektorit të IMTV: O. D kryeinspektor (I), H. O, A. D, A. L, U. Q; ndërsa **5** (gjashtë) inspektorët e tjerë përfshirë dhe kryeinspektorin (II) nuk plotësojnë kriteret.

Për sa më sipër, **konstatohet** se në IMTV Bashkia Elbasan, para dhe përgjatë periudhës objekt auditimi, është punësuar staf në kundërshtim me nenin 11 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”i ndryshuar i cili përcakton se:

*Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit.*

Kryeinspektorët dhe disa nga inspektorët e cituar më sipër, nuk kanë profilin e duhur arsimor për të ushtruar detyrën e K/inspektorit dhe atë të inspektorit. Mungesa e stafit të kualifikuar, sidomos atij me *profil inxhinierik*, përbën mungesë cilësore për mbarëvajtjen e punës së inspektoratit, pasi nuk kanë kualifikimet e nevojshme për të kryer akte kontrolli apo për të përcaktuar dhe përshkruar teknikisht situatat e konstatuara gjatë inspektimit të subjekteve në terren.

▪ Lidhur me strukturën organizative të IMTV Bashkia Elbasan nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe informacionit të pasqyruar në tabelën e mësipërme, rezultoi se: deri në 08.05.2022 njësia ka funksionuar me numrin e plotë të inspektorëve **(1+8)** konform strukturës organizative të miratuar me Urdhrin e kryetarit dhe me VKB nr. 117 DT. 14.12.2021 “Mbi numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Elbasan dhe njërive vartëse të saj për vitin 2022” me 9 inspektorë (**1** kryeinspektor + **8** inspektorë) dhe funksionoi e tillë deri në 8 maj 2022; nga data 09.05.2022 deri më 23.06.2022 ka funksionuar me **10(1+9)** pra me 1 inspektor më shumë se ç’përmban struktura organizative e miratuar; me largimin e kryeinspektorit O.D nga data 23.06.2022 deri në 10.08.2022 njësia funksionoi me numrin e miratuar prej **9** inspektorësh (1+8); nga data 11.08.2022 deri në datë 10.11.2022 ka funksionuar me 1 inspektor më pak pra me **8(1+7)** inspektorë dhe nga data 11.11.2022 deri në fund të vitit 2022 ka ushtruar funksionet e veta me 2 inspektorë më pak se numri 9 i miratuar në strukturë pra me **7(1+6)** inspektorë.

**Konstatim:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se njësia e IMTV Bashkia Elbasan gjatë vitit 2022 *nuk ka ushtruar* funksionet e veta me një strukturë të plotë, konform akteve ligjore/nënligjore dhe të atyre rregullatore bashkisë;

**2.** Për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, janë ushtruar inspektime në **83** subjekte, për të cilat janë mbajtur proces verbal - konstatimi dhe janë nxjerrë vendime.



Në tabelën mëposhtë pasqyrohet një informacion i përmbledhur:

Procedura të mbajtura viti 2022	Numri i akteve të mbajtura	Seria e përdorur	Përdorur 2022 (në nr)	Anulluar (në nr)	Vlera totale (në lekë)	Vlera e paguar (në lekë)
proces verbal- konstatimi	83	0000351-0000373 0000374-0000380 0000381-0000410 0000411-0000440 0000441-0000460 anulluar (470)	87	10	<b>41,100,000</b>	<b>3,100,000</b>
vendim pezullim punimesh	1	0000201-0000203 0000204 anulluar (230)	1	26		
vendim dënim me gjobë	83	0000351-0000364 0000365-0000380 0000381-0000410 0000001-0000030 0000031-0000039 anulluar (060)	85	21		
vendim prishje objekti	81	0000381-0000390 0000391-0000410 0000161-0000200 0001201-0001223 anulluar (1230)	83	7		
<b>4</b>	<b>248</b>	<b>50 / 2021</b>		<b>64</b>		

Burimi: IMTV/Bashkia Elbasan

- Lidhur me kontrollet e zhvilluara gjatë vitit 2022, një informacion i detajuar pasqyrohet në aneksin nr.1 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

- Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se gjatë vitit 2022 nga **83** kontrolle të ushtruara në terren, janë përpiluar **81** Vendime për “prishje objekti” për 81 subjekte, të cilat kanë rezultuar pa leje të lëshuar nga DPKZHT/Bashkia Elbasan dhe janë shoqëruar edhe me vendosje të masës administrative.

▪ Lidhur me 83 aktet e mbajtura “proces verbal konstatimi”, rezultoi se janë nxjerrë vendime “masa administrative” ndaj **83** subjekteve kundërvajtës në vlerën totale 41,100,000 lekë, konform akteve ligjore në fuqi;

- Nga **83** subjektet me “masë administrative” është pranuar dhe paguar gjoba nga **7** subjekte në vlerën totale 3,100,000 lekë; detyrimi i papaguar nga **76** subjekte kundërvajtës është 38,000,000 lekë për të cilat nga IMTV janë dërguar praktikat në Gjykatë për kthimin e tyre në titull ekzekutiv; **12** nga këto çështje rezultojnë me kallëzim penal;

- Nga auditimi **u konstatua** se vlera e masës së gjobës, nuk është vendosur konform përcaktimeve të ligjit nr. 119/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, në nenin 52, pika 1 germa (e), është ndryshuar si më poshtë:

*e) kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 35,000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi dhe me...*

Në këto kushte masa e gjobës e caktuar 500,000 lekë është masë e cila nuk mbështetet në ligj, pasi me ndryshimet e cituara më sipër, masa e gjobës përlllogarit sipas vlerës së punimeve të kryera pa leje, dhe në çdo rast kur kemi të bëjmë me ndërtim për qëllime fitimi, masa e gjobës është jo më pak se 35,000 lekë për metër katror.

▪ Lidhur me këto mangësi, audituesit kanë sqaruar në hyrje të këtij akt konstatimi, se do duhej që në stafin e IMTV-së të kishte staf të kualifikuar, sidomos me profil inxhinierik/teknik, pasi me ndryshimet e ligjit nuk kemi më tarifa fikse gjore në vlerë të përcaktuar sipas rasteve, por kërkohet analizë e situatës, ekspertizë dhe staf i kualifikuar për të nxjerrë përlllogaritjet dhe vendosur masën e gjobës në përputhje me dispozitat ligjore.

3. Nga kontrolli i dokumentacionit për periudhën objekt auditimi, rezulton të jenë bërë **12** kallëzime penale ndaj subjekteve që kanë kryer punime ndërtimore pa leje, konform nenit 5 germa (dh) të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit” i ndryshuar;

Nr.	Emër Mbiemër	Lloji i objektit	Kallëzim penal	
			Nr.	datë
1	D K	Ndërtim muri, betonim brezash, hapje grope dhe lidhje kolonash prej hekuri	359	23.02.2022
2	B B	Ndërtim objekti me sipërfaqe 18 m <sup>2</sup>	1143	12.08.2022
3	D K	Fillimi i ndërtimit të një objekti duke bërë hapjen e themeleve, lidhjen e hekurit dhe vendosjen e armaturës.	1007	04.07.2022
4	D K	Objekt magazinë me sipërfaqe rreth 300 m <sup>2</sup>	1006	04.07.2022
5	B M	Prishja e fasadës së pallatit Nr. 64/1 në pjesën jugore dhe perëndimore	875	06.06.2022
6	A K	Objekt magazinë rreth 300 m <sup>2</sup>	776	16.05.2022
7	A L	Objekt shtesë kati i dytë	726	09.05.2022
8	A K	Objekt shtesë kati i dytë	681	27.04.2022
9	I T	Objekt magazinë	680	27.04.2022
10	I D	Rikonstruksion objekti ekzistues dhe fillim punimesh për ndërtim objekti të ri	568	04.04.2022
11	B K	Objekt pergolatë me konstruksion metalik dhe veshje xhami	560	01.04.2022
12	Xh P	Objekt dy kat	489	16.03.2022

Burimi: Bashkia Elbasan/IMTV

4. Me mosangazhimin e IKMT për ekzekutimin e vendimeve të marra nga IMTV, është krijuar një periudhë e gjatë kohore inaktive. Nga ana e IMTV për këtë periudhë **u konstatua se nuk është ushtruar ri-inspektim** në objektet me “leje pezullimi” apo “Vendim prishje” në moszbatim të VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore” pika 1/b/iii;

- Gjithashtu nga komunikimi verbal u konstatua se kjo situatë e krijuar mbart rrezikun e aplikimit të këtyre objekteve në proces legalizimi pranë ASHK-së. Nga auditimi rezultoi se ka komunikim dhe bashkëpunim midis Bashkisë Elbasan dhe ASHK-së si për marrje informacioni dhe për kërkesë pezullimi të procedurës për legalizim. Nga auditimi rezulton se gjatë vitit 2022 ka patur korrespondencë zyrtare, konfirmuar kjo nga numri 52 i shkresave.

- Lidhur me konstatimet e mësipërme, çdo subjekti kundërvajtes i është krijuar një dosje me gjithë praktikën e ndjekur: proces verbale, vendime, foto etj, duke bërë të mundur miradministrimin e dokumentacionit, konform kërkesave ligjore.

- Nga auditimi rezultoi se gjatë periudhës nën auditim 2022, *nuk janë zhvilluar* inspektime në terren si bashkëpunim midis IMTV dhe IKMT.

5. Nga auditimi **rezultoi se** nuk ka një sistem elektronik për regjistrimin në kohë të akteve të përpiluara nga IMTV, për një bashkëpunim dhe administrimin me efektivitet të informacionit nga IKMT, Drejtoria e Taksave, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të zhvillimit të territorit dhe Drejtoria Ligjore. Në mungesë edhe të mjeteve dhe makinerive të IMTV-së Bashkia Elbasan, ky sistem do të bënte të mundur hartimin e një plani efektiv nga IKMT për të ekzekutuar brenda një periudhe të afërt kohore vendimet e IMTV.

6. Nga kontrolli i dokumentacionit, u **konstatua** se kryeinspektori, për periudhën objekt auditimi ka miratuar planin vjetor të punës me nr. 06/1 prot., datë 06.01.2022, por nuk është fragmentuar në plane mujore me qëllim rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së IMTV-së kjo në kundërshtim me pikën 1 germa b/ii të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”,

dhe pika 2 e nenit 112 të Rregullores së Bashkisë Elbasan, miratuar me Urdhrin e kryetarit nr. 27 dhe me nr. 1776 prot., datë 20.04.2018.

Nr.	Lloji i aktit	2022
7	Kallëzime penale	12
8	Kërkesa drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv	81
9	Informacion periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT	4 (çdo 3 mujor)
10	Plane vjetore të punës të miratuara nga k/inspektori	1

Burimi: Bashkia Elbasan /IMTV

➤ **Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV-së; Për subjektet të cilat kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV**

1. Nga auditimi rezultoi se për subjektet kundërvajtës, krahas vendimit “masë administrative” është shoqëruar me vendim “prishje objekti” për **81** subjekte; vendim “pezullim punimesh” për **1** subjekt;

▪ IMTV Bashkia Elbasan ka dërguar raportimet 3 mujore në IKMT si më poshtë vijon:  
Shkresa nr. 558 prot., datë 31.03.2022 me objekt “Dërgohet informacion” për periudhën Janar-Mars 2022;

Proces Verbale Konstatimi	Vendime me gjobë	Likuiduar	Vendime prishje objekti	Ekzekutuar	Kallëzime penale
24	24	2	22	1	2

Shkresa nr. 1177 prot., datë 29.08.2022 me objekt “Dërgohet informacion” për periudhën Prill - Qershor 2022 (në tejkalim të afatit);

Proces Verbale Konstatimi	Vendime me gjobë	Likuiduar	Vendime prishje objekti	Ekzekutuar	Kallëzime penale
31	27	0	27	1	7

Shkresa nr. 1371 prot., datë 14.10.2022 me objekt “Dërgohet informacion” për periudhë Korrik - Shtator 2022;

Proces Verbale Konstatimi	Vendime me gjobë	Likuiduar	Vendime prishje objekti	Ekzekutuar	Kallëzime penale
20	20	1	20	0	3

Shkresa nr. 18 prot., datë 10.01.2023 me objekt “Dërgohet informacion” për periudhën Tetor-Dhjetor 2022;

Proces Verbale Konstatimi	Vendime me gjobë	Likuiduar	Vendime prishje objekti	Ekzekutuar	Vendime pezullimi	Kallëzime penale
12	12	1	11	0	1	0

2. Nga kontrolli i dokumentacionit, rezultoi se ndonëse në IKMT janë përcjellë kërkesat për bashkëpunim në ekzekutimin e vendimeve për “prishje objekti”, për periudhën nën auditim dhe deri më tani, nga ana e IKMT nuk është ekzekutuar asnjë vendim.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se **3** objekte për të cilat është lëshuar “Vendim për prishje”, janë ekzekutuar vullnetarisht; ndërsa për **2** objekte vendimet janë ekzekutuar me mjetet e bashkisë.

Nr.	Emër mbiemër	Lloji objektit	Vendim prishje		Urdhër Ekzekuti		Procesverbal ekzekutimi Vendimit për prishje objekti
			Nr.	datë	Nr.	datë	
1	N M	Mur rrethues me beton arme dhe dy kolona prej betoni	60	23.08.2021	1560	05.12.2022	Procesverbal ekzekutimi i mbajtur më datë 05.12.2022
2	A R	Tendë me konstruksion metalik	129	20.04.2022	725	09.05.2022	Procesverbal ekzekutimi i mbajtur më datë 09.05.2022
3	S T dhe A T	Shkelje e lejes duke tejkaluar dimensionet e pergolatës metalike	111	07.02.2022 <b>Ekzekutuar vullnetarisht.</b>			
4	K M	Shkelja e pikes 6 te lejes duke mos bere njoftim fillim punimesh ne sistemin e-leje.	139	13.05.2022 <b>Ekzekutuar vullnetarisht.</b>			
5	A K	Objekt rreth 32 m <sup>2</sup>	197	02.12.2022 <b>Ekzekutuar vullnetarisht</b>			
<b>5</b>			<b>3</b>		<b>2</b>		

Burimi; Bashkia Elbasan/IMTV

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe nga komunikimi verbal, inspektorët u shprehën se: “Me mjetet e bashkisë është bërë e mundur ekzekutimi i vendimit “për prishje” vetëm për 2 objekte pa leje. Kjo pasi vet bashkia nuk disponon mjetet e nevojshme për ekzekutimin e vendimeve për çdo lloj objekti. Për këtë arsye i është kërkuar IKMT-së të kryejë ekzekutimin e vendimeve për prishjen e objekteve pa leje. Deri më tani nga ana e IKMT- së nuk është ekzekutuar asnjë vendim”.

U **konstatua** se nga ana e IMTV, nisur nga vonesat e IKMT për ekzekutim të vendimeve dhe pasojat përveçse ligjore e financiare por edhe sociale që sjell, nga IMTV /Bashkia Elbasan rezulton të jetë paraqitur në kërkesat buxhetore vjetore për vitin 2022 si nevojë imediate, pajisja e IMTV-së Bashkia Elbasan (blerje) me mjetet dhe makineritë e duhura të cilat shërbejnë për prishjen e objekteve, pra për ekzekutimin e vendimeve për “prishje objekti pa leje”. Për vitin 2022 kërkesa i është drejtuar Kryetarit të Bashkisë me shkresën nr. 1124 prot., datë 08.08.2022. Kjo kërkesë është përsëritur edhe për vitin 2023 dhe rezulton të mos jetë planifikuar në PBA 2022-2024. Pajisja e IMTV-së me mjetet e nevojshme (fadroma) do të sillte rritje të efektivitetit në aktivitetin e IMTV nga njëra anë dhe besueshmërinë e komunitetit tek veprimtaria e bashkisë, në zbatim të Ligjit nr. 139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 3 “Misioni i vetëqeverisjes vendore”.

**3.** Nga auditimi dhe informacioni nga evidencat e vëna në dispozicion, lidhur me historikun e gjobave të vendosura nga IMTV ndër vite, rezulton si mëposhtë:

Viti 2020		Viti 2021		Viti 2022	
Numri i debitorëve	Vlera e detyrimit	Numri i debitorëve	Vlera e detyrimit	Numri i debitorëve	Vlera e detyrimit
36		28		83	41,100,000
<b>Arkëtuar</b>					
7	1,019,750	3	216,450	47 / 7 (të 2022)	8,865,768 3,100,000
<b>Mbetur</b>					
29		25		76	38,000,000
			<b>Totali 31.12.2022</b>	<b>130</b>	<b>2020 – NA 2021 - NA 2022 - 38,000,000</b>

Burimi: Bashkia Elbasan/IMTV

Nga një analizë dhe verifikim i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se debitorët deri në 31.12.2022 i janë nënshtruar këtyre procedurave<sup>20</sup>:

Nr	Lloji i procedurës	Numri sipas llojit
1	Ekzekutim i detyrueshëm	108
2	Ekzekutim vullnetar	3
3	Ekzekutim me këste	14
4	Ekzekutim në proces/pjesërisht	5
<b>Totali i debitorëve deri në 31.12.2022</b>		<b>130</b>

*Punoi: Grupi i auditimit*

**Konstatim:** Nga të dhënat e pasqyruara në tabelat e mësipërme vihet re se arkëtimet nga gjobat e IMTV -së kanë patur trend në rënie deri në fund të vitit 2021; gjatë vitit 2022 me futjen e shërbimit përmbartimor është përmirësuar situata, duke sjellë rritjen e numrit të arkëtimeve. Deri në datë 31.12.2022 numri i debitorëve të mbartur është ulur në 130 dhe vlera debitorëve vetëm për vitin 2022 është 38,000 mijë lekë, ndërsa për vitet 2020 dhe 2021 *ka mungesë informacioni*. Kjo për faktin se nuk ka raporte statistikore mbi vlerën historike të gjobave të vendosura nga IMTV, gjë që tregon se nuk janë zhvilluar analiza periodike dhe vjetore mbi veprimtarinë e saj, nuk është raportuar te titullari dhe te njësia përgjegjëse për kontabilizimin e tyre.

4. Nga kontrolli, verifikimi i dokumentacionit dhe komunikimi verbal **rezultoi** se vjelja e gjobave për vendimet e marra nga IMTV, në rastet e mospagimit vullnetar nga subjekti i kundërligjshëm dërgohen në Gjykatë për kthimin e tyre në titull ekzekutiv; Ekzekutimi i vendimeve të gjykatës realizohet nëpërmjet zyrave përmbartimore private, në zbatim të ligjit nr. 10031/2018 datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat” i ndryshuar me ligjin nr. 109/2016 datë 27.10.2016. Për vitin 2022 bashkëpunimi ka qenë me përmbartuesin privat Ensola Kuçi, përzgjedhur para periudhës nën auditim. Njoftimi për këtë shërbim është publikuar në ëeb-in e Bashkisë Elbasan datë 29.09.2021 <https://elbasani.gov.al/notices/> “Kontrata e Shërbimit” është plotësuar sipas Modelit të përcaktuar në Udhëzimin nr. 4321/4 datë 18.07.2017 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e Modelit të Kontratës që lidhet midis Shoqërisë përmbartimore/përmbartuesit gjyqësor privat dhe palës së interesuar përpara fillimit të procedurave të ekzekutimit”. Për vitin 2022 rezultojnë *149 praktika* të vëna në dispozicion të përmbartuesit për ekzekutim të vendimit gjyqësor.

Nga auditimi rezultoi se Bashkia Elbasan (pala kreditore në cilësinë e palës kërkuese të shërbimit) ka si përfaqësues ligjor të saj Kryeinspektorin e IMTV; ndërsa për procedurën të ndryshme të ankimmuara në gjykatë, janë ndjekur nga juristi i IMTV-së znj. H.T., e cili ka ushtruar funksionet e saj deri në tetor të vitit 2022; me largimin e saj nga puna ky funksion i ka kaluar zyrës juridike të bashkisë. Gjatë periudhës në auditim dhe jo vetëm, siç është përshkruar edhe më lart, IMTV është karakterizuar jo vetëm me mungesë të stafit profesionist (moszbatim i kriterëve ligjore), por edhe me lëvizje të tyre (largime), duke e lënë strukturën e IMTV-së të cinguar edhe profesionalisht. Kjo ka çuar në veprimtari jo eficiente të saj. Në “Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të bashkisë Elbasan” nuk janë pasqyruar përgjegjësitë, detyrat/përshkrimet e punës sipas çdo pozicioni, duke mos patur një ndarje dhe përshkrim të plotë e të qartë të detyrave që duhet të përmbushen dhe përgjegjësi që ka inspektori dhe kryeinspektori.

➤ **Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.**

1. Nga kontrolli i dokumentacionit, rezultoi se janë ushtruar nga k/inspektori/ët inspektime në objektet e pajisura me leje ndërtimi, dhe vetëm për ato subjekte që kanë rezultuar në kundërvajtje

<sup>20</sup> Lista e debitorëve 2020, 2021 e 2022 bashkëngjitur Akt konstatimit (aneks)

janë përpiluar “proces verbale konstatimi”, u **konstatua** se për subjektet e tjera nuk janë përpiluar akte kontrolli, veprim ky në kundërshtim me nenin 4, nenin 5 germa (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar dhe nenin 51 “Inspektimi” të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, pikës 2 të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”.

Njëkohësisht sqarohet se në mungesë të stafit të kualifikuar, ky kontroll do ishte i pamundur pasi punonjësit nuk kanë kualifikimin sipas ligjit për të kryer akte inspektimi/ kontrolli në objektet që kanë leje ndërtimi. Kjo vërtetohet edhe nga fakti i mbajtjes së proces verbalit të konstatimit vetëm për “shkelje afati” pra konstatim i karakterit ligjor.

**Titulli i Gjetjes:** Mbi organizimin dhe funksionimin joefektiv të IMTV.

**Situata: I.** *Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi:*

**1.1** Nga auditimi i strukturës organizative të IMTV-së, u konstatua se në IMTV Bashkia Elbasan, para dhe përgjatë periudhës objekt auditimi, është punësuar staf në kundërshtim me nenin 11 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”i ndryshuar;

**1.2** Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se njësia e IMTV Bashkia Elbasan gjatë vitit 2022 *nuk ka ushtruar* funksionet e veta me një strukturë të plotë, konform akteve ligjore/nënligjore dhe të atyre rregullatore bashkisë;

**1.3** Nga auditimi u konstatua se vlera e masës së gjobës, nuk është vendosur konform përcaktimeve të ligjit nr. 119/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, në nenin 52, pika 1 germa (e);

**1.4** Me mosangazhimin e IKMT për ekzekutimin e vendimeve të marra nga IMTV, është krijuar një periudhë e gjatë kohore inaktive. Nga ana e IMTV për këtë periudhë **u konstatua** se nuk është ushtruar ri-inspektim në objektet me “leje pezullimi” apo “Vendim prishje” në moszbatim të VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore” pika 1/b/iii;

**1.5** Nga auditimi rezultoi se nuk ka një sistem elektronik për regjistrimin në kohë të akteve të përpiluara nga IMTV, për një bashkëpunim dhe administrimin me efektivitet të informacionit nga IKMT, Drejtoria e Taksave, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të zhvillimit të territorit dhe Drejtoria Ligjore. Në mungesë edhe të mjeteve dhe makinerive të IMTV-së Bashkia Elbasan, ky sistem do të bënte të mundur hartimin e një plani efektiv nga IKMT për të ekzekutuar brenda një periudhe të afërt kohore vendimet e IMTV.

**1.6** Nga kontrolli i dokumentacionit, u **konstatua** se kryeinspektori, për periudhën objekt auditimi ka miratuar planin vjetor të punës me nr. 06/1 prot., datë 06.01.2022, por nuk është fragmentuar në plane mujore me qëllim rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së IMTV-së kjo në kundërshtim me pikën 1 germa b/ii të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”, dhe pika 2 e nenit 112 të Rregullores së Bashkisë Elbasan, miratuar me Urdhrin e kryetarit nr. 27 dhe me nr. 1776 prot., datë 20.04.2018.

**II.** *Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV-së; Për subjektet të cilat kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV:*

**2.1.** Ndonëse në IKMT janë përcjellë kërkesat për bashkëpunim në ekzekutimin e vendimeve për “prishje objekti”, për periudhën nën auditim (deri në shtator 2023), nga ana e IKMT nuk është ekzekutuar asnjë vendim. U konstatua se nga ana e IMTV, nisur nga vonesat e IKMT për ekzekutim të vendimeve dhe pasojat përveçse ligjore e financiare por edhe sociale që sjell, nga IMTV /Bashkia Elbasan rezulton të jetë paraqitur në kërkesat buxhetore vjetore për vitin 2022 si nevojë

immediate, pajisja e IMTV-së Bashkia Elbasan (blerje) me mjetet dhe makineritë e duhura të cilat shërbejnë për prishjen e objekteve, pra për ekzekutimin e vendimeve për “prishje objekti pa leje”. Për vitin 2022 kërkesa i është drejtuar Kryetarit të Bashkisë me shkresën nr. 1124 prot., datë 08.08.2022. Kjo kërkesë është përsëritur edhe për vitin 2023 dhe rezulton të mos jetë planifikuar në PBA 2022-2024. Pajisja e IMTV-së me mjetet e nevojshme (fadroma) do të sillte rritje të efektivitetit në aktivitetin e IMTV nga njëra anë dhe besueshmërinë e komunitetit tek veprimtaria e bashkisë, në zbatim të Ligjit nr. 139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 3 “Misioni i vetëqeverisjes vendore”.

**2.2** Nga të dhënat e pasqyruara në tabela vihet re se arkëtimet nga gjobat e IMTV -së kanë patur trend në rënie deri në fund të vitit 2021; gjatë vitit 2022 me futjen e shërbimit përmbarimor është përmirësuar situata, duke sjellë rritjen e numrit të arkëtimeve. Deri në datë 31.12.2022 numri i debitorëve të mbartur është ulur në 130 dhe vlera debitore vetëm për vitin 2022 është 38,000 mijë lekë, ndërsa për vitet 2020 dhe 2021 ka mungesë informacioni. Kjo për faktin se nuk ka raporte statistikore mbi vlerën historike të gjobave të vendosura nga IMTV, gjë që tregon se nuk janë zhvilluar analiza periodike dhe vjetore mbi veprimtarinë e saj, nuk është raportuar te titullari dhe te njësia përgjegjëse për kontabilizimin e tyre;

**III** *Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit*

**3.1** Nga kontrolli i dokumentacionit, rezultoi se janë ushtruar nga k/inspektori/ët inspektime në objektet e pajisura me leje ndërtimi, dhe vetëm për ato subjekte që kanë rezultuar në kundërvajtje janë përpiluar “proces verbale konstatimi”, u konstatua se për subjektet e tjera nuk janë përpiluar akte kontrolli, veprim ky në kundërshtim me nenin 4, nenin 5 germa (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar dhe nenin 51 “Inspektimi” të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, pikës 2 të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”.

- Njëkohësisht sqarohet se në mungesë të stafit të kualifikuar, ky kontroll do ishte i pamundur pasi inspektor k/inspektori/ët nuk plotësojnë kriteret e kualifikimit profesional/arsimor konform ligjit, për të kryer akte inspektimi/ kontrolli në objektet që kanë leje ndërtimi. Kjo vërtetohet edhe nga fakti se nga ana e IMTV-së janë mbajtur proces verbale konstatimi vetëm për “shkelje afati” pra konstatim i karakterit ligjor.

**Kriteri:** Ligji 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 4, neni 5 germa dh; Ligji Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” neni 51 “Inspektimi” i ndryshuar me Ligjin nr. 119/2020 neni 52 pika 1/e; VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”; pika 1/b/ii; Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 3, neni 29 pika 3,4; Pika 2 e nenit 112 të Rregullores së Bashkisë Elbasan, miratuar me Vendimin e kryetarit nr. 27 dhe me nr. 1776 prot., datë 20.04.2018.

**Ndikimi:** Ndikon në ndërtimet e reja në mos përputhje të planit rregullues; Shmangen detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë; Nuk jep garanci për një kontroll efektiv dhe cilësor të territorit.

**Shkaku:** Strukturë me personel të pakualifikuar dhe në mospërputhje me detyrimet që përcakton ligji.

**Rëndësi:** E lartë

**Rekomandim 1:** Kryetari i Bashkisë Elbasan, të marrë masa për një strukturë të IMTV të me staf të kualifikuar kryesisht të profilit inxhinieri, për të rritur cilësinë e inspektimit dhe të kontrollit për ndërtimet pa leje dhe zbatimin e lejeve të ndërtimit;

**Rekomandimi 2:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës, Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe medias, Drejtorinë e Taksave e Tarifa Vendore dhe Drejtorinë e Prokurimeve publike të marrin masa për implementimin e një sistemi elektronik për regjistrimin në kohë të akteve të përpiluara nga inspektorët e IMTV si dhe për sigurimin e infrastrukturës dhe mjeteve të nevojshme, për të bërë të mundur ekzekutimin në kohë të vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje.

**Rekomandimi 3:** Kryeinspektori dhe inspektorët e IMTV-së të hartojnë e miratojnë plane mujore e vjetore mbështetur edhe në informacionin mbi lejet e ndërtimit të lëshuara nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të territorit; të mbajnë akte kontrolli për të gjitha inspektimet që kryejnë tek ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse; të bëjnë një vlerësim real të masës së gjorbës për kundërvajtësin duke zbatuar ligjshmërinë e standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës; të hartojnë raporte periodike dhe vjetore mbi aktivitetin e njësisë; të raportojnë tek Drejtoria e Financës për kontabilizimin në kohë të vendimeve “me gjorbë” të zbardhura prej tyre si dhe t’i kushtohet vëmendje e veçantë masave për ekzekutimin në kohë të vendimeve “me gjorbë” ndaj kundërvajtësve aktualë dhe arkëtimit të tyre nga debitorët historikë.

## IV GJETJE DHE REKOMANDIME

### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Elbasan nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Për periudhën objekt auditimi nuk ka takime të dokumentuara të GMS, nuk janë hartuar dhe miratuar gjurmët standarde të auditimit, nuk ka përditësuar Rregulloren e brendshme sipas strukturave organizative të miratuara, nuk ka hartuar Listën (hartën)/manualin e proceseve të punës, mungon rregullorja e posaçme e konfliktit të interesit, nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar dhe zhvilluar edhe programe trajnimesh në njësinë vendore për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit; Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjike me afat jo më pak se 5 vjet, plane dhe raporte vjetore mbi problematikat e hasura dhe zgjidhjen që iu është dhënë gjatë veprimtarisë së njësisë publike; menaxhimi dhe mirëmbajtja e sistemeve dhe programeve IT, nuk bëhet sipas kërkesave dhe standardeve ligjore në fuqi dhe paraqet risk në komprometimin e të dhënave që këto sisteme ruajnë dhe administrojnë. Mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16, 20, 21, 22, nenin 32 të ligjit nr. 68/2017” Për financat e vetëqeverisjes vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 9-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1.Rekomandimi.** Kryetari i Bashkisë Elbasan, marrë masa për njohjen nga menaxhimi dhe nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, të rritjes dhe forcimit të aktivitetit GMS, të koordinimit të MFK dhe koordinimit të riskut, të përditësojë Rregulloren e brendshme sipas strukturave organizative të miratuara, të miratojë gjurmët e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, forcimin dhe standardizimin në menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe programeve IT, për forcimin e aktiviteteve të kontrollit, informimit dhe monitorimit në bashki.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**1.2.Rekomandimi.** GMS dhe Koordinatorin i menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe Koordinatorin të riskut, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e planit strategjik dhe planit vjetor për aktivitetet dhe çështjet që duhet të analizojë dhe grafikon e takimeve që do realizojë, për



hartimin e raporteve vjetore, si një rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të punës për çdo drejtori dhe njësi varësie, për të arritur objektivat institucionale në shërbim të komunitetit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**1.3.Rekomandimi.** Nëpunësi Autorizues, Nëpunësi Zbatues dhe GMS të marrin masa për miratimin e një rregulloreje për menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e aktiveve afatgjata të njësisë nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, në zbatim të akteve ligjore në fuqi.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**1.4.Rekomandimi.** Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme të marrë masa për të hartuar plane dhe programe trajnimi për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë; të kontribuojë në krijimin e një strukture organizative sa më efektive, plotësimin me personel të saj, për të rritur efektivitetin e shërbimeve dhe funksioneve që i atribuon ligji në dobi të komunitetit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi dhe analizimi i aktivitetit të Njësisë së Auditit të Brendshëm në Elbasan u konstatua se:

-Nga auditimi i strukturës së NJAB mbi emërimet dhe certifikimet e audituesve, rezultoi se drejtuesi i NJAB i emëruar 6 mujorin e dytë, rezultoi i pa certifikuar si auditues i brendshëm, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 11, pika 2/b; “Manualin i Auditit të Brendshëm”, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 100/2016 i ndryshuar; Aktualisht NJAB po funksionon pa drejtues që prej datës 24.02.2023 dhe me 3 auditues, nga të cilët një auditues i certifikuar si “Auditues i brendshëm” dhe dy janë në proces certifikimi;

-Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e auditimeve rezultoi se nuk është hartuar nga drejtuesi i NJAB dhe miratuar nga kryetari i Bashkisë Elbasan “Plani i ndryshuar vjetor për vitin 2022” në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 14/ç,i; Manuali i Auditimit të Brendshëm Kap.III, Rubrika 3.5;

-Nga auditimi i vlerësimit me koeficient risku të njësisë të strukturës organizative objekt auditimi si dhe i planifikimit/realizimit të misioneve audituese mbi bazën e vlerësimit të riskut, referuar kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm ku specifikohet raporti mes sistemeve/fushave me risk të lartë dhe atyre me risk të mesëm/të ulët, rezultoi se për vitin 2021 ky raport është [2:8] ose më i ulët dhe për vitin 2022 është [5:5] ose më i ulët; Mos respektimi i këtij raportit është në kundërshtim të ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” Kapitulli III paragrafi 3 pika 3.1.2;

-Nga auditimi mbi rekomandimet e lëna nga NJAB në misionet audituese të realizuara në 2 vitet e fundit, rezultoi se numri i tyre vjen në rënie; i atyre me status “zbatuar” *për vitin 2021* janë 36 ose 53% të totalit të rekomandimeve të lëna; *për vitin 2022* janë 15 ose 45.5% të totalit të rekomandimeve; rekomandimet me status “pa zbatuar” nuk ka; rekomandime të shprehura në vlerë janë lënë 2 nga të cilat një është zbatuar dhe një është në proces. Pra numri i rekomandimeve “të zbatuara” ka ardhur në rënie nga viti 2021 në vitin 2022;

-Nga verifikimet e dokumentacionit, analiza e informacionit të pasqyruar në tabela dhe raportet vjetore që NJAB ka dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, rezultoi se: numri i auditimeve të planifikuara është *për vitin 2021* me 11 misione audituese dhe *për vitin 2022* me 10 auditime; nuk janë përfshirë në planet strategjike dhe ato vjetore të gjitha njësitë e strukturës me referim koeficientin e riskut, kjo situatë ka ardhur si rezultat i një vlerësimi jo real dhe një analize të pa studiuar të nivelit të riskut për çdo njësi të strukturës, ku ato me risk të lartë auditohen çdo vit, me risk të mesëm në çdo 3 vjet dhe ato me risk të ulët në çdo 5 vjet, të gjitha këto në

moszbatim të ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” Kapitulli III, pika 3.1.2;

-Nga auditimi rezultoi se në dosjet e misioneve audituese rezultuan dokumente standarde pa nënshkrimin e anëtarëve të grupit auditues, pa praktikën e nevojshme dokumentare në rastin e refuzimit të një prej anëtarëve të grupit auditues, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” Kapitulli IV – 4.1.1/1 dhe Formatet standard të tij;

- Nga ana e subjekteve të audituara, nuk janë hartuar Planet e veprimit të cilat i dërgohen NJAB jo më vonë se 30 ditë pune pas dërgimit nga ana e saj të Raportit Përfundimtar, duke mos përmbushur detyrimin nr. 5 e skemës finale të auditimit, në moszbatim të kreut 4.1.12 hapi 11” i “Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

-NJAB nuk ka ndjekur hapat e procesit të monitorimit, për zbatimin e rekomandimeve nga ana e subjekteve të audituara brenda afateve të përcaktuara, në mos zbatim të përcaktimeve të kreut 4.1.13.1 dhe 4.1.13.2 “Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit” paragrafi 3 si dhe “Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve” paragrafi 4; mos raportimit te subjekteve te audituara në moszbatim te kreut 4.1.13.3 “Përgjegjësitë e njësisë për të zbatuar rekomandimet e AB”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 9-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Elbasan, të marrë masa për të strukturuar NJAB, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin, për të përmbushur misionin e saj në arritjen e objektivave.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2.2.Rekomandimi:** Njësia e Auditit të Brendshëm të bëjë një vlerësim real të koeficientit të riskut për fushat/sistemet objekt i misioneve audituese, për të përfshirë në planet strategjike dhe vjetorë sektorët e fushave me risk, siç janë: zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, menaxhimin e burimeve njerëzore etj., duke respektuar raportin mes sistemeve /fushave vlerësuar me koeficient të lartë ndaj atyre me koeficient të mesëm/ulët në hartimin e planeve strategjike e vjetor të njësisë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2.3.Rekomandimi:** Njësia e Auditit të Brendshëm të ndjekë me korrektësi çdo fazë të misionit auditues duke e plotësuar me praktikën dokumentare përkatëse; pas dërgimit të raportit përfundimtar në subjektin e audituar, t’i kërkojë menaxherit të tij të reagojë në lidhje me rekomandimet e lëna dhe të raportojë periodikisht, sipas afateve të përcaktuara në planin e veprimit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3.Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2022 në Bashkinë Elbasan niveli i realizimit të të ardhurave është 63%, duke sjellë diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit të bashkisë për sa i takon pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve. Niveli i ulët i realizimit të të ardhurave ka ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të bashkisë dhe marrjen e angazhimeve buxhetore pa patur burime financimi reale. Këto veprime janë kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; si dhe Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 27.02.2019 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2020-2022". Për vitin 2022 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan është miratuar me VKB-në nr. 119, datë 14.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave në Bashkinë Elbasan për vitin 2022”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 36-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1.Rekomandimi:** Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Elbasan të angazhohet në marrjen e masave gjatë gjithë vitit me qëllim mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifavat vendore në nivelet më të larta sipas planifikimit.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**4.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se për vitin 2022, kontratat e lidhura për vjeljen e tarifës orare të parkimit me Bashkinë Elbasan dhe Agjentët Tatimorë janë protokolluar me të njëjtin numër dhe të njëjtën datë përkatësisht nr. 17/3 prot., datë 17.03.2022, për vitin 2022. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Sektori i Tregjeve Fruta-Perime dhe Menaxhimit të Parkimit janë 43,980 bileta të shpërndara në total për vitin 2022 në vlerën 2,199,000 lekë, janë kthyer 49 bileta parkimi me proces verbalin e mbajtur në datë 17.03.2022 nga agjenti Sh. K. dhe 49 bileta parkimi me proces verbalin e mbajtur në datë 24.03.2022 nga agjenti Xh. B. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se biletat e parkimit të shpërndara nuk janë sipas numrit serial me kronologji, për arsye të kthimeve dhe mos rakordimit midis dy sektorëve të bashkisë, përkatësisht Sektori i Tregjeve Fruta-Perime dhe Menaxhimit të Parkimit dhe Sektori i Buxhetit dhe Financës.

Ndërsa nga parkimi i rezervuar për bizneset për vitin 2022, janë arkëtuar 9,793,500 lekë për 187 biznese. Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur me taksën e parkimit rezulton se Bashkia Elbasan nuk ka të miratuar me VKB sipërfaqe për parkimin e mjeteve me pagesë. Gjithashtu, nuk është e qartë si bëhet llogaritja e kësaj takse nga Sektori i Tregjeve Fruta-Perime dhe Menaxhimit të Parkimit kur nuk janë miratuar m<sup>2</sup> që janë të disponueshme për parkim. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 32. VKB nr. 60, datë 18.06.2020, “Për miratimin e kriterëve dhe përcaktimin e rrugëve dhe shesheve publike për administrimin e shërbimit të parkimit me pagesë të Bashkisë Elbasan” ndryshuar me VKB nr. 86, datë 31.08.2021 dhe VKB nr. 23, datë 04.03.2022. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 52-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me strukturat e tjera në Bashkinë Elbasan të identifikojnë sipërfaqen që është në dispozicion për parkim me pagesë dhe të nxjerrin aktet e nevojshme për miratimin e kësaj sipërfaqe si të disponueshme për parkim. Sipërfaqe kjo që duhet të jetë baza për llogaritjen e taksës së parkimit, si dhe rakordimin e vlerës së biletave të parkimit të shpërndara, duke i shpërndare dhe ndjekur sipas numrit serial kronologjik, duke pasqyruar me rigorozitet kthimet dhe procedurat e rakordimit midis dy sektorëve të Bashkisë, përkatësisht Sektori i Tregjeve Fruta-Perime dhe Menaxhimit të Parkimit dhe Sektori i Buxhetit dhe Financës.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**5.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të studimit Tekniko - ekonomik së bashku me anekset e përcaktuara dhe nga verifikimet për zbatimin e udhëzimit nr.1, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të Fondit Pyjor dhe Kulloror Publik”, nuk ka dalë asnjë VKM për heqjen nga Fondi Pyjor/Kulloror për 12 hektar shfrytëzim nga subjekti ekonomik “Y.S” SHPK, aq më tepër të kemi dhe një ndryshim të zërit kadastral për këto 12 hektar. Nisur nga QKB si dhe duke parë aktivitetin dhe pagesën e taksave të subjektit “Y.S” SHPK me NIPT L.....T, ndër to dhe Tarifën për Mbrojtjen dhe Përmirësimin e Mjedisit siç referohet nga Inspektoriati i Mjedisit të Bashkisë Elbasan, duket qartë që ky subjekt ekonomik, po ushtron aktivitet të plotë duke shfrytëzuar lejen minerare shfrytëzimi PN-3593-05-2012 që prej vitit 2013. Konkluzioni është që ky subjekt po ushtron veprimtarinë ekonomike duke shfrytëzuar sipërfaqen prej 12 hektarësh, pa pasur një kontratë përdorimi të Fondit Pyjor/Kulloror të këtyre 12 hektarëve në pronësi të Bashkisë Elbasan, që prej vitit 2012.

B - Për subjektin “SH.G” SHPK me NIPT K.....D

Nga auditimi është konstatuar se në dosje administrohen disa kontrata qiraje 1 vjeçare për përdorimin e fondit pyjor/kullosor me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, për vitin 2007, si dhe me Komunën Shushicë për vitet 2011, 2012 dhe 2013. Megjithatë subjekti ekonomik, shfrytëzon sipërfaqen prej 5 hektarësh që prej vitit 2014 pa kontratë qiraje si dhe nuk ka përmbushur detyrimet për heqjen nga fondi pyjor/kullosor të cilin e shfrytëzon dhe ky fond është aset i Bashkisë Elbasan.

C - Për subjektin “Rr.U.A” SHPK me NIPT J.....O  
Nga auditimi është konstatuar se në dosje administrohen disa kontrata qiraje 1 vjeçare për përdorimin e fondit pyjor/kullosor me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, për vitin 2013, 2014 të cilat janë ripërsëritur. Në konkluzion, ky subjekt ekonomik, shfrytëzon sipërfaqen prej 0,5 hektarësh që prej vitit 2015 pa kontratë qiraje si dhe nuk ka përmbushur detyrimet për heqjen nga fondi pyjor/kullosor të cilin e shfrytëzon dhe ky fond është aset i Bashkisë Elbasan.

D - Për subjektet U.Q SHPK me NIPT J.....Q dhe V.H SHPK me NIPT K.....C  
Për këto subjekte ekonomike, nga Bashkia Elbasan, Agjencia e Shërbimeve Pyjore, nuk administrohet asnjë dosje subjekti, pra praktikisht Bashkia Elbasan nuk ka asnjë informacion për aktivitetin e U.Q SHPK dhe V.H SHPK në territorin e saj dhe nuk ka asnjë informacion për sa i përket shfrytëzimit të aseteve të saj (fondit pyjor/ kullosor në total prej 4,58 ha) për efekt të nxjerrjes së gurit gëlqeror siç parashikohet në aktet e miratimit të lejes minerare, përkatësisht nr. 922/1 datë 10.05.2016 për U.Q SHPK dhe nr. 1304/3 datë 26.01.2009 për V.H SHPK.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligji nr. 9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin Pyjor”, neni 17 si dhe neni 19 pika 3, si dhe nenin 801 dhe 802 të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 “të “Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë” miratuar me ligjin Nr.7850, datë 29.7.1994, me ndryshimet, si dhe nenin 24, pika 10 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, dhe VKM 1353 datë 10.10.2008, i ndryshuar “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 52-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1.Rekomandimi:** Nga Bashkia Elbasan, të merren masa në mënyrë të menjëhershme që të bllokohet aktiviteti ekonomik i këtyre guroreve, deri në momentin e përfundimit të procedurave ligjore, në lidhje me heqjen nga fondi pyjor dhe ndryshimi i zërit kadastral i sipërfaqeve përkatëse të guroreve të sipërcituara. Gjithashtu, para momentit të zhblokimit, pasi të jenë kryer të gjitha procedurat ligjore për heqjen nga fondi pyjor, Bashkia Elbasan të bëjë një vlerësim për dëmin e shkaktuar nga përdorimi i paligjshëm i sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullosor, dhe t’jua faturojë subjekteve përkatëse private.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**6.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se në 4 raste në fondin pyjor dhe kullosor janë nënshkruar kontrata me shoqëritë koncesionare, të cilët janë në papajtueshmëri me Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për dhënie në Përdorim të Fondit Pyjor, konkretisht si vijon:

-Kontrata qiraje nr.1616, datë 02.04.2021, HEC Kotorri e nënshkruar ndërmjet Bashkisë Elbasan, e përfaqësuar nga Kryetari i saj, z. G.LL dhe Shoqërisë "A" ShPK, e regjistruar si person juridik në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS L.....T.

-Kontrata qiraje nr.1322, datë 28.02.2018, HEC Kamiçani e nënshkruar ndërmjet Bashkisë Elbasan, e përfaqësuar nga Kryetari i saj, z. Q.S dhe shoqërisë “I” ShPK e regjistruar si person juridik në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS K.....N.

-Kontrata qiraje nr.1323, datë 28.02.2018, HEC Arcova e nënshkruar ndërmjet Bashkisë Elbasan, e përfaqësuar nga Kryetari i saj, z. Q.S dhe shoqërisë “I” ShPK e regjistruar si person juridik në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS K.....N.

-Kontrata qiraje nr.1919/2, datë 13.05.2020, HEC Bukaniku e nënshkruar ndërmjet Bashkisë Elbasan, e përfaqësuar nga Kryetari i saj, z. G.LL dhe Shoqërisë "B.N" ShPK, e regjistruar si person juridik në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS K.....O.

Për sa me sipër, rezulton se përcaktimet e Nenit 3 dhe Nenit 5 (pika 5.2) e kontratave përkatëse të cilat bien në kundërshtim me pikën 20 të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit Nr.01, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik" i ndryshuar ku citohet "*Pagesa e qirasë është vjetore, duke u llogaritur nga data e lidhjes së kontratës dhe shlyhet në momentin e lidhjes së kontratës dhe në të njëjtën datë në vitin pasardhës*". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 52-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Elbasan të analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për rishikimin e Nenit 3 dhe Nenit 5 (pika 5.2) të kontratave të sipërcituara si dhe llogaritjen e detyrimeve.

### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se për vitin 2022 në Bashkinë Elbasan janë konstatuar probleme në zbatimin e buxhetit vendor, si vijon:

- Shpenzimet për ndihmën ekonomike dhe paafësinë zënë peshën kryesore për 48 % ose 2,027 milion lekë ndaj shpenzimeve gjithsej prej 4,174 milion lekë, çka bën të domosdoshme përmirësimin e politikave sociale për të zbutur papunësinë dhe varfërinë.

- Shpenzimet për paga paraqiten të larta prej 900 milion lekë dhe zënë 21 % ndaj shpenzimeve gjithsej 4,174 milion lekë. Ndikim ka pasur numri i madh i të punësuarve prej 481 punonjës me 210 mijë banore, madje më i larte së bashkitë tjera që mbulojnë popullsi të njëjte brenda juridiksionit të tyre, konkretisht: Bashkia Shkoder paraqet 327 punonjës me 213 mijë banore dhe Bashkia Durres 378 punonjës me mbi 250 mijë banore. Gjithashtu paraqitet raport i zhdrejtë midis numrit punonjësve prej 418 veta me ngarkesën e punës tyre, për disa pozicione pune, pasi nuk justifikohen me dokumente dhe programe pune, konkretisht:

- Drejtoria e auditit përbehet nga 5 punonjës, të cilët kane kryer 7 auditime gjithsejtë ose rreth 1 auditim/ vit, çka tregon se audituesit nuk kane ngarkesën e duhur të punës.

- Drejtoria përgjithshme shërbimeve organizative përbehet nga 10 punonjës, ku 5 punonjës te ankimit administrativ dhe përfaqësimit në gjykate përfaqësohet nga 5 veta, të cilët kane mbuluar 5 vendime gjyqësore për 2022 ose 1 vendim/punonjës.

- Drejtoria e administratës dhe burimeve njerëzore përbehet nga 11 punonjës, ku vetëm arkiv-protokolli paraqet 5 punonjës.

- Drejtoria e aseteve dhe strehimit përbehet nga 9 punonjës, ku mbi 10,000 prona e asete brenda juridiksionit të Bashkisë nuk janë pajisur me certifikate pronësie.

- Drejtoria e politikave arsimit parashkollor, trashëgimisë kulturore, turizmit e sportit përbehet nga 25 punonjës, në një kohe që paralel funksionojnë në vete njësite shpenzuese si Qendra Ekonomike Arsimit, Klubi Shumë sportesh, Qendra Artit dhe Trashëgimisë Kulturore.

- Shpenzimet operative janë realizuar 654 milion lekë dhe zënë 15 % ndaj totalit të shpenzimeve 4,174 milion lekë. Problem paraqet raporti i zhdrejtë i shpenzimeve operative me shpenzimet për pagat, ose në masën 73 %, çka tregon mungesë efektiviteti, eficence dhe ekonomiciteti të shpenzimeve operative në funksion të aktivitetit kryesor Bashkisë. Ky tregues flet për një planifikim të pa studiuar, me rezerva dhe pa kriter në disa zëra. U konstatua 2 zëra shpenzimesh me peshë kryesore në shpenzimet operative, konkretisht:

- Shpenzimet e pastrimit zënë vendin e parë prej 18 % ndaj shpenzimeve operative gjithsej dhe janë realizuar 120 milion lekë nga 144 milion të planifikuara.

- Shpenzime për energjinë elektrike zënë vendin e dyte prej 15,2 % ndaj shpenzimeve operative dhe janë realizuar 100 milion lekë nga 124 milion të planifikuara. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 73-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1. Rekomandimi:** Bashkia Elbasan në miratim të buxhetit të vitit 2024 të marre masa:

- a. Për uljen e numrit të familjeve me ndihme ekonomike dhe paaftësisë, duke përmirësuar politikat sociale për të zbutur papunësinë dhe varfërinë.
- b. Për rishikimin dhe shkurtimin e organikes, me qëllim vendosjen e një raporti të drejte midis numrit të punësuarve me ngarkesën e punës tyre.
- c. Për uljen e shpenzimeve operative, veçanërisht shpenzimet e pastrimit dhe të energjisë elektrike dhe shpenzimeve tjera, duke i planifikuar dhe menaxhuar drejt dhe duke ushtruar kontroll periodik ndaj tyre, në mënyre që të vendoset një raport i drejte midis shpenzimeve operative me shpenzimeve për paga, duke siguruar kështu eficienten e tyre.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i shpenzimeve të Agjensia Shërbimeve Publike Elbasan për vitin 2022, janë konstatuar parregullsi në buxhetin e saj, si vijon:

**a.** Shpenzimet për paga pasqyrohen në vlerën 143,382,507 lekë, me një organike prej 295 punonjës dhe 19 punonjës përkohshëm me fond page 3,114,082 lekë.

- Për disa punonjës për pozicionet e punës që mbulojnë, paraqitet mospërputhje me ngarkesën e punës tyre, pasi nuk e justifikojnë me dokumente dhe programe pune.

- Për 5 sektor numri i stafit drejtues-profesional rezulton i barabarte dhe në 1 rast më i madh se numri punonjësve, në vend që të ndodhte e kundërta.

Sa sipër, konkretisht:

\* sektori juridik e personeli prej 13 veta: 1 përgjegjës, 1 protokollues, 1 sekretare, 2 specialiste, 8 shofere, ose më shumë shofere se stafi drejtues-specialiste.

\* sektori mirëmbajtje rrugës qytet 23 veta: 1 përgjegjës, 2 teknik, 2 specialist, 12 punëtor, 6 shofer, pra numri punëtorëve i përafërt me numrin stafit drejtues-teknik-shofer.

\* sektori i ndriçimit, sinjalistikes dhe dekorit 17 veta: 1 përgjegjës, 2 specialiste, 4 teknik, 8 punëtor, 2 shofer, ose numri i punëtorëve është i barabarte me numrin stafit drejtues-teknik.

\* sektori agronomik, ujitje kullim 24 veta: 1 përgjegjës, 1 teknik, 3 specialiste, 10 agronom, 6 punëtor, 3 shofer, ose me shume agronome se specialistë e punëtorë.

\* sezonale prej 20 veta.

**b.** Shpenzimet operative prej 233,540,891 lekë janë me të larta se shpenzimet për paga 143 milion lekë. Shpenzimet operative prej 233 milion zënë 50 % ndaj shpenzimeve gjithsej 466 milion. Peshën kryesore e zënë 3 zëra shpenzimesh për 202 milion lekë ose 86 % ndaj totalit, përkatësisht: shpenzimet për roje 35 %, shpenzimet energjisë elektrike 33 % dhe shpenzimet për automjetet 18 %. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitë publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 73-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1. Rekomandimi:** Nga Agjensia Shërbimeve Publike Elbasan të marre masa:

a. Për rishikimin dhe shkurtimin e organikes për disa sektorë dhe të shmang punonjësit e përkohshëm, me qëllim vendosjen e një raporti të drejte midis numrit të punëtorëve me stafin drejtues-tekniko-profesional si dhe me ngarkesën e punës.

b. Për uljen e shpenzimeve operative, veçanërisht shpenzimet për roje, shpenzimet energjisë elektrike dhe shpenzimet për automjetet, në mënyre që të vendoset një raport i drejte midis shpenzimeve operative me shpenzimeve për pagat, duke realizuar kështu efektshmerinë dhe eficienten e tyre.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**9. Gjetje nga auditimi:** Agjensia e Shërbimeve Publike Elbasan paraqet 34 milion lekë fatura të pa likuiduara deri më datë 31.12.2022. Në ASHP janë lenë rekomandime për “shlyerjen e faturave

ne afat duke respektuar radhën dhe kohen e krijimit sipas parimit FIFO”, nga auditi brendshëm ne dhjetor 2022, por gjendja pjesërisht ka ndryshuar, pasi është shkelur përsëri radha e likuidimeve duke krijuar fatura te pa likuiduara prej 18 milion lekë për vitin 2022, në kundërshtim me UMF 01 datë 10.01.2022 ” Për detyrimet e prapambetura”, me nenin 52 të ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 73-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1. Rekomandimi:** Agjensia e Shërbimeve Publike Elbasan të marre masa:

- Të shlyej faturat e pa likuiduara të prapambetura për vlerën 34 milion lekë.
- Të marre masa për shlyerjen e detyrimet te subjekteve brenda afatit ligjor dhe të zbatoje radhën e likuidimeve, për efekt të mos diferencimit tyre.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**10. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Elbasan paraqet 67 milion lekë fatura të pa likuiduara deri më datë 31.12.2022, sipas llojit të detyrimit, sa vijon:

- vlera 16,908,200 lekë, llogaria 401 detyrim për shpenzime operative (602).
- vlera 50,194,781 lekë, llogaria 486 detyrim për shpenzime investimesh (231), te cilat zëne 75 % ndaj totalit detyrimeve. Bashkia ka përfshirë në buxhetin 2022 shlyerjen e plotë të detyrimeve të prapambetura 67 milion lekë, bazuar në UMFE nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin buxhetit 2022”, kreu III, pika 126 dhe UMFE nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin, publikimin detyrimeve prapambetura” dhe aktin normativ 34 datë 03.12.2021.

Bashkia Elbasan në disa raste nuk ka shlyer detyrimet e subjekteve në kohen dhe afatin e duhur prej 30-60 dite, dhe ka shkelur radhën e likuidimeve, në kundërshtim me nenin 52 ligjit 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin sistemit buxhetor” ndryshuar, si dhe UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen detyrimeve prapambetura” dhe me Udhëzimin plotësues pikat 82-91. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 73-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1. Rekomandimi:** Bashkia Elbasan të marre masa:

- a. Të shlyej faturat e pa likuiduara të prapambetura për vlerën 67 milion lekë.
- b. Të marre masa për shlyerjen e detyrimet të subjekteve brenda afatit ligjor dhe të zbatoje radhën e likuidimeve, për efekt të mos diferencimit tyre.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Në bilancin e vitit 2022 paraqet aktiv-pasivin në total të rakorduar për vlerën 5,272,532,072 lekë, por nuk rakordon në aktiv llogaria analitike 468 “Debitor ndryshëm” për 1,056,298,715 lekë me llogarinë analitike në pasiv 467 “Debitorë ndryshëm” për 1,064,539,415 lekë (kjo e fundit është e zberthyer dhe e kuadruar).

- Bashkia nuk ka ndjekur të gjitha hapat ligjor për arkëtimin e debitorëve, madje ka pasur mundësi arkëtimi për disa punonjës dhe subjekte juridike, me të cilët ka marrëdhënie pune dhe kontraktore, konkretisht:

**a.** Vlera 1,028,436 lekë, detyrimet kontraktore të pashlyera nga 6 subjekte qiramarrëse, të cilët kane marre me qira ambiente dhe objekte të Bashkisë, ndërsa Bashkia nuk ka marre masa për arkëtimin e qirave deri në zgjidhjen e kontratave, për moszbatimin e kushteve të kontratave. Bashkia ka përdorur 2 standarde për vjeljen e qirave, pasi ka likuiduar qiratë e 2 mjeteve Wolzswagen e Fadroma te marra ne përdorim, ndërsa nuk ka arkëtuar vlerën 1,028,436 lekë për objektet e dhëna me qira, përkatësisht: subjektet C ShPK 87,750 lekë, I.B98,700 lekë, V.I ShPK 41,426 lekë, Ujësjelesi fshat 666,648 lekë dhe E.D 133,920 lekë.

**b.** Vlera 24,759,020 lekë, debitorë lëne nga KLSH ndaj 42 subjekteve fizike dhe juridike, detyrime të pranuar dhe kontabilizuara nga bashkia, madje disa punonjës dhe subjekte kanë marrëdhënie pune dhe kontraktuale me bashkinë për vitin 2022 dhe ndaj tyre bashkia nuk ka bere ndalesa, konkretisht:

- V.B, përgjegjës i sektorit gjelbërimit ASHP debitor për vlerën 63,755 lekë,
- anëtarët e këshillit Bashkiak debitor për vlerën 2,657,507 lekë,

-subjekti "B.N" ShPK debitor për 2,508,627 lekë, ndërsa është likuiduar pa i bere ndalesa, sipas urdhër shpenzimit 425 datë 10.06.2022, etj.

- subjekti "E " ShPK debitor 554,020 lekë, ndërsa është likuiduar pa i bere ndalesa, sipas urdhër shpenzimit nr. 843 datë 14.09.2022 dhe nr. 1242 datë 27.12.2022 etj.

-subjektit "E" ShPK debitor 658,590 lekë, nuk i janë bërë ndalesa.

**c.** vlera 1,038,751,959 lekë, debitorët prapambetur ish-komunave, njësite e bashkisë.

Veprime në kundërshtim me kushtet e kontratave respektive, me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin aktiveve njësitë sektorit publik" pika 93, me ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994 "Kodi Civil RSH", me ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 "KPA në RSH" nenet 98 dhe 102, me ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" nenet 21 dhe 33 si dhe Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 73-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike dhe Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Elbasan të marrë masa për:

**a.** Sistemimin, kuadrimin e llogarisë aktive 468 "Debitorë ndryshëm" për vlerën 1,056,298,715 lekë me llogarinë pasive 467 "Debitorë ndryshëm" 1,064,539,415 lekë.

**b.** Zbatimin e të gjitha hapave ligjore për arkëtimin e vlerës 1,064,539,415 lekë, llogaria 467.

**c.** Arkëtimin e vlerës 6,442,499 lekë, për personat dhe subjektet debitorë të punësuar dhe me marrëdhënie kontraktore me Bashkinë Elbasan, konkretisht:

- anëtareve këshillit Bashkiak debitor për 2,657,507 lekë, sipas listës përkatëse.

- V.B debitor për vlerën 63,755 lekë,

-subjekti "B.N" ShPK debitor për vlerën 2,508,627 lekë,

- subjekti "E " ShPK debitor për vlerën 554,020 lekë,

-subjekti "E" ShPK debitor për vlerën 658,590 lekë.

**d.** Arkëtimin e vlerës 1,028,436 lekë, detyrimet kontraktore pashlyera nga 6 subjekte qiramarrëse, konkretisht: shoqëria "C " ShPK 87,750 lekë, z. I. F. B. 98,700 lekë, shoqëria "V.I " 41,426 lekë, Ujësjiellësi fshat 666,648 lekë dhe z. E.D 133,920 lekë.

**Brenda datës 30.06.2024**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i Aseteve të Bashkisë Elbasan, rezulton se Drejtoria e asetëve nuk ka pajisur me dokument pronësie 10,086 prona të paluajtshme, të cilat nuk janë regjistruar pranë ASHK, nga këto: *Bashkia 3,508 prona dhe 12 Njësiti Administrative 6,578 prona* pa certifikate pronësie, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 20/2020 "Për kadastrën". Drejtoria e Aseteve nuk disponon shkresa në drejtim të ASHK, për zgjidhjen e problemit të regjistrimit pasurive të saj, pasi ky proces është neglizhuar dhe nuk ka ecur periodikisht krahasuar me aplikimet e bëra.

- Drejtoria e Aseteve nuk ka regjistruar në kontabilitet 22 prona paluajtshme pajisur me certifikate pronësie në 2022 (*15 apartamente, 5 are, 1 truall dhe 1 ish-zyre arsimore*), sipas aneksit 11 pika 3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit në kundërshtim me Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 73-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1. Rekomandimi:** Bashkia Elbasan të marrë masa për regjistrimin e 10,086 pronave të saj, krijimin e regjistrimit pronave, pajisjen e tyre me certifikatë pronësie, duke bashkëpunuar me institucionet tjera si dhe regjistrimin në kontabilitet 22 prona paluajtshme, pajisur me certifikate pronësie në vitin 2022 (*15 apartamente, 5 are, 1 truall dhe 1 ish-zyre arsimore*), sipas aneksit 11 pika 3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit

**Menjëherë dhe në vijimësi**



**13.Gjetje nga auditimi:** Bashkia Elbasan për 9 raste në vlerën 1,768,894 lekë nuk janë bërë hyrje oponencat teknike, për rikonstruksionin e 2 shkollave, palestrave, terreneve sportive, rrugëve, mbikalimit hekurudhor dhe argjinaturës mbrojtëse lumit Shkumbin, te kryera nga Instituti Ndërtimor Tirane. Veprime në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitë publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 73-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**13.1. Rekomandimi:** Bashkia Elbasan të administroje duke i bërë hyrje 9 oponencat teknike për vlerën 1,768,894 lekë, për rikonstruksionin e 2 shkollave, palestrave, terreneve sportive, rrugëve, mbikalimit hekurudhor dhe argjinaturës mbrojtëse lumit Shkumbin, të kryera nga Instituti Ndërtimor Tirane, sipas kërkesave ligjore.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**14.Gjetje nga auditimi:** U konstatuan 2 raste me shkelje për vlerën 42,800 lekë në shërbimet dhe blerjet me vlera të vogla, konkretisht:

- Bashkia Elbasan ka likuiduar për vitin 2022 padrejtësisht OSHE vlerën 22,800 lekë (19 njësi x 100 lekë /muaji x 12 muaj), pasi në fatura është shtuar për çdo muaj si zë shpenzimi edhe taksa e aparateve (televizorit) prej 100 lekë/rasti, në një kohe që nuk ka aparate, konkretisht: për tregun e lire, linjat ndriçimit rrugor, thertorja dhe 12 njësite administrative e tjerë, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë sektorit publik” dhe me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 9, pika 4, neni 12 pika 3.

- Sipas urdhër shpenzimit nr. 1058 datë 10.11.2022 për vlerën 120,000 lekë është likuiduar një subjekt privat “I.C”, për qira tënde (18 m<sup>2</sup> me kapacitet 3 karrige, 1 kolltuk dhe 1 tavoline) për nevoja panairit disa ditore të Bashkisë, rezulton se: vlera 20,000 lekë TVSH (100,000+20,000 TVSh=120,000) është likuiduar padrejtësisht subjektit, pasi nuk është shitje tende por qira tende me aktmarrëveshje provizore, e cila nuk i nënshtrohet aplikimit të TVSH por tatimit burim, sipas legjislacionit fiskal. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 73-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**14.1. Rekomandimi:** Bashkia Elbasan të arkëtoje vlerën 42,800 lekë dhe të eliminojë mangësitë në blerjet e vogla, përkatësisht:

- të arkëtoje vlerën 22,800 lekë nga OSHE, për përfitim tepër të taksës televizorit prej 100 lekë/njësi për çdo muaj për vitin 2022, për 19 njësi e sektor, në kushtet kur nuk ka aparate.
- të arkëtoje vlerën 20,000 lekë TVSh, përfituar padrejtësisht nga subjekt “I.C”, për qiranë e një tende.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi shpenzimeve në Agjensia e Shërbimeve Publike Elbasan për vitin 2022, u konstatuan shkelje në 4 raste për vlerën 536,678 lekë, konkretisht:

- ASHP ka marre 20 punonjës të përkohshëm mbi organike, në mënyre pa justifikuar dhe pa ngarkesë punë, pasi: shërbimi ujitjes dhe kullimit gjatë sezonit është detyrë e sektorit “agronomik, ujitje kullim” prej 24 veta i miratuar organike dhe e 12 njësiteve administrative si dhe e bordit kullimit, madje këta 20 punonjës janë definitiv dhe jo provizore, sepse mbulojnë afërsisht gjithë vitin 2022 (mars-dhjetor).

- ASHP paraqet vlera të larta prej 83 milion lekë ose 35 % e totalit shpenzimeve operative, për pagesën e rojeve të objekteve, çka mund të reduktohej në numër dhe në vlera me të ulët, në kushtet e disponimit të 1154 cope kamera sigurie të cilat minimizojnë rojet fizike, në fakt ka ndodhur e kundërta.

- Në 4 raste u konstatuan vonesa për likuidimin e faturave nr. 91, nr. 100, nr. 109 vitit 2021 të “U” ShPK, sipas urdhër shpenzimeve nr. 21, nr. 22, nr. 23 datë 10.02.2022.

- Është likuiduar OSHE vlera 536,678 lekë për kamate vonesa për energjinë elektrike të papaguar para Qershorit 2022, sipas urdhër shpenzimeve 164 datë 15.08.2022, në vend të personave

përgjegjës që kanë shkelur afatet ligjore. Mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj operatorit ekonomik FSHU është në kundërshtim me nenin 52 ligjit 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin sistemit buxhetor” ndryshuar, me UMF 5 datë 27.12.2014 “Për shlyerjen detyrimeve prapambetura”, me Udhëzimin plotësues, pikat 82-91. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 73-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**15.1. Rekomandimi:** Agjensia e Shërbimeve Publike Elbasan të marre masa për:

- të shmang punësimin e punonjësve përkohshëm për vitin 2024, pasi nuk justifikohen me ngarkesë pune, madje ky shërbim i tyre mbulohet nga sektori “agronomik, ujitje kullim” dhe 12 njësite administrative si dhe bordi i ujitjes-kullimit.
- të analizoje gjendjen dhe te reduktoje numrin e rojeve të objekteve për vitin 2024, për efekt të minimizimit shpenzimeve, pasi ky lloj shpenzimi ka peshën kryesore të shpenzimeve operative.
- të analizoje dhe nxjerr përgjegjësi e mos likuidimit në afat të faturave të OSHEE në vlerën 536,678 lekë, me qëllim shmangjen e kamatëvonesave të paguara nga institucioni dhe mos lejimin në të ardhmen.

### **Menjëherë**

**16.Gjetje nga auditimi** Nga auditimi rezultoi se në 7 raste në procedurat e prokurimit publik, njësia e prokurimit nuk ka argumentuar kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht në procedurat me objekt si vijon:

- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i shkollës mesme “Kostandin Kristoforidhi”, (rikonstruksion dhe shtesë anësore 4 kate dhe palestër)”.
- Në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim rrjeti KUZ në zonat Informale”. zhvilluar në vitin 2022.
- Në procedurën e prokurimit me objekt “Sistemim asfaltim i rrugëve “Grigor Nosi”, “Xhafer Duhaxhiu”, “Hasan Kopili” në lagjen 5 Maji” zhvilluar në vitin 2022.
- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion, shtesë 4-kat dhe palestër {Shkolla Artistie Onufri” (e mesme e bashkuar) zhvilluar në vitin 2022.
- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i palestrave dhe tavaneve sportive, Shkolla e Mesme e Bashkuar “Luigj Gurakuqi”, Elbasan zhvilluar në vitin 2022.
- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rivitalizimi urban i qendrës së Gjinarit dhe Fushëkuqës”, zhvilluar në vitin 2022.
- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i gjendjes faktike të rrugës “Azmi Stringa” dhe “10 Korriku”, lagja “V. Xhuvani”, zhvilluar në vitin 2022. Veprimet e mësipërme në hartimin e kriterëve të veçanta të DST, bien në kundërshtim me kërkesat e pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2 faqe 96-172 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**16.1.Rekomandim** Kryetari i Bashkisë Elbasan të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kriteret e veçanta për kualifikim që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e objektit që prokurohet.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**17.Gjetje nga auditimi** Nga auditimi rezultoi se në 3 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht si vijon:

- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i shkollës mesme “Kostandin Kristoforidhi”, (rikonstruksion dhe shtesë anësore 4 kate dhe palestër)” me vlerë të fondit limit 130,818,929 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2022, është shpallur fitues shoqëria “B.N” ShPK me Nipt: K.....O për të cilën është lidhur kontrata nr. 3938/8 prot., datë 12.10.2022 për vlerën

119,492,640 lekë pa TVSH dhe vlera 140,255,606 lekë me TVSH, dhe me afat 8 (tetë) muaj nga data e lidhjes së kontratës i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të DST, por është kualifikuar dhe shpallur fitues.

- Në procedurën e prokurimit me objekt "Sistemim asfaltim i rrugëve "Grigor Nosi", "Xhafer Duhanxhiu", "Hasan Kopili" në lagjen "5 Maji" me vlerë të fondit limit 46,518,160 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2022, është shpallur fitues shoqërisë "B.N" Shpk, për të cilën është lidhur kontrata nr. 1288/6 prot datë 10.06.2022 për vlerën 43,635,704 lekë pa TVSH dhe vlera 52,362,845 lekë me TVSH, dhe me afat 3 (tre) muaj/deri më 10.09.2022 nga data e lidhjes së kontratës.

- Në procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksion, shtesë 4-kat dhe palestër Shkolla Artistie "Onufri" (e mesme e bashkuar) me vlerë të fondit limit 173,252,378 lekë pa TVSh zhvilluar në vitin 2022, është shpallur fitues shoqëria "E" Shpk për të cilën është lidhur kontrata nr. 4305/6 prot., datë 26.10.2022 për vlerën 159,373,270 lekë pa TVSH dhe vlera 191,247,923 lekë me TVSH, dhe me afat 11 muaj, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të DST, por është kualifikuar dhe shpallur fitues në kundërshtim me kërkesat e nenit 92, pika 3, nenit 99 pika 1 e ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2 faqe 96-172 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**17.1.Rekomandim** Titullari i AK Bashkia Elbasan, të analizojë arsyet e anomalive në vlerësimin e ofertave nga KVO, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**18.Gjetje nga auditimi: 1.1** Nga auditimi mbi regjistrin e parashikimeve dhe atë të realizimit të prokurimeve për blerje me vlerë të vogël u konstatua se: për mallra/grupmallra dhe shërbime/grup shërbime të njëjta, janë parashikuar me copëzim të fondit në 3 raste me vlera në tejkallim të vlerës limit prej 1,000,000 lekë, respektivisht:

- "Help desk Ticketing software 10 përdorues 2500l/m user 3 vjet" & "Blerje volume Licensing Microsoft 365 busines basic 100 user", me vlerë totale të fondit limit (pa TVSh) prej 1,583,333 lekë.

- "Kuti për ruajtjen e përhershme të dokumenteve RHK (40x20x18)" & "Dosje për ruajtjen e përhershme të dokumenteve (36x24)" & "Blerje dhurata ceremoniale, flamuj, korniza etj." & "Kartolina për fundviti", me vlerë totale të fondit limit (pa TVSh) prej 1,989,165 lekë.

- "Pjesë këmbimi goma, bateri, vaj etj" & "Furnizim/vendosje pjesë këmbimi" & " Shpenzime për mirëmbajtje mjete transporti" & "Goma" & " Vajra lubrifikantë" & "Vajra mishel", me vlerë totale të fondit limit (pa TVSh) prej 3,499,998 lekë. Për sa më lartë veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 56, pika 11, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". me Udhëzimi nr. 4, datë 18.06.2021 "Për hartimin e regjistrin të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrin të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik", Udhëzimi nr. 05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", Udhëzimi nr. 05, datë 29.07.2022 "Për disa ndryshime në manualin teknik që shoqëron Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike".

**1.2** Nga verifikimi i dosjeve të procedurave të prokurimit rezulton se në 2 dosje procedurash nga 16 dosje gjithsej, ka mungesë të dokumentacionit apo mangësi në përmbajtje si: Ftesa për ofertë në të gjitha rastet nuk kishin të plotësuar tabelën tip me informacionin e nevojshëm financiar; testimi i tregut nuk është bërë në çdo rast dhe si rrjedhojë as procesverbali përmbledhës apo dhe vendimi mbi çmimin e mallit/shërbimit, në rastet kur është bërë nuk ka të regjistruar datën kur është dokumentuar testimi; lista e OE që i janë përgjigjur ftesës apo klasifikimi përfundimtar i tyre, si dhe mungesë të dokumentacionit të OE fitues, në kundërshtim këto me ligjin nr. 162, datë

23.12.2020; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 dhe paketa e Udhëzimeve të MFE - APP përkatësisht: nr. 05, datë 25.06.2021; nr. 05, datë 29.07.2022; nr. 04 datë 20.05.2022; nr. 03, datë 18.06.2021 etj.

**1.3** Referuar regjistrin të parashikimeve, u konstatua se nuk jepet përshkrim i qartë mbi procedurën nëse përfshin përveç mallrave dhe shërbimit nga OE edhe magazinimin apo jo në ambientet e tij apo në ato të bashkisë, si në rastin e "Blerje medikamente dhe ushqim për qentë pa pronar", në kundërshtim me nenin 1 pika 2 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

**1.4** Nga verifikimi i dosjeve të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël rezultoi se në 2 raste (dosje) procedurash mungon Urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit apo shërbimit konkretisht në: "Dosjen nr. 14 "Mbikëqyrja e objektit për "F.V.barriera rrugore mbrojtëse" me UP nr. 777, dt. 10.02.2022 dhe USH nr. 1105, dt. 24.11.2022 dhe "Dosjen nr. 16 "Transporti për uniforma të SHMZSH (donacion Holanda)" me UP nr. 5849, datë. 14.12.2022 dhe USH nr. 98, dt. 22.02.2023", në kundërshtim me pikat 42,43 (për NA), 52,53,54 (për NZ) të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik". (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2 faqe 96-172 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**18.1. Rekomandim:** Drejtoria/ Sektori i Prokurimit Publik dhe Komisioni i Blerjeve me vlerë të vogël si pjesë përbërëse e saj, të marrin masa për të zbatuar rigorozisht në çdo procedurë gjithë hapat përkatës dhe me dokumentacionin e plotë përbërës, sipas kërkesave që përcaktojnë aktet ligjore e nënligjore mbi procedurat e prokurimit publik në përgjithësi dhe ato për blerjet me vlerë të vogël në veçanti.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**18.1. Rekomandim:** Drejtoria/ Sektori i Prokurimit Publik dhe Komisioni i Blerjeve me vlerë të vogël si pjesë përbërëse e saj, të marrin masa që: për mallra/grupmallra dhe shërbime/grup shërbime të njëjta të planifikohen pa copëtuar fondin total të parashikuar; të bëhen pjesë e dosjes dokumentimi i të gjitha hapave të procedurës si dhe që në parashikim të përshkruhet në mënyrë të detajuar përveç karakteristikave të mallit/shërbimit dhe transportit, edhe vendmagazinimi për mallrat me specifike të veçantë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**18.2.Rekomandim:** Titullari i njësisë vendore në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues apo personi i autorizuar prej tij, të miratojë për çdo rast urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave apo shërbimeve për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**19.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjeve fizike të procedurave të prokurimit dhe dosjeve të zbatimit të punimeve për periudhën 01.01.2022 deri me 31.12.2022 rezultoi se dosjet fizike nuk janë të numëruara, të inventarizuara, dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit në përfundim të procesit, në kundërshtim me nenin 36, Kreun V, ligji nr.9154 datë 06.11.2003 "Për arkivat" si dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2 faqe 96-172 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**19.1.Rekomandimi:** Sektori i prokurimeve dhe investimeve në Bashkinë Elbasan me qëllim shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentit, të marrë masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, por edhe për të gjitha rastet në vijim, në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**20.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit për objektet “Rikonstruksioni dhe ndërhyrje në linjën KUZ dhe ndërtimi i sheshit të parkimit të varrezat publike” dhe “Sistemim asfaltim i rrugëve “Grigor Nosi”, “Xhaferr Duhaxhiu”, “Hasan Kopili”, në lagjen 5 Maji” rezulton se Drejtorja e Projektimit dhe Azhornimit Topografik, grupi i projektimit gjatë hartimit të preventivit të punimeve ka përfshirë zërin “spërkatje me bitum në shtresën e stabilizant” dhe “zërin e transportit të zërave të prishjes të shtresave të betoni”, të cilat janë të përfshirë respektivisht në analizat e çmimeve të shtresave asfaltike dhe prishjet e shtresave betonit, veprime në kundërshtim me VKM nr.629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 172-197 të Projekt Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**20.1 Rekomandimi:** Drejtorja e Projektimit dhe Azhornimit Topografik, në Bashkinë Elbasan të marrë masat që në hartimin e projekt preventiva në projektet që do të projektohen nga kjo Drejtori, për çdo zë pune të paraqesë sipas analizave të manualeve të çmimeve në fuqi, me qëllim evidentimin e llogaritjes në preventiv dy herë të të njëjtit zë pune.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**21.Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të objektit “Rikonstruksioni dhe ndërhyrje në linjën KUZ dhe ndërtimi i sheshit të parkimit të varrezat publike” rezultuan mangësitë si më poshtë:

- Projekti, preventivi i ripunuar dhe procesverbali mbi rakordimin e volumeve janë të pa firmosur dhe vulosur nga AK.

- Gjatë ndryshimeve në projekt u konstatua se janë hequr në preventivin e ripunuar zërat për ndërtimin e dekantuesit të ujërave të zeza para derdhjes në përrua dhe pusit në sistemin e vaditjes për vaditjen e bimësisë së mbjellë rreth zonës së parkimit pa aprovimin e AK. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Udhëzimi nr.2, datë 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I, pika 7, dhe 7.1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 172-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**21.1. Rekomandimi:** Bashkinë Elbasan të marrë masat që të gjitha ndryshimet e realizuara të projekt të aprovohen nga AK, me qëllim që të shprehin dakordësinë dhe aprovimin zyrtar në rolin e Investitorit të punimeve, për çdo ndryshim të kërkuar nga Sipërmarrësi i punimeve dhe më pas certifikimin e këtyre punimeve të miratuara.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**21.2. Rekomandimi:** Bashkia Elbasan të marrë masa për parashikimin e një investimi në të ardhmen për ndërtimin e dekantuesit, me qëllim evitimin e ndotjeve të mjedisit dhe marrjen e aprovimeve përkatëse.

*Menjëherë*

**22.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit për objektet “Rikonstruksioni dhe ndërhyrje në linjën KUZ dhe ndërtimi i sheshit të parkimit të varrezat publike” dhe “Sistemim asfaltim i rrugëve “Grigor Nosi”, “Xhaferr Duhaxhiu”, “Hasan Kopili”, në lagjen “5 Maji” u konstatua mungesa e dokumenteve kryesorë teknik të zbatimit të punimeve të ndërtimit që vërteton kontrollin e cilësisë së punimeve, si certifikatat e cilësisë së materialeve të ndërtimit dhe testet laboratorike, mix design për betonet, veprime në kundërshtim me Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” kreu III, Dokumentacioni Teknik i Punimeve të Ndërtimit ku citohet: “.9.Në kantierin e punimeve krijohet e plotësohet gradualisht dosja teknike e objektit, ku sipas problematikës, mbahen: dh) Certifikatat e cilësisë të materialeve e të produkteve, testimet dhe rezultatet e tyre”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 172-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**22.1 Rekomandimi:** Mbikëqyrësi i punimeve dhe Sektori i Investimeve në Bashkinë Elbasan të marrin masat për administrimin e dokumentacionit të nevojshëm teknik, me qëllim verifikimin e cilësinë e materialeve e të produkteve të përdorura.

**23.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se miratimi i “Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup>”, me nr. AN131020220037, për të cilën është marrë vendimi për miratim Nr. 2769/5 Prot; datë 07.12.2022, të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, për objektin “Prishje e objektit ekzistues dhe ndërtim i objektit me 4, 6, 8, 10, 11 dhe 12 kat me 2 kate parkim nëntokë”, me adresë në lagjen “Dyli Haxhire”, Bashkia Elbasan, me subjekt zhvillues z. D.S, është aplikuar gabim sipërfaqja prej 91.3 m<sup>2</sup> për kalimin në favor të Bashkisë Elbasan 3% (tre përqind) të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale sipas Ligjit nr. 22/2018 “Për strehim social”, datë 03.05.2018.

Nga përllogaritja e grupit të auditimit, sipërfaqja takuese si kontribut i sektorit privat ndaj fondit publik të banesave sociale, rezulton të jetë 5564.32 m<sup>2</sup> (sip. banim) \* 0.03 = 166.93 m<sup>2</sup>. Bashkia Elbasan referuar akt marrëveshje me subjektin zhvillues z. D.S ka përcaktuar si detyrim sipërfaqen prej 91.3 m<sup>2</sup> me diferenc 75.63 m<sup>2</sup> (166.91-91.3) banim që duhet të kaloj në favor të Bashkisë Elbasan. Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar si dhe V.K.M.-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar me V.K.M.-në nr. 271 datë 06.04.2016 “Për një ndryshim në V.K.M.-në nr. 408 datë 13.05.2015”, nenin 19 të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 5, faqe 197-218 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**23.1.Rekomandimi:** Drejtorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të marrë të gjitha masat e nevojshme për lidhjen e një Akt-marrëveshjeve me subjektet zhvillues “Z. D.S”, për kalimin e sipërfaqes totale prej 75.63 m<sup>2</sup> (166.91-91.3) banim në favor të Bashkisë Elbasan.

**24.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe zhvillimit u konstatua se në 3 (tre) raste, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

- Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250m<sup>2</sup>”, me nr. AN190220220018, për të cilën është marrë vendimi për miratim Nr. 2369/6 Prot; datë 25.08.2022, të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, për objektin "Godinë shërbimi 1 kat" me adresë "Katund i Ri", Bashkia Elbasan, me subjekt zhvillues z. A.H është shqyrtuar me afate të tej zgjatura prej 83 ditësh pune, nuk është kërkuar ose respektuar mendimi i autoriteteve që duhet të shprehen në lidhje me lejet e ndërtimit, Mungon projekti për instalimet e ngrohje – ftohjes dhe ventilimit (H-VAC), së bashku me dokumentacionin shoqërues, relacionin, vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, licencat profesionale, preventivin e punimeve, si dhe policën dhe deklaratën e përgjegjësisë profesionale, nuk respekton distancat urbane nga kufiri i pronës në fasadë lindore të objektit sipas përcaktimeve të Nenin 34 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 4. Distanca e miratuar e ndërtesës nga kufiri i pronës është 0.8 m (fasada lindore është kallkan), ndërsa distanca minimale e lejuar sipas dispozitave ligjore është 1 m, nuk zbaton përcaktimet për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapësira publike. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore 1/180, referuar dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Elbasan, KSHR = 8% dhe KSHP = 8%, në këtë leje nuk ka asnjë parashikim për plotësimin e këtyre dy treguesve të zhvillimit si dhe nuk është në përputhje me përdorimin e lejuar të tokës për njësinë strukturore. Nga pasaporta e njësisë strukturore 1/180, pjesë e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Elbasan, marrim informacionin se kjo njësi i përket sistemit urban (UB), kategori banim (85%) dhe shërbime(15%).
- Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250m<sup>2</sup>, me nr. AN131020220037, për të cilën është marrë vendimi për miratim Nr. 2769/5 Prot; datë 07.12.2022, të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, për objektin “Prishje e objektit ekzistues dhe ndërtim i objektit me 4, 6, 8, 10, 11 dhe 12 kat me 2 kate parkim nëntokë”, me adresë në lagjen “Dyli Haxhire”, Bashkia Elbasan,

me subjekt zhvillues z. D.S nuk zbaton përcaktimet për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapësira publike. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore 1/27, marrim informacionin se koeficienti i shfrytëzimit të territorit për rrugë KSHR është 22% dhe koeficienti i shfrytëzimit të territorit për hapësira publike KSHP është 15%, Nuk është respektuar kushti për infrastrukturën, përcaktuar në lejen e zhvillimit. Referuar dokumentit të lejes së zhvillimit, me nr. 2550/2 prot; datë 30.09.2022, pika 6 “Kushte të veçanta”, nënpika 3 si dhe mungon licenca profesionale personale e hartuesit të studimit sizmik, Për këtë studim, është ngarkuar licenca e subjektit N ShPK, ku znj. E.V figuron në rolin e drejtueses teknike (informacion i marrë nga licenca profesionale e subjektit), por ky fakt nuk vërteton se znj. E.V është e licencuar për kryerjen e studimeve sizmike.

- Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe me të madhe se 250 m<sup>2</sup>, me nr. AN200120220033, për të cilën është marrë vendimi për miratim Nr. 2316/5 Prot; datë 16.03.2022, të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, për objektin "Objekt shërbimi 1 kat ", me adresë në fshatin Katund i Ri, Elbasan, me zhvillues z.B.K, znj.V.K, z.A.K znj.S.K, nuk paraqet konturin e pasurisë si edhe të dhëna të tjera për gjendjen faktike të objektit dhe objekteve kufitare, Mungon projekti për instalimet e ngrohje – ftohjes dhe ventilimit (H-VAC), së bashku me dokumentacionin shoqërues, nuk ka filluar ndërtimin brenda afateve të përcaktuara në ligj. Referuar dokumentit të lejes së ndërtimit, për të cilën është marrë vendimi për miratim Nr. 2316/5 Prot; datë 16.03.2022, të Kryetarit të Bashkisë Elbasan si dhe nuk zbaton përcaktimet për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapësira publike, Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore 3/8, referuar dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Elbasan, KSHR = 12% dhe KSHP = 15%, në këtë leje nuk ka asnjë parashikim për plotësimin e këtyre dy treguesve të zhvillimit.

Sa me sipër veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, nenet 10, 15, 21, Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Elbasan, Neni 8.1.2, 8.1.3, 8.1.4. VKM-në nr. 1162, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 5, faqe 197-218 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**24.1.Rekomandimi:** Nga SPZHT dhe Bashkia Elbasan të merren të gjitha masat për të kërkuar, në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose çertifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacion e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi, si dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi me mangësi të tilla. SPZHT duhet të kërkojë në çdo rast dokumentacionin që vërteton statusin aktiv dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) të subjekteve që kanë hartuar projektin ndërtimor. SPZHT dhe Bashkia Elbasan të marrin masa për të kontrolluar të gjithë dokumentacionin e dorëzuar mbi saktësinë dhe plotësinë e tij, SPZHT dhe Bashkia Elbasan të marrin masa për të kërkuar në çdo rast që aplikohet për leje ndërtimi, rifreskimin e kartelave të pasurisë së paluajtëshme në më pak se tre muajt e fundit, me qëllim marrjen e sigurisë se mbi pronë nuk janë aplikuar tjetërsime.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**24.2.Rekomandimi:** Nga SPZHT dhe Bashkia Elbasan të merren të gjitha masat për të shqyrtuar vetëm ato aplikime për leje zhvillimi, të cilat kanë ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, ndër të tjera, edhe projekt-idenë arkitektonike të objektit që kërkohet të zhvillohet, me qëllim dhënien e një vlerësimi të saktë mbi respektimin e kriterëve urbane në varësi të funksionit të saj dhe të përdorimit të tokës, në përputhje me dispozitat ligjore.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**25.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi organizimin dhe funksionimin u konstatuan veprime dhe praktika jo efektive të IMTV Bashkia Elbasan si vijon:

**I. Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi:**

**1.1** Nga auditimi i strukturës organizative të IMTV-së, u konstatua se në IMTV Bashkia Elbasan, para dhe përgjatë periudhës objekt auditimi, është punësuar staf në kundërshtim me nenin 11 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar.

**1.2** Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se njësia e IMTV Bashkia Elbasan gjatë vitit 2022 *nuk ka ushtruar* funksionet e veta me një strukturë të plotë, konform akteve ligjore/nënligjore dhe të atyre rregullatore të bashkisë.

**1.3** Nga auditimi u konstatua se vlera e masës së gjobës, nuk është vendosur konform përcaktimeve të ligjit nr. 119/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, në nenin 52, pika 1 germa (e).

**1.4** Me mosangazhimin e IKMT për ekzekutimin e vendimeve të marra nga IMTV, është krijuar një periudhë e gjatë kohore inaktive. Nga ana e IMTV për këtë periudhë u konstatua se nuk është ushtruar ri-inspektim në objektet me “leje pezullimi” apo “Vendim prishje” në moszbatim të VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore” pika 1/b/iii.

**1.5** Nga auditimi rezultoi se nuk ka një sistem elektronik për regjistrimin në kohë të akteve të përpiluara nga IMTV, për një bashkëpunim dhe administrimin me efektivitet të informacionit nga IKMT, Drejtoria e Taksave, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të zhvillimit të territorit dhe Drejtoria Ligjore. Në mungesë edhe të mjeteve dhe makinerive të IMTV-së Bashkia Elbasan, ky sistem do të bënte të mundur hartimin e një plani efektiv nga IKMT për të ekzekutuar brenda një periudhe të afërt kohore vendimet e IMTV.

**1.6** Nga kontrolli i dokumentacionit, u konstatua se kryeinspektori, për periudhën objekt auditimi ka miratuar planin vjetor të punës me nr. 06/1 prot., datë 06.01.2022, por nuk është fragmentuar në plane mujore me qëllim rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së IMTV-së kjo në kundërshtim me pikën 1 germa b/ii të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”, dhe pika 2 e nenit 112 të Rregullores së Bashkisë Elbasan, miratuar me Urdhrin e kryetarit nr. 27 dhe me nr. 1776 prot., datë 20.04.2018.

**II. Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV-së; Për subjektet të cilat kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV:**

**2.1.** Ndonëse në IKMT janë përcjellë kërkesat për bashkëpunim në ekzekutimin e vendimeve për “prishje objekti”, për periudhën nën auditim (deri në shtator 2023), nga ana e IKMT *nuk është ekzekutuar asnjë vendim*. U konstatua se nga ana e IMTV, nisur nga vonesat e IKMT për ekzekutim të vendimeve dhe pasojat përveçse ligjore e financiare por edhe sociale që sjell, nga IMTV /Bashkia Elbasan rezultojnë të jetë paraqitur në kërkesat buxhetore vjetore për vitin 2022 si nevojë imediate, pajisja e IMTV-së Bashkia Elbasan (blerje) me mjetet dhe makineritë e duhura të cilat shërbejnë për prishjen e objekteve, pra për ekzekutimin e vendimeve për “prishje objekti pa leje”. Për vitin 2022 kërkesa i është drejtuar Kryetarit të Bashkisë me shkresën nr. 1124 prot., datë 08.08.2022. Kjo kërkesë është përsëritur edhe për vitin 2023 dhe rezultojnë të mos jetë planifikuar në PBA 2022-2024. Pajisja e IMTV-së me mjetet e nevojshme (fadroma) do të sillte rritje të efektivitetit në aktivitetin e IMTV nga njëra anë dhe besueshmërinë e komunitetit tek veprimtaria e bashkisë, në zbatim të Ligjit nr. 139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 3 “Misioni i vetëqeverisjes vendore”.

**2.2** Nga të dhënat e pasqyruara në tabela vihet re se arkëtimet nga gjobat e IMTV -së kanë patur trend në rënie deri në fund të vitit 2021; gjatë vitit 2022 me futjen e shërbimit përmbartimor është përmirësuar situata, duke sjellë rritjen e numrit të arkëtimeve. Deri në datë 31.12.2022 numri i debitorëve të mbartur është ulur në 130 dhe vlera debitorëve vetëm për vitin 2022 është 38,000 mijë lekë, ndërsa për vitet 2020 dhe 2021 *ka mungesë informacioni*. Kjo për faktin se nuk ka raporte statistikore mbi vlerën historike të gjobave të vendosura nga IMTV, gjë që tregon se nuk janë



zhvilluar analiza periodike dhe vjetore mbi veprimtarinë e saj, nuk është raportuar te titullari dhe te njësia përgjegjëse për kontabilizimin e tyre.

**III. Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.**

**3.1** Nga kontrolli i dokumentacionit, rezultoi se janë ushtruar nga k/inspektori/ët inspektime në objektet e pajisura me leje ndërtimi, dhe vetëm për ato subjekte që kanë rezultuar në kundërvajtje janë përpiluar “proces verbale konstatimi”, u konstatua se për subjektet e tjera që janë inspektuar dhe kanë rezultuar korrekt me kërkesat ligjore nuk janë përpiluar akte kontrolli, veprim ky në kundërshtim me nenin 4, nenin 5 germa (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar dhe nenin 51 “Inspektimi” të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, pikës 2 të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”.

- Njëkohësisht theksojmë se në mungesë të stafit të kualifikuar, ky kontroll do ishte i pamundur pasi inspektor k/inspektori/ët nuk plotësojnë kriteret e kualifikimit profesional/arsimor konform ligjit, për të kryer akte inspektimi/ kontrolli në objektet që kanë leje ndërtimi. Kjo vërtetohet edhe nga fakti se nga ana e IMTV-së janë mbajtur proces verbale konstatimi vetëm për “shkelje afati” pra konstatim i karakterit ligjor. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 6, faqe 218-230 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**25.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Elbasan, të marrë masa për të krijuar një strukturë të IMTV me staf të kualifikuar kryesisht të profilit inxhinieri, për të rritur cilësinë e inspektimit dhe të kontrollit për ndërtimet pa leje dhe zbatimin e lejeve të ndërtimit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**25.2.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës, Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe medias, Drejtorinë e Taksave e Tarifa Vendore dhe Drejtorinë e Prokurimeve publike të marrin masa për implementimin e një sistemi elektronik për regjistrimin në kohë të akteve të përpiluara nga inspektorët e IMTV si dhe për sigurimin e infrastrukturës dhe mjeteve të nevojshme, për të bërë të mundur ekzekutimin në kohë të vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**25.3.Rekomandimi:** Kryeinspektori dhe inspektorët e IMTV-së të hartojnë e miratojnë plane mujore e vjetore mbështetur edhe në informacionin mbi lejet e ndërtimit të lëshuara nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të territorit; të mbajnë akte kontrolli për të gjitha inspektimet që kryejnë tek ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse; të bëjnë një vlerësim real të masës së gjobës për kundërvajtësin duke zbatuar ligjshmërinë e standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës; të hartojnë raporte periodike dhe vjetore mbi aktivitetin e njësisë; të raportojnë tek Drejtoria e Financës për kontabilizimin në kohë të vendimeve “me gjobë” të zbardhura prej tyre si dhe t’i kushtohet vëmendje e veçantë masave për ekzekutimin në kohë të vendimeve “me gjobë” ndaj kundërvajtësve aktualë dhe arkëtimit të tyre nga debitorët historikë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nga Titullari i njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera

në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **3,418,530 lekë me TVSH**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “*Rikonstruksioni dhe ndërhyrje në linjën KUZ dhe ndërtimi i sheshit të parkimit te varrezat publike*” nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt me vlerë **887,852 lekë me TVSh**, veprime në kundërshtim me kontratën me nr. 5457/6 prot., datë 07.03.2022, lidhur midis Bashkisë Elbasan dhe OE “I ” ShPK. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 172-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1.Rekomandimi:** Bashkia Elbasan të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **877,852 lekë me TVSh** nga OE “I ” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës me nr. 5457/6 prot., datë 07.03.2022, me objekt “*Rikonstruksioni dhe ndërhyrje në linjën KUZ dhe ndërtimi i sheshit të parkimit te varrezat publike*”, vlerë kjo që përbën dëm ekonomik ndaj fondeve të buxhetit të shtetit.

**Branda datës 30.6.2024**

**2. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “*Sistemim asfaltim i rrugëve “Grigor Nosi”, “Xhaferr Duhaxhiu”, “Hasan Kopili”, në lagjen 5 Maji*” nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt me vlerë **778,220 lekë me TVSh**, veprime në kundërshtim me kontratën me nr. 1288/6 prot., datë 10.06.2022, lidhur midis Bashkisë Elbasan dhe OE “B.N ” ShPK. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 172-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1.Rekomandimi:** Bashkia Elbasan të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 778,220 lekë me TVSh nga OE “B.N ” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës me nr. 1288/6 prot., datë 10.06.2022, me objekt “*Sistemim asfaltim i rrugëve “Grigor Nosi”, “Xhaferr Duhaxhiu”, “Hasan Kopili”, në lagjen 5 Maji*”, vlerë kjo që përbën dëm ekonomik ndaj fondeve të buxhetit të shtetit.

**Branda datës 30.6.2024**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se për vitin 2022 Bashkia Elbasan ka lidhur kontratë pastrimit e qytetit me subjektin “A” ShPK, për të cilën rezultuan mangësi dhe shkelje, sa vijon:

a. Në 1 rast, Bashkia ka likuiduar padrejtësisht vlerën 321,720 lekë dem ekonomik për subjektin “A” ShPK, konkretisht zëri “*transport mbetjeve voluminoze*” për 459 ton, përfituar nga subjekti i pastrimit, në kundërshtim me ligjin nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin integruar mbetjeve urbane” dhe me VKM nr. 319 datë 31.05.2018 “Për miratimin masave për koston menaxhimit integruar mbetjeve urbane” si dhe me shtojcën 1 miratuar me këtë VKM.

b. Në 4 raste nuk janë zbritur sipërfaqet e zëna nga rikonstruksionet e rrugëve, shesheve, trotuareve, gjate vitit 2022, përkatësisht:

- Nuk është zbritur vlera 225,060 lekë për sipërfaqen rruge 5100 m2 “shtresa çakulli stabilizant” dhe sipërfaqen trotuar 950 m2 “vendosje pllaka” objekti “*sistemim asfaltim rrugëve Xhaferr Duhaxhiu, Grigor Nosi, Hasan Kopili, lagje 5 Maj*”, sipas urdhër shpenzimit 727 datë 16.08.2022, situacionit 1, kontratës 1288/6 datë 10.06.2022, afat 1 muaj.

- Nuk është zbritur vlera 54,250 lekë për sipërfaqen rruge 3500 m2 “shtresa çakulli e stabilizant” në objektin “*Ndërtim i sheshit parkimit të varrezave publike*”, sipas urdhër shpenzimit 795 datë 07.09.2022 dhe 1261 datë 29.12.2022, situacionit 1, kontratës 5457/6 datë 07.03.2022 me afat 5 muaj.

- Nuk është zbritur vlera 149,581 lekë për sipërfaqen rruge 4,021 m2 “Shtresa çakulli e stabilizant” në objektin “*Asfaltim rrugëve Shpëtim Arapi dhe shesheve pallateve 580/16, 580/16, 580/17,*

580/19, 580/30 ne lagjen 11 Nëntori”, sipas urdhër shpenzimit 855 datë 19.09.2022 dhe situacionit nr. 2.

\* Nuk është zbritur vlera 139,537 lekë për sipërfaqen sheshe 3,401 m2 shtresa “rërë dhe pllaka betoni” dhe sipërfaqen trotuar 350 m2 vendosje “shtresa rërë” në objektin “Rikonstruksion i shesheve të pallateve 650, 651,652, 653 në lagjen Partizani”, sipas urdhër shpenzimit 862 datë 21.09.2022 dhe situacionit 1, kontratës 5237/8 datë 24.01.2022. Në total vlera e paguar tepër për vitin 2022 është vlera 568,428 lekë e cila përbën dëm ekonomik, pagesa për pune pakryer për subjektin e pastrimit “A” ShPK.

Veprime në kundërshtim me kontratën nr. 1186/17 datë 14.12. 2021, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik dhe me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin". (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 73-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** Bashkia Elbasan të marrë masa për arkëtimin e vlerës **890,148 lekë** nga firma pastrimit “A” ShPK, përkatësisht:

- a. vlera 321,720 lekë, për zërin “transport i mbetjeve voluminoze” si shpenzim pa baze ligjore dhe të ndërpresë pagesën e këtij zëri për vitin 2024;
- b. të rishikoje zërin “transport dhe largim i mbetjeve urbane direkt nga shtëpitë e qytetareve për çdo dite” me mbarimin e afatit kontraktor, pasi është shpenzim i pajustificuar;
- c. vlera 568,428 lekë, pagese për pune te pakryer ne zërin “Fshirje mbetjeve urbane”, për sipërfaqet e zëna nga rikonstruksionet rrugëve, shesheve, trotuareve qytetit të vitit 2022.

**Branda datës 30.6.2024**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i bankës për vitin 2022 rezultoi se në 7 raste, është likuiduar TVSH 2–herë për vlerën 709,648 lekë për zërat “Pajisjet elektrike e hidraulike”, pasi nuk është ndarë veças vlera e “montimit” të pajisjeve pa TVSh dhe veças vlera e “pajisjeve” me TVSh dhe vihet në fund të situacionit, për rrjedhojë përfutuar padrejtësisht nga subjektet, konkretisht:

1. vlera 23,587 lekë, “B.N” ShPK, për objektin “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet varfra e të pafavorizuara”, sipas urdhër shpenzimit 295 dhe 296 datë 11.05.2022.
2. vlera 244,886 lekë, “B.N ”, për objektin “Rikonstruksion 3 rrugëve dhe shesheve pallateve 579,579/3, 579/4, 579/5, 580/1”, sipas urdhër shpenzimit 425 datë 10.06.2022.
3. vlera 85,315 lekë, “B” ShPK, për objektin “Rikonstruksion i fushës minikalçetos dhe rrethim i kompleksit sportiv Sh.Lamcja”, sipas urdhër shpenzimit nr. 430 datë 10.06.2022.
4. vlera 107,080 lekë, “E” ShPK, për objektin “Rikonstruksion rrugës Abdyl Kajanaku”, sipas urdhër shpenzimit nr. 426 datë 10.06.2022.
5. vlera 13,400 lekë, “E” ShPK, për objektin “Rikonstruksion shtese kati dhe palestër Shkolla Artistike Onufri”, sipas urdhër shpenzimit nr. 1242 datë 27.12.2022.
6. vlera 180,000 lekë, “S.” ShPK, për objektin “Rehabilitim sheshit urban lindje rrugës Iljaz Kosova, xhamia Fush-Mret”, sipas urdhër shpenzimit 1152 datë 07.12.2022.
- 7- vlera 55,380 lekë, subjekti fizik “A.B ” për blerjen e 5 pompave zhytëse dhe elektrike për nevoja të saj sipas urdhër shpenzimit nr. 142 datë 21.07.2022 të ASHP.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 ,“Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 73-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1. Rekomandimi:** Bashkia Elbasan të marrë masa për arkëtimin e vlerës **709,648 lekë** e cila përbën dëm ekonomik, për likuidim 2 herë TVSH, në 7 raste, të TVSH-së për 5 subjekte:

1. Subjekti “B.N” ShPK, në vlerën 23,587 lekë
2. Subjekti “B.N” ShPK në vlerën 244,886 lekë
3. Subjekti “B” ShPK në vlerën 85,315 lekë
4. Subjekti “E” ShPK në vlerën 107,080 lekë
5. Subjekti “E” ShPK në vlerën 13,400 lekë

6. Subjekti "S." ShPK. në vlerën 180,000 lekë
7. Subjekti fizik "A.B" në vlerën 55,380 lekë

**Branda datës 30.06.2024**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i bankës për vitin 2022 rezultoi se në 2 raste, Bashkia Elbasan ka likuiduar 76,600 lekë, për pagese pushime vjetore të pakryera të vitit 2022, në vend të kompensimit tyre me pushime, duke qene e mundur kryerja e tyre deri ne fund te 3-mujorit pare 2023, në kundërshtim me VKM nr. 568 datë 06.10.2021 "*Për miratimin rregullave për kohëzgjatjen punës e pushimit, orët shtese dhe kompensimin tyre ne institucionet administratës shtetërore, institucionet pavarura, njësite vetëqeverisjes vendore*", kap III, pika 8, konkretisht: 42,732 lekë A.Q 02.09.2022 dhe 33,869 lekë L.Z, sipas urdhër shpenzimit 771 datë 02.09.2022 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 73-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5.1. Rekomandimi:** Bashkia Elbasan të marrë masat për arkëtimin e vlerës **76,600 lekë** për pagesë të paligjshme të pushimeve vjetore 2022, në vend të kompensimit me pushime, konkretisht: z. A.Q në vlerën 42,732 lekë dhe znj. L.Z në vlerën 33,869 lekë.

**Branda datës 30.06.2024**

**6. Gjetje nga auditimi:** Në objektin "*Rikonstruksion i fushës së minikalçetos dhe rrethim me kangjella i murit verior të kompleksit sportiv "Shefqet Lamcja"*" nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, situacionit përfundimtar, librezave të masave dhe auditimit në terren, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt me vlerë **76,062 lekë me TVSh**, veprime në kundërshtim me kontratën me nr.5269/6 prot., datë 13.12.2021, lidhur midis Bashkisë Elbasan dhe OE "B" ShPK. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 172-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1.Rekomandimi:** Bashkia Elbasan të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **76,062 lekë** me TVSh nga OE "B" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës me nr. 5269/6 prot., datë 13.12.2021, me objekt "*Rikonstruksion i fushës së minikalçetos dhe rrethim me kangjella i murit verior të kompleksit sportiv "Shefqet Lamcja"*", vlerë kjo që përbën dëm ekonomik ndaj fondeve të buxhetit të shtetit.

**Branda datës 30.6.2024**

## **C.I. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA - TË ARDHURA TË MUNGUARA.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se Bashkia Elbasan për transportin e administratës dhe kryerjen e shërbimeve publike të Bashkisë, ka nënshkruar kontratë qiraje me subjektin "E" ShPK për 3 automjete, për një periudhë 1-3 vjeçare (2021-2022-2023) sipas kontratave respektive të miratuar me VKB. Bashkia ka likuiduar dhe vazhdon likuidimin e qirasë të 3 mjeteve, përkatësisht:

- 1 autoveture "*Wolvagen Sharan*" me 60,000 lekë/muaj, ose lekë/ 3 vite
- 1 fadrome "*Caterpillar*" me 178,000 lekë/muaj x 12 muaj x 3 vite = 6,408,000 lekë
- 1 automjet "*Land-Rover*" me 75,000 lekë/muaj x 12 muaj=900,000 lekë/vit

Shpenzimi i qirasë prej 9,5 milion lekë paraqet mos efektivitet të fondeve, pasi me këtë vlere 3 mjetet mund te bliheshin te reja. Gjithashtu nuk argumentohen tarifat e larta të qirasë për 3 mjetet dhe nuk justifikohet arsyeja e marrjes me qira te 3 mjeteve, pasi Bashkia dhe ndërmarrja e shërbimeve publike për kryerjen e këtyre shërbimeve disponon mjetet e veta, madje te këtyre llojeve, konkretisht: 15 autovetura (*vetura, furgona dhe foristrada etj*), 8 fadroma, 2 borëpastruese, 1 traktor, 3 eskavator, kamionë të ndryshëm, mjete tjera të blera në 2022. Veprime në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*". (*Më hollësisht*

*trajtuar në pikën 3 faqe 73-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Elbasan të ndërpresë likuidimin dhe kontratat me subjektet qiradhënëse “E” ShPK me mbarimin e afateve kontraktore janar 2024, për 3 automjetet e marra me qira, përkatësisht: “Wolzvagen Sharan”, Fadrome “Caterpillar” dhe 1 “Land-Rover”, pasi këto shpenzime qiraje nuk janë efektive për buxhetin, sepse Bashkia dhe ASHP disponon mjetet e veta.

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se për vitin 2022 Bashkia Elbasan ka shpenzuar vlerën 1,120,359 lekë mos efektivitet shpenzimesh, për dieta jashtë vendit në Budva, për 50 pjesëmarrës përfshire dhe anëtar KB, në kuadër të bashkëpunimit me Bashkinë Tivar për forcimin vlerave kulturore historike, sipas urdhër shpenzimit nr. 936 dhe nr. 937 datë 12.10.2022, rezulton se shpenzimet për dietat me jashtë shtetit nuk justifikohen, pasi: trajtimi me diete jashtë shtetit të anëtareve të KB, të cilët nuk janë pjese e administratës, bien ndesh me çdo lloj pagese tjetër, përveç 10% pagës titullarit dhe është në papajtueshmëri me funksionin këshilltarit dhe konflikt interesi, me ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Gjithashtu mungojnë rezultatet dhe analiza e shërbimit si dhe relacioni, për efekt justifikimi dietave si dhe nuk justifikohet numri i lartë prej 50 vetash me burim financimi nga taksapaguesit. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 870, datë 14.02.2011 “Për trajtimin financiar punonjësve dërgohen shërbim jashtë vendit”, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 73-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Elbasan të shmang shpenzimet jo efektive, për dieta me jashtë vendit të pa justifikuara, me numër të lartë prej 50 pjesëmarrës përfshire dhe anëtar KB, sipas urdhër shpenzimit nr. 936 dhe nr. 937 datë 12.10.2022.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë rezulton se për vitin 2022 janë debitor 13 qytetarë me vlerë totale 495,211 lekë dhe nga vitet e mëparshme në vlerë totale 15,195,508 lekë, që përbën në total 15,690,719 lekë, të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Elbasan. Ky veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27. Ligjin nr. 95/2018 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c. Ligjin nr. 98/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 1, “në nenin 27, pika 3, shkronja “c”. VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “ Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 2.6, faqe 51-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit duhet të bashkëpunojnë dhe të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për vlerën **15,690,719 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se: Në fund të vitit 2022 gjendja e debitorëve është në vlerën 139,229,606 lekë ndërsa progresiv deri në 31.12.2022 për subjektet fizik/juridik është 732,528,023 lekë, vlerë kjo që sjell të ardhura të pa-arkëtuara nga planifikimi në buxhetin e Bashkisë Elbasan. Gjendja e debitorëve e familjarëve është në vlerën 91,931,722 lekë ndërsa progresiv deri në 31.12.2022 për subjektet fizik/juridik është 295,754,386 lekë, vlerë kjo që sjell të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Elbasan. Për taksën e tokës bujqësore për vitin 2022 janë debitorë 9287 familjeve me vlerë të detyrimit 23,152,825 lekë, ndërsa vlera

progresive deri me 31.12.2022, që përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Elbasan është në vlerën 75,567,148 lekë. Gjendja e debitorëve ndaj drejtorisë së ShMZSh-së progresiv deri në 31.12.2022 është 1,069,250 lekë, vlerë kjo që sjell të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Elbasan.

Në total borxhi tatimor në Bashkinë Elbasan rezulton në vlerë 1,029,351,659 lekë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Elbasan. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Tatim Taksave lidhur me zbatimin e hapave që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar bizneset debitorë sipas Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4 pika 1 dhe 2, Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 89, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore të Republikës së Shqipërisë”, pika 89, i ndryshuar. Pas kalimit të afatit për pagimin në mënyrë vullnetare të këtyre detyrimeve, Drejtoria e Tatimeve Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave ka urdhëruar bllokimin e llogarive bankare apo llogarive depozitë për 2079 subjekte në vlerën 417,628 mijë lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 2.6, faqe 51-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1.Rekomandimi:**Drejtorja e Tatim Taksave në Bashkinë Elbasan, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të vitit 2022 në vlerën:

1. Taksa dhe tarifa familjare në vlerë 295,754,386 lekë;
2. Debitorë e Bizneseve në vlerë 732,528,023 lekë;
3. Debitorë ndaj Drejtorisë së ShMZSh në vlerë 1,069,250 lekë.

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Tatim Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Tatim Taksave, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Sektori i Tatim Taksave të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Elbasan, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i gjobave të vendosura nga Inspektorati i Mbrojtës Territorit, Bashkia Elbasan për vitin 2022 janë vendosur 83 gjoba në vlerë 41,100,000 lekë, nga të cilat është paguar në mënyrë vullnetare nga 8 subjekte vlera 3,600,000 lekë si dhe nuk kanë paguar 75 subjekte me vlerë totale të gjobave të vendosura 37,500,000 lekë për periudhën 01.01.2022-31.12.2022. Nga Inspektorati i Mbrojtës Territorit nuk janë ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, në kundërshtim me nenin 16, i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime, nenet, 9, 22 dhe 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 2.6, faqe 51-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.2.Rekomandimi:**Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për vlerën totale **37,500,000 lekë**. Gjithashtu, IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit

duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

**Brenda datës 30.6.2024**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre në Bashkinë Elbasan, rezultojnë 43 subjekte që ushtrojnë aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë (në 60 pika karburanti), nga të cilat 33 pika kanë licenca me afat më të shkurtër se 5 vjet dhe me pagesa pjesore dhe 27 pika kanë licenca 5-vjeçare, ndërsa 35 subjekte për 50 pika karburanti janë të autorizuar dhe kanë paguar detyrimet sipas kërkesave ligjore dhe për 10 pika karburanti për 8 subjekte janë pa autorizim për periudha të ndryshme me një efekt financiar me vlerë totale 1,197,832 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Elbasan. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, Neni 20-Autorizimet pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 2.6, faqe 51-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Tatim Taksave të marrë masa që subjektet të pajisen menjëherë me autorizimin përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke paguar detyrimet ndaj Bashkisë Elbasan me vlerë vjetore **1,197,832 lekë** secili sipas aneksit nr. II.6.2 bashkëlidhur raportit të auditimit. Gjithashtu Drejtoria e Tatim Taksave të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet me qëllim që të kryhen pagesat e plota brenda afateve.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pagesave të kontratave të qirasë për hapsirat publike rezulton se qiramarrësi z. E.D nuk kanë paguar detyrimet e kontratës në vlerën 133,920 lekë për sipërfaqen 45 me<sup>2</sup>, cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Elbasan. Veprime në kundërshtim me Kodin Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840. Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36. VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar. VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”. VKB nr. 120 datë 29.12.2021 “Mbi miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan për vitin 2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 2.6, faqe 51-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1.Rekomandimi:** Drejtoria Tatim Taksave në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë të marrin masa dhe të ndjekin të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës **133,920 lekë** nga qiramarrësit z. E.D që nuk kanë paguar detyrimet për tokën e marrë me qira.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**8.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratave të qirave për shoqëritë të telefonisë celulare u konstatua se, nga 13 kontrata të nënshkruara më bashkinë në vlerën 2,293,750 lekë, kanë likuiduar detyrimet 11 kontrata në vlerën 1,748,750 lekë si dhe nuk kanë kryer pagesën 2 subjekte në vlerën 545,000 lekë për vitin 2022 e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Elbasan. Paraqitur në formë tabele në aneksin nr. 4 pika 2.6 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. VKM nr.1064 datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të këshillit të ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave". *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 2.6, faqe 51-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1.Rekomandimi:** Nga Bashkia Elbasan si dhe nga Drejtoria e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinarisë dhe Mjedisit, të merren masa që të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimit të prapambetur për tarifën e qerasë prej **545,000 lekë** nga operatori V. sh.a.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **D. MASA DISIPLINORE**

**Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil apo për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.**

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Elbasan**, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për punonjësit, si më poshtë:

**1. Z. Q.T**, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës.

**2. Znj. A.M**, me detyrë Drejtor Drejtorie në Drejtorine e Përgjithshme të Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës.

### **Për shkeljet e konstatuara**

Në mos zbatimin e kërkesave të ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, 2 dhe 3 të raportin përfundimtar të auditimit).

**3. Znj. E.T**, me detyrë Drejtor Drejtorie në Drejtorine e Administratës dhe Burimeve Njerëzore.

### **Për shkeljet e konstatuara**

Në mos zbatimin e kërkesave të ligji nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin” dhe Manualit MFK lidhur me strukturat organizative, politikat dhe praktikat që lidhen menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore; të VKM nr. 117 dt. 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” Lidhja 1 e 2 etj. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1 të raportin përfundimtar të auditimit).

**4. Z. K.Ç**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave, Tarifave Vendore.

**5. Z. F.D**, agjent parkimi, përgjegjës për tërheqjen dhe dorëzimin nga arka për biletat e parkimit.

### **Për shkeljet e konstatuara**

Në mos zbatimin e kërkesave të ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 93 “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë” neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2 të raportin përfundimtar të auditimit).

**6. Z. T.S**, me detyrë Drejtor në Drejtorine e Politikave të Shërbimit Urban.

**7. Z. S.B**, me detyrë Specialist në Sektorin e Hartimit të Analizave dhe Monitorimit të Shërbimeve Urbane, në cilësinë e supervizorit të pastrimit.

**8. Z. I.Sh**, me detyrë Specialist në Sektorin e Hartimit të Analizave dhe Monitorimit të Shërbimeve Urbane, në cilësinë e supervizorit të pastrimit, supervizor i pastrimit.



**9. Z. B.L**, me detyrë Specialist në Sektorin e parandalimit dhe mbulimit në terren të emergjencave Civile, në cilësinë e supervisorit të pastrimit.

#### **Për shkeljet e konstatuara**

Në mos zbatimin e kërkesave të ligji nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane" dhe me VKM 319, datë 31.05.2018 "Për miratimin masave për koston menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane". (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 të raportin përfundimtar të auditimit).

**10. Znj A.S**, me detyrë Drejtor Drejtorie në Drejtorin e Aseteve dhe Strehimit.

**11. Z. G.P**, me detyrë Përgjegjës në Sektorin e Pronave.

**12. Znj. A.B**, me detyrë Specialiste në Sektorin e Pronave.

**13. Znj. A.P**, me detyrë Specialiste në Sektorin e Pronave.

#### **Për shkeljet e konstatuara**

Në procesin e regjistrimit të asetëve paluajtshme Bashkisë Elbasan, pasi nuk ka pajisur me certifikate pronësie 10,086 prona të peregjistruara deri me 31.12.2022, pranë ASHK, në kundërshtim me ligjin 20/20 "Për Kadastrën". (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 të raportin përfundimtar të auditimit).

**14. Z. O.K**, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Prokurimeve Publike.

**15. Z. A.B**, me detyrë Përgjegjës në Sektorin e Projektimit Inxhinierik dhe Arkitektonik.

**16. Z. E.S**, me detyrë Përgjegjës në Drejtorinë e Prokurimeve Publike.

#### **Për shkeljet e konstatuara**

Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, apo shërbejnë edhe si pengesë për konkurrencën e hapur, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; sipas përcaktimeve të pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 të raportin përfundimtar të auditimit).

**17. Z. K.L**, me detyrë Drejtor në Qendrën e Artit.

**18. Z. K.H**, me detyrë Specialistë në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

**19. Z. Y.K**, me detyrë Përgjegjës në Qendrën Ekonomike.

#### **Për shkeljet e konstatuara**

Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, në vlerësimin dhe shpallje fituese të ofertës e cila për devijime të vogla nuk plotësojnë kriteret në kërkesat kualifikuese, ndërsa duhej të ishin skualifikuar dhe KVO duhej ti kishte rekomanduar titullarit anulimin e procedurave të prokurimit, për arsye se asnjë nga operatorët ekonomik pjesëmarrës nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 të raportin përfundimtar të auditimit).

**20. Znj. A.M**, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

#### **Për shkeljet e konstatuara**

- Në cilësinë e Drejtorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për mos zbatim të kërkesave të ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar si dhe V.K.M.-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të

ndryshuar me V.K.M.-në nr. 271 datë 06.04.2016 “Për një ndryshim në V.K.M.-në nr. 408 datë 13.05.2015” Në miratimin e lejeve të ndërtimit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 dhe 6 të raportin përfundimtar të auditimit).

#### **E. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.**

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara ekzistojnë, pasi personat nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e masës disiplinore znj. O.D me detyrë ish/Kryeinspektore e Inspektorati kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, z. A. Z. me detyrë ish/Kryeinspektore e Inspektorati kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, për moszbatim të detyrave të përcaktuara në VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”.

#### **F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL**

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Elbasan pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

**b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

**Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.**

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

